ALESSANDRO SIMONI
SOKOL SADUSHI
SOKOL ÇOMO

VËSHTRIM KRAHASUES MBI PROCEDURËN CIVILE

Redaktor gjuhësor: Marie Mata

Redaktor shkencor: Sokol Sadushi & Sokol Çomo

Ky botim u realizua nga Justice Reform International në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në kuadrin e Kredisë së Bankës Botërore "Për reformën në drejtësi"

© Copyright: Shkolla e Magjistraturës

Përshëndetje

Të dashur kolegë lexues,

Shkolla e Magjistraturës u krijua në vitin 1996 si institucioni përgjegjës për trainimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke ndjekur modelet më të avancuara të institucioneve të ngjashme në Evropë.

Për një kohë relativisht të shkurtër ajo ka zenë vend si një aktore energjike në procesin e reformës ligjore e gjyqësore në Shqipëri, pasi një institucion trainimi me nivel të lartë është parakusht i rëndësishëm për një drejtësi që plotëson standardet e kërkuara nga një shoqëri e zhvilluar demokratike.

Misioni i shkollës sonë nuk do të mund të realizohej në rast se pjesë e procesit të trainimit dhe edukimit ligjor nuk do të ishte edhe botimi i teksteve të së drejtës dhe të jurisprudencës.

Projekti i Bankës Botërore për botimin e këtij cikli me gjashtë libra është një kontribut i rëndësishëm në këtë drejtim. Botimet janë në fushat e mëposhtme: administrimi i gjykatave, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi, e drejta ndërkombëtare private, pronësia intelektuale, falimentimi dhe procedura civile.

Secili prej librave ka tri autorë, të cilët janë përzgjedhur me kujdes – një ekspert ndërkombëtar i njohur në fushën përkatëse, një pedagog i lëndës në Shkollën e Magjistraturës, një ekspert shqiptar nga praktika.

Kontribut të pakrahasueshëm e të rëndësishëm në këtë botim kanë dhënë zoti Larry Tamam, drejtor i konsorciumit ndërkombëtar Justice Reform International dhe bashkëpunëtorja e tij shqiptare, zonja Tefta Zaka.

Dëshiroj shumë që këto botime t'u përgjigjen pritshmërive tuaja në fushat përkatëse.

Uroj e shpresoj që botime të tjera do të vijojnë.

Lexim të mbarë!

Arjana Fullani

PËRMBAJTJA

KREU I PARË 11
INTERPRETIMI I LIGJEVE 11
a – Objektivat mësimorë 11
b – Materialet referuese kryesore 11
1. Kodi civil francez i vitit 1804 12
2. Kodi civil austriak i vitit 1811 12
3. Kodi civil italian i vitit 1942 – dispozita paraprake të kodit civil 12
4. Dispozitat që përmban legjislacioni shqiptar për interpretimin e ligjeve .. 13
5. Mënyrat e interpretimit të ligjit 16
5.1. Interpretimi me analogji *17*
5.2. Interpretimi a contrario *19*
5.3. Interpretimi sipas qëllimit të ligjvënësit *22*
c – Lexime plotësuese 26
PJESA 1 27
1. Kompetenca ligjbërëse e gjyqtarëve dhe kufizimet e saj 27
2. Interpretimi kundrejt ligjbërjes 28
3. Shkallët e ndryshme të krijueshmërisë gjyqësore: kufizimet materiale 29
4. Ligjbërja gjyqësore dhe legjislacioni: mënyrat e ndryshme të të dyja proceseve 31
PJESA 2 35
1. Të drejtat themelore dhe rëndësia e tyre për interpretimin e ligjit procedural . 35
2. Kushtetuta italiane 35
3. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 37
4. E drejta për ankim efektiv dhe proces të rregullt 37
5. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas legjislacionit shqiptar 39
d – Çështje për diskutim 44
1. Interpretimi dhe zbatimi – Interpretimi: Çfarë është? 44
2. Ligji dhe fakti 47
3. Interpretimi dhe zbatimi 51
4. Trajtimi i normave ligjore 52
5. Kush interpreton? 54

6. Krijuesit e normave dhe interpretuesit e normave 60
7. Legalizmi 62
8. Hapësirat vepruese për interpretimin dhe zbatimin 64
e – Fjalori terminologjik 66
f – Udhëzime praktike 67

KREU I DYTË 69
PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS CIVILE 69
- PARIMI I INICIATIVËS SË PALËVE 69
- PARIMI I "KONTRADIKTORITETIT" 69
- OBJEKTI I MOSMARRËVESHJES DHE NDRYSHIMI I TIJ 69
a – Objektivat mësimorë 69
b – Materialet referuese kryesore 69
1. Nenet 1 – 30 të Kodit shqiptar të Procedurës Civile – Parimet themelore të procesit gjyqësor 70
2. Parimi i iniciativës së palëve 75
3. Parimi i iniciativës së palëve sipas legjislacionit shqiptar 79
a) Rasti i parë *83*
b) Rasti i dytë *85*
c) Rasti i tretë *87*
4. Roli i gjykatës gjatë procesit 87
5. Parimi i "kontradiktoritetit" 89
6. Parimi i "kontradiktoritetit" sipas legjislacionit shqiptar 91
7. Për identifikimin dhe ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes – shkurtimisht, për bashkimin e palëve të treta 95
8. Identifikimi dhe ndryshimi i objektit të mosmarrëveshjes sipas legjislacionit shqiptar 98
c – Çështje për diskutim 100
d – Lexime plotësuese 103
e – Bibliografi 103
f – Fjalori terminologjik 104
g – Udhëzime praktike 105

KREU I TRETË 108
PARIME TË PËRGJITHSHME 108
- KONCEPTI I PADISË 108
- KONCEPTI I JURIDIKSIONIT 108
- KONCEPTI I KOMPETENCËS 108
a – Objektivat mësimorë 108

b – Materialet referuese kryesore 108
1. Padia 108
2. Kuptimi i padisë sipas legjislacionit shqiptar 111
3. Kërkesat procedurale 113
4. Kërkesat procedurale sipas legjislacionit shqiptar 117
4.1. Zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor 118
4.2. Zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor sipas legjislacionit shqiptar 120
4.3. Interesi ligjor 122
4.4. Abuzimi me të drejtat procedurale 125
5. Juridiksioni 126
6. Juridiksioni sipas legjislacionit shqiptar 131
7. Kompetenca 135
8. Kompetenca sipas legjislacionit shqiptar 138
a) Kompetenca lëndore *138*
b) Kompetenca tokësore *139*
9. Veprimet e gjykatave në lidhje me kompetencën. Konfliktet e kompetencës 141
c – Çështje për diskutim 142
d – Lexime plotësuese 145
e – Bibliografi 145
f – Fjalori terminologjik 145
g – Udhëzime praktike 146

KREU I KATËRT 148
- AVOKATËT 148
- NGARKIMI I SHPENZIMEVE GJYQËSORE 148
a – Objektivat mësimorë 148
b – Materialet referuese kryesore 148
Për avokatët 148
1. Kodi shqiptar i Procedurës Civile, nenet 84 - 101 148
2. Ligji për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë 161
3. Ngarkimi i shpenzimeve gjyqësore 180
4. Shpenzimet gjyqësore sipas legjislacionit shqiptar 186
c – Çështje për diskutim 192
d – Lexime plotësuese 193
Kodi i Sjelljes për Avokatët në Komunitetin Europian *193*
e – Bibliografi 205
f – Fjalori terminologjik 205

KREU I PESTË 207
E DREJTA E PROVAVE 207
a – Objektivat mësimorë 207
b – Materialet referuese kryesore 207
1. Kuptimi i së drejtës së provave – parime të përgjithshme 207
2. Dëshmitarët 210
2.1. Përdorimi i provës me dëshmitarë kur janë të disponueshme edhe provat shkresore 210
2.2. Personat që nuk mund të pyeten si dëshmitarë 214
2.3. Marrja në pyetje e dëshmitarëve: marrja në pyetje nga gjykata dhe pyetja e kryqëzuar e dëshmitarëve 217
3. Dëshmitarët sipas legjislacionit shqiptar 223
3.1. Thirrja dhe deklarimet e dëshmitarëve 224
3.2. Vlerësimi i deklarimeve të dëshmitarëve 226
4. Provat shkresore 231
4.1. Paraqitja e shkresave në procesin civil 231
4.2. Dokumentet zyrtare dhe dokumentet private 233
5. Provat shkresore sipas legjislacionit shqiptar 234
5.1. Fuqia provuese e shkresave 237
5.2. Mënyra e paraqitjes dhe e kërkimit të provave shkresore 238
5.3. Kundërshtimi i vërtetësisë së provave shkresore 240
5.4. Kundërshtimi për falsitet 241
6. Prova e ekspertit 243
6.1. Caktimi i ekspertëve të gjykatës dhe kërkesat që duhet të përmbushë ekspertiza 243
6.2. Opinione krahasuese për provën e ekspertit 244
7. Eksperti sipas legjislacionit shqiptar 246
7.1. Koncepti dhe llojet e ekspertimit 246
7.2. Natyra juridike e ekspertimit gjyqësor 246
7.3. Subjekti i ekspertimit 247
7.4. Objekti i ekspertimit 247
7.5. Caktimi i ekspertimit dhe i ekspertëve 248
7.6. Kryerja e ekspertimit dhe mendimi i ekspertëve 249
7.7. Çmuarja e ekspertimit 250
8. Prova të tjera 251
8.1. Pohimi civil 251
8.2. Betimi civil 251
9. Shpjegimet e palëve dhe pohimi sipas legjislacionit shqiptar 253
9.1. Ndërpyetjet e palëve (pohimet e palëve) 255

10. Prezumimet dhe provat e tërthorta 256
11. Prezumimet sipas legjislacionit shqiptar 256
c – Çështje për diskutim 257
d – Lexime plotësuese dhe bibliografi 258
e – Fjalori terminologjik 259
f – Udhëzime praktike 260

KREU I GJASHTË 261
VENDIMET 261
a – Objektivat mësimorë 261
b – Materialet referuese kryesore 261
1. Dhënia e vendimeve 261
2. Llojet e ndryshme të vendimeve 266
3. Llojet e vendimeve që parashikon legjislacioni shqiptar 267
3.1. Vendimet e ndërmjetme 267
3.2. Vendimet përfundimtare 269
3.3. Vendimet jopërfundimtare 272
3.3.1. Efektet juridike të pushimit të gjykimit 273
4. Vendimet e formës së prerë 274
5. Efekti *res judicata* (gjëja e gjykuar) 275
6. Gjëja e gjykuar sipas legjislacionit shqiptar 277
a) Identiteti i palëve *278*
b) Identiteti në objekt *278*
c) Identiteti i shkakut *278*
7. Efekte të tjera të vendimeve 278
8. Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat 279
I. Krahasimi i domosdoshëm *282*
II. Normat ligjore me elementë ndërkombëtarë *283*
III. Normat ligjore me natyrë krejtësisht kombëtare *287*
9. Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat shqiptare 289
10. Struktura e vendimit dhe roli i gjyqtarit 294
c – Çështje për diskutim 296
d – Lexime plotësuese dhe bibliografi 298
e – Fjalori terminologjik 298
f – Udhëzime praktike 299

KREU I SHTATË 300
EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM 300
a – Objektivat mësimorë 300

b – Materialet referuese kryesore 300
PJESA 1 300
1. Ekzekutimi i detyrueshëm: një vështrim krahasues i procedurave të ekzekutimit në sistemet ligjore europiane më kryesore 300
2. Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm: titulli ekzeutiv . 306
3. Detyrueshmëria provizore e vendimeve gjyqësore 307
4. Kërkesa të tjera për ekzekutimin e vendimeve 311
5. Ekzekutimi i detyrueshëm në të holla 315
6. Etapat në procedurat e likuidimit 318
7. Ekzekutimet specifike: ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar dhe ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar .. 319
PJESA 2 321
1. Ekzekutimi i detyrueshëm sipas legjislacionit shqiptar 321
1.1. Objekti i ekzekutimit 323
2. Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë dhe juridikë 325
2.1. Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme 325
2.2. Veprimet e shitjes së sendeve të luajtshme të sekuestruara 326
3. Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme 330
3.1. Veprimet e shitjes së sendeve të paluajtshme 331
4. Ekzekutimi mbi mjetet e lundrimit 333
5. Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet për të cilat personat e tretë i detyrohen debitorit 333
6. Ekzekutimi mbi pagën e debitorit 335
7. Ekzekutimi i kërkuar nga shumë kreditorë 336
8. Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore .. 337
9. Ekzekutimi mbi shumat e llogarive në banka 337
10. Ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar 338
11. Ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar 340
12. Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit 341
12.1. Kundërshtimi i vlefshmërisë së titullit ekzekutiv 341
12.2. Ankimi kundër veprimeve rë përmbaruesit gjyqësor nga palët 342
12.3. Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nga personat e tretë 343
13. Pezullimi dhe pushimi i ekzekutimit 345
14. Parashkrimi i titujve ekzekutivë 346
c – Çështje për diskutim 347
d – Lexime plotësuese dhe bibliografi 349
e – Fjalori terminologjik 349
f – Udhëzime praktike 350

KREU I PARË

INTERPRETIMI I LIGJEVE

a – OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet:

- të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e ndërtimit të argumenteve që mbështetin kuptimin e normave ligjore;
- të njohin dispozitat më të rëndësishme për interpretimin e ligjeve që ekzistojnë në sistemet ligjore të cilat i përkasin traditës të së drejtës kontinentale;
- të njohin dhe të administrojnë teknikat kryesore të interpretimit të ligjeve;
- të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e standardeve ndërkombëtare të procesit të rregullt gjyqësor në interpretimin e normave procedurale;
- të jenë të vetëdijshëm për vështirësitë që lidhen me modelet e interpretimit, të cilat mund të perceptohen edhe si ligjbërje nga gjyqësori;
- të jenë në gjendje të argumentojnë si duhet identifikimin e fushës së veprimit dhe kuptimin e normave procedurale.

b – MATERIALET REFERUESE KRYESORE

Shënim i autorit: *Jo të gjitha sistemet ligjore të zonës ku vepron e drejta kontinentale kanë parashikuar rregulla legjislative për interpretimin e ligjeve. Në disa vende, si p.sh. në Gjermani, doktrina lidhur me ndërhyrjet e ligjvënësit në fushën e interpretimit të ligjeve ka qenë tradicionalisht shumë skeptike. Pavarësisht nga kjo gjë, disa prej kodifikimeve më të rendësishme të së drejtës civile përmbajnë dispozita të rëndësishme për interpretimin e ligjeve, si edhe për kufizimin e kompetencës ligjbërëse të gjykatës*

1. Kodi civil francez i vitit 1804

Neni 4 Gjyqtari, i cili refuzon të japë vendimin nën pretekstin e heshtjes, të paqartësisë apo të pamjaftueshmërisë së ligjit, i nënshtrohet procedimit me akuzën e qenies fajtor për refuzimin e dhënies së drejtësisë.

Neni 5 Gjyqtarët ndalohen të prononcohen për zgjidhjet ligjore të çështjeve që kanë në shqyrtim.

Shënim i autorit: *Dispozitat e Kodit civil francez kanë një nënndarje tepër të qartë ndërmjet hapësirave të ligjvënësit dhe të gjyqtarit, e cila është edhe themeli i doktrinës moderne të ndarjes së pushteteve. Kodi austriak, i cili ka hyrë në fuqi disa vite më vonë, përmban udhëzime shumë më të hollësishme që i japin mundësi për interpretuesit për diskrecion më të gjerë. Megjithatë, gjyqtarët kanë hezituar gjithmonë të jenë krijues në mbështetje të këtij autorizimi, duke parapëlqyer të operojnë sipas teknikave tradicionale.*

2. Kodi civil austriak i vitit 1811

Neni 6 Gjatë zbatimit të ligjit, atij nuk mund t'i bëhet asnjë interpretim tjetër, përveç interpretimit që del qartë nga kuptimi i mirëfilltë i fjalëve, në kontekstin që janë përdorur dhe nga qëllimi evident i ligjvënësit.

Neni 7 Kur një çështje nuk mund të zgjidhet në bazë të fjalëve ose të kuptimit të mirëfilltë të ligjit, gjyqtari duhet të mbështetet në zgjidhjet e parashikuara nga ligjet e tjera për çështje të ngjashme, si dhe në arsyetimet që kanë mbështetur hartimin e këtyre ligjeve. Nëse çështja mbetet ende e dyshimtë, ajo duhet të zgjidhet nga gjyqtari duke zbatuar parimin e së drejtës natyrore, si dhe duke u mbështetur në faktet e çështjes, të grumbulluara sipas rregullave dhe të vlerësuara me kujdes.

Shënim i autorit: *Stili austriak pati ndikim edhe mbi të drejtën italiane, në Kodin civil të vitit 1865 dhe në kodifikimin e vitit 1942 që vazhdon të jetë ende në fuqi, i cili, në dispozitat e tij paraprake, përmban edhe rregulla për interpretimin. Duke ndjekur një qëndrim edhe më pozitivist, Kodi italian i vitit 1865 ka përmendur frazën "parimet e përgjithshme të së drejtës" në vend të frazës "parimet e së drejtës natyrore", të përmendur në Kodin austriak. Më vonë, Kodi i vitit 1942 solli një modernizim të mëtejshëm duke i'u referuar "parimeve të përgjithshme të rendit ligjor të shtetit".*

3. Kodi civil italian i vitit 1942 – Dispozitat paraprake të kodit civil

Neni 12 Në interpretimin e ligjit, atij nuk mund t'i jepet asnjë kuptim

tjetër përveç kuptimit që del qartë nga domethënia e tij aktuale, e parë kjo edhe nga këndvështrimi i lidhjeve që ligjet kanë me njëri- tjetrin, si dhe nga qëllimi i ligjvënësit.

Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet me një dispozitë specifike, merren në konsideratë dispozita të tjera që rregullojnë çështje të ngjashme ose analoge; nëse çështja mbetet ende e dyshimtë, vendoset në përputhje me parimet e përgjithshme të rendit ligjor të shtetit.

4. Dispozitat që përmban legjislacioni shqiptar për interpretimin e ligjeve

Legjislacioni procedural civil shqiptar nuk përmban në mënyrë të detajuar dispozita të përgjithshme që të parashikojnë metodat e interpretimit të ligjeve. Përgjithësisht, nuk është në natyrën e legjislacionit tonë të parashikojë hollësisht rregullat dhe mënyrat e interpretimit të ligjeve. Gjykata e bën interpretimin e ligjit duke u nisur kryesisht nga parimet e përgjithshme, të cilat gjejnë referencën e tyre në doktrinën juridike.

Sidoqoftë, në Kodin e procedurës civile gjenden pak dispozita që japin një kuptim të përgjithshëm për mënyrën si duhet të veprojë gjykata në raste të mangësive, të paqartësive ose të kundërshtive të ligjeve dhe të dispozitave ligjore me njëra-tjetrën. Vendimet gjyqësore, ku vendin kryesor e zenë vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë rolin e tyre përcaktues në orientimin e gjykatave për të interpretuar drejt ligjet. Megjithatë, interpretimi i ligjit për të arritur në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes mbetet detyrë e çdo gjyqtari dhe jo vetëm e gjykatave më të larta.

Në nenin 1, paragrafi i dytë, të Kodit të Procedurës Civile thuhet:

"Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë".

Kjo është e vetmja dispozitë procedurale që gjendet në Kodin e procedurës civile, mbi bazën e së cilës gjykata detyrohet të shprehet për zgjidhjen e çështjes, për të realizuar funksionin e saj kryesor, atë të dhënies së drejtësisë.

Kjo dispozitë i krijon mundësinë gjykatës që, në raste të tilla, të bëhet interpretuesi i ligjit apo i normës konkrete juridike, mbi bazën e së cilës merr zgjidhje çështja konkrete.

Shënim i autorit. *Mendojmë që është i nevojshëm një trajtim teorik i kuptimit të interpretimit të ligjit në aspektin doktrinar, për të orientuar studentët fillimisht mbi përmbajtjen e kapitullit të parë.*

Interpretimi gjyqësor është interpretim i ligjit që bën gjykata kur zgjidh çështjen gjyqësore konkrete në të cilën zbatohet ky ligj. Interpretimi gjyqësor shprehet në vendimin e gjykatës dhe është i detyrueshëm vetëm për atë çështje për të cilën është marrë vendimi. Interpretimi gjyqësor është një lloj i veçantë i interpretimit të ligjit, sepse vendimi i gjykatës që ka marrë formën e prerë, merr fuqi ligjore, d.m.th., po atë karakter detyrues që ka edhe ligji. Prandaj interpretimi gjyqësor nuk mund të identifikohet me interpretimin që bën çdo organ administrativ ose person zyrtar sa herë që udhëhiqen prej ligjit, sa herë që e zbatojnë ligjin.

Interpretimi i normës juridike nga gjykata kryhet në kontekstin e kazusit ose rastit të dhënë. Duke iu referuar rastit konkret nën rishikim, interpretimi mund të përfshijë në kuptimin e tij të gjitha bazat, arsyet e rëndësishme ligjore dhe arsyet e shoqëruara me përmbajtjen sociale dhe boshtin logjik.

Në vendimet për interpretimin e normës juridike, gjykata zbërthen dyshimet interpretuese të prezantuara tek ajo. Kjo do të thotë se, si rezultat i formulimeve të paqarta, të pasakta ose të paplota të dispozitave, interpretuesi dhe zbatuesi ka ose mund të ketë vështirësi në njohjen e kuptimit aktual të normës ligjore. Gjykata, kur interpreton dispozitat, merr në konsideratë sistemin e tyre linguistik, përmbajtjen sociale dhe boshtin logjik, si dhe qëllimin e dispozitës.

Gjykata është e detyruar, veçanërisht në kontekstin e sistemit, të ketë në konsideratë dispozitat kushtetuese dhe normat e tjera ligjore, të cilat referojnë në vlerat nga të cilat shoqëria udhëhiqet dhe që në hierarkinë e normave qëndrojnë mbi dispozitat e tjera. Gjykata është e detyruar të marrë në konsideratë vlerat, të cilat nuk janë dhënë qartë drejtpërdrejt në dispozitat ligjore, kur ato interpretohen.

Në këtë mënyrë gjykata jep një ndihmesë domethënëse për të arsyetuar kuptimin e rregullt të dispozitave të ligjit në të gjithë legjislacionin dhe në ndërgjegjësimin shoqëror. Sipas rregullave të së drejtës, në një shtet të krijuar mbi ndarjen e pushteteve dhe në aspektin e pavarësisë së gjyqësorit, interpretimi gjyqësor operativ është një komponent i domosdoshëm i procesit gjyqësor për zbatimin e ligjit.

Mënyra dhe motivet mbi të cilat ngrihet çështja para gjykatës, kanë të bëjnë me një dispozitë ligjore, interpretimi i së cilës kërkohet. Për këtë, paraprakisht, duhet të nxirret norma nga teksti legjislativ në mënyrë interpretuese. Me fjalë të tjera, pala në gjykim (ose gjykatesi *ex officio*) merr nga teksti legjislativ normën, e cila duhet të interpretohet.

Prandaj gjykata është e ngarkuar për të gjykuar për mënyrën dhe motivet mbi të cilat është ngritur çështja, që do të thotë se duhet të vendosë të interpretojë normën. Vecse, në këtë rast, gjykata duhet të rinterpretojë tekstin

legjislativ. Kështu, gjykata mund të nxjerrë nga teksti legjislativ jo të njëjtën normë, por një normë tjetër (çka edhe mund të ketë ndodhur, sidomos aty ku shikon mënyrën ndonjëherë të dykuptimtë, shumëkuptimëshe, të errët në të cilën janë formuluar tekstet legjislative). Për të konkretizuar këtë ide vlen të citohet vendimi nr. 14, datë 16.2.2001, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin njësohet praktika gjyqësore në lidhje me fillimin e afatit të rekursit kundër vendimit të dhënë në mungesë të palës që ushtron rekursin, d.m.th., nëse rekursi mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit apo brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit. Në këtë vendim, ndërmjet të tjerave, arsyetohet: *"Ndërsa neni 444 i Kodit të procedurës civile parashikon se afatet e ankimit fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar, neni 148/1 i po këtij Kodi parashikon se, kur afati është përcaktuar me ditë..., përjashtohet dita... në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloje afati, d.m.th. afati fillon të llogaritet nga dita e nesërme. Në këtë rast ndeshja midis dy dispozitave është evidente. Ndërsa neni 444, në paragrafin e parë të tij, parashikon se, kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, në mungesë të njërës palë, afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Pra, kjo dispozitë parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e gjykatës së shkallës së parë për t'i njoftuar vendimin palës që ka qenë në mungesë, ndërsa hesht për gjykatën e apelit... Janë pikërisht mungesat, paqartësitë e kundërthëniet e dispozitave procedurale të cituara më lart, arsyet që imponojnë arritjen e interpretimit të njësuar në bazë të analizës e të përfundimeve të parashtruara "*.

Gjyqtari duhet të ketë kujdes të mos krijojë nëpërmjet interpretimit një normë të re ligjore. Interpretimi që bën gjykata, nuk është dhe nuk mund të jetë krijim i normave ligjore. Ajo jep kuptimin e saktë të rregullt të normave ligjore, të shprehura në dispozitat ligjore në pajtim me parimet kushtetuese, ndërkohë që zbaton rregullat e interpretimit të pranuara në një kulturë ligjore të përfshirë në rregullat demokratike të ligjit.

Në interpretim, gjykata nuk shkon më tutje dhe nuk shton asgjë në sistemin e normave detyruese ligjore. Ajo vetëm shpall, pohon përmbajtjen e këtyre normave. Kështu, interpretimi i kryer nga gjykata ka vetëm karakter "deklarativ" dhe jo natyrë ligjbërëse. Pushtetet e ndara kushtetuese e detyrojnë atë të bëjë kështu, duke e përjashtuar nga roli i ligjbërësit. Ky qëndrim vihet re në shumë vendime njësuese të Gjykatës së Lartë, si dhe në disa vendime për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, që ka kryer Gjykata Kushtetuese.

Për konkretizim, po përmendim qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, të cilat vlejnë edhe për çështjen që po flasim. Në mënyrë të argumentuar analizohet ky koncept doktrinar, sidomos në vendimin nr. 75, datë 19.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese, ku ajo interpreton nenet 128, 140 dhe 149 të Kushtetutës, duke arsyetuar në këtë mënyrë: *"Për*

interpretimin e këtyre normave, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të kryejë rolin e ligjvënësit pozitiv, duke parashikuar një për një të gjitha rastet që mund të përfshihen në këto shkaqe kushtetuese, sepse do të ishte e pamundur një gjë e tillë, ndërkohë që Kushtetuta, ligjet apo edhe vendimet gjyqësore nuk mund të kodifikojnë me saktësi aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit a prokurorit, apo rastet se kur ligji është shkelur rëndë. Interpretimi që Gjykata Kushtetuese u bën dispozitave apo termave konkretë të Kushtetutës, ka për qëllim të japë dhe të përcaktojë në mënyrë analitike kriteret, konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë si dhe të Prokurorit të Përgjithshëm".

Në vendimin njësues nr. 10, datë 24.3.2004, pyetjes së shtruar se cilat janë disa nga "masat e tjera të përshtatshme" që merren nga gjykata për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206, shkronja "b", të Kodit të procedurës civile, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i përgjigjen me shumë kujdes për të mos arritur në interpretime të tilla që sjellin krijimin e normave të reja juridike. *"Llojet e tjera të masave të sigurimit të padisë, sipas parashikimit të pikës "b" të nenit 206 të Kodit të procedurës civile, përveç masës së pezullimit të ekzekutimit, janë të papërcaktuara në mënyrë konkrete. Kjo do të thotë se gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por, në të njëjtën kohë, pa rrezikuar mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të të paditurit"*[1].

5. Mënyrat e interpretimit të ligjit

Shënim i autorit. *Në këtë pjesë mendohet të trajtohen tri llojet e interpretimeve mbi bazën e rasteve të shkëputura nga praktika gjyqësore shqiptare. Për secilin nga llojet e interpretimeve është dhënë një kuptim duke u shoqëruar me rastin praktik.*

Ligji duhet të jetë i qartë, por në realitet ndodh që edhe të mos jetë i tillë. Interpretuesi, sidomos gjyqtari, nëpërmjet interpretimit, është i detyruar të zgjidhë çdo paqartësi që i paraqitet, për ta bërë ligjin sa më të kuptueshëm. Gjykata bën një interpretim jurisprudencial dhe të qëndrueshëm për t'i dhënë normës legjislative vlerën e saj konkrete dhe pa pasur për qëllim të zëvendësojë ligjvënësin. Ligjit nuk duhet t'i jepet tjetër kuptim, veç kuptimit që rezulton qartas në të.

1) Vendimi nr 10, datë 24.3.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në të vërtetë, ligji nuk na jep ndonjë normë interpretimi. Doktrina përcakton disa mënyra interpretimi. Njihen disa lloje interpretimesh, si: interpretimi deklarativ, restriktiv (kufizues), ekstensiv (zgjerues)[2], shfuqizues,[3] interpretimi me analogji, a contrario (argumentin për të kundërtën) etj. Njëkohësisht, gjatë interpretimit të ligjeve, duhet kërkuar edhe *ratio legis* (qëllimi i ligjvënësit).

Siç shihet, ka shumë mënyra për interpretimin e ligjit. Dhe nuk janë vetëm këto. Nga të gjitha këto mënyra interpretimi të ligjit, na intereson të trajtojmë mënyrat kryesore të interpretimit që gjykata i bën ligjit për shkak të zgjidhjes së çështjeve konkrete. Ato janë:

a) interpretimi me analogji,
b) interpretimi i kundërt (a contrario),
c) interpretimi sipas qëllimit të ligjvënësit.

Le t'i shohim me radhë.

5.1. *Interpretimi me analogji*

Rregulla e parashikuar në nenin 1, paragrafi i dytë, të Kodit të procedurës civile, sipas së cilës gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë, e detyron atë njëkohësisht të realizojë një mënyrë interpretimi tjetër të ligjit, që është ajo me analogji.

Interpretimi me analogji kryhet në ato raste kur, gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete, gjykata konstaton se ligji nuk parashikon ndonjë rregull të caktuar për zgjidhjen e saj. Meqenëse gjykata, për shkak të ometimit ligjor, nuk mund ta refuzojë zgjidhjen e çështjes, ajo detyrohet të bazohet në një ligj apo normë tjetër juridike që parashikon një rast të ngjashëm apo të përafërt me rastin në shqyrtim.

Interpretimi me analogji që i bën gjykata një rasti në shqyrtim, nuk duhet ngatërruar me interpretimin zgjerues të tij. Këto mënyra interpretimi janë të

2) Në qoftë se një normë e ligjit ka kuptimin e ngushtë (kufizues), por, njëkohësisht, ka edhe kuptimin e gjerë (zgjerues), atëherë, si kuptim i saktë i saj, do të merret kuptimi i ngushtë, për arsye se ky kuptim përfshihet medoemos, ndërsa kuptimi i gjerë është i mundshëm.

3) Në qoftë se me gjithë interpretimin e normës, ligji mbetet i errët a i paqartë, ose kuptimi që del, ndryshon nga përmbajtja e vërtetë, pra nuk ka lidhje me të, apo rezultati që del, është i pakuptueshëm, jologjik, atëherë kjo dispozitë konsiderohet si e paqenë. Kjo përbën interpretimin abrogativ ose shfuqizues, që është një metodë e cila përdoret gjatë kontrollit të kushtetutshmërisë së normës ose gjatë inicimit nga gjyqtari të një gjykimi të tillë kushtetues.

ndryshme. Ndryshimi ndërmjet tyre qëndron, sepse, kur zgjidhet një çështje me anë të interpretimit zgjerues, zbatohet ligji që parashikon rastin konkret në shqyrtim, ndërsa gjatë interpretimit me analogji zbatohet ligji që parashikon jo rastin konkret, por një rast tjetër analog që ngjason më tepër me të. Interpretimi me analogji nuk i shmanget ligjit, por është një mjet që siguron zbatimin e drejtë të tij. Interpretimi me analogji nuk lejohet dhe nuk bëhet kundër ligjit, por në bazë dhe për zbatim të tij. Analogjia është e përjashtuar kur rasti në shqyrtim është i parashikuar nga ligji. Sidoqoftë, edhe në rastet kur zgjidhja e çështjes në shqyrtim nuk është e parashikuar drejtpërdrejt nga ligji, gjykata duhet të orientohet nga mënyra si i zgjidh ligji rastet e tjera të po kësaj natyre, të cilat, në thelb, janë të njëjta. Interpretimi me analogji duhet të përdoret si përjashtim dhe jo si rregull.

Të shohim një rast praktik nga vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë nëpërmjet të cilit ajo është përpjekur që, në mungesë të një dispozite konkrete, të kryejë interpretimin me analogji të rastit në shqyrtim. Në vendimin nr 1029, datë 27.10.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërmjet të tjerave, arsyetojnë:

"... Kolegjet e Bashkuara, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, çmojnë se, gjersa në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me mënyrën si do të zgjidhen pasojat që rrjedhin prej ekzekutimit të një vendimi, i cili është prishur më pas me një vendim të formës së prerë, është e nevojshme që, në kuptim të nenit 314 të Kodit të procedurës civile, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr.643, datë 11.05.2000, të dhënë nga Kolegjet e Bashkuara, ta bëjnë vetë ato dhe, nëpërmjet vendimit që do të japin për këtë qëllim, të ofrojnë një zgjidhje të njësuar për rastet e ngjashme të praktikës gjyqësore, sipas këtij arsyetimi:

Në Kodin e procedurës civile të mëparshëm, në nenin 190/1 të tij, parashikohej në mënyrë të shprehur se: *"Kur vendimi i ri që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar, detyrohet të kthejë të gjitha përfitimet që ka marrë nga ekzekutimi i vendimit".* **Një dispozitë e tillë nuk ekziston më në Kodin e procedurës civile në fuqi, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet të ekzistojë një zgjidhje e tillë e problemit edhe nën këtë regjim juridik të ri.** Sipas nenit 1/1 të Kodit të procedurës civile, *"gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë".* **Pra, zgjidhja që duhet të jepet, nuk mund të jetë e ndryshme nga zgjidhja që ofrohet në dispozitën e sipërcituar të Kodit të mëparshëm të procedurës civile.** Shtrohet pyetja: **A ekziston në Kodin e procedurës civile në fuqi ndonjë dispozitë konkrete që të**

japë një zgjidhje të tillë për raste të ngjashme? Duke iu referuar nenit 319/2 të Kodit të procedurës civile, që parashikon rrjedhojat nga prishja e vendimit që është dhënë në ekzekutim të përkohshëm, **gjejmë këtë rregullim:** *"Në rast se pas prishjes së vendimit të parë padia rrëzohet dhe vendimi merr formë të prerë, gjyqfituesi i parë detyrohet t'i kthejë palës tjetër gjithçka që ka marrë me ekzekutim të përkohshëm të vendimit të parë".* **Nëpërmjet interpretimit logjik të kësaj dispozite,** arrihet në përfundimin se zgjidhja e pasojave që vijnë nga ekzekutimi i një vendimi detyrimi, i cili prishet më pas me një vendim të formës së prerë, nuk mund të jetë e ndryshme nga zgjidhja e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i përkohshëm i një vendimi që nuk ka marrë formë të prerë, i cili është prishur më pas me një vendim të formës së prerë.

Si përfundim, në të gjitha rastet kur vendimi i ri që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar, detyrohet të kthejë të gjitha përfitimet që ka marrë nga ekzekutimi i vendimit.

Kthimi i përfitimeve, si rregull, duhet të percaktohet në vendimin e ri të formës së prerë që jepet pas prishjes së vendimeve të mëparshme. Megjithatë, edhe në rastet kur në këtë vendim gjykata nuk shprehet në mënyrë të qartë për rregullimin e pasojave që kanë ardhur nga ekzekutimi tërësisht apo pjesërisht i vendimit të padrejtë, që është prishur më pas, zgjidhja në këtë mënyrë e pasojave është evidente. Zyra e përmbarimit që ka bërë ekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të vendimit të padrejtë, që është prishur më pas, me kërkesën e gjyqfitüesit, sipas procedurës që përcakton neni 511 i Kodit të procedurës civile, duhet të detyrojë përfituesin të kthejë të gjitha përfitimet e padrejta".

5.2. Interpretimi a contrario

Interpretimi a contrario është një mënyrë interpretimi që gjykata e realizon për zgjidhjen e një çështjeje në shqyrtim, duke i dhënë dispozitës ligjore kuptimin e kundërt të asaj që ajo duket se paraqet në fakt. Kjo metodë interpretimi nuk do të thotë se gjyqtari duhet të abuzojë me ligjin, por ai duhet t'i japë normës juridike atë kuptim që në të vërtetë del nga i gjithë kuptimi dhe fryma e ligjit dhe e parimeve themelore mbi të cilat është ndërtuar ai. Duke interpretuar normën juridike në kuptimin e kundërt, gjykata arrin të nxjerrë kuptimin e saktë të dispozitës konkrete, nga e cila varet zgjidhja e çështjes.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 8, datë 24.3.2005, në pikën 3 të tij, përmban një mënyrë të arsyetuari që rrjedh nga interpretimi a contrario i ligjit. *Ky rast praktik është një interpretim a contario i*

dispozitës konkrete. Megjithëse neni 498 i Kodit të procedurës civile nuk e parashikon në mënyrë të shprehur shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet interpretimit a contrario, arrijnë në përfundimin se kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji civil në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve.

Në këtë vendim, ndërmjet të tjerave, arsyetohet: *"...Për sa i përket pyetjes së tretë, nëse kërkesa për rishikim duhet të shqyrtohet nga Kolegji civil në dhomë këshillimi apo në seancë publike me pjesëmarrjen e palëve, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në këtë përfundim:*

Kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, sipas Kodit të procedurës civile, konsiderohet si mjet i posaçëm dhe i jashtëzakonshëm ankimi, krahas apelit dhe rekursit, që janë mjetet e zakonshme të ankimit.

Ndërsa nëpërmjet ushtrimit të dy mjeteve të zakonshme të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor në një gjykate më të lartë parashtrohen shkaqe që kanë të bëjnë me përmbajtjen e çështjes, nëpërmjet kërkesës për rishikim parashtrohen vetëm faktet apo rrethanat që, sipas nenit 494 të Kodit të procedurës civile, përbëjnë shkaqe ligjore për rishikimin e një vendimi të formës së prerë".

Ndërsa kur shqyrtohet një apel apo një rekurs, gjykata më e lartë, përkatësisht, gjykata e apelit apo Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, shqyrtojnë themelin e çështjes dhe vendosin për bazueshmërinë e vendimit të kundërshtuar, kur shqyrtohet një kërkesë rishikimi, Kolegji Civil vetëm vlerëson nëse kërkesa për rishikim i referohet dhe është e mbështetur në një nga rastet e përcaktuara në nenin 494 të Kodit të procedurës civile, si dhe nëse është bërë nga pala që e ka këtë të drejtë (neni 498 i K.pr.civile). Pra, kur shqyrton kërkesën për rishikim, Kolegji Civil nuk i hyn vlerësimit të bazueshmërisë së vendimit që kërkohet të rishikohet, por vetëm vlerëson nëse ka shkaqe "për të hapur rrugën" për një gjykim të ri të çështjes nga e para. Kur vendoset që kërkesa për rishikim të pranohet, Kolegji Civil nuk shprehet për pabazueshmërinë apo për paligjshmërinë e vendimit, por e prish atë për shkak të vënies në dyshim të tij për një nga shkaqet e reja të krijuara pas marrjes formë të prerë të vendimit i cili kërkohet të rishikohet. Nisur nga argumentimi i mësipërm, mospjesëmarrja e palëve nuk cenon të drejtën e tyre për një proces të rregullt gjyqesor, në themel të së cilës qëndron dhënia e mundësive të barabarta të gjitha palëve për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Respektimi i parimit kushtetues të procesit të rregullt gjyqësor zë fill në momentin që fillon gjykimi i çështjes nga e para, pas prishjes se vendimit dhe dërgimit të çështjes gjykatës kompetente.

Në të kundërt, po të pranohej thirrja e palëve dhe pjesëmarrja e tyre gjatë

shqyrtimit të kërkesës për rishikim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, dashur pa dashur, do të impononte debatin midis palëve, hyrjen e tyre dhe të gjykatës në vlerësimin e problemeve që kanë të bëjnë me themelin dhe bazueshmërinë e çështjes ose, sidoqoftë, në një vlerësim më të thellë, sesa thjesht vlerësimi i ekzistencës ose jo të shkakut të rishikimit.

Neni 498 i Kodit të procedurës civile **nuk e parashikon në mënyrë të shprehur shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve,** siç parashikonte kjo dispozite para ndryshimit, dhe neni 499, para shfuqizimit. Gjithsesi, qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë ndryshimi i mënyrës së shqyrtimit të kërkesës për rishikim, por vetëm transferimi i kompetencës nga gjykata që ka dhënë vendimin që kërkohet të rishikohet, në Gjykatën e Lartë. Në arsyetimin e mësipërm shtohet edhe fakti që dispozita e pandryshuar e nenit 499 të Kodit të procedurës civile parashikonte që rishikimi i vendimit të formës së prerë bëhej nga gjykata e shkallës së parë në dhomë këshillimi dhe jo në seancë gjyqësore publike. Edhe kjo gjykatë, nga pikëpamja ligjore, vlerësonte si edhe sot Gjykata e Lartë, nëse ekzistonte ose jo shkaku për rishikim dhe vendoste lidhur me kërkesën. Kur një procedurë e tillë i ishte përcaktuar gjykatës së shkallës së parë, tregon se vullneti i ligjvënësit nuk ka ndryshuar kur të njëjtën kompetencë (vlerësimin e kërkesës për rishikim) ia ka dhënë Gjykatës së Lartë.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin se kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Civil në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve".

Interpretimin a contrario e gjejmë edhe në një rast tjetër praktik nga vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr. 14, datë 16.2.2001, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërmjet të tjerave, arsyetojnë: *" Përfundimin e mësipërm Kolegjet e Bashkuara e nxjerrin nga analiza në tërësi e dispozitave procedurale të cituara më lart, të cilat rregullojnë afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, duke trajtuar këtë analizë në lidhje me përmbajtjen e nenit 1, paragrafi 2, të Kodit të procedurës civile. Sipas kësaj dispozite, "gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Kjo rregull është e zbatueshme jo vetëm për zgjidhjen në tërësi të një çështjeje të caktuar nga gjykata, së cilës i është paraqitur për shqyrtim, por edhe për aspekte apo probleme të veçanta të saj, si të së drejtës materiale, ashtu edhe të së drejtës procedurale. Dispozitat e Kodit të procedurës civile, të cituara më lart, të cilat rregullojnë afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, nga mënyra e formulimit të tyre, në mënyrë evidente paraqesin paplotësi, paqartësi e kundërthënie. Është detyrim kushtetues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që buron prej nenit 141/2 të Kushtetutës, për t'u dhënë këtyre dispozitave kuptimin e duhur duke*

plotësuar boshllëqet, duke qartësuar anët e errëta dhe duke shmangur kundërthëniet. Në funksion të këtij qëllimi, interpretimi i njësuar i këtyre dispozitave procedurale duhet të bëhet në mënyrën që është më e favorshme për palën që kërkon të përfitojë prej tyre. Në rastin në shqyrtim, pala që kërkon të përfitojë, është pala që ka qenë në mungesë në gjykimin në apel dhe që ka paraqitur rekurs për në Gjykatën e Lartë..."

Dhe, më tej, në vendim thuhet : " Ndërsa neni 444 i Kodit të procedurës civile parashikon se afatet e ankimit fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar, neni 148/1 i Kodit të procedurës civile parashikon se, kur afati është përcaktuar me ditë..., përjashtohet dita... në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloje afati, d.m.th. afati fillon të llogaritet nga dita e nesërme. Në këtë rast ndeshja midis dy dispozitave është evidente. Ndërsa neni 444, në paragrafin e parë të tij, parashikon se, kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë të njërës palë, afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Pra, kjo dispozitë parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e gjykatës së shkallës së parë që t'i njoftojë vendimin palës që ka qenë në mungesë, ndërsa hesht për gjykatën e apelit. **Prej interpretimit nga e kundërta (ad contrario) të dispozitës së mësipërme arrihet në përfundimin se afati i rekursit kundër vendimit të apelit edhe për palën tjetër që ka qenë në mungesë, fillon nga dita e dhënies së vendimit dhe jo nga dita e njoftimit të vendimit. Kjo është në harmoni me nenin 472, paragrafi i fundit, të Kodit të procedurës civile, por bie ndesh me nenin 476/1 të këtij Kodi.**

Janë pikërisht mungesat, paqartësitë dhe kundërthëniet e dispozitave procedurale të cituara më lart, arsyet që imponojnë arritjen e interpretimit të njësuar në bazë të analizës e përfundimeve të parashtruara".

5.3. Interpretimi sipas qëllimit të ligjvënësit

Kur dispozita ligjore nuk e jep në mënyrë të qartë kuptimin e saj, atëherë, nga metodat e interpretimit që ndiqen, gjykata mer në konsideratë qëllimin që ka pasur ligjvënësi në hartimin e dispozitës konkrete.

Interpretimi i ligjit që bën gjykata për zgjidhjen e çështjeve konkrete, orientohet kryesisht nga qëllimi i ligjvënësit. Kjo është metoda e interpretimit që konstatohet rëndom në praktikën gjyqësore, sa herë që gjyqtari kërkon të zgjidhë çështjen duke e interpretuar ligjin nëpërmjet studimit, analizës, si dhe krahasimit të dispozitave ligjore me njëra-tjetrën, por edhe me ligjet e tjera.

Në rastin praktik të mëposhtëm, evidentohet qartë qëllimi që ka pasur ligjvënësi për hartimin dhe miratimin e ligjit"Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Ky qëllim i ligjvënësit është orientimi kryesor që kanë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në interpretimin që u bënë ligjeve

të cilat krijojnë një përplasje ndërmjet tyre për zgjidhjen e konfliktit midis ish-pronarëve dhe sindikatave.

Në vendimin nr 85, datë 29.6.2001, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë thuhet: "

"1. Sa herë përplasen interesat e ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre), që përfitojnë kthimin (restitucionin) e ndërtesave të pandryshuara apo të trojeve të pazëna, sipas dispozitave të ligjit nr.7698, datë 15..1993, me interesat e sindikatave që i kanë fituar këto ndërtesa apo troje, sipas dekretit nr.204, datë 5.6.1992, pasojat e të cilit janë rregulluar me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998, përparësi ka mbrojtja e interesave të ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre).

2. Ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998, "Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992, "Për pasurinë e sindikatave"", është i zbatueshëm për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Edhe sikur dekreti nr.204, datë 5.6.1992, "Për pasurinë e sindikatave", të kishte marrë fuqi juridike rregullisht, duke u kundërfirmuar nga kryeministri dhe nga ministri i Financave, si dhe të ishte miratuar nga Kuvendi rregullisht, në sesionin më të afërt, përsëri përparësi do të kishte ligji "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" kundrejt dekretit për pasurinë e sindikatave.

Në pamje të parë, të krijohet ideja që përparësi duhet të kishte dekreti, sepse ky akt normativ me fuqinë e ligjit është miratuar përpara ligjit dhe se njohja e së drejtës së pronësisë së sindikatave mbi pronat që kanë në administrim në funksion të qëllimit të ushtrimit të veprimtarisë së tyre sipas ligjit dhe statutit të tyre, do të përbënte një rregullim të veçantë në raport me rregullimet e përgjithshme të marrëdhënieve të pronësisë që bëhet me ligjin "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Është parim juridik i njohur dhe i gjithëpranuar ai, sipas të cilit, përparësi në respektim merr rregullimi i veçantë i pranuar në një ligj të caktuar, kundrejt rregullimit të përgjithshëm të pranuar në një ligj tjetër, në qoftë se njëri ligj nuk konsiderohet se shfuqizon tjetrin.

Megjithatë, dy regjimet juridike të dy akteve normative me fuqinë e ligjit (dekretit dhe ligjit në fjalë), në një vështrim më të përgjithshëm, do të përbënin një kuadër të caktuar të një regjimi juridik në ndryshim, i cili **ka pasqyruar dhe ka rregulluar në një proces evoluimi të shpejtë idetë dhe qëllimet e ligjvënësit me karakter politik, ekonomik dhe social.**

Në atë kohë nuk kishte filluar ende ndonjë nismë ligjvënëse për kthimin e pronave apo për kompensimin e ish-pronarëve të shpronësuar nga shteti në periudhën e regjimit komunist dhe ligjvënësi (përfshi edhe Presidenti) nuk

kishte ndonjë pengesë juridike për të disponuar pjesë të pronës shtetërore në dobi të sindikatave, të cilat, pas ndryshimeve përkatëse ligjore, fitonin personalitet të plotë juridik, pjesë e të cilit do të ishte edhe pavarësia e tyre e plotë ekonomike dhe financiare. Në atë kohë nuk përjashtohej mundësia që sindikatave t'u kalonin në pronësi, sipas modaliteteve të dekretit, edhe ndërtesa të pandryshuara apo troje të lira, të cilat ishin shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar apo marrë pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, pas *datës* 29 Nëntor 1944.

Ligji nr.7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me hyrjen e tij në fuqi, solli një rregullim të plotë e të drejtë të problemit të kthimit të pronave apo kompensimit të ish-pronarëve.

Ligjvënësi vendosi të kthejë në natyrë, jo të kompensojë, të gjitha ndërtesat e pandryshuara dhe trojet e lira (të pazëna) të ish-pronarëve, pa bërë përjashtim nëse këto vazhdonin të ishin në pronësi të shtetit apo kishin kaluar gjatë viteve të shkuara në pronësi të pronarëve të tjerë. Ky rregull zbatohej pa përjashtim edhe kundër atyre që i kishin përfituar këto prona kundrejt shpërblimit e me mirëbesim dhe i kishin poseduar e gëzuar ato qetësisht për një kohë të gjatë.

Në këtë drejtim, ligjvënësi nuk ka bërë përjashtim për asnjë person të tretë përfitues të ligjshëm, përfshi këtu edhe sindikatat përfituese prej dekretit në fjalë, në mundësinë që dekreti të kishte fituar fuqi juridike rregullisht. Sipas këtij ligji, personat e tretë përfitues të ligjshëm nuk do të prekeshin vetëm në qoftë se ish-pronari i pronës së kërkuar për t'u kthyer do të ishte ndonjë nga subjektet e parashikuara në nenet 23 e 24 të tij.

Si përfundim, dekreti nr.204, datë 5.6.1992, do të ruante fuqinë, po ta kishte fituar atë rregullisht, dhe ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998, do të ishte i zbatueshëm për sa u përket pronave në formën e ndërtesave të pandryshuara apo të trojeve të pazëna, duke i lënë ato në pronësi të sindikatave, vetëm në rast të ekzistencës së kushteve të neneve 23 e 24 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" si dhe, në mënyre evidente, në rastet kur ish-pronarët (trashëgimtarët e tyre) rezulton të mos u jenë drejtuar komisioneve të kthimit e të kompensimit të pronave të ngritura pranë bashkive e këshillave të rretheve. Kuptohet që këtu nuk vihet në diskutim fitimi nga sindikatat i pronësisë mbi pasurinë shtetërore që shteti ka vendosur t'ua kalojë sindikatave dhe që nuk ka lidhje me atë pasuri të paluajtshme që u kthehet ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre.

Gjithashtu, nënvizojmë se ligji nr. 7698, datë 15.4.1993, në nenin 29 të tij, parashikon se "të gjitha dispozitat ligjore që vijnë ne kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen".

Në këtë drejtim nuk do të bënte përjashtim edhe dekreti nr.204, datë 5.6.1992, edhe sikur ai të kishte marrë fuqi juridike pas nxjerrjes së tij, nëpërmjet kundërfirmimit të tij, sipas nenit 29 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Ai do të gjente zbatim vetëm brenda hapësirës që nuk do të krijonte ndeshje me ligjin e kthimit e të kompensimit të pronave. Brenda kësaj hapësire do të gjejë zbatim edhe ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998, i cili ka marrë përsipër të rregullojë pasojat që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit ...". Edhe "rregullimi i pasojave" për të ardhmen nuk mund të bëhet në mënyrë të tillë që t'u bjerë ndesh dispozitave të ligjit të kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

Në të gjitha rastet kur ka konflikt midis ish-pronarëve e sindikatave, përparësi në zgjidhjen e tyre merr interpretimi dhe zbatimi i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993. Kjo përparësi respektohet jo vetëm kur këto konflikte kanë lindur, janë gjykuar dhe vendimet kanë marrë formë të prerë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998, por edhe për rastet e vërtetuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji ".

E njëjta metodë interpretimi gjendet edhe në rastin e mëposhtëm. Në vendimin nr 979, datë 29.9.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë ndërmjet të tjerave: *"Në aplikim të nenit 467/a të Kodit të procedurës civile, kur gjykata e apelit prish vendimin për herë të dytë dhe e mban çështjen për ta shqyrtuar vetë si shkallë e parë, çështja shqyrtohet* nga i njëjti trup gjykues, pa e ndërprerë gjykimin...

Në rrethanat e mësipërme, çështja shtrohet nëse, në aplikim të nenit 467/a të Kodit të procedurës civile, gjykata e apelit, në të njëjtin gjykim, pra i njëjti trup gjykues, prish për herë të dytë vendimin e gjykatës së rrethit dhe po ky trup gjykues e shqyrton çështjen si shkallë e parë në të njëjtin gjykim apo vetëm prish vendimin e gjykatës së rrethit, ndërsa gjykimi si shkallë e parë bëhet veças, qoftë edhe me një trup gjykues tjetër. **Neni 467/a parashikon se gjykata e apelit, kur prish vendimin, nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë, por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë. Termi "gjykata e apelit" në dispozitën e mësipërme është përdorur në kuptimin procedural e jo institucional e, si i tillë, nënkupton trupin gjykues. Për pasojë, kur dispozita shprehet se gjykata e apelit e shqyrton vetë çështjen si shkallë e parë, kjo ka kuptimin se çështja shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, pa e ndërprerë gjykimin.** (Në këtë paragraf vihen re elemente të interpretimit a contrario që bën gjykata) [shënim i autorit]

Shprehja "si gjykatë e shkallës së parë" nuk do të thotë se në këto raste gjykata e apelit paraqitet si shkallë e parë, por se, ashtu si në rastin që parashikon neni 465 i po këtij Kodi, edhe në rastin e aplikimit të nenit 467/a,

gjykata e apelit mund të përsëritë tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor. **Në të kundërtën, në rast se ligjvënësi do të kishte për qëllim që gjykata e apelit në këtë rast do të gjykonte në shkallë të parë, atëherë duhet të kishte parashikuar edhe të drejtën e një ankimi kundër vendimit të kësaj gjykate, gjë që nuk e ka bërë. Përveç kësaj, nëpërmjet kësaj dispozite, ligjvënësi ka pasur për qëllim të bëjë ekonomi gjyqësore, pra të reduktojë zvarritjet e gjykimit.** Po të pranosh të kundërtën, pra, që në aplikim të nenit 467/a, kur çështja gjykohet për herë të dytë nga gjykata e apelit, bëhen dy gjykime, njëri si gjykatë apeli dhe i dyti si gjykatë e shkallës së parë, gjë që nuk përjashton gjykimin e çështjes nga një trup tjetër gjykues, atëherë do të zvarritej gjykimi në të njëjtën mënyrë sikur çështja, pas prishjes nga gjykata e apelit, të dërgohej për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Për pasojë, në këto raste, në një gjykim, me një vendim përfundimtar, gjykata e apelit edhe prish për herë të dytë vendimin e gjykatës së rrethit, edhe e zgjidh çështjen në themel. Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit është i gabuar e, si i tillë, duhet të prishet.

Në këto kushte, çështja duhet të dërgohet në gjykatën e apelit Shkodër për vazhdimin e gjykimit nga i njëjti trup gjykues për të zgjidhur çështjen në themel".

Ndërsa në vendimin nr. 7, datë 24.3.2005, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë: *"Kolegjet e Bashkuara çmojnë se është e rëndësishme të kuptohet drejt qëllimi i ligjvënësit kur në nenin 30 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, ka përcaktuar se të gjitha ligjet e mëparshme që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, shfuqizohen. Me miratimin e ligjit të ri, ligjvënësi nuk ka pasur për qëllim të zhvlerësojë pasojat që ka sjellë zbatimi i ligjit të vitit 1993, por ta plotësonte atë, për efekte të krijimit të mundësive maksimale për kthimin apo kompensimin e plotë të pronave ish-pronarëve, pa kufizimet që kishte ligji i vjetër dhe ta plotësonte më tej atë edhe lidhur me verifikimin e dyfishtë të mosmarrëveshjeve të lindura më parë apo që do të lindin pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sa më sipër, ka qenë detyrim kushtetues për Kuvendin i cili, sipas nenit 181 të Kushtetutës, duhet të plotësonte legjislacionin për çështjet që lidhen me shtetëzimin dhe konfiskimin e pronave, të kryera para hyrjes në fuqi të Kushtetutës".*

c – LEXIME PLOTESUESE

Fragmente nga M. Cappelletti, "Gjyqtari si ligjbërës," në *Procesi gjyqësor në perspektivën krahasuese',* Oxford, Clarendon Press, 1989.

Shënim i autorit: *Mauro Cappelletti ka qenë një prej figurave më kryesore të së*

lëvizjes për "akses në drejtësi." Në këtë shkrim ai përpiqet të përvijojë ekuilibrin e vështirë që duhet të gjendet nga gjyqtari midis nevojës për të respektuar vullnetin e ligjvënësit dhe paqartësisë së teksteve legjislative.

PJESA 1

1. Kompetenca ligjbërëse e gjyqtarëve dhe kufizimet e saj[4)]

Termi "ligji gjyqësor" është përdorur nga Jeremy Bentham në përshkrimin e common law për të theksuar pikëpamjen se gjyqtari, megjithëse, sikurse thuhet, normalisht nuk bën gjë tjetër veçse *deklaron ligjin ekzistues,* në të vërtetë mund të thuhet se *e krijon atë.* Për të përdorur termin e Bentamit, duhet pasur e qartë se fusha e ligjit gjyqësor i është nënshtruar një zgjerimi shumë masiv që prej kohës së tij. Për më tepër, kjo dukuri nuk është e kufizuar vetëm në vendet e sistemit common law ose në botën common law. Përkundrazi, ajo ka marrë përmasa mbarëbotërore [...]. Me sa kuptoj unë, për këtë zhvillim ekzistojnë dy arsye kryesore:

E para është rritja marramendëse e ndërhyrjes parlamentare dhe, më përgjithësisht, e ndërhyrjes statutore, në epokën tone. Sado paradoksale të tingëllojë, zgjerimi i legjislacionit ka sjellë një zgjerim paralel të ligjit të bërë nga gjyqtarët. Rritja e ligjit statutor nuk është veçse njëri prej aspekteve të rritjes së përgjithshme të pushtetit në të gjitha degët e tij, duke përfshirë edhe gjyqësorin. Duke qene se edhe hartuesit më të mirë të ligjeve lënë hapësira që duhet të plotësohen nga gjyqësori, si dhe shumëkuptimshmëri të fshehura që duhet të zgjidhen nga ky pushtet, zgjerimi i ligjit statutor e ka zgjeruar në mënyrë të pashmangshme dhe vazhdon ta zgjerojë fushën në të cilën veprojnë ligjet gjyqësore.

Një tjetër arsye bindëse për zgjerimin e fushës së ligjit gjyqësor është rritja e shumë vendeve drejt miratimit dhe ekzekutimit gjyqësor të deklaratave të të drejtave të njeriut. Nuk ka pothuajse asnjë dyshim se deklaratat e të drejtave të ekzekutueshme nga gjyqësori, veçanërisht nëse e parashikojnë këtë gjë, e zgjerojnë ndjeshëm krijimtarinë e mundshme të gjyqtarëve.

Më gjerësisht, rritja e rolit të gjyqësorit në shoqëritë moderne mund të shihet

---

4) Këto dy materiale të M.Cappelletti dhe të William Twining, që janë përdorur si leksime suplementare, studentët shqiptarë duhet t'i vështrojnë doemos në aspektin krahasues, ku evidentohet ndjeshëm dallimi ndërmjet shkollës europiane dhe asaj të common law. (Shënim i autorëve të tekstit)

si zhvillim i domosdoshëm për të ruajtur sistemin demokratik të kontrollit dhe balancës.

Këto tema do të analizohen gjerësisht [...] në vazhdim. Pas përmendjes së arsyeve për zgjerimin e ligjit gjyqësor, kapitulli trajton ndryshimet procedurale kryesore ndërmjet legjislacionit dhe bërjes së ligjeve nga gjykatat, pikat e dobëta dhe të forta të këtyre të fundit, si dhe problemin e madh të ligjshmërisë së një ligjbërjeje të tillë. Seksionet e fundit të këtij kapitulli orvaten të cilësojnë diskutimet e prirjeve mbarëbotërore, duke trajtuar nga perspektiva krahasuese disa ndryshime ndërmjet vendeve dhe familjeve ligjore të ndryshme.

2. Interpretimi kundrejt ligjbërjes

Le t'i kthehemi edhe një herë deklaratës së përmendur më sipër se, aktualisht, hapësira për bërjen e ligjeve nga gjyqësori (ose, sipas terminologjisë së Bentamit, për ligjin gjyqësor) është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, pjesërisht për shkak të zgjerimit të ligjit statutor. Kjo deklaratë presupozon se nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm ndërmjet interpretimit (statutor) dhe bërjes së ligjeve. Interpretimi gjyqësor, pa dyshim, është krijues, madje edhe në rastet e gjuhës në dukje të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, nëpërmjet së cilës është shprehur qëllimi i ligjvënësit. Problemi i vërtetë nuk është ndryshimi i dukshëm mes interpretimit gjyqësor (jokrijues), nga njëra anë, dhe ligjbërjes gjyqësore, nga ana tjetër, por shkalla e krijueshmërisë si edhe mënyrat, kufizimet dhe pranueshmëria e ligjbërjes nga gjykatat. Pra, më duhet t'i kthehem problemit, i cili në fakt është problemi i vërtetë i rolit të gjyqtarit përkundrejt rolit të ligjvënësit. Kjo çështje kërkon sqarime konceptuale dhe një cilësim të përcaktuar. Le të fillojmë me disa prej sqarimeve.

Në botën perëndimore është prodhuar një sasi e konsiderueshme literature në gjuhë të ndryshme për të demonstruar se, me apo pa dijeninë e interpretuesit, në çfarëdolloj interpretimi përcillet një shkallë e caktuar krijimtarie dhe diskrecioni – qoftë ky interpretim i ligjit ose i çdolloj tjetër produkti të shoqërisë njerëzore, si: muzika, poezia, artet vizive ose filozofia. Të interpretosh do të thotë të depërtosh mendimet, frymëzimet dhe gjuhën e përdorur nga të tjerët për t'i kuptuar ata dhe, në rastin e gjyqtarit, jo më pak se, le të themi në rastin e muzikantit, t'i riprodhosh, t'i ekzekutosh ose t'i zbatosh ato në një kohë apo mjedis të ndryshëm. Sikurse e dimë të gjithë, riprodhimi dhe ekzekutimi ndryshojnë shumë, midis të tjerash, në varësi të cilësive, të botëkuptimit dhe të mënyrës së interpretimit. Kush do ta krahasonte ekzekutimin muzikor të Artur Rubinstein me atë të komshiut të zhurmshëm? Ose, kush do ta barazonte interpretimin e Rubinstein, le të themi me atë të Cortot, Gieseking ose

Horowitz? Interpretuesi, aq sa përpiqet të jetë besnik i tekstit të tij, po aq i detyruar është të jetë i lirë, pasi as poema, as kompozimi muzikor ose ligji nuk janë të tilla që nuk lënë asnjë hapësirë për variacione dhe nuanca, pra për interpretim krijues. Vetëm mendoni se fjalët, sikurse edhe notat muzikore, nuk janë veçse simbole konvencionale, kuptimi i të cilave u nënshtrohet pashmangshmërisht ndryshimeve dhe është i hapur ndaj pyetjeve dhe pasigurive.

Sikurse ka shkuar gjyqtari Oliver Wendell Holmes, që në vitin 1899, nuk është e vërtetë se në praktikë (dhe unë nuk di ndonjë arsye përse teoria duhet të mos bjerë dakord me praktikën) një fjalë e caktuar apo një grup i caktuar fjalësh të kenë vetëm një kuptim. Zakonisht, një fjalë ka disa kuptime, madje edhe në fjalor. Çështje dhe pasiguri të tilla duhet të zgjidhen nga interpretuesi. Ai duhet të plotësojë boshllëqet, të përcaktojë nuancat kuptimore dhe të qartësojë shumëkuptimshmëritë. Për të vepruar në këtë mënyrë, ai duhet të bëjë një zgjedhje. Por, duke e paraqitur edhe një herë nëpërmjet fjalëve të babait të realizmit ligjor amerikan, kur ekziston një dyshim se mjeti i thjeshtë i logjikës nuk mjafton, edhe nëse ai është i fshehur ose i padukshëm, gjyqtarëve u duhet të ushtrojnë prerogativën sovrane të zgjedhjes. Realisht, interpretuesi duhet t'i japë jetë të re një teksti të vdekur, një simboli të thjeshtë të një akti jetësor të një personi tjetër.

3. Shkallët e ndryshme të krijueshmërisë gjyqësore: kufizimet materiale

Çështja e përmendur më sipër, se nuk ekziston ndonjë ndryshim i dukshëm ndërmjet interpretimit gjyqësor dhe ligjbërjes, ka nevojë për një cilësim të përcaktuar për të shmangur keqkuptimet serioze.

Të pranuarit se në çdo akt interpretimi përcillet një shkallë e caktuar krijueshmërie (ose ajo që i jep së njëjtës gjë një element zgjedhjeje dhe diskrecioni) nuk duhet të ngatërrohet me një pohim për *liri të plotë* të interpretuesit. Diskrecioni nuk është domosdoshmërisht arbitraritet i pastër; gjyqtari, ndonëse është një ligjbërës i pashmangshëm, jo domosdoshmërisht është një arbitrar, krejtësisht i pavarur nga ligjbërësi. Çdo sistem ligjor i civilizuar është përpjekur realisht të përcaktojë dhe të zbatojë disa *kufizime të lirisë gjyqësore,* procedurale dhe materiale.

Kufizimet procedurale janë aq të rëndësishme sa përfshijnë (duke përdorur formulën e Benjamin Cardozo) natyrën e vërtetë të procesit gjyqësor (këto kufizime do të diskutohen në vazhdim). Përkundrazi, kufizimet materiale ndryshojnë ndjeshëm nga njëra epokë te tjetra dhe nga njëra shoqëri në tjetrën,

si dhe brenda çdo epoke apo shoqërie të caktuar. Ato përfshijnë mjete të tilla, si: precedentët gjyqësorë, opinionet akademike, urdhrat e monarkëve, vendimet e parlamenteve, ligjet parlamentare, kodet pa boshllëqe dhe të tjera si këto.

Për të qenë të sigurt, kufizimet materiale nuk janë një *conditio sine qua non* për natyrën gjyqësore të procesit vendimmarrës. Me fjalë të tjera, marrja e vendimit *bazuar mbi ligjet materiale të mëparshme* nuk është një karakteristikë thelbësore *sine qua non* e veprimtarisë gjyqësore. Gjyqtarët mund t'i bazojnë vendimet e tyre mbi vlerat e drejtësisë ose mbi ndonjë simbol tjetër shumë të gjerë të vlerave (dhe, duke qenë kaq i gjerë, praktikisht është edhe i pakuptimtë) dhe përsëri të jenë gjyqtarë. Kush do ta mohonte karakterin gjyqësor të vendimeve të dhëna dy mijë vjet më parë nga gjykuesit klasikë romanë, ose të vendimeve të dhëna disa shekuj më parë nga kancelarët anglezë, bazuar mbi *drejtësinë* ose ndërgjegjen?

Pra, çështja - dhe cilësimi i përcaktuar që është i nevojshëm – është se, të flasësh për gjyqtarin si ligjbërës, në njëfarë kuptimi, nuk është gjë tjetër veçse një banalitet i dukshëm, një truizëm i pakuptimtë. Pa dyshim, çdo interpretim është krijim dhe, sigurisht, interpretimi gjyqësor është ligjbërje. Duke cituar përsëri lord Radcliff, nuk ka diskutim më shterp sesa ai mbi çështjen nëse gjyqtari bën ligje. Pa dyshim, ai bën. Si mund të veprojë ndryshe ? Dhe është pikërisht kjo pikë ku fillon edhe një diskutim i vërtetë botëror. Për ta thëksuar përsëri, ky diskutim mbarëbotëror lidhet me shkallën e krijueshmërisë si edhe me mënyrat, kufizimet dhe ligjshmërinë e ligjbërjes nga gjykatat. Është e qartë se në një vendim të mbështetur mbi drejtësinë ka më shumë hapësira për zgjedhje, sesa në një vendim të mbështetur mbi precedentë të përcaktuar ose norma të detajuara legjislative. Pra, shkalla e krijueshmërisë është më e madhe te të parat. Po aq i vërtetë sa ç'është fakti se asnjë precedent ose legjislacion nuk mund ta detyrojë *plotësisht* interpretuesin, po aq i vërtetë është edhe fakti se gjyqtari i detyruar të zbatojë precedentët dhe/ose legjislacionin, duhet të paktën t'i referojë argumentet e tij në këtë ligj të krijuar që më parë dhe jo (vetëm) te drejtësia. Po ashtu, është e vërtetë se çdo situatë faktike në jetën e njeriut është e re dhe unike, kështu që ka gjithmonë baza për dallimin nga precedenti ose për të argumetuar *a contrario (në sensin e kundërt)* më shumë sesa nëpërmjet analogjisë – ose a anasjellta – nëpërmjet dispozitave ligjore. Kështu, rezultati përfundimtar i interpretimit nuk mund të paracaktohet asnjëherë mekanikisht dhe ne mënyrë joekuivoke. Por ekziston gjithmonë një emërues i përbashkët, si për interpretimin ligjor, ashtu edhe për interpretimin e çështjeve të ndryshme. Zakonisht, fjalët kanë një kuptim aq të pranuar gjerësisht, sa edhe gjyqtarët më aktivë dhe më dinamikë do ta kishin të vështirë ta injoronin. Duhet të theksohet me forcë se kufizimet materiale nuk janë aspak të

pakuptimta. Ato e detyrojnë gjyqtarin deri në një shkallë të caktuar, megjithëse nuk mund ta detyrojnë kurrë plotësisht.

Gjithsesi, do të dëshiroja të theksoja edhe faktin se kufizimet materiale nuk përcaktojnë natyrën e procesit gjyqësor. Nëse një gjyqtar është i lirë ta bazojë vendimin mbi norma të drejtësisë të pashkruara dhe të shprehura në mënyrë jo qartë, veprimtaria e tij nuk mund të diferencohet shumë, materialisht, nga ajo e një ligjvënësi të pakufizuar. Ndërsa gjykimi, i cili i nënshtrohet ligjit statutor dhe/ose precedentit, mund të krahasohet me veprimtarinë e ligjvënësit, kompetenca ligjbërëse e të cilit duhet të lëvizë brenda kufijve të Kushtetutës së shkruar dhe gjykimit kushtetues. Nga pikëpamja materiale, ndryshimi i vetëm i mundshëm ndërmjet gjykimit dhe legjislacionit mund të mos i përkasë aq llojit, sa shpeshtësisë ose sasisë, d.m.th. *shkallës:* sasia më e madhe dhe, zakonisht, karakteri më specifik dhe i detajuar i ligjit të zakonshëm (statutor dhe/ose precedenti), kundrejt sasisë më të paktë dhe zakonisht karakterit më të paqartë të ligjit kushtetues.

Pra, përballjet e ligjvënësit me kufijtë materialë janë më pak të shpeshta dhe, zakonisht, kufijtë janë më pak të përcaktuar. Por, legjislacioni nuk pushon së qeni krijues dhe ligjbërës për faktin e thjeshtë se, ndonjëherë, kufij dhe norma shumë të përcaktuara kushtetuese përballen dhe duhet te zbatohen nga vetë ligjvënësit. Pra, nga ky këndvështrim, natyrat e të dyja proceseve, legjislativ dhe gjyqësor, nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Të dyja janë ligjbërëse. Sikurse u tha edhe më lart, çështja ndryshon nga pikëpamja *procedurale,* por kjo është një pikë që do të diskutohet më poshtë, kur të diferencohet mënyra e ligjbërjes gjyqësore nga ligjbërja e legjislacionit.

4. Ligjbërja gjyqësore dhe legjislacioni: mënyrat e ndryshme të të dyja proceseve

Sikurse kemi parë deri tani, krijueshmëria është një tipar i pashmangshëm i gjykimit. Janë të shumta arsyet për theksin e veçantë që po i vihet këtij tipari në shekullin tonë dhe shkalla e krijueshmërisë që kërkohet në kohën tonë, është vërtet shumë më e lartë sesa ajo e kohëve të shkuara. Tani ne duhet të përballemi edhe me një problem tjetër: nëse krijueshmëria gjyqësore barazohet me legjislacionin. Me fjalë të tjera, nëse nëpërmjet ushtrimit të një roli krijues gjyqtarët ushtrojnë - dhe ndoshta abuzojnë me - një kompetencë legjislative.

Në leksionin e tij në Holdsuorth, në vitin 1956, lord Diplock tha se "gjykatat, për shkak të natyrës së funksionit të tyre, janë të detyruara të veprojnë si ligjbërëse". Unë nuk bie dakord. Çështja e parashtruar në seksionin e mëparshëm është se gjyqtarët detyrohen të jenë *ligjbërës.* Ata duhet të

interpretojnë, d.m.th. të integrojnë, të qartësojnë, të modelojnë dhe, jo rrallë, ta krijojnë ligjin *ex novo*. Megjithatë, ky fakt nuk i bën ata ligjbërës. Vazhdon të mbetet një ndryshim thelbësor mes proceseve legjislative dhe gjyqësore. Nga këndvështrimi material, si procesi legjislativ, ashtu edhe ai gjyqësor, janë procese ligjbërëse. Por, *mënyra e procedimit* të këtyre dy proceseve është krejtësisht e ndryshme. Ky ndryshim meriton vëmendje të veçantë për të shmangur ngatërrimin e rrezikshëm. Gjyqtarët e mirë janë, dhe shfaqen se janë, krijues, dinamikë, ligjbërës aktivë. Por vetëm gjyqtarët e dobët do të *veprojnë* si ligjbërës. Dhe, me të vërtetë, nëse gjykata vepron si ligjbërëse, ajo pushon së qeni gjykatë.

Duhet pranuar se ngatërrimi i përmendur në këtë seksion mund të duket se është, dhe në shumë raste është, vetëm terminologji dhe jo përmbajtje. Për shembull, duke qenë të drejtë me lord Diplock, duhet pranuar se, ndërsa flitet vazhdimisht për gjykatat si ushtruese të kompetencave legjislative dhe për gjyqtarët që veprojnë si ligjbërës, ai duket se afirmon se gjyqtarët janë *ligjbërës*. Megjithatë, legjislacioni është vetëm një mënyrë për bërjen e ligjeve dhe një mënyrë krejtësisht e ndryshme nga ajo gjyqësore.

Kjo gjë demonstrohet më shumë nga përvojat faktike sesa nga teoritë e sofistikuara. Përvojat historike tregojnë qartë se natyra e procesit gjyqësor, duke mos u karakterizuar aspak si një proces jokrijues, mund të karakterizohet (a) nga lidhja e tij me çështjet dhe mosmarrëveshjet, pra me palët, dhe (b) nga paanshmëria e gjyqtarit. Mijëra vjet të mençurisë njerëzore janë përqendruar në ato që janë quajtur rregullat bazë të drejtësisë natyrore, të gdhendura me forcë në dy aforizmat e lashtë: *nemo judex in causa propria* dhe *audiatur et altar pars*. Këto rregulla kërkojnë që gjyqtari të jetë *mbi palët*, pra që ai të mos vendosë për vete dhe të mos u nënshtrohet presioneve të palëve. Gjithashtu, ato kërkojnë që të gjitha palëve t'u jepet mundësia e barabartë për t'u dëgjuar nga një gjyqtar i paanshëm, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Një rregull e tretë, e nënkuptuar ose jo në dy rregullat e para, nuk është më pak e rëndësishme. Edhe ajo është e gdhendur në një kuplet në latinisht për të nxjerrë në pah mençurinë e lashtë të përmbajtjes së saj: *ubi non est actio, ibi non est jurisdictio* ose, e shprehur në një frazë që ka të njëjtin kuptim, *nemo judex sine actore*. Ajo tregon se, ndryshe nga proceset legjislative dhe administrative, procesi gjyqësor nuk fillohet me nismën e gjykatës, *ex officio*; që të fillohet, ajo ka nevojë për një pretendues, një palë paditëse, *një aktor* – madje edhe duhet të ndiqet në vazhdimësi pasi sillet nga palët në gjykatë.

Ekzistojnë shumë tipare kryesore që e diferencojnë thellësisht procesin gjyqësor nga procesi politik dhe këto tipare janë një herë e përgjithmonë, kufijtë bazë, por edhe forca unike dhe mbresëlënëse e këtij procesi. Mendoj se askush nuk do të shihte një shtrembërim të procesit legjislativ ose administrativ nëse

në të përfshihen legjislatorët ose nëpunësit e administratës, madje edhe me një interes të njëanshëm në çështjet që ata rregullojnë; nëse ata përfaqësojnë individë dhe grupe dhe veprojnë në favor të tyre; nëse nuk dëgjojnë interesat dhe grupet e opozitës dhe nëse i fillojnë proceset e tyre, pa pritur për kërkesën e palës së interesuar. Në vendet perëndimore po spikat një rrymë për të bërë gjyqësore, sikurse ka qenë edhe më parë, proceset administrative dhe legjislative. Në këto procese janë prezantuar dëgjimet e interesave konfliktues; janë miratuar instrumentet (duke përfshirë kartat e të drejtave të njeriut dhe normat detyruese të procedurave administrative dhe legjislative) për mbrojtjen e minoriteteve ose të maxhorancave të papërfaqësuara nga veprimet e njëanshme të legjislaturës, ekzekutivit dhe agjencive administrative; si dhe është predikuar paanshmëria e degëve të politikës. Mbetet një fakt që këto janë karakteristika tipike të procesit gjyqësor, aq shumë as mund të flitet për "bërjen gjyqësore" të proceseve jogjyqësore. Është po ashtu fakt se kjo pirje për të "bërë gjyqësore" edhe proceset jogjyqësore është gjithmonë një përpjekje embrionike, pasi asnjë sistem legjislativ ose administrativ nuk do të funksiononte në pritje për t'u vënë në lëvizje nga një individ ose grup individësh dhe derisa të gjithë individëve të interesuar ose grupeve të tyre t'u jepej mundësia e përshtatshme për t'u dëgjuar.

Karakteristikat e sipërpërmendura janë shumë të përgjithshme. Gjithashtu, ato janë elastike dhe të hapura ndaj interpretimeve krijuese, duke përfshirë këtu edhe interpretimin gjyqësor. Një pjesë e mirë e doktrinës dhe e metodikave më të mira procedurale ndër shekuj janë marrë me trajtimin e këyre karakteristikave dhe duhet pranuar se ka ende shumë paqartësi dhe ndryshime, jo vetëm ndërmjet vendeve të ndryshme, por edhe brenda të njëjtit vend. Ky fakt nuk nënkupton se këto karakteristika janë të pakuptimta. Ato janë larg të qenit përgjithësime boshe dhe janë shumë të rëndësishme, të lidhura dhe reaguese me zbatimin konkret, ndonëse nuk kanë arritur asnjëherë një kristalizim përfundimtar dhe të pakundërshtueshëm. Pjesa më e madhe e asaj që është zhvilluar si gjykimi kushtetues gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit në SHBA, Republikën Federale Gjermane, Itali dhe disi më pak në Francë, Austri dhe Japoni, si edhe nga agjenci gjykuese transkombëtare, si Komisioni dhe Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka qenë një përpjekje për t'i dhënë kuptim konkret këtyre karakteristikave – sikurse jemi përpjekur të demonstrojmë unë dhe disa të tjerë nëpërmjet dy projekteve të mëdha studimore krahasuese.

Sigurisht, këto karakteristike janë me natyrë *formale* ose *procedurale*. Ato tregojnë *mënyrën* ose konturet e saj kryesore të veprimit gjyqësor. Por, natyra e tyre procedurale nuk duhet të konsiderohet si kufizim i rëndësisë së tyre. Sikurse ka thënë edhe gjyqtari Douglas, në vitin 1971, në fjalimin e tij për Gjykatën e

Lartë të Shteteve të Bashkuara: 'Është mjaft domethënëse që pjesa më e madhe e dispozitave të Kartës së të Drejtave të Njeriut janë me natyrë procedurale".

Dhe, me të vërtetë, fakti që këto karakteristika janë të një natyre procedurale mund të tregojë se, deri në njëfarë mase, ato janë më të qëndrueshme dhe u nënshtrohen më pak transformimeve radikale që mund të pësojnë karakteristikat me natyrë materiale. Ndonëse konkretizimi i këtyre karakteristikave mund të ndryshohet dhe në fakt ndryshon nga një periudhë në tjetrën dhe nga një vend në tjetrin, ato përcaktojnë konturet e natyrës së vërtetë të procesit gjyqësor, *pavarësisht nga vendi dhe koha.*

Elasticiteti i tyre mund të jetë i madh, por jo i kufizuar. Një gjyqtar që vendos për një çështje që nuk ka ardhur para tij nga një palë; që nuk i jep palës së paditur një mundësi të arsyeshme për t'u mbrojtur ose që vendos për një çështje të vetën, mund të vazhdojë ta veshë mantelin e gjyqtarit dhe të vazhdojë ta quajë veten gjyqtar, por ai nuk është më gjyqtar.

Ky seksion duhet të mbyllet me një tërheqje të vëmendjes për relativitetin. Në botën reale nuk ka gjëra absolutisht të ndara. Diskutimi mbi natyrën e procesit gjyqësor nuk do të thotë se në botën reale elementet tipike të procesit gjyqësor nuk ndërveprojnë ose nuk duhet të ndërveprojnë me elemente tipike të proceseve të një natyre tjetër. Për shembull, gjykatat, veçanërisht gjykatat e larta, mund të kenë autoritet procedural ligjbërës, si në rastin e disa juridiksioneve të common law. Përse nuk duhet të jenë vetë gjykatat ose të kenë mundësi të jenë, ligjbërësit më të mirë të mundshëm në përcaktimin dhe miratimin e vazhdueshëm të rregullave teknike të procedurës me të cilat ato merren çdo ditë? Po ashtu, gjatë ushtrimit të kësaj kompetence ligjbërëse, gjyqtarët veprojnë si ligjbërës dhe jo si gjykues. Gjithashtu, gjyqtarët kryejnë një rol ndoshta jogjyqësor dhe kuazilegjislativ kur japin mendime konsultative, siç është, p.sh., rasti (ose të paktën ka qenë deri kohët e fundit) i disa gjykatave të larta në Kanada, Indi, Suedi, Finlandë dhe në më shumë se dhjetë shtete nga 50 shtetet e SHBA-së.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjykatat e larta në vendet socialiste kur ato jepnin udhëzime të përgjithshme për interpretimin ligjor, të cilat ishin të detyrueshme për gjykatat më të ulëta dhe ishin të shkëputura nga konteksti i çështjeve dhe i mosmarrëveshjeve konkrete. Dhe nuk është i ndryshëm rasti kur gjykata të larta në vende të ndryshme të botës shpallin *obiter dicta;* të cilat synojnë, të paktën *de facto*, të kenë një ndikim *erga omnes,* megjithësc ato nuk janë të domosdoshme për marrjen e vendimit për çështjen në seancë. Në të gjitha këto situata, gjykatat veprojnë si ligjbërës, pasi nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis verdiktit të gjykatës – vendimit, opinionit, udhëzimit, dispozitivit dhe "objektit të mosmarrëveshjes" që duhet të zgjidhet. Nga ana

tjetër, gjyqtarët – veçanërisht kryetarët e gjykatave dhe sidomos kryetarët e gjykatave të larta – nuk e shmangin dot kryerjen e një sërë veprimtarish me natyrë administrative kur ata ushtrojnë përgjegjësitë për organizimin e gjykatave të tyre dhe të gjykatave më të ulëta në sistemin e tyre të gjykatave, ose kur vendosin, për shembull, kalendarin vjetor të gjykatës, kur ndajnë çështjet nëpër trupat gjykues ose kur i caktojnë një çështje njërit apo tjetrit gjyqtar brenda trupit gjykues.

PJESA 2

1. Të drejtat themelore dhe rëndësia e tyre për interpretimin e ligjit procedural

Shënim i autorit: *Një prej problemeve më të mëdha në interpretimin e normave procedurale është nevoja e vazhdueshme për të garantuar se zbatimi i tyre është në përputhje me standardet e procesit të drejtë dhe të rregullt ligjor. Standarde të tilla tashmë janë të përmendura në pjesën më të madhe të kushtetutave moderne dhe në një sërë instrumentesh ndërkombëtare. Shpesh, ato janë të formuluara në terma tepër të përgjithshëm, duke e bërë të vështirë identifikimin e përmbajtjes së saktë të tyre. Interpretimi i tyre nga gjykatat kushtetuese dhe juridiksionet mbikombëtare është në evoluim të vazhdueshëm.*

Kushtetuta shqiptare përmban disa dispozita lidhur me pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe me disa elemente të procesit të rregullt ligjor (si p.sh., publiciteti, shih nenin 146). Mes vendeve që përdorin të drejtën kontinentale, Italia është një vend mjaft interesant, pasi kohët e fundit ka prezantuar në nivel kushtetues një sërë standardesh të tilla tepër të detajuara në versionin e ri të nenit 111. Zbatimi në praktikë i disa prej këtyre të drejtave (për shembull, afati në proceset civile) ka rezultuar i vështirë. Gjithsesi, kjo dispozitë paraqet një listë interesante të garancive themelore dhe një zhvillim të vonshëm të idesë së "procesit të rregullt ligjor".

2. Kushtetuta italiane

Neni 24

(1) Kushdo ka të drejtë të paraqesë çështje përpara një gjykate për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm.
(2) E drejta e mbrojtjes është e padhunueshme në çdo faze dhe shkallë të gjykimit.
(3) Ligji u siguron personave në pamundësi institutet e nevojshme (avokatët), mjetet për ngritjen e padisë ose për t'u mbrojtur para çdo gjykate.
(4) Ligji përcakton kushtet dhe mënyrën e riparimit të gabimeve gjyqësore.

Neni 111

(1) Drejtësia zbatohet nëpërmjet një procesi të drejtë, të rregulluar me ligj.

(2) Çdo proces zhvillohet mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit mes palëve, në kushte të barabarta, para një gjyqtari të paanshëm dhe të pavarur. Ligji përcakton afatet e arsyeshme për procedurat gjyqësore.

(3) Në procesin penal, ligji garanton informimin e menjëhershëm dhe në mirëbesim të të akuzuarit për natyrën dhe shkaqet e akuzave të ngritura kundër tij; atij i jepet koha dhe kushtet e nevojshme për të organizuar mbrojtjen; ai ka të drejtë që, në prani të gjyqtarit, të marrë në pyetje personat që dëshmojnë në ngarkim tij, të thërresë dhe të marrë në pyetje persona të tjerë që dëshmojnë në mbrojtje të tij, në kushte të njëjta me palën akuzuese, si dhe të marrë çdo mjet dhe provë tjetër në favor të tij; i akuzuari mund të ketë ndihmën e një përkthyesi, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur gjatë procesit gjyqësor.

(4) Në proceset penale, provat administrohen vetëm mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit mes palëve. Asnjë i pandehur nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e dëshmive që jepen nga dëshmitarë që c shmangin me ose pa qëllim marrjen në pyetje dhe hetimin nga pala kundërshtare (nga mbrojtja).

(5) Ligji përcakton rastet se kur provat administrohen pa kontradiktoritetin mes palëve ose me pëlqimin e të pandehurve, ose si pasojë e shkeljeve të provuara.

(6) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

(7) Kundër vendimeve dhe masave që merren nga gjykatat e zakonshme apo speciale për liritë personale, mund të paraqitet gjithmonë rekurs në gjykatën e kasacionit për shkeljet e ligjit. Këto dispozita mund të anashkalohen vetëm në rastet kur vendimet jepen nga gjykatat ushtarake dhe në kohë lufte.

(8) Kundër vendimeve të marra nga Këshilli i Shtetit dhe gjykata e llogarive, rekurset në gjykatën e kasacionit pranohen vetëm për motive që lidhen me juridiksionin.

Shënim i autorit: *Gjithsesi, një përparim i tillë në nivelin kushtetues kombëtar është krahasimisht më pak i rëndësishëm sesa zhvillimi galopant që kanë njohur garancitë procedurale, së pari, brenda kuadrit të KEDNJ-së dhe, më pas, në të drejtën e Bashkimit Europian, kryesisht nëpërmjet jurisprudences së Gjykatës së Drejtësisë të komuniteteve europiane, e cila ka zhvilluar doktrinën e "mbrojtjes gjyqësore efektive" që po imponon gradualisht një ekzaminin të kujdesshëm në të gjitha sistemet procedurale të shteteve anëtare.*

3. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Neni 6.1

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë, qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë të gjithë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralitetit, të rendit publik ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve apo mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkon këtë, ose në masën e gjykuar krejtësisht të domosdoshme nga gjykata, kur, në rrethana të veçanta, publiciteti do të ishte i një natyre që do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Shënim i autorit: *Prezantimi i doktrinës së "mbrojtjes gjyqësore efektive" mund të vërehet në formulimin e nenit 47 të Kartës Europiane të të Drejtave Themelore, i cili duhet të zhvendosej në nenin 107, pjesa 2 e projektit të ri të Kushtetutës Europiane.*

4. E drejta për ankim efektiv dhe proces të rregullt

Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit Europian, ka të drejtën e ankimit efektiv përpara një gjykata në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen.

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht që më parë. Çdokush duhet të ketë mundësinë të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet.

Çdo personi në mungesë të burimeve të mjaftueshme financiare duhet t'i garantohet ndihmë ligjore, në rast se kjo ndihmë do të siguronte akses efektiv në drejtësi.

Shënim i autorit: *Doktrina e efektshmërisë, e përfshirë tashmë në dokumentet e sipërpërmendura, ka pasur zhvillim gradual. Fillimisht, Gjykata Europiane e Drejtësisë i trajtonte të drejtat si një çështje që i përkiste krejtësisht së drejtës komunitare dhe mjetet për mbrojtjen e tyre, si çështje të së drejtës kombëtare. Në çështjen "Rewe-Zentralfinanz EG dhe Rewe-Zentral AG v. Landwirtschaftskammer fur das Saaland"; të vitit 1976,*

Gjykata Europiane e Drejtësisë nënvizoi parimin e autonomisë procedurale kombëtare: "Janë gjykatat kombëtare organet e autorizuara të garantojnë mbrojtjen ligjore të qytetarëve, e cila u buron nga efekti i drejtpërdrejtë i dispozitave të së drejtës komunitare". Megjithatë, Gjykata Europiane e Drejtësisë vendosi dy kërkesa që duhet të përmbusheshin brenda autonomisë kombëtare: "Parimin e krahasueshmërisë", sipas të cilit mjetet e garantuara nga gjykatat kombëtare për zbatimin e së drejtës komunitare duhet të ishin ekuivalente me mjetet e garantuara për zbatimin e së drejtës kombëtare. ("[...] kushte të tilla nuk mund të jenë më pak të favorshme sesa ato që lidhen me paditë e ngjashme që ngrihen brenda një shteti të caktuar") dhe parimin e "efektshmërisë," i cili thotë se kushtet për mbrojtjen e të drejtave para gjykatave kombëtare nuk duhet ta bëjnë të pamundur zbatimin në praktikë të së drejtës komunitare.

Një qëndrim i tillë solli pashmangshmërisht mospërputhjen mes parimit të përgjithshëm të autonomisë procedurale kombëtare dhe parimit të efektshmërisë. Një prej çështjeve më të dëgjuara në të cilën Gjykata Europiane e Drejtësisë është përballur me këtë konflikt, ka qenë "R. v. Sekretari i Shtetit për Transportin, ex parte Factortame Shpk dhe të Tjerët" (1990), ku gjykata i ka detyruar gjykatat angleze të japin një grant provizor në një çështje, në një kohë kur kjo gjë, sipas së drejtës vendëse, nuk ishte nën kompetencën e tyre.

Për shembull, Gjykata Europiane e Drejtësisë ka shqyrtuar edhe çështje që kishin të bënin me shumën e kompensimit në një rast kur vendimi i marrë nga gjykata vendëse për riparimin e shkeljes të së drejtës komunitare përcaktonte një shumë të pamjaftueshme si limit kompensimi ("Marshall v. autoritetit shëndetësor II të zonës së Southempton dhe South West",1993). Ky ishte përsëri rasti i legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar që vendoste një limit prej 6.250 £, si kompensim.

Gjykata tha se: "Në rastin kur masa që merret, është kompensim financiar [...], ajo duhet të jetë e përshtatshme, në atë që ajo duhet të bëjë të mundur që dëmet dhe humbjet aktuale të shkaktuara si rezultat i pushimit diskriminues të çështjes, të kompensohen si duhet dhe në përputhje të plotë me rregullën kombëtare të zbatueshme," dhe në atë që "një kompensim i tillë duhet të jetë i plotë dhe nuk duhet të kufizohet a priori për shkak të shumës". Pas një numri të konsiderueshëm mendimesh, thelbi i të cilave ka qenë efektshmëria e së drejtës komunitare, disa prej vendimeve të kohëve të fundit duket se po ndjekin një qëndrim më të ekuilibruar, duke i lënë më shumë diskrecion ligjvënësit vendës në zgjedhjen e mjeteve procedurale për shkeljen e së drejtës

5. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas legjislacionit shqiptar

Interpretimi i normave procedurale duhet kryer nga gjykata në mënyrë të tillë që të garantojë se edhe zbatimi i tyre bëhet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor. E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese e individëve, nëpërmjet së cilës ata kërkojnë realizimin e procedurave të drejta dhe të ndershme ligjore. Nga njëra anë, kjo e drejtë kushtetuese paraqitet si garanci për shtetasit kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit dhe, nga ana tjetër, ajo përbën një detyrim për këto të fundit që të mos cenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve, pa ua siguruar respektimin e procedurave të rregullta ligjore.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e drejta për një proces të rregullt ligjor përmendet në mënyrë specifike në dy nene të saj; neni 42 e rendit atë krahas të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, ndërsa neni 131, shkronja "f", e përcakton si një çështje juridiksioni për Gjykatën Kushtetuese.

Kushtetuta, nëpërmjet nenit 42, ka bërë një zgjidhje disi të veçantë. Ajo ka bashkuar në një nen kushtetues dy formulime që rrjedhin nga amendamenti i pestë i Kushtetutës amerikane, i ndërthurur me nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, si dhe me pikën 1 të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate të pavarur e të paanshme është elementi i përbashkët që rezulton i parashikuar në dispozitat ndërkombëtare të sipërcituara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndërsa koncepti i procesit të rregullt ligjor, i cili përmendet vetëm në pikën 1 të nenit 42, është një ndërthurje e formulimit të amendamentit të pestë me titullin e nenit 6 të Konventës Europiane.

E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk është një e drejtë që mund të mbulojë të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit. Po t'i referohemi nenit 6 të KEDNJ-së, do të gjejmë një kuptim më të gjerë në formulimin e tij. Në këtë nen përfshihen: e drejta për t'u dëgjuar, e drejta e një gjykimi të drejtë, procesi i hapur publik, zhvillimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës, parimi i prezumimit të pafajësisë, e drejta e të akuzuarve për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën, e drejta e tij për t'u mbrojtur, e drejta të bëjë pyetje dhe të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve, e drejta të ndihmohet falas nga një përkthyes kur nuk kupton gjuhën e përdorur etj.

Në konceptin e nenit 6 të Konventës Europiane, i cili është mjaft i gjerë, parashikohen disa nga të drejtat e njeriut, të cilat në Kushtetutën tonë nuk gjenden të parashikuara vetëm në nenin 42 të saj. Janë edhe nenet 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës, të cilat, në tërësinë e tyre, të japin kuptimin e një përafrimi

me nenin 6 të Konventës Europiane. Ndërsa në Kodin e procedurës civile janë nenet 4, 6, 18, 22, 26, 27, 28 etj., që përmendin elemente të veçanta të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Procesi i rregullt ligjor është një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e një gjykimi të zakonshëm. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës vetëm sa e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij ndonjë kuptim të hollësishëm. Të kuptuarit e kësaj dispozite vështirësohet, pasi nuk jepet ndonjë përkufizim për procesin e rregullt ligjor. Atë që nuk e jep Kushtetuta, është përpjekur ta zgjidhë praktika e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë, të cilat janë orientuar kryesisht nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.Të gjitha këto raste janë zgjidhur nëpërmjet metodave të interpretimit të ligjit.

Problemet e procesit të rregullt ligjor lidhen kryesisht me procedurat gjyqësore. Në të drejtën e individëve për një proces të rregullt gjyqësor përfshihen mjaft të drejta dhe garanci kushtetuese e ligjore. *Shkelja e garancive kushtetuese,* që parashikohen në kreun e lirive dhe të të drejtave vetjake të analizuara nga këndvështrimi i procedurave të ndjekura, janë konsideruar nga gjykatat pjesë përbërëse e një procesi të parregullt ligjor. Megjithëse jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe ajo e Gjykatës së Lartë kanë filluar tashmë të marrin një fizionomi të tyre, në drejtim të kuptimit që paraqet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ-ja për procesin e rregullt ligjor, ende nuk ka një qëndrim të konsoliduar dhe nuk kuptohet lehtë se çfarë përfaqëson ai. Prandaj, nuk mendohet se i jepet zgjidhje kuptimit të procesit të rregullt ligjor me interpretimin si objekt të këtij koncepti kushtetues, pasi është praktika gjyqësore, e cila, duke u pozicionuar gradualisht dhe duke u orientuar më drejt, shmang njëkohësisht edhe ndonjë keqkuptim. Gjithashtu, interpretimi që vetë gjyqtarët u bëjnë dispozitave procedurale në këndvështrimin e standardeve kushtetuese, i konsolidon më tej konceptet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Kështu, mundësinë e individit për t'iu drejtuar gjykatave për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e atyre ligjore, për shkak të rëndësisë së posaçme, praktika gjyqësore e ka parashikuar shprehimisht si të drejtë vetjake në nenin 42 të saj. Me vendimin 25/2002, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetuese pikën 2 të nenit 34 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikonte se dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të prokurorit është i paankimueshëm, duke arsyetuar : *"E drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore edhe nga Konventa Europiane... dhe se ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar. Kufizimi që i bën kësaj të drejte dispozita e ligjit ... nuk gjen mbështetje edhe te neni 17 i Kushtetutës".*

E drejta për një seancë të drejtë e të ndershme përfshin të gjitha procedurat dhe garancitë dhe qëndron në thelb të konceptit për gjykim të drejtë. Standardet ndërkombëtare që udhëheqin drejtimin e gjykimit bëjnë të qartë se këto të drejta përbëjnë *garanci minimale.* Respektimi i secilës prej këtyre garancive nuk siguron në të gjitha rastet e rrethanat se një seancë ka qenë e ndershme dhe e drejtë. E drejta për gjykim të drejtë është më e gjerë se shuma e garancive individuale dhe varet nga i gjithë drejtimi i gjykimit.

Një parim themelor dhe parakusht për gjykim të drejtë është që gjykata e ngarkuar me përgjegjësinë e bërjes së vendimeve për një çështje, *duhet të jetë e krijuar me ligj, si dhe të jetë kompetente, e pavarur dhe e paanshme.* E drejta për gjykim përpara një gjykate kompetente, të pavarur e të paanshme, të krijuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet dhënë, por, gjithashtu, ajo duhet të shihet se po jepet.

Në praktikën gjyqësore është konsideruar shkelje e procesit ligjor rasti i dhënies së vendimit nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që ligji kërkonte trup gjykues. Dhënia e vendimit nga një gjyqtar i vetëm në rastin konkret lidhet me mungesën e kompetencës së organit përkatës dhe njëkohësisht shkel konceptin kushtetues që parashikohet në nenin 42 të saj për zhvillimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Në vendimin nr 35, datë 12.12.2003, Gjykata Kushtetuese, duke interpretuar dispozitat e Kodit të procedurës civile në funksion të standardeve kushtetuese, arsyeton *"...se mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në momentin e paraqitjes së padisë, të disa rregullave procedurale që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi, ka sjellë cenimin e një elementi thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente.*

Çështjen në shqyrtim, gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar me një gjyqtar të vetëm. Neni 35 i Kodit të procedurës civile ka parashikuar si një kusht thelbësor për përbërjen e rregullt të trupit gjykues, vlerën në lekë të aktit administrativ që kundërshtohet. Përcaktimi i vlerës së padisë në rastet e kundërshtimit të paligjshmërisë së akteve administrative, përbën njëkohësisht një element thelbësor për të vendosur për gjykatën kompetente.

Gjykata e shkallës së parë, kur ka pranuar për shqyrtim kërkesëpadinë, nuk e ka vlerësuar këtë aspekt të rëndësishëm procedural, i cili bëhet vendimtar në ecurinë e mëtejshme të procesit. Verifikimi i kompetencës, i juridiksionit apo i përbërjes së rregullt të trupit gjykues për gjykimin e një çështjeje, si momente thelbësore të një procesi ligjor, të cilat kanë gjetur pasqyrim në pjesë të veçanta të Kodit të procedurës civile, mbeten si një detyrim për t'u zgjidhur nga vetë gjykata dhe që nuk lidhen domosdoshmërisht me disponibilitetin e palëve në gjykim.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke shqyrtuar një padi që kishte për objekt kundërshtimin e aktit administrativ me një vlerë të konsiderueshme, por edhe të matshme objektivisht, ka lejuar shkeljen e një prej elementeve thelbësore të procesit të rregullt ligjor, që ka të bëjë me gjykatën kompetente".

E drejta për t'u dëgjuar në seancë *nga një gjykatë e paanshme* është një tjetër element i rëndësishëm që gjykatat, kur e kanë interpretuar, e kanë konsideruar si pjesë përbërëse të procesit të rregullt ligjor.

Paanshmëria e vërtetë dhe të hequrit si i paanshëm janë që të dyja themelore për ruajtjen e respektit ndaj drejtësisë. E drejta për një gjykatë të paanshme kërkon që gjyqtarët të mos kenë interesa në një çështje të veçantë dhe të mos kenë mendime të paraformuara rreth saj.

Paanshmëria nënkupton që gjyqtarët nuk duhet të fshehin paragjykime rreth çështjes së vënë përpara tyre dhe se ata duhet të mos veprojnë në mënyra që nxitin interesat e njërës palë. Sfidat ndaj paanshmërisë së gjykatës janë shkaktuar në kontekste të ndryshme, përfshirë rastin kur një gjyqtarë ka marrë pjesë në shkallë të tjera të proceseve në cilësi tjetër, si dhe kur gjyqtarët kanë pasur interes vetjak në proceset ose ndonjë marrëdhënie me një nga palët.

Rastet që ekzaminojnë paanshmërinë e gjykatave, paraqiten në dy aspekte: *njëri është testi objektiv* që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm të anshmërisë, *tjetri është testi subjektiv* që shqyrton anësinë vetjake. Këto raste tregojnë që pamja e jashtme e anshmërisë vlerësohet bashkë me anshmërinë e vërtetë. Ekziston mendimi i përgjithshëm që gjyqtari është personalisht i paanshëm, derisa njëra nga palët të mos ngrejë prova për të kundërtën në rrjedhën e procesit. Paanësia e gjykatës në një proces është jo vetëm garanci kushtetuese për respektimin e të drejtave dhe lirive të individit, por njëkohësisht ndikon në konsolidimin e sistemit gjyqësor.

Në praktikën gjyqësore ka raste të shkeljes së këtij parimi të rëndësishëm. Një gjyqtar, i shkarkuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se është shkelur parimi i paanësisë, pasi në përbërje të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kishin gjykuar ankesën e tij ndaj shkarkimit nga detyra, kishin marrë pjesë dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 48/1999, konkludon se pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më

qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Fakti që dy gjyqtarë të Kolegjeve të Bashkuara marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse është institucioni ose organi, anëtarë të të cilit ata janë zgjedhur, është një shkak i arsyeshëm që nuk mënjanon te kërkuesi dyshimin që, në rastin konkret, objektivisht ekziston. Shkelja e parimit të paanshmërisë në gjykim ishte një shkak i arsyeshëm për Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar vendimin e Kolegjeve të Bashkuara.

E drejta e individëve për t'u mbrojtur përbën thelbin e konceptit që jurisprudenca gjyqësore ka krijuar për procesin e rregullt ligjor. Garancitë që ofron neni 31 i Kushtetutës, në analizë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane, kur janë vërejtur nga gjykatat se janë shkelur, kanë sjellë cenimin e të gjithë procesit.

Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale dhe jurisprudencës gjyqësore, në një proces gjyqësor, avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur avokati vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij në mbrojtje të të drejtave të klientit, ai shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat.

E drejta për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme është një tjetër standard kushtetues e ligjor mbi ecurinë normale të procesit.

Procedurat duhet të fillohen dhe të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme. Kjo e drejtë i detyron autoritetet të sigurojnë që të gjitha procedurat, nga fazat paraprake, deri tek apeli përfundimtar, të përfundojnë dhe të jepen gjykimet brenda një kohe të arsyeshme. E drejta për t'u gjykuar menjëherë përmban në vetvete maksimën që drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. Se çfarë është një kohë e arsyeshme, gjykohet dhe interpretohet nga rrethanat e secilit rast. Elementet që merren në shqyrtim, përfshijnë legjislacionin, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e vetë palës si dhe sjelljen e autoriteteve.

Një kriter thelbësor i një seance të drejtë e të ndershme në një çështje është *parimi i "barazisë së armëve"* midis palëve. Barazia e mjeteve, që duhet respektuar gjatë gjithë procesit të gjykimit, do të thotë që të dyja palët të trajtohen në një mënyrë që i siguron ato të kenë pozitë të barabartë procedurale gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të jenë në pozita të barabarta për të paraqitur çështjen e tyre. Ajo do të thotë që secilës palë duhet t'i ofrohet mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet në kushte që nuk e vënë atë në disavantazh të konsiderueshëm ndaj palës kundërshtare.

Ky parim është sanksionuar edhe në dispozitat procedurale. Në nenin 19 të Kodit të procedurës civile parashikohet: "Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështetin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u

referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim". Në nenin 155 dhe 156 të këtij Kodi janë përcaktuar rregullat për njoftimin e padisë dhe të akteve që i bashkëngjiten asaj, si dhe koha e nevojshme që i sigurohet të padituri për t'u njohur me këto akte dhe për t'u përgatitur për gjykimin e çështjes.

d – ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Çështja e parë

Krijoni tri vendime fiktive mbështetur në dispozitat ekzistuese të legjislacionit shqiptar, ku zgjidhja e çështjes të bëhet nëpërmjet interpretimit: 1) me analogji, 2) në sensin e kundërt *(a contrario)*, 3) duke marrë në konsideratë qëllimin e ligjbërësit.

Çështja e dytë

Gjyqtari duhet të jetë i vetëdijshëm se gjatë veprimtarisë së tij si interpretues i normave ligjore mund të vihet në shënjestër të kritikave që bazohen mbi perceptimet e ndryshme për dallimin midis ligjbërjes dhe interpretimit të ligjeve, midis ligjit dhe faktit dhe, në përgjithësi, mbi qëndrimin e përhapur negativ drejt çdo gjëje që perceptohet si sjellje "legalistike" apo "sjellje juristi".

Është gjithashtu e rëndësishme të mendohet për pabazueshmërinë e disa presupozimeve lidhur me natyrën e arsyetimeve gjyqësore. Në këtë këndvështrim, do të ishte mjaft i dobishëm leximi i kapitullit për interpretimin dhe zbatimin, në librin e W. Twining – D. Miers, *Si të veprojmë me ligjet. Manuali i interpretimit* (London-Dublin-Edingburgh, botimi i 3-të, 1991, f. 172 – 199). Shpjegoni nëse dhe në ç'mënyrë dallimet e përmendura në faqet e këtij libri zbatohen në kontekstin aktual shqiptar.

Po ashtu, do të ishte me mjaft interes shkrimi i juristit shqiptar, Kristaq Traja, i cili mban një qëndrim kritik ndaj praktikës së deritanishme shqiptare.[5)]

1. Interpretimi dhe zbatimi – Interpretimi: Çfarë është?

Teologët interpretojnë Biblën; producentët, aktorët dhe kritikët interpretojnë

5 K. Traja – Gjyqtar në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg. Artikuj teorikë – "Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Koha e precedentit", Jeta Juridike, nr.1, tetor 2005.

veprat; historianët interpretojnë ngjarjet e së kaluarës dhe juristët, si pjesë të punës së tyre profesionale, interpretojnë ligje, rregullore, çështje, kontrata, testamente dhe lloje të tjera të dokumenteve.

Fjala *interpretim* ka disa nuanca kuptimore. Për sa u takon normave ligjore, fjala *interpretim* zakonisht përdoret në kuptimin e *qartësimit të fushës së veprimit të normave* ose *dhënies së kuptimit* të një norme ose pjese të saj. Në disa kontekste, ajo mund të trajtohet si sinonimike me fjalë të tilla, si: *sqaroj, trajtoj, shpjegoj* ose *shtjelloj*. Të gjitha këto nuanca sugjerojnë se fjala konkrete ka një kuptim të qëndrueshëm dhe të përcaktuar dhe është roli i interpretuesit që ta kërkojë dhe ta nxjerrë në pah këtë kuptim, si në kërkim të një thesari të fshehur. Por, shpesh, fjala *interpretim* përdoret për të sugjeruar një rol më të gjerë të interpretuesit, i cili përfshin një element të shpjegimit ose të zgjedhjes, madje edhe të krijimit. [...] Pra, analogjia e thesarit të fshehur nuk përshtatet në kontekstin e interpretimit të Hamletit nga Oliver, ose të Sonatave të Betovenit nga Brendel, ose të interpretimit të lirë të Kuranit nga teologët myslimanë. Në këto kontekste, do të dukej e çuditshme ta trajtoje interpretimin vetëm si një çështje shpjegimi ose zbulimi. Interpretuesi punon me një material që ofron hapësira të variueshme për zgjedhje ose ndërhyrje nga ana e tij.

Hapësirat për zgjedhje dhe krijim në procesin e interpretimit varen pjesërisht nga mundësitë që ka për t'u përshtatur materiali bazë që do të interpretohet, pjesërisht nga situata dhe koncepti i përkthyesit për rolin e tij dhe pjesërisht nga një sërë faktorësh të tjerë. Në këtë libër ne trajtojmë interpretimin e normave, të formulimeve të normave dhe në kapitujt vijues, interpretimin e burimeve të së drejtës, pra materialin bazë (lëndën e parë) të normave të së drejtës, që janë çështjet dhe ligjet. Në kontekstet që merren me trajtimin e normave, është normale që metodat e interpretimit të krahasohen duke përdorur terma të tillë, si *"strikt", "literal", "liberal"* dhe *"i lirë"*. Mbiemra të tillë mund të përdoren për të përfaqësuar momente të ndryshme të një procesi, i cili varion nga kërkimi dhe zbulimi i thjeshtë i një kuptimi të përcaktuar qartë në një veprimtari që i afrohet relativisht krijimit të lirë të diçkaje të re.

Në teologji, bëhet dallimi ndërmjet komentimit (interpretimit gjuhësor strikt të teksteve biblike) dhe shpjegimit të shkrimeve të shenjta (kërkimit të së vërtetës shpirtërore të fshehur pas teksteve). Termi "shpjegimet e shkrimeve" është prezantuar në shkencën sociale nga Dilthey dhe të tjerë dhe është bërë i qëndrueshëm në këtë kontekst si një term që karakterizon pikëpamjen se veprimet njerëzore duhet të shpjegohen nëpërmjet kuptimeve të brendshme që u jepen këtyre veprimeve nga vetë personat që i kryejnë ato. Është sugjeruar se Hart, i cili e vë theksin në pikëpamjet e brendshme të normave, përkrah një lloj të tillë interpretimi edhe për ligjet.

Midis shpjegimeve të shkrimeve në teologji dhe shkencave sociale dhe metodave liberale të interpretimit të ligjeve ekziston një ngjashmëri në atë se të gjitha këto metoda fokusohen te qëllimi dhe synimi, si tiparet kryesore për të kërkuar kuptimet e fjalëve. Në kontekstin aktual, ne do ta zgjerojmë herë pas here termin *interpretim* për të përfshirë, si 'fushën e veprimit' të normave (situatat konkrete që ato mbulojnë), ashtu edhe 'kuptimin' e tyre. Këto janë dy ide të ndara, por të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën: për shembull, në raste të dyshimta, një ushtar ose një burokrat, të cilët mund ta kenë një koncept të qartë të fushës së veprimit të normave ose të rregulloreve, mund t'i zbatojnë ato në mënyrë "shabllone", pa e kuptuar qëllimin ose "thelbin" e tyre të vërtetë. Kuptimi i një norme (i shpjeguar ndoshta sipas qëllimit, synimit ose kontekstit) mund të jetë një ndihmë e dobishme për të përcaktuar fushën e saj të veprimit, por, dikush mund të jetë i interesuar në 'kuptimin' e një norme relativisht të qartë për arsye të tjera, për shembull, për ta kritikuar atë.

Çështja sa vjen dhe thellohet. Ajo që përfshihet në kuptimin e një situate, norme ose ligji, është një çështje serioze dhe mjaft problematike e teorisë sociale. Kohët e fundit, interpretimi i ligjeve ka tërhequr vëmendjen e akademikëve (kërkuesve) të disiplinave të tjera, duke përfshirë gjuhësinë, semiotikën (studimi i shenjave), retorikën, teorinë letrare dhe historinë e ideve. Ka pasur debate mjaft të nxehta sa u takon analogjive mes interpretimit të teksteve ligjore, letrare dhe teologjike. Kur kemi shkruar hyrjen e interpretimit të normave, jemi përballur me një dilemë: nga njëra anë, ne nuk mund ta trajtojmë në mënyrë të detajuar këtë gamë të gjerë të çështjeve komplekse dhe perspektivave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, nuk mund t'i trajtojmë ato si të shkëputura nga njëra-tjetra. Strategjia jonë do të jetë të përqendrohemi te vështirësitë e përcaktimit të fushës së veprimit të normave të veçanta (aspekti i ngushtë i interpretimit), pasi këto janë tepër komplekse dhe meritojnë vëmendje të veçantë, por do të sugjeronin se është po aq e dobishme dhe shpesh e domosdoshme, të kërkosh, të gërmosh, të përcaktosh ose të ndërtosh kuptimin e një norme për të përcaktuar fushën e saj të veprimit dhe kjo është, pa dyshim, një detyrë e vështirë [...].

Por, vëmendja tërhiqet përsëri: interpretimi literal dhe gjuhësor po trajtohet si sipërfaqësor dhe interpretimi liberal dhe i nxjerrjes së kuptimit të brendshëm, si më i thellë. Në fund të fundit, fjalët dhe teksti ngjasojnë me sipërfaqen, ndërsa eksplorimi i kuptimit, i qëllimit dhe i kontekstit nënkupton zhytjen në këto thellësi të errëta. "Letra zhduket, por shpirti mbijeton". Kjo është një pikëpamje tërheqëse, por implikon supozime që janë sipërfaqësore dhe të rrezikshme. Për shembull, ajo pranon se analiza tekstuale është më e thjeshtë sesa atribuimi i kuptimit ose ndërtimi i qëllimeve; pranon se interpretimi liberal

parapëlqehet më shumë se interpretimi literal; ajo nuk lë hapësira për norma të pakuptimta, të paqëllimta ose joracionale; dhe, më e rrezikshmja nga të gjitha, ajo provokon analiza të rrepta të tekstit kundrejt eksplorimit të kuptimit, qëllimit, synimit dhe kontekstit. Në vazhdim do të sfidojmë secilin prej këtyre supozimeve, pa fshehur parapëlqimin tonë të përgjithshme për një metodë liberale dhe kontekstuale të interpretimit. Interpretuesi i aftë i kushton vëmendje pikëpamjes kryesore, tekstit dhe kontekstit.

2. Ligji dhe fakti

Para së gjithash, interpretimi i normave ligjore duhet të dallohet nga zbulimi i fakteve në bazë të këtyre normave. Në kontekstin ligjor, ky dallim zakonisht karakterizohet nga termat "çështje e ligjit" dhe "çështje mikse të ligjit dhe të faktit". Ndërsa këta terma të saktë nuk përdoren gjerësisht në kontekstet joligjore, dallimi ndërmjet tyre është i njohur dhe disa prej implikimeve të tij zbatohen njëlloj. Për qëllime ligjore, *së pari,* këto implikime kanë të bëjnë me atë që vendimet për çështjet e faktit zakonisht nuk përbëjnë precedentë për intepretuesit e mëpasshëm, ndërsa vendimet për çështjet e ligjit përbëjnë precedentë; *së dyti,* në gjyqet me juri, çështjet e faktit zakonisht u rezervohen anëtarëve të jurisë, ndërsa çështjet e ligjit i takojnë ekskluzivisht gjyqtarit (megjithatë, gjyqtari mund t'i anulojë disa çështje të faktit ose mund t'i japë udhëzime jurisë për mënyrën e marrjes së vendimit për një çështje të caktuar); *së treti*, vendimet për çështjet e ligjit zakonisht kërkohet të mbështeten nga justifikime publike, ndërkohë që kjo gjë nuk kërkohet për vendimet për çështjet e faktit; *së katërti*, në rastet e apelimeve kundër konstatimit të përgjegjësisë penale, si bazueshmëria e apelimit, ashtu edhe kushtet sipas të cilave mund të lejohet apelimi, orvaten të jenë më të favorshme për personin e dënuar në rastet kur apelimi përfshin çështje të ligjit, në raport me rastet kur apelimi përfshin vetëm çështje të faktit ose çështje mikse të ligjit dhe të faktit; *së pesti*, gjykatat e apelit nuk do ta hedhin poshtë një zbulim të fakteve (pasi ato, as nuk kanë parë dhe as nuk kanë dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve nën ekzaminim). Ato mund ta hedhin poshtë atë vetëm nëse zbulimi i konstatuar nga gjykata më e ulët nuk ka qenë i mbështetur në provat që janë paraqitur para saj, ose ka qenë kaq i paarsyeshëm sa të mos ketë kuptuar realisht se cilat janë kërkesat e ligjit.

Me pak fjalë, nga dallimi i çështjeve të faktit dhe çështjeve të ligjit vijnë pasoja të rëndësishme praktike. Por, të përcaktosh bazën konceptuale mbi të cilën mbështetet ky dallim nuk është aspak e lehtë dhe, për këtë, ekzistojnë dy arsye kryesore: *E para* është se avokatët trajtojnë si çështje të faktit çështje

të cilat, në kontekstet joligjore, nuk mendohen si të tilla. Shembull tipik është vlerësimi i fakteve të çështjes (cili është veprimi që ka kryer dikush, kur, me kë ose në emër të kujt e ka kryer, me çfarë ideje apo qëllimi e ka kryer dhe me çfarë pasojash), si një veprim që është në përputhje ose devijon nga një standard i shprehur ose i nënkuptuar nga një normë ligjore që aplikohet për të. Rastet tipike janë gjykimet që lidhen me deri në ç'masë dhe për sa kohë duhet të ekzistojë një tërësi e caktuar faktesh që të përmbushen kërkesat e normës ligjore si dhe gjykimet për sjelljen dhe mendimet e individëve, si kërkesa për ligjshmërinë e vendimeve ose të veprimeve të tyre.

Një shembull tjetër lidhet me interpretimin e fjalëve të zakonshme të përmendura në ligje. Nisur nga premisa bazë se, duke qenë se shpreh ligjet, interpretimi i legjislacionit duhet të jetë çështje e ligjit, gjykatat, sa i takon interpretimit të fjalëve legjislative, pranojnë dy qëndrime: *Së pari,* në rastet kur një fjale i është dhënë një kuptim ligjor i caktuar ose teknik, qoftë nga ligji, qoftë nga një vendim gjyqësor, interpretuesi duhet t'i japë kësaj fjale pikërisht këtë kuptim. Nëse kësaj fjale i jepet një tjetër kuptim, atëherë ajo do të jetë e gabuar si një çështje e ligjit. Nga ana tjetër, në rastet kur fjala është një fjalë e zakonshme e gjuhës angleze, i takon interpretuesit t'i japë asaj kuptimin që ajo mbart zakonisht në kontekstin që përdoret; kjo është një çështje e faktit. Mendoni, për shembull, se një ligj e parashikon si kundërvajtje përfshirjen në sjellje "fyese" në publik; po ashtu, supozoni se dikush hyn në klub në Wimbledon dhe shpërndan fletëpalosje që dënojnë aparteidin në Afrikën e Jugut, teksa dy lojtarë të bardhë nga Afrika e Jugut janë në mes të lojës. Nëse kjo do të përbëjë një sjellje 'fyese', është një çështje që do të marrë përgjigje në varësi të asaj që gjykata kupton me fjalën 'fyerje'. Nëse ajo do t'i japë fjalës kuptimin që ajo mbart zakonisht në kontekstin e përdorur, gjykata e apelit nuk do ta hedhë poshtë vendimin edhe në rast se nuk bie dakord me këtë vendim; por ajo do ta rrëzojë vendimin nëse ai është i pabazuar në kuptimin që asnjë gjykatë e familjarizuar me përdorimin e zakonshëm të gjuhës, normalisht, nuk do ta merrte atë vendim. Ajo do të vepronte po njësoj në rastet kur fjala ka një kuptim të qëndrueshëm në kontekstin e një dispozite të veçantë statutore. *Arsyeja e dytë* është se gjykatat nuk kanë përcaktuar kritere përfundimtare për të vendosur nëse një çështje është çështje ligji ose fakti. Për shembull, ndërsa pasojat e dy qëndrimeve të mbajtura për interpretimin e fjalëve statutore të përmendura në paragrafin e mësipërm janë të qarta, ajo çka nuk është e qartë është baza mbi të cilën një interpretues duhet të bëjë gjykimin fillestar për një fjalë të caktuar – pra, nëse ajo ka kuptim të zakonshëm apo mbart një kuptim teknik ose specifik. Ka një sërë rastesh në të cilat, gjatë viteve, gjykatat i kanë trajtuar në mënyra të ndryshme çështjet, si çështje të

faktit dhe si çështje të ligjit. Duke qenë se ka qenë gjithmonë e vështirë të parashikohet si do të klasifikohet nga gjykatat një çështje e caktuar, disa shkrimtarë e konsiderojnë si një faktor përcaktues qëllimin e klasifikimit. Për shembull, çështjet që mendohet se janë të përshtatshme, vendosen nga juria ose, nga ana tjetër, çështjet që mendohen si të papërshtatshme për t'iu nënshtruar apelimit ose krijimit të precedentëve, do të trajtohen si çështje të faktit. Të përcaktuarit se çfarë është e përshtatshme do të thotë të kërkohet një vlerësim i epërsive dhe i mangësive të një trajtimi të tillë. Të trajtuarit e një çështjeje si çështje e faktit e lejon ligjin të reflektojë standardet kulturore, të zbatohet relativisht lehtë nga magjistratët e rinj ose nga juritë (të cilat do të marrin udhëzime më të thjeshta nga gjyqtari), si dhe të jetë në përputhje me kuptimin e përditshëm. Për të kundërshtuar kritikat se ligji do të zbatohet në mënyra të ndryshme dhe të paqëndrueshme, një çështje mund të trajtohet si çështje e ligjit. Kjo gjë rrit kontrollin e gjykatave të apelit ndaj vendimeve të gjykatave dhe tribunalëve më të ulët, duke garantuar kështu një shkallë më lartë njëtrajtësie në gjykim.

Pavarësisht këtyre vështirësive në klasifikim, disa çështje janë të përcaktuara qartë si çështje të ligjit apo çështje të faktit. Pyetjet, përgjigjet e të cilave varen nga ekzistenca e provave që tregojnë se një fakt është ose nuk është i vërtetë, janë gjithmonë çështje të faktit. Ndodh që këto prova të marrin formën e fakteve materiale, si p.sh.: fotografitë, një dokument ose gjurmët e gishtave mbi një armë; shpesh ato përfshijnë dëshminë e dëshmitarit, ndoshta edhe të një eksperti që dëshmon lidhur me përvojën që ata kanë kaluar. Në secilin prej rasteve, provat mund të jenë të hapura ndaj cenimeve, mbi bazën se ato nuk mund të tregojnë të vërtetën për çështjen në diskutim (për shembull, dokumenti ka qenë fals ose dëshmitari okular nuk ka pasur fushëpamje në kohën materiale), se ajo nuk është përfundimtare (për shembull, shenjat e gishtave janë të paqartë ose dëshmitari okular ka qenë në kushtet e pamjes së kufizuar). Kështu, probabiliteti i fakteve të pohuara për të qenë të vërteta është i ulët ose, edhe nëse provat tregojnë të vërtetën, ato nuk duhet (me ose pa kualifikim) të pranohen (për shembull, nëse dëshmitari okular është bashkëpunëtor). Gjithsesi, duhet të jemi të kujdesshëm për të mos folur për këto raste, në dukje të thjeshta, që përfshijnë identifikimin e objekteve dhe personave, sikur me identifikimin e tyre faktet nuk kërkojnë përpunim të mëtejshëm. Duke folur kundër nocionit se faktet mund të mendohet se *flasin për vete*, White argumenton: "avokati e di se për të provuar çështjen e tij nuk duhet vetëm të demonstrojë të vërtetën ose probabilitetin e premisave të caktuara të fakteve; ai duhet t'i paraqesë gjyqtarit ose jurisë një këndvështrim të arsyeshëm për çështjen në tërësi dhe ky këndvështrim nuk duhet të ketë

kuptim vetëm si një çështje e rrethanave faktike, por edhe si një mbështetje e veprimeve që janë kryer".

Ndërsa çështje të këtij lloji kërkojnë përgjigje për pyetjet, si: Kush po e ngiste atë makinë? Në çfarë date? Në cilin qytet? (të cilave mund t'u kthehet përgjigje vetëm nëpërmjet procesit të interferimit, sepse në të vërtetë askush nuk e ka parë të padituriu, por është parë makina e tij dhe ai nuk ka asnjë alibi për kohën materiale), çështje të tjera të faktit kërkojnë përgjigje për pyetje të tilla, si: Si po e ngiste makinën shoferi? (kushdo që të ishte) ose Cila mund të ishte shkalla e tij e përqendrimit në varësi të mënyrës si po e ngiste ai makinën?. Për shembull, një fotografi mund të tregojë shenja të thella të gomave në sipërfaqen e rrugës që kanë filluar 20 metra larg dhe kanë mbaruar në mes të rrugës së kalimit me vija të bardha. Çështja është si duhet të përshkruhet ngarja e makinës nga këto të dhëna, si: normale, e shpejtë ose tejet e shpejtë për rrethanat dhe, për frenimin, si: i kontrolluar, i menjëhershëm ose i vonuar. Gjithsesi, mund të arrihet në përfundimin se, faktikisht, shenjat e gomave në rrugë tregojnë se shoferi po e ngiste shpejt makinën dhe nuk po i kushtonte shumë vëmendje këtij procesi. Po ashtu, mund të arrihet në përfundimin se ai po thyente një normë ligjore të caktuar për mënyrën e ngarjes së makinës dhe përsëri mbetet për t'u vendosur nëse kjo mënyrë e ngarjes së makinës është *pakujdesi* ose *papërgjegjshmëri* dhe në kundërshtim me aktin "Për trafikun rrugor" të vitit 1988. Sikurse e kemi parë, edhe kjo çështje është një çështje e faktit dhe, në rast se magjistratët ose juritë duhet të vendosin nëse i padituri e ka ngarë makinën *në mënyrë të pakujdesshme* ose *të papërgjegjshme,* gjykata e apelit do të ndërhyjë në vendimin e tyre vetëm nëse vendimi do të ishte marrë pa qenë askush i familjarizuar me përdorimin e zakonshëm të këtyre fjalëve.

Në mënyrë të ngjashme, disa çështje janë vetëm çështje të ligjit, si çështjet që lidhen me procedurën, juridiksionin, pranueshmërinë e provave ose ligjin e zbatueshëm. Madje është çështje e ligjit edhe pyetja *nëse një çështje e caktuar është çështje ligji apo fakti.* Nuk është e vështirë të jepen shembuj të zbatimit të këtij dallimi në kontekstet joligjore. Për shembull, pyetja *Ishte Johnny ai që hëngri reçelin?* është një çështje e faktit, ndërsa pyetja nëse përdorimi i bishtit të fshesës nga Johnny përbën *hyrje në qilar* është një çështje që përfshin kuptimin e fjalës "hyrje" dhe është çështje interpretimi. Nëse Johnny kapej në hyrjen e qilarit me derën gjysmë të hapur, me këmbën të pozicionuar sikur të donte ta mbante derën hapur dhe me një tabaka me ushqim në duar, çështja e faktit do të ishte nëse këmba e tij ndodhej brenda kufirit të qilarit dhe çështja e interpretimit do të ishte që, nëse këmba e tij ndodhej brenda kufirit të qilarit, a do të përbënte kjo gjë "hyrje" sipas kuptimit të normës ligjore. Nëse çështja do të parashtrohej

në formën e një pyetjeje të vetme: *A hyri Johnny në qilar?,* atëherë do të ishte një çështje mikse e faktit dhe e interpretimit.

Në pothuajse të gjithë shembujt e përmendur këtu, realë dhe hipotetikë, faktet nuk janë të diskutueshme. Kjo eliminon një vështirësi që është thelbësore, si për praktikën ligjore, ashtu edhe për shumë probleme në jetën reale që përfshijnë normat në kontekstet joligjore. Në shumë situata problematike, ekziton dyshimi ose paqartësia rreth asaj që ka ndodhur në të vërtetë. Këto çështje dalin jashtë temës së këtij shkrimi, por kjo nuk do të thotë aspak se ato janë të parëndësishme.

3. Interpretimi dhe zbatimi

Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet nocioneve të interpretimit dhe zbatimit të një norme ligjore, megjithëse në praktikë ky dallim nuk është gjithmonë i qartë. Në kuptimin e tij të ngushtë, "interpretimi" i referohet sqarimit të fushës së përgjithshme të veprimit ose të kuptimit të një norme. Ndonjëherë, interpretimi i një norme mund të kërkohet pa iu referuar ndonjë ngjarjeje ose situate specifike, në pothuajse të njëjtën mënyrë sikurse hartuesi i një fjalori synon të qartësojë kuptimet e një fjale, pa iu referuar domosdoshmërisht ndonjë rasti të veçantë në të cilin ajo është përdorur. Po ashtu, një ligj mund të ketë një seksion ku të japë përkufizime ose sqarime të fjalëve të përdorura në ligj. Këto japin udhëzime të përgjithshme për zbatimin e ardhshëm të normave ligjore. Por, dyshimet dhe paqartësitë për interpretimin më shpesh ngrihen duke iu referuar disa rasteve ose ngjarjeve që supozohet të kenë ndodhur apo që janë hipotetike. Në kontekste të tilla, nuk është gjithmonë e lehtë të bëhet dallimi ndërmjet interpretimit të një norme (i përgjithshëm) dhe zbatimit të saj për faktet e çështjes (specifik).

Është e rëndësishme të kuptohet përse ndodh shpesh që ky dallim të mos funksionojë. Interpretimi i normës ndodh sa herë që ajo zbatohet për një çështje të veçantë për të prodhuar një rezultat të caktuar; por mënyra e interpretimit të normës mund të mos jetë e shprehur dhe të jetë lënë e nënkuptuar. Nëse ka dyshime se cili duhet të ishte rezultati në një çështje të caktuar, nuk do të thotë se ky rezultat do të ishte më i qartë nëse dyshimi do të kishte lidhje me interpretimin ose zbatimin, ose me të dyja këto; po ashtu, ky mund të mos jetë domosdoshmërisht rasti kur dyshimi zgjidhet ose me kalimin nga intepretimi i përgjithshëm te ai specifik, ose anasjelltas. Më tej, termat si *i përgjithshëm* dhe *specifik* janë çështje relative dhe disa prej zgjedhjeve më të vështira që duhen bërë gjatë interpretimit, lidhen me zgjedhjen e niveleve të duhura të përgjithësimit.

Një prej karakteristikave të traditës common law është parapëlqimi për të proceduar më shumë me marrjen e vendimit rast pas rasti, sesa nëpërmjet formulimit paraprak të normave të përgjithshme dhe të qarta. Tradita common law shpesh zhvendoset nga interpretimi specifik në atë të përgjithshëm, madje edhe nga interpretimi specifik në një interpretim tjetër specifik, më shumë sesa nga interpretimi i përgjithshëm në atë specifik.

Kur një gjykatë ose ndonjë interpretues tjetër i autorizuar vendos se një çështje e veçantë ndodhet brenda fushës së veprimit të një doktrine të caktuar, ato mund të lënë shprehimisht ose në mënyrë të tërthortë pyetje të hapura për rastet në të ardhmen lidhur me fushën e veprimit të normës ose të parimit përkatës. Kjo gjë mund të shprehet në mënyrë analitike, si në vijim: 'Nëse X, atëherë Y.' Le ta themi me një shembull specifik. Shprehja-(shën i red) "kjo është një çështje e X-it" përfshin interpretimin e normës ose të parimit, pasi ajo thotë diçka rreth fushës së saj të veprimit, megjithëse lë të hapura çështjet e kufijve të saj të jashtëm. Ka një ndryshim kur thuhet "kjo është një çështje e qartë e X-it" dhe të jepet një përkufizim i përgjithshëm i X-it, por të dyja janë shembuj të interpretimit të X-it.

4. Trajtimi i normave ligjore

Mendoni për grupet e mëposhtme të foljeve, të cilat zakonisht përdoren me fjalët *normë* ose *norma,* si objekte të tyre:

(a) hartoj, bëj, ndryshoj, miratoj, përshtas;
(b) shpall, deklaroj, komunikoj;
(c) zbuloj, identifikoj;
(d) shpreh, shtjelloj, shpjegoj, analizoj, rishpreh, perifrazoj, sqaroj;
(e) interpretoj, zbatoj, dalloj, apeloj;
(f) i bindet, është në përputhje me, respektoj, punoj për, ndjek, veproj sipas;
(g) nuk i bindet, shkel, dhunoj, injoroj, shmang;
(k) shtrembëroj, zgjeroj, manipuloj, kufizoj, ngushtoj, reduktoj, anashkaloj, përjashtoj;
(i) zbatoj, mbështes, mbroj, kritikoj, kundërshtoj, nuk miratoj;
(j) rrëzoj, anuloj, jap, shfuqizoj, bëj të paefektshme.

Kjo listë, e cila, sigurisht, këtu nuk mund të jepet e plotë, paraqet disa tregues të gamës së gjerë të veprimtarive të përfshira në *trajtimin e normave ligjore.* Grupimet sugjerojnë një mënyrë të gatshme dhe të përafërt për diferencimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive që merren me trajtimin e normave ligjore. Eksplorimit dhe shpjegimit të marrëdhënieve mes këtyre veprimtarive, si dhe veprimtarive të tjera që mund të lidhen me to, mund t'u

kushtohet një libër i tërë. Një teori gjithëpërfshirëse për trajtimin e normave ligjore në përgjithësi do të kishte nevojë për një sistem të zhvilluar të koncepteve dhe të dallimeve. Për shembull, mendoni disa nuanca kuptimore që përcillen nga dallimi ndërmjet *mosmiratimit* dhe *kritikës* së një norme, ose ndërmjet *bindjes* ndaj rregullave dhe *të punuarit sipas rregullave.* Me qëllimin e demonstrimit në një mënyrë tepër të përgjithshme të marrëdhënies midis interpretimit dhe veprimtarive të tjera që lidhen me normat, këto sofistikime janë të panevojshme, megjithëse mund të jenë shpjeguese. Në këtë fazë, do të kufizohemi vetëm në trajtimin e tri çështjeve:

Së pari, disa prej foljeve të listës janë shembuj të qartë të veprimtarisë që zakonisht kuptohet si *interpretim*, ndërsa të tjera, siç janë, për shembull, *zgjeroj, shtrembëroj* ose *ngushtoj* lidhen me kufijtë e fushës së veprimit. Në kontekstin e trajtimit të normave, për aq kohë sa fjalë të tilla nënkuptojnë përcaktimin e fushës së veprimit të normës, ato trajtohen me të drejtë si shembuj të interpretimit.

Së dyti, disa prej veprimtarive janë kërkesa të interpretimit, megjithëse të pavarura nga ky proces. Me fjalë të tjera, interpretimi i një norme presupozon se ajo është ekzistente, se është identifikuar dhe ndoshta është pranuar si e vlefshme. Shumëkush mund ta përcaktojë, ta deklarojë dhe ta shpallë një normë edhe pa e interpretuar atë, por do të ishte e çuditshme të thuhej se është interpretuar një normë që nuk është bërë ende ekzistente, ose që nuk është e përcaktuar. [...] Ekziston një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet interpretimit të një norme dhe hartimit të normave të shkruara dhe të përcaktuara. Normalisht, hartuesi do të përpiqet të paraprijë kuptimet e mundshme që mund t'i bashkëlidhen formulimit të tij dhe do të përpiqet të përdorë fjalë në një mënyrë të tillë që të përjashtojë interpretimet që mund të prishin objektivin (objektivat) e normës. Për hartuesin e normës mund të thuhet se ai interpreton paraprakisht ekzistencën e normës. [...]

Së treti, disa prej foljeve presupozojnë interpretim. Kështu, foljet *bindem, nuk bindem, kundërshtoj, funksionoj, shmang* dhe *kritikoj* presupozojnë se aktori i ka bashkëlidhur normës një kuptim të caktuar, në mënyrë të shprehur ose të pashprehur. Po ashtu, është i mundur përdorimi i termave, si *mosbindje* ose *pajtueshmëri me,* për të përshkruar sjelljen e një aktori që nuk është i ndërgjegjshëm për normën në fjalë; por, një përshkrim i tillë presupozon në vetvete një interpretim të normës.

Çështja se interpretimi mund të presupozohet nga një lloj tjetër veprimtarie, ose mund të jetë pjesë e saj, meriton vëmendje për dy arsye: *së pari*, sepse kaq shumë veprimtari që merren me trajtimin e normave, e presupozojnë ose e përfshijnë interpretimin dhe e justifikojnë faktin që ne e konsiderojmë si aftësi

bazë aftësinë interpretuese dhe, *së dyti*, sa herë që interpretimi është pjesë e një veprimtarie tjetër, kjo veprimtari është pjesë e një konteksti të përgjithshëm që garanton standarde për gjykimin e përshtatshmërisë së një interpretimi të caktuar. Për shembull, një avokat mund ta përpunojë më tej interpretimin e veçantë të një ligji si pjesë e përpjekjes për të bindur gjykatën që ta marrë vendimin në favor të klientit të tij. Ky rol dhe ky synim garantojnë një bazë për vlerësimin e përshtatshmërisë së interpretimit të tij. Zakonisht, interpretimi është një prej elementeve në veprimtaritë ose detyrat më komplekse që merren me trajtimin e normave. Disa prej veprimtarive që merren me trajtimin e normave, nuk e përfshijnë domosdoshmërisht interpretimin, për shembull, shpallja ose shfuqizimi i një norme; por, shumë prej veprimtarive që merren me trajtimin e normave, e përfshijnë ose e presupozojnë interpretimin. Në rrethana të tilla, detyra e interpretimit, në kontekstin e veprimtarisë, duhet të shihet si një e tërë.

5. Kush interpreton?

Gjatë shqyrtimit të funksioneve të normave dhe zgjidhjes së problemeve nëpërmjet normave, ne kemi trajtuar kryesisht, por jo ekskluzivisht, çështjen e ndryshimit midis pasjes dhe mospasjes së normave. Këto çështje janë veçanërisht të rëndësishme për një lloj aktori, i cili është në pozicion të tillë që mund të influencojë mbi ngjarjet duke prezantuar, shfuqizuar ose ndryshuar një normë – me fjalë të tjera, legjislatori ose ligjbërësi, qoftë Parlamenti, një autoritet lokal, senati i një universiteti, anëtarët e një shoqate që hartojnë statutin e tyre, gjyqtari që interpreton një ligj. Por, kjo lloj mundësie nuk është e hapur për të gjithë. Shumë probleme që lidhen me normat, lindin në një situatë kur norma ekziston; ajo është një mjet që sfidon aktorin. Për aktorin ajo mund të jetë: pengesë, kërcënim, udhëzim, ndihmë, mbështetje, mjet e mëdyshje ose shumë gjëra të tjera. Në varësi të faktit se kush është aktori dhe çfarë po përpiqet të arrijë, ai mund të dëshirojë të vijë në përputhje me normën, t'i bindet, ta citojë, ta zbatojë, të mbështetet mbi këtë normë, ta trajtojë, ta manipulojë, ta shmangë, ta anashkalojë, të mos i bindet ose ta injorojë atë. Ai mund ta përdorë normën si udhëzues për vendimin ose për veprimin që do të kryejë, si ndihmë për parashikimin, si arsye për të justifikuar një rrjedhë të caktuar veprimi ose për të bindur dikë tjetër se duhet të marrë një vendim të caktuar etj. Në pafundësinë e proceseve dhe të transaksioneve sociale, në të cilat normat përfaqësojnë elemente të caktuara, ekziston një larmishmëri e mënyrës së përdorimit të normave. Sikurse kemi parë edhe më lart, shumë prej këtyre veprimtarive përfshijnë ose presupozojnë interpretimin. Nëse unë

jam një qytetar që përpiqet të shmangë pagesën e taksave të panevojshme, duke qëndruar brenda kufijve të ligjit, kam nevojë të kem njohuri për disa koncepte lidhur me kuptimin e normave përkatëse. Po ashtu, nëse unë planifikoj të mos u bindem disa ligjeve, në shenjë proteste, duhet të kem një ide të arsyeshme dhe të qartë për fushën e veprimit dhe për kuptimin e ligjit në fjalë.

Dallimi ndërmjet personave që janë në një pozicion të tillë, që të mund të ndryshojnë normat, dhe personave që përballen me normat që kanë ekzistuar që më parë, nuk është as i thjeshtë, as shumë i qartë. Është një e vërtetë se normat shpesh ndryshojnë gjatë procesit të interpretimit nga interpretuesit zyrtarë, sikurse janë gjyqtarët. Shembulli më i qartë është ai i një norme jo të përcaktuar verbalisht, siç janë, për shembull, rregullat bazë të jurisprudencës në traditën common law; por mund të thuhet edhe se fusha e veprimit të dispozitës së "procesit të rregullt ligjor" në amendamentin e pestë të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara është zgjeruar me kalimin e viteve, megjithëse teksti ka mbetur i pandryshuar. Në kontekstet formale, zakonet dhe normat e tjera, jo të përcaktuara verbalisht, shfaqen, zhvillohen, ndryshohen, zvetënohen dhe zhduken, shpesh nëpërmjet akteve dhe zgjedhjeve të njerëzve të paidentifikuar, të cilët nuk kanë një autoritet ose kompetencë të njohur qartësisht. Por, dallimi vlen të ruhet, pasi ka shumë raste kur një person që përballet me një normë të caktuar nuk është në gjendje ta ndryshojë atë për të ardhmen. Për shembull, ekziston një ndryshim midis gjyqtarit, i cili kur prezanton një interpretim të ndryshëm të ligjit thuhet se e ka *zgjeruar* ose *shtirë* atë, duke krijuar kështu një precedent për të ardhmen, dhe dikujt tjetër, ndoshta një nëpunës i ri, i cili mund të pretendojë *ta përpunojë një normë,* por interpretimi i tij pothuajse e lë normën të pandryshuar në të ardhmen.

Nuk kemi mundësi të japim këtu një paraqitje të plotë të të gjithë aktorëve që duhet të interpretojnë normat si pjesë të përmbushjes së një roli apo detyre të caktuar. Por, është e dobishme të shihen në të njëjtën kohë situatat standarde në të cilat lindin çështjet e interpretimit, si dhe marrëdhëniet mes llojeve të ndryshme të aktorëve brenda kontekstit të një procesi të vetëm. Le të fillojmë me një shembull ligjor: proceset ligjore kanë një sërë pjesëmarrësish, por më të rëndësishmit prej tyre, përveç palëve ndërgjyqëse,, konsiderohet se janë ligjbërësi, këshilluesi, avokati, gjyqtari (ose autoriteti tjetër që merr vendimin) dhe zbatuesi i ligjit (i cili shfaqet në momente të ndryshme gjatë procesit, që prej hetimit dhe zbulimit, deri te ekzekutimi i vendimeve të gjykatës). Secila prej këtyre kategorive të pjesëmarrësve mund të përkufizohet sipas roleve që ato kanë: ligjbërës, këshillues, bindës, zbulues të fakteve, interpretues dhe zbatues të normave, arsyetues të vendimeve, ekzekutues të vendimeve e kështu me radhë.

Këto role kanë mbivendosje. Për shembull, si bindja e gjyqtarit (avokatia), ashtu edhe arsyetimi i vendimit për çështjet e ligjit përfshijnë dhënien e arsyeve të qëndrueshme që janë pothuajse të së njëjtës natyrë – në bindjen e gjyqtarit, avokati shpesh kërkon të nxitë një përfundim të çështjes duke "shitur" një arsyetim të mirë. Po ashtu, veçanërisht gjyqtari *"mund të përfshihet ndonjëherë në procesin legjislativ, në kuptim të bërjes ose ndryshimit të normave."* Në proceset gjyqësore nuk ndodh vetëm të ketë mbivendosje të roleve të pjesëmarrësve në këto procese, ndonjëherë në mënyra tepër të ndërlikuara, por shpeshherë një pjesëmarrës i vetëm mund të ketë më shumë se një rol. Për shembull, i njëjti person mund të përfshihet në procesin e zbulimit të fakteve, të interpretimit dhe të zbatimit të normave dhe të përcaktimit të sanksioneve që mund të vendosen mbi palën humbëse.

Kjo analizë e disa prej detyrave më kryesore në trajtimin e normave aplikohet si për kontekstin ligjor, ashtu edhe për kontekstin joligjor. Sigurisht, në praktikë, normalisht ekzistojnë më pak diferencime mes roleve të pjesëmarrësve në proceset e thjeshta civile në raport me proceset tipike ligjore. Kjo është një arsye që justifikon ekzistencën e një elementi artificialiteti kur flasim, sikur të ishim në familje, për nënën, si "legjislator", zbatues të ligjeve dhe prokuror dhe për babanë, si gjyqtar. Por, detyrat e bërjes së normave, avokatisë, zbulimit të fakteve, zbatimit të normave e kështu me radhë janë të identifikueshme nëse i përshtatemi situatës familjare, madje edhe nëse ato nuk janë shumë të qarta në mendjet e pjesëmarrësve ose ndahen në një ose dy persona.

Ky diferencim i llojeve dhe i qëndrimeve të ndryshme është element kyç në metodën e zgjidhjes së gjërave të panjohura rreth normave, e cila do të trajtohet më poshtë. Modeli i procesit penal ilustron disa prej roleve më kryesore të përfshira në trajtimin e normave gjatë një procesi të strukturuar mirë, në të cilin disa prej pjesëmarrësve kanë autoritetin e ndryshimit ose të modifikimit të normave dhe disa të tjerë jo. Por, kjo gjë nuk jep një panoramë të plotë të të gjitha roleve të mundshme që përfshihen në trajtimin e normave, si dhe të gjitha përdorimet e mundshme të normave që mund të përballen gjatë llojeve të ndryshme të ndërveprimeve sociale. Për shembull, normat zbatohen për ndërtimin e argumenteve, të justifikimeve për sjelljet e kryera në të shkuarën ose që mund të kryhen në të ardhmen. Po ashtu, mund të krijohen situata të tilla ku krijuesi i normave të shqetësohet, të dëmtohet ose të mundet në argumentim nga norma e tij që citohet kundër tij; shembull i thënies *"të vritesh me dorën tënde"*. Për të analizuar një shembull të tillë, shpesh është e nevojshme të identifikohen roli dhe qëndrimi i pjesëmarrësve përkatës, si dhe të shpjegohet përdorimi nga ana e tyre i një ose më shumë normave në kontekstin specifik

të tregimit se cilët janë këta pjesëmarrës, cila është situata e tyre dhe çfarë po përpiqen të bëjnë ata [...].

Një prej pikave të dobëta të shumë vlerësimeve tradicionale të interpretimit ligjor është se ato përqendrohen, në mënyrë të shprehur ose të pashprehur, mbi një qëndrim të vetëm – zakonisht atë të një gjyqtari neutral ose të një interpretuesi neutral. [...] Këto role 'neutrale' ose 'të paanshme' të pretenduara janë shumë problematike. Në jurisprudencë, vëmendje shumë e madhe u është kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me rolin e duhur të gjyqtarëve. A bëjnë dhe a duhet të bëjnë ata ligje, apo thjesht duhet t'i zbatojnë ato? A bëjnë ata politika? Deri në ç'pikë mund të jetë i paanshëm gjyqtari në çështjet e diskutueshme? Shumë shpesh, paqartësitë rreth rolit të duhur të gjyqtarit bashkohen me problemet e interpretimit.

Një kundërshtim edhe më i rëndësishëm mbi qëndrimet e gjyqtarëve dhe të interpretuesve është se thuhet shumë pak ose pothuajse nuk përmendet fare ajo që përbën interpretimin e duhur të aktorëve të tjerë ose vështirësitë me të cilat ata përballen. Kjo çon në një varfërim radikal të diskutimeve për interpretimin ligjor, ndonjëherë deri në pikën ku ato mund të keqkuptohen seriozisht. Në veprën e tij shumë interesante për interpretimin e ligjeve, zoti Rupert Cross i ka kushtuar vëmendje të madhe faktit se 'pjesa dërrmuese e ligjeve nuk vijnë kurrë para gjykatave për interpretim'; por, më pas, ai kalon në një analizë që kryesisht bazohet mbi supozimin se hartuesit ose interpretuesit e këtyre ligjeve sillen sikur të kishin parashikuar se ato do të interpretoheshin në rrugë gjyqësore. Në rastin më të mire, kjo do të ishte një superthjeshtëzim i konsiderueshëm.

Për ta shtjelluar më shumë këtë çështje, le të imagjinojmë tri karaktere: një këshillues i kujdesshëm, një avokat aventurier dhe një interpretues të pakënaqur. Kur një klient, një qytetar i mirë ose i keq qoftë, konsultohet me një këshillues (ose çfarëdolloj këshilluesi tjetër profesionist), ai mund të parashtrojë pyetjen: "Nëse unë bëj X gjë, çfarë do të më ndodh?" Në të vërtetë, ai është duke i kërkuar këshilluesit të tij të parashikojë disa prej pasojave të veprimeve që ai propozon të kryejë. Supozoni se këshilluesi mendon se ka disa dyshime rreth fushës së veprimit të disa prej normave përkatëse të mundshme, të cilat do të përbëjnë edhe bazën e këshillave të tij. Cili do të ishte interpretimi i duhur në këto rrethana? Sigurisht, këshilluesi mund t'ia shpjegojë dyshimet klientit të tij, por, nëse vihet nën presion për të dhënë një përgjigje përfundimtare, këshilluesi i kujdesshëm do të bëjë ndoshta një interpretim pesimist të normës – në njëfarë mënyrë do ta interpretojë kundër klientit të tij për të lejuar një hapësirë gabimi. Gjatë hartimit të dokumenteve, këshillues të tillë, zakonisht jepen pas interpretimeve të tilla pesimiste ose të

kujdesshme për arsye bindëse – është pjesë e punës së tyre të parashikojnë rastësitë, duke përfshirë këtu edhe një interpretim jofavorizues. Në situatën tone hipotetike vetëm një këshillues mendjengushtë dhe aspak i frytshëm do ta bazonte këshillën e tij vetëm mbi parashikimin se si mund të interpretohej në gjykatë ligji material i zbatueshëm, veçanërisht nëse norma është pjesë e 'shumicës dërrmuese' sipas Corss, e cila ndodh rrallë, ose nuk ndodh asnjëherë, që të paraqitet para gjykatave.

Supozoni tani një klient i cili, pavarësisht këshillës së kujdesshme të këshilluesit, bën X gjë dhe është pa shumë fat. Si rezultat i kësaj paditet ose ndiqet penalisht. Mendoni sikur ai vendos ta kundërshtojë çështjen për një çështje të ligjit dhe avokatit aventurier i besohet detyra e përfaqësimit të tij: Si do ta interpretojë ky i fundit normën e zbatueshme? Është e qartë se do të ishte e papërshtatshme që, në argumentimin e tij, ai të përdorte interpretimin e këshilluesit. Në vend të kësaj, ai do të sillet si optimist dhe do të marrë në konsideratë interpretimet e mundshme që do të prodhojnë një rezultat në favor të klientit të tij. Në argumentimin e çështjes para gjykatës, ai mund të përqendrohet në interpretimin më racional nga interpretimet e mundshme, ku secili prej tyre do të konvertohej me fitoren e klientit të tij. Kështu, lidhur me të njëjtin veprim, përfaqësuesit ligjorë të klientit mund të japin intrepretime të ndryshme për një normë të paqartë – njëri interpretim pesimist dhe tjetri optimist – dhe të dy ata do të kenë të drejtë nëse merren në konsideratë rolet dhe rrethanat. Në një mënyrë të thjeshtuar, kjo është pjesë e përvojës së përditshme të praktikës gjyqësore. Kjo gjë është evidente, por harrohet ose trajtohet sipërfaqësisht nga pothuajse të gjitha përshkrimet mbarëtradicionale të interpretimit ligjor.

Së fundi, le të merremi me një tjetër karakter imagjinar që do ta quajmë interpretuesi i pakënaqur. Ky është një person që përballet me një normë, e cila, të paktën në pamje të parë, duket se vjen në kundërshtim me atë që dëshiron ose me atë që ai beson se është e drejtë. Nëse i kthehemi për një moment modelit mekanistik të vendimmarrjes dhe më pas të themi se interpretuesi ka një dyshim në një rast të caktuar, do të ishte sikur të thoshim se ai ka një dyshim për fushën e veprimit të normës ose për zbatimin e saj për faktet e çështjes, ose për të dyja, pra vihet në dyshim edhe rezultati. Gjithsesi, një model i tillë është shumë i thjeshtë sikurse edhe përshkrimi i pjesës më të madhe të proceseve vendimmarrëse, dhe nuk është e pazakonshme për interpretuesit që të kenë dyshime për rezultatin për disa arsye që nuk kanë lidhje me asnjë prej premisave. Rasti ilustrativ i interpretuesit të pasigurt i cili, ndonëse dëshiron të jetë në përputhje me normën, vihet në mëdyshje reale për fushën e veprimit dhe të zbatimit të saj, mund të krahasohet me rastin e

interpretuesit që përballet me një normë për fushën e veprimit të së cilës ai ka pak ose aspak dyshime, por, pikërisht për këtë arsye, ai përballet me një problem. Ekzistojnë disa arsye përse interpretuesi që gjendet në një situatë të tillë, mund të jetë i pakënaqur: ai mund të mos bjerë dakord me politikën në zbatim të normës; mund ta pëlqejë politikën, por mund të mos pëlqejë normën specifike si një instrument për rxitjen e saj; mund të bjerë dakord edhe me normën, edhe me politikën, por, për disa arsye, mund të dëshirojë shmangien e rezultatit që do të prodhohej nga një zbatim i drejtpërdrejtë i normës; ose mund të ketë disa tipare të rastit konkret që e shtyjnë atë të dëshirojë një rezultat të ndryshëm nga ai i sugjeruar nga interpretimi më i mundshëm i normës. Pra, e thënë thjesht, ai dëshiron diçka, pavarësisht nga norma.

Kështu, ndonëse fusha e veprimit të normës mund të jetë e qartë, problemi i interpretuesit të pakënaqur është se, të paktën në mënyrë sipërfaqësore, kjo fushë kthehet në një pengesë që ai të sigurojë rezultatin që dëshiron. I përballur me këtë lloj situate, interpretuesi mund të gjendet në një pozitë të tillë që, për të arritur rezultatin që dëshiron, ai mund të përdorë mjete të tjera përveç interpretimit, për shembull, nëpërmjet injorimit, anashkalimit ose shmangies nga norma; por, kur nuk gjendet në një pozitë të tillë, shpesh ai priret nga interpretimi i normës nëpërmjet zgjerimit ose shtrirjes së saj. Nuk duhet të priremi drejt shoqërimeve emotive të termave, si 'manipulues' ose 'legalistik', duke i menduar ato si veprimtari që kryhen vetëm nga personazhet negative. Interpretimi që i bën Portia kontratës së Shylock me Antonio ishte një shembull klasik i interpretimit legalistik; Portia konsiderohet gjerësisht si heroinë dhe qëllimet e saj të admirueshme; por, mjeti që ajo përdor konsiderohet si një shembull i 'ligjshmërisë'.

Në këto rrethana, mund të lindë një konflikt ndërmjet dëshirës për të manipuluar një normë të qartë për të arritur rezultatin e dëshiruar dhe vlerës së bindjes ndaj normave; i përballur me këtë konflikt, interpretuesi i pakënaqur mund të zgjedhë mbështetjen e interpretimit të drejtpërdrejtë të normës. Ky është shpesh rasti kur interpretuesi i pakënaqur është gjyqtar. Sikurse ka thenë Coleridge J.: 'Ndoshta, mënyra më efikase e sigurimit të ligjeve të mira, pa dyshim një mënyrë e lejuar edhe nga Gjykata e Drejtësisë, është të veprohet krejtësisht sipas frymës dhe gjuhës së ligjeve të këqija, duke i lënë problemet e tyre të ndihen plotësisht duke u dhënë efekt të plotë'.

Manipulimi i mundshëm i normës nuk shter alternativat e interpretuesit të pakënaqur për trajtimin e problemit të tij. Por, vlen të theksohet se dyshimi është çështje relative. Nuk është e pazakonshme, si në kontekstin ligjor, ashtu edhe në kontekstin joligjor, që disa pjesëmarrës të shprehin dyshime për interpretimin ose për zbatimin e një norme, ndërsa të tjerët të pretendojnë se

norma është e qartë. Kështu, interpretuesi i pakënaqur mund të jetë në gjendje të përgatitë terrenin për një interpretim më pak të qartë, duke krijuar ose duke ngritur një dyshim që duhet të zgjidhet. Mund të jetë detyra e avokatit ose e interpretuesit tjetër të sajojë dyshime për të arritur objektivat e tij. Dhe, vërtet, disave mund t'u pëlqejë të veprojnë në këtë mënyrë:

Prirja e vëllait tim Foster për të gjetur boshllëqe në ligje më kujton një histori të treguar nga një autor i vjetër për një burrë që hëngri një palë këpucë. Kur e pyetën nëse i kishin pëlqyer, ai u përgjigj se pjesa më e mirë ishin të çarat (pjesa nga hyn këmba). Kjo është edhe ndjesia e vëllait tim për ligjet; sa më shumë boshllëqe të kenë ato, aq më të pëlqyeshme janë për të. Pra, ai nuk i pëlqen ligjet.

Dyshimi dhe pakënaqësia janë çështje relative. Nuk mund të hiqet dot një vijë ndarëse ndërmjet problemit të vërtetë të fushës së veprimit të normës dhe kuptimit të saj, duke shfrytëzuar paqartësitë dhe shumëkuptimshmëritë e mundshme dhe duke i bërë të pranishme ato qëllimisht për të mbjellë farat e dyshimit për atë që më parë konisderohej si e qartë. Në këtë kontekst, duhet të mos e marrim shumë seriozisht nocionin e pakënaqësisë së interpretuesit. Ajo që është e qartë, është se ekziston një lloj konlikti dhe interpretuesi i pakënaqur, të paktën duket se lufton kundër frymës, qëllimit ose synimit, ose asaj që presupozohet se përcakton kuptimin e normës. Kjo shtron çështjen e marrëdhënies që ekziston mes krijuesve të normave dhe interpretuesve të normave.

6. Krijuesit e normave dhe interpretuesit e normave

Me gjithë kompleksitetin e tij, problemi i interpretimit zë një vend qendror të rëndësishëm në integritetin e ligjit –në ndryshim nga problemet e tjera, ai nxjerr në pah natyrën bashkëpunuese të detyrimit për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nëse interpretuesi duhet të mbrojë kuptimin e një misioni të dobishëm, legjislatura nuk duhet t'i imponojë atij detyra të pakuptimta. Nëse hartuesit e ligjeve duhet të heqin përgjegjësitë e tij, si përgjigje, ai duhet të jetë në gjendje të parashikojë mënyra racionale dhe relativisht të qëndrueshme për interpretimin. Kjo varësi e ndërsjellë reflektohet në të gjitha rregullat ligjore. Asnjë përqendrim i inteligjencës, mençurisë ose vullnetit të mirë, sado i strukturuar të jetë, nuk mund të realizojë me sukses përpjekjen për t'ia nënshtruar sjelljen njerëzore sundimit të rregullave dhe normave.

Ky fragment është një shembull relativisht i sofistikuar i pikëpamjes se marrëdhënia ndërmjet krijuesit të normave dhe interpretuesit është kryesisht marrëdhënie bashkëpunimi. Kështu, gjyqtarët konsiderohen si agjentët ose

partneret e rinj të krijuesve të normave; roli i zyrtarëve është të përmbushin, të ekzekutojnë, të zbatojnë ose të mbështetin vullnetin e ligjvënësit. Ndërsa kjo përfaqëson një konceptim të rolit të interpretuesit që duhet t'u delegohet shumë interpretuesve zyrtarë, është e rëndësishme të dimë se bashkëpunimi nuk është marrëdhënia e vetme e mundshme midis krijuesve dhe hartuesve të normave.

Në rastet kur interpretuesi nuk është zyrtar, marrëdhënia mund të variojë nga bashkëpunimi i plotë, në një armiqësi të hapur. Antonio, te *Tregtari i Venedikut,* na kujton se 'djalli mund të citojë edhe Librin e Shenjtë për të arritur qëllimin e tij'. Qëndrimet e interpretuesve potencialë mund të kenë ndikime të rëndësishme për stilin e hartimit të normave në formë verbale të fiksuar. Karl Llewellyn që u përpoq të mbështetej mbi mirëbesimin e shumë tregtarëve dhe arsyen e mirë të shumë gjyqtarëve, e justifikoi 'stilin e hapur' të hartimit të Kodit uniform tregtar, si më poshtë: "Gjuha teknike dhe fjalitë e ndërlikuara nuk mund të shmangen plotësisht, por ato mund të reduktohen sa më shumë. Predispozicioni kryesor për këtë reduktim është besimi se gjykatat do t'i japin efektin e arsyeshëm qëllimit të arsyeshëm të gjuhës". Krahasojeni këtë deklaratë me detyrën e hartuesit të një ligji për të ardhurat: "Nuk mjafton vetëm të arrihet një shkallë e caktuar e saktësisë së formulimit të ligjit, në mënyrë që të kuptohet nga personi që e lexon atë në mirëbesim, por është i domosdoshëm edhe zbatimi i tij. Disa e konsiderojnë rolin e tyre thjesht si interpretues dhe zbatues të ligjit, pa marrë parasysh rastet e papritura; disa të tjerë mund të shkojnë edhe më tej dhe të kërkojnë të provokojnë veprimin e legjislativit duke nxjerrë në pah absurditetin e dispozitës [...].

Këta shembuj do të ishin të mjaftueshëm për të treguar se marrëdhënia mes krijuesve të normave dhe interpretuesve të tyre është komplekse dhe se modelimi i saj si bashkëpunuese, megjithëse interesant, është një superthjeshtëzim i shkallës së saktësisë së formulimit të ligjit, të cilin një person që e lexon me keqbesim, mund të mos e kuptojë. Do të ishte shumë më mirë nëse ai nuk do të mund të pretendonte se e ka keqkuptuar atë".

Bashkëpunimi ndërmjet krijuesve të normave dhe zyrtarëve nuk ka dyshim se është një marrëdhënie më e natyrshme, por kjo nuk duhet të merret e mirëqenë. "Në nivelin e përgjithshëm të teorisë politike, marrëdhënia ndërmjet legjislativit dhe degëve të tjera të pushtetit nuk duhet të shihet domosdoshmërisht si një marrëdhënie partneriteti në një përpjekje të vetme të përbashkët. Nocioni i kontrolleve dhe i balancës, doktrina e rishikimit gjyqësor, konceptimi i gjyqtarëve si supervizore janë të gjithë tregues se një vështrim kaq monolitik i sistemit të qeverisjes është shumë i thjeshtë. Historia ligjore ka pasur mjaft shembuj të gjyqtarëve, të cilët kanë vepruar në një mënyrë të tillë që sugjeron

se roli i tyre ka qenë më shumë pengimi, sesa nxitja e vullnetit të ligjvënësit.

Më tej, edhe nëse një interpretues zyrtar e konsideron rolin e tij si thelbësisht bashkëpunues, në raste të veçanta ai mund të përballet me zgjedhjen e vështirë të mënyrës së përmbushjes së rolit që ka. Një normë mund të provojë se është një instrument jo i përsosur i politikës së tij; ajo mund të jetë kapërcyer nga ndryshimet sociale, të rejat e teknikës ose ndryshimi i opinionit publik; mënyrat e sjelljes së krijuesit të normës në kohën e hartimit të këtij instrumenti dhe mënyrat e reagimit të tyre në rast të përballjes së saj me gjykatën në një kohë të mëvonshme, nuk janë domosdoshmërisht të njëjta. Gjyqtarët e vënë në një pozicion të tillë nuk përgjigjen në të njëjtën mënyrë.

7. Legalizmi

Ne tashmë jemi njohur me disa shembuj të interpretimit ose të sjelljeve të tjera që mund të etiketohen si 'legaliste'. Interpretimi 'literal' që bëhet nga gjyqtarë ose aktorë të tjerë, referohet ndonjëherë edhe me termat 'literalist', 'legalist' ose 'formalist'. Koncepte të tilla janë jo shumë të përkufizueshme dhe kërkojnë shpjegim mjaft të hollësishëm. Këtu do të japin vetëm disa vëzhgime elementare për llojet e ndryshme të legalizmit, për shoqërimet emotive të këtij termi, si dhe për disa motive dhe funksione të sjelljes legaliste.

Mbiemri 'legalist' aplikohet në mënyra të ndryshme për sjelljen, qëndrimet, individët, stilet gjyqësore, madje edhe për sistemet dhe kulturat ligjore në tërësi. Sa i takon sjelljes dhe qëndrimeve, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet të paktë tri përdorimeve kryesore, të cilat reflektojnë mendime të ndryshme: pëlqimi i pasjes së shumë normave dhe procedurave formale komplekse; këmbëngulja për bindjen strikte ndaj normave ekzistuese dhe interpretimi i normave në një mënyrë joelastike, strikte dhe literale. Secila prej tyre lidhet ngushtë me qëndrime ose role të ndryshme. Kështu, e para lidhet me krijimin e normave, e dyta, me zbatimin ose me respektimin dhe e treta, me interpretimin.

Nuk ekziston ndonjë lidhje e domosdoshme mes sjelljes 'legaliste' sa i takon secilit prej qëndrimeve. I njëjti person mund të favorizojë pasjen e shumë normave, por mund të jetë i përgatitur që, në rrethana të caktuara, t'i anashkalojë ose t'i injorojë normat ekzistuese dhe mund të favorizojë ose interpretimin liberal, ose interpretimin literal, pa pasur papajtueshmëri. Po ashtu, krijuesi i normave mund të kundërshtojë krijimin e normave dhe të procedurave formale, pasi beson se, sapo të krijohen, ato duhet të ekzekutohen rreptësisht ose të interpretohen në mënyrë strikte. Për shembull, një pedagog universiteti mund të kundërshtojë me forcë hartimin e rregulloreve të detajuara

që rregullojnë sekretimin dhe klasifikimin e provimeve me shkrim, pasi nëse këto rregullore do të ekzistonin, ai do të ndihej i detyruar t'i zbatonte ato në mënyrë strikte ose t'i interpretonte ato në mënyrë literale ose rigoroze. Pra, krijuesi pjellor i normave, pedanti i normave dhe interpretuesi literal ose strikt kanë karakteristika të ndryshme, të cilat mund t'i përkasin ose jo të njëjtit person.

Sa i përket interpretimit të normave ekzistuese, kërkohen disa diferencime të tjera. Ndërsa interpretuesi i pakënaqur mund t'i konsiderojë disa norma (nëse interpretohen në një mënyrë të caktuar) si një pengesë për të arritur rezultatin që dëshiron, gjyqtari ose administratori mund të përdorë një interpretim strikt ose literal për disa arsye, për shembull, për të shmagur idenë e 'krijuesit të normave ose të plotësimit të qëllimit të krijuesit të normave'.

Këto vëzhgime elementare duhet të jenë të mjaftueshme për të paraqitur dy supozime të përgjithshme si të dyshimta, në rastin më të mirë, ose ndoshta të pavërteta; pra idenë se 'legalizmi është një e keqe e domosdoshme dhe idenë se sjellja legaliste duhet të shpjegohet vetëm ose kryesisht nëpërmjet termave të psikologjisë së individit'.

Në shumë kontekste, terma, si 'legalizëm' dhe 'formalizëm', janë emotive, duke mbartur mbi vete sugjerimin e mosmiratimit. Për shembull, avokatët vënë përballë njëra-tjetrës sjelljet 'avokatore' dhe 'legaliste', ndoshta duke nënkuptuar se e para është sjellje profesionale dhe përfshin gjykimin e mirë, dhe e dyta është e pandershme, mendjengushtë ose e papjekur. Gjithsesi, zgjedhjet për të pasur më pak ose më shumë norma, t'i respektosh rigorozisht normat ekzistuese ose t'i injorosh ato, t'i shmangësh ose t'i ekzekutosh vetëm pjesërisht, t'i interpretosh gjerësisht ose ngushtësisht, në mënyrë strikte ose liberale, nuk janë zgjedhje që mund të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme. Për ta parashtruar çështjen shumë shkurt: funksionimet dhe mosfunksionimet e formalizmit (duke përfshirë këtu legalizmin, si një prej shfaqjeve të tij) janë të shumta, në mënyrë të veçantë nëse përfshihen krijimi, ekzekutimi, respektimi dhe interpretimi i normave brenda sferës së tij. Interpretimi literal mund të nxitet nga dëshira për të dhënë drejtësi në një çështje të caktuar, për të nxjerrë në pah absurditetin e një norme të veçantë, nga politika e kufizimeve gjyqësore ose për t'u dhënë efekte disa prezumimeve, si p.sh.: prezumimi i pafajësisë ose prezumimi në favor të ruajtjes së të drejtave ekzistuese të pronës. Në këtë kuptim, interpretimi legalist, në vetvete, nuk është as i keq, as i mirë.

Një tjetër supozim i dyshimtë është se sjellja legaliste është kryesisht një funksion i psikologjisë së individit, që mund të shpjegohet në termat e personalitetit dhe qëndrimeve të njerëzve si individë. Nuk ka asnjë dyshim se individët shfaqin tendenca ose modele të sjelljes që mund të shpjegohen, të paktën pjesërisht, nëpërmjet ndryshimeve psikologjike. Por, duhet të jetë e

qartë nga ato që kemi thënë, se kjo sjellje mund të shpjegohet edhe nëpërmjet një sërë faktorësh të tjerë, si: konteksti, roli dhe qëllimi imediat. Kështu, një gjyqtar mund të përdorë metodën literale për një ligj dhe metodën liberale për një ligj tjetër, gjë e cila ka më pak lidhje me personalitetin e tij se qëndrimet e përgjithshme. Shumë gjyqtarë veprojnë në këtë mënyrë.

Këtu nuk kemi mundësi të eksplorojmë në detaje ose në thellësi natyrën, format dhe funksionet e formalizmit dhe të legalizmit. Është një temë e rëndësishme dhe jo e trajtuar. Mund të na vijë në ndihmë këtu një citim nga interpretimi që i bën Douglas Hay një shembulli të legalizmit: gjyqtarët anglezë kanë interpretuar në mënyrë tejet të ngushtë dhe formale pjesën më të madhe të ligjeve penale. Pjesërisht, kjo gjë është bazuar në praktikën e shekullit të 17-të, por, duke qenë se në shekullin e 18-të u kaluan shumë ligje të rëndësishme, gjykata reagoi me interpretime tejet të ngushta. Shumë ndjekje penale, të bazuara mbi prova të shkëlqyera dhe të kryera me shpenzime të konsiderueshme, dështuan për shkak të problemeve të vogla të formës së aktpadisë... nëse një datë ose emër ishte gabim, ose nëse i akuzuari përshkruhej si 'fermer' dhe jo me termin e miratuar 'pronar i vogël tokash', ndjekja dështonte.

Gjykatat konkludonin se defekte të tilla ishin përfundimtare dhe zotërinjtë që ndiqnin gjyqet si spektatorë, ngriheshin në këmbë dhe tërhiqnin vemendjen e gjyqtarit për gabimet e mundshme. Këto formalizma në të drejtën penale dukeshin qesharake për kritikën e asaj kohe, si dhe për shumë historianë të mëvonshëm. Argumenti i tyre ishte (dhe është) se, për të qenë e efektshme, e drejta penale duhet të njihet dhe të jetë e përcaktuar, në vend që të jetë me të papritura dhe e errët. Prokurorët nuk miratonin humbjen e kohës dhe shpenzimin e të hollave për aspektet teknike; thuhej se hajdutët talleshin me gjykatën që i linte të lirë nëpërmjet këtyre të çarave të ligjit. Por, duket se pjesa masive angleze tërhoqi konkluzione të tjera. Kujdesi i madh për format, shkëmbimet legaliste dhe pa pasion mes avokatit dhe gjyqtarit, argumentuan se ata që administronin dhe që përdornin ligjet, duhet t'u nënshtroheshin rregullave të tyre. Kështu, ligji kthehet në diçka më shumë sesa në krijesën e hartuesve të tij – ai kthehet në një pushtet me kërkesat e tij më të larta se ato të prokurorit, gjyqtarit, avokatit. Pra, përfundimisht, paefektshmëria e tij e madhe, formalizmi i tij absurd ishin pjesë e forcës së tij si ideologji.

8. Hapësirat vepruese për interpretimin dhe zbatimin

Në një model mekanistik të vendimmarrjes, marrëdhënia mes normave, fakteve dhe përfundimeve mund të shprehet në formën e një silogjizmi (arsyetimi deduktiv). Gjykuesi përcakton dhe pohon normën ligjore si premisën

kryesore, ai përcakton dhe pohon faktet materiale, si premisën më pak të rëndësishme dhe përfundimi vjen si një konkluzion i domosdoshëm. Çështja e interpretimit lind kur interpretuesi duhet të zgjedhë, si për sa i përket fushës së veprimit të premisës kryesore, ashtu edhe sa i takon mënyrës si duhet të zbatohet ajo për faktet (që janë dhënë). Si është e mundur lindja e çështjeve të tilla? Një përgjigje e shkurtër mund të jepet si vijon:

Së pari, hartuesit e normave shpesh e lënë qëllimisht një shkallë diskrecioni për interpretuesit e normave, siç mund të jenë gjyqtarët ose nëpunësit civil, për të përcaktuar kufijtë ose për çështjet e tjera të vështira; ose ata mund të hartojnë një politikë të përgjithshme, por krijojnë qëllimisht një instrument jo shumë të qartë të kësaj politike dhe e lënë funksionimin e tij të padetajuar në momentin e zbatimit.

Së dyti, hartuesit e normave mund të mos arrijnë të parashikojnë të gjitha rastësitë e mundshme dhe rezultati mund të jetë lindja e dyshimeve nëse norma kishte pasur qëllim zbatimin edhe në këto rrethana që duket se nuk ishin parashikuar nga hartuesit e saj dhe, e lidhur ngushtë me këtë pikë, qëllimet e hartuesve te normave janë të prirur drejt pasaktësive dhe problemet mund të lindin për efektin e saktë që mund të jetë synuar në një rast të caktuar.

Së treti, lidhur me normat e fiksuara verbalisht, ndonëse hartuesi dëshiron të parashikojë çdo rast të mundshëm, gjuha është shumë e pasaktë dhe e lakueshme.

Së katërti, në rastin e normave të pafiksuara verbalisht mund të krijohen edhe paqartësi të tjera në fazën e formulimit të normës (nëse arrihet ndonjëherë kjo fazë) për shkak të mungesës së një pike të përbashkët për nisjen e bisedimeve rreth fushës së saj të veprimit dhe të zbatimit.

Së pesti, ekziston edhe faktori i pajtueshmërisë. Një detyrë kryesore e interpretimit është pajtimi i normave (dhe i burimeve të normave, sikurse mund të jenë çështjet e ndryshme), pasi, zakonisht, një normë e vetme i përket një aglomerati ose sistemi më të gjerë. Çështja kryesore është se, për sa kohë pajtueshmëria e normave konsiderohet si vlerë, ajo përbën një bazë, si për krijimin e problemave për interpretuesit, ashtu edhe për ndihmesën e tyre për t'i zgjidhur ato. Një dyshim ose paqartësi për interpretimin mund të zgjidhet duke iu referuar normave të tjera, por adresimi te një normë tjetër, që ndoshta është e papajtueshme me normën në fjalë, mund të krijojë dyshime për interpretimin e një norme në dukje të drejtpërdrejtë dhe të qartë.

Delegimi i qëllimshëm i diskrecionit, padija e faktit, papërcaktueshmëria e qëllimit, kufizimi i gjuhës, fleksibiliteti i normave jo të fiksuara në formë verbale, konfliktet ndërmjet vlerës së pajtueshmërisë brenda një sistemi dhe vlerave të tjera, si dhe mospërputhjet e qëllimit, rolit ose situatës midis krijuesit të normës dhe interpretuesit, janë thjesht disa prej kushteve më të zakonshme

që u japin shkas problemeve të interpretimit dhe zbatimit të normave. Në këtë pikë, është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa faktorë të tillë krijojnë hapësira për interpretimin, këto hapësira nuk janë të pakufizuara. Intepretuesi në mëdyshje ose i pakënaqur prezantohet me disa zgjedhje, por, në praktikë, gama e interpretimeve të mundshme, të kënaqshme ose të përshtatshme u nënshtrohet kufizimeve. Natyra dhe forca e këtyre kufizimeve do të variojë nga një kontekst në tjetrin. Për shembull, në diskutimin e hapësirave të mundshme për avokatët dhe gjyqtarët në gjykatat e apelit në Amerikë, Karl Llewellyn identifikoi 14 'faktorë kryesorë të qëndrueshëm', të cilët tentonin të reduktonin paqartësitë dhe të kufizonin gamën e zgjedhjeve në praktikë, siç ishin, për shembull: kushtet mendore të avokatëve, identifikimi paraprak dhe sqarimi i çështjeve, mënyrat e pranuara për trajtimin e burimeve autoritative të ligjit dhe për paraqitjen e argumenteve para gjykatës, si dhe për kufizimet e vendimmarrjes në grup dhe publicitetit. Nuk ka asnjë dyshim se lista e tij mund të vazhdojë të zgjerohet. Këta 'faktorë të qëndrueshëm' variojnë sipas kontekstit dhe aktorëve që përfshihen në to. Në një kontekst të dhënë, shpesh, përcaktimi i fushës së veprimit dhe i kufizimeve të zgjedhjeve në procesin e interpretimit, i takon një gjykimi mjaft delikat.

Shënim i autorit: *William Twining është profesor i së drejtës në Kolegjin Universitar të Londrës, si dhe një prej teoricienëve më të shquar në botë.*

e - FJALORI TERMINOLOGJIK

Nemo iudex in causa propria = Rregull që shpreh parimin sipas të cilit gjyqtari nuk mund të vendosë në një çështje mbi të cilën ka interes të drejtpërdrejtë.

Audiatur et altera pars = *"Duhet të dëgjohet edhe pala tjetër"*. Formulë me të cilën sintetizohet një nga parimet bazë të sistemit procedural italian. Vlen të theksohet parimi i kontradiktorialitetit, me anë të të cilit palët kundërshtare duhet të dëgjohen para gjyqtarit dhe të vlerësohen arsyet e tyre dhe përjashtimet në sensin e kundërt.

Ubi non est actio, ibi non est iurisdictio = *"Ku nuk ka padi, nuk ka juridiksion"*. Kjo rregull krijon një pasojë të pashmangshme të ekzaminuar më parë (***«nemo iudex sine actore»***), që do të thotë: që autoriteti gjyqësor të mbrojë një të drejtë, është e domosdoshme të ketë një të drejtë që të merret në shqyrtim.

Nemo iudex sine actore = "*Asnjë gjyqtar pa aktor*". Më saktë, kjo do të thotë që asnjë autoritet gjyqësor nuk mund të marrë masa gjyqësore nëse nuk i është paraqitur një kërkesë nga paditësi me anë të së cilës ligjësohet për ta ushtruar.

f - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Në interpretimin e ligjeve, gjyqtari nuk mund t'i japë ligjit kuptim tjetër përveç atij kuptimi që del qartë nga domethënia e tij, e parë kjo edhe nga këndvështrimi i lidhjeve që ligjet kanë me njëri-tjetrin si dhe nga qëllimi i ligjvënësit.

2. E vetmja dispozitë procedurale që gjendet në Kodin e procedurës civile (neni 1, paragrafi i dytë), mbi bazën e së cilës gjykata detyrohet të shprehet për zgjidhjen e çështjes, për të realizuar funksionin e saj kryesor, atë të dhënies së drejtësisë, i krijon mundësinë asaj të bëhet interpretuesi i ligjit.

3. Vendimet gjyqësore, ku vendin kryesor e zenë vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, kanë rolin e tyre përcaktues në orientimin e gjykatave për të interpretuar drejt ligjet. Sidoqoftë, interpretimi i ligjit për të arritur në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes mbetet detyrë e çdo gjyqtari dhe jo vetëm e gjykatave më të larta.

4. Interpretimi gjyqësor shprehet në vendimin e gjykatës dhe është i detyrue-shëm vetëm për atë çështje për të cilën është marrë vendimi. Interpretimi gjyqësor është një lloj i veçantë i interpretimit të ligjit, sepse vendimi i gjykatës që ka marrë formën e prerë, merr fuqi ligjore, d.m.th., po atë karakter detyrues që ka edhe ligji.

5. Kur një çështje nuk zgjidhet për arsye se dispozita ligjore është e dyshimtë për t'u zbatuar, ka kundërthënie apo paqartësi, atëherë mund të vendoset edhe në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës.

6. Gjatë interpretimit të normave procedurale duhet garantuar se zbatimi i tyre është në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor.

7. Në vendimet interpretuese, gjykata zbërthen dyshimet që prezanton norma juridike. Gjykata, kur interpreton dispozitat, merr në konsideratë sistemin e tyre gjuhësor, përmbajtjen sociale dhe boshtin logjik, si dhe qëllimin e vetë dispozitës. Ajo është e detyruar të ketë në konsideratë dispozitat kushtetuese dhe normat e tjera ligjore, të cilat referojnë në vlerat nga të cilat shoqëria udhëhiqet dhe që në hierarkinë e normave qëndrojnë mbi dispozitat e tjera.

8. Gjyqtari duhet të ketë kujdes që, nëpërmjet interpretimit, të mos krijojë një normë të re ligjore. Interpretimi që bën gjykata, nuk është dhe nuk mund të jetë krijim i normave ligjore. Ajo jep kuptimin e saktë të rregullt të normave të shprehura në dispozitat ligjore në pajtim me parimet kushtetuese, ndërkohë që zbaton rregullat e interpretimit të pranuara në një kulturë ligjore të përfshirë në rregullat demokratike të ligjit.

9. Kur një mosmarrëveshje nuk mund të marrë zgjidhje me ndonjë dispozitë

konkrete, atëherë merren në konsideratë dispozita të tjera që rregullojnë çështje të ngjashme ose analoge.

10. Interpretimi me analogji kryhet në ato raste kur, gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete, gjykata konstaton se ligji nuk parashikon ndonjë rregull të caktuar për zgjidhjen e saj. Meqenëse gjykata, për shkak të ometimit ligjor, nuk mund ta refuzojë zgjidhjen e çështjes, ajo detyrohet të bazohet në një ligj apo normë tjetër juridike që parashikon një rast të ngjashëm apo të përafërt me rastin në shqyrtim.

11. Interpretimi *a contrario* është një mënyrë interpretimi që gjykata e realizon për zgjidhjen e një çështjeje në shqyrtim, duke i dhënë dispozitës ligjore kuptimin e kundërt të asaj që ajo duket se paraqet në të vërtetë. Duke interpretuar normën juridike në kuptimin e kundërt, gjykata arrin të nxjerrë kuptimin e saktë të dispozitës konkrete, nga e cila varet zgjidhja e çështjes.

12. Interpretimi i ligjit që bën gjykata për zgjidhjen e çështjeve konkrete, orientohet kryesisht nga qëllimi i ligjvënësit. Kjo është metoda e interpretimit që konstatohet rëndom në praktikën gjyqësore, sa herë që gjyqtari kërkon të zgjidhë çështjen duke e interpretuar ligjin nëpërmjet studimit, analizës, si dhe krahasimit të dispozitave ligjore me njëra-tjetrën, por edhe me ligjet e tjera.

KREU I DYTË

PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS CIVILE

- PARIMI I INICIATIVËS SË PALËVE
- PARIMI I "KONTRADIKTORITETIT"
- OBJEKTI I MOSMARRËVESHJES DHE NDRYSHIMI I TIJ

a - OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet:

- Të zotërojnë parimet e përgjithshme lidhur me kufizimet e kompetencës së gjyqtarit për sa i përket zgjedhjes së fakteve që duhet të merren në shqyrtim dhe kryerjes së akteve procedurale.
- Të jenë të vetëdijshëm për kërkesat e "procesit të rregullt gjyqësor" gjatë gjykimit të çështjes civile.
- Të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e interpretimit korrekt të pretendimeve të palëve për një shqyrtim të shpejtë dhe efektiv të çështjes.

b - MATERIALET REFERUESE KRYESORE

Karakteristikat kryesore të modelit shqiptar të procedurës civile mund të kuptohen duke lexuar titullin e parë të pjesës së parë të kodit. Ky titull përfshin rregulla që janë përdorur në kontekste të ndryshme (për shembull, nga Kodi italian) dhe janë të shpërndara në seksione të ndryshme të këtij Kodi.

1. Nenet 1 – 30 të Kodit shqiptar të Procedurës Civile[1] – Parimet Themelore të Procesit Gjyqësor

Neni 1

Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile si dhe të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

Neni 2

Vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Palët janë të lira të tërheqin padinë në çdo kohë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit.

Neni 3

Kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në këtë Kod.

Neni 4

Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme.

Objekti i mosmarrëveshjes

Neni 5

Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve.

1) Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë".

Pretendimet parashtrohen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.

Neni 6

Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Faktet

Neni 7

Fakt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike.

Neni 8

Palët kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështetin pretendimet e tyre.

Neni 9

Gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor.

Provat

Neni 11

Provat janë të dhëna që merren në formën e parashikuar nga ky Kod dhe që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces.

Neni 12

Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj.

Neni 13

Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen.

Faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi.

Neni 14

Gjykata ka për detyrë të kryejë një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 15

Palët janë të detyruara të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor. Gjykata i ngarkon ato me përgjegjësi në rast mosveprimi ose pengimi me faj të tyre.

E drejta

Neni 16

Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe të veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë, pa kërkesën e palës.

Neni 17

Gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Kontradiktoriteti

Neni 18

Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim.

Neni 19

Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështetin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.

Neni 20

Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit.

Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.

Neni 21

Kur ligji e lejon dhe rrethanat e çështjes diktojnë marrjen e një vendimi gjyqësor, pavarësisht nga dijenia e një pale, kjo e fundit ka të drejtën të ankohet në rrugë gjyqësore ndaj vendimit të dhënë.

Mbrojtja

Neni 22

Palët mund të mbrohen vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm.

Neni 23

Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 24

Gjykata dëgjon gjithnjë palët drejtpërsëdrejti, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Pajtimi i palëve

Neni 25

Është detyrë e gjykatës të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje.

Karakteri publik i procesit gjyqësor
(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 1)

Neni 26

Seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe sipas këtij Kodi.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e medias, kur çmon se nuk është në dobi të gjykimit. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

Përdorimi i gjuhës shqipe në gjykim

Neni 27

Në të gjitha fazat e gjykimit përdoret gjuha shqipe.

Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjykimit me anë të përkthyesit.

Gjykata në procesin gjyqësor civil
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 2)

Neni 28

Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 29

Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.

Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.

Publikimi i vendimit përfundimtar
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 3)

Neni 30

Kur çmohet se publikimi i vendimit përfundimtar i shërben rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, urdhëron publikimin e vendimit në media.

Kur njoftimi nuk jepet në afatin e caktuar nga gjykata, pala, në favorin e së cilës është dhënë vendimi, ka të drejtë të kërkojë publikimin me shpenzimet e personit që detyrohet.

2. Parimi i iniciativës së palëve

Dispozitat e pjesës së parë të Kodit shqiptar të procedurës civile mbështeten mbi disa parime bazë, të cilat janë pothuajse gjerësisht të pranuara nga të gjitha traditat procedurale të vendeve të së drejtës kontinentale. Një prej këtyre parimeve është edhe *parimi i iniciativës së palëve.* Në njëfarë kuptimi, ky parim është rrjedhojë e parimit të paanshmërisë dhe një zgjerim i tij në fushën e së drejtës procedurale, e cila prezanton probleme më teknike sesa thjesht garancitë e paanshmërisë të mishëruara në të drejtën publike ose në organizimin gjyqësor. Dhe, në të vërtetë, ndërsa kushdo e pranon se gjyqtari duhet të jetë tërësisht neutral ndaj çdo mosmarrëveshjeje që shqyrton, për sa i takon funksionit të gjyqtarit lidhur me trajtimin dhe klasifikimin ligjor të fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe të hapave që ai duhet të ndërmarrë për përshpejtimin e procesit, situata për publikun e thjeshtë mund të jetë më pak e qartë.

Qëndrimi i përgjithshëm në këtë kontekst përshkruhet qartë në seksionin e Enciklopedisë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar, që i kushtohet procedurës[2]:

2) IECL, vëll. XVI, në **Procedura civile, kap.6, Proceset e zakonshme gjyqësore në shkallën e parë**, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen-Hague-Boston-London, faqet 62 – 65:

"Nuk ekziston asnjë kontradiktë lidhur me rolin e gjyqtarit për fillimin e procesit gjyqësor: me përjashtim të disa rasteve të veçanta (asnjë prej të cilave nuk prek juridiksionin e gjykatave të shkallës së parë), është pranuar gjerësisht se, për shkak të parimit të kontrollit të objektit të çështjes nga palët, konsideruar si rezultat i natyrës krejtësisht private të së drejtës për t'u mbrojtur nëpërmjet procesit civil, gjyqtari nuk mund të vihet vetë në lëvizje. Kjo duhet të bëhet ose nga personat privatë (individë ose korporata), ose nga prokurori publik, në rastet kur ky i fundit mund të veprojë me iniciativën e tij në çështjet civile. Gjithsesi, sapo çështja vjen para gjyqtarit (në shumicën e sistemeve ligjore), atij i kërkohet të marrë një vendim të pandikuar nga çdo nismë e marrë nga palët. Pamundësia e gjyqtarit për të vepruar në këtë mënyrë sanksionohet ose me mundësinë për të apeluar, ose me mundësinë e fillimit të procesit penal apo civil kundër gjyqtarit fajtor për mohimin e dhënies së drejtësisë. Gjithashtu, në asnjë rast gjyqtari nuk mund të japë një vendim që i tejkalon kufijtë e padisë që ai ka në shqyrtim, d.m.th. të vendosë *ultra petita.* Por, ekzistojnë opinione të ndryshme lidhur me shkallën e kompetencave të gjyqtarit në pranimin e fakteve që përbëjnë bazën e mosmarrëveshjes dhe rregullave ligjore që zbatohen për to".

Ndonëse në parim u takon palëve të vlerësojnë faktet e nevojshme për të ngritur argumentet, gjyqtarit, megjithatë, i lejohet të marrë në shqyrtim fakte që nuk janë përmendur në kërkesat e palëve, nëse garantohet respektimi i parimit të kontrollit të palëve mbi objektin e çështjes dhe i së drejtës së tyre për t'u dëgjuar. Kompetenca e gjyqtarit për të devijuar nga kuadri faktik i pretenduar nga palët mbështetet mbi faktin se legjislatura të ndryshme orvaten t'i japin kompetenca më të gjera, si gjyqtarit që shqyrton çështjen, ashtu edhe gjykatës se faktit për sa i takon kërkimit të provave. Aktualisht, pothuajse të gjitha hetimet mund të urdhërohen me iniciativën e vetë gjykatës. Është e vërtetë edhe se këto kompetenca zakonisht përdoren thjesht për të provuar fakte të pretenduara nga palët. Por, në disa raste, ekziston mundësia të urdhërohen hetime të veçanta me kërkesën e vetë gjyqtarit, i cili mund të zbulojë fakte relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që nuk janë paraqitur nga palët. Në një rast të tillë, megjithëse hetimet kryhen me iniciativën e vetë gjykatës lidhur me faktet që palët i kanë parashtruar gjyqtarit, ky i fundit në fakt e ka zgjeruar kuadrin faktik të çështjes. Ky është një devijim nga natyra kontradiktore e procesit gjyqësor.

Shënim i autorit: *Kjo është baza e nenit 5 të Kodit francez të procedurës civile, i cili thotë: "Gjyqtari duhet të vendosë për të gjitha pikat e objektit të çështjes dhe vetëm për to", si dhe e nenit 115 të Kodit italian të procedurës civile, sipas të cilit: "Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga ligji, gjyqtari duhet ta mbështetë vendimin mbi prova të parashtruara nga palët ose nga prokurori publik".*

Gjithësesi, ai mund ta mbështetë vendimin, pa nevojën e provave, mbi nocionet faktike që janë pjesë e përvojës së zakonshme". Normalisht (aktualisht ekzistojnë edhe rastet përjashtimore), neni i fundit interpretohet si ndalues i hetimeve të mëtejshme kur çështja është mjaftueshmërisht e qartë nga provat e parashtruara nga palët.

"Sa i takon kërkimit të provave, është pranuar gjerësisht se gjyqtari duhet t'i zbatojë normat ligjore me iniciativën e tij *(jura novit curia)* dhe ai nuk varet as nga argumentet ligjore që mbështeten nga palët, as nga mënyra si i klasifikojnë ato faktet. Realisht, sipas një teorie [...] shkaku i padisë që përbën edhe të drejtën subjektive, mbrojtja gjyqësore e së cilës kërkohet, është përtej autoritetit të gjyqtarit."

Shënim i autorit: *Kompetenca e gjyqtarit për çështjet ligjore dhe klasifikimin ligjor të fakteve është parashikuar, për shembull, në nenin 113 të Kodit italian të procedurës civile, i cili thotë: "Në zgjidhjen e çështjes, gjyqtari duhet ta bazojë vendimin e tij mbi dispozitat e ligjit, përveç rasteve kur ligji i jep atij kompetencën të vendosë sipas drejtësisë", si edhe në nenin 12 të Kodit francez të procedurës civile, sipas të cilit: "Gjyqtari duhet ta zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me rregullat ligjore që zbatohen për të".*

Ai duhet ta zgjidhë mosmarrëveshjen në bazë të fakteve dhe të dokumenteve të çështjes në shqyrtim, pa e kufizuar veten në kuptimin që mund të sugjerohet nga palët. Pavarësisht nga sa më sipër, gjyqtari nuk mund ta ndryshojë kuptimin apo bazën ligjore në rastin kur palët, mbi bazën e një marrëveshjeje të shprehur dhe në ushtrim të të drejtave që gëzojnë, e kufizojnë gjyqtarin vetëm në përkufizimet ligjore apo çështjet e ligjit ku ata kërkojnë të kufizohet argumentimi i çështjes.

Me ngritjen e një mosmarrëveshjeje, palët mund ta veshin gjyqtarin me kompetencat e një arbitri kur mosmarrëveshja lidhet me të njëjtat çështje apo me të njëjtat rrethana, gjë që i nënshtrohet apelimit në rastin kur palët nuk kanë hequr dorë në mënyrë të shprehur nga ushtrimi i kësaj të drejte".

"Në këto raste e drejta e palëve për t'u dëgjuar për çështjet e ligjit të ngritura me iniciativën e vetë gjyqtarit ekziston edhe nëse diskutohet papranueshmëria e kërkesës për fillimin e procesit (padisë) për shkak të politikave publike. Përjashtimet nga ky rregull pranohen vetëm për çështjet që nuk janë të reja, duke qenë se ato janë tashmë të përfshira në ankesën e parashtruar, ose nëse ka cenim të politikave publike.

Megjithatë, ky parim mund të kufizohet. Nëpërmjet një marrëveshjeje të shprehur dhe në respektim të të drejtave nga të cilat palët lejohet të heqin dore, ato mund të parashtrojnë para gjyqtarit klasifikimin ligjor dhe çështjet e ligjit ku ato duan ta kufizojnë argumentimin e çështjes. [Sa i takon nenit 12 të Kodit francez], disa autorë thonë se rregulla nuk mund të zbatohet në rastet kur klasifikimi ligjor i fakteve është pjesë integrale e shkakut të kërkesës për fillimin e procesit. Duhet të theksohet se ky klasifikim shpesh nxjerr nevojën e marrjes në shqyrtim të fakteve të tjera, përveç atyre që janë shqyrtuar fillimisht.

Përveç dispozitave të reja ligjore që e autorizojnë gjyqtarin për zbatimin e normave ligjore, edhe nëse kjo gjë nuk kërkohet nga palët, gjykata franceze e kasacionit duket se mbështet një nocion shumë klasik të rolit të gjyqtarit".

Shënim i autorit: *Ky qëndrim i gjykatës franceze të kasacionit, i cili provon edhe një herë tjetër rolin e saj kryesor ligjbërës në zhvillimin e sistemit ligjor francez, mbështetet në nenin 4 të Kodit francez të procedurës civile, që thotë se: "Objekti i një mosmarrëveshjeje duhet të zgjidhet mbi bazën e pretendimeve përkatëse të ngritura nga palët. Këto pretendime duhet të paraqiten në kërkesën fillestare dhe në mbrojtje. Pavarësisht nga sa më sipër, objekti i një mosmarrëveshjeje mund të ndryshohet nëpërmjet pretendimeve të ndërmjetme kur provohet se ato kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet fillestare".*

"Në mënyrë të ngjashme, edhe sipas ligjit italian, kompetenca e gjyqtarit për të vendosur se cilat norma ligjore duhet të zbatojë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të caktuar është e kufizuar".

Shënim i autorit: *Sipas interpretimit të nenit 113 të Kodit italian të procedurës civile, dhënë nga gjykata italiane e kasacionit, gjyqtari ndalohet "të zëvendësojë me iniciativën e tij kërkesën që është paraqitur formalisht dhe shprehimisht nga palët"[3] dhe ai duhet të respektojë "lidhjen midis kërkesës dhe vendimit, duke marrë në konsideratë argumentet e paraqitura dhe pasojat ligjore të mbrojtjes të së drejtës." Këtij neni duhet t'i shtohet edhe neni 112 i K.pr.civile që e ndalon shprehimisht gjyqtarin të vendosë me iniciativën e tij për mbrojtjen, e cila duhet të ndërtohet nga vetë palët".*

"Por, ligji francez shfaq njëlloj hezitimi lidhur me çështjen nëse gjyqtari mund të zbatojë një normë tjetër ligjore dhe jo atë në të cilën duhet të mbështetet, sikur kjo të çonte qoftë edhe pjesërisht në marrjen në shqyrtim

3) Gjykata e Kasacionit, 1 gusht 1960, nr. 2253, në Jurisprudenca italiane, 1961, I, 398)

nga ana e tij të fakteve që "nuk janë pjesë përbërëse e mosmarrëveshjes". Ndërsa disa shkrimtarë francezë të procedurës e pranojnë këtë mundësi, gjykata e kasacionit, duke i qëndruar një interpretimi të kufizuar, e ka hedhur poshtë këtë gjë. Gjyqtari mund të riklasifikojë faktet, shkakun ose qëllimin e kërkesës vetëm nëse, duke vepruar në këtë mënyrë, ai nuk falsifikon kuptimin e qartë dhe të dukshëm të kërkesave të palëve. Duke folur në mënyrë më të përgjithshme, në të gjitha sistemet ligjore, gjyqtarit i kërkohet të zbatojë norma ligjore me iniciativën e tij. Në shumë prej sistemeve, gjyqtari ka kompetenca të caktuara në drejtim të nxitjes së ecurisë formale të kërkesës për fillimin e procesit. Kjo është veçanërisht e vërtetë në Itali dhe në Francë ku gjyqtari që ka në shqyrtim çështjen, ka disa kompetenca lidhur me ndryshimin e ritmit të procesit për t'iu përshtatur rrethanave specifike të çdo çështjeje. Në vende të tjera, palët kanë ende kompetenca të konsiderueshme për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar se mosmarrëveshja po ecën në drejtimin e gjetjes së një zgjidhjeje që u vjen përshtat atyre."

Shënim i autorit: *Është interesante të vërehet se bazat e parimit të iniciativës së palëve mund të gjenden ndonjëherë edhe në kodet civile, përveçse në kodet e procedurës civile. Ky është, për shembull, rasti i nenit 2907 të Kodit civil italian të vitit 1942, i cili thotë: "Mbrojtja ligjore e të drejtave garantohet nga pushteti gjyqësor, me kërkesë të palëve apo të prokurorit publik, ose me iniciativën e tij, në rastet e parashikuara me ligj."*

3. Parimi i iniciativës së palëve sipas legjislacionit shqiptar

Vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, *përveç kur ligji parashikon ndryshe*. Kjo është rregulla që parashikohet që në nenin 2 të Kodit shqiptar të procedurës civile. Sipas kësaj rregulle, që i njeh të drejtën palës për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të disponuar në mënyrë individuale për të drejtat e saja, sanksionohet jo vetëm ky parim i rëndësishëm procedural, por njëkohësisht evidentohet edhe një parim tjetër, ai i paanësisë së gjykatës në zgjidhjen e çështjes.

Jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar në këtë dispozitë procedurale edhe përjashtimin, sipas të cilit mund të ketë raste kur fillimi i procesit të mos bëhet me kërkesë të palës. Kështu njihet e drejta që procesi civil të bëhet edhe me kërkesë të ndonjë organi tjetër, i cili nuk ka atë interes të drejtpërdrejtë që ka pala.

Në kohën e miratimit të Kodit të procedurës civile, në vitin 1996, i njihej e drejta prokurorit të ngrinte padi në një proces gjyqësor civil. Me gjithë ndryshimet që iu bënë këtij Kodi në vitin 2001 (të cilat shfuqizuan nenet 84-

89 që parashikonin në një titull të veçantë pozicionin e prokurorit), atij nuk i është mohuar e drejta të bëjë padi. Kështu, në Kodin e familjes, të miratuar në vitin 2003, i është njohur e drejta prokurorit të paraqesë padi në gjykatë. Konkretisht, sipas neneve 20/3, 173/2, 228 dhe 264, shkronja "ç", prokurori ka të drejtën e kundërshtimit në gjykatë të martesës, të njohjes së atësisë ose të amësisë, të heqjes së përgjegjësisë prindërore, të vendosjes së kujdestarisë etj. Gjithashtu, neni 264 , shkronja "d", ia ka njohur këtë të drejtë edhe noterit.

Parimi i iniciativës së palëve ose, siç quhet ndryshe, parimi i disponibilitetit realizohet me anë të padisë. Padia nënkupton të drejtën e personit që bën pretendimin për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Ky është kuptimi që jepet për padinë në nenin 31 të Kodit të procedurës civile. E drejta për fillimin e një procesi gjyqësor është thelbësore që t'u njihet palëve, për arsye se ato janë më të motivuara dhe nisen nga interesa më të ngushtë për të vënë në lëvizje gjykatën. Kjo konsiderohet edhe si një nga të drejtat kushtetuese të shtetasve. Përmbushja e kësaj të drejte realizohet sipas rregullave të caktuara ligjore. Konkretizimi i këtij parimi gjendet i pasqyruar gjerësisht në shumë dispozita të Kodit të procedurës civile.

Kodi i procedurës civile, për shkak të respektimit të parimit të iniciativës së palëve, nuk e lejon gjykatën të ndryshojë bazën juridike të padisë. Neni 16 i këtij Kodi e përcakton këtë rregull. Gjyqtari nuk mund të tejkalojë kufijtë e padisë *(ultra petita)*. Nga ana tjetër, po kjo dispozitë i njeh të drejtën gjykatës t'u bëjë një cilësim të saktë fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur nga përcaktimi që mund të propozojnë palët *(jura novit curia)*[4]. Ky është një parim i rëndësishëm që duhet dalluar nga parimi tjetër, *curia novit iura o legem*[5]. Megjithatë, kompetenca e gjyqtarit për të vendosur

4 Latinisht, gjykata njeh ligjin (të drejtën e zbatueshme). Kjo maksimë nuk përdoret kur i referohemi një ligji të huaj; pra i bie barra palës që e referon ligjin e huaj, të provojë përmbajtjen e tij dhe lidhjen me çështjen.

5 Kjo përbën një nga dallimet më të dukshme midis procesit gjyqësor të **civil law** *(të së drejtës kontinentale) dhe atij të* **common law** *(të së drejtës anglo-saksone):* **iura novit curia** *është parimi i përgjithshëm i rendit juridik të civil law, por që nuk njihet nga common law, në të cilin është në fuqi parimi i kundërt,* **curia novit iura**, *ku i përket palës nderi t'i tregojë gjyqtarit ligjin e zbatueshëm në rastin në shqyrtim. Për më tepër, do të përbënte mungesë të rëndë korrektese profesionale nëse pala nuk njofton gjyqtarin për ekzistencën e precedentëve të detyrueshëm për objektin e çështjes. Është vërejtur se parimi* **iura novit curia** *përbën mbase arsyen kryesore të fryrjes tej mase të magjistraturave kontinentale. Kjo larushi del veçanërisht në pah në të drejtën ndërkombëtare private ku në common law është në fuqi parimi* **iura aliena non novit curia** *(e drejta e huaj nuk është e detyrueshme për gjykatën). Sidoqoftë, në rendin juridik italian, kompetenca e gjyqtarit për të vendosur* **ex officio** *ligjin e zbatueshëm shtrihet edhe ndaj legjislacionit të huaj.*

se cilat norma të së drejtës duhet të aplikojë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk është aq e lehtë për t'u realizuar. Duket sikur ka një devijim nga natyra kontradiktore e procesit gjyqësor. Nenet 6 dhe 28 të Kodit të procedurës civile duhen analizuar me kujdes në raport me nenin 16 të tij. Po të shohim legjislacionin italian, në këtë drejtim, duket se e ai ndalon gjyqtarin ta bëjë një gjë të tillë, ndërkohë që legjislacioni francez paraqet një lloj hezitimi. Pikërisht ky moment është i rëndësishëm për t'u mbajtur në vëmendje.

Duke iu referuar këtyre dispozitave procedurale, vihet re se palët mund të venë në lëvizje gjykatën dhe të fillojnë vetë një proces gjyqësor (neni 2). Janë palët ato që përcaktojnë objektin e mosmarrëveshjes (neni 5), që kanë të drejtë të ndryshojnë bazën juridike të padisë (neni 16/2), të provojnë faktet mbi të cilat e bazojnë pretendimin e vet (neni 12), të caktojnë mënyrën e mbrojtjes në gjyq (nenet 22, 23), të ndryshojnë shkakun ligjor të objektit të padisë (nenet 28, 185), të shtojnë, të pakësojnë ose të ndryshojnë objektin e padisë (nenet 28, 185), të heqin dorë nga gjykimi ose e drejta e padisë (neni 201) etj.

Gjithashtu, palët kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet shumë gjykatave kompetente (neni 54), të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit (neni 72), rivendosjen në afat (neni 151), sigurimin e padisë (neni 202), marrjen e provave (neni 223), caktimin e ekspertëve (neni 225), zëvendësimin e palëve në proces (neni 184), pyetjen e dëshmitarëve, ballafaqimin, ose heqjen dorë nga pyetja e tyre (nenet 231 e vijues, nenet 240, 242), sigurimin e provës (neni 292), paraqitjen e kundërpadisë (neni 160), vënien në ekzekutim të vendimit të dhënë në favor të tij (neni 515), ushtrimin e ankimit etj. Është e kuptueshme se të gjitha këto të drejta janë në disponimin e vetë palës.

Ekzistenca e këtij parimi e detyron gjykatën të jetë e kujdesshme dhe të kufizohet vetëm në kërkesat e palës që ka nisur procesin. Për gjykatën vepron rregulla, sipas së cilës, *gjykata që gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet* (neni 6). Kjo do të thotë se gjykata në zgjidhjen e çështjes nuk duhet të kapërcejë caqet e kërkesave të palëve. Ajo duhet të ruajë raportin ndërmjet kërkesës së palës dhe shpalljes së vendimit.

Me fillimin e procesit, gjykata u kërkon palëve kryerjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme që nevojiten për zhvillimin normal të tij. Ajo u kërkon palëve të interesuara paraqitjen e provave, të fakteve e të të dhënave të ndryshme, të cilat i nënshtrohen hetimit gjyqësor. Merren ato prova që janë të domosdoshme dhe që kanë lidhje me çështjen që gjykohet. Të gjitha provat që i paraqiten për shqyrtim gjykatës, vlerësohen dhe argumentohen në vendimin përfundimtar me objektivitet, në përputhje me ligjin, duke u bazuar edhe në bindjen e brendshme të vetë gjyqtarit.

Pavarësisht nga pozicioni që merr gjykata, kjo nuk e shmang palën që paraqet

një pretendim nga detyrimi, për ta provuar atë. Pala që pretendon një të drejtë, ka njëkohësisht detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Barra e të provuarit lidhet me të drejtën e palës që pretendon një fakt për të shfrytëzuar të gjitha ato rregulla që ligji kërkon për marrjen e provave, si: pyetja e dëshmitarëve, dëgjimi, paraqitja e shkresave dhe e dokumenteve të ndryshme, kërkimi i ekspertimit, sigurimi i provave etj.

Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi. Tejkalimi i kërkesave të palëve dhe që shkon me kapërcim të objektit apo të shkakut të padisë, është konsideruar me të drejtë nga gjykatat në shumë raste si shkelje ligjore.

Kufizimi që ka gjykata e zakonshme për të kapërcyer kufijtë e kërkesave të palëve në një proces gjyqësor, nuk mund të zbatohet në mënyrë të njëllojtë dhe me kaq rigorozitet edhe për gjykimin kushtetues. Midis tyre ka një dallim thelbësor, i cili është shumë i rëndësishëm për t'u evidentuar.

"Kufijtë e shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, ashtu si të gjitha çështjet që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese, si rregull, janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara nga subjekti inicues. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese. Ky gjykim ka të bëjë me ato raste kur, gjatë procesit kushtetues, krahas objektit kryesor që lidhet me antikushtetutshmërinë e një norme, shfaqen edhe disa akte të tjera të bazuara mbi këtë normë ose pandashmërisht të lidhura me të, të cilat nuk mund të mbeten jashtë këtij kontrolli kushtetues.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për antikushtetutshmëri ndaj një ligji, akti të autoritetit administrativ ose të një vendimi gjykate, kur Gjykata Kushtetuese gjen se norma e goditur është antikushtetuese, sepse është bazuar në një ligj tjetër, i cili edhe ai mund të jetë antikushtetues, atëherë ajo, në kushtet e një gjykimi incidental të normës juridike, mund ta deklarojë edhe këtë ligj antikushtetues dhe pa fuqi juridike, pavarësisht nga kërkesa. Shqyrtimi i këtyre çështjeve tej objektit dhe shkakut të kërkesës së subjektit që parashikon dhe neni 47 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i përshtatet gjykimit kushtetues dhe përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.

Gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve gjykata bëhet vetë iniciuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një akti tjetër, megjithëse ndaj tij kërkuesi nuk ka bërë ndonjë kërkesë konkrete. Ky moment ngjan me nismën që ushtronte më parë Gjykata Kushtetuese, por nuk duhet kuptuar si i tillë, pasi në gjykimin e këtyre çështjeve, gjithmonë ka një kërkesë të paraqitur për shqyrtim, mbi

bazën e së cilës ka filluar dhe gjykimi kushtetues. Ndërsa në rastin e nismës, pra të gjykimit kryesisht, nuk ka kërkesë nga ndonjë subjekt. Pikërisht ky moment përbën edhe dallimin kryesor.

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese ka disa raste kur ajo ka shqyrtuar çështjen tej objektit dhe shkakut të kërkesës së subjektit përkatës. Në vendimin nr. 65/99, Gjykata e Lartë i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të shpallte dispozitat e Kodit penal që parashikonin dënimin me vdekje, të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Meqenëse objekti i kërkesës së paraqitur ishte vetëm papajtueshmëria me Kushtetutën e dënimit me vdekje lidhur me dispozitat e Kodit penal dhe jo të Kodit penal ushtarak, Gjykata Kushtetuese, duke çmuar ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis dispozitave të dy kodeve, vendosi të shqyrtojë tej objektit të kërkesës edhe kushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit penal ushtarak që parashikonin dënimin me vdekje në kohë paqeje.

Në gjykime që lidhen me kontrollin paraprak të normës, Gjykatës Kushtetuese nuk i ndalohet të tejkalojë objektin e kërkesës. Kjo rrjedh nga natyra që ka kontrolli paraprak dhe nga fakti se Gjykata Kushtetuese, duke qenë në rolin e garantit të Kushtetutës, gjatë kontrollit që u bën marrëveshjeve ndërkombëtare ose çështjeve të shtruara për referendum, nuk mund të lejojë në asnjë rast antikushtetutshmërinë në to, thjesht për arsye se kërkuesi nuk e ka ngritur në kërkesën e tij. Prandaj dhe disponibiliteti i Gjykatës Kushtetuese duhet dalluar deri diku me kufizimin që ekziston për gjykatën e zakonshme, kur ajo shqyrton çështje gjyqësore, ku kësaj të fundit nuk i lejohet në mënyrë absolute tejkalimi i objektit të kërkesës së paraqitur"[6].

Sidoqoftë, pavarësisht nga kjo analizë që i bëhet gjykimit kushtetues, kjo nuk nënkupton se parimi i iniciativës së palëve nuk vepron në gjykime të kësaj natyre. Ky është veçse një përjashtim që zbatohet shumë rrallë në praktikën kushtetuese. Ndërsa për gjykimin e zakonshëm, konstatimi i rasteve kur gjykata shkon tej kërkesave të parashtruara nga palët është konsideruar me të drejtë si shkelje që cenon të gjithë procesin gjyqësor.

Po citojmë tri vendime që konkretizojnë pikërisht shkeljen e parimit të iniciativës së palëve nga gjykatat e zakonshme.

Rasti i parë

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 901, datë 21.6.2000, ndërmjet të tjerave, kanë arsyetuar: *"Me këtë zgjidhje të dyja gjykatat*

---

6) Sadushi, Sokol.: Kontrolli kushtetues, botim i vitit 2004, faqe 188.

kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 2 dhe 6 të K.pr.civile. Sipas nenit 2/1 të K.pr.civile, "Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe", ndërsa, sipas nenit 6, "Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet".

Në rastin konkret, gjykata është vënë në lëvizje nga firma "CICEK"-sh.p.k., e cila ka paditur Portin Detar. Mosmarrëveshja e tyre ka lindur lidhur me detyrimin e të paditurit për të paguar një shumë të caktuar, që përbën dëmin e krijuar prej mospërmbushjes së detyrimit që rrjedh nga kontrata e depozitës së një sasie mielli prej 100 tonë. Në çdo rast që shqyrton një padi civile, gjykata, në përfundim të gjykimit, është e detyruar të shprehet lidhur me pranimin ose mospranimin e të gjitha kërkimeve të paditësit ndaj të paditurit të thirrur prej tij. Thirrja me cilësinë e të paditurit e personave të tjerë është në disponimin e paditësit. Gjykata nuk mund të dalë jashtë kufijve proceduralë të gjykimit midis palëve në konflikt. Si rregull, ajo nuk mund të krijojë ndërgjyqësi të ndryshme nga ajo që kërkojnë palët.

Në rastin në shqyrtim, gjykata ishte e detyruar të shprehej lidhur me kërkimet e paditësit "CICEK"-sh.p.k, kundrejt të paditurit, Portit Detar, duke vendosur përfundimisht për pranimin ose rrëzimin e padisë (tërësisht apo pjesërisht). Duke mos u shprehur lidhur me kërkimet e paditësit ndaj të paditurit të thirrur prej tij, gjykata, në aspektin procedural, e ka lënë të pazgjidhur konfliktin midis tyre, ndërsa, duke thirrur kryesisht si të paditur "ENGLAND"-sh.p.k. dhe shtetasin Muhamet Balla dhe duke vendosur detyrimin e "ENGLAND"-sh.p.k. ndaj "CICEK"-sh.p.k., ka dalë jashtë kufijve të gjykimit midis palëve në konflikt. Ajo ka vendosur në favor të firmës "CICEK"-sh.p.k. një detyrim të pakërkuar prej saj. Duke vepruar kështu, është shkelur parimi procedural i disponibilitetit të kërkimeve të palëve (neni 6 i K.pr.civile).

Paditësi e disponon vullnetin e tij nëpërmjet kërkimeve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në objektin e padisë, ndërsa i padituri, vullnetin e tij e disponon duke pranuar tërësisht ose pjesërisht kërkimet e paditësit, apo duke mos i pranuar ato. Në një gjykim të filluar i padituri mund të përdorë për t'u mbrojtur, sipas disponimit të tij, mjete të caktuara të cilat i paraqet proceduralisht nëpërmjet prapësimeve apo kundërpadisë. Prapësimi, si mjet procedural mbrojtjeje i të paditurit ndaj një padie të ngritur kundër tij, parashikohet në menyrë implicite në nenin 31/2 të K.pr.civile, sipas të cilit, "Padia i jep të drejtën palës tjetër kundërshtare për të diskutuar mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi". Nisur nga formulimi i dispozitës së mësipërme, rezulton se i padituri në një gjykim të filluar mund t'i kundërdrej-

tojë paditësit arsyet që, nga pikëpamja e faktit apo e ligjit, i bëjnë të papranueshme kërkimet e tija të paraqitura me anë të padisë. Në rastin e paraqitjes së prapësimit, i padituri nuk del me kërkime të veçanta ndaj paditësit, prandaj gjykimi i çështjes përqendrohet brenda kuadrit të kërkimeve të paditësit, të shprehura në objektin e padisë.

Në rastin në shqyrtim, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Porti Detar, Shëngjin, përmban pjesërisht tiparet e një prapësimi. Kundrejt kërkimit të paditësit, të paraqitur në objektin e padisë për pagimin e kundërvleftës së sasisë prej 100 tonë miell dhe të kamatës përkatëse, i padituri ka paraqitur arsyet që e bëjnë të papranueshëm këtë kërkim. I padituri, Porti Detar, Shëngjin, ka prapësuar duke pretenduar që midis paditësit "CICEK"-sh.p.k. dhe "ENGLAND"-sh.p.k. ka pasur një kontratë furnizimi për një sasi mielli dhe se sasia prej 100 tonë është tërhequr nga shtetasi Muhamet Balla, në emër dhe për llogari të "ENGLAND"-sh.p.k., sipas porosisë së kësaj të fundit. Në këto rrethana, në qoftë se pala e paditur do të provonte këtë prapësim, atëherë çështja do të zgjidhej duke rrëzuar padinë ."

Rasti i dytë

Konstatimi i tejkalimit të objektit të padisë *(ultra petita)* nga ana e gjykatës është konsideruar, edhe në aspektin kushtetues, në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese, si shkelje e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Nga jurisprudenca gjyqësore po citojmë dy nga këto vendime:

Në vendimin nr.**20, datë 2.7.2003 ,G**jykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ndërmjet të tjerave, arsyeton: *"Paraprakisht, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se të dyja pretendimet e para që parashtron kërkuesi dhe që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit dhe të barazisë së armëve në proces, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi apo të vendosjes së njërës palë në një pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër, ndërkohë që kjo pabarazi është reflektuar edhe në arsyetimin në mënyrë të njëanshme të argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elemente thelbësore që prekin parimin e paanësisë në gjykim dhe cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.*

Duke i'u referuar rastit në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk e kanë respektuar parimin e paanësisë në gjykim. Shkelja e këtij parimi kushtetues konsiston në faktin se të dyja gjykatat kanë disponuar tej kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe e kanë zgjidhur

mosmarrëveshjen midis palëve duke u shprehur edhe për ato që nuk janë kërkuar nga pala paditëse.

Kërkesëpadia ka pasur për objekt detyrimin e palës së paditur të dorëzojë apartamentin duke përmbushur detyrimet kontraktore në shumën 500.000 lekë për secilin, ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar atë në disa drejtime. Gjykata ka disponuar tej objektit të padisë, sepse e ka detyruar kërkuesin të bëjë kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e apartamenteve në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndërkohë që një gjë e tillë nuk rezulton e kërkuar shprehimisht nga paditësi. Kërkimi në objektin e padisë për dorëzim sendi nuk duhet ngatërruar me kalimin e pronësisë, sepse për këtë kalim pronësie është e domosdoshme përmbushja e detyrimeve kontraktore nga palët. Gjithashtu, megjithëse, sipas objektit të padisë, rezulton se pala paditëse ka kërkuar përmbushjen e detyrimeve kontraktore në shumën 500.000 lekë, gjykata, pa respektuar korrektësisht kërkesat procedurale që kërkon ligji për shtesën e objektit të padisë, detyron kërkuesin të paguajë tej kësaj shume si dhe njëkohësisht të kryejë një tjetër punim shtesë që lidhet me riparimin e ballkoneve.

Gjykata e apelit, Tiranë, ka detyruar palën e paditur të paguajë fitimin e munguar për të gjithë paditësit dhe për dy prej tyre edhe kushtin penal, por nuk arsyeton dhe nuk argumenton se në çfarë dispozite ligjore është bazuar për marrjen e një vendimi të tillë, megjithëse një kërkesë e tillë ishte rrëzuar e argumentuar nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme. Në vendimin e saj, gjykata e apelit nuk u jep përgjigje argumenteve të parashtruara në kërkesën ankimore nga pala e paditur, duke krijuar dyshime se në zgjidhjen e kësaj çështjeje ajo ka qenë e njëanshme. Sigurisht, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të analizojë provat dhe faktet se ku janë bazuar gjykatat për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ajo mbetet detyrë funksionale e gjykatave që zgjidhin çështjen. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, në aspektin e kontrollit kushtetues, konstaton se në këtë proces gjyqësor nuk është respektuar parimi i paanësisë në gjykim, që në rastin konkret reflektohet në drejtim të pranimit në mënyrë të njëanshme të kërkesave vetëm të njërës palë, pa dhënë argumentet ligjore, si dhe të mosdhënies përgjigje dhe mosanalizimit të argumenteve që ka parashtruar pala tjetër. Është detyrë e gjykatës së zakonshme ta mbështetë vendimin e saj mbi mjetet, faktet, dokumentet dhe të gjitha provat e tjera që sjellin palët, por duke i analizuar dhe duke i arsyetuar ato në bazë të ligjit dhe me objektivitet.

Në rastin në shqyrtim, vendimi i gjykatës së apelit merret vetëm me pretendimet e palës paditëse dhe nuk arsyeton për t'i rrëzuar si të pambështetura në ligj dhe në prova argumentet e kërkuesit. Në këto kushte, Gjykata

Kushtetuese çmon se, pa i hyrë analizës së provave apo fakteve të paraqitura nga palët në gjykim, por duke vlerësuar procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit vetëm në drejtim të respektimit të parimit të paanësisë, është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor".

Rasti i tretë

Në një tjetër vendim, Gjykata Kushtetuese e përforcon kuptimin e parimit të disponibilitetit në gjykim. Kështu, në vendimin nr .8, datë 23.04.2004, ndërmjet të tjerave, ajo arsyeton: *"Një formë tjetër e shkeljes së kësaj të drejte themelore, për proces të rregullt, është edhe ajo e mosrespektimit nga ana e këtyre gjykatave të parimit të disponibilitetit të padisë. Duke mos pasur parasysh kërkesat e neneve 6, 16/2 e 28 të Kodit të procedurës civile, ku gjen pasqyrim ky parim kryesor i procesit gjyqësor, të dyja gjykatat kanë vepruar në drejtim të kundërt. Kështu, ato kanë ndryshuar kryesisht, pa pëlqimin e kërkuesve, bazën juridike të padisë, duke e gjykuar atë jo si padi revendikimi e pronarit joposedues kundër posedueusit të paligjshëm jopronar, por si padi që rrjedh nga detyrimet e lindura nga kontrata e qirasë së banesave. Pra, në këtë rast, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë i ka kaluar kufijtë e padisë, sepse ajo është shprehur edhe për gjëra që nuk i janë kërkuar, siç është vërtetimi nga ana e saj i ekzistencës së marrëdhënies juridike të qirasë së banesave midis pjesëmarrësve në proces ose i detyrimit të subjekteve të interesuara t'u paguajnë kërkuesve çmim të reduktuar të qirasë së banesave dhe jo shpërblim për përdorimin e sendit".*

4. Roli i gjykatës gjatë procesit

Sidoqoftë, gjykata, duke iu referuar parimit të njohur *iuria novit curia,* nuk mund të zgjidhë çështjen ligjore, pa mbajtur rol përcaktues gjatë gjithë procesit. Kjo nuk e largon gjykatën nga respektimi i parimit të paanësisë, por, në një farë mënyre, as nuk ia kufizon asaj të drejtën që të mos kërkojë, qoftë edhe kryesisht, kryerjen e disa veprimeve që ndihmojnë në zbatimin e drejtë të ligjit. Ky rol i gjykatës nuk nënkupton të qenët e saj aktive në ecurinë e procesit gjyqësor. Njëkohësisht, as nuk gjen pasqyrim si ndonjë parim i veçantë procedural. Megjithatë, nga shumë dispozita të Kodit të procedurës civile rezulton dukshëm se gjykata, me iniciativën e vet dhe pa qenë e imponuar nga palët, mund të marrë vendime dhe të kryejë veprime të ndryshme procedurale që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes në mënyrë sa më të drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Janë shumë dispozita në Kodin e procedurës civile që paraqesin këtë funksion të gjykatës, duke i dhënë asaj të drejtë, qoftë edhe kryesisht dhe pa

qenë nevoja e kërkesës së palëve, të kryejë disa veprime të caktuara. Konkretisht, është gjykata që *kryesisht* :

- vendos nëse çështja hyn në juridiksionin administrativ ose gjyqësor (neni 59);
- vendos moskompetencën duke ia dërguar çështjen gjykatës kompetente (neni 61);
- përcakton vetë vlerën e padisë, kur është e pamundur (neni 68);
- urdhëron njoftimin e Avokaturës së Shtetit për të përfaqësuar në gjykim organet administrative (neni 79/a);
- përcakton vetë taksën mbi aktet, kur paraqitet e vështirë (neni 104);
- kryen me iniciativë disa veprime sipas nenit 158, që lidhen me plotësimin e kërkesëpadisë, përjashtimin e paditësit nga taksat, thirrjen e dëshmitarëve;
- thërret personin e tretë, kur e çmon të nevojshme (neni 193);
- kërkon të dhëna me shkrim për akte e dokumente nga organet shtetërore (neni 224);
- kërkon përsëritjen e ekspertimit, kur është i paqartë ose i metë (neni 229);
- bën ballafaqimin ose ripyetjen e dëshmitarëve (nenet 240, 241);
- heq dorë nga pyetja e dëshmitarëve (neni 243);
- bën këqyrjen në vend të sendeve, personave (neni 286);
- vendos për kryerjen e riprodhimeve fotografike apo filmimeve (neni 289);
- vendos pezullimin ose pushimin e gjykimit (nenet 297, 299) etj.

Një aspekt i veçantë i rolit të gjykatës vihet re në rastin kur ajo ndeshet me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Në raste të tilla, gjykata mund të disponojë kryesisht. Sipas këtij rregulli, gjykata a gjyqtari mund të shprehen për nulitetin e aktit absolutisht të pavlefshëm edhe në mungesë të një kërkese të veçantë nga pala. Për deklarimin e pavlefshmërisë relative të aktit administrativ kërkohet detyrimisht kërkesa e palës që të nxirret një vendim gjyqësor[7].

Të gjitha këto dispozita që cituam, nuk i japin gjykatës rol aktiv në zgjidhjen e çështjes dhe nuk e injorojnë parimin e iniciativës së palëve në proces. Ligji i njeh gjykatës këto të drejta që ajo të zbatojë normat ligjore me iniciativën e saj, pa shkelur disponibilitetin e palëve në proces. Është parimi *iuria novit curia* që i njeh të drejtë gjykatës të kërkojë shpjegime *për faktet që ajo i çmon të nevojshme*

7) Në dallim nga rishikimi gjyqësor, në procedurat e rishikimit administrativ mund të deklarohet pavlefshmëria relative e aktit edhe pa kërkesë të palës, por me nismën e organit më të lartë. Neni 121 i Kodit të procedurave administrative parashikon nismën e organit kompetent për shfuqizimin ose revokimin e aktit administrativ. Një rregull e tillë është e zbatueshme në administratë edhe për arsye të parimit të hierarkisë.

për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9), të kërkojë shpjegime *nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme* për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 17), të kryejë hetim gjyqësor në përputhje me ligjin (neni 14), të bëjë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve *pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët (neni* 16/2), të kërkojë respektimin e parimit të kontradiktoritetit (neni 20), të çmojë provat në bazë të bindjes së saj të brendshme (neni 29, 309), të pranojë vetëm ato prova që janë domosdoshme dhe që kanë lidhje me çështjen e gjykimit (neni 213) etj.

5. Parimi i "kontradiktoritetit"

Parimi i "kontradiktoritetit", "i së drejtës për t'u dëgjuar" ose, më përgjithësisht, "i procesit të rregullt gjyqësor" po perceptohet gjithnjë e më tepër si një e drejtë themelore, sikurse është provuar edhe prej disa materialeve të paraqitura në kapitullin I. Në këtë seksion do të përqendrohemi në shprehjen e tij në nivelin e kodifikimeve të së drejtës procedurale. Le të shohim, gjithashtu, përshkrimin e përgjithshëm të rëndësisë së këtij parimi në publikimet e përmendura edhe më sipër.

"Një parim thelbësor që përmendet shpesh, është ai i drejtësisë apo, më saktë, nevoja e respektimit të së drejtës për t'u dëgjuar. Detyrimi i respektimit të këtij parimi, i cili ndonjëherë i atribuohet së drejtës natyrore, nuk është karakteristikë vetëm e vendeve të së drejtës kontinentale, pasi, në sistemet romaniste, ky parim nuk është më i veçantë sesa parimi i oralitetit dhe publicitetit të seancave gjyqësore. Është mjaft domethënës fakti se kjo e drejtë e veçantë duhet t'i atribuohet një rregulli themelor më të përgjithshëm, përmbajtja e të cilit është tepër e ngjashme, ndonëse emërtimet variojnë nga një autor në tjetrin: karakteri kontradiktor i procesit, parimi i kontradiktoritetit."

Ky parim është parashikuar, për shembull, në nenin 101 të Kodit italian të procedurës civile *(**Shënim i autorit:** ky nen thotë se: "Në rastet kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, gjyqtari mund të marrë vendim mbi një kërkesë të paraqitur, nëse pala e paditur është thirrur në gjykatë sipas rregullave dhe është paraqitur").*

Ky parim është vërtetuar në mënyrë të veçantë edhe në nenin 16 të Kodit francez të procedurës civile, ndryshuar në vitin 1981. *(**Shënim i autorit:** Ky nen thotë se: "Në çdo rast, gjyqtari duhet të zbatojë dhe të jetë në përputhje me parimin inter partes". Në vendimin e tij gjyqtari nuk mund të marrë në shqyrtim çështje, shpjegime dhe dokumente që mbështeten apo janë të prodhuara nga palët, me përjashtim të rasteve kur palët i kanë dhënë atij mundësinë të ngrejë argumente në mënyrë kundërshtuese. Gjyqtari nuk duhet ta bazojë vendimin mbi çështje ligjore të ngritura me iniciativën e tij, pa i ftuar më parë palët të komentojnë për to")*

Nga kjo dispozitë del se parimi i kontradiktoritetit është i një rëndësie të veçantë në të drejtën franceze, pasi ai zbatohet edhe për vetë gjyqtarin, përveç diskutimeve mes palëve.

Rrjedhimisht, termi *"kontradiktoritet"* ka kuptim të ndryshëm nga ai që mbart zakonisht, kur procedura kontestuese krahasohet me procedurën në mungesë. Si rregull e përgjithshme që drejton fillimin dhe vazhdimësinë e procesit gjyqësor, parimi i kontradiktoritetit, i nxjerrë nga fragmente të legjislacionit dhe të jurisprudencës, përfshin, si marrëdhënien midis palëve, ashtu edhe marrëdhënien e tyre me gjyqtarin. Për sa u përket marrëdhënieve midis palëve, nga ky parim mund të nxirret: detyrimi i njoftimit për fillimin e procesit, detyrimi për të respektuar afate të caktuara kohore për paraqitjen, detyrimi për të lejuar diskutimin midis palëve, i cili përfshin sistemin e shkëmbimit të pretendimeve (në sistemin francez: konkluzionet), si dhe detyrimi për të ruajtur një minimum të caktuar drejtësie, në mënyrë të veçantë për sa i takon gjetjes së dokumenteve dhe hartimit të shkresave që i dërgohen gjykatës gjatë shqyrtimit të çështjes.

Gjithashtu, parimi i kontradiktoritetit ka disa rrjedhoja edhe në lidhje me marrëdhëniet me gjyqtarin. Edhe në rastin kur gjyqtari luan rol aktiv gjatë zhvillimit të procesit, edhe kur procesi nuk ka më natyrë kontradiktore, gjyqtari duhet të jetë krejtësisht neutral dhe të kufizojë përdorimin e njohurive të tija personale për faktet që diskutohen. Dispozita të shpërndara ndihmojnë për të garantuar se e gjithë çështja i nënshtrohet vetëm diskutimit të palëve. Por, ndonjëherë, kjo kërkesë anashkalohet nëpërmjet abuzimit me dërgimin e shkresave në gjykatë gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në çdo rast, neni 17 i Kodit francez të procedurës civile *(**Shënim i autorit:** Ky nen thotë: "Në rastet e lejuara me ligj apo kur rrethanat kërkojnë lëshimin ex parte të një urdhri/vendimi, pala tjetër ka të drejtën e rekursit në rast të përkeqësimit të situatës nga ky urdhër/vendim")* parashikon se kur një urdhër/vendim lëshohet pa dijeninë e palës, ajo gëzon të drejtën e apelimit kundër këtij urdhri/vendimi të gabuar.

Në zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, neni 7 i kodit francez *(**Shënim i autorit:** Ky nen thotë se: "Gjyqtari nuk mund ta bazojë vendimin mbi fakte që nuk janë në shqyrtim. Gjyqtari nuk mund të marrë në shqyrtim fakte që nuk janë të pretenduara shprehimisht nga palët në mbështetje të argumenteve të tyre")* e ndalon gjyqtarin ta bazojë vendimin e tij mbi fakte që nuk janë pjesë e mosmarrëveshjes. Rrjedhimisht, gjyqtari nuk mund ta arsyetojë vendimin mbi bazën e njohurive personale, mbi çështjet ligjore të ngritura me iniciativën e tij apo nëpërmjet shpjegimeve komentuese të kërkuara, pa i ftuar më parë palët të japin vërejtjet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, neni 774 i Kodit belg të procedurës civile i kërkon gjyqtarit rihapjen e procesit para rrëzimit të plotë apo të pjesshëm të

kërkesës në mundësinë e një mbrojtjeje që palët nuk e kanë bërë para tij.

Së fundi, duhet të theksohet se, në përputhje me progresin që prej revolucionit francez, në ushtrim të funksioneve administrative të gjykatave, me përjashtim të rrethanave të veçanta, gjyqtarëve u kërkohet kudo të arsyetojnë vendimet e tyre.

Shënim i autorit: *Kuptimi i gjykimit në gjykatat franceze është dhënë në nenin 455 të K.pr.civile, i cili parashikon se: "Gjykimi duhet të parashtrojë në mënyrë të përmbledhur pretendimet përkatëse të palëve dhe argumentet e tyre mbështetëse. Ky prezantim mund të ketë formën e referencës me pretendimet e palëve dhe me datën përkatëse. Duhet të jepen arsyet e gjykimit. Vendimi i gjykatës duhet të jetë në mbështetje të dispozitave në fuqi".*

6. Parimi i "kontradiktoritetit" sipas legjislacionit shqiptar

Parimi i kontradiktoritetit, si një ndër parimet më të rëndësishme që duhet të karakterizojë procesin gjyqësor në kuptim të neneve 18, 19 dhe 20 të Kodit të procedurës civile, lidhet me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t'u dëgjuar, për t'i bërë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat ato mbështetin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore, me qëllim realizimin sa më të drejtë të parimit të mbrojtjes së interesave të tyre në gjykim.

Ekzistenca e këtij parimi lidhet me kuptimin që i jepet në jurisprudencën gjyqësore barazisë së armëve osc barazisë së mjeteve në proces. Barazia e armëve dhe parimi i kontradiktoritetit janë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Barazia e mjeteve, që duhet respektuar gjatë gjithë procesit të gjykimit, do të thotë që të dyja palët të trajtohen në një mënyrë që i siguron ato të kenë pozitë të barabartë procedurale gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të jenë në pozita të njëjta për të paraqitur çështjen e tyre. Mbi këtë bazë, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë. Në çdo fazë të gjykimit, asnjëra nga palët nuk duhet ta ndiejë veten në pozita haptas të disfavorshme përballë kundërshtarit të vet.[8]

Në gjykimet penale, ku prokurori ka të gjithë makinerinë e shtetit pas tij,

---

8) Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 19, datë 12.6.2003, Përmbledhje e vendimeve, viti 2003, faqe 103.

parimi i barazisë së armëve është garanci thelbësore e së drejtës për të mbrojtur vetveten. Ky parim siguron që mbrojtja të ketë mundësi për të përgatitur dhe për të paraqitur çështjen e vet në pozita të barabarta me atë të prokurorit.

Respektimi i këtij parimi është i rëndësishëm edhe në procedurat gjyqësore civile. Parimi i kontradiktoritetit është sanksionuar në disa dispozita procedurale. Në nenin 19 të Kodit të procedurës civile parashikohet: *"Palët duhet t'i bëjnë të njohur njera-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështetin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore të cilave do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim".* Në nenin 155 dhe 156 të këtij Kodi janë përcaktuar rregullat për njoftimin e padisë dhe të akteve që i bashkëngjiten asaj, si dhe koha e nevojshme që i sigurohet të padituri për t'u njohur me këto akte e për t'u përgatitur për gjykimin e çështjes.

Me parimin e kontradiktoritetit lidhet mundësia e palës për të qenë e pranishme në gjykim dhe për t'u dëgjuar. Nga ky parim rrjedh një tjetër e drejtë themelore e shtetasve - e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. *E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim* është pjesë përbërëse e së drejtës për të mbrojtur veten. Kushtetuta dhe ligji i japin përparësi pjesëmarrjes në gjykim nëpërmjet së cilës palët bëjnë të mundur realizimin e të gjithë të drejtave të tjera. *"Do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim".* [9]

E drejta për të marrë pjesë në gjykim presupozon jo vetëm pjesëmarrjen fizike të palës, por krijimin e mundësive që, duke njohur pretendimet e palës tjetër, të jetë në gjendje të parashikojë prapësimet dhe pretendimet e saja. Kjo nuk është kërkesë formale dhe pa rëndësi, por thelbësore dhe e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të palës, sepse vetëm në këtë mënyrë sigurohet roli i paanshëm i gjykatës dhe i jepet asaj mundësia reale të shprehë me vendim opinionin për çështjen, pa cenuar rregullsinë e procesit.

Ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë dhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, pjesëmarrja në gjykim dhe ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të lidhura mes tyre dhe që plotësojnë njëra-tjetrën për garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Si e tillë, e drejta e mbrojtjes nuk mund të mohohet dhe as të reduktohet. Mohimi i *së drejtës për t'u dëgjuar* dhe për t'u mbrojtur përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin ligjor të parregullt, në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

9) Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 109, datë 28.5.2002, Përmbledhje vendimesh, faqe 137.

E drejta për t'u mbrojtur me avokat, në njëfarë mënyre, është pjesë përbërëse e respektimit të këtij parimi. Që e drejta e mbrojtjes me avokat të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që, në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por edhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve. Në një vendim të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje, ndërmjet të tjerave, arsyetohet: *"Në këto rrethana, Kolegji Administrativ duhej ta shtynte gjykimin për një ditë tjetër dhe jo ta gjykonte çështjen në mungesë të avokatit të kërkuesit. Kjo mënyrë gjykimi është mohim i së drejtës së mbrojtjes, e cila, si e drejtë themelore, garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Dhunimi i kësaj të drejte, jo vetëm i ka hequr mundësinë kërkuesit të gëzojë mbrojtje të specializuar, por ka sjellë edhe shkeljen e parimit të kontradiktoritetit. Kjo shkelje ka të bëjë me faktin se kërkuesi në këtë proces nuk është vënë në kushte barazie me palën tjetër. Ndryshe nga kjo e fundit, e cila ka qenë e mbrojtur me avokat dhe ka parashtruar pretendimet e veta rreth problemeve që kanë lindur gjatë këtij gjykimi, kërkuesit, jo për fajin e tij, por për shkaqe që nuk vareshin nga ai, nuk i është krijuar një mundësi e tillë".* [10]

Kontradiktoriteti në gjykim ndërmjet palëve, sipas nenit 19 të Kodit të procedurës civile, nënkupton qartësimin e pozicionit të secilës prej tyre për bërjen të njohur të fakteve, të mjeteve mbi të cilat mbështetin pretendimet, të provave, si dhe të dispozitave ligjore, me qëllim realizimin e mbrojtjes së më efikase në gjykim.

Pozicioni i gjykatës në raport me palët si dhe me provat e pretendimet që ato paraqesin ndikohet nga respektimi i kontradiktoritetit në gjykim (neni 20). Ka disa dispozita procedurale që i njohin të drejtën gjykatës të kërkojë shpjegime për faktet *që ajo i çmon të nevojshme* për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9), të kërkojë shpjegime nga pikëpamja e së drejtës *që ajo e çmon të nevojshme* për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 17), të kryejë hetim gjyqësor në përputhje me ligjin (neni 14), të bëjë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, *pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët (neni* 16/2), të çmojë provat në bazë të bindjes së saj të brendshme (neni 29, 309), të pranojë vetëm ato prova që janë domosdoshme dhe që kanë lidhje me çështjen e gjykimit (neni 213) etj.

Pavarësisht nga ndonjë pozicion në pamje aktiv që mund të marrë gjyqtari, kur fton palët për të dhënë shpjegime për çështje që i çmon të nevojshme nga pikëpamja e së drejtës dhe që i shërbejnë ecurisë normale të procesit, ai është

10) Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 198, datë 19.12.2001, Përmbledhje e vendimeve, viti 2001, faqe 305.

i detyruar të mbështetë vendimin e tij vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet dhe provat e treguara nga secila palë. Provat e marra në procesin gjyqësor duhet t'i nënshtrohen debatit ndërmjet palëve. Të gjitha provat do t'i shërbejnë gjykatës për të dhënë vendimin e saj, vetëm pasi palëve t'u jenë krijuar mundësitë për të diskutuar mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit. Në vendimin nr. 23, datë 25.7.2003, Gjykata Kushtetuese, për këtë argument që po trajtojmë, ndërmjet të tjerave, arsyeton në këtë mënyrë: "*Gjithashtu, gjykata e apelit nuk i ka vënë palët në kushte pabarazie, qoftë për sa i përket paraqitjes së provave në proces, qoftë për sa i përket zbatimit të parimit procedural të kontradiktoritetit. Në gjykimet e mëparshme, gjykata u kanë dhënë mundësi të dyja palëve të paraqesin provat, të cilat janë vlerësuar edhe në rigjykimin në gjykatën e apelit. Kjo e fundit e ka mbështetur vendimin e saj në shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të sjella nga palët, për të cilat këto të fundit kanë debatuar duke shprehur opinionet e prapësimet e tyre, pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa iu mohuar ndonjë e drejtë që lidhet me cenimin e së drejtës së mbrojtjes në kuptimin kushtetues. Nëse gjykata e apelit çmoi që nuk është e nevojshme marrja e provave të tjera me dëshmitarë, nuk do të thotë se i ka mohuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes. Nga arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit del se arsyeja e mosmarrjes së provave me dëshmitarë në rigjykim nuk kishte të bënte me cenimin e parimit të barazisë së armëve, por me vlerësimin dhe rëndësinë e tyre nga këndvështrimi i zgjidhjes së drejtë të çështjes*".[11]

Nga sa është theksuar më lart, si dhe nga ky qëndrim që mbahet në jurisprudencën kushtetuese, arrihet në përfundimin se, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, çështja i nënshtrohet vetëm diskutimit të palëve në seancë gjyqësore. Ky është kuptimi që del nga nenet 17, 19, 20 dhe 309 të Kodit të procedurës civile. Megjithatë, neni 21 i këtij Kodi i jep të drejtë gjykatës që, kur e lejojnë rrethanat e çështjes, të marrë vendim gjyqësor, pavarësisht nga dijenia e palës tjetër. Për ilustrim shërben rasti kur kërkesa për sigurimin e padisë mund të shqyrtohet edhe pa praninë e palës kundërshtare. Neni 202 i Kodit të procedurës civile parashikon: "Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të veçanta ose të ngutshme, *mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër*". Kjo përbën një përjashtim nga rregulla që kërkon debatimin e palëve për të gjitha provat, faktet dhe pretendimet që paraqiten. Megjithatë, detyrimi i gjykatës për të arsyetuar vendimin, si dhe e drejta e palës që nuk ka qenë e pranishme në gjykim për t'u ankuar ndaj vendimit të marrë, konsiderohen si garanci për të pasur në shkallët e tjera të gjykimit një proces të rregullt ligjor.

11) Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 23, datë 25.7.2003, Përmbledhje e vendimeve, viti 2003, faqe 121.

7. Për identifikimin dhe ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes – shkurtimisht, për bashkimin e palëve të treta

Një aspekt i rëndësishëm i procedurës trajtohet në nenin 5 të Kodit shqiptar të procedurës civile, i cili parashikon se objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve. Të gjitha sistemet ligjore duhet të trajtojnë çështjen e kufizimit të mundësisë për ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes gjatë procesit gjyqësor. Në lidhje me këtë gjë, Kodi shqiptar parashikon se: "Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto kërkesa kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit".

Në seksionin vijues, i nxjerrë nga po i njëjti seksion i *Enciklopedisë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar,*[12] do të shohim panoramën e përgjithshme të traditës italiano – franceze në këtë aspekt, së bashku me disa çështje që lidhen me kërkesat e ndërmjetme dhe incidentet procedurale. Teksti është paksa i ndryshuar (shih seksionet brenda kllapave) për të trajtuar edhe zhvillimet e mëvonshme:

"Shpesh, edhe në shkallën e parë të gjykimit, shfaqen ndërlikime që e zgjerojnë objektin e mosmarrëveshjes: ndryshimi i kërkesës, kundërpaditë, procedimet prej apo kundër palëve të treta. Këto aplikime të ndërmjetme janë të prirura të prishin rrjedhën normale të procesit dhe të krijojnë vështirësi për sa u përket kompetencave dhe procedurave.

Në mënyrë që të parandalohen të gjitha këto, herë pas here shkrimtarët janë përpjekur të riafirmojnë parimin se objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të ndryshohet, madje as në shkallën e parë të gjykimit. Gjithsesi, nevoja praktike dhe dëshira që e gjithë mosmarrëveshja të trajtohet nga i njëjti gjyqtar, e kanë ndaluar zbatimin e këtij parimi, të paktën për sa u takon kërkesave. Në disa sisteme ligjore, në prani të rrethanave të caktuara, palët lejohen ta ndryshojnë kërkesën.

Zgjidhjet e tyre janë tepër të ngjashme për sa u përket pretendimeve dhe fakteve të reja që i paraqiten gjyqtarit apo gjykatës. Sa u takon kërkesave të ndërmjetme që paraqiten përpara gjyqtarit që shqyrton çështjen në ato sisteme ligjore ku ekziston kjo procedurë, nenet 183 dhe 184 të Kodit italian, në versionin në fuqi deri në vitin 1995, të cilat thjesht konfirmonin praktikën e ndjekur sipas dispozitave të vjetra, parashikonin një qëndrim tepër liberal.

Sipas versionit të vjetër të nenit 183, palët mund të ndryshonin pretendimet, mbrojtjen, si dhe qëndrimet e mbajtura në kërkesë dhe në përgjigje të seancës

12 Enciklopedia ndërkombëtare e së drejtës së krahasuar, faqet 90 – 92.

së parë gjyqësore para gjyqtarit që shqyrton çështjen, ndërsa neni i vjetër 184 i lejonte palët të ndryshonin kërkesat e tyre, mbrojtjen dhe pretendimet, të prodhonin dokumente të reja, të ofronin prova të reja, si dhe të ndërtonin një mbrojtje të re në procedurat vijuese para gjyqtarit që shqyrton çështjen derisa çështja të kalonte në gjykatën kolegjiale duke provuar se ka elemente të reja, por një *emendatio libelli* dhe jo një *mutatio libelli.*[13] Ndryshime të tjera janë të papranueshme dhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës që mbron të drejtat e mbrojtjes.

Nga versioni i vjetër i nenit 184 del se palët nuk inkurajoheshin të ishin krejtësisht në përputhje me dispozitat e Kodit, duke u kërkuar atyre të paraqitnin me saktësi në kërkesë dhe në kundërpërgjigjen e palës së paditur pretendimet e tyre, çështjet ligjore dhe provat ku mbështeteshin këto pretendime. Gjykata e kasacionit i ka lejuar palët të plotësojnë çështjet faktike dhe ligjore pas seancës së parë gjyqësore para gjyqtarit që shqyrton çështjen, ndërsa autorët do t'i lejonin provat dhe pretendimet e reja vetëm pasi gjyqtari ta transferonte gjykimin në gjykatën kolegjiale. Praktika sunduese tregoi se seanca e parë për diskutimin e çështjes e humbiste rëndësinë e saj dhe orvatej të parandalonte kthimin e saj një prej momenteve kyçe të procedurës, në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit.

Shënim i autorit: *Është mjaft interesante të thuhet se dispozitat italiane të përshkruara në Enciklopedi, të cilat janë modifikuar në vazhdim me një akt të vitit 1990, që ka hyrë në fuqi në vitin 1995, janë shumë më kufizuese në drejtim të mundësisë së ndryshimit të pretendimeve gjatë ecurisë së procesit gjyqësor. Sipas përmbajtjes së tekstit të ri të nenit 183, në seancën e parë "pala paditëse mund të paraqesë pretendime dhe mbrojtje që mund të jenë rezultat i kundërpërgjigjeve apo i mbrojtjes së palës së paditur. [...] Të dyja palët mund t'i saktësojnë dhe t'i modifikojnë pretendimet, mbrojtjet apo përfundimet tashmë të paraqitura". Koha që jepet nga gjyqtari për dorëzimin e argumenteve me shkrim lidhur me këto modifikime, nuk mund t'i kalojë 30 ditët. Duke qenë se teksti i ri i nenit 184 aktualisht merret me provat (duke i dhënë gjyqtarit vetëm kompetencën e caktimit të një afati për paraqitjen e provave të reja nëse kjo gjë kërkohet nga palët), mundësia e gjerë që ekzistonte më përpara për modifikimin e pretendimeve gjatë ecurisë së procesit tashmë është shfuqizuar.*

---

13) Latinisht: Kjo shprehje e përdorur tregon parashtrimin gjatë procesit të kërkesave të reja, përjashtimeve dhe përfundimeve të reja në raport me ato të paraqitura me aktin e përmendur. Kur kemi të bëjmë me një kërkesë të re, është e nevojshme paraqitja e fakteve të reja, në mënyrë të tillë që të zgjerohet objekti i kërkesës. Mutatio libelli ndryshon nga emendatio libelli, pasi konsiston në një korrigjim të thjeshtë ose saktësim të kërkesës gjyqësore.

Neni 4 i Kodit francez, një dispozitë analoge me ligjin e vjetër italian *(Shënim i autorit: Shih më sipër për tekstin e plotë të nenit 4 të Kodit francez të procedurës civile),* parashikon se objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshohet me anë të kërkesave të ndërmjetme kur këto janë mjaftueshmërisht të lidhura me kërkesën fillestare. Kur një kërkesë e tillë paraqitet para gjykatës dhe çështja është duke u përgatitur nën kujdesin e gjyqtarit që shqyrton çështjen, ky i fundit nuk shqyrton ekzistencën e lidhjeve të mjaftueshme, por thjesht vendos nëse duhet të pranojë ose jo bashkimin e kërkesave të ndërmjetme me procesin fillestar.

Në ligjin belg dhe holandez, ndryshimet e kërkesës para gjyqtarit që shqyrton çështjen, janë lehtësisht të pranueshme dhe i nënshtrohen vetëm nevojës kryesore për të respektuar të drejtat e mbrojtjes. Kështu, neni 134 i Kodit holandez e lejon palën paditëse të ndryshojë, të zgjerojë apo të ngushtojë kërkesën fillestare, për aq kohë sa ky ndryshim nuk prek të drejtat e mbrojtjes dhe pala tjetër nuk kundërshton. Në mungesë të marrëveshjes, gjyqtari vendos vetëm mbi bazën e kriterit për respektimin e të drejtave të mbrojtjes. Në të vërtetë, ky sistem i jep të liri më të gjera veprimi palës paditëse, e cila merr iniciativen dhe ndryshon kërkesën, në krahasim me palën tjetër, pasi e para gjithmonë mund të shpresojë se e dyta nuk do të kundërshtojë.

Në mënyrë të ngjashme, neni 807 i Kodit belg i lejon ndryshimet e pretendimeve nëse provohet se kjo bëhet nëpërmjet një kërkese që i komunikohet palës tjetër dhe se pretendimet shtesë apo pretendimet e ndryshuara mbështeten mbi një fakt apo akt mbi të cilin është mbështetur edhe kërkesa. Kjo tregon, gjithashtu, se ekziston edhe dëshira që pala tjetër të mos kapet në befasi. Së fundi, heshtja e dispozitave legjislative të Luksemburgut për këtë çështje nuk e ka penguar zbatimin në praktikë të zgjidhjeve të ngjashme me ato të pranuara shprehimisht nga sistemet e tjera ligjore.

Ndërhyrja vullnetare apo e detyruar e palëve të treta është pranuar në mënyra të ngjashme nga sisteme të ndryshme ligjore. Kodet, të cilat janë më të detajuara në këto ndërhyrje, sesa në ndërhyrje të tjera incidentale, përmbajnë rregulla të caktuara dhe të veçanta lidhur me to. Ndërhyrja nuk duhet ta vonojë gjykimin e çështjes kryesore. Në Francë ka pasur hezitime në pranimin e faktit nëse një gjyqtar duhet ta urdhërojë me iniciativën e tij bashkimin e palëve të treta, duke qenë se kjo vjen në kundërshtim me parimin e kontrollit të palëve mbi objektin e çështjes. Kodi belg e ka hedhur poshtë shprehimisht këtë zgjidhje (neni 811). Gjithsesi, ligji francez e lejon gjyqtarin t'i ftojë palët të përfshijnë në proces të gjithë personat e interesuar, prania e të cilëve gjykohet si e nevojshme nga gjyqtari për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 332, § 1) .

*(**Shënim i autorit:** Neni 332, § 1, i Kodit francez të procedurës civile thotë: "Gjyqtari mund t'i ftojë palët të nisin procedimet kundër të gjithë personave të interesuar, prania e të cilëve gjykohet e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes). Ligji italian e lejon, si gjykatën, ashtu edhe gjyqtarin që ka në shqyrtim çështjen, të urdhërojnë bashkimin e palëve të treta, nëse kjo gjë konsiderohet e arsyeshme (neni 107). (Shënim i autorit: Neni 107 i Kodit italian të procedurës civile thotë: "Në rastet kur gjyqtari e gjykon të arsyeshme që procesi të zhvillohet edhe kundrejt një pale të tretë që është e përfshirë në mosmarrëveshje, ai urdhëron ndërhyrjen e saj")*

Për sa i takon formës së paraqitjes së ndërhyrjeve incidentale, shumë prej sistemeve ligjore lejojnë që këto të paraqiten në kërkesë, por ka edhe sisteme të tjera ku është pala e tretë ajo që ndërhyn për t'u bashkuar.[14]

8. Identifikimi dhe ndryshimi i objektit të mosmarrëveshjes sipas legjislacionit shqiptar

Në nenin 5 të Kodit të procedurës civile është parashikuar se objekti i mosmarrëveshjeve përcaktohet në pretendimet e palëve. Kjo lidhet me ushtrimin nga palët të të drejtave të tyre procedurale gjatë gjykimit në bazë të ligjit dhe pa pasur qëllim dëmtimin e interesave të palës tjetër apo pengimin e zhvillimit normal të procesit. Ushtrimi nga ana e palëve i të drejtave procedurale që lidhen me ngritjen e padisë (si ndryshimi i shkakut apo i objektit të padisë), kundërpaditë, procedimet prej apo kundër palëve të treta etj., e vendosin gjykatën në një pozicion të tillë që të tregohet e kujdesshme për të ndaluar përpjekjet e palëve ose të përfaqësuesve të tyre për zgjatjen e paarsyeshme dhe ndërlikimin e procesit.

Legjislacioni procedural shqiptar nuk parashikon ndonjë afat kohor për parashtrimin e këtyre pretendimeve. Ato mund të paraqiten gjatë gjithë fazave të zhvillimit të gjykimit në shkallën e parë. Këto pretendime mund të paraqiten, si në aktin e fillimit të procesit gjyqësor, ashtu edhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Kjo do të thotë se ushtrimi i të drejtave të tilla mund të realizohet në çdo moment që vlerësohet si i përshtatshëm nga ana e palës. Duke e analizuar nenin 5 të Kodit të procedurës civile në raport me nenin 185, rezulton se paditësit i njihet e drejta të shtojë, të ndryshojë ose të pakësojë objektin e padisë apo edhe vetë shkakun e padisë, me kusht që

14) Përkthimet e dispozitave të Kodit francez të procedurës civile, të cituara më sipër, janë marrë nga C. Dodo, Kodi francez i procedurës civile, në anglisht, Dobbs Ferry, New York, Oceana Pub., 1998.

pretendimet e parashtruara gjatë procesit të kenë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit. Nga të dyja elementet e padisë, pra shkaku dhe objekti, paditësi mund të ndryshojë vetëm njërin dhe jo të dyja njëkohësisht. Në rast se ndodh një gjë e tillë, atëherë ndryshon krejtësisht padia dhe, për rrjedhojë, do të mungojë me pretendimet e fillimit lidhja që konsiderohet si e mjaftueshme nga ligji.

Sipas së drejtës procedurale shqiptare, gjatë gjykimit të çështjes, palët kanë të drejtë të ndreqin ose të modifikojnë gabimet që mund të kenë bërë në fillim të procesit, duke treguar me saktësi atë shkak ose objekt të padisë që i përshtatet rregullimit sa më të mirë të marrëdhënieve të tyre. Mbi këtë bazë, paditësit i lind e drejta të shtojë, të pakësojë kërkimet e padisë.

Nga ushtrimi i kësaj të drejte nuk përjashtohet as pala e paditur. Të gjitha kundërshtimet që paraqiten nga i padituri kundrejt kërkimeve të paditësit, bëjnë të mundur realizimin e së drejtës së mbrojtjes në gjykim. Midis këtyre mjeteve të mbrojtjes janë prapësimet, nëpërmjet të cilave, pala e paditur kundërshton pranimin e padisë, duke e mbajtur mosmarrëveshjen gjyqësore brenda kufijve të padisë. Në qoftë se pala e paditur i zgjeron kufijtë mbi të cilët është ngritur kërkesëpadia, nëpërmjet kërkimeve të tjera, atëherë, sipas ligjit, ajo ushtron kundërpadinë.

Kundërpadia është padi e të paditurit kundrejt paditësit, që ushtrohet në gjykimin e një padie të filluar. Në nenin 160 të Kodit të procedurës civile parashikohet : "I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi". Kështiu jemi përpara kushteve të kundërpadisë kur i padituri, si rrjedhojë e një padie të ngritur ndaj tij me objekt lirimin dhe dorëzimin e një objekti, ushtron kundërpadinë ndaj paditësit me objekt kundërshtimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave që i ka njohur pronësinë atij.

Pretendimi i paraqitur në kundërpadi duhet të ketë lidhje me pretendimin e padisë ose objekti i kundërpadisë të jetë i aftë për kompensimin me atë të padisë. Kundërpadia paraqitet si padi më vete dhe, për këtë arsye, ajo duhet të përmbajë të gjitha rregullat që ndiqen për ngritjen e padisë. Për sa i përket kohës së ngritjes së kundërpadisë, ligji e lejon paraqitjen e saj përpara gjykatës gjatë fazave të zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë, derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor.

Në ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes mund të ndikojnë edhe kërkesat që bëjnë palët për marrjen e provave të tjera, përveç atyre që janë paraqitur gjatë seancës përgatitore a gjyqësore. Edhe këtu ligji e kushtëzon kërkesën për marrjen e provave të reja me rrethanat e dala rishtas dhe që janë në dobi të gjykimit. Një moment i tillë vlerësohet nga gjykata e cila u jep

palëve një afat jo më shumë se 10 ditë për të përcaktuar faktet dhe provat e reja (neni 180).

Në ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes ndikojnë edhe palët e treta që mund të paraqiten ose të thirren nga gjykata në seancë. Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur pretendon për vete tërësisht ose pjesërisht sendin ose një të drejtë që është objekt i padisë në shqyrtim, ose që lidhet me përfundimin e gjykimit, duke ngritur padi kundër të dyja palëve ose njërës prej tyre (neni 189). Ndërhyrja kryesore shkakton ndryshimin e gjykimit të filluar për arsye se, krahas padisë së ngritur, shtohet edhe një padi tjetër. Kjo është një padi e re që ka lidhje me padinë e parë, për shkak se ndërhyrësi kryesor në këtë rast paraqitet si paditës dhe dy palët ndërgjyqëse (paditës dhe i paditur) mund të shndërrohen të dyja në të paditur.

Gjithashtu, në bazë të ligjit, lejohet të ndërhyjnë në një proces gjyqësor edhe persona që konsiderohen si ndërhyrës dytësorë ose si persona të tretë. Këta mund të hyjnë vetë ose të thirren nga gjykata, kur çmohet e arsyeshme se ato kanë interes për çështjen. Personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë.

Pikërisht, janë të gjitha këto palë, që nga paditësi, i padituri, ndërhyrësi kryesor, ndërhyrësi dytësor apo personi i tretë, të cilat, duke ushtruar të drejtat që u njeh ligji, mund të ndikojnë në ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes. Sidoqoftë, është gjykata ajo që i vlerëson nëse kërkesat e reja që mund të lindin gjatë shqyrtimit të çështjes, kanë ose jo lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit, me qëllim që procesi të mos e humbasë kuptimin e vërtetë si dhe qëllimin që duhet të arrijë.

c -ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Materialet e paraqitura në seksionin B japin një panoramë krahasuese të vendit që zënë disa parime kryesore të procedurës civile në disa prej traditave më të shquara europiane. Zgjedhja është bërë duke privilegjuar përshkrimet e fokusuara mbi kodet italiane dhe franceze të procedurës civile (si edhe mbi disa kodifikime të frymëzuara nga tradita franceze), të cilat janë të afërta me Kodin shqiptar. Megjithëse të ngjashme, është e qartë se kodifikimet e përdorura si materiale burimore për këtë vështrim të përgjithshëm janë larg të qenit identike në tekstet e tyre. Ndryshimet tekstuale ekzistojnë, por ato nuk korrespondojnë automatikisht me ndryshimet reale. Nëpërmjet përdorimit të

dispozitave të ndryshme mund të arrihen rezultate të njëjta ose tepër të ngjashme, sikurse mund të ndodhë që dispozita të ngjashme të sjellin pasoja krejt të ndryshme për shkak të shumë faktorëve, të cilët fillojnë nga kultura juridike e variojnë me kontekstet praktike në të cilat zbatohen këto dispozita.

Në këtë mënyrë, lokalizimi i sistemit të tyre ligjor në këtë përshkrim të përgjithshëm do të ishte një ushtrim shumë i dobishëm për magjistratët e ardhshëm, të cilët do të përpiqen të kuptojnë si përshtaten zgjidhjet e përdorura në Shqipëri me këtë panoramë. Më poshtë po paraqesim një udhëzim të mundshëm për një ushtrim të tillë. Në këndvështrim të materialeve të paraqitura më sipër, magjistratët e ardhshëm duhet të përpiqen të përshkruajnë rolin e parimit të iniciativës së palëve dhe të parimit të "kontradiktoritetit" në procedurën civile shqiptare, duke u kushtuar vëmendje të veçantë këtyre çështjeve:

Parimi i iniciativës së palëve

1) Cilat dispozita (edhe të tjera përveç atyre të përfshira në nenet 1 – 30) mund të shihen si shprehje e këtij parimi? Cilat dispozita mund të konsiderohen si shprehje e rolit aktiv të gjyqtarit, pra si përjashtim nga kjo rregull? Cilat janë arsyet e mundshme për ekzistencën e këtyre përjashtimeve?

2) Përshkrimet e përmendura më sipër në disa pika përmendin mundësinë e ngritjes së padive dhe të kërkesave nga prokurori publik. Cili është roli i prokurorit publik në çështjet civile në sistemin ligjor shqiptar – rol aktiv apo rol potencial? Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit se mundësitë e rolit autonom të prokurorit publik në fushën e së drejtës private, në shumicën e vendeve të traditës kontinentale nuk janë tërësisht të shfrytëzuara. Kështu, pra, teoria nuk përputhet me praktikën.

3) A mund të jepni tre shembuj të vendimeve që shkojnë *ultra petita* (përtej pretendimeve të ngritura nga palët)?

4) Sipas ligjit shqiptar, cilat prej fakteve që nuk janë përmendur nga palët në pretendimet e tyre, mund të merren në shqyrtim nga gjyqtari? Cilat fakte mund të konsiderohen si pjesë e "përvojës së zakonshme"? Përpiquni të kuptoni se çfarë dispozite/dispozitash pasqyrojnë përmbajtjen e nenit 115 të Kodit italian të procedurës civile (shih më sipër për tekstin në shënimet e autorit).

5) Cilat dispozita të Kodit shqiptar të procedurës civile reflektojnë parimin se gjyqtari duhet t'i zbatojë normat e së drejtës sipas iniciativës së tij (jura novit curia)? A zbatohet plotësisht kjo edhe për të drejtën e huaj kur kjo e drejtë duhet të zbatohet nga gjyqtari shqiptar në kontekstin e së drejtës private ndërkombëtare?

6) Përpiquni të kuptoni çfarë dispozite/dispozitash pasqyrojnë përmbajtjen

e nenit 12 të Kodit francez të procedurës civile (shih më sipër për tekstin në shënimet e autorit).

7) A ka raste në të drejtën shqiptare kur gjyqtari nuk vendos mbi bazën e arsyetimit ligjor rigoroz, por mbi bazën e "drejtësisë" *(equitas)*? A mund të veprohet në këtë mënyrë, nëse kjo gjë kërkohet nga palët?

8) A ekzistojnë rregulla të lidhura drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me parimin e iniciativës së palëve në Kodin civil apo legjislacionin tjetër substantiv në fushën e së drejtës tregtare apo private?

9) A mund ta detyrojnë palët gjyqtarin t'i referohet një dokumenti të caktuar në marrjen e vendimit për pretendimet e ndryshme (pretendimet alternative dhe sekondare)? A mund të jepni tre shembuj të pretendimeve alternative apo sekondare përkatësisht në fushën e kontratave, dëmtimeve apo pronës?

10) A mund të pranohet rrëzimi në mënyrë jo të shprehur nga gjyqtari i një prej pretendimeve? A mund të jepni një shembull?

Parimi i "kontradiktoritetit"

1) Cilat dispozita (edhe të tjera përveç atyre të përfshira në nenet 1 – 30) mund të shihen si shprehje e këtij parimi? Cilat dispozita mund të konsiderohen si kufizim i së drejtës për t'u dëgjuar, pra si përjashtim nga kjo rregull? Cilat janë arsyet e mundshme për ekzistencën e këtyre përjashtimeve?

2) Cilat dispozita të ligjit shqiptar korrespondojnë më përmbajtjen e nenit 16 të Kodit francez të procedurës civile (shih më sipër për tekstin në shënimet e autorit)?

3) Cilat marrëveshje në të cilat është palë edhe shteti shqiptar përmbajnë rregulla që mund të konsiderohen si shprehje e parimit të "kontradiktoritetit"?

4) Cilat janë mundësitë e apelimit të palëve të cilave u përkeqësohet situata nga një urdhër i nxjerrë nga gjyqtari, pa përfshirjen e tyre?

5) Versioni aktual i nenit 183 të Kodit italian të procedurës civile i jep gjyqtarit kompetencën që t'u kërkojë palëve "sqarimet e nevojshme" dhe t'u tregojë atyre "çështjet që mund të ngrihen me iniciativën e tij *(ex officio)*, të cilat ai i gjykon si të arsyeshme për t'u parashtruar". Për një kohë të gjatë kjo ka qenë kompetencë, jo detyrim, por, aktualisht, po tenton të konsiderohet si një kompetencë – detyrë edhe në kuptim të nenit 16 të Kodit francez të procedurës civile. A ka debate apo dispozita korresponduese në ligjin shqiptar për këtë gjë? A mund të ometojë ligjërisht gjyqtari përmendjen e një problemi që mund të ngrihet *ex officio* dhe mund ta zgjidhë përfundimisht çështjen dhe ta ngrejë këtë problem në gjykimin përfundimtar, pa e diskutuar më parë me palët?

6) Cilat janë instrumentet që synojnë t'u garantojnë më të dobtëve të drejtën për t'u dëgjuar?

Këtu do të ishte e përshtatshme të paraqiteshin një ose më shumë çështje reale apo fiktive, të cilat mund të shërbenin si shembull i mirë i zbatimit në të drejtën shqiptare të një prej parimeve të përgjithshme të përmendura në titullin I të K.pr.civile (dhe idealisht të parimit të iniciativës së palëve).

Identifikimi dhe ndryshimi i objektit të mosmarrëveshjes

1) Cilat janë afatet kohore për ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes sipas ligjit shqiptar?

2) A mund të jepni tre shembuj të kërkesave për ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes që mund të konsiderohen si "mjaftueshmërisht të lidhura" me pretendimet fillestare (shih nenin 5 të Kodit shqiptar të procedurës civile)?

3) A ekzistojnë afate kohore për ndryshimin e kërkesave?

4) A ka abuzime të praktikuara në juridiksionet shqiptare me anë të ndryshimeve te kërkesave (për shembull, me qëllim ngadalësimin e procedurave)?

5) Përshkruani dallimet kryesore, nëse ka, midis rregullave aktuale shqiptare për bashkimin e palëve të treta dhe atyre të sistemeve ligjore të përshkruara në materiale.

d – LEXIME PLOTESUESE

Parimet e iniciativës së palëve dhe të kontradiktoritetit duhet të kuptohen edhe nga këndvështrimi i debatit për aktivizmin gjyqësor. Një trajtim standard krahasues, i cili vazhdon të jetë me mjaft interes në këtë drejtim, është:

J.A. Jolowicz, "The Active Role of the Court in Civil Litigation" (Roli aktiv i gjykatës në mosmarrëveshjet civile), në M.Cappelletti dhe J.A. Jolowicz, *Public Interest Parties and the Active Role of the Judge in Civil Litigation* (Palët me interes publik dhe roli aktiv i gjyqtarit në mosmarrëveshjet civile) Giuffrè-Oceana Pub., Milano-Dobbs Ferry New York, 1975.

e – BIBLIOGRAFI

Për bazat e parimeve të përgjithshme në procedurën civile italiane mund të lexohen:

L.P.Comoglio, C.Ferri, M.Taruffo, *Lezioni sul processo civile* (Leksione për procesin civil), Bolgna, il Mulino, 2° ed., 1998.

E.T.Liebman, *Manuale di diritto processuale civile: Principi (Manual i së drejtës procedurale civile: Parime), 6° ed.,* Milano, Giuffrè, 2002.

A. Proto Pisani, *Lezioni di diritto processuale civile (Leksione të së drejtës procedurale civile),* Napoli, Jovene, 4° ed., 2002.

Tarzia, "Le principe du contradictoire dans la procedure civile italianne" (Parimi i kontradiktoritet në procedurën civile italiane), in *Revue Internazionale de Droit Comparé,* 1981, pp. 789 ss.

Për problemet që lidhen me ndryshimin e pretendimeve në të drejtën italiane (përveç fragmenteve të cituara më sipër), mund të lexohet:

C.Ferri, *Struttura del processo e modificazioni della domanda (Struktura e procesit dhe ndryshimi i kërkesës),* Padova, CEDAM, 1975.

Kushdo që ka interes për një trajtim të koncentruar të parimeve të lartpërmendura në procedurën civile gjermane, mund të lexojë pjesët përkatëse të H.Koch-F.Diedrich, *Civil Procedure in Germany (Procedura civile në Gjermani),* The Hague-London-Boston-München, Kluwer-Beck, 1998.

Të dhënat për dispozitat e Kodit italian të procedurës civile të paraqitura më sipër, mund të integrohen me një këndvështrim praktik të zhvillimit të çështjeve civile në Itali, si: aspekti i paraqitur nga M.Taruffo në "Civil Procedure and the Path of a Civil Case" (Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile), in J.S.Lena and U.Mattei (eds.), *Introduction to Italian Law (Hyrje në të drejtën italiane),* The Hague-London-New York, Kluwer International, pp. 159 ss.

Reformat e kohëve të fundit në procedurën civile në Itali janë paraqitur nga V.Varano, "Civil Procedure Reform in Italy" (Reforma e procedurës civile në Itali), në *American Journal of Comparative Law,* 45 (1997), pp. 657 ss.

f - FJALORI TERMINOLOGJIK

Pretendim/ kërkesë = Kërkesë drejtuar gjykatës për fillimin e gjykimit mbi një argument të caktuar.

Palë e paditur = Pala kundër së cilës, në një proces civil, kërkohet pushimi i cenimit ose rivendosja e së drejtës.

Palë paditëse = Personi që ndërmerr iniciativën për fillimin e një procesi civil dhe, në këtë cilësi, në parim, ka barrën e paraqitjes para gjykatës të fakteve dhe të provimit të tyre.

Parim i iniciativës së palëve/ kontrolli i palëve mbi objektin e çështjes = Parim sipas të cilit pretenduesit gëzojnë lirinë e fillimit të procesit gjyqësor, veshjes së tij me përmbajtjen që ata dëshirojnë, duke e pezulluar ose ndërprerë atë sipas dëshirës.

Parim i kontradiktoritetit/ e drejta për t'u dëgjuar = Parim që nënkupton lirinë e

secilës prej palëve të një procesi, për të marrë dijeni për gjithçka që duhet me qëllim realizimin me sukses të pretendimit ose mbrojtjes së saj.

Incident procedural = Çështje që ngrihen gjatë procesit të filluar, të cilat sjellin efektin e pezullimit të zhvillimit të tij ose të ndryshimit të karakterit që ai ka.

Prapësim = Mjet mbrojtjeje, nëpërmjet të cilit, pala e paditur kundërshton pranimin e padisë, duke e mbajtur mosmarrëveshjen gjyqësore brenda kufijve të padisë.

Kundërpadi = Padi e të paditurit kundrejt paditësit që ushtrohet në gjykimin e një padie të filluar, kur kërkimi ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi.

g - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Parimi i iniciativës së palëve u njeh të drejtën atyre për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të disponuar në mënyrë individuale. Procesi civil të bëhet edhe me kërkesë të ndonjë organi tjetër, i cili nuk ka interesin e drejtpërdrejtë që ka pala, si p.sh.: prokurori, noteri etj., të cilët paraqesin padi në rastet që e lejon ligji.

2. Gjyqtari nuk mund të japë një vendim që i tejkalon kufijtë e padisë. Për gjykatën vepron rregulla sipas së cilës gjykata që gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

3. Gjyqtari ndalohet të zëvendësojë me iniciativën e tij kërkesën që është paraqitur formalisht dhe shprehimisht nga palët dhe duhet të respektojë "lidhjen midis kërkesës dhe vendimit, duke marrë në konsideratë argumentet e paraqitura dhe pasojat ligjore të mbrojtjes të së drejtës".

4. Me fillimin e procesit, gjykata u kërkon palëve kryerjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme që nevojiten për zhvillimin normal të tij. Ajo u kërkon palëve të interesuara paraqitjen e provave, të fakteve e të të dhënave të ndryshme, të cilat i nënshtrohen hetimit gjyqësor. Merren ato prova që janë të domosdoshme dhe që kanë lidhje me çështjen që gjykohet.

5. Gjyqtarit nuk i lejohet të marrë në shqyrtim fakte të cilat nuk janë përmendur në kërkesat e palëve, duke garantuar kështu respektimin e parimit të kontrollit të palëve mbi objektin e çështjes dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar. Për kërkimin e provave, gjyqtari duhet të aplikojë rregullat e së drejtës me iniciativën e tij (jura novit curia) dhe nuk varet nga argumentet ligjore që mbështeten nga palët dhe as nga mënyra si i klasifikojnë ato faktet.

6. Gjykata, duke iu referuar parimit *iuria novit curia,* nuk mund të zgjidhë

çështjen ligjore, pa mbajtur një rol përcaktues gjatë gjithë procesit. Kjo nuk e largon gjykatën nga respektimi i parimit të paanësisë, por as nuk ia kufizon të drejtën që të mos kërkojë kryesisht kryerjen e disa veprimeve që ndihmojnë në zbatimin e drejtë të ligjit.

7. Të gjitha provat që i paraqiten për shqyrtim gjykatës, vlerësohen dhe argumentohen në vendimin përfundimtar me objektivitet, në përputhje me ligjin, duke u bazuar edhe në bindjen e brendshme të vetë gjyqtarit. Ai duhet ta zgjidhë mosmarrëveshjen në bazë të fakteve dhe të dokumenteve të çështjes në shqyrtim, pa e kufizuar veten në kuptimin që mund të sugjerohet nga palët. Ligji i njeh gjykatës të drejtën që të zbatojë normat ligjore me iniciativën e saj, pa shkelur iniciativën e palëve në proces.

8. Kufizimi që ka gjykata e zakonshme për të kapërcyer kufijtë e kërkesave të palëve në një proces gjyqësor nuk mund të zbatohet në mënyrë të njëllojtë dhe me aq rigorozitet edhe për gjykimin kushtetues.

9. Parimi i kontradiktoritetit lidhet me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t'u dëgjuar si dhe për t'i bërë të njohur njëra-tjetrës në kohën e duhur mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështetin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore, me qëllim realizimin sa më të drejtë të parimit të mbrojtjes së interesave të tyre në gjykim.

10. Me parimin e kontradiktoritetit lidhet mundësia e palës për të qenë e pranishme në gjykim dhe për t'u dëgjuar. Nga ky parim, rrjedh një tjetër e drejtë themelore e shtetasve - e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

11. E drejta për të marrë pjesë në gjykim presupozon jo vetëm pjesëmarrjen fizike të palës, por krijimin e mundësive që, duke njohur pretendimet e palës tjetër, të jetë në gjendje të parashikojë prapësimet dhe pretendimet e saja.

12. "Barazia e armëve" dhe transparenca në shkëmbimin e argumenteve janë gurët e themelit të rolit të pushtetit gjyqësor. Sigurohuni gjithmonë se, për çdo çështje ligjore, palët kanë pasur mundësinë të shprehin qëndrimin e tyre, me mundësi të barabarta për t'u njohur me materialet procedurale përkatëse.

13. Ushtrimi nga ana e palëve i të drejtave procedurale që lidhen me ngritjen e padisë, kundërpadisë, procedimet prej apo kundër palëve të treta etj., e vendos gjykatën në një pozicion të tillë që të tregohet e kujdesshme për të ndaluar përpjekjet e palëve ose të përfaqësuesve të tyre për zgjatjen e paarsyeshme dhe ndërlikimin e procesit.

14. Pretendimet e palëve për objektin e mosmarrëveshjes mund të paraqiten gjatë gjithë fazave të zhvillimit të gjykimit në shkallën e parë. Paditësit i njihet e drejta të shtojë, të ndryshojë ose të pakësojë objektin e padisë apo edhe vetë shkakun e padisë, me kusht që pretendimet e parashtruara gjatë procesit të kenë një lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.

15. Nga të dyja elementet e padisë (shkaku dhe objekti), paditësi mund të ndryshojë vetëm njërin dhe jo të dyja njëkohësisht. Në rast se ndodh një gjë e tillë, atëherë ndryshon krejtësisht padia dhe, për rrjedhojë, do të mungojë me pretendimet e fillimit lidhja që konsiderohet si e mjaftueshme nga ligji.

16. Prapësimet janë mjet mbrojtjeje, nëpërmjet të cilave, pala e paditur kundërshton pranimin e padisë, duke e mbajtur mosmarrëveshjen gjyqësore brenda kufijve të padisë.

17. Kundërpadia është padi e të paditurit kundrejt paditësit që ushtrohet në gjykimin e një padie të filluar. Pala e paditur, nëpërmjet kërkimeve të tjera, i zgjeron kufijtë mbi të cilët është ngritur kërkesëpadia. Pretendimi i paraqitur në kundërpadi duhet të ketë lidhje me pretendimin e padisë, ose objekti i kundërpadisë të jetë i aftë për kompensimin me atë të padisë. Kundërpadia paraqitet si padi më vete dhe duhet të përmbajë të gjitha rregullat që ndiqen për ngritjen e padisë. Paraqitja e saj bëhet përpara gjykatës gjatë fazave të zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë, derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor.

18. Në ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes mund të ndikojnë edhe kërkesat që bëjnë palët për marrjen e provave të tjera, përveç atyre që janë paraqitur gjatë seancës përgatitore a gjyqësore. Ligji e kushtëzon kërkesën për marrjen e provave të reja me rrethanat e dala rishtas dhe që janë në dobi të gjykimit.

19. Në ndryshimin e objektit të mosmarrëveshjes ndikojnë edhe ndërhyrësi kryesor, ndërhyrësi dytësor apo personat e tretë. Ndërhyrja kryesore shkakton ndryshimin e gjykimit të filluar për arsye se paraqitet si paditës dhe dy palët ndërgjyqëse (paditës dhe i paditur) mund të shndërrohen në të paditur. Personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë.

20. Të gjitha palët mund të hyjnë vetë ose të thirren nga gjykata kur çmohet e arsyeshme se ato kanë një interes për çështjen. Gjykata është ajo që vlerëson nëse kërkesat e reja që mund të lindin gjatë shqyrtimit të çështjes, kanë ose jo lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit, me qëllim që procesi të mos e humbasë kuptimin e vërtetë si dhe qëllimin që duhet të arrijë.

KREU I TRETË

PARIME TË PËRGJITHSHME

- KONCEPTI I PADISË
- KONCEPTI I JURIDIKSIONIT
- KONCEPTI I KOMPETENCËS

a – OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet të jenë të aftë:

- të vlerësojnë nëse pretenduesi e ka zotësinë dhe interesin ligjor të kërkuar;
- të përcaktojnë nëse gjenden para një "mosmarrëveshjeje civile" të bazuar;
- të vlerësojnë nëse po veprojnë brenda kompetencave që i janë caktuar me ligj gjykatës ku ata punojnë.

b – MATERIALET REFERUESE KRYESORE

1. Padia

Titulli II i pjesës së përgjithshme të Kodit shqiptar të procedurës civile trajton konceptin e "padisë." Këtë koncept e njohin dhe e përdorin shumë sisteme procedurale të Europës Kontinentale. Pra, materialet referuese për përkufizimin dhe përdorimin praktik të tij sipas perspektivës shqiptare mund të gjenden edhe në një numër të konsiderueshëm të sistemeve të huaja ligjore. Trajtimin e çështjeve që lidhen me konceptin e "padisë", mund ta fillojmë duke iu referuar sistemit ligjor të fqinjit të saj jugor, Greqisë, ku, në të vërtetë, ky koncept është pothuajse i njëjtë me atë të përdorur në Shqipëri. Sipas Pelayia Yessiou-Faltsi:[1)]

1) **Pelayia Yessiou-Faltsi: Procedura civile në Greqi,** *Athens - Hague – Boston - London, Sakkoulas - Kluwer, 1995.*

"(...) padia përkufizohet si akti procedural i ngritjes së një kërkese për mbrojtje gjyqësore të së drejtës subjektive. Pra, padia mbështetet mbi një të drejtë private konkrete dhe kërkon pushimin e ndërhyrjeve që mund t'i bëhen asaj. Megjithatë, nocioni procedural i padisë dallon nga pretendimi material, të cilin mbajtësi i një të drejte subjektive e ushtron ndaj mbajtësit të detyrimit. Pavarësisht mbështetjes së saj mbi një të drejtë materiale, padia ngrihet edhe kundër shtetit, përveçse kundër personit ndaj të cilit është ushtruar e drejta private. Kështu, përveç marrëdhënies të së drejtës private që ekziston midis palëve, e cila mbështetet mbi të drejtën subjektive në fjalë, ngritja e një padie institucionalizon një marrëdhënie tjetër ligjore midis palës paditëse dhe shtetit. Kjo marrëdhënie ka natyrën e së drejtës publike dhe, aktualisht, ka mbështetje kushtetuese. Ajo shënon të drejtën e palës paditëse kundër shtetit për të pasur një vendim gjyqësor të bazuar duke garantuar se nuk ekziston asnjë pengesë procedurale".

Shënim i autorit: *Ky përkufizim i padisë, si kërkesë drejtuar kundër shtetit, duket se përkon me përkufizimin e dhënë nga Kodi shqiptar i procedurës civile, në nenin 31 të tij. Një përkufizim shumë i ngjashëm jepet në nenin 30 të Kodit francez të procedurës civile: "Padia, për sa i takon pretenduesit, duhet të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjyqtari të vendosë për pranueshmërinë e saj. Pala kundërshtare lejohet të kontestojë bazueshmërinë e pretendimit".*

Në traditën e së drejtës civile paditë klasifikohen sipas kategorive të ndryshme dhe përsëri nënndarjet e parashikuara në vende të tjera duket se aplikohen edhe në kontekstin shqiptar.

Për shembull, sipas Peter Herzog:[2)]

"Zakonisht, autorët francezë i ndajnë paditë: ose në padi reale *(in rem)*, personale dhe mikse (sipas së drejtës themelore që ato kanë për qëllim të mbrojnë), *ose në padi që ngrihen për pasuri të luajtshme ose të paluajtshme (sipas objektit të mosmarrëveshjes). Paditë mund të klasifikohen sipas dy grupimeve të përmendura më sipër. Kështu, mund të ketë padi që ngrihen për pasuri të paluajtshme që mund të jenë personale, reale ose mikse; si dhe padi që ngrihen për pasuri të luajtshme që gëzojnë ndonjë prej këtyre karakteristikave.*

Paditë reale ngrihen për të mbrojtur një të drejtë *in rem* – për shembull, të drejtën e pronës (si të pasurive të luajtshme, ashtu edhe të tokës) apo të drejtën e përdorimit. Padia reale më e njohur është ajo e rivendikimit, nëpërmjet së

2) Peter Herzog : **Procedura civile në Francë,** *Hague, M. Nijhoff, 1967, f.250-252:*

cilës zotëruesi i një prone kërkon kthimin e saj. Paditë personale ngrihen për të kërkuar mbrojtjen e një të drejte *in personam (personale),* sikurse mund të jetë pagimi i dëmeve ose pjesëtimi i një pjese të pasurisë në bazë të marrëveshjeve kontraktore. Ndërsa paditë reale janë të kufizuara në numër dhe të emërtuara në mënyrë specifike, padive personale kryesisht u mungon përshkrimi specifik.

Paditë personale përfshijnë, si të drejtën personale, ashtu edhe të drejtën *in rem.* Padia për prishjen e një kontrate është një padi *in personam*, por, duke qenë se në të drejtën franceze përfundimi më i thjeshtë i një kontrate shitjeje (normalisht) kalon edhe titullin, prishja e kontratës cenon edhe titullin e pronësisë, duke pasur kështu edhe një pasojë *in rem.*

Për pak a shumë të njëjtat arsye, paditë për pjesëtimin e pronave të blera në bazë të një kontrate mund të konsiderohen si padi mikse. Nëse blerësi i një shtëpie, sipas një kontrate shitjeje, akuzon shitësin për mbajtje në posedim të pronës së shitur, padia është personale sa kohë që blerësi kërkon të sigurojë përmbushjen e detyrimit të shitësit për dorëzimin e posedimit. Por, nëse padia përfshin edhe vlefshmërinë e kontratës – e cila, nëse është e vlefshme, kalon edhe titullin – atëherë ajo është reale.

Sikurse është përmendur edhe më sipër, sipas një kategorizimi tjetër, paditë ndahen në padi që ngrihen për pasuri të luajtshme dhe në padi që ngrihen për pasuri të paluajtshme. Paditë që ngrihen për pasuri të luajtshme, mund të jenë reale, personale apo mikse, sikurse mund të jenë edhe paditë që ngrihen për pasuri të paluajtshme. Gjithsesi, për shkak të mbrojtjës së kufizuar të së drejtës së pronës mbi pasuritë e luajtshme, sipas ligjit francez, paditë reale që ngrihen për pasuri të luajtshme, janë relativisht të pakta. Padi të tilla ngrihen kryesisht për pasuritë e paluajtshme.

Autorët francezë i ndajnë paditë reale që ngrihen për pasuri të paluajtshme, në dy lloje të veçanta: padi për titullin e pronësisë dhe padi posedimore. Paditë për titullin e pronësisë përdoren për marrjen e një vendimi lidhur me titullin e pronësisë, si për vetë pasurinë e paluajtshme, ashtu edhe për një të drejtë më pak të rëndësishme që lidhet me të, sikurse është e drejta e përdorimit.

Paditë posedimore janë mjete të shpejta (të drejtpërdrejta) për mbrojtjen e posedimit, pavarësisht nga titulli. Ndonëse ligjet aktuale përmendin vetëm paditë posedimore në përgjithësi, tradicionalisht, janë diskutuar tri lloje të padive posedimore: *padia e rivendikimit*, nëpërmjet së cilës një person i ndjekur forcërisht nga toka e tij siguron kthimin e saj; *padia e pushimit të cenimit*, nëpërmjet së cilës një person, posedimet e të cilit cenohen nga akte që nuk barazohen me dëbimin, mund të garantojë mbrojtje; *kallëzimi i një punimi të ri*, nëpërmjet të cilit një person, i cili kërcënohet nga ndërtimi në tokën ngjitur, mund të fitojë nga gjykata një urdhër për të penguar vazhdimin e ndërtimit.

Paditë posedimore sillen gjithmonë para gjykatave të shkallës së parë. Titulli i pronësisë nuk merret në shqyrtim dhe mosmarrëveshjet që lidhen me titullin, mund të mos bashkohen me paditë posedimore. Në një padi posedimore, pala e paditur duhet të presë deri në përfundim të saj para se të ngrejë një padi për rivendosjen e titullit të pronësisë; në një padi për titullin e pronësisë, pala paditëse e humbet të drejtën për të ngritur një padi posedimore. Si rregull, personi që ngre një padi posedimore duhet të ketë qenë në posedim për një vit dhe e drejta e tij për mbrojtje duhet të ketë nisur brenda po kësaj periudhe."

2. Kuptimi i padisë sipas legjislacionit shqiptar

Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Nga ky përkufizim që jep neni 31 i Kodit të procedurës civile, dalin disa funksione kryesore të padisë. Ajo është mjet procedural i rëndësishëm, nëpërmjet së cilës realizohet e drejta e personit për të vënë në lëvizje gjykatën, për të thirrur në gjykim palën kundërshtare me të cilën ka një mosmarrëveshje juridike, për të kërkuar nga gjykata mbrojtje gjyqësore për të drejtën që pretendon, si dhe për të detyruar gjykatën të shprehet mbi bazueshmërinë ose jo të pretendimit të tij.

Me anë të padisë, pala realizon kërkimin e vet të së drejtës materiale kundrejt palës kundërshtare ose sqaron raportet e veta juridike me të. Padia, në kuptimin procedural, është kërkimi i drejtuar gjykatës për mbrojtjen e një të drejte civile subjektive ose për njohjen e ekzistencës, ose të mosekzistencës së një raporti juridik të caktuar. Ajo është mjeti i mbrojtjes së një të drejte. Nga ana tjetër, padia, në kuptimin material, është pretendimi i një të drejte materiale i kundërdrejtuar të padituri nga paditësi nëpërmjet gjykatës. Në kuptimin material, padia është e drejta civile e mbrojtur nga gjyqi. Me padinë është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe e drejta e palës kundërshtare për të ngritur prapësimet e saja, si dhe për të ushtruar kundërpadinë, mbi bazën e një procesi gjyqësor kontradiktor.

Legjislacioni ynë procedural nuk e ndalon personin të ngrejë padinë jo vetëm ndaj subjekteve private, por edhe ndaj subjekteve të së drejtës publike. Mosmarrëveshja juridike e krijuar ndërmjet një personi dhe shtetit, të përfaqësuar nga organet përkatëse të administratrës publike, i jep kësaj mosmarrëveshjeje natyrën e një marrëdhënieje në fushën e së drejtës publike. Kështu, palës i lind e drejta të paditë shtetin dhe, nëpërmjet një padie të tillë, i kërkon gjykatës shpallje të bazuar të pretendimit. Për këtë nuk ekziston, as pengesë ligjore, as kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42, parashikon të drejtën e cilitdo për t'iu drejtuar gjykatës, ndërsa, në nenin 44, parashikon se *kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.*

Kjo dispozitë kushtetuese u njeh të drejtën personave të ngrenë padi në gjykatë edhe ndaj organeve shtetërore. Edhe në dispozita të tjera procedurale parashikohet një e drejtë e tillë e personave ndaj autoriteteve shtetërore. Mjafton t'i referohemi kuptimit të përgjithshëm që ka neni 32 i Kodit të procedurës civile që e lidh ngritjen e padisë me të drejtën për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që mund të jetë shkelur. Në mënyrë më të hollësishme kjo e drejtë është parashikuar dhe nënkuptuar në kreun II të Kodit, që bën fjalë për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ku, si palë kundërshtare, paraqitet autoriteti shtetëror, i cili ka nxjerrë një akt administrativ që pretendohet si i paligjshëm, ose ka refuzuar shqyrtimin ose miratimin e një akti të tillë.

Me anë të padisë, paditësi synon të rivendoset një e drejtë e tij e shkelur dhe i padituri detyrohet të ekzekutojë, d.m.th. të përmbushë detyrimin e tij kundrejt paditësit. Në raste të tjera, paditësi, me anën e gjykimit, synon të përcaktohet ose të njihet vetëm ekzistenca e një marrëdhënieje juridike të caktuar midis tij dhe të padiburit ose ekzistenca e një të drejte. Padia mund të ngrihet edhe për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin. Qëllimin e paditësit në ngritjen e padisë e përcakton shprehimisht neni 32 i Kodit të procedurës civile.

Për sa i përket klasifikimit të padive, legjislacioni civil shqiptar nuk ka ndonjë dallim thelbësor me legjislacionet e tjera, sidomos me atë francez. Nëse si kriter për klasifikimin e padive do të merret e drejta themelore, ato ndahen në: padi *reale, personale* dhe *mikse*. Shembujt e nxjerrë nga legjislacioni francez dhe të përdorur më sipër vlejnë edhe për legjislacionin shqiptar.

Objekti i mosmarrëveshjes është një tjetër kriter që i klasifikon paditë, të cilat ngrihen për pasuri të paluajtshme dhe për pasuri të luajtshme. Tri llojet e padive (reale, personale dhe mikse) nuk bëjnë ndonjë dallim për sa i përket pasurisë së paluajtshme apo të luajtshme. Ato ngrihen për secilën prej tyre. Vetë paditë reale, nga ana e tyre, kur ngrihen për pasurinë e paluajtshme ndahen në: padi për titullin e pronësisë dhe në padi posedimore. Mënyrat juridike të pronësisë kanë karakter real ose karakter detyrimi. Mjetet juridike civile reale synojnë mbrojtjen nga shkeljet e tagreve të pronarit, posedimit, gëzimit dhe disponimit.

Kodi ynë civil, duke u nisur nga mënyra e cenimit të pronësisë, i ndan paditë për titullin e pronësisë në: padi për kërkimin e sendit ose, siç quhet ndryshe, padi e revendikimit (neni 296) dhe në padi mohuese (neni 302). Këto dy padi njihen si padi reale, sepse synojnë njohjen e drejtpërdrejtë reale të së drejtës së pronësisë.

Sipas qëllimit të paditësit, në të drejtën procedurale njihen padia e njohjes ose e vërtetimit dhe padia e detyrimit. Paditë e njohjes janë padi deklarative, sepse ngrihen për të vërtetuar gjyqësisht qenien ose mosqenien e një marrëdhënieje juridike. Në vetvete, ato shërbejnë si bazë për një gjykim në të ardhmen, kur e drejta e njohur ose e vërtetuar cenohet nga të tjerët. Paditë e detyrimit kanë për qëllim dhënien e një vendimi nga ana e gjykatës, me të cilin detyrohet një ose më shumë persona të bëjnë ose jo një veprim, si p.sh., të japin një send, të paguajnë një shumë etj.

Njihen, gjithashtu, edhe klasifikime të tjera të padive, si p.sh., padi kryesore apo aksesore. Në rast se një padi ushtrohet me një kërkesë të veçantë, ajo konsiderohet si kryesore, ndërsa kur padia jep shkak për të ushtruar edhe një padi tjetër do të jetë si padi aksesore (padia për kamatë, shpërblim dëmi etj.).

3. Kërkesat procedurale

Gjykata e merr në shqyrtim çështjen vetëm nëse përmbushen disa kushte – të ashtuquajturat kërkesa procedurale. Ekzistenca e interesit ligjor në gjykim, zotësia për të qenë palë, juridiksioni dhe kompetenca mund të konsiderohen të gjitha si kërkesa procedurale. Natyra dhe lidhjet e këtyre kërkesave, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha sistemet procedurale kontinentale, analizohen në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar:*[3]

"Para se gjykata ta marrë në shqyrtim çështjen, d.m.th. të shprehet lidhur me bazueshmërinë e pretendimit, duhet të vendoset më parë pranueshmëria e procedurave gjyqësore. Kërkesat absolute duhet të dallohen nga ato relative, të cilat, gjithashtu, e pengojnë gjykimin në themel, por merren në shqyrtim vetëm nëse pala e paditur parashtron një objeksion.

Kërkesat procedurale lidhen si me gjykatën, ashtu edhe me palët ose objektin e mosmarrëveshjes. Gjykata duhet të jetë kompetente në kuptimin e gjerë të fjalës, duke përfshirë juridiksionin ndërkombëtar, kompetencën tokësore

---

3) IECL, vëll. XVI, në ***Procedurën civile, kap. 6, Procedurat e zakonshme në shkallën e parë****, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London, faqe 112 – 114:*

(vendin) dhe kompetencën lëndore. Kërkesa e fundit përfshin dy kuptime: kuptimin e gjerë, sipas të cilit mosmarrëveshja duhet të jetë brenda sferës të së drejtës private (dhe nuk duhet te jetë e tillë që të trajtohet brenda procedurave civile administrative apo atyre që nuk përmbajnë konflikt në vetvete) dhe kuptimin e ngushtë, sipas të cilit gjykata specifike duhet të jetë kompetente për gjykimin e çështjes për sa u takon kufizimeve të juridiksionit.

Palët duhet të jenë reale, të kenë zotësinë për të qenë palë në gjykim dhe për të kryer procedurat ligjore. Nëse kjo zotësi mungon, në pro-cedurat ligjore duhet të marrë pjesë përfaqësuesi ligjor i palëve. Gjithashtu, palët duhet të kenë të drejtën e paraqitjes në gjykatë. Së fundi, disa kërkesa procedurale lidhen me objektin e padisë. Për shembull, pretendimi duhet të jetë në përputhje me procedurat gjyqësore. Ai nuk duhet të jetë objekt i një padie tjetër që është në gjykim e sipër apo të jetë *res judicata (gjë e gjykuar).*

Në Zvicër, kodet procedurale të kantoneve që flasin kryesisht gjuhën gjermane, kanë mbetje të *jus commune* sa kohë që ato i përshkruajnë kërkesat e një pretendimi si kërkesa procedurale. Kështu, disa kantone e konsiderojnë si kërkesë procedurale negative faktin se një pretendim mund të kufizohet nga koha apo nga heqja e një të drejte.

Në kantone të tjera, *locus standi*[4] është një kërkesë procedurale pozitive. Në vende të tjera, kërkesat procedurale absolute lidhen me kërkesat relative dhe merren në konsiderate vetëm nëse pala e paditur paraqet një objeksion dhe e paraqet atë në fazën përgatitore të procesit.

Kërkesat procedurale relative nuk merren në konsideratë nga gjykata për aq kohë sa pala e paditur nuk ka paraqitur ndonjë objeksion dhe nuk e ka paraqitur atë në fazën përgatitore të procesit.

Në pjesën më të madhe të padive, të gjitha kërkesat procedurale përmbushen në mënyrë të dukshme, kështu që nuk ekziston ndonjë arsye për shqyrtimin specifik të tyre; madje, zakonisht, ato as nuk përmenden. Ndryshe qëndron puna kur ekzistojnë dyshime, të cilat mund të ngrihen nga pala e paditur nëpërmjet objeksioneve. Në këtë rast, dallimi ndërmjet kërkesave procedurale absolute dhe relative merr rëndësi të veçantë. Objeksionet që lidhen me kërkesat procedurale, mund të ngrihen në çdo kohë. Në Gjermani objeksionet që lidhen me kërkesat procedurale relative, mund të ngrihen vetëm para seancës gjyqësore për shqyrtimin e çështjes, për aq kohë sa e pala e paditur nuk ka paraqitur një arsye të fortë për vonesën. Në Austri, objeksionet që lidhen me kërkesat procedurale relative, mund të ngrihen gjatë seancës së

4) latinisht- legjitimimi

parë gjyqësore. Sidoqoftë, në praktikë pranohen edhe objeksionet e ngritura në një moment tjetër, nëse faktet mbi të cilat ato mbështeten marrin jetë në një fazë të mëvonshme.

Shumica e kodeve zvicerane, me përjashtim të mbetjes *jus commune*[5] të përmendur më sipër, priren drejt një ndarjeje të qartë midis kërkesave procedurale absolute dhe relative të procedurave gjyqësore në po të njëjtën mënyrë si kodet gjermane dhe austriake. Legjislacioni i kohëve të fundit kërkon shprehimisht që kërkesat procedurale absolute të merren në konsideratë nga gjykatat *ex officio.*

Por, për të qartësuar nëse padia para gjykatës mund të vazhdojë të procedohet, gjithmonë kërkohet një vendim paraprak. Kjo gjë mund të realizohet, si në një seancë të veçantë, ashtu edhe në seancën e shqyrtimit të çështjes. Në Austri, një kërkesë mund të rrëzohet edhe gjatë fazës së shqyrtimit paraprak, nëse del i qartë fakti i mungesës së kërkesave procedurale. Nëse nuk rrëzohet, kërkesa procedurale duhet të plotësohet në seancën e parë përgatitore, e cila është e detyrueshme në një gjykatë të shkallës së parë me kompetencë të zgjeruar dhe diskrecionale në një gjykatë të shkallës së parë me kompetencë të kufizuar. Data për zhvillimin e kësaj seance caktohet me paraqitjen e kërkesës. Kjo i jep palës së paditur mundësinë për të ngritur objeksione që lidhen me kërkesat procedurale. Gjithsesi, pala nuk mund të refuzojë bashkimin e këtij objeksioni me shqyrtimin në themel të çështjes. Nëse arrihet në përfundimin se në seancën e parë mungon një kërkesë procedurale, atëherë padia duhet të pushohet menjëherë nëse pala paditëse nuk e kalon çështjen në një gjykatë që ka juridiksion mbi palën e paditur. Por, nëse gjykata kërkon kohë për të marrë vendimin, ajo ka dy alternativa: të urdhërojë një seancë tjetër paraprake ose, nëse është e përshtatshme, të kombinojë një seancë të tillë me gjykimin dhe vendimin për çështjen kryesore.

Sipas pikëpamjes mbizotëruese, rregulla që kërkesat procedurale të shqyrtohen *ex officio* nuk do të thotë se gjykata duhet të investigojë gjithmonë *motu proprio* të gjitha faktet që lidhen me çështjen, por vetëm në rastet kur ngrihen dyshime. Edhe në një rast të tillë, ajo mund t'u kërkojë palëve të japin prova sa herë që kërkohet kjo gjë.

Për sa i përket radhës së marrjes në shqyrtim të kërkesave procedurale në rastet kur ka më shumë se një prej tyre që vihet në dyshim, opinionet ndahen.

5) latinisht, e **drejta e përbashkët. Ius commune** *i referohet rastit kur duam të vëmë në dukje rregulla, parime, që, megjithëse nuk janë të shkruara, janë të gjithëpranuara.*

Kodi gjerman nuk merret me këtë problem. Pikëpamja se vetëm një gjykatë kompetente mund të shqyrtojë kërkesat proedurale – pra duke vënë gjithmonë të parën kompetencën e gjykatës – po hidhet poshtë gjerësisht. Nga njëra anë, nocioni se të gjitha gjykatat e shkallës së parë qëndrojnë në të njëjtin nivel (neni 549, §. 2) dhe se një çështje mund të kalojë nga një gjykatë në një tjetër, sugjeron se kërkesa procedurale, mungesa e së cilës mund të përcaktohet më me lehtësi, duhet të merret në shqyrtim e para, kështu që investigimet e mëtejshme eliminohen me konstatimin e mungesës së kërkesës procedurale. Nga ana tjetër, bindja dhe logjika procedurale kërkojnë që të shqyrtohen në fillim ato kërkesa procedurale që do të pengonin pranueshmërinë e gjithë procedurave civile në tërësi.

Nëse gjykata konstaton se nuk është kompetente për çështjen që i është adresuar, çështja duhet të kalojë sa më shpejt që të jetë e mundur në gjykatën kompetente. Nëse objekti i një mosmarrëveshjeje del jashtë kompetencës së gjykatës, apo nëse gjykatës i mungon kompetenca tokësore, ajo duhet të deklarohet si jokompetente; nëse konstatohet kjo gjë, me kërkesë të palës paditëse, mosmarrëveshja mund t'i kalojë për shqyrtim gjykatës së përshtatshme.

Kodi austriak ka një dispozitë të ngjashme (§ 261 par. 6), por, në ndryshim nga e drejta gjermane, urdhri për transferimin e çështjes nuk është i detyrueshëm për gjykatën ku është adresuar çështja. Pala e paditur mund të kundërshtojë edhe kompetencën e gjykatës së dytë duke pretenduar se nuk ka paraqitur pretendimet në gjykatën e parë. Në Gjermani dhe në Austri çështja mbetet *lis pendens (pezull) – d.m.th.* para dhe pas transferimit – duke u ruajtur kështu të gjitha afatet kohore që vendosen nga institucioni që kryen procedimet.

Forma me anë të së cilës merren vendimet mbi kërkesat procedurale, ndryshon në mënyrë të ndjeshme në të drejtën gjermane dhe atë austriake. Në Gjermani, nëse mungon një kërkesë procedurale, padia do të pushohet si e papranueshme. Nëse padia pranohet, për objeksionin e palës së paditur do të vendoset me anë të një gjykimi të ndërmjetëm në një seancë të veçantë, përndryshe, ky objeksion do të përmendet në vendimin përfundimtar. Ndërsa, në Austri, padia që nuk pranohet, do të pushohet me një urdhër të gjykatës, i cili *ex facie*[6] nuk prek thelbin e çështjes; kjo vlen edhe për një objeksion të pabazuar. Forma e vendimit është e vlefshme edhe për procedurën e apelimit".

6) Latinisht: shfaqja, dukja; diçka që duket sheshit.

4. Kërkesat procedurale sipas legjislacionit shqiptar

Për fillimin e një procesi gjyqësor është e nevojshme ekzistenca e disa kushteve thelbësore, të cilat konsiderohen si elemente përcaktuese të vetë procesit. Këto njihen si kërkesa procedurale, të cilat vlerësohen nga gjykata. Legjislacioni procedural shqiptar nuk parashikon ndonjë kriter për klasifikimin e kërkesave procedurale. Ashtu si në legjislacionin e huaj, edhe në Kodin e procedurës civile njihen kërkesat procedurale, të cilat duhet të plotësohen me qëllim që procesi të vazhdojë në normalitet.

Kodi nuk i ndan kërkesat procedurale në absolute dhe relative. Megjithatë, një ndarje e tillë që lidhet me marrjen e tyre në shqyrtim kryesisht nga gjykata apo vetëm mbi kërkesën e palës së paditur gjatë procesit, është e nënkuptuar edhe në dispozitat procedurale të këtij kodi. Kështu, zotësia për të qenë palë, interesi i ligjshëm (ligjshmëria aktive dhe pasive), kompetenca e gjykatës, juridiksioni mund të konsiderohen si kërkesa procedurale absolute, për arsye se gjykata i merr ato në shqyrtim edhe kryesisht. Njihen, gjithashtu, edhe kërkesa të tjera, të cilat mund të klasifikohen si relative. Këto kërkesa nuk merren në shqyrtim kryesisht nga gjykata, por vetëm nëse pala e paditur paraqet prapësime gjatë gjykimit. Mund të përmendim kërkesën për parashkrimin e së drejtës së ngritjes së padisë, e cila vlerësohet nga gjykata vetëm kur kryhet prapësimi nga pala e paditur.

Koha e paraqitjes së kërkesave procedurale në legjislacionin tonë nuk kushtëzohet me ndonjë afat kohor. Ligji për këtë çështje hesht. Pretendime të tilla mund të paraqiten, si në veprimet përgatitore, ashtu edhe gjatë ecurisë së mëtejshme të procesit gjyqësor. Kërkesat procedurale rregullohen në shumë dispozita të Kodit të procedurës civile. Kështu, në nenet 33, 90-95, parashikohet zotësia për të qenë palë në një proces gjyqësor civil; në nenin 176 dhe në të gjithë krerët që rregullojnë gjykimet e posaçme, parashikohet interesi i ligjshëm i palës; në nenet 35-64 parashikohet kompetenca dhe juridiksioni i gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve civile etj.

Vendimet që merren nga gjykata lidhur me kërkesat procedurale, kushtëzohen nga vetë natyra e tyre. Përgjithësisht, vendimet që merr gjykata kur konstaton mungesën e ndonjë prej kërkesave procedurale, nuk janë vendime përfundimtare. Kodi i procedurës civile, në nenet 125-127, jep kuptimin e vendimeve që merr gjykata. Nga analiza e këtyre dispozitave ligjore arrihet në përfundimin se gjatë shqyrtimit të kërkesave procedurale, gjykata nuk e zgjidh çështjen në themel. Për rrjedhojë, vendimi që ajo merr nuk është përfundimtar, sepse ajo nuk mban qëndrim duke i dhënë të drejtë njërës apo tjetrës palë mbi natyrën e mosmarrëveshjes juridike.

Me vendimet jopërfundimtare, gjykata i jep fund procesit, por pa e zgjidhur çështjen në themel. Neni 127 i Kodit parashikon se këto vendime mund të jenë vendime pushimi. Sidoqoftë, vetë kjo dispozitë pranon se gjykata mund të konsiderojë si vendim jopërfundimtar çdolloj vendimi tjetër me kusht që t'i japë fund procesit dhe të mos e zgjidhë çështjen në themel. Kështu p.sh., vendimet për mungesën e kompetencës ose të juridiksionit janë vendime pushimi, sepse e ndalojnë gjykimin e mëtejshëm të çështjes, pa e zgjidhur atë në themel. Të ndryshme janë vendimet që merren nga gjykata në rastet kur ajo konstaton mungesën e ligjësimit të paditësit, të zotësisë së tij për të vepruar etj. Në këto raste gjykata merr vendime rrëzimi, të cilat janë vendime jopërfundimtare dhe që duhen dalluar nga vendimet përfundimtare të rrëzimit. Për këto të fundit bëhet pengesë parimi i gjësë së gjykuar që të trajtohen përsëri, ndërsa vendimet jopërfundimtare të rrëzimit nuk bëhen pengesë për t'u shqyrtuar përsëri nga gjykata. Kështu p.sh., në qoftë se rrëzohet padia e një ndërgjyqësi, sepse në kohën e ngritjes së padisë nuk kishte zotësinë për të vepruar në gjykim dhe vendimi i dhënë ka marrë formën e prerë, kjo nuk e ndalon palën që, kur të ketë shmangur pengesën ligjore që lidhej me zotësinë për të vepruar (d.m.th., të jetë bërë madhor ose t'i jetë kthyer zotësia për të vepruar), të ngrejë përsëri të njëjtën padi. Ky arsyetim vlen edhe për kërkesat e tjera procedurale që lidhen me moskompetencën e gjykatës ose me mungesën e juridiksionit, por jo me ligjshmërinë e palës. Në rastet kur gjykata shprehet për mungesën e ligjshmërisë së palës, nuk mund t'i njihet e drejta të ngrejë të njëjtën padi. Ndaj këtyre vendimeve ligji njeh të drejtën e ankimit, që përgjithësisht ka formën e një ankimi të veçantë.

Të gjitha kërkesat procedurale do t'i analizojmë me radhë në vijim.

4.1. *Zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor*

Sikurse kemi parë edhe më lart, dy prej kërkesave procedurale janë: zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor. Kodi shqiptar i procedurës civile parashikon shprehimisht se një padi mund të ngrihet vetëm nga një person me zotësi juridike për të vepruar (neni 33). Në këtë kontekst, sistemi ligjor shqiptar është në linjën e traditës kontinentale, duke e lidhur zotësinë për të zhvilluar një proces gjyqësor me zotësinë për të lidhur një kontratë. Edhe në këtë rast, e drejta greke ofron një paralelizëm të mirë. Në po të njëjtin libër të Pelayia Yessou-Faltsi, të cituar edhe më sipër, thuhet:

"(...) Sipas nenit 62 të Kodit grek të procedurës civile, në parim, zotësia për të qenë palë në gjykim varet drejtpërdrejt nga personaliteti, d.m.th. nga zotësia për të pasur të drejta dhe detyrime sipas ligjit material. Pra, të gjithë personat fizikë, pavarësisht nga mosha, dhe të gjithë personat juridikë të pranuar nga e drejta materiale kanë zotësinë për të qenë palë në gjykim".

(...) Por, Kodi i procedurës civile i vitit 1967, duke ndjekur kryesisht modelin gjerman, e ka zgjeruar zotësinë për të qenë palë në gjykim, duke përfshirë edhe shoqatat e personave që i janë dedikuar një qëllimi specifik dhe ortakëritë civile, madje edhe kur atyre nuk u është dhënë statusi (personaliteti) juridik (neni 62). Sipas vendimeve aktuale të gjykatave, tashmë pranohet se zotësia për të qenë palë në gjykim përfshin, për shembull: grupin e bashkëpronarëve të një ndërtese, "bashkëpronësinë" e një anijeje, partitë politike, konsortiumin e shoqatave të biznesmenëve etj.

Zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor, d.m.th. kryerja e akteve të ndryshme procedurale në emrin tënd personal është përsëri e përcaktuar sipas një referimi në të drejtën civile. Kjo zotësi duhet të dallohet nga zotësia për të qenë palë në gjykim, pasi nuk korrespondon më me personalitetin, por me zotësinë për të kryer akte juridike. Kështu, të gjithë personave mbi moshën 18 vjeç u është dhënë kryesisht zotësia e plotë për të kryer akte procedurale në emër të tyre, me përjashtim të rasteve kur këta persona hyjnë në kategorinë e personave me zotësi të kufizuar (për shembull, personat nën kujdestari) apo personat pa zotësi për të vepruar (për shembull, personat të cilëve u mungon kjo zotësi për shkak të një sëmundje të përhershme fizike ose mendore, personat e dënuar për kryerjen e veprave penale gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burgim). Personat me zotësi të kufizuar e ruajnë të drejtën për të kryer akte procedurale në emër të tyre për aq kohë sa ata kanë zotësinë për të kryer akte ligjore. Personat absolutisht të paaftë në fushën e së drejtës civile mund t'i kryejnë procedurat vetëm nëpërmjet personave të përmendur në dispozitat ligjore materiale specifike. Një shembull i zakonshëm do të ishin të miturit, të cilët normalisht përfaqësohen nga prindërit e tyre. Në mënyrë të ngjashme, kur bëhen palë në gjykim, entitetet ligjore mund t'i kryejnë aktet procedurale nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe palët pa statusin e personit juridik nëpërmjet personave që drejtojnë aktivitetin e tyre. Të huajt, të cilët nuk e kanë zotësinë për të marrë pjesë në gjykim në emër të tyre sipas ligjit të vendit të origjinës, konsiderohet se e gëzojnë këtë zotësi para gjykatave greke në rastin kur kjo zotësi u jepet atyre sipas ligjit grek".[7]

---

7) Pelayia Yessiou-Faltsi: ***Procedura civile në Greqi,*** *Athens - Hague – Boston - London, Sakkoulas - Kluwer, 1995, faqe 193-195.*

4.2. Zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gjyqësor sipas legjislacionit shqiptar

Neni 90 i Kodit të procedurës civile pranon se *palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi.* Pra, pjesëmarrës në një proces është personi a subjekti që është mbajtës i të drejtave dhe interesave të ligjshëm, me kërkesën e të cilit fillon procesi (pala aktive) ose kundër të cilit zhvillohet procesi (pala pasive). Kjo nënkupton edhe pasjen e interesit të ligjshëm për çështjen në shqyrtim, që më lart u trajtua si ligjshmëri aktive dhe pasive.

Pala në çdo proces gjyqësor kërkohet të provojë këtë interes të saj të ligjshëm me çështjen në shqyrtim. Kjo vërtetohet kur pala plotëson tri kushte:

- të ketë zotësi për të qenë palë (zotësia e palës);
- të ketë zotësinë e kryerjes së veprimeve të caktuara (zotësia procedurale);
- të vërtetojë lidhjen e domosdoshme midis interesit të palës dhe çështjes konkrete (ligjshmëria e palës).

Zotësia për të qenë palë lidhet me aftësinë e pjesëmarrësit në proces, për të qenë mbajtës të drejtash dhe detyrimesh. Aftësia juridike e personave fizikë e juridikë lidhet me personalitetin e tyre juridik.

Zotësia procedurale ka të bëjë me mundësitë e palës për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme që kërkohen në një proces gjyqësor. Zotësia procedurale e nënkupton njëkohësisht edhe zotësinë e palës, por pranohet si element i veçantë që konkretizohet në rastet kur-pala mund të plotësojë kushtin e parë dhe të mos jetë në gjendje të plotësojë të dytin. Pra, lidhet, p.sh., me mungesën e zotësisë së plotë për të vepruar të shtetasve në një proces gjyqësor. Neni 33 i Kodit të procedurës civile e trajton këtë aspekt duke parashikuar: *"Nuk mund të ngrihet padi nga një person të cilit i mungon zotësia juridike për të vepruar".*

Ligjshmëria e palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin e ligjshëm dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim. Kjo ligjshmëri e palës është e provuar, si në rastin kur pala kërkon një të drejtë dhe për këtë arsye fillon procesin gjyqësor- *ligjshmëri aktive* (p.sh., kërkon pronësinë mbi një send), ashtu edhe në rastin kur ndaj palës është filluar një procedim - *ligjshmëri pasive* (p.sh., detyrohet të paguajë një shumë të caktuar). Në të dyja rastet gjykata duhet të vlerësojë ligjshmërinë e palës në procesin gjyqësor me qëllim zgjidhjen përfundimtare dhe me drejtësi të çështjes. Kjo çështje do të trajtohet në vijim.

Zotësia për të vepruar në një gjykim dallon nga zotësia për të qenë palë. Zotësia për të qenë palë lidhet *me gëzimin e të drejtave* civile, ndërsa zotësia për të vepruar realizohet nëpërmjet *ushtrimit të këtyre të drejtave*. Përgjithësisht,

personat që kanë zotësinë për të qenë palë, e kanë edhe zotësinë për të vepruar. Sidoqoftë, ka edhe kufizime të zotësisë për të vepruar. Sipas ligjit, personat që nuk kanë zotësinë për të vepruar në një proces gjyqësor, nuk privohen nga zotësia për të qenë palë. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Sipas nenit 91 të Kodit të procedurës civile, *personat që nuk kanë zotësinë për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre.* Qenia e këtyre personave si palë në proces gjyqësor nuk u jep mundësinë për të ushtruar vetë të drejtat në mënyrë personale, por nëpërmjet përfaqësuesve. Kjo ndodh në rastet kur dikush nuk e ka zotësinë për të vepruar për arsye të moshës, të ndonjë dënimi penal, ose kur dikujt mund t'i jetë kufizuar ose t'i jetë hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor.

Sipas nenit 7 të Kodit civil, *i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor,* ndërsa, sipas nenit 8, *i mituri që nuk ka mbushur këtë moshë, është i pazoti për të vepruar dhe veprimet juridike kryhen në emër të tij nga përfaqësuesi ligjor.* Në nenin 10 të Kodit civil parashikohet rasti kur personit madhor, për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet ose t'i kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim gjykate. Kjo procedurë konkretizohet në nenet 382 e vijuese të Kodit të procedurës civile. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, njeh edhe një lloj tjetër kufizimi të së drejtës për t'u zgjedhur për të dënuarit me heqje të lirisë nga gjykata.

Edhe personi juridik, si subjekt i së drejtës, ka zotësi për të qenë palë në një gjykim. Sidoqoftë, për arsye të vetë natyrës dhe qëllimit të veprimtarisë që kryen, ai nuk mund të ushtrojë vetë këtë zotësi juridike. *Personi juridik,* sipas nenit 31 të Kodit civil, *vepron me anë të organeve të veta të parashikuara nga ligji. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.*

Nga fakti se zotësia për të qenë palë është zotësia për të gëzuar të drejtat, kurse zotësia për të vepruar është aftësia për t'i ushtruar vetë këto të drejta, del se personat që nuk kanë të drejtën për të ushtruar të drejtat e tyre, nuk mund të veprojnë vetë në gjykim. Kjo pazotësi e tyre kthehet në pazotësi absolute, kur është për të gjitha të drejtat, dhe pazotësi relative, kur kufizohet vetëm në ushtrimin e disa të drejtave. Nga kjo rrjedh se ata persona që kanë pazotësi ushtrimi absolute, qëndrojnë si palë në gjykim me anë të përfaqësuesve të tyre ligjorë (prindërit ose kujdestarët), ndërsa personat që kanë pazotësi ushtrimi relative, marrin pjesë në gjykim duke qenë të asistuar nga personat që autorizon ligji. Nenet 91 dhe 94 të Kodit të procedurës civile e rregullojnë këtë moment.

Vendimet që merr gjykata në rastet që lidhen me zotësinë për të qenë palë apo me zotësinë për të vepruar, do të jenë vendime të ndërmjetme. Në raste të tilla veprojnë rregullat procedurale që lidhen me përfaqësimin në gjyq të personave të tillë (nenet 90 e vijuese).

4.3. Interesi ligjor

Neni 32 i Kodit shqiptar të procedurës civile parashikon se ngritja e padisë kërkon që palët të kenë interes ligjor në njohjen apo rrëzimin e pretendimit. Një dispozitë e ngjashme ekziston edhe në Kodin grek të procedurës civile, faqet 197-198:

"Sipas një dispozite tepër të qartë të Kodit të procedurës civile (neni 68), mbrojtja ligjore mund t'u garantohet vetëm personave që pretendojnë se kanë interes ligjor të drejtpërdrejtë. Kjo kuptohet si një kërkesë tjetër procedurale dhe zakonisht lidhet me nevojën për mbrojtje ligjore. Duke qenë se neni 68 i Kodit të procedurës civile kërkon që interesi ligjor të jetë i drejtpërdrejtë, pranohet gjerësisht edhe se kjo nevojë duhet të lidhet me marrëdhënie ligjore tashmë të krijuara më shumë sesa me ato që mund të krijohen në të ardhmen".

Interesi i ligjshëm në një proces gjyqësor lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të cenuar prej dikujt tjetër. Neni 32 i Kodit të procedurës civile të Republikës së Shqipërisë e kushtëzon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar atë që i përket sipas ligjit, ose me atë që i është prekur si një e drejtë. Interesi në gjykim është i lidhur me faktin se, pa ndërhyrjen e gjykatës, pala do të pësonte një dëm. Prandaj, shmangia e dëmit që mund t'i vijë palës nga veprimi ose nga fakti i një tjetri, e nënkupton interesin e ligjshëm të saj në një proces gjyqësor.

Mbi këtë bazë u garantohet mbrojtja ligjore personave që pretendojnë interes të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë. Interesi kërkohet të jetë konkret. Kjo do të thotë se shkelja e së drejtës duhet të ketë ndodhur. Neni 32 i Kodit të procedurës civile e lidh ngritjen e padisë me interesin e ligjshëm *që është shkelur*. Sipas kësaj dispozite, cenimi i një të drejte duhet t'i ketë ndodhur palës në kohën që ngrihet padia. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të justifikojë interesin e tij ligjor dhe çështja të jetë e pjekur për gjykim, d.m.th., e tillë që interesi të mos jetë abstrakt dhe vetëm i përfytyrueshëm. Gjithashtu, kërkohet që çështja të jetë aktuale, në kuptimin që interesi të vazhdojë të ekzistojë në kohën e gjykimit.

Megjithatë përpara një interesi të ligjshëm do të ndodhet pala edhe kur

pretendon para gjykatës se dëmi është i mundshëm të ndodhë në një të ardhme të afërt. Sipas nenit 202 të Kodit, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, gjykata, me kërkesë të paditësit, lejon marrjen e masave të sigurimit të padisë, siç mund të jetë, p.sh., vendosja e sekuestros (neni 206/a).

Interesi i ligjshëm nuk përjashtohet edhe në rastin kur ngrihet një padi, pa u cenuar ende një e drejtë. Neni 32, shkronja "b" dhe "c" e lejojnë ngritjen e padisë edhe për vërtetimin e qenies ose të mosqenies së një marrëdhënieje juridike, si dhe për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti. Në këto raste pala kërkon që këto të drejta të vërtetohen me vendim gjyqësor. Që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose për rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet të bëhet vetëm prej atij të cilit i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (ligjshmëria aktive) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit (ligjshmëria pasive).[8]

Interesi i ligjshëm ose ligjshmëria e palës në gjykim gjendet i pasqyruar në shumë dispozita procedurale. Neni 176 ngarkon gjykatën të verifikojë ligjshmërinë si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre. Në mënyrë më konkrete ky koncept sanksionohet në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Sipas nenit 325 të Kodit të procedurës civile, çdo shtetas mund të ngrejë një padi në gjykatë, nëse konsideron se me aktin e paligjshëm i është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i ligjshëm. Nga kjo rezulton se individi a personi juridik mund të hapin konfliktin administrativ nëse janë përmbushur dy kushte:

Së pari: Akti administrativ duhet të argumentohet si i paligjshëm. Shkelja, para së gjithash, ka të bëjë me konceptin për ligjshmërinë. Paditësi ka detyrimin të argumentojë përpara gjykatës paligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar. Paligjshmëria kërkohet të argumentohet, si në rastin e shfuqizimit të aktit, ashtu edhe të ndryshimit të tij.

Së dyti: Paditësi të jetë cenuar në interesat dhe në të drejtat e tija në mënyrë *të drejtpërdrejtë ose edhe të tërthortë.* Shkelja ka të bëjë me interesin e drejtpërdrejtë vetjak ose edhe të tërthortë, i cili duhet të jetë i bazuar në ligj. Interesi i paditësit nuk mund të jetë i interpretuar arbitrarisht. Ai duhet të rezultojë nga norma juridike dhe të bazohet në to. Interesi duhet të jetë vetjak dhe i drejtpërdrejtë, që do të thotë se duhet të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë midis vendimit të nxjerrë, nga njëra anë, dhe interesit të paditësit, nga ana tjetër.

---

8) Lamani, Alqiviadh, Procedura civile, Tiranë, 1962, faqe 34.

Akti administrativ duhet të cenojë personalisht paditësin dhe interesat e tij. Megjithatë, ligji nuk përjashton edhe interesin e tërthortë, që në të vërtetë është i lidhur edhe me prekjen e interesave kolektivë.

Rrethi i subjekteve që ligjësohen, ndryshon në varësi të pavlefshmërisë së një akti apo veprimi juridik. Kështu, dihet se pavlefshmëria absolute e një akti apo veprimi juridik është një gjendje e tillë që dëshmon për inekzistencën apo nulitetin, si dhe të pasojave juridike të tyre që në momentin që ato janë kryer. Prandaj, për konstatimin e kësaj pavlefshmërie nuk kërkohet domosdoshmërisht subjekti specifik, i lidhur drejtpërdrejt me aktin ose veprimin. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ e bën çdo organ shtetëror a subjekt juridik e fizik i cili ndeshet me të. Ky lloj konstatimi juridik është një lënie mënjanë e nulitetit të aktit, duke argumentuar arsyet e moszbatimit.

Ndryshon problemi i ligjësimit te pavlefshmëria relative e aktit. Dihen efektet juridike që krijon një akt i tillë deri në çastin e anulimit të tij. Pasojat e aktit relativisht të pavlefshëm janë të ligjshme deri në çastin kur organi kompetent deklaron pafuqinë e tij juridike. Kjo do të thotë se interesi për të kundërshtuar një akt të tillë duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe i specifikuar. Pra, vetëm pala që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga akti, ka të drejtë të kërkojë anulimin e tij në rrugë administrative a gjyqësore.

Përcaktimi i saktë ligjor i konceptit të ligjshmërisë së paditësit nga ana e gjykatës në një mosmarrëveshje civile përbën kushtin kryesor për rregullsinë e një procesi gjyqësor. Kur gjatë gjykimit del se padia është ngritur nga një person që nuk ka të drejtë ta ngrejë, ose është ngritur kundër një personi ndaj të cilit nuk duhej të ngrihej, me kërkesën e palës së interesuar gjykata mund të lejojë zëvendësimin e paditësit ose të të paditurit të parë me paditësin të cilit i përket e drejta që të ngrejë padinë ose me të paditurin kundër të cilit duhej të ngrihej padia. Për këtë zëvendësim gjykata duhet të marrë më parë pëlqimin e të dyja palëve dhe të personit që hyn në vend të tyre si palë (neni 184). Në këtë rast, gjykata merr vendim të ndërmjetëm. Ndryshe qëndron problemi kur palët nuk japin pëlqimin për zëvendësimin. Në rastet kur gjykata konstaton mungesën e ligjshmërisë aktive të paditësit, ajo merr vendim për rrëzimin e padisë. Ky është vendim përfundimtar, sepse e zgjidh çështjen përfundimisht, për sa i përket paditësit konkret. Gjithashtu, ai nuk ka të drejtë të ngrejë një padi të njëjtë me të parën.

Rastet kur gjykata, padrejtësisht, nuk ka ligjësuar individin në një çështje konkrete për të-ngritur një padi, jurisprudenca kushtetuese shqiptare i ka konsideruar si mohim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës e, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 42 të Kushtetuës të Republikës së Shqipërisë.

4.4. Abuzimi me të drejtat procedurale

Personi që abuzon me të drejtën për të ngritur padi, duke qenë i ndërgjegjshëm për pathemelësinë ose pabazueshmërinë në ligj të saj, ose që përdor mashtrimin, mund të dënohet nga gjykata me gjobë deri në 50000 lekë, pa llogaritur shpërblimin e dëmit që mund të kërkohet. Ky është kuptimi që i jep abuzimit të së drejtës procedurale neni 34 i Kodit shqiptar të procedurës civile.

Sipas këtij parimi, palët, përfaqësuesit ligjorë ose avokatët, në ngritjen e padisë duhet të priren nga qëllimi i ligjshëm i palës si dhe etika e morali, të cilat janë aspekte që duhet të karakterizojë një proces gjyqësor. Sipas dispozitës së sipërcituar, palët nuk duhet të ngrenë padi dhe të bëjnë pretendime me dijeninë e tyre dhe me ndërgjegje se janë të gabuara, të pathemelta dhe të padrejta, me qëllim që të dëmtojnë palën tjetër ose të pengojnë zhvillimin normal të procesit gjyqësor. Kjo dispozitë procedurale kërkon domosdoshmërisht paramendimin dhe ndërgjegjësimin e plotë të palës për pathemelësinë dhe pabazueshmërinë në ligj të padisë që në çastin kur padia paraqitet në gjykatë. Zbatimi i kësaj dispozite nuk kryhet në rastet kur nuk ekziston dukshëm ky keqbesim i palës. Kryerja e veprimeve të tilla sjell ndëshkimin materialisht të palës. Caktimi i këtij detyrimi është lënë në vlerësimin e gjykatës, e cila, krahas gjobës, mund të vendosë edhe shpërblimin e dëmit.

Nuk përjashtohen rastet kur pala mund të abuzojë me të drejtën e ngritjes së padisë, por, sidoqoftë, këto ndeshen rrallë në procedurat tona gjyqësore. Gjykatat tona kanë refuzuar ta zbatojnë një dispozitë të tillë dhe, për rrjedhojë, nuk gjenden raste të procedurave haptas të gabuara të zbatimit të ligjit.

Një dispozitë e ngjashme mund të gjendet edhe në Kodin grek të procedurës civile:[9]

"Kodi i procedurës civile i vitit 1967 ka prezantuar për herë të parë në mënyrë të shprehur në proceset civile greke një parim themelor (neni 116), i cili ndalon abuzimin me të drejtat procedurale. Ky parim kërkon që palët, përfaqësuesit ligjorë dhe avokatët e tyre t'i kryejnë procedurat në përputhje me rregullat e moralit të mirë dhe mirëbesimit dhe vendos një detyrim të përgjithshëm që këta individë të thonë të vërtetën. Neni 116 institucionalizon një ndalim konkret të përdorimit të të drejtave të garantuara nga e drejta procedurale për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë këto të drejta. Për shembull, shmangia që i bën pala paditëse bashkimit në një padi të vetme të disa pretendimeve të veçanta kundër së njëjtës palë të paditur, me qëllimin e vetëm për të shmangur kompetencën lëndore të një gjykate më të

9) *Kodi grek i procedurës civile, faqe 198-200.*

lartë, është konsideruar si abuzim. Në aspektin e zbatimit praktik, ndalimi i abuzimit me të drejtat procedurale ka nxjerrë në pah një rëndësi më të madhe për sa u takon procedurave të zbatimit të ligjit.

Por, neni 116 nuk deklaron në mënyrë të shprehur papranueshmërinë e aktit procedural që sjell si pasojë abuzimin me të drejtat; janë parashikuar vetëm gjoba financiare, të cilat jepen rrallë nga gjykatat greke. Për rrjedhojë, ndikimi i tyre praktik është tepër i kufizuar. Kështu, debatet doktrinale që morën shkas nga kodi i vjetër i vitit 1935 lidhur me faktin nëse ndalimi i abuzimit me të drejtat civile, sipas nenit 281 të Kodit Civil, do të shtrihej edhe në fushën e proceseve civile dhe nëse kjo gjë do të çonte në papranueshmërinë e akteve përkatëse, e kanë ruajtur rëndësinë e tyre praktike.

Ndërsa një pjesë e doktrinës greke konsideron se neni 281 i Kodit civil përfshin një fushë të gjerë veprimi, gjykatat greke kanë refuzuar ta zbatojnë atë për sa u takon të drejtave procedurale, me përjashtim të procedurave për zbatimin e ligjit ku neni 281 i Kodit civil kërkohet të zbatohet në bazë të formulimit se këto procedura përfshijnë ushtrimin e të drejtave materiale. Sipas një këndvështrimi më të gjerë, një ndalim i përgjithshëm i abuzimit me të drejtat në të gjitha fushat e së drejtës, pra edhe për të drejtat procedurale, tashmë duhet të pranohet mbi bazën e nenit 25, §3, të Kushtetutës së vitit 1975, sipas të cilit "ushtrimi abuziv i të drejtave nuk është i lejueshëm". Thuajse njëzëri, doktrina ligjore greke ka pranuar se, sipas nenit 116 të Kodit të procedurës civile, mosmarrëveshjet "e pabazuara," d.m.th. abuzimi me drejtën e aksesit në gjykata, sanksionohen edhe nëpërmjet përgjegjësisë së parashikuar në dispozitat e përgjithshme për shpërblimin e dëmit të Kodit civil. Gjithsesi, në jurisprudencën aktuale greke nuk gjenden ilustrime tipike të zbatimit të kësaj përgjegjësie, me përjashtim të disa rasteve të procedurave të pajustifikuara të zbatimit të ligjit. Për më tepër, Areios Pagos ka refuzuar më parë të pranojë riparimin e dëmit të provokuar nga mosmarrëveshjet "e pabazuara" në favor të palës humbëse, si në papajtueshmëri me efektin *res judicata* (gjësë *së gjykuar)* të prodhuar nga marrja e vendimit".

5. Juridiksioni

Termi "juridiksion" është paksa i paqartë dhe mund të përdoret në një sërë kuptimesh të ndryshme, duke krijuar një lloj pështjellimi. Një përshkrim i shkurtër i nuancave të ndryshme të kësaj fjale mund të gjendet në M. Cappelletti, J.M. Perillo, *Procedura civile në Itali:*[10]

10) M. Cappelletti, J.M. Perillo, **Procedura civile në Itali,** *Martinus Nijhoff, Hague, 1965, faqe 80-81.*

"Termi 'juridiksion' përdoret dhe keqpërdoret shpesh: Kuptimi i tij, zakonisht, varion sipas kontekstit në të cilin ai përdoret. Megjithëse, në kuptimin e tij të ngushtë, termi 'juridiksion' përdoret për të përshkruar pushtetet shtetërore – në mënyrë specifike pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor – ky term përdoret për të treguar edhe kompetencat që vetë shteti u jep organeve të tija. Ndoshta, në më të shumtën e rasteve, termi përdoret në kuptimin e dytë për të përshkruar kompetencat e një gjykate të veçantë ose të një lloji të veçantë të gjykatave. Pështjellimi shkaktohet edhe për shkak të përdorimit tepër të gjerë të termit 'juridiksion' për t'iu referuar ushtrimit të një kompetence më shumë sesa vetë kompetencës, për të treguar një territor dhe për të përshkruar kërkesat apo kushtet për ushtrimin e kompetencës.

Për të eliminuar paqartësinë dhe shumëkuptimshmërinë, është përkrahur përdorimi i termit 'juridiksion gjyqësor' për të treguar kompetencën e shtetit për t'ia nënshtruar një individ apo një çështje të caktuar procesit të tij gjyqësor. Juridiksioni gjyqësor i përshkruar në këtë mënyrë kufizohet nga ligji ose kushtetuta e vetë shtetit, apo nga një organ politik më i lartë, sikurse është federata. Po ashtu, ky term mund të kufizohet edhe nga ligjet e shteteve të huaja deri në masën që këto shtete të caktuara pranojnë të njohin kompetencën e një organi politik të huaj për t'ia nënshtruar një individ ose çështje proceseve të tija gjyqësore. Për shembull, e drejta amerikane zbaton kriteret e saja për të vendosur nëse duhet të pranohet ose jo një gjykim/vendim i huaj. Rregullat që përcaktojnë njohjen ose pranimin e kompetencës së një shteti të huaj për t'ia nënshtruar një individ apo çështje proceseve të tija gjyqësore, disa autorë i kanë quajtur edhe si rregullat e "juridiksionit të tërthortë".

Shënim i autorit: *Përkufizimi i dhënë më sipër rezulton në dy lloje të juridiksionit: kombëtar dhe ndërkombëtar. Juridiksioni kombëtar vendos se cila prej degëve të gjyqësorit do të shqyrtojë një çështje të caktuar: gjykatat civile, penale apo administrative. Përcaktimi i kufirit ndarës mes juridiksionit civil dhe administrativ është veçanërisht delikat. Kjo çështje trajtohet me hollësi* në Procedurën civile në Greqi:[11]

"Ndërsa dallimi midis çështjeve penale, nga njëra anë, dhe çështjeve civile ose administrative, nga ana tjetër, nuk ka shkaktuar vështirësi, përcaktimi i kufijve mes juridiksionit të gjykatave civile dhe administrative ka krijuar probleme serioze. Ndarja kushtetuese e juridiksionit, e përmendur më sipër, e ka vendosur përcaktimin e mosmarrëveshjeve si "civile" ose "administrative" në qendër të sistemit gjyqësor grek.

11) Procedura civile në Greqi (cit.), faqe 127-129.

(...) Për këto arsye, akademikët grekë kanë studiuar intensivisht tiparet karakteristike të një mosmarrëveshjeje administrative krahasuar me tiparet e një mosmarrëveshjeje civile. Sipas një opinioni teorik, si dhe të një jurisprudence të qëndrueshme të Këshillit të Shtetit, gjatë dhjetëvjeçarëve të kaluar, të gjitha mosmarrëveshjet që trajtojnë funksionin e një shërbimi publik, duhet të konsiderohen si administrative. Nga ana tjetër, një vendim i rëndësishëm i Areios Pagos dhe disa akademikë të shquar grekë mbështetin një kriter më rigoroz: vetëm mosmarrëveshjet e provokuara nga veprime ose mosveprime të organeve publike gjatë ushtrimit të autoritetit të tyre publik mund të konsiderohen si administrative. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, opinioni mbizotërues ka ndjekur një përkufizim, i cili konsideron si një moment karakteristik të secilës prej mosmarrëveshjeve normat ligjore që duhet të zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Mosmarrëveshjet që rregullohen me norma që i përkasin së drejtës administrative materiale, konsiderohen si administrative dhe ato që i përkasin juridiksionit të gjykatave administrative. Nga ana tjetër, nëse aplikohet e drejta private, mund të flasim vetëm për mosmarrëveshje civile.

Sipas mendimit mbizotërues, dallimi midis një mosmarrëveshjeje administrative të "juridiksionit të plotë" ose të "anulimit" trajton vetëm shkallën e kompetencave që i lejohen gjykatës, kryesisht për sa i takon faktit nëse ky juridiksion kufizohet vetëm në anulimin e një akti të paligjshëm apo, përkundrazi, ai përfshin edhe gjykimin e mëtejshëm mbi të drejtat e palës së dëmtuar dhe dëmet që i janë shkaktuar asaj nga një veprim administrativ i paligjshëm. Sipas nenit 95, §1.a, të Kushtetutës së vitit 1975, kundërshtimet e akteve administrative të paligjshme, të cilat sillen para Këshillit të Shtetit mbi bazën e shkeljes së ligjit, përkufizohen si mosmarrëveshje të anulimit, duke qenë se kjo gjykatë e shkallës së parë apo gjykatat e apelit (me disa përjashtime) gëzojnë juridiksion të plotë, gjë që do të thotë se, përveç anulimit të akteve të paligjshme, ky juridiksion përfshin edhe gjykimin mbi pretendimet e palëve.

Pavarësisht mbështetjeve teorike, vështirësitë e përkufizimit të saktë të mosmarrëveshjeve civile apo administrative vazhdojnë të ekzistojnë; kjo do të thotë se vazhdojnë të shfaqen edhe konfliktet e juridiksionit mes gjykatave civile dhe administrative. Në më të shumtën e rasteve, konfliktet shkaktohen nga karakteri i veçantë i palëve, të cilat, si persona juridikë të së drejtës private, janë të ngarkuara me detyra që përfshijnë edhe autoritetin publik. Në një rast të tillë, Gjykata e Lartë Speciale ngarkohet me detyrën e përcaktimit të juridiksionit të duhur duke përkufizuar saktë natyrën e mosmarrëveshjes së kontestuar, si civile apo administrative. Në bazë të një dispozite të shprehur

kushtetuese (neni 17, § 4.a), mosmarrëveshjet që përfshijnë përcaktimin e kompensimit për pronën e konfiskuar, pavarësisht karakterit të tyre administrativ, kanë mbetur në mënyrë të përjashtimore nën juridiksionin e gjykatave civile".

Krahasuar me "juridiksionin kombëtar", "juridiksioni ndërkombëtar" nënkupton tërësinë e normave që përcaktojnë rastet se kur një i huaj mund të paditet në gjykatat vendëse. Sipas *Enciklopedisë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* (cit.):[12]

"Asnjë prej sistemeve ligjore të trajtuara më sipër nuk përmban norma të përgjithshme të shprehura që të përcaktojnë kufirin ndarës mes juridiksionit kombëtar dhe juridiksionit ndërkombëtar. Në mënyrë më specifike, asnjë normë e shprehur nuk përcakton rrethanat në të cilat një i huaj mund të paditet në një gjykatë vendëse. Kështu, kompetenca e një gjykate vendëse për të gjykuar çështje që përmbajnë elementë të huaj duhet të derivojë nga struktura e normave ligjore që përcaktojnë kompetencën tokësore të gjykatave. Për rrjedhojë, kompetenca tokësore zakonisht përfshin edhe juridiksionin ndërkombëtar, me përjashtim të rasteve kur ky i fundit është përjashtuar shprehimisht, si për shembull, në rastin e diplomatëve, personave me imunitet apo përjashtimeve të tjera. Gjithsesi, në çështje të caktuara, p.sh., në lidhjet martesore, ekzistojnë dispozita specifike që rregullojnë juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave vendëse".

Shënim i autorit: *Konventa e Brukselit, e datës 27 shtator 1968, "Për juridiksionin dhe ekzekutimin e vendimeve të çështjeve civile dhe tregtare", ka pasur ndikim shumë të madh mbi këtë çështje. Konventa e konsideron vendbanimin si kriter të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit. Kështu, një individ mund të paditet në gjykatat vendëse nëse ai/ajo ka banimin (apo selinë në rastin e personave juridikë) në këtë vend. Megjithatë, është e drejta kombëtare e çdo shteti palë të përcaktojë nëse një individ do ta ketë ose jo vendbanimin brenda territorit të tij. Përveç rregullës së përgjithshme të sipërpërmendur, konventa e Brukselit vendos edhe një sërë rregullash të tjera të veçanta.*

Kodi shqiptar i procedurës civile, në nenet 39 dhe 40, parashikon shprehimisht imunitetin e anëtarëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur gjykimi zhvillohet për objekte - pasuri të paluajtshme – të ndodhura në Shqipëri. Për më tepër, përfaqësuesit e shteteve të tjera dhe grupet e tyre të shoqërimit nuk

---

*12) **Enciklopedia ndërkombëtare e së drejtës së krahasuar** (cit.), faqe 114.*

mund të paditen në gjykatat shqiptare kur ata qëndrojnë me ftesë zyrtare të Republikës së Shqipërisë.[13] Është e vlefshme t'i referohemi edhe zhvillimit të normave italiane për imunitetin e përfaqësive diplomatike, sikurse përshkruhet në procedurën civile në Itali:

"Doktrina tradicionale e imunitetit kryesisht ka lindur nga e drejta zakonore ndërkombëtare. Ajo mbronte shtetet e huaja, kryetarët e shteteve, agjentët diplomatikë dhe familjet e tyre nga paditja, por nuk kufizonte të drejtën e tyre për të ngritur padi. Për dhjetëra vite, gjykatat italiane e kanë kufizuar fushën e veprimit të imunitetit. Aktualisht, shtetet e huaja i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave italiane për veprimet që ato kryejnë, sikur të ishin persona privatë".

Shënim i autorit: *Sipas së drejtës italiane, shtetet e huaja janë të pajisura me imunitet vetëm për veprime "iure imperi" ose, me fjalë të tjera, për veprime që janë shprehje e sovranitetit të shtetit. Për shembull, gjykata italiane e kasacionit ka vendosur se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të paditen në një gjykatë italiane për shërbimet e avionëve të tyre ushtarakë në territorin italian sipas Marrëveshjes së Atlantikut Verior.*[14]

"Gjykatat italiane kanë arsyetuar se teoria tradicionale e imunitetit të shteteve të huaja daton nga periudha kur shtetet ishin të pajisura me imunitet nga paditja edhe në gjykatat e tyre. Duke qenë se Italia, ashtu sikurse pjesa më e madhe e shteteve moderne, ka pranuar të paditet, gjykatat kanë arsyetuar se parimi i barazisë mes shteteve nuk cenohet nëse lejohet paditja e shteteve të huaja në gjykatat italiane. Legjislativi është përpjekur të zbutë efektet e kësaj doktrine duke kërkuar që, nëse shteti tjetër garanton mbrojtje të ndërsjellë, të merret pëlqimi paraprak i ministrit të Drejtësisë përpara sekuestrimit, ngrirjes apo vendosjes së gjobës mbi pronën e shtetit të huaj".

Shënim i autorit: *Kërkesa për autorizimin e ministrit të Drejtësisë është shpallur si antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese italiane.*[15]

Së fundi, është me interes të sjellim këtu nenin 37 të Kodit shqiptar të procedurës civile, i cili kundërshton mundësinë e kalimit të juridiksionit të gjykatave shqiptare me marrëveshje një juridiksioni të huaj, me përjashtim të

13) Kjo çështje do të shtjellohet më hollësisht në vijim të këtij kreu.

14) Gjykata e kasacionit, 3 gusht 2000, nr. 530 në Drejtësinë civile, 2001, I, 747.

15) Gjykata Kushtetuese, 15 korrik 1992 nr. 329, në Revistën e së drejtës ndërkombëtare, 1992, 395.

rasteve kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si edhe kur këto përjashtime janë të parashikuara në marrëveshje.

Një dispozitë shumë e ngjashme ka qenë e parashikuar në nenin 4 të Kodit italian të procedurës civile dhe është shfuqizuar me ligjin nr.218, datë 31.5.1995. Aktualisht, sipas ligjit të lartpërmendur, juridiksioni italian mund të kalohet me marrëveshje vetëm me dy kufizime: të drejtat që diskutohen duhet të jenë të disponueshme dhe marrëveshja duhet të jetë me shkrim. Me fjalë të tjera, edhe dy shtetas italianë mund të zgjedhin me marrëveshje ta adresojnë çështjen para një gjykate të një shteti tjetër, nëse gjykata e pranon juridiksionin.

6. Juridiksioni sipas legjislacionit shqiptar

Me juridiksion kuptohet ndarja e formave kryesore të ushtrimit të veprimtarisë shtetërore. Termi *"juridiksion"* nënkupton, gjithashtu, edhe shqyrtimin e çështjeve brenda një territori ose hapësirave të një veprimtarie të caktuar institucionale. Pra, në këtë mënyrë, juridiksioni paraqitet si ushtrim i një lloji veprimtarie juridike sipas një ndarjeje të përcaktuar pushtetesh dhe brenda një hapësire të kufizuar territoriale.

Termi juridiksion shpeshherë ngatërrohet me kompetencën. Në të vërtetë, këta terma janë shumë të përafërt me njëri-tjetrin, por nuk janë të njëjtë. Në disa legjislacione të huaja ky dallim ndërmjet tyre nuk bëhet. Legjislacioni ynë, po ashtu edhe doktrina, janë përpjekur të nxjerrin në pah se midis tyre ka veçori. Kodi i procedurës civile dhe Kodi i procedurave administrative japin disa formulime për ta, por nuk marrin përsipër të qartësojnë specifikën e tyre.

Aftësia e një organi administrativ të njohur nga ligji për ushtrimin e funksioneve administrative, nëpërmjet nxjerrjes së akteve administrative, e bën atë kompetent. Kur themi, p.sh., se një çështje është në kompetencën e gjykatës ose në kompetencën e një organi administrativ, si p.sh. të Këshillit të Ministrave ose të bashkisë, në të vërtetë kemi gabuar, sepse në këto raste nuk e kemi kuptuar drejt kompetencën e organit. Duhet të kemi parasysh se jemi duke bërë fjalë për konceptin juridiksion dhe se ajo çështje është në juridiksionin gjyqësor ose në juridiksionin administrativ. Në rast se themi se ky ose ai organ administrativ ka të drejtë të zgjidhë këtë ose atë çështje, atëherë mund të arrijmë në përfundimin se e kemi kuptuar që bëhet fjalë për kompetencën e organit të administratës.

Kuptimi për juridiksionin jepet *sipas nënndarjes së veprimtarisë shtetërore* në tri pushtete. Nga kjo nëndarje dallojmë: *juridiksionin legjislativ, ekzekutiv* dhe *gjyqësor.*

Hartimi i rregullave të përgjithshme hyn në juridiksionin e pushtetit legjislativ; marrja e masave për sigurimin e zbatimit në praktikë të këtyre rregullave është në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv dhe zgjidhja e konflikteve të veçanta nën dritën e rregullave të përgjithshme është në juridiksionin gjyqësor.[16].

"Sipas mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ushtrimit të kontrollit mbi ligjshmërinë e aktit kemi një ndarje tjetër juridiksionesh. Një mosmarrëveshje civile është objekt i juridiksionit gjyqësor, ndërsa një mosmarrëveshje e natyrës administrative mund të bëhet objekt i *juridiksionit administrativ, gjyqësor* ose *kushtetues.*

Ndarja e juridiksionit administrativ nga juridiksioni gjyqësor bazohet jo vetëm në doktrinën e ndarjes së pushteteve, por edhe në dallimin që ekziston midis së drejtës private dhe asaj publike. Konfliktet që lindin nga veprimtaria e autoriteteve shtetërore, kur bazohen në të drejtën private, nuk janë konflikte të natyrës të së drejtës publike. Ato nuk i nënshtrohen juridiksionit administrativ, por do t'i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor.

Në juridiksionin gjyqësor hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet penale dhe civile që parashikohen në kodet dhe ligjet përkatëse. Kur një çështje është në juridiksionin e një organi, nuk mund të shqyrtohet njëkohësisht nga një juridiksion tjetër. Asnjë institucion tjetër, thuhet në nenin 36 të Kodit të procedurës civile, nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Kështu p.sh., ndërkohë që gjykata shqyrton një konflikt civil ndërmjet dy palëve me objekt, si p.sh. detyrimin e të paditurit të lirojë dhe të dorëzojë banesën, kryefari i bashkisë nxjerr një urdhër administrativ për lirimin e këtij objekti.[17] Vlen t'i referohemi një vendimi të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në të cilin, ndërmjet të tjerave, arsyetohet: "Zgjidhja e mosmarrëveshjeve juridiko-civile nuk është në juridiksionin administrativ... Në rastin në shqyrtim, nga i padituri është pretenduar se banon në banesë, në bazë të një kontrate qiraje dhe se prona nuk i është kthyer paditësit në bazë të ligjit, ndërsa paditësi ka pretenduar qenien e tij pronar dhe ka kërkuar lirimin e dorëzimin e saj. Që nga viti 1971 ka qenë gjykata ajo që ka shqyrtuar kërkimet e palëve në gjykim duke marrë vendimet përkatëse. Fakti që këto vendime nuk janë zbatuar, nuk përligj bashkinë të nxjerrë urdhër administrativ. Pra, urdhri i kryetarit të bashkisë, edhe në këtë aspekt, nuk ka bazë ligjore."[18] Gjithashtu, nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor një konflikt administrativ, pa ezauruar më parë të gjitha rrugët që kërkon

16) Komentar, Kodi i procedurave administrative, viti 2004, faqe 54.

17) Sokol Sadushi, E drejta administrative, botim i vitit 2005, faqe 99.

18) Shih më gjerë vendimin nr. 1071, datë 7.11.2000, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

juridiksioni administrativ. Kështu p.sh., një subjekt juridik, pa e parapaguar detyrimin tatimor, nuk mund t'i drejtohet gjykatës me padi me objekt anulimin e aktit administrativ[19].

Edhe konfliktet e së drejtës ndërkombëtare nuk trajtohen nga juridiksioni administrativ ose gjyqësor, i cili shtrihet vetëm te çështjet kombëtare. Ka rregulla të veçanta për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare te juridiksioni i huaj dhe anasjelltas.

Juridiksioni kuptohet edhe si ndarje e gjerë e veprimtarisë shtetërore në formën e fushave ku ushtrohet kjo veprimtari. Kjo ndarje bëhet për sektorë të tillë, si: ekonomia, financa, mbrojtja, transporti publik, drejtësia, rendi etj. Kështu, p.sh., një mosmarrëveshje që lind midis subjekteve të ndryshme për aspekte të përcaktimit të detyrimeve tatimore ose doganore, hyn, në kuptimin e gjerë, në juridiksionin administrativ dhe, në kuptimin e ngushtë, në juridiksionin e Ministrisë së Financave.

Koncepti i juridiksionit përdoret edhe për të përcaktuar ndarjen territoriale brenda kufijve të së cilës vepron organi administrativ që duhet të zgjidhë çështjen konkrete. Kështu, p.sh., shpesh përdoret terminologjia se kjo çështje hyn në juridiksionin e policisë ndërtimore ose të bashkisë. Juridiksioni territorial, si term, përdoret shpesh në legjislacion.

Detyrë fillestare e gjykatës është *verifikimi i juridiksionit përkatës.* Përpara se të fillojë një proces, gjykata duhet të saktësojë nëse ka juridiksion që të vendosë për çështjen. Juridiksioni gjyqësor vendoset në çastin kur paraqitet kërkesa për zgjidhjen e një çështjeje e në vazhdimësi të procesit. Sipas nenit 59 të Kodit të procedurës civile, *gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ.* Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.

Pranohet se midis organeve administrative dhe gjykatës për një çështje të caktuar mund të lindin konflikte për juridiksionin. Secili prej këtyre organeve mund të pretendojë se çështja në shqyrtim hyn ose jo në juridiksionin e tij. E drejta procedurale shqiptare nuk e lejon konfliktin e juridiksionit ose, edhe nëse ndodh një gjë e tillë, përpiqet t'i japë një zgjidhje përfundimtare. Neni 36 i Kodit të procedurës civile parashikon se asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Kjo dispozitë nënkupton se vendimi që merr gjykata, është i

19) Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 18, date 17.11.2004, Përmbledhje e vendimeve, viti 2004.

detyrueshëm për çdo organ. Nga kjo pikëpamje, konflikti i juridiksionit nuk mund të konsiderohet si konflikt i pazgjidhshëm, për arsye se në nenin 60 të këtij Kodi parashikohet se, *kur një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për një shqyrtim, hyn në juridiksionin administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet nga Gjykata e Lartë me kërkesën e institucionit shtetëror. Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë masa vetëm për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin.* Megjithatë dispozitat ligjore nuk shmangin zvarritjet që mund t'i vijnë procesit nga pretendimet që kanë palët për çështje të juridiksionit.

Dispozitat procedurale nuk e lejojnë lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet palëve për çështje të cilat bien në kundërshtim me rregullat që përcaktojnë juridiksionin gjyqësor civil. Gjithashtu, palët nuk mund të lidhin marrëveshje për t'i kaluar juridiksionin e gjykatave shqiptare një juridiksioni të huaj. Përjashtimi bëhet vetëm për raste kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personit juridik pa banim a qëndrim në Shqipëri, si edhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Kodi i procedurës civile, në nenin 39 dhe 40, parashikon çështjen e juridiksionit të gjykatave shqiptare ndaj përfaqësuesve diplomatikë e konsullorë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe grupeve të tyre të shoqërimit kur janë të ftuar zyrtarisht. Këta përfaqësues nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përjashtimisht rasteve kur ata pranojnë vullnetarisht si dhe kur ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga konventa e Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike".

Vlen për të ilustruar rastin në shqyrtim një referencë tek një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i cili ka pasur për objekt çështjen e shtrirjes së juridiksionit të gjykatave shqiptare ndaj përfaqësuesve diplomatikë. Në këtë gjykim kushtetues pala kërkonte detyrimin e ministrit të Drejtësisë të jepte lejen për ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor.

Konkretisht, gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr.1808, datë 24.4.1997, kishte vendosur detyrimin e ambasadorit të Republikës Italiane që të paguante në favor të kërkuesve qiranë e truallit të rezidencës në shumën 3424 dollarë amerikanë në muaj. Vendimi kishte marrë formë të prerë dhe zyra e përmbarimit, Tiranë, në përputhje me kërkesat e nenit 526 të Kodit të procedurës civile, i kishte kërkuar ministrit të Drejtësisë dhënien e lejes për ekzekutim.

Për zgjidhjen e drejtë të çështjes, Gjykata Kushtetuese iu referua konventës së Vjenës, datë 18 prill 1961, "Për marrëdhëniet diplomatike", në të cilën shteti shqiptar është palë. Sipas konventës së Vjenës, agjenti diplomatik, i

cili, me disa përjashtime, që përmenden në nenin 31/1, gëzon imunitetin e juridiksionit penal, civil dhe administrativ të shtetit pritës. Ky parim i konventës është sanksionuar edhe në nenin 39 të Kodit të procedurës civile, sipas të cilit anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur pranojnë vullnetarisht ose kur objekti i padisë ka të bëjë me sende të paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë (neni 39, aktualisht ka ndryshuar në shkronjën "b"). Sipas nenit 31/1, germa "a" dhe nenit 1/ë të konventës së Vjenës, agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit për veprime lidhur me një ndërtesë private ose terrenin përkatës që ndodhet në territorin e shtetit pritës, kur e posedon atë për llogari të shtetit akreditues për qëllimet e misionit.

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese, ndërmjet të tjerave, arsyeton: " Në këto rrethana, duke pasur parasysh hierarkinë e akteve normative sipas neneve 116 dhe 122/2 të Kushtetutës, marrëveshja ndërkombëtare ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Prandaj, në këtë rast, do të zbatohen kërkesat e nenit 31/1, germa "a", të konventës së Vjenës. Për sa i përket pretendimit të kërkuesve se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore vjen në kundërshtim me nenin 142/3 të Kushtetutës, për rastin konkret, ai është i pabazuar. Sipas kësaj dispozite, asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Por, në rastin konkret, organet përkatëse shtetërore shqiptare nuk mund t'i marrin ato masa, sepse i pengojnë detyrimet që ka marrë shteti shqiptar, sipas konventës së Vjenës dhe frymës së Kushtetutës. Prandaj, kërkesa e kërkuesve (...) duhet të rrëzohet si e pabazuar".[20]

7. Kompetenca

Juridiksioni, në kuptimin e "juridiksionit gjyqësor" të shpjeguar më sipër, duhet të dallohet nga termi "kompetencë." Ky i fundit tregon "kompetencën që legjislatura u ka dhënë gjykatave për të shqyrtuar çështjet që paraqiten para tyre. Më konkretisht, është mbështetur ideja që termi "kompetencë e përgjithshme" të përdoret për të përshkruar kompetencën e përgjithshme të pushtetit gjyqësor, për t'ia nënshtruar individë apo çështje të caktuara proceseve

20) Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 11, datë 10.3.2000, Përmbledhje vendimesh, viti 2000-2001, faqe 25.

të tija gjyqësore, dhe termi "kompetencë specifike" të përdoret për të përshkruar kompetencën që ka një gjykatë e veçantë për të dëgjuar një çështje të caktuar. Nga ana e saj, "kompetenca specifike" përmbledh dy koncepte të veçanta: "kompetenca në lëndë," e cila i referohet kompetencës së gjykatës për të shqyrtuar çështje me karakter të veçantë ose me vlerë monetare, dhe "kompetenca tokësore," e cila tregon kompetencën e një gjykate për të shqyrtuar çështje për shkak të vendndodhjes gjeografike të individëve, sendeve apo ngjarjeve që përfshihen në procesin gjyqësor. Kompetencat tokësore quhet ndryshe edhe vendore".

Shënim i autorit: *Kodi shqiptar i procedurës civile e trajton kompetencën në lëndë në një mënyrë shumë të drejtpërdrejtë dhe të thjeshtë. Sipas nenit 41, të gjitha mosmarrëveshjet civile janë në kompetencën e gjykatave të shkallës së parë. Për qëllimet tona studimore, kompetenca tokësore, dispozitat e së cilës janë edhe më të specifikuara, paraqet më shumë interes. Rregulla e përgjithshme është se gjykata kompetente është gjykata e vendit ku i padituri ka vendqëndrimin ose vendbanimin dhe, kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme.*

Sigurisht, nëse i padituri është person juridik, faktori vendimtar për përcaktimin e kompetencës së gjykatës është vendi ku personi juridik ka qendrën (selinë) e tij. Gjithsesi, si në shumë sisteme të tjera ligjore, ekzistojnë një sërë rastesh përjashtimore, për shembull, kur mosmarrëveshja ka të bëjë me të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme, kompetenca i përket gjykatës së vendit ku ndodhet objekti, ose pjesa më e madhe e tij. Përjashtime të tjera lidhen me rastet kur paditë rrjedhin nga trashëgimia, kallëzimi i një punimi të ri apo nga marrëdhëniet e punës. Si në pjesën më të madhe të sistemeve ligjore, Kodi shqiptar i procedurës civile e lejon ndryshimin e kompetencës tokësore me marrëveshje ndërmjet palëve. Po, marrëveshja duhet të jetë me shkrim dhe kompetenca nuk mund të ndryshohet në rastet e rregulluara nga neni 45 (të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme, kallëzimi i punimeve të reja) dhe neni 46 (paditë që rrjedhin nga trashëgimia dhe pavlefshmëria e testamentit). Do të ishte me interes këtu të shihnim si trajtohet kjo gjë nga e drejta greke. Procedura civile në Greqi, cit.:[21]

"Si rregull, kompetenca tokësore përcaktohet me ligj. Rregullime të tilla ligjore bazohen mbi qëndrueshmërinë e lidhjeve ndërmjet palëve ndërgjyqëse ose objektit të padisë me një vend të caktuar. Në rrethana të caktuara,

21) ***Procedura civile në Greqi,*** *cit. faqe. 141-142.*

kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje ndërmjet palëve (nenet 42–44 të Kodit të procedurës civile: *forum conventionale vel prorogatum*, ndërprerje e juridiksionit) ose vetëm përjashtimisht mund të përcaktohet me vendim gjykate (nenet 46, 48–51 të Kodit të procedurës civile: *forum judiciale*, juridiksioni gjyqësor). Sipas së drejtës greke, qenia e një individi në një vend të caktuar dhe mundësia e tij për të siguruar shërbime nuk janë as të mjaftueshme, as të nevojshme për përcaktimin e kompetencës tokësore. Doktrina e *forum non conveniens* nuk është zhvilluar në Greqi. Një gjykatë me kompetencë tokësore duhet ta dëgjojë patjetër çështjen që paraqitet para saj, pavarësisht nga pasojat që mund të sjellë kjo gjë.

Kompetenca tokësore mund të jetë e përgjithshme ose specifike. Juridiksioni që lidhet me individin, përkufizohet si i përgjithshëm kur mbulon të gjitha paditë që ngrihen kundër tij, me përjashtim të rastit kur ekziston një juridiksion ekskluziv i veçantë. Qëllimi i këtij juridiksioni të përgjithshëm është të shmangë mungesën e gjykatave me kompetencë tokësore. Nga ana tjetër, juridiksioni specifik i referohet një kompleksiteti mosmarrëveshjesh, të cilat, mbi bazën e dispozitave ligjore të veçanta, sillen para gjykatave të përcaktuara shprehimisht më shumë sesa para gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, në varësi të lidhjes që ekziston mes distrikteve të këtyre gjykatave dhe pretendimit që kontestohet.

Më tej, juridiksionet speciale ndahen në juridiksione konkurruese dhe juridiksione ekskluzive. Juridiksioni special konkurrues mund të bashkëjetojë me juridiksionin e përgjithshëm të një individi, madje edhe me juridiksione të tjera konkurruese, në kuptimin që ai lejon zgjedhjen midis gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave me juridiksion special. Kodi grek i procedurës civile ka prezantuar gjashtë kategori të juridiksioneve konkurruese (nenet 33, 35 – 40).

Ndryshe nga juridiksioni konkurrues, juridiksioni ekskluziv është i detyrueshëm, pasi ai përjashton, si juridiksionin e përgjithshëm, ashtu edhe çdo juridiksion tjetër special (konkurrues ose ekskluziv). Në Kodin e procedurës civile janë parashikuar edhe gjashtë kategori të tjera të juridiksionit ekskluziv (nenet 27 – 31, 34, 933).

Në rastin e bashkëjetesës së disa juridiksioneve konkurruese, është e drejta e palës paditëse të zgjedhë atë që e gjykon si më të përshtatshëm (neni 41 i Kodit të procedurës civile). Po ashtu, ky është edhe momenti më i përshtatshëm për të përcaktuar padinë kryesore ndaj padive të tjera që mund të ngrihen (neni 41).

8. Kompetenca sipas legjislacionit shqiptar

Kompetenca është e drejta dhe detyra e një organi për të ushtruar veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të ligjit. Kjo veprimtari e organit kompetent shprehet në tërësinë e akteve dhe të veprimeve që ato kryejnë dhe nëpërmjet të cilave formohet dhe shfaqet vullneti. Pra, kompetenca i kufizon hapësirën e veprimit organit të kryejë funksionet ose të ndërhyjë në të drejtat dhe atributet që me ligj i janë caktuar një organi tjetër. Nëse kuptohen drejt kompetencat e çdo organi dhe nëse ato arrihen të zbatohen saktësisht dhe në përputhje me kërkesat e ligjit, atëherë paligjshmëria dhe shpërdorimi mënjanohen.

Kompetenca përbën për organin jo vetëm të drejtën ligjore për të kryer një veprimtari konkrete, por edhe detyrim për ta ushtruar këtë veprimtari. E drejta e gjykatës është të shqyrtojë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në Kodin e procedurës civile e në ligje të tjera. Njëkohësisht, kjo e drejtë e gjykatës është e ndërthurur edhe me detyrimin se ajo se nuk mund të refuzojë shqyrtimin e saj, me përjashtim të rasteve që parashikohen shprehimisht në Kod. Pra, gjykata nuk mund të shmanget nga kryerja e veprimtarisë të përcaktuar me ligj. Legjislacioni ynë procedural imponon gjykatën t'i japë zgjidhje çdo mosmarrëveshjeje civile që i paraqitet për shqyrtim.

Kompetenca nuk e kufizon gjykatën që ta përdorë këtë atribut ligjor vetëm për një periudhë të kufizuar. Ajo është një e drejtë që i njihet asaj për të vepruar në vazhdimësi dhe nuk është e kushtëzuar me element kohor. Kompetenca është e rëndësishme për t'u njohur edhe për arsye se një koncept më i qartë për të shmang në praktikë shumë mosmarrëveshje dhe konflikte artificiale që krijohen midis gjykatës dhe organeve administrative.

Kompetenca paraqitet në disa lloje:

a) Kompetenca lëndore

Për përcaktimin e kompetencës lëndore merret si kriter përmbajtja ose natyra e çështjeve që zgjidhen nga gjykata. Kompetenca lëndore nënkupton të drejtën dhe detyrën e gjykatës mbi lëndën e caktuar. Në këtë kuptim, gjykatat kanë të drejtë të ushtrojnë funksionet e tyre brenda rrethit të kompetencave, që ligji u njeh, pa ndërhyrë në kompetencat e organeve të tjera. Neni 41 i Kodit të procedurës civile njeh kompetencën lëndore të gjykatave të shkallës së parë për të gjitha mosmarrëveshjet civile ose mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera. Nenet 452 e vijuese të Kodit njohin kompetencën lëndore të gjykatës së apelit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës së parë. Gjithashtu, në disa dispozita procedurale të Kodit, si në nenet 60, 62, 64 dhe 472 e vijuese, parashikohet kompetenca lëndore e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar ankimet për konfliktet e kompetencave dhe të juridiksionit, si dhe rekurset ndaj vendimeve të gjykatave të apelit.

b) Kompetenca tokësore

Çdo gjykatë vepron në hapësirën juridiksionale të një territori të përcaktuar nga ligji. Elementi përcaktues për të dalluar këtë lloj kompetence nga të tjerat janë kufijtë territorialë dhe juridiksionalë, brenda të cilëve kryhet veprimtaria e gjykatës. Për të përcaktuar kompetencën tokësore është e domosdoshme njohja e disa kritereve. Duke iu referuar dispozitave të Kodit të procedurës civile, konstatohet se kriteri që ka vendosur ligji, bëhet përcaktues për shqyrtimin e çështjes në këtë gjykatë dhe jo në një tjetër. Kriteret janë: vendbanimi ose vendqëndrimi, vendndodhja e pasurisë ose e pjesës më të madhe të saj, vendi i vërtetimit të një ngjarjeje ose fakti me efekte juridike, vendi i përmbushjes së një detyrimi ose vendi i ekzekutimit etj. Për caktimin e kompetencës tokësore këto kritere nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin, por, në varësi të ekzistencës së disa elementeve të tjera, ato mund të përzgjidhen. Këtu ndikon lidhja që kanë palët me njëra-tjetrën, mosha e tyre, personaliteti juridik, zotësia për të vepruar, objekti i padisë, si dhe ekzistenca e marrëveshjes.

Pra, nga këto kritere që parashikon Kodi, rezulton se kompetenca tokësore përcaktohet me ligj. Megjithatë, kompetencën tokësore në përputhje me ligjin mund ta përcaktojnë palët me marrëveshje midis tyre ose edhe vetë gjykata (neni 52 dhe 56). Sidoqoftë, e drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë (neni 54).

Mbi bazën e këtyre kritereve, padia mund të ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri dhe, kur nuk ka vendbanim, vendqëndrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, padia ngrihet në gjykatën e vendit ku banon paditësi (neni 42). Për sa u përket padive kundër personave juridikë ato ngrihen në gjykatën e vendit ku ai ka qendrën e tij. Kjo konsiderohet si kompetencë e përgjithshme.

Padi të tjera ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet, ose është vërtetuar një ngjarje apo fakt me efekt juridik, si p.sh. shkaktimi i një dëmi, kallëzimi i një punimi të ri etj. (neni 45). Kjo është një kompetencë e veçantë.

Njihet sipas Kodit *kompetenca alternative* ose *konkurruese* në rastet kur paditë që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit, ngrihen, si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu edhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi (neni 48); paditë për kërkim ushqimi dhe paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, mund të ngrihen, si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu edhe paditësi (neni 47); paditë për vërtetimin e qenies ose të mosqenies së martesës, për anulimin e

martesës dhe për zgjidhjen e saj mund të ngrihen, si në gjykatën e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët, ashtu edhe në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri (neni 51). Në nenin 48, paragrafi i dytë, parashikohet edhe një alternativë e tretë në rastin e ngritjes së padisë për kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit *edhe* në gjykatën e vendit ku banon paditësi. Pra, parashikohet ngritja e padisë në një nga gjykatat e vendit ku ka banimin i padituri, paditësi, ose është shkaktuar dëmi. Kompetenca alternative në këtë rast është ndërmjet tri gjykatave. Jemi përpara kompetencës alternative edhe kur ndaj shumë të paditurve që kanë vendbanime të ndryshme, zgjidhet një nga gjykatat e vendit ku banon cilido prej tyre (neni 53).

Kodi njeh edhe kompetencën ekskluzive, kur ngritja e padisë bëhet vetëm në një gjykatë të përcaktuar. Sipas nenit 44 të tij, paditë kundër të miturve që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç ose kundër personave të cilëve u është hequr krejtësisht zotësia për të vepruar, ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin përfaqësuesi i tyre ligjor. Paditë që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbaruesi për ekzekutimin e detyruar, ngrihen në gjykatën e vendit të ekzekutimit (neni 50). Lidhur me rastin kur vendi i ekzekutimit të detyrimit nuk është i caktuar nga ligji, nga kontrata ose nga vetë natyra e detyrimit, sipas nenit 461 të Kodit civil, ekzekutimi bëhet në vende të ndryshme. Megjithatë kjo kompetencë mbetet ekskluzive, sepse është vetë ligji që, në varësi të llojit të ekzekutimit, përcakton edhe vendin se ku kryhet.

Gjithashtu, njihet e drejta e palëve për të përcaktuar me marrëveshje me shkrim kompetencën tokësore. Kjo marrëveshje është e zbatueshme me përjashtim të padive që ngrihen për kërkimin e të drejtave reale mbi sendet e paluajtshme, për pjesëtimin ose posedimin e sendeve të përbashkëta, si dhe për pavlefshmërinë e testamentit dhe për pjesëtimin e trashëgimit (nenet 45, 46). E drejta e palëve për të caktuar me marrëveshje me shkrim gjykatën kompetente nuk mund të jetë e pakufizuar. Sigurisht, palët duhet të kenë parasysh ligjin si dhe kompetencën lëndore të gjykatës. Nuk mund të bëhet kompetente me anë të marrëveshjes, si p.sh. një gjykatë e shkallës së dytë ose Gjykata e Lartë.

Gjykata mund të përcaktojë edhe vetë kompetencën tokësore të një gjykate tjetër kur konstaton se në këtë gjykatë mosmarrëveshja mund të zgjidhet më shpejt dhe më lehtë sesa në gjykatën e zgjedhur nga paditësi (neni 56). Gjithashtu, për arsye të lidhjes që mund të ketë padia kryesore me kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore, gjykata që është kompetente për shqyrtimin e çështjes, mund të shqyrtojë edhe një çështje tjetër për të cilën nuk është kompetente. Në këtë rast ajo merr vendim për gjykimin e tyre në një çështje të vetme (neni 55).

9. Veprimet e gjykatave në lidhje me kompetencën. Konfliktet e kompetencës

Kodi shqiptar i procedurës civile, në nenet 59 e vijuese, ka parashikuar së bashku rastet kur kundërshtohet juridiksioni dhe kompetenca. Sipas nenit 61 dhe 62, kur gjykata konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente. Kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.

Gjykata mund të vendosë për moskompetencën, si në veprimet përgatitore (neni 158/a), ashtu edhe gjatë seancës gjyqësore. Kodi shprehet në nenet 62 dhe 158/a vetëm për ankimin ndaj vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën duke e lënë të patrajtuar rastin kur gjykata rrëzon kërkesën e palës për moskompetencën dhe vazhdon shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Ankimi për këtë rast do t'i bashkohet ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

Neni 56 parashikon një tjetër rast kur gjykata vendos për kompetencën. Rregulla që parashikohet në këtë nen, nuk është e njëjtë me rastin e mësipërm kur gjykata vendos moskompetencën. Në dallim nga neni 61, gjykata e konsideron veten kompetente, por, me kërkesë të palëve, mund të vendos dërgimin e çështjes në një tjetër gjykatë kompetente për dy arsye:

- në gjykatën tjetër mosmarrëveshja mund të zgjidhet më shpejt dhe më lehtë sesa në gjykatën e zgjedhur nga palët;
- shihet me vend kërkesa e të padituri, të cilit nuk i dihej vendbanimi ose vendqëndrimi, për gjykimin e mosmarrëveshjes në gjykatën e vendit ku ai ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tanishëm.

Dërgimi i çështjes në gjykatën kompetente sipas nenit 56 të këtij Kodi duhet të bëhet domosdoshmërisht në gjykatën që ka kompetencë lëndore dhe tokësore. Pra, ligji kërkon që çështja në shqyrtim duhet të ndodhet përpara rastit të kompetencës alternative ose konkurruese.

Neni 64 i Kodit parashikon mënyrën si duhet të veprojë gjykata, së cilës i paraqitet për shqyrtim një çështje për shkak të konfliktit të kompetencës. Çështja mund të dërgohet nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, ashtu edhe nga një gjykatë më e lartë në një gjykatë më të ulët. Për gjykatën së cilës i paraqitet një çështje e tillë qëndron detyrimi për ta pranuar atë për shqyrtim. Kjo dispozitë i nënkupton të gjitha rastet, si kur gjykata që ka dërguar çështjen ka qenë jokompetente (neni 61), ashtu edhe kur ajo, megjithëse ka qenë kompetente, për arsye të shkaqeve që parashikon neni 56, ia dërgon atë për shqyrtim një gjykate tjetër kompetente. Konfliktet për kompetencë ndërmjet gjykatave nuk lejohen,

por gjykata, pa ndërprerë gjykimin e çështjes, ka të drejtë t'i parashtrojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë e cila vendos për rregullimin e kompetencës (neni 64).

Në rast se në një gjykatë ose në gjykata të ndryshme janë duke u shqyrtuar njëkohësisht mosmarrëveshje civile midis të njëjtave palë dhe me të njëjtin shkak e objekt padie, atëherë ligji parashikon pushimin e gjykimit të çështjes të paraqitur më pas. Në doktrinën juridike kjo situatë quhet gjyqvarësi ose listpendencë.[22)]

Nga analiza që mund t'i bëhet nenit 58 të Kodit të procedurës civile, rezulton se gjyqvarësia ka ngjashmëri me parimin e gjësë së gjykuar. Në të dyja rastet e njëjta çështje me të njëjtët palë objekt dhe shkak nuk mund të gjykohet përsëri. Ndryshimi ndërmjet tyre është se tek parimi i gjësë së gjykuar kërkohet që vendimi i parë të ketë marrë formë të prerë, ndërsa, në situatën e gjyqvarësisë, çështjet janë në gjykim njëkohësisht. Pra, tek gjëja e gjykuar i ndalohet gjykatës të japë vendim për të njëjtën çështje, për shkak se ajo është gjykuar më parë, ndërsa tek gjyqvarësia nuk i lejohet gjykatës të gjykojë të njëjtën çështje që është duke u gjykuar. Kur konstatohet një situatë e tillë, gjykata duhet të vendosë pushimin e çështjes që është paraqitur më vonë, duke i dhënë mundësi gjykatës të zgjidhë përfundimisht çështjen e paraqitur më parë.

c – ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Ashtu sikurse edhe materialet e paraqitura në seksionin B të kapitullit II, materialet e shfrytëzuara në këtë kapitull provojnë edhe një herë se sistemet procedurale shqiptare mbështeten në frymën e traditës kontinentale, me një strukturë dhe përmbajtje të ngjashme me shumë kode të tjera perëndimore. Në këtë kapitull të veçantë, i është lënë hapësirë e konsiderueshme materialeve që trajtojnë sistemet ligjore të vendeve fqinje me Shqipërinë, si p.sh., të Greqisë. Kështu, bëhet shumë shpejt evident fakti se, pavarësisht ndryshimeve të mëdha në zhvillimin historik të këtyre dy sistemeve ligjore, në fushën specifike të procedurës civile moderne ndryshimet janë shumë të pakta.

Si edhe në kapitullin e mëparshëm, një ushtrim i dobishëm do të ishte testimi i njohurive për sistemin ligjor shqiptar nëpërmjet përpjekjes për gjetjen e ndryshimeve (në detaje apo perspektivë) sipas metodës së ndjekur në kontekstet krahasuese.

22) Latinisht: rrjedh nga **exceptio litis pendentis-** *që ka kuptimin e çështjeve apo konflikteve të varura.*

Padia

1) Konceptimi i padisë si një marrëdhënie ligjore ndërmjet individit që kërkon rivendosjen e një të drejte dhe shtetit, ka implikime të së drejtës kushtetuese. A mund të përmendni bazat kushtetuese të padisë, nëse ka, sipas së drejtës shqiptare?

2) A përshtatet nënndarja e padive sipas doktrinës franceze (e përshkruar më sipër) me kuadrin ligjor shqiptar? A mund të jepni shembuj të secilit prej llojeve të padive të përshkruara?

Kërkesat procedurale

1) A zbatohet plotësisht në të drejtën shqiptare dallimi midis kërkesave procedurale absolute dhe relative? Përshkruani dispozitat e Kodit shqiptar të procedurës civile, të cilat mund të konsiderohen se i përkasin secilës prej këtyre kategorive.

2) Cilat janë afatet kohore që zbatohen sipas Kodit shqiptar të procedurës civile, për sa i përket ngritjes së objeksioneve që lidhen me kërkesat procedurale?

3) Cila është forma e marrjes së vendimeve nga gjyqtarët shqiptarë lidhur me kërkesat procedurale? Cilat janë llojet e apelimeve që mund të përdoren kundër këtyre vendimeve?

Zotësia për të qenë palë në gjykim dhe zotësia për të zhvilluar një proces gyqësor

1) Cilat janë, sipas së drejtës shqiptare, kërkesat lidhur me zotësinë për të qenë palë në gjykim dhe zotësinë për të zhvilluar një proces gjyqësor?

2) Përmendni dallimin midis zotësisë për të qenë palë në gjykimin e zakonshëm (gjykimin në themel) dhe në procedurat për zbatimin e ligjit sipas së drejtës shqiptare.

3) Jepni tre shembuj të subjekteve që kanë zotësinë për të qenë palë në gjykim, po jo zotësinë për të zhvilluar një proces gjyqësor sipas së drejtës shqiptare.

Interesi ligjor

1) Cili është përkufizimi që mund të jepet për "interesin ligjor" sipas Kodit shqiptar të procedurës civile?

2) A gjen zbatim edhe në Shqipëri përjashtimi nga koncepti i interesit ligjor i "marrëdhënieve të ardhshme ligjore", sikurse është pranuar nga doktrina greke? Jepni një shembull të një marrëdhënieje ligjore të kësaj natyre.

Abuzimi me të drejtat procedurale

Përshkruani se deri në çfarë mase mund të konsiderohen si të zbatueshme edhe në kontekstin shqiptar rregullat dhe doktrinat për abuzimin me të drejtat procedurale sipas së drejtës greke (bazuar në nenin 116 të Kodit grek të procedurës civile).

Juridiksioni

1) A i përcakton në mënyrë të qartë Kodi shqiptar i procedurës civile kufijtë ndarës midis juridiksionit civil dhe juridiksionit administrativ? Nëse po, cilat janë kriteret?

2) Cila është procedura që ndiqet për marrjen e vendimit mbi konfliktet e juridiksionit?

3) Në disa sisteme ligjore, për shembull në sistemin ligjor italian, ngritja e çështjeve të juridiksionit shpesh përdoret si një mënyrë për shtyrjen e procedurave gjyqësore. A është zbatuar ndonjëherë në praktikën shqiptare ose a është teorikisht e mundur të zbatohet një abuzim i tillë me procedurat?

4) A zbatohen rregulla të veçanta në proceset gjyqësore para gjykatave shqiptare në rastet kur palët paditëse apo të paditura janë shtetas të huaj?

5) Cilat subjekte, nëse ka, gëzojnë imunitet nga juridiksioni i gjykatave shqiptare? Përshkruani se deri në çfarë shkalle mund të konsiderohen si të zbatueshme edhe për përvojën shqiptare zhvillimet aktuale të së drejtës italiane?

Kompetenca

1) Cila është procedura që ndiqet për marrjen e vendimit mbi konfliktet e kompetencës sipas Kodit shqiptar të procedurës civile?

2) Cilat janë rregullat e kompetencës të parashikuara në Kodin shqiptar të procedurës civile, të cilat mund të ndryshohen me marrëveshje ndërmjet palëve?

3) Shpjegoni cilat janë, nëse ka, ndryshimet mes rregullave greke të kompetencës të përshkruara më sipër dhe rregullave shqiptare.

d - LEXIME PLOTËSUESE

Rregullat e zotësisë për të qenë palë në gjykim dhe të interesit ligjor kanë ndikime të·mëdha politike, pasi ato mund të përdoren për të përjashtuar nga proceset gjyqësore grupe dhe organizata që përfaqësojnë – ose pretendojnë se përfaqësojnë – interesa të shumë individëve, siç mund të jenë çështjet që lidhen me mjedisin apo me mbrojtjen e konsumatorit. Rrjedhimisht, debati për "paditë e grupeve të individëve" po përhapet gjerësisht në gjithë sistemet ligjore. Një lexim me interes për prirjet aktuale të sistemeve ligjore kontinentale dhe të common law do të ishte M.Taruffo, "Some Remarks on Group Litigation in Comparative Perspective" *("Opinione për mosmarrëveshjet në grup sipas perspektivës krahasuese")*, në *Duke Journal of International and Comparative Law*, 2001, f. 405.

e - BIBLIOGRAFI

Parimeve të përgjithshme të së drejtës italiane mund t'u referohemi përsëri nëpërmjet veprave të cituara në kapitullin 2.

Për sa i përket abuzimit me të drejtat procedurale mund t'i referohemi M.Taruffo (ed.), *Abuse of Procedural Rights: Comparative Standards of Procedural Fairness,(Abuzimi me të drejtat procedurale: standarde krahasuese të drejtësisë procedurale)* Hague, Kluwer, 1999.

f - FJALORI TERMINOLOGJIK

Juridiksioni - kompetenca (kombëtar, ndërkombëtar) = Kompetenca e gjykatës për të vendosur mbi një mosmarrëveshje, duke presupozuar se kompetenca për këtë grup çështjesh bazohet mbi rregulla të zbatueshme për organizimin gjyqësor.

Padia = Akti që ka për qëllim të garantojë respektimin e të drejtave të individit në një gjykatë të sistemit të drejtësisë.

Gjyqvarësia ose listpendenca = Pushimin e gjykimit të çështjes të paraqitur më pas, në rast se në një gjykatë ose në gjykata të ndryshme janë duke u shqyrtuar njëkohësisht mosmarrëveshje civile midis të njëjtave palë dhe me të njëjtin shkak e objekt padie.

g - UDHËZIME PRAKTIKE:

3. Padia është mjet procedural i rëndësishëm, nëpërmjet së cilës realizohet e drejta e personit për të vënë në lëvizje gjykatën, për të thirrur në gjykim palën kundërshtare me të cilën ka një mosmarrëveshje juridike, për të kërkuar nga gjykata mbrojtje gjyqësore për të drejtën që pretendon, si dhe për të detyruar gjykatën që të shprehet mbi bazueshmërinë ose jo të pretendimit të tij.

4. Me padinë është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe e drejta e palës kundërshtare për të ngritur prapësimet e saja dhe për të ushtruar kundërpadinë, mbi bazën e një procesi gjyqësor kontradiktor.

5. Kushtetuta dhe legjislacioni ynë procedural e lejon personin të ngrejë padinë jo vetëm ndaj subjekteve private, por edhe ndaj subjekteve të së drejtës publike. Palës i lind e drejta të paditë shtetin dhe nëpërmjet një padie të tillë t'i kërkojë gjykatës shpallje të bazuar të pretendimit të tij.

6. Për fillimin e një procesi gjyqësor është e nevojshme ekzistenca e disa kërkesave procedurale, të cilat konsiderohen si elemente përcaktuese të vetë procesit dhe që vlerësohen nga gjykata.

7. Mos i konsideroni asnjëherë kërkesat formale të një procesi gjyqësor, si kërkesa të pastra formale, të cilat mund të bëhen pengesë për marrjen e një vendimi "të drejtë" gjyqësor. Secila prej tyre synon mbrojtjen e vlerave të veçanta që duhet të mbrohen edhe në interesin e përgjithshëm të shoqërisë.

8. Zotësia për të qenë palë, interesi i ligjshëm, kompetenca e gjykatës, juridiksioni, konsiderohen si kërkesa procedurale absolute, sepse gjykata ato i merr në shqyrtim edhe kryesisht. Njihen edhe kërkesat procedurale relative, të cilat nuk merren në shqyrtim nga gjykata kryesisht, por vetëm pasi pala e paditur paraqet objeksione gjatë gjykimit.

9. Koha e paraqitjes së këtyre kërkesave nuk kushtëzohet me ndonjë afat kohor. Pretendime të tilla mund të paraqiten, si në veprimet përgatitore, ashtu edhe gjatë seancës gjyqësore.

10. Që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (ligjshmëria aktive) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit (ligjshmëria pasive).

11. Interesi i ligjshëm i palës në një proces gjyqësor kërkon ekzistencën e zotësisë për të qenë palë si dhe të zotësisë për të kryer veprime të caktuara.

12. Zotësia për të qenë palë lidhet *me gëzimin e të drejtave* civile, ndërsa zotësia për të vepruar realizohet nëpërmjet *ushtrimit të këtyre të drejtave.*

Personat që nuk kanë zotësinë për të vepruar në një proces gjyqësor, nuk privohen nga zotësia për të qenë palë.

13. Palët nuk duhet të ngrenë padi dhe të bëjnë pretendime me dijeninë e tyre dhe me ndërgjegje se janë të gabuara, të pathemelta dhe të padrejta, me qëllim që të dëmtojnë palën tjetër ose të pengojnë zhvillimin normal të procesit gjyqësor. Kryerja e veprimeve të tilla sjell ndëshkimin materialisht të palës që abuzon me të drejtën e ngritjes së padisë.

14. Juridiksioni paraqitet si ushtrim i një lloji veprimtarie juridike sipas një ndarjeje të përcaktuar pushtetesh dhe brenda një hapësire të kufizuar territoriale. Gjykata e verifikon juridiksionin e saj që në fillim të procesit gjyqësor.

15. Palët nuk lejohen të lidhin marrëveshje për t'i kaluar juridiksionin e gjykatave shqiptare një juridiksioni të huaj, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

16. Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përjashtimisht rasteve kur ata pranojnë vullnetarisht si dhe ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga konventa e Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike".

17. Kompetenca është e drejta dhe detyra e një organi për të ushtruar veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të ligjit. Për përcaktimin e kompetencës lëndore merret si kriter përmbajtja ose natyra e çështjeve që zgjidhen nga gjykata, ndërsa për kompetencën tokësore elementi përcaktues janë kufijtë territorialë dhe juridiksionalë, brenda të cilëve kryhet veprimtaria e gjykatës.

18. Kriteret ligjore, si: vendbanimi ose vendqëndrimi, vendndodhja e pasurisë ose e pjesës më të madhe të saj, vendi i vërtetimit të një ngjarjeje ose fakti me efekte juridike, vendi i përmbushjes së një detyrimi ose vendi i ekzekutimit, janë përcaktuese për shqyrtimin e çështjes në një gjykatë dhe jo në një tjetër.

19. Kur gjykata konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesë të palëve, si në veprimet përgatitore, ashtu dhe gjatë seancës gjyqësore vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.

20. Gjykata mund të vendosë dërgimin e çështjes në një tjetër gjykatë kompetente kur në gjykatën tjetër mosmarrëveshja mund të zgjidhet më shpejt dhe më lehtë sesa në gjykatën e zgjedhur nga palët, si dhe kur shihet me vend kërkesa e të padituit, të cilit nuk i dihej vendbanimi ose vendqëndrimi, për gjykimin e mosmarrëveshjes në gjykatën e vendit ku ai ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tanishëm.

21. Mbi gjykatën, së cilës i paraqitet për shqyrtim një çështje për shkak të konfliktit të kompetencës, qëndron detyrimi për ta pranuar atë për shqyrtim.

KREU I KATËRT

- AVOKATËT
- NGARKIMI I SHPENZIMEVE GJYQËSORE

a – OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet:

- të jenë në gjendje të administrojnë marrëdhëniet me avokatët, brenda dhe jashtë sallës së gjyqit;
- të kenë njohuri për standardet minimale etike dhe profesionale të profesionit ligjor;
- të kenë njohuri për rëndësinë dhe efektet e vendimeve për shpenzimet gjyqësore.

b – MATERIALET REFERUESE KRYESORE

PËR AVOKATËT

1. Kodi shqiptar i Procedurës Civile, nenet 84-101

Shënim i autorit: *Në të gjitha sistemet ligjore, kompetenca, pavarësia, besnikëria ndaj klientit, ruajtja e mirëbesimit të klientit, si dhe përgjegjësitë ndaj gjykatës, kolegëve e publikut, konsiderohen si cilësitë kryesore profesionale të avokatëve. Mjetet me anë të të cilave zbatohen këto cilësi kudo nëpër botë janë mjaft të ndryshme, sidomos për sa i përket nënndarjes midis normave joformale (rregullat e etikës) dhe normave ligjore formale. Procesi i 'legalizimit' të etikës ligjore dhe format e saj të ndryshme në vende të ndryshme mund të jenë një pikë e mirë për fillimin e diskutimeve mbi problemet e përgjithshme. Në këtë*

aspekt, mund të shihen fragmentet për "Cilësitë kryesore profesionale", shkëputur nga G. C. Hazard, Jr. - A. Dondi, Etika ligjore: studim krahasues:[1])

Në ushtrimin e profesionit të tyre, avokatët udhëhiqen nga parimet kryesore të etikës. Këto parime mund të kuptohen si cilësi profesionale, në raport me cilësitë personale të specifikuara në terminologjinë klasike greke dhe nga personalitetet e lashta, si Ciceroni. Cilësitë personale klasike përfshinin guximin, patriotizmin dhe miqësinë.

Në gjuhën profesionale moderne, veçanërisht në Europë, termi 'cilësi' përdoret më gjerësisht. Në çdo rast, referimi u bëhet normave etike nga të cilat duhet të udhëhiqen avokatët në përmbushjen e rolit të tyre profesional. Cilësitë profesionale të avokatëve janë: kompetenca, pavarësia, besnikëria ndaj klientit; ruajtja e fshehtësisë së sekreteve të klientit, përgjegjësitë ndaj gjykatës dhe kolegëve si dhe sjellja e respektueshme në çështjet personale dhe profesionale [...].

Në sisteme të ndryshme ligjore, këto cilësi shprehen në terma disi të ndryshëm dhe sipas përparësive të ndryshme. Për shembull, profesionet ligjore në Francë, Itali dhe Spanjë i japin përparësi dhe rëndësi të madhe pavarësisë, duke e nënkuptuar atë si nga klientët, ashtu edhe nga shteti. Në Gjermani, për shembull, ky profesion ka norma shumë të specifikuara dhe e vë theksin mbi përgjegjësitë e avokatëve ndaj gjykatës, përparësi kjo që e ka origjinën e saj historike në konceptimin e profesionit ligjor gjerman si në shërbim të shtetit. Në Amerikë, ky profesion i kushton shumë rëndësi besnikërisë ndaj klientit. Por, cilësitë profesionale të pranuara gjerësisht janë pak a shumë të njëjtat, duke qenë se, në traditën perëndimore, profesioni ligjor është njohur si i tillë që në shekullin e 12-të.

Në kohët e hershme këto cilësi kanë qenë të shprehura si maksima të profesionalizmit. Në historinë e kohëve më të vonshme, të njëjtat koncepte janë pasqyruar në rregullore të shkruara – statute, urdhra gjyqësorë dhe memorandume të dhomës së avokatisë. Për shembull, ndalimi që i bëhet një avokati të konsideruar si "mashtrues" për të ushtruar profesionin e tij – i cili përpiqet të përfaqësojë një klient në një çështje, por që vepron kundër interesave të klientit në po këtë çështje ose në një çështje tjetër – ka një histori të lashtë dhe shpreh besnikërinë ndaj klientit.

Rregullat e këtij profesioni, të imponuara nga gjykatat ose nga legjislacioni, u korrespondojnë kryesisht parimeve etike dhe aspiratave të shprehura nga

---

1 *G. C. Hazard, Jr. - A. Dondi,* Etika ligjore: studim krahasues, *Stanford, Stanford University Press, 2004, faqe 109 e në vazhdim*

vetë profesioni. Sigurisht, jo të gjithë avokatët u janë përmbajtur gjithmonë këtyre parimeve etike. Në pothuajse çdo komunitet ka avokatë që përfshihen në sjellje jokorrekte profesionale. Gjatë kohëve të ndryshme, në mjaft komunitete, anëtarët e profesioneve ligjore janë korruptuar. Tradicionalisht, praktikimi i ligjit ka kërkuar njëanshmëri dhe fshehtësi, elemente këto që krijojnë mundësinë për sjellje të paskrupullt dhe mashtruese. Njëanshmëria dhe fshehtësia janë të papajtueshme me versionet e përgjithshme të standardeve të zakonshme të etikës. Praktikimi i ligjit paraqet në mënyrë të pashmangshme mundësinë për mashtrimin e klientëve dhe të palëve të tjera, si dhe për shfrytëzimin e procedurave ligjore që dëmtojnë, si klientët, ashtu edhe palët e tjera. Duke qenë se këto mundësi janë të mishëruara në praktikimin e ligjit dhe shkeljet janë të pashmangshme, konceptet etike që kanë drejtuar historikisht praktikimin e ligjit, janë simbolizimi i mundësive për abuzim. Abuzimet etike nga avokatët kontribuojnë në shfrytëzimin dhe mohimin e drejtësisë në raste të caktuara, në keqfunksionimin e administrimit të drejtësisë dhe në një mosbesim të gjerë ndaj avokatëve dhe sistemit të drejtësisë. Po ashtu, ato dobësojnë rendin e vërtetë ligjor mbi të cilin mbështetet gjithë veprimtaria e profesionit ligjor.

Megjithatë, formulimet verbale të cilësive profesionale shërbejnë të paktën si këshilla me anë të të cilave avokatët shprehin vetveten lidhur me etikën e profesionit të tyre. Si të gjitha këshillat e tjera, ato u referohen idealeve që kërkohen të përmbushen: kërkimi i së vërtetës, garantimi i drejtësisë për të gjithë, si dhe ruajtja e ndershmërisë së panjollosur të profesionit. Por, formulimet e etikës profesionale synojnë jo thjeşht përmendjen e cilësive profesionale, por edhe zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale të avokatit. Praktikimi i ligjit nuk është vetëm një ekzistencë teorike ose një profesion i ushtruar në një vend të mbyllur. Ai është një aktivitet që kryhet në një botë reale të mbushur me rreziqe dhe pasiguri, si për klientët, ashtu edhe për avokatët, dhe kryhet nga njerëz jo të përsosur që përpiqen të sigurojnë jetesën.

Ky "realitet i kufizuar" bëhet shumë evident kur formulimet etike shndërrohen në rregulla ligjore të detyrueshme për sjelljen. Në këtë perspektivë, konceptet e etikës profesionale përfshijnë konflikte dhe kontradikta që janë të ngjashme me ato të diskutimeve të zakonshme morale. Për shembull, në diskutimet e zakonshme morale është këshillë me vend të thuhet se duhet të themi gjithmonë të vërtetën. Por, është diçka krejt e ndryshme të thuhet se do të ishte jo e ligjshme të mos i tregohet me ndërgjegje një anëtari të forcave sulmuese naziste vendi i fshehtë i një të arratisuri të pafajshëm, si p.sh Ana Franku. Një konflikt i ngjashëm ekziston në konceptet etike që drejtojnë

praktikimin e ligjit, midis aspiratave morale, nga njëra anë, dhe rregullave të etikës që marrin në konsideratë situatën reale, nga ana tjetër. Ky konflikt mund të ilustrohet nëpërmjet disa shembujve. [...]

Shembulli i parë ka të bëjë me detyrimin profesional të avokatit për besnikëri ndaj klientit [...].

Konflikti midis përgjegjësisë së avokatit ndaj klientit dhe përgjegjësisë si qytetar zakonisht lind në çështjet moderne të spiunazhit dhe të tradhtisë. Personi i akuzuar për kryerjen e këtyre veprave gjykohet në një gjykatë kombëtare me ndihmën e një avokati, përpjekjet e të cilit i kushtohen kundërshtimit të akuzës dhe, në këtë mënyrë, dobësimit të kontrollit ligjor ndaj tradhtisë kundër vendit. Në një kuptim më të zbutur, i njëjti konflikt ekziston edhe për avokatin që mbron një person të akuzuar për kryerjen e një krimi në rastet kur lirimi i tij imponon një kufizim të kontrolleve sociale të krijuara nga e drejta penale. E njëjta gjë vlen edhe për avokatin që përfaqëson një korporatë biznesi që kundërshton zbatimin e një rregulle të vendosur nga qeveria.

[...] Pra, parimet e etikës ligjore kundërshtojnë ndonjëherë parimet e shprehura gjerësisht të moralit civil. Po ashtu, ato kundërshtojnë parimet e shprehura nga disa filozofë të moralit dhe parimet e shprehura në "etikën e folklorit", ose ajo çka njerëzit e zakonshëm e quajnë të drejtë apo të gabuar. Për shembull, etika e folklorit kërkon që ne të jemi besnikë me shokët tanë, por kjo etikë na kërkon edhe që t'i bindemi ligjit. Çfarë ndodh nëse një shok i cili ka shkelur ligjin, përpiqet të fshihet në shtëpinë time? Në jetën e zakonshme, njerëzit përballen pashmangshmërisht me dilema që vijnë nga udhëzimet kontradiktore të parimeve të përgjithshme etike që ne i pranojmë plotësisht. Dhe ne nuk hezitojmë të pranojmë se duhet të jemi besnikë me shokët (si një pohim i përgjithshëm) dhe se (përgjithësisht) duhet t'i bindemi ligjit.

Konceptet e etikës ligjore përfshijnë konflikte të ngjashme midis qëllimeve të përgjithshme për të cilat bien dakord të gjithë avokatët, dhe situatave specifike ku qëllimet e përgjithshme evidentojnë veprime që konfliktojnë me njëri-tjetrin. Shumë prej avokatëve dëshirojnë të mendojnë për profesionin e tyre si një profesion që u përmbahet qëllimeve të përgjithshme etike, si detyrimi për të qenë besnikë ndaj klientëve dhe për të qenë të ndershëm me gjykatën. Por, edhe nëse shprehen si detyrime universale, këto qëllime duhet të kuptohen si të aspirueshme dhe jo si deklarata pikë për pikë sipas normave drejtuese. Mendoni, për shembull, deklaratën "Përgjegjësia kryesore e një avokati është garantimi i administrimit të duhur të drejtësisë." Një deklaratë e tillë zakonisht injoron faktin se avokatët, individualisht, nuk mund ta garantojnë dot këtë gjë dhe se, në të vërtetë, vetë sistemi i drejtësisë shpesh nuk arrin ta realizojë

këtë gjë. Po ashtu, ekziston një konflikt i pashmangshëm ndërmjet aspiratave etike dhe detyrimeve etike të marra në konsideratë me maturi dhe kujdes, ashtu sikurse ekziston një konflikt i pashmangshëm midis moralit të mbështetur mbi fenë (për shembull standardet kristiane) dhe normave që njerëzit shfaqin në jetën e përditshme".

Midis cilësive profesionale, e para renditet kompetenca. Kjo ka një vlerë të pavarur dhe është sfondi i gjithë cilësive të tjera. Sikurse na kujtojnë Hazard dhe Dondi (faqe 115):

"Paaftësia e një avokati mund të jetë aq e dëmshme, sa ai mund të mos arrijë të kuptojë detyrat e tjera profesionale. Një avokat i paaftë nuk është i besueshëm se do të përmbushë angazhimet profesionale që ka marrë përsipër. Zakonisht, një avokat i paaftë është i frikësuar gjatë kryerjes së punës së tij dhe shpesh është i predispozuar të bëjë gabime. Ashtu sikurse gabimet e një kirurgu të paaftë, e një infermieri apo ndërtuesi sjellin pasoja mjaft serioze, edhe avokatët e paaftë bëjnë gabime të rënda, megjithëse ndodh që ato mos të jenë të dukshme".

Për të arritur një nivel të përshtatshëm të kompetencës profesionale, vendet e Europës kontinentale kanë zhvilluar një sistem të mbështetur (citimi vazhdon të jetë shkëputur nga Hazard dhe Dondi, f. 124 e në vijim): "mbi një kombinim të shkollimit universitar dhe të një stazhi pune të supervizuar nga qeveria. Programet mësimore të universitetit janë hartuar mbi bazën e së drejtës romake dhe trajtojnë konceptet ligjore klasike, duke e vënë theksin mbi ligjin material (pronën, kontratat dhe të drejtën penale, dëmet civile e kështu me radhë). Konceptet e së drejtës procedurale (duke përfshirë procedurën në mosmarrëveshjet civile dhe penale, juridiksionin, të drejtën ndërkombëtare private, njohjen e vendimit) janë të përfshira vetëm në pjesën e dytë të programeve mësimore dhe janë të paraqitura në terma formalë më shumë sesa në terma praktikë. Në disa programe mësimore, një lëndë mjaft e rëndësishme është jurisprudenca, ekspozicioni i bazave teorike të ligjit, duke përfshirë edhe të drejtën natyrore. Procesi mësimor në universitetet europiane të drejtësisë kryesisht është teorik dhe konceptual, i paraqitur nga profesorë që janë akademikë në këto fusha. Në përgjithësi, procesi mësimor konsiston në paraqitjen e rregullave të së drejtës sikurse parashikohen në kodet dhe përmbledhjet ligjore, trajtimin e normave nga perspektiva historike dhe teorike, si dhe të komentarëve shkencorë për normat ligjore dhe marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën.

Pra, ligji paraqitet më shumë nga këndvështrimi i një juristi ose gjyqtari sesa nga këndvështrimi i një avokati. Metoda pedagogjike përcjell mesazhin se ligji është i qartë dhe i përcaktuar. Shumë profesorë europianë janë edhe

ushtrues të profesionit ligjor dhe e kuptojnë mirë se, nga këndvështrimi i avokatëve dhe i klientëve të tyre, ligji shpeshherë është i paqartë dhe i papërcaktuar. Gjithsesi, në shkollimin ligjor europian është konsideruar si i papërshtatshëm dhe aspak relevant krahasimi i koncepteve teorike të shpalosura në programin mësimor universitar me 'ligjin në veprim', sikurse praktikohet në jetën e përditshme. Profesorët e konsiderojnë veten si një trup pedagogjik të shkencës njerëzore dhe jo si instruktorë për trajnime profesionale, deri në shkallën që ata përjashtojnë nga trajtimi mësimor aspektet praktike të së drejtës dhe administrimin e drejtësisë.

Në traditën akademike të shkollimit universitar europian, programet mësimore japin bazat filozofike dhe historike për kuptimin dhe vlerësimin e ligjit si një element kryesor të civilizimit perëndimor. Ky qëndrim përçohet, si te studentët që do të jenë avokatët e ardhshëm, ashtu edhe te studentët që do të përmbushin detyra të tjera. Ky është një qëndrim i respektimit, ndoshta edhe i adhurimit të ligjit, krejt i ndryshëm nga vlerësimi realist i ligjit, sikurse administrohet në praktikë.

Në vendet në zhvillim, si në ato të traditës kontinentale, ashtu edhe ato të traditës së common law, formaliteti i përciptë i shkollimit ligjor është përkeqësuar nga mangësitë në burimet mësimore të universiteteve. Klasat janë shumë të mëdha dhe mësimi zhvillohet në mënyrë të tillë që flet vetëm lektori dhe studentët presupozohet thjesht të riprodhojnë përmendsh. Në këtë mënyrë, pra, ka shumë pak mundësi për reflektime ose diskutime lidhur me tekstin e ligjit, duke mos përmendur këtu kompleksitetin e zbatimit të ligjit në praktikë. Në të njëjtën kohë, nga perspektiva e financave publike, nuk ka shumë alternativa praktike për një vend në zhvillim që përpiqet të modernizojë sistemin e tij ligjor. Nuk ka asnjë dyshim se është shumë më mirë të ketë një shkollim ligjor formalist sesa të mos ketë fare. Po ashtu, është shumë e qartë se do të ishte shumë më mirë të dilnin gjyqtarë dhe avokatë të trajnuar jo mirë, sesa gjykatat të mbusheshin me njerëz që nuk kanë fare trajnim ligjor.

Tradita europiane vazhdon në Europën Lindore dhe Perëndimore dhe është përcjellë nga Spanja dhe Portugalia në vendet ibero-amerikane dhe nëpërmjet modelit gjerman në Japoni dhe Kinë. Ky konceptim i 'auditorit' për shkollimin ligjor universitar është koherent, duke marrë në konsideratë në programet mësimore karrierën e mundshme të pjesës më të madhe të studentëve. Shumë studentë të universiteteve europiane që studiojnë për drejtësi, nuk hyjnë në profesionet ligjore, as si gjyqtarë, as si avokatë. Përkundrazi, shumë prej tyre fillojnë karrierën si nëpunës në biznes dhe në administratën publike, ku njohuritë e përgjithshme për ligjin dhe kapaciteti për një mendim të kujdesshëm dhe shprehje verbale janë aftësi të vlefshme. Ky konceptim i auditorit të

studentëve mbështet edhe prezantimin e ligjit në formë logjike dhe teorike, në mënyrë të ngjashme me programet mësimore të universiteteve të ekonomisë, të inxhinierisë, që janë relativisht teorike. Programet mësimore të universiteteve të së drejtës nuk adresojnë 'anën e errët' të ligjit që mund të shpalosej sipas një metode 'realiste' në shkollimin ligjor.

Koncepti i së drejtës si një shkencë e bazuar në historinë klasike dhe logjike shprehet jo vetëm në programet mësimore universitare, por edhe në literaturën akademike dhe profesionale të së drejtës. Në traditat europiane dhe japoneze, formimi ligjor konsiston në shpalosjen dhe komentimin e teksteve formale të ligjit, në mënyrë të dallueshme nga rrethanat praktike të praktikimit dhe të administrimit të tij.

Pjesa më e madhe e të diplomuarve të universiteteve të drejtësisë të stilit europian bëhen profesionistë të ligjit, disa si gjyqtarë, disa si avokatë dhe një pjesë e vogël si noterë. Thelbi i ligjit për këta profesionistë të ardhshëm është specifikimi dhe artikulimi filozofik dhe historik i normave ligjore. Thelbi i teknikës ligjore konsiston në diskutimet sipas kësaj metode. Kështu, një konceptim formal i ligjit bëhet një profeci e vazhdueshme vetëpërmbushëse. Ligji 'është' sistemi i trajtuar nga ana historike dhe filozofike i normave formale, i shtjelluar nga profesorët e specializuar në traditën akademike, i cili u mësohet në këtë mënyrë studentëve që marrin vlerësime të ndryshme akademike duke demonstruar aftësi të ngjashme. Fakti nëse ky ligj shkollimi është i përshtatshëm për gjyqtarë ose avokatë është çështje tjetër.

Për ata që synojnë të bëhen anëtarë të profesioneve ligjore në sistemet e së drejtës kontinentale, faza tjetër konsiston në kombinimin e testimeve profesionale dhe të stazhit profesional të punës. Përmbajtja, kategorizimi dhe shkalla e vështirësisë së këtyre elementeve ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Disa vende kanë një testim pas diplomimit dhe një tjetër pas stazhit profesional. Vende të tjera kanë një sistem stazhi, si për ata që dëshirojnë të bëhen gjyqtarë, ashtu edhe për ata që dëshirojnë të bëhen avokatë; ka edhe që kanë krijuar rrugë të ndryshme që prej momentit të fillimit të stazhit. Në disa sisteme, stazhi është i kontrolluar dhe i rregulluar rreptësisht dhe përfshin mësimin formal substancial të çështjeve 'praktike'. Në sisteme të tjera, stazhi mund të konsistojë vetëm në sigurimin e një pozicioni si asistent në një zyrë avokatie, duke u marrë kështu me punë të rëndomta (fotokopjime) dhe me zbatimin e porosive. Vendet e Europës Veriore, kryesisht Franca dhe Gjermania, kanë ruajtur standarde të larta për stazhin profesional. Në disa vende të tjera, standardet janë tepër formale, madje edhe farsë.

Në Itali, mbikëqyrja rregullatore e sistemit është neglizhuar dhe cilësia aktuale e stazhit nuk është e njësuar, por gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma të shumta.

Në shumë vende që kanë përdorur sistemin europian kontinental, kërkohet testim i aftësive profesionale. Dikur, pranimi për të ushtruar veprimtarinë në praktikë ishte i lejueshëm me përfundimin e fakultetit të së drejtës dhe ky sistem vazhdon të jetë ende në fuqi në disa vende europiane dhe në disa vende të Amerikës Latine. Në vendet ku kërkohet kryerja e një testimi, ky testim konsiston në përgjigjet me shkrim të pyetjeve që lidhen me rregullat e së drejtës. Testimi tipik përfshin pjesën me shkrim dhe testimin me gojë. Shumë sisteme kërkojnë edhe zbulimin e të dhënave personale të aplikuesit për të përcaktuar nëse ka pasur ngjarje skualifikuese, si për shembull, dënimet penale.

Me plotësimin e këtyre kërkesave, aplikuesi pranohet provizorisht si profesionist, si gjyqtar, avokat ose anëtar i një profesioni ligjor të specializuar, sikurse është *noteria*. Pranimi si avokat në shumë prej vendeve europiane administrohet nga dhoma e avokatisë e qytetit ose e provincës, duke reflektuar faktin se, historikisht, profesioni ligjor është një profesion i lidhur me lokalitetin. Për shembull, në Francë *qendrat rajonale për formimin profesional të avokatëve* janë të bashkëlidhura me gjykatat rajonale të apelit. Pranimi në një lokalitet të caktuar zakonisht rezulton me marrjen e një licence që është e vlefshme në gjithë territorin e vendit. Ata që pranohen si gjyqtarë karriere, hyjnë në një sistem të strukturuar mjaft mirë të vlerësimit dhe të promovimit të mundshëm, duke filluar nga gjykatat më të ulëta dhe duke kulmuar me emërimin në gjykatat më të larta të vendit.

Në shumë prej sistemeve, pranimi si avokat u nënshtrohet kërkesave për përvojë të mëtejshme në praktikë ose instruktimit nga një avokat me përvojë. Atyre që pranohen për të ushtruar profesionin në praktikë, para se të bëhen anëtarë të dhomës së avokatisë, mund t'u kërkohet kalimi i një periudhe prove. Për shembull, në Francë, kandidati duhet të përfundojë një program trajnues njëvjeçar dhe, më pas, një periudhe dyvjeçare të pranimit me kusht për ushtrimin e profesionit nën mbikëqyrjen e një avokati me përvojë. Vetëm pas përfundimit me sukses të kësaj periudhe fitohet pranimi i plotë. Deri vitet e fundit, në shumë prej vendeve europiane u ruajtën dallimet mes degëve të ndryshme të profesionit ligjor. Gjithsesi, prirja moderne shkon drejt eliminimit të këtyre dallimeve.

Në sistemet e së drejtës kontinentale, pasi një avokat pranohet të ushtrojë profesionin e tij në praktikë, suksesi profesional varet nga vlerësimi jozyrtar

ose 'reputacioni'. Disa sisteme ligjore ruajnë dallimet formale të bazuara mbi arritjet e mëpasshme. Për shembull, në Francë, autoriteti i profesionit në çdo qytet mbikëqyret nga një drejtues i dhomës së avokatisë, dirigjuesi, zgjedhja e të cilit reflekton respektimin e reputacionit të lartë. Po ashtu, shumë avokatë janë edhe profesorë të së drejtës, kështu që reputacioni i tyre në profesionin ligjor vjen kryesisht nga reputacioni i tyre në botën akademike.

Në këndvështrimin e këtyre kërkesave për pranimin e ushtrimit të profesionit në praktikë, në shumë prej sistemeve ligjore kontinentale, avokatët kanë aftësitë kryesore intelektuale, nivel të lartë të njohurive dhe kapacitet për t'u kushtuar vëmendjen e duhur problemeve intelektuale. Këto elemente të rëndësishme të kompetencës në profesionin ligjor dhe në mënyrat e shumta të zbatimit të tij në praktikë janë të mjaftueshme për ushtrimin kompetent të profesionit. Megjithatë, ka edhe kualifikime të tjera që janë të rëndësishme gjatë zbatimit të ligjit në praktikë: imagjinata, guximi, aftësitë bindëse personale dhe të qenët realist për dobësitë njerëzore, duke përfshirë këtu edhe dobësitë e gjyqtarëve dhe të nëpunësve të tjerë. Këto kualifikime shfaqen gjatë praktikës dhe prodhojnë shkallë të ndryshme, por 'të padukshme', të aftësive në radhët e avokatëve me përvojë."

Shënim i autorit: *Ndërsa pavarësia, kompetenca, besnikëria dhe mirëbesimi ndaj klientit janë cilësitë kryesore profesionale nga këndvështrimi i një klienti, nga perspektiva e një magjistrati detyrimet më relevante kanë të bëjnë me gjykatën dhe marrëdhëniet me avokatin e palës kundërshtare. Hazard dhe Dondi (f. 234 e në vazhdim) e kategorizon detyrimin kryesor nën emërtesën "i hapur me gjykatën", një ide së cilës i është dhënë kuptimi si më poshtë vijon:*

Një avokat ka shumë raste për të bërë deklarata para gjykatës. Rastet më të zakonshme lidhen me përcaktimin e seancave të ardhshme gjyqësore – datat në të cilat avokati mund të jetë i pranishëm dhe që janë të përshtatshme për dëshmitë e dëshmitarëve. Një diskutim më i ndërlikuar mund të adresojë faktin që një çështje e caktuar mund të zgjidhet me marrëveshje, si dhe mundësinë që seancat e tjera gjyqësore të jenë të panevojshme.

Gjatë diskutimeve për zgjidhjet e çështjeve me marrëveshje ekziston një konflikt midis parimit se klienti ka autoritetin përfundimtar lidhur me kushtet e marrëveshjes dhe parimit se avokati flet i autorizuar në gjykatë për të gjitha problemet që lidhen me çështjen. Avokati mund ta marrë të mirëqenë se klienti ka rënë dakord për zgjidhjen e çështjes me marrëveshje dhe mund të përballet

më pas me një rebelim të klientit kundër kushteve të propozuara ose për shkak të faktit se ka pasur një keqkuptim, ose për shkak se ai ka ndryshuar mendim. Në rastin kur klienti është një entitet biznesi, deklarata e avokatit për palën, e cila thotë se çështja është zgjidhur, zakonisht pranohet pa pyetje nga gjykata dhe nga pala kundërshtare, kështu që çështja konsiderohet e mbyllur. Është e kuptueshme se një klient, i cili përfaqëson një entitet biznesi, e kupton rëndësinë e arritjes së një kompromisi, se avokatët i kuptojnë rastet kur klientët autorizojnë arritjen e një kompromisi dhe se, nëse ndonjë prej këtyre premisave nuk del e saktë, klienti do të ankohet kundër avokatit. Por, nëse klienti është një individ i zakonshëm, zakonisht gjykatat do ta konsiderojnë çështjen si të zgjidhur përfundimisht vetëm kur klienti të ketë nënshkruar dokumentet e marrëveshjes. Në disa sisteme kontinentale, këto raste parandalohen nga rregulla se një marrëveshje hyn në fuqi vetëm nëse nënshkruhet nga klienti.

Komunikime të tjera midis avokatit dhe gjykatës mund të lidhen, për shembull: me ekzistencën e një dokumenti që ka të bëjë me çështjen dhe me identitetin e mbajtësit të tij; nëse dëshmitari i mundshëm është i gatshëm për të dëshmuar; nëse mosmarrëveshje të tjera që lidhen me konfliktin në fjalë, presin zgjidhje në një gjykatë tjetër ose nëse njoftimi që kërkohet për disa faza procedurale është transmetuar siç duhet. Avokatët janë të detyruar të jenë plotësisht të sinqertë në çështje të tilla dhe në përgjigjet gjatë hetimeve që kanë të bëjnë me to.

Detyrimi i avokatit për të qenë i hapur me gjykatën në çështje të tilla qëndron mbi çdo detyrim tjetër që ai ka ndaj klientit, me përjashtim të rrethanave shumë të veçanta në të cilat gjykata drejton pyetje që nuk janë të lejueshme. Është e kuptueshme, për shembull, se gjykata në një çështje penale nuk mund t'i kërkojë avokatit të palës së paditur nëse i akuzuari është vërtet fajtor. Kjo pyetje është jokorrekte dhe avokati duhet të refuzojë t'i përgjigjet. Në të kundërt, duke pretenduar se pyetjet e drejtuara nga gjykata janë korrekte, avokati duhet t'u përgjigjet atyre në përputhje me detyrimin e tij për të qenë i hapur me gjykatën.

Detyrimi për të qenë i hapur me gjykatën shprehet me terma të ndryshëm në kode të ndryshme. Ndoshta, shprehja më e saktë e këtij detyrimi është ajo që i drejtohet avokatit anglez: "Avokati ka detyrimin kryesor ndaj gjykatës për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe në interes të drejtësisë; ai duhet ta ndihmojë gjykatën në administrimin e drejtësisë dhe nuk duhet ta mashtrojë gjykatën ose ta keqorientojë atë me dashje ose nga pakujdesia. [...]

Kodi italian i etikës ligjore, neni 14, ndoshta ka më shumë saktësime teknike:

'Deklarimet e bëra gjatë procesit gjyqësor lidhur me ekzistencën ose mosekzistencën e fakteve objektive që janë element specifik për vendimin e gjyqtarit, me të cilat avokati njihet drejtpërsëdrejti, duhet të jenë të vërteta.

Avokati nuk duhet të paraqesë me qëllim të dhëna false ose të paraqesë deklarata që ai e di se nuk janë të vërteta.

Avokati është i detyruar të përmendë vendimet që mund të jenë dhënë në rastet kur kërkon marrjen e një vendimi që mbështetet mbi të njëjtën situatë faktike.'

Rregullat italiane reflektojnë aspekte të detyrimit për të qenë i hapur me gjykatën, të cilat janë të rëndësishme për të gjitha sistemet ligjore. Termi 'fakte objektive' nënkupton përjashtimin e shprehjeve retorike, opinioneve, 'ngjyrimeve', si dhe të shprehjeve të tjera që nuk mund të përfaqësohen dot qartë dhe në mënyrë konkrete. Termi 'element specifik për vendimin e gjyqtarit' rregullon detyrimin për paraqitjen e deklaratave që lidhen me çështjet ligjore përkatëse, të përcaktuara qartë. Termi 'njihet drejtpërsëdrejti' rregullon detyrimin për paraqitjen e deklaratave që avokati i jep si të mbështetura mbi njohuritë e tij. Termi 'ka dijeni' rregullon detyrimin lidhur me provat e deklaratave të dëshmitarit ose të dokumenteve që janë haptas të falsifikuara. Gjykata ose një vëzhgues tjetër mund të arrijnë në përfundimin se avokati *kishte dijeni* se provat ishin të falsifikuara vetëm në rastet kur provat janë haptas të falsifikuara.

Dispozita e Kodit italian lidhur me 'vendimet e dhëna' i përgjigjet një problemi thuajse universal që lind në gjykatat me një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh. Në raste të tilla, avokatët e palëve janë të familjarizuar me situatën aktuale të çështjeve të tyre, por gjyqtari mund edhe të mos jetë, veçanërisht sa u takon vendimeve të marra më parë nga një gjyqtar tjetër. Avokatët nuk duhet të 'luajnë' me sistemin duke kërkuar ndryshime të vendimeve kur dosja kalon nga gjyqtar te një gjyqtar tjetër. Mundësia për të vepruar në këtë mënyrë është tepër e madhe në sistemet e gjykatave me kalendarë të mbingarkuar dhe me një dhomë avokatie aq të madhe saqë gjyqtarët dhe avokatët nuk e njohin njëri- tjetrin. Në disa sisteme ligjore kontinentale koncepti se ndryshimi në vendime nuk duhet të kërkohet kur dosja kalon nga një gjyqtar te një gjyqtar tjetër quhet me një lloj tolerance 'ekonomi procedurale'. Problemi është se një vendim i marrë në një fazë më të hershme të çështjes vazhdon të drejtojë procesin edhe në fazat e mëvonshme, madje edhe nëse vendimi është i pasaktë ose është marrë nga një gjyqtar tjetër.

Kodi i sjelljes për avokatët në Komunitetin Europian, seksioni 4.4., thotë thjesht se: "Një avokat nuk duhet t'i japë asnjëherë gjykatës me dijeninë e tij informacion të gabuar ose të rremë." Për fat të keq, në disa sisteme ligjore

avokatët përpiqen t'i shmangen kësaj rregulle sa më shumë që të jetë e mundur. Gjyqtarët janë mosbesues ndaj pothuajse çdo gjëje që thonë avokatët dhe detyrimi për të qenë të hapur me gjykatën është pothuajse i papërdorshëm. Në çdo rast, nëse gjyqtari nuk i beson ato që thotë avokati, në pjesën ku avokati flet për gjëra për të cilat ka njohuri personale, avokati do të ketë vështirësi në komunikimet e ardhshme me gjyqtarin, ndoshta edhe me gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate. Gjyqtarët mund të reagojnë me sanksione të ndryshme, në varësi të sistemit. Për shembull, në rast të mungesës së disponueshmërisë së dëshmitarit për shkak të sëmundjes së tij, gjyqtari mund t'i kërkojë avokatit të paraqesë vërtetimin e doktorit, por, nëse gjyqtari i beson avokatit, deklarata gojore e avokatit do të ishte e mjaftueshme. Ky aspekt i reputacionit të avokatit në sistemin ligjor shpesh referohet si 'kredit' ose 'kredibilitet' i avokatit. Sikurse reputacioni në përgjithësi, edhe kredibiliteti i avokatit në gjykatat krijohet ose prishet nëpërmjet përvojave dhe shkëmbimeve informale të përvojave.

Që prej kohëve të hershme, mbi avokatët janë vendosur detyrime kundër abuzimeve të tilla, si sjellja para gjykatës e padive të pabazuara, bërja e mocioneve të panevojshme, tejzgjatjet e procedurave dhe shqetësimi i dëshmitarëve.

Dhoma amerikane e Avokatëve, në rregullën 3 - 4, parashikon se një avokat nuk duhet:

- të pengojë në mënyrë të paligjshme aksesin e palës tjetër për provat e çështjes, të ndryshojë në mënyrë të paligjshme, të shkatërrojë ose të fshehë një dokument ose materiale të tjera që mund të kenë fuqi provuese;
- të falsifikojë provat, të ndihmojë dëshmitarët për të dhënë dëshmi të rreme ose të nxitë marrjen në pyetje të një dëshmitari që ndalohet me ligj;

[...]

- t'u referohet çështjeve (gjatë procesit gjyqësor) që nuk mbështeten mbi prova të pranueshme, të shprehë qëndrime personale për faktet në diskutim ose të japë opinione personale për bazueshmërinë e një shkaku, për kredibilitetin e një dëshmitari, fajësinë e një pale ndërgjyqëse në një çështje civile ose për fajësinë ose pafajësinë e një personi të akuzuar.

Një tjetër rregull e Dhomës amerikane të Avokatëve parashikon në mënyrë më të përgjithshme se: "Një avokat nuk duhet të ngrejë ose të mbrojë para gjykatës një padi, të pohojë ose të përgënjeshtrojë një çështje, për aq kohë sa nuk ka baza ligjore për të vepruar në këtë mënyrë".

[...]

Abuzimet procedurale të ngjashme me ato të përmendura në Kodin amerikan të etikës ndodhin edhe në sistemet e së drejtës kontinentale, megjithëse janë

disi të ndryshme për shkak të ndryshimeve procedurale që reflektohen në rolin e gjyqtarit dhe të avokatit në këto sisteme. Në sistemet ligjore kontinentale, një gjyqtar i kujdesshëm do ta dallonte dhe do të merrte menjëherë masa për një konflikt të pabazuar. Gjithsesi, një shqyrtim i tillë nuk do të ekzistonte në rastin e gjyqtarëve indiferentë ndaj abuzimeve, i cili, për fat të keq, është rasti në shumë prej sistemeve ligjore kontinentale. Por, në çdo sistem ligjor, ndodh rrallë që abuzimet procedurale t'u nënshtrohen procedimeve disiplinore profesionale. Në sistemet gjyqësore të drejtuara si duhet, me gjyqtarë dhe avokatë shumë të disiplinuar, numri i vogël i ankesave për abuzime procedurale sugjeron se edhe kundërvajtjet janë të pakta në numër. Në sisteme të tjera, mungesa e ankesave mund të tregojë se vetëm një sjellje jokorrekte shumë e ekzagjeruar do të tërhiqte vëmendjen e gjykatave ose të autoriteteve disiplinore.

Në rastet kur zbatimi i ligjit kundër abuzimeve procedurale nuk është shumë kërkues, pala që ka vuajtur nga abuzimi procedural, ka pak mundësi për të kundërshtuar, përveç depozitimit në gjykatë të një kërkese për zhdëmtim. Gjykatat hezitojnë të përfshihen dhe një referim pranë autoriteteve disiplinore thjesht nënkupton një raund tjetër të mosmarrëveshjes. Për avokatët që akuzohen, një referim i tillë mund të jetë një përpjekje e palës kundërshtare për të risjellë para gjykatës një çështje të rrëzuar më parë. Kur mjeti i vetëm praktik i ankimit është kërkesa për zhdëmtim, rezultati është një ulje e nivelit të standardeve procedurale dhe një gjendje kronike e abuzimeve procedurale. Shumë sisteme të gjykatave janë në këto kushte. Në shumë sisteme aparati disiplinor është thjesht formal. Ankesat bëhen rrallë, pasi dihet se në përgjigje të tyre do të bëhet shumë pak ose aspak. Kjo vjen për shkak të faktit se nuk ka një personel investigativ për t'u marrë me provat dhe nuk ka një komitet aktiv të Dhomës së Avokatëve që të marrë në shqyrtim provat që mund të grumbullohen.

Në shumë sisteme ligjore, gjyqtarët i konsiderojnë problemet që lidhen me sjelljen jokorrekte të avokatëve, si diçka që është jashtë përgjegjësive të tyre. Në shumë sisteme të së drejtës kontinentale, gjyqtari nuk ka autoritetin të vendosë sanksione të drejtpërdrejta mbi një avokat që kryen një shkelje. Si pasojë, ideja e 'abuzimeve procedurale' si një çështje që tërheq vemendjen gjyqësore, në shumë sisteme nuk është zhvilluar sa duhet ose është thuajse inekzistente".

2. Ligji për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë

L I G J
Nr.9109, datë 17.7.2003,

"PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

KREU I

PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Avokatia në Republikën e Shqipërisë është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar.

Neni 2

Avokati jep ndihmë juridike nëpërmjet:

a) këshillimit ligjor për çështje të ndryshme;

b) përgatitjes së kërkesëpadive ose të kërkesave gjatë procedimit penal, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit ose të organeve të administratës publike;

c) përgatitjes së kërkesave drejtuar gjykatës së apelit, Gjykatës Kushtetuese, gjykatave ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë;

ç) përgatitjes së ankesave dhe kërkesave të personave fizikë ose juridikë;

d) përpilimit të akteve që u nënshtrohen veprimeve noteriale;

dh) hartimit të kontratave e të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike;

e) pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale;

ë) përfaqësimit të personave fizikë ose juridikë në çështjet civile dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike;

f) veprimeve të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj.

Neni 3

1. Avokati ushtron profesionin e tij individualisht ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë, duke u organizuar në zyra avokatie.
2. Avokati nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zyre avokatie.

Neni 4

Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, nuk mund të jetë, njëkohësisht, gjyqtar, prokuror, noter, nëpunës civil ose punonjës i administratës publike.

Neni 5

1. Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përpara çdo gjykate, prokurorie ose organi të administratës publike.
2. Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin e shtetit ku jepet ndihma juridike.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRAT E AVOKATIT

Neni 6

1. Avokati, në funksion të ushtrimit të profesionit të tij, ka të drejtë të kërkojë nga institucionet e administratës publike, në përputhje me ligjin, shpjegime, të dhëna dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.
2. Institucionet e administratës publike, sipas kompetencës dhe procedurave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, janë të detyruara të përmbushin kërkesat e avokatit.
3. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të institucioneve të administratës publike ose nga entet e tjera jopublike, avokati ka të drejtë të paraqesë brenda 5 ditëve në gjykatë kërkesën për realizimin e detyrimit nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

Neni 7

1. Avokati ka të drejtë të takojë personin e mbrojtur prej tij, në mënyrë private dhe pa kufizim kohor, në çdo gjendje të kufizimit të lirisë personale. Organet kompetente kanë të drejtë të mbikëqyrin takimin ndërmjet avokatit dhe personit të mbrojtur, por, në çdo rast, u ndalohet të dëgjojnë bashkëbisedimin ndërmjet tyre.
2. Organi i prokurorisë, gjykata, administrata e burgjeve dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të sigurojnë praninë e avokatit, kur këtë e kërkon personi i mbrojtur prej tij, i ndaluar, i arrestuar ose që është duke vuajtur dënimin. Në të gjitha rastet, prania e avokatit duhet të sigurohet menjëherë.
3. Avokati nuk ka të drejtë t'i kërkojë dhe t'i ofrojë ndihmë juridike një personi të ndaluar ose të arrestuar, pa kërkesën e këtij të fundit.

Neni 8

Avokati ka të drejtë, në përputhje me procedurat hetimore, të marrë pjesë në proces, të pyesë personin e mbrojtur prej tij, dëshmitarët dhe ekspertët, të lexojë dhe të njohë në përfundim të hetimit të gjitha aktet e dokumentet, që janë të lidhura me çështjen dhe t' i nënshkruajë ato.

Neni 9

1. Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij.
2. Avokati duhet të sigurojë që asnjë konflikt interesash nuk ekziston ndërmjet tij dhe personit që mbron ose përfaqëson.
3. Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim.
4. Avokatit i ndalohet të bëjë kallëzim në organin e ndjekjes penale dhe nuk mund të pyetet si dëshmitar për personin, të cilit i ka kryer shërbime dhe ndihmë juridike, si dhe për rrethana që ai i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit.
5. Avokatit i ndalohet të marrë pjesë në një çështje, kur ai ka qenë i ngarkuar më parë në të si gjykatës, prokuror, oficer i policisë gjyqësore ose si dëshmitar.

6. Avokati nuk lejohet të japë ndihmë ligjore ose të përfaqësojë një person, kur ka këshilluar ose ka përfaqësuar më parë palën kundërshtare në të njëjtën çështje, ose kur avokati ka lidhje gjaku apo ka interes të njëjtë me palën kundërshtare.

7. Avokatët që shërbejnë në të njëjtën zyrë avokatie, nuk lejohen të përfaqësojnë palët kundërshtare në të njëjtën çështje.

8. Avokatët që ushtrojnë profesionin e tyre pranë së njëjtës zyrë avokatie, prezumohet se janë në dijeni dhe zotërojnë dokumentet për këdo që është mbrojtur apo është përfaqësuar nga zyra e tyre.

9. Përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, avokati është i detyruar të sigurohet se nuk vepron në konflikt me interesat e personit që mbrohet ose përfaqësohet prej tij. Kur avokati dyshon se është duke vepruar në konflikt interesash, ai duhet të marrë miratimin me shkrim nga palët, të cilat mendohet se preken nga ky konflikt interesash.

Neni 10

Avokatët, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duhet të mbajnë një libër shënimesh ku shënohen të gjitha shërbimet ligjore të dhëna, kontratat me shkrim, duke përdorur sistemin numerik, emrin e tij, si dhe emrin e zyrës së avokatisë.

Neni 11

1. Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtjur ose të përfaqësuar prej tij;

b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas

(masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë);

c) me ligj.

2. Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër.

Neni 12

1. Avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, që të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjykimit.

2. Shpërblimi me përqindje, i parallogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin e mbrojtjes apo të përfaqësimit të suksesshëm të çështjes.

3. Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huasë për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jo gjyqësisht.

Neni 13

1. Nëse avokati vendos të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e mëtejshme e një personi, është i detyruar ta njoftojë atë 15 ditë përpara mbarimit të shërbimit nga ana e tij.

2. Avokati është i detyruar t'i shërbejë klientit të tij gjatë periudhës 15-ditore para mbarimit të shërbimit dhe t'i njoftojë atij çdo të dhënë për çdo shumë parash, prona apo kompensim që avokati mban për klientin.

3. Brenda 15 ditëve nga dhënia e njoftimit, avokati duhet t'i kthejë klientit të gjitha dokumentet e lidhura me çështjen ose t'i dërgojë ato në adresën e treguar nga avokati i ngarkuar rishtas. Gjithashtu, avokati është i detyruar t'i kthejë klientit parapagimin që ka marrë prej tij, përveç kur, bashkërisht, merren vesh ndryshe.

Neni 14

Nëse personi që përfiton ndihmën juridike nga avokati, vendos të zgjidhë kontratën përpara përfundimit të çështjes ose shërbimit, avokati ka të drejtën të kërkojë shpërblimin për punën e kryer.

Neni 15

Avokati ka të drejtë të transferohet nga një dhomë në një dhomë tjetër avokatie, për sa kohë që paguan kontributet përkatëse të anëtarësisë. Në këtë rast ai duhet të marrë një miratim, si nga dhoma që largohet, ashtu edhe nga dhoma ku ai dëshiron të bëhet anëtar.

Neni 16

1. Avokati, kryesisht apo për shkak të ligjit, duhet të heqë dorë përkohësisht nga ushtrimi i profesionit të tij, për aq kohë sa është në marrëdhënie pune me administratën publike.

2. Për të gjitha rastet e treguara në pikën 1 të këtij neni, avokati duhet të njoftojë me shkrim dhomën e avokatëve ku bën pjesë.

3. Në rast të ndërprerjes së ushtrimit të profesionit të avokatit për arsye të moshës ose të shëndetit, nëse nuk ushtron një veprimtari tjetër, avokati ka të drejtë të jetë anëtar i dhomës së avokatisë, si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë që organizohen prej saj.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË DHE TË DHOMAVE TË AVOKATISË

Neni 17

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik, që ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga shteti.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë.

3. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë parashikohen në statutin e saj.

4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjegjëse për themelimin e dhomave të avokatisë. Numri minimal i avokatëve që mund të formojnë një dhomë avokatie, caktohet në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

5. Çdo avokat mund të jetë anëtar vetëm i një dhome avokatie. Çdo dhomë është e përbërë nga avokatë, të cilët janë anëtarë të saj dhe praktikojnë ose kanë praktikuar për herë të fundit profesionin e avokatit në juridiksionin e saj.

6. Çdo dhomë avokatie ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat e parashikuara në ligj dhe në statutin e vendimet e tjera, të miratuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Neni 18

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të dhomave të avokatisë janë, përkatësisht, Këshilli i Përgjithshëm dhe Këshilli Drejtues.

Neni 19

1. Organi më i lartë i përfaqësimit dhe i vendimmarrjes i Dhomës Kombëtare të Avokatisë është Këshilli i Përgjithshëm.

2. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përbëhet nga jo më pak se një përfaqësues i zgjedhur për këtë qëllim nga çdo dhomë avokatie, sipas statutit.

3. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ushtron këto kompetenca:

a) miraton Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

b) miraton Kodin e etikës së avokatit;

c) përcakton, duke u bazuar në kriterin e vjetërsisë në profesionin e avokatit, të aftësive profesionale të treguara dhe në edukimin profesional e akademik të posaçëm dhe pas konsultimeve me ministrin e Drejtësisë, listën e avokatëve që mund të ushtrojnë profesionin e tyre përpara gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese (kriteret më të hollësishme për këtë përzgjedhje përcaktohen në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë);

ç) zgjedh jo më pak se 5 anëtarë të saj në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

d) cakton kontributin që derdhin dhomat e avokatisë në Dhomën Kombëtare të Avokatisë;

dh) shqyrton dhe miraton llogaritë vjetore dhe buxhetin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

e) analizon veprimtarinë e dhomave të avokatisë, nëse ajo është në përputhje me këtë ligj dhe me Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

ë) ndihmon dhe bashkërendon veprimtaritë e dhomave të avokatisë, në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të avokatëve, si dhe të dhomave të avokatisë;

f) miraton rregullat e përgjithshme për zhvillimin e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit;

g) miraton rregullat dhe kushtet që duhet të përmbushen nga asistentët në periudhën e stazhit për avokat, si dhe për trajnimin profesional të tyre.

4. Vendimet e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë,

për miratimin e akteve të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 3 të këtij neni, quhen të miratuara kur për to kanë votuar jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 20

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm të tij.

2. Rregulla më të hollësishme për organizmin dhe funksionimin e administratës mbështetëse të Këshillit Drejtues, caktohen në statut.

3. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ushtron këto kompetenca:

a) thërret Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

b) përgatit Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) përgatit Kodin e etikës së avokatit;

ç) përfaqëson Dhomën Kombëtare të Avokatisë në marrëdhënie më të tretët, sipas rregullave të caktuara në statut;

d) përgatit llogaritë vjetore për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

dh) shqyrton dhe miraton kërkesat për lejimin e ushtrimit të profesionit të avokatisë;

e) revokon me ose pa afat, ose heq lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje me ligjin dhe Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

ë) merr masa për ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të vendimeve të marra nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 21

Këshilli i përgjithshëm i çdo dhome avokatie ka këto kompetenca:

a) zgjedh përfaqësues të saj në Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në përputhje me numrin maksimal të pjesëmarrjes, të vendosur nga kjo e fundit;

b) zgjedh anëtarët e këshillit drejtues, kryetarin dhe sekretarin e dhomës;

c) shqyrton dhe analizon ecurinë në punë dhe trajnimin profesional të avokatëve dhe të asistentëve, që bëjnë pjesë në dhomën e avokatisë;

ç) promovon tek anëtarët e saj mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të ligjit, statutit dhe Kodit të etikës së avokatit;

d) përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarëve të saj;

dh) shqyrton dhe, nëse çmon, miraton vendimet e marra nga këshilli drejtues i dhomës së avokatisë;

e) mban regjistrin e anëtarëve që ushtrojnë apo kanë ushtruar profesionin e avokatit në atë juridiksion, si dhe njofton Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çdo ndryshim në përbërjen e saj.

Neni 22

Këshilli drejtues i dhomës së avokatisë ushtron këto kompetenca:

a) thërret mbledhjen e përgjithshme të dhomës së avokatisë;

b) përgatit çdo vit llogaritë vjetore, për shqyrtim dhe miratim nga këshilli i përgjithshëm;

c) trajton çdo kërkesë për anëtarësi dhe, nëse çmon, i rekomandon Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit;

ç) shqyrton dhe miraton statutin e zyrave të avokatisë që vendosen në juridiksionin e saj, kur çmon përputhshmërinë e tij me ligjin dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

d) cakton, me pëlqimin e tyre, avokatin apo zyrën e avokatisë, ku stazhieri do të përmbushë detyrimet e tij;

dh) cakton avokat për të ndjekur çështjet gjyqësore, kur i kërkohet nga gjykata;

e) cakton një avokat që të marrë përsipër çështje, të cilat janë braktisur nga një avokat i mëparshëm dhe klienti nuk ka mundur të gjejë një tjetër;

ë) shqyrton ankesat kundër asistentëve të avokatëve që ushtrojnë profesionin në juridiksionin e vet, si dhe merr masa disiplinore që i çmon të përshtatshme, në përputhje me ligjin, Kodin e etikës së avokatit dhe të statutit të vetë dhomës së avokatisë;

f) përmbush detyra të tjera të parashikuara në statutin e dhomës së avokatisë apo i që i caktohen nga këshilli i përgjithshëm i saj.

Neni 23

1. Dhoma mund të hapë llogari bankare në një bankë, që është e licencuar të ushtrojë biznes bankar në Republikën e Shqipërisë, për të mbajtur paratë e klientëve të ndryshëm të avokatëve anëtarë të dhomës, si garanci bankare për çështje që parashikojnë pagesa të mëdha.

2. Tërheqja e shumave nga ajo llogari duhet të kryhet me dy firma, njëra nga të cilat duhet të jetë nga kryetari, zëvendëskryetari ose sekretari i

përgjithshëm i dhomës dhe firma tjetër duhet të jetë nga klienti përkatës. Interesi bankar i përfituar nga ky operacion duhet t'i kalojë dhomës.

KREU IV

ZYRA E AVOKATISË

Neni 24

1. Kur dy ose më shumë avokatë dëshirojnë të themelojnë një zyrë avokatie, ata, fillimisht, duhet të dërgojnë aktin e themelimit dhe statutin e saj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë duhet të miratojë statutin e zyrës së avokatisë brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse ai nuk është dakord me statutin e paraqitur, ajo duhet t'ia kthejë të interesuarit modelin e paraqitur së bashku me kërkesën e saj për ndryshimet, që dhoma mendon se i duhen bërë statutit. Aplikanti duhet të kthejë projektin e ndryshuar brenda 15 ditëve.

3. Zyra e avokatisë, nëse e sheh të arsyeshme dhe brenda interesit të vet, pasi është miratuar si e tillë nga dhoma, mund t'i drejtohet gjykatës për t'u njohur si person juridik, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

KREU V

KUSHTET PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË AVOKATIT

Neni 25

Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë mund ta ushtrojë çdo shtetas shqiptar që plotëson këto kushte:

a) të ketë kryer arsimin e lartë juridik brenda vendit ose jashtë vendit, por të njësuar me të;

b) të jetë regjistruar në një dhomë avokatie dhe në Ministrinë e Drejtësisë si asistent pranë një avokati, të ketë përfunduar periudhën njëvjeçare të stazhit dhe të ketë marrë mendimin pozitiv të avokatit;

c) të ketë marrë më shumë se 50 për qind të pikëve në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatisë;

ç) të gëzojë integritet moral dhe qytetar, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të plotësojë kërkesat e etikës për ushtrimin e profesionit të avokatit;

d) të mos jetë dënuar për vepra penale të kryera me dashje, sipas parashikimeve të Kodit të etikës së avokatit;

dh) të mos jetë pjesëmarrës në marrëdhënie apo veprimtari publike ose private, të cilat, sipas ligjit, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodit të etikës së avokatit, janë të papajtueshme ose të papërshtatshme me figurën dhe ushtrimin e profesionit të avokatit;

e) të jetë anëtar i dhomës së avokatisë në juridiksionin e së cilës ndodhet zyra e tij e punës.

Neni 26

1.Provimi i kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit zhvillohet përpara një komisioni me këtë përbërje:

a) tre anëtarë të caktuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

b) një anëtar i caktuar nga ministri i Drejtësisë;

c) një anëtar i caktuar ndërmjet punonjësve akademikë të Shkollës së Magjistraturës.

2. Rregullat e funksionimit, numri i kandidatëve për avokat, si dhe mënyra si do të zhvillohet provimi, vendosen rast pas rasti nga Këshilli Drejtues i Dhomës së Avokatisë.

Neni 27

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose mbi kërkesën e personit që kërkon të ushtrojë profesionin e avokatit, ka të drejtë ta përjashtojë nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit, nëse për këtë vendoset me shumicën e votave të fshehta të të gjithë anëtarëve të saj.

2. Përjashtimi nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit mbështetet në kohëzgjatjen e tyre në ushtrimin e profesionit të juristit, aftësitë profesionale të treguara dhe edukimin e posaçëm profesional e akademik. Rregulla të hollësishme për kushtet dhe kriteret e përjashtimit nga provimi i kualifikimit caktohen nga Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. Vendimi për përjashtimin nga detyrimi, për dhënien e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, miratohet nga ministri i Drejtësisë.

Neni 28

Personat që kanë punuar jo më pak se 2 vjet si gjyqtarë, prokurorë, noterë, si dhe jo më pak se 3 vjet në pozicionin e drejtuesit, këshilltarit apo specialistit të strukturave juridiko-profesionale të Presidencës, Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, aparatit të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e strukturave të Avokaturës së Shtetit, si dhe në atë të punonjësit akademik të brendshëm të lëndëve juridike në shkollat e larta, përjashtohen nga përmbushja e detyrimit të parashikuar në shkronjën "b", pika 1, të nenit 25 të këtij ligji.

Neni 29

1. Avokati ka të drejtë të ketë një ose më shumë asistentë.
2. Asistentët zgjidhen nga vetë avokati ndërmjet personave të diplomuar juristë, që nuk kanë marrë lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit.
3. Avokati ka për detyrë që, brenda 15 ditëve nga ajo e lidhjes së marrëdhënieve të punës me asistentin, të depozitojë dokumentacionin e tij për regjistrim në dhomën e avokatisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë.
4. Me autorizimin me shkrim të avokatit dhe, kurdoherë, me pëlqimin me shkrim të klientit, asistenti përfaqëson ose mbron të interesuarit në periudhën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale dhe në seancat përgatitore për çështjet civile.

Neni 30

1. Kërkesa për ushtrimin e profesionit të avokatit i drejtohet, si rregull, dhomës së avokatisë ku kërkuesi ka vendbanimin e tij.
2. Dhoma e avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për ushtrimin e profesionit të avokatit, duhet të marrë në shqyrtim kërkesën dhe, së bashku me mendimin e saj, e përcjell për shqyrtim në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.
3. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të njoftojë kërkuesin, nëse ai i plotëson kushtet për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, si dhe për ditën e caktuar për zhvillimin e tij.

Neni 31

1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë shpall datat e zhvillimit të provimeve të kualifikimit, për ushtrimin e profesionit të avokatit, për atë vit kalendarik.
2. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, brenda muajit janar të çdo viti, miraton edhe përfaqësuesit e tij në komisionin e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Neni 32

Në qoftë se kandidati për avokat nuk arrin të grumbullojë minimumin e pikëve të nevojshme kualifikuese për ushtrimin e profesionit të avokatit, ai mund të marrë pjesë përsëri në provimin kualifikues, me kusht që të kryejë edhe gjashtë muaj të tjerë periudhë stazhi si asistent pranë një avokati.

Neni 33

1. Komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose me propozimin e dhomës së avokatëve, organeve gjyqësore, të prokurorisë, ministrit të Drejtësisë apo të personave të interesuar, është organi kompetent për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përgjigjet dhe kontrollohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, sipas rregullave të përcaktuara në statut ose nga vetë ai.

2. Rregulla të hollësishme për përbërjen dhe funksionimin e komitetit disiplinor dhe të komisioneve të posaçme disiplinore të Dhomës Kombëtare të Avokatisë caktohen në statut.
3. Leja për ushtrimin e profesionit të avokatit hiqet, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:

a) është lëshuar në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji;

b) vërtetohet se avokati ka përdorur dokumente të falsifikuara për të marrë lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit;

c) vuan nga një sëmundje, sëmundje mendore ose dëmtime fizike, të cilat bëjnë të pamundur ushtrimin normal të profesionit;

ç) është deklaruar i falimentuar;

d) nuk ka paguar kontributin e anëtarësisë;

dh) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat për ushtrimin e profesionit të avokatit;

e) është dënuar nga gjykata për kryerjen e veprave penale, me dashje, që janë parashikuar në Kodin e etikës së avokatit.

4. Për avokatët e huaj, përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, heqja e lejes së posaçme për ushtrimin e profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, bëhet edhe në rastin kur atij i është hequr leja e ushtrimit të profesionit të avokatit në shtetin e tij.

5. Shqyrtimi i çështjes dhe dëgjimi i avokatit të proceduar disiplinarisht, nëse është i mundshëm, bëhet nga një komision i posaçëm disiplinor, me dyer të mbyllura.

6. Avokati i proceduar disiplinarisht ka të drejtë të marrë pjesë dhe të dëgjohet nga komisioni disiplinor, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të caktuar prej tij, ndërmjet avokatëve.

7. Avokati përfaqësues duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit të çështjes.

8. Komisioni disiplinor duhet të marrë dhe të publikojë vendimin e tij brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e parë e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

KREU VI

REGJISTRAT E DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË

Neni 34

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Ministria e Drejtësisë mbajnë pranë tyre regjistrin e të gjithë avokatëve, si dhe administrojnë dokumentacionin përkatës, që lidhet me të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatit.

2. Regjistri i avokatëve, për secilin prej tyre, përmban të dhënat e mëposhtme:

a) identitetin;

b) datëlindjen;

c) shkollën e lartë ku avokati është diplomuar si jurist;

ç) titujt dhe gradat shkencore;

d) nivelin e njohurive në gjuhë të huaja;

dh) dhomën e avokatisë ku është anëtar, në juridiksionin e së cilës, si rregull, avokati ushtron profesionin e tij;

e) adresën e zyrës së tij ose adresën dhe emrin e zyrës së avokatisë, nëse avokati është anëtar i saj;

ë) të dhëna për thyerjen e disiplinës.

3. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ka në

kompetencë të vendosë që, përveç të dhënave të treguara në pikën 2 të këtij neni, në regjistrin e avokatëve të pasqyrohen edhe të dhëna të tjera.

4. Dhoma e avokatisë, për juridiksionin e saj, mban regjistrin e avokatëve dhe dokumentacionin përkatës, sipas listës së të dhënave të treguara në këtë nen.

Neni 35

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhomat e avokatisë për juridiksionin e saj, si dhe Ministria e Drejtësisë mbajnë regjistrin e asistentëve si dhe administrojnë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2. Regjistri i asistentëve, për secilin prej tyre, përmban të dhënat e mëposhtme:

a) adresën e zyrës së tij ose adresën dhe emrin e zyrës së avokatisë, nëse avokati është anëtar i saj;

b) identitetin;

c) datëlindjen;

ç) shkollën e lartë ku asistenti është diplomuar si jurist;

d) titujt dhe gradat shkencore, nëse ka të tilla;

dh) nivelin e njohurive në gjuhë të huaja;

e) datën e fillimit dhe të përfundimit të periudhës së stazhit, të nevojshme për pranimin e pjesëmarrjes së tij në provimin e kualifikimit, për ushtrimin e profesionit të avokatit;

ë) datat e provimit të kualifikimit, në rast se nuk është kualifikuar;

f) emrin dhe adresën e avokatit, pranë të cilit ushtron veprimtarinë e tij si asistent.

2. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë ka në kompetencë të vendosë që, përveç të dhënave të treguara në pikën 2 të këtij neni, në regjistrin e asistentëve të pasqyrohen edhe të dhëna të tjera.

KREU VII

AVOKATI I HUAJ

Neni 36

1. Shtetasi i huaj mund të ushtrojë profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë nëse plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj për shtetasit shqiptarë dhe pas dhënies së provimit të kualifikimit në gjuhën shqipe.

2. Rregullat për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit të huaj përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

KREU VIII

ANKIMET DHE DISIPLINA

Neni 37

1. Ankesat për çdo sjellje ose veprim të avokatit i drejtohen kryetarit të dhomës së avokatisë.

2. Ankimi kundër avokatit mund të bëhet nga:

a) çdo person që mbrohet, përfaqësohet ose ndihmohet juridikisht prej tij;

b) çdo person i tretë, që pretendon se është dëmtuar nga sjellja ose veprimet e avokatit.

3. Këshilli drejtues i dhomës së avokatisë duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë ankesën, duke u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj. Me të njëjtat kritere të shqyrtohet rasti i ankimit të një avokati kundër një avokati tjetër.

4. Në rast se, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, rezulton se rrethanat e paraqitura në të janë të vërteta, avokatit përgjegjës i kërkohet:

a) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të zgjidhë problemin në fjalë;

b) të kompensojë dëmin e shkaktuar ankuesit, në masën që çmohet e drejtë nga rrethanat që rezultojnë nga shqyrtimi i ankesës.

5. Avokati ose ankuesi, në qoftë se nuk bien dakord me vendimin, kanë të drejtën e apelimit në komitetin disiplinor të dhomës së avokatisë.

6. Apelimi duhet t'i paraqitet me shkrim sekretarit të dhomës brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit.

Neni 38

1. Avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor në rast se pretendohet se:

a) ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e avokatisë;

b) ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në statut, në Kodin e etikës së avokatit dhe me rregullat e tjera, të vendosura nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe dhomat e avokatisë;

c) është bërë apelim nga ankuesi ndaj një vendimi, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 37 të këtij ligji.

2. Procedimin disiplinor të avokatit kanë të drejtë ta kërkojnë personat e treguar në pikën 2 të nenit 37 të këtij ligji, si dhe organet drejtuese të dhomës së avokatisë. Ministri i Drejtësisë, nëse çmon se ka vend për procedim disiplinor, mund t'i sugjerojë Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë ndërmarrjen e një veprimi të tillë.

Neni 39

1. Procedimi disiplinor ndaj avokatit realizohet nga komiteti disiplinor i dhomës përkatëse ku ai është anëtar.

2. Komiteti disiplinor përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe jo më shumë se pesë avokatë me përvojë, të zgjedhur nga këshilli i përgjithshëm i dhomës së avokatisë.

3. Komiteti disiplinor shqyrton dhe gjykon çështjet nëpërmjet një komisioni disiplinor, të përbërë nga jo më pak se tre dhe jo më shumë se pesë anëtarë. Përbërja e komisionit disiplinor caktohet nga këshilli drejtues i dhomës së avokatisë.

Neni 40

1. Procedimi disiplinor fillon me paraqitjen e kërkesës nga subjektet e treguara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji.

2. Brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, këshilli drejtues i dhomës së avokatisë cakton përbërjen e komisionit disiplinor dhe, nëpërmjet kryetarit të tij, duhet të njoftojë palën kërkuese dhe avokatin që është subjekt procedimi disiplinor, për orën, datën, vendin e zhvillimit të seancës, si dhe për përbërjen e komisionit disiplinor të zgjedhur për shqyrtimin e çështjes.

3. Procedura disiplinore duhet të zhvillohet brenda 30 ditëve nga ajo e paraqitjes së ankesës.

4. Në çdo kohë, por jo më vonë se 7 ditë nga data e caktuar për zhvillimin e seancës, palët mund t'i kërkojnë këshillit drejtues të dhomës së avokatisë, duke paraqitur motive të arsyeshme që:

a) të caktojë një datë tjetër për zhvillimin e seancës së procedimit disiplinor;

b) të ndryshojë përbërjen e komisionit disiplinor.

Neni 41

1. Palët në procedimin disiplinor kanë të drejtë të paraqiten dhe të shpjegohen në seancë vetë ose nëpërmjet mbrojtjes dhe përfaqësimit me avokat. Në qoftë

se njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në seancë, pa motive të arsyeshme, komisioni disiplinor shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

2. Gjatë procedurës ankimore, komisioni disiplinor mund të dëgjojë shpjegime nga palët dhe dëshmitarët e tyre.

3. Shpjegimet e palëve dhe dëshmitë në seancë mund të jepen me gojë ose me shkrim.

4. Komisioni disiplinor mund të marrë në konsideratë dokumentet e paraqitura përpara tij, me cilësinë e provës, si dhe të urdhërojë avokatin që procedohet për thyerje disiplinore, që të paraqesë përpara tij dosjen ose dokumentet që disponon për çështjen, subjekt gjykimi.

Neni 42

1. Komisioni disiplinor duhet të marrë vendimin e tij dhe ta shpallë atë brenda 10 ditëve. Vendimet në komision disiplinor merren me shumicën e votave të anëtarëve të vet.

2. Komisioni disiplinor duhet t'u dërgojë palëve, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrisë së Drejtësisë kopje të vendimit të shpallur prej tij.

Neni 43

Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit të avokatit, komisioni disiplinor i dhomës së avokatisë mund të japë një nga masat disiplinore të mëposhtme:

a) vërejtje me shkrim;

b) gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet;

ç) i propozon komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Neni 44

1. Komisioni disiplinor, përveç masave të përmendura më sipër, mund të urdhërojë avokatin e proceduar për thyerje disiplinore që t'u paguajë palëve të dëmtuara një shumë të hollash si kompensim për dëmin e shkaktuar.

2. Komisioni disiplinor mund të urdhërojë avokatin e proceduar për thyerje disiplinore, që të paguajë shpenzimet e palëve të tjera dhe të dhomës së avokatisë për përballimin e çështjes disiplinore në fjalë.

Neni 45

1. Palët pjesëmarrëse në procedimin disiplinor, brenda dhjetë ditëve nga shpallja e vendimit të komisionit disiplinor, mund të bëjnë apel në komitetin disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Avokati, brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, mund ta apelojë vendimin e komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë në gjykatën e apelit Tiranë.

Neni 46

Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të regjistrojë vendimet e procedurave disiplinore dhe të njoftojë Ministrinë e Drejtësisë për këto vendime. Regjistrat duhet të jenë të hapur për t'u parë nga çdo avokat.

Neni 47

1. Çdo avokat dhe çdo zyrë avokatie duhet të kenë një vulë.

2. Vula duhet të tregojë titullin "avokat", identitetin e avokatit ose të avokatëve dhe, në rastin e një zyre avokatie, adresën e zyrës.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

1. Ministria e Drejtësisë kujdeset që veprimtaria e avokatisë të ushtrohet normalisht dhe në përputhje me ligjin.

2. Rregullat e hollësishme për ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje me këtë ligj, caktohen në statutin dhe në Kodin e etikës së avokatit, të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifat e shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 49

1. Avokatët që kanë fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligj, nuk u nënshtrohen detyrimeve për pjesëmarrjen dhe kalimin me sukses të provimit kualifikues, të parashikuar nga ky ligj.

2. Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të dhomave të avokatëve vazhdojnë veprimtarinë e tyre deri në përfundim të afateve, të parashikuara në ligjin nr. 7827, datë 31.5.1994, "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë".

3. Procedurat e emërimit si asistentë pranë një avokati dhe periudha e kryerjes së stazhit nga ana e tyre, për personat që i kanë përmbushur ato përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme edhe për efekt të vlefshmërisë së emërimit si asistent dhe ecurisë së afatit njëvjeçar të punës së tyre, të parashikuara nga nenet 25, shkronja "b" dhe 29 të këtij ligji.

Neni 50

Dispozitat e statutit dhe të Kodit të etikës së avokatit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të miratura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen kur nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 51

Ligji nr. 7827, datë 31.5.1994, "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 52

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

3. Ngarkimi i shpenzimeve gjyqësore

Kodi shqiptar i procedurës civile përmban rregulla për caktimin dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore në nenet 102 e në vazhdim. Në mënyrë të veçantë, neni 106 parashikon se palës që ka humbur, i kërkohet të paguajë shpenzimet e palës fituese, duke ndjekur kështu një qëndrim që është mbizotërues në sistemet ligjore kontinentale.

Shënim i autorit: *Që prej një kohe të gjatë, debati ligjor ndërkombëtar po vë në dukje rëndësinë e rregullave për ngarkimin e shpenzimeve procedurale për funksionimin e duhur të makinerisë së drejtësisë, si dhe për të rritur "aksesin në drejtësi". E njëjta gjë zbatohet edhe për rregullat e tarifave të avokatëve. Ndonëse zgjidhjet teknike (veçanërisht ato të përdorura në ShBA) mund të jenë shumë të ndryshme nga ato të traditës kontinentale, është e rëndësishme që gjyqtarët të kenë njohuri për disa çështje kryesore që janë të debatueshme në një numër vendesh gjithmonë në rritje. Parimi bazë në ligjin shqiptar, sikurse në Itali dhe Gjermani, është "ngarkimi i shpenzimeve", d.m.th. kërkesa që pala humbëse në një mosmarrëveshje gjyqësore t'i paguajë palës fituese të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve gjyqësore, duke përfshirë edhe tarifat e avokatit. Parimi i përgjithshëm që gjendet pas ngarkimit të shpenzimeve, është ta bëjë sa më të plotë fitoren e palës fituese. Ndërsa, në ShBA, qëndrimi kryesor (me disa përjashtime të pakta) është se secila nga palët është përgjegjëse për tarifat e avokatit të saj, pavarësisht nga fakti se cila palë humb apo fiton, në vendet e traditës kontinentale (kjo edhe për sa i përket Anglisë) ngarkimi i shpenzimeve është një normë e mosmarrëveshjeve ligjore.*

Për këtë ndryshim ndërmjet Amerikës dhe Europës janë kryer një sërë studimesh mbi aspektin praktik të ngarkimit të shpenzimeve për funksionimin e sistemit ligjor dhe për shoqërinë në tërësi.

Sikurse ka shkruar edhe H.M.Kritzer, në ***"Tarifat e avokatit dhe sjellja e avokatit në mosmarrëveshjet gjyqësore: çfarë thotë realisht literatura empirike?"***(Teksas, rishikimi i ligjit 80, qershor 2002, faqe 1943-1983), problemi mund të studiohet nga perspektiva të ndryshme:

"Efektet e ngarkimit të shpenzimeve kanë qenë subjekt i një pune të gjerë teorike nga profesorët e së drejtës dhe ekonomistët. Çështjet që ata kanë parashtruar përfshijnë:

- Efektet e ngarkimit të shpenzimeve mbi depozitimin e mosmarrëveshjeve të 'pabazuara' [...].
- Efektet mbi marrjen e vendimeve për gjetjen e zgjidhjeve alternative në raport me depozitimin e çështjeve në gjykatë.
- Efektet e rregullave për ngarkimin e shpenzimeve në çështjet që zgjidhen me marrëveshje lidhur me ngarkimin e shpenzimeve.
- Vëllimi i mosmarrëveshjeve.
- Zhvillimi i ligjit.

Çuditërisht, midis atyre që kanë marrë përsipër të kryejnë këto analiza teorike, ka pak kompromis. Disa analistë argumentojnë se ngarkimi i shpenzimeve duhet të rritë predispozicionin për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet

pa shkuar para gjykatës, ndërsa të tjerë argumentojnë se ai do të rritë numrin e çështjeve që do të shkojnë në gjykatë. Disa thonë se numri i çështjeve të depozituara do të ulet, ndërsa të tjerë thonë se ky numër do të rritet, megjithëse ky ndryshim në mendime reflekton pjesërisht edhe llojet e çështjeve që merren në konsideratë nga analistët (pra, çështjet jo shumë të bazuara do të kenë më pak gjasa të sillen para gjykatave, ndërsa çështjet me një bazueshmëri më të madhe do të kenë më shumë gjasa të sillen para gjykatave). Katz e përmbledh si më poshtë këtë pasiguri:

Njohuritë ekonomike aktuale nuk na krijojnë mundësinë të parashikojmë me siguri nëse prirja drejt një zhdëmtimi më të plotë do të rritë apo do të zvogëlojë kostot e mosmarrëveshjeve, duke mos përmendur këtu nëse do të ishte më mirë t'i renditnim këto shpenzime përkrah me çdo përfitim tjetër social që mund të prodhohet. Arsyeja e këtij konkluzioni agnosticist (jo shumë të besueshëm) është e kuptueshme. Shpenzimet ligjore influencojnë të gjitha aspektet e procesit të mosmarrëveshjes, që prej vendimit për depozitimin e kërkesëpadisë e zgjedhjen midis zgjidhjes së saj me marrëveshje apo me proces gjyqësor. Kombinimi i gjithë këtyre efekteve të jashtme është tepër i vështirë për t'u rregulluar me anë të rregullës së thjeshtë ku "paguan humbësi". Në vend të kësaj, zhdëmtimi i tarifave ligjore rregullon disa efekte të jashtme, ndërkohë që nuk arrin të adresojë, madje përkeqëson disa të tjera. Literatura konfirmon kompleksitetin e efekteve të ngarkimit të shpenzimeve".

Shënim i autorit: *Midis studimeve të cituara nga Kritzer, një mjaft interesant është realizuar në Ontario, Kanada, e cila, ndryshe nga ShBA-ja, zbaton rregullën e ngarkimit të shpenzimeve që aplikohet në Europën kontinentale dhe në Shqipëri. 'Një studim i kohëve të fundit, i cili u mbështet mbi intervista të shumta më tepër sesa mbi analiza statistikore të rasteve aktuale, përfshin ngarkimin e shpenzimeve në Ontario. Në vitin 1982, unë zhvillova një numër intervistash me korporata avokatësh dhe korporata zyrtarësh në Toronto dhe rrethinat e saj. Një prej temave më të rëndësishme të intervistave ishte ndikimi i perceptuar i ngarkimit të shpenzimeve. Personat që iu përgjigjën këtyre intervistimeve e diferencuan ndikimin e ngarkimit të shpenzimeve sipas dy dimensioneve kryesore: përmasat e çështjeve (të thjeshtat kundrejt të ndërlikuarave) dhe lloji i mosmarrëveshjeve (individualet kundrejt korporatave). E thënë më thjesht, për korporatat, ngarkimi i shpenzimeve ishte pjesë e bërjes së llogarive se kur duhej zgjidhur një çështje dhe nëse kjo çështje duhej të adresohej në gjykatë. Në më të shumtën e rasteve, çështja e shpenzimeve është dytësore krahasuar me interesat e mëdha që janë në lojë, dhe ndërsa çështjet bëhen më pak të rëndësishme, shpenzimet dhe ngarkimi i shpenzimeve bëhet një problem gjithmonë e më i ndjeshëm. Sipas të intervistuarve, rezultati përfundimtar ishte inkurajimi i zgjidhjes së çështjeve me marrëveshje në rastet kur korporata është palë e paditur dhe mosnxitja e ngritjes së padive, veçanërisht kur ekzistojnë dyshime për çështjen, në rastet kur korporata vepron si palë paditëse. Sipas të intervistuarve, për individët, efektet e ngarkimit të shpenzimeve ishin të drejtpërdrejta: 'ngarkimi i shpenzimeve shërben për të mos i nxitur individët të përfshihen në çështje që mund të përfundojnë në gjykatë ose për t'i inkurajuar ata të pranojnë zgjidhje që mund të jenë më pak të favorshme se ato që mund të arrihen në gjykatë'.*

Megjithëse jo e shprehur në këta terma, ishte e qartë se të intervistuarit i shihnin palët ndërgjyqëse (kur ato ishin individë) si të prirura për t'iu shmangur rreziqeve. Disa avokatë e cilësuan këtë shqetësim duke theksuar se, për shumë individë, kërcënimi se duhet të paguajnë shpenzimet e palës tjetër nuk është aspak i pëlqyeshëm, pasi këta individë nuk kanë mjete me anë të të cilave t'i paguajnë këto shpenzime. Dy të intervistuar e përmblodhën mendimin e tyre në këtë mënyrë: vetëm korporatat dhe të varfrit mund të përballojnë çështje të mëdha. Mosmarrëveshjet para gjykatës janë sporti ose i njerëzve shumë të pasur, ose i njerëzve shumë të varfër.

Pra, efektet e përshkruara nga të intervistuarit e mi kishin të bënin më shumë me palët e mundshme ndërgjyqëse sesa me avokatët që duhet të përfaqësonin këto palë. Një efekt i mundshëm mbi avokatët, i sistemit të përmendur nga vetë ata, ishte praktika që avokatët e palëve paditëse të dëmtuara personalisht të hiqnin dorë nga tarifa që u takonte, në rast se çështja nuk fitohej, pjesërisht për shkak të faktit se avokatët kuptuan se klientët e tyre do të kishin mjaft probleme për të paguar shpenzimet e palës kundërshtare dhe nuk do të kishin mundësi të paguanin edhe avokatin e tyre.

Intervistat e kryera në Ontario nxorën në pah edhe një çështje tjetër të rëndësishme që kishte të bënte me ngarkimin e shpenzimeve dhe, më konkretisht, me mënyrën e ngarkimit të shpenzimeve në rastet e zgjidhjes së çështjes me marrëveshje. Në Angli, tradita është që pala e paditur pranon të paguajë shpenzimet e palës paditëse, duke pasur mundësinë të kërkojë 'vlerësimin' e shpenzimeve (gjë që do të thotë se pretendimi për shpenzimet rishikohet nga një punonjës i gjykatës). Megjithatë, duket se, në vende të tjera, çështja e shpenzimeve ose nuk është pjesë e shprehur e zgjidhjes se çështjes me marrëveshje, ose është kryesisht pjesë e negociatave. Kjo e fundit është edhe modeli i aplikuar në Ontario. Në intervistat që zhvillova në këtë vend në vitin 1982, përgjigjet thoshin se çështja e ngarkimit të shpenzimeve trajtohet si pjesë e paketës së çështjeve që zgjidhen me marrëveshje dhe disa prej palëve besonin se, në zgjidhjet e çështjeve me marrëveshje, mënyra më e mirë ishte të parashikohej shprehimisht një element i "shpenzimeve" dhe të tjerë mendonin se varianti më i mirë do të ishte që thjesht të përmendej një

shifër dhe t'i lihej avokatit dhe klientit të tij/saj të zgjidhnin konkretisht më pas çështjen e tarifave ligjore. Një person me të cilin kontaktova, i cili ishte një prej atyre individëve që qëndronin hapur në anën e avokatit, më tha se në shumë raste çështja kryesore për arritjen e një zgjidhjeje me marrëveshje është trajtimi i problemit të shpenzimeve në mënyrë që avokati i palës paditëse të sigurohet se do të marrë tarifën e tij/saj; kryesisht, ky person sugjeronte se, nëse përmbusheshin interesat e avokatit, edhe çështja mund të zgjidhej. Nuk mund të përcaktoj dot se deri në çfarë mase kjo gjë përkonte me çështjen konkrete ose sa e përhapur ishte kjo pikëpamje".

Shënim i autorit: *Përveç rregullave legjislative për caktimin përfundimtar të shpenzimeve gjyqësore, ndërmjet sistemeve ligjore ekziston një larmishmëri edhe më e madhe për sa u përket metodave të përllogaritjes së tarifave ligjore dhe të asaj që ndodh në praktikë lidhur me atë që i paguan aktualisht shpenzimet e shërbimeve ligjore. Edhe në këtë rast, Kritzer paraqet një klasifikim interesant, duke dhënë disa konkluzione përfundimtare për ndërlikimet etike:*

"Avokatët nuk janë asgjë nëse nuk janë krijues dhe kjo krijueshmëri tregon mënyrat e shumta që avokatët kanë përdorur për llogaritjen e tarifave të tyre. Fusha e gjerë e përllogaritjeve të tarifave mund të grupohet sipas gjashtë llojeve të ndryshme të përllogaritjeve:

• Tarifat fikse, ku avokatët specifikojnë një tarifë që parapaguhet; tipike për punën e përditshme ku detyrat janë të përcaktuara qartë dhe të parashikuara.

• Tarifat që bazohen mbi kohën, ku avokati përcakton kohën që ka harxhuar dhe e llogarit tarifën duke shumëzuar orët e punës me honoraret për një orë.

• Tarifat mbi bazën e detyrave që përmbushen, ku avokati cakton shuma fikse për secilën prej nëndetyrave (për shembull, kaq për shkrimin e një letre, kaq për një bisedë telefonike etj.), në mënyrë tepër të ngjashme me një doktor që e merr pagesën në varësi të procedurave që kryen.

• Skemat statutore, ose të tjera të mbështetura mbi ligje, të cilat janë të lidhura në njëfarë mënyre me vlerën e transaksionit ose me shumën e të hollave të përfshirë në mosmarrëveshje.

• Tarifat e mbështetura mbi komisione, ku tarifa e avokatit bazohet mbi një përqindje të caktuar të shumës që rikuperohet, ose të vlerës së çështjes që trajtohet.

• Tarifat e 'bazuara mbi vlerën', ku avokati gjykon për punën dhe rezultatin e arritur në 'interes' të klientit dhe e përcakton tarifën në bazë të asaj që avokati mendon se klienti duhet ose është i gatshëm të paguajë.

Listës së mësipërme i mungojnë 'tarifat e ngjarjeve të mundshme', 'tarifat e kushtëzuara' dhe 'tarifat e kështillimit'. Kjo vjen për shkak të faktit se këto nuk janë metoda të llogaritjeve, me përjashtim të 'tarifave të mbështetura në komisione', të cilat, nga natyra, janë tarifa të ngjarjeve të mundshme. Çështja nëse avokati e ngre ose e ul nivelin e tarifës bazuar mbi rezultatin përfundimtar mund të përfshihet në secilën prej tri metodave të para të përllogaritjeve. Bonuset, në rast të fitimit të çështjes, dhe zbritjet, në rast të humbjes së saj, janë të përfshira në dy rregullimet e fundit. Elementi i ngjarjeve të mundshme për llogaritjen e tarifave mund të diskutohet si një nënçështje e përllogaritjes së tarifave.

Çështja se kush i paguan tarifat e avokatit ose, në mënyrë alternative, kush mbulon shpenzimet e shërbimeve të avokatit, është më e drejtpërdrejtë. Kryesisht, ekzistojnë katër mundësi 'të qarta':

• Përdoruesi i shërbimeve ligjore e paguan tarifën nga burimet e vetë përdoruesit të këtyre shërbimeve.

• Tarifa paguhet nga pala kundërshtare.

• Tarifa paguhet nga një palë e tretë ose, thënë ndryshe, pala e tretë mbulon shpenzimet e shërbimeve të avokatit.

• Avokati e kryen punën pa asnjë tarifë (d.m.th. avokati mbulon shpenzimet e shërbimeve avokatore).

E para prej këtyre metodave, pra 'pagesa private' merr tri forma kryesore:

• Pagimi i një avokati privat duke përdorur burimet në zotërim.

• Pagimi i një avokati privat duke përdorur fonde të siguruara nga pala kundërshtare.

• Pagimi i rrogës së një avokati të punësuar nga përdoruesi i shërbimeve ligjore.

Sistemi i dytë, në të cilin është pala kundërshtare ajo që paguan tarifat, ndodh në tri situata:

• Kur ekziston një parim i përgjithshëm për ngarkimin e shpenzimeve, i cili është rasti i shumë prej vendeve të tjera, përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

• Kur ekziston një ligj specifik që parashikon se pala humbëse duhet të paguajë edhe shpenzimet e palës fituese, sikurse është edhe rasti i një numri çështjes specifike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

• Kur ekziston një marrëveshje paraprake që parashikon mbulimin e tarifave ligjore.

Edhe pagesat e kryera nga një palë e tretë mund të marrin një prej formave të mëposhtme:

• Një 'agjenci sigurimesh' paguan tarifat e avokatit privat.

• Qeveria ose 'fondi i ndihmës ligjore' paguan tarifat e avokatit privat.

• Shërbimet garantohen nga një avokat me rrogë që punon për një agjenci

të shërbimeve ligjore që mund të financohet privatisht ose publikisht.

Forma përfundimtare e 'pagesës' është mospagimi. Këtu nuk po përfshijmë rregullimet e tarifave 'të ngjarjeve të mundshme' në të cilat avokati paguhet vetëm nëse çështja fitohet, por po përfshijmë shërbimet ligjore që ndërmerren duke mos pritur marrjen e pagesës (*pro bono*).

Ndërsa pjesa më e madhe e mënyrave të përfaqësimit kryhet duke përdorur një prej katër formave 'të qarta' të 'pagimit të tarifave', është i mundshëm edhe kombinimi i këtyre formave në mënyra të ndryshme. Në regjimet e ngarkimit të shpenzimeve, është tepër e përhapur forma që pala humbëse paguan vetëm një pjesë të shpenzimeve ligjore të palës fituese, e cila paguan diferencën. Shumë avokatë përdorin atë që mund të quhet *'de facto pro bono'* kur tarifat që u ngarkohen klientëve privatë , shlyhen ose reduktohen duke qenë se klienti nuk mund të paguajë dot tarifat e zakonshme të avokatit.

Tarifat ligjore u krijojnë avokatëve terrenin për të kryer sjellje jokorrekte. Çuditërisht, ne dimë shumë pak lidhur me frekuencën e këtyre llojeve të sjelljeve. Autorët kanë diskutuar çështjet e etikës që kanë lindur nga rregullimet e ndryshme të tarifave, por këto ndjekin ngushtësisht faktorët nxitës të përmendur më sipër. Në rastet kur autorët kanë diskutuar shembuj ose shembuj të supozuar të sjelljeve joetike lidhur me tarifat, këto diskutime kanë qenë shumë anekdotike. Ajo çka ne dimë nga studimet sistematike empirike, priret ta lidhë sjelljen joetike jo aq shumë me rregullimet specifike të tarifave, por me çështje të tilla, si shpërfillja e praktikës, presionet klienteliste, konteksti praktik (d.m.th. gjykatat ose agjencitë ku e ushtron veprimtarinë avokati) dhe konteksti social i firmës ligjore. Kështu, nuk ka të dhëna empirike se një rregullim i caktuar i tarifave shton gjasat për sjellje joetike, megjithëse natyra e veçantë e sjelljeve joetike varet shumë nga mënyra e kryerjes së pagesës."

4. Shpenzimet gjyqësore sipas legjislacionit shqiptar

Shërbimi gjyqësor, si një shërbim publik shtetëror, ka kostot e veta financiare për funksionimin normal të tij. Duke qenë një shërbim publik shtetëror, veprimtaria e gjykatave e merr financimin bazë nga buxheti i shtetit. Por, edhe si për shumë shërbime të tjera publike, qytetarët duhet të paguajnë një pjesë të shpenzimeve të nevojshme për inicimin dhe zhvillimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore në të cilat ata përfshihen si palë.

Shpenzimet gjyqësore që duhet të paguhen nga qytetarët, përbëhen nga taksa mbi aktet, shpenzimet për aktet që kryhen, si dhe shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimit. Niveli i taksave për shërbimet gjyqësor përcaktohet në

ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij ligji, niveli i taksave në lekë që duhet të paguhen në rastin e paraqitjes në gjykatë të padisë, janë:

a) për pension ushqimor	0
b) për vërtetim fakti	100
c) padi për zgjidhje martese	1500
ç) padi për pavlefshmëri te veprimeve juridike	1500
d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore si dhe për shkaktim dëmi	
- me vleftë deri 100 000 lekë	1500
- me vleftë mbi 100 000 lekë	1%
dh) padi për pjesëtim pasurie	1500
e) padi për kthim në punë	0

Por, nga analizimi i taksave për shërbimet gjyqësore që parashikohen në ligjin "Për sistemin e taksave", konstatohet se ky ligj nuk ka respektuar kërkesën e nenit 104/1 të Kodit të procedurës civile, sipas të cilit taksa mbi aktet paguhet në bazë të vlerës së padisë. Kjo kërkesë e Kodit është respektuar vetëm në përcaktimin e nivelit të taksës për paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktore dhe nga shkaktimi i dëmit jokontraktor, por këto nuk janë të vetmet padi të cilat janë të vlerësueshme. Kështu, një padi e vlerësueshme është padia për kërkimin e sendit (padia e rivendikimit), e parashikuar nga neni 296 i Kodit civil. Për shembull, pala paditëse depoziton në gjykatë një padi, nëpërmjet së cilës kërkon që pala e paditur t'i dorëzojë një pasuri të paluajtshme, e cila mund të jetë një vilë luksoze ose një sipërfaqe trualli me një vlerë prej 50.000.000 lekë.

Sipas nenit 104/1 të Kodit të procedurës civile, taksa për paraqitjen e kësaj padie duhet të paguhet në bazë të vlerës së padisë, por në ligjin për sistemin e taksave mungon një parashikim për nivelin e taksës për këtë padi. Në këto kushte, praktikisht, për këtë padi me vlerë shumë të madhe, paditësi do të paguajë një taksë prej vetëm 1500 lekë, ndërkohë që, në rast se do të kërkonte nga pala e paditur pagimin e një shume prej 50.000.000 lekësh, ai duhet të paguante një taksë të barabartë me 1 për qind të kësaj shume, të barabartë me 500.000 lekë. Pra duket qartë se ligji për sistemin e taksave ka një defekt në përcaktimin e nivelit të taksave gjyqësore.

Gjithashtu, një e metë tjetër e ligjit është dhe mosparashikimi i taksës për disa padi të pavlerësueshme, të cilat mund të mos rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore ose nga shkaktimi i dëmit jokontraktor, si p.sh.: paditë posedimore, paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, paditë për deklarimin

e një personi të zhdukur ose të vdekur, paditë për zhvleftësimin e një letre me vlerë, paditë për vërtetimin e qenies ose të mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte, paditë për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti etj. Në praktikë, për këto padi merret taksa fikse 1500 lekë, por duhet thënë se kjo nuk është e parashikuar me ligj. Kjo praktikë e shkaktuar nga mangësitë e ligjit mund të thuhet se vjen në kundërshtim edhe me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit, taksat, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve caktohet me ligj.

Taksa duhet të paguhet në çastin e paraqitjes së padisë në gjykatë. Taksat fikse deri në 1500 lekë vilen nëpërmjet pullës së taksës duke iu vendosur pulla kërkesëpadisë. Pullat e taksave janë letra me vlerë, me anën e të cilave vërtetohet pagesa e taksës nga personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendës e të huaj. Rolin e agjentit të taksave e luajnë punonjësit e administratës gjyqësore të ngarkuar me këtë detyrë. Pranimi për gjykim i kërkesëpadive për të cilat nuk është aplikuar pulla e taksës, quhet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas legjislacionit në fuqi. Kurse taksat për paraqitjen e padive të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe nga shkaktimi i dëmit me vleftë mbi 100 000 lekë, nuk mund të vilen nëpërmjet pullave të taksës. Në këto raste, vlera e përllogaritur e taksës i arkëtohet palës paditëse dhe transferohet në llogaritë e të ardhurave tatimore të buxhetit të shtetit.

Vlera e padisë caktohet zakonisht nga pala paditëse në kërkesëpadinë që ajo paraqet në gjykatë. Kur në kërkesëpadi nuk është caktuar vlera e saj, ose kur vlera e caktuar ka ndryshime të dukshme me vlerën e vërtetë, gjykata e cakton atë sipas rregullave ta parashikuara në nenet 65 deri në 70 të Kodit të procedurës civile. Kur në kohën e ngritjes së padisë caktimi i vlerës së saj paraqitet i vështirë, taksa mbi aktet caktohet nga gjykata në mënyrë të përafërt.

Për caktim të gabuar të vlerës së padisë dhe për llogaritje të gabuara të taksave mbi aktet, palët mund të bëjnë ankim të veçantë (neni 110 i K.pr.c.).

Taksa e akteve për paraqitjen në gjykatë merret si për paditë, ashtu edhe për kundërpaditë. Gjithashtu, kjo taksë merret edhe për ndërhyrjen kryesore. Kur një padi përmban shumë objekte, taksa e akteve merret veçanërisht për çdo objekt. Kështu, kur padia ka objekt edhe të vlerësueshëm, edhe të pavlerësueshëm, taksa merret si për objektin e vlerësueshëm, ashtu edhe për atë të pavlerësueshëm.

Taksat mbi aktet nuk kthehen në rastet kur vendoset pushimi i gjykimit, kthimi i kërkesëpadisë si e paplotë dhe kur çështja nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor. Kur objekti i padisë pakësohet, nuk kthehet taksa mbi aktet, e paguar për pjesën e pakësuar të objektit të padisë, ndërsa kur objekti i padisë shtohet, merret taksë edhe për pjesën e shtuar të objektit të padisë (neni 103 i K.pr.c.).

Në rastin kur taksa mbi aktet është caktuar në mënyrë të përafërt nga gjykata për shkak se në çastin e ngritjes së padisë caktimi i vlerës së padisë paraqitej i vështirë, dhe nga gjykimi rezulton se vlera e padisë del më e madhe ose më e vogël nga ajo e caktuar nga gjykata, atëherë palës paditëse i kërkohet të paguajë shumën plotësuese të taksës ose i kthehet shuma e marrë tepër (neni 104/3 i K.pr.c.). Nga pagimi i taksës mbi aktet përjashtohen vetëm personat e parashikuar në dispozitat për taksën mbi aktet (neni 105/b & I i K.pr.c.). Por, në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", nuk janë parashikuar raste të përjashtimit nga pagimi i taksave lidhur me paraqitjen e padisë në gjykatë dhe ky fakt përbën një mangësi serioze të këtij ligji.

Në disa ligje të veçanta është parashikuar përjashtimi nga pagimi i taksës për paraqitjen në gjykatë të padisë për disa persona të caktuar fizikë dhe juridikë. Në rast se në përfundim të gjykimit padia e paditësit, i cili në bazë të ligjit është përjashtuar nga pagimi i taksës mbi aktet, për paraqitjen e padisë është pranuar plotësisht ose pjesërisht, taksa mbi aktet nga e cila ishte përjashtuar paditësi i ngarkohet palës së paditur në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata (neni 106/1 i K.pr.c.).

Shpenzime gjyqësore janë shpenzimet që bëhen gjatë gjykimit për njoftimin e akteve, për thirrjen e dëshmitarëve, të ekspertëve, të përkthyesve, për realizimin e këqyrjes së sendeve, për verifikimin në vend të përmbajtjes së një shkrese, për këqyrjen e personave, përkthimin e dokumenteve, vërtetimin e kopjeve të dokumenteve, të eksperimenteve etj. Shpenzimet për dëshmitarët, për ekspertët dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, si rregull, parapaguhen nga pala që i ka kërkuar, në shumën që ka caktuar gjykata.

Me këtë duhet kuptuar se, kur pala propozon një provë, gjykata e urdhëron që më parë të depozitojë shumën e nevojshme për pagimin e shpenzimeve, të cilat janë të nevojshme për marrjen e kësaj prove. Në qoftë se provën e kanë propozuar të dyja palët, gjykata urdhëron që shumën e nevojshme për pagimin e shpenzimeve ta depozitojnë të dyja palët në pjesë të barabartë. Në këtë mënyrë, palët detyrohen të mendojnë në është e nevojshme ose jo që prova, të cilën mendojnë ta propozojnë, të merret në gjykimin e çështjes. Në këtë mënyrë shmanget ngarkimi i hetimit gjyqësor me veprime procedurale të tepërta.

Por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, mund të ngarkojë njërën ose të dyja palët të paguajnë shpenzimet e tyre, pavarësisht se cila prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit ose të këqyrjes. Kur një palë është e detyruar të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme (neni 105 i K.pr.c.).

Dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesit kanë të drejtë të marrin shpenzimet që kanë bërë për paraqitjen e tyre, si dhe një shpërblim për largimin e tyre nga vendi i punës. Ekspertët kanë të drejtë të shpërblehen edhe për shërbimin e kryer. Masa e shpenzimeve dhe e shpërblimeve që u takojnë dëshmitarëve dhe ekspertëve, caktohet nga Këshilli i Ministrave (neni 105/a i K.pr.c.).

Personat që përjashtohen nga pagimi i taksës mbi aktet, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore. Në këto raste, shpenzimet përballohen nga një fond i veçantë i parashikuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit. Ky rregull është vendosur për arsye se në një gjykim shpenzimet mund të jenë aq të mëdha, saqë në disa raste, parapagimi i tyre, për palën që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, mund të jetë pengesë për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore të së drejtës subjektive civile. Këtë të drejtë procedurale mund ta shfrytëzojnë vetëm personat fizikë. Në rast se në përfundim të gjykimit personi që përjashtohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, e fiton gjyqin plotësisht apo pjesërisht, shpenzimet gjyqësore që janë paguar nga fondet shtetërore i ngarkohen palës që humbet gjyqin në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata (neni 106/1 i K.pr.c.). Organet e pushtetit publik dhe personat e tjerë juridikë që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet, përjashtohen nga pagimi i taksës, paguajnë shpenzimet e tjera gjyqësore (neni 105/b i K.pr.c.).

Në rast se pala gjatë gjykimit është asistuar ose është përfaqësuar me avokat, ajo do të duhet që të paguajë paraprakisht edhe tarifën e avokatit të saj. Në bazë të ligjit nr.9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 11, shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij;

b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas. Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) me ligj.

Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër.

Sipas nenit 12 të këti ligji:

1. Avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjykimit.

2. Shpërblimi me përqindje, i parallogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin e mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes.

3. Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huasë për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jogjyqësisht.

Por, as në Kodin e procedurës civile, as në ligjin nr.9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", nuk janë parashikuar rregulla se deri në çfarë mase do të rimbursohet pala që fiton gjyqin nga pala që e humbet gjyqin lidhur me tarifën që ajo i ka paguar avokatit të saj. Aktualisht, në caktimin e masës së shumës që duhet të rimbursohet për tarifën e avokatit, gjykatat bazohen në rregulloren nr.2, datë 21.3.1996, të ministrit të Drejtësisë "Për caktimin e tarifave të shpërblimit tavan, për ndihmën juridike që japin avokatët". Por, duhet thënë se kjo rregullore tashmë duhet konsideruar e vjetëruar dhe e papërshtatshme, pasi ajo ka dalë në bazë të nenit 44 të ligjit nr.7827, datë 31.5.1994, "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", i cili tashmë është i shfuqizuar.

Taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera dhe shpërblimi për një avokat që mund të ketë paguar paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata. I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, në përpjesëtim me pjesën e refuzuar të padisë.

Me këtë do të kuptojmë se:

a) në rast se gjykata e pranon plotësisht padinë e ngritur nga paditësi, atëherë i padituri detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore;

b) në rast se gjykata e pranon pjesërisht padinë e ngritur nga paditësi, atëherë i padituri detyrohet të paguajë vetëm shpenzimet gjyqësore që janë bërë për pjesën e pranuar të padisë. Për pjesën e padisë që është rrëzuar, gjykata duhet të ngarkojë me pagimin e shpenzimeve palën paditëse;

c) në rast se padia rrëzohet nga gjykata, paditësi duhet të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore që ka bërë i padituri.

Gjykata duhet t'i ngarkojë palës që e ka humbur gjyqin, vetëm shpenzimet që kanë qenë të nevojshme për zhvillimin e gjykimit. Shpenzimet e panevojshme i ngelen në ngarkim palës që i ka bërë ato, pavarësisht nga fakti nëse e ka fituar apo e ka humbur gjyqin. Pala që fiton gjyqin, ka për detyrë t'i specifikojë dhe t'i vërtetojë veç e veç shpenzimet procedurale që ka bërë për çdo veprim procedural.

Gjithashtu, i padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, edhe në rast se është vendosur pushimi i gjykimit (neni 106 i K.pr.c.).

Kur çështja përfundon me pajtim, shpenzimet gjyqësore mbeten në ngarkim të secilës palë që i ka bërë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt (neni 108 i K.pr.c.).

Kur i padituri, me sjelljen e tij, nuk i ka dhënë shkak ngritjes së padisë,

shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit (neni 107/2 i K.pr.c.).

Personi i tretë që bën ndërhyrje dytësore, nuk detyrohet dhe as ngarkohet me pagimin e shpenzimeve gjyqësore (neni 109 i K.pr.c.).

Pala që, me vonim të pajustifikuar, shkakton shtyrjen e gjykimit të çështjes, ngarkohet me shpenzimet e bëra për këtë shtyrje (neni 107/1 i K.pr.c.). Ky rregullim është vendosur për të parandaluar sjelljet abuzive të palëve, të cilat do ta zvarritnin gjykimin. Caktimin dhe ngarkimin e shpenzimeve palës që ka vepruar me faj, gjykata e bën menjëherë pasi vendos për shtyrjen e seancës gjyqësore dhe nuk është e nevojshme të presë vendimin përfundimtar.

Sipas nenit 310 të Kodit të procedurës civile, gjykata, në përfundim të gjykimit, në pjesën urdhëruese të vendimit përfundimtar, ndër të tjera, duhet të përmendë se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Në rast se gjykata nuk e përmend në vendim se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, palët kanë të drejtë të kërkojnë plotësimin e vendimit brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e tij, sipas nenit 313 të Kodit të procedurës civile.

Për caktim të gabuar të shpenzimeve gjyqësore, palët mund të bëjnë ankim të veçantë (neni 110 i K.pr.c.).

c - ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Për avokatët

1) Identifikoni burimet ligjore në ligjin shqiptar, të cilat imponojnë mbi anëtarët e profesioneve ligjore detyrimet e besnikërisë, të përgjegjësisë dhe të mirëbesimit.

2) Tregoni nëse, sipas mendimit tuaj, rregullimi aktual i profesioneve ligjore në Shqipëri përkon me standardet e përcaktuara në Kodin europian të sjelljes, të paraqitur në pikën D.

3) Renditni shtatë shembuj të abuzimeve procedurale, duke përmendur mjetet e mundshme ligjore (nëse ka) që mund të vihen në lëvizje nga palët ose nga gjyqtari.

Për ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore

1) Ilustroni rastet përjashtimore në ligjin shqiptar (nëse ka ndonjë) lidhur me rregullën e ngarkimit të shpenzimeve, të parashikuar në nenin 106 të Kodit të procedurës civile.

2) Shpjegoni se cilat do të ishin sipas mendimit tuaj efektet (përfituese ose dëmtuese) e prezantimit të "rregullës amerikane" (secila prej palëve përballon shpenzimet e saj, edhe nëse fiton) në sistemin ligjor shqiptar.

3) Shpjegoni, sipas njohurive që keni, vendin që zë praktika dhe ligji shqiptar në klasifikimin e metodave për pagesën e tarifave ligjore të paraqitura në pjesën e fundit të artikullit të Kritzer.

4) A ekziston ndonjë rregullim ligjor i "tarifave të ngjarjeve të mundshme" (d.m.th. një marrëveshje sipas së cilës, nëse humbet, avokati nuk merr asgjë, por, nëse fiton, merr një përqindje të shumës së fituar) në ligjin shqiptar? Nëse jo, cila është arsyeja?

d - LEXIME PLOTESUESE

Kodi i Sjelljes për Avokatët në Komunitetin Europian (Model i Kodit të etikës, i publikuar nga Këshilli i Dhomave të Avokatisë dhe Shoqërive Ligjore të Bashkimit Europian)

1 Hyrje

1.1 Funksioni i avokatit në shoqëri

Në një shoqëri që mbështetet mbi respektimin e shtetit të së drejtës, avokatët përmbushin një rol të veçantë. Detyrat e tyre nuk fillojnë dhe mbarojnë me kryerjen si duhet të asaj që atyre u lejohet me ligj. Një avokat duhet t'u shërbejë interesave të drejtësisë dhe atyre të drejtave dhe lirive që i duhet të mbrojë dhe të kërkojë. Detyra e avokatit është jo vetëm të mbrojë çështjen e klientit, por të jetë edhe këshilluesi i tij.

Pra, funksioni i avokatit shtron përpara tij një sërë detyrimesh morale dhe ligjore (që ndonjëherë duket se vijnë në kundërshtim me njëri-tjetrin) ndaj:

- klientit;
- gjykatave ose autoriteteve të tjera, para të cilave ai mbron çështjen e klientit të tij ose vepron në emër të tij;
- profesionit ligjor në përgjithësi dhe çdo anëtari të tij në veçanti;
- publikut për të cilin ekzistenca e një profesioni të lirë dhe të pavarur, që u përmbahet dhe respekton rregullat e krijuara nga vetë profesioni, është një mjet thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut përballë autoritetit të shtetit dhe interesave të tjerë të shoqërisë.

1.2 Natyra e rregullave të sjelljes profesionale

1.2.1 Rregullat e sjelljes janë përcaktuar me pranimin e tyre të vullnetshëm nga individët ndaj të cilëve ato zbatohen, për të siguruar përmbushjen si duhet nga ana e avokatëve të një funksioni që është pranuar si mjaft i rëndësishëm nga gjithë shoqëritë e civilizuara. Mosrespektimi nga ana e avokatëve i këtyre rregullave duhet të rezultojë së fundmi edhe në sanksione disiplinore.

1.2.2 Rregullat e veçanta të dhomave të avokatëve ose shoqërive ligjore krijohen nga traditat e tyre specifike. Ato i janë përshtatur organizimit dhe sferës së veprimtarisë së profesionit në shtetet anëtare përkatëse, procedurave të tyre administrative dhe gjyqësore, si dhe legjislacioneve kombëtare. Nuk është as e mundur, as e dëshirueshme që këto rregulla të nxirren jashtë kontekstit të tyre, dhe as të bëhen përpjekje për t'u dhënë një zbatim më të përgjithshëm rregullave që, në vetvete, janë të paafta për një zbatim të tillë.

Por, këto rregulla të veçanta të secilës prej dhomave të avokatëve ose shoqërive ligjore mbështeten mbi të njëjtat vlera dhe, në shumicën e rasteve, demonstrojnë parime themelore të përbashkëta.

1.3 Qëllimi i Kodit

1.3.1 Integrimi i vazhdueshëm i Bashkimit Europian dhe Zonës Ekonomike Europiane, si dhe shtimi i veprimtarive të avokatëve midis shteteve brenda Zonës Ekonomike Europiane bënë evidente nevojën e interesit të publikut për hartimin e rregullave të përbashkëta që do të zbatoheshin nga të gjithë avokatët brenda Komunitetit për sa i përket veprimtarisë së tyre në shtete të tjera anëtare, pavarësisht përkatësisë së dhomës së avokatisë ose shoqërisë ligjore. Një qëllim specifik i hartimit të këtyre rregullave është zbutja e vështirësive që rezultojnë nga zbatimi i "praktikimit të dyfishtë", sikurse përcaktohet në nenin 4 të udhëzimit të KE-së 77/249, datë 22 mars 1977.

1.3.2 Organizatat që përfaqësojnë profesionin ligjor nëpërmjet Këshillit të Dhomave të Avokatisë dhe Shoqërive Ligjore të Bashkimit Europian, propozojnë që rregullat e kodifikuara sipas neneve të mëposhtme:

- të pranohen aktualisht si shprehje e konsensusit të të gjitha dhomave të avokatisë ose shoqërive ligjore të Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane;
- të miratohen si rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar sa më shpejt që të jetë e mundur në përputhje me procedurat kombëtare të Zonës Ekonomike Europiane sa u takon veprimtarive në shtete të tjera anëtare të avokatëve të Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane;
- të merren në konsideratë gjatë proceseve të rishikimit të rregullave kombëtare për profesionin ligjor ose praktikën ligjore me qëllim harmonizimin e tyre të vazhdueshëm.

Po ashtu, ato shprehin dëshirën që rregullat kombëtare për profesionin ligjor ose praktikën ligjore të interpretohen dhe të zbatohen aty ku është e mundur në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

Pasi rregullat e këtij Kodi të jenë miratuar si rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar sa i takon veprimtarisë së ushtruar nga avokatët në shtete të tjera anëtare (përveç atij të origjinës), ata mbeten të detyruar të respektojnë rregullat e dhomës së avokatisë ose shoqërisë ligjore në të cilën ata janë anëtarë, sa kohë që këto rregulla janë në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

1.4 Fusha e zbatimit – Ratione Personae[2]

Rregullat e mëposhtme do të zbatohen për avokatët e Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane sikurse janë përcaktuar në udhëzimin 77/249 të datës 22 mars 1977.

1.5 Fusha e zbatimit - Ratione Materiae[3]

Pa cenuar përpjekjet për arritjen e harmonisë së vazhdueshme të rregullave të profesionit ligjor dhe të praktikës ligjore që zbatohen brenda shteteve anëtare të BE-së, rregullat e mëposhtme do të zbatohen për veprimtaritë në shtete të tjera anëtare të avokatëve të Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane. Veprimtaritë jashtë kufijve nënkuptojnë:

(a) të gjitha kontaktet profesionale me avokatë të shteteve të tjera anëtare dhe

(b) veprimtaritë profesionale të avokatit në shtete të tjera të BE-së, pavarësisht nga fakti nëse avokati është fizikisht i pranishëm në atë shtet.

1.6 Përkufizime

Në këto rregull:

"Shteti anëtar i origjinës" nënkupton shtetin anëtar të dhomës së avokatisë ose të shoqërisë ligjore së cilës i përket avokati. "Shteti anëtar pritës" nënkupton çdo shtet anëtar ku avokati kryen veprimtarinë e tij jashtë kufijve.

"Autoritet kompetent" nënkupton organizatën (organizatat) profesionale ose autoritetin (autoritetet) e shtetit anëtar përkatës përgjegjës për hartimin e rregullave të sjelljes profesionale dhe administrimin e disiplinës së avokatëve.

---

2) Lidhur me individët për të cilët zbatohet kjo fushë.

3) Lidhur me çështjet që përfshihen gjatë zbatimit të kësaj fushe.

2 Parime të përgjithshme

2.1 Pavarësia

2.1.1 Detyrimet e shumta të cilave u nënshtrohet avokati kërkojnë pavarësinë e tij absolute, lirinë nga të gjitha ndikimet, veçanërisht nga ato që mund të lindin nga interesat e tij personalë ose nga presionet e jashtme. Për të pasur besim në procesin e drejtësisë, kjo pavarësi është po aq e nevojshme sa edhe paanshmëria e gjyqtarit. Kështu, avokati duhet të shmangë çdo cenim të pavarësisë së tij dhe të jetë i kujdesshëm për të mos kompromentuar standardet e tij profesionale në mënyrë që të kënaqë klientin e tij, gjykatën dhe palët e treta.

2.1.2 Pavarësia është e nevojshme, si në çështjet konfliktuale, ashtu edhe në çështjet jokonfliktuale. Kështilla që avokati i jep klientit të tij, nuk ka vlerë nëse jepet për përfitime personale të avokatit, për interesa të tij ose në përgjigje të presioneve të jashtme.

2.2 Besimi dhe integriteti personal

Marrëdhëniet e besimit mund të ekzistojnë vetëm nëse morali i avokatit, ndershmëria dhe integriteti i tij nuk vihen në dyshim. Për avokatin, këto cilësi tradicionale janë detyrime profesionale.

2.3 Mirëbesimi

1.3.1 Thelbi i funksionit të avokatit konsiston në faktin se klienti duhet t'i tregojë avokatit gjëra për të cilat ai nuk mund të komunikojë me persona të tjerë dhe se avokati duhet të marrë informacione të tjera mbështetur në marrëdhënien e mirëbesimit. Pa pasur sigurinë e ekzistencës së mirëbesimit nuk mund të ketë besim. Pra, mirëbesimi është në këtë mënyrë një e drejtë dhe detyrim kryesor dhe themelor i avokatit.

Detyrimi i avokatit për mirëbesim i shërben interesit të administrimit të drejtësisë, si edhe interesit të klientit. Si i tillë, ai gëzon një mbrojtje të veçantë nga shteti.

2.3.2 Avokati duhet të respektojë mirëbesimin e gjithë informacionit që merr gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale.

2.3.3 Detyrimi i mirëbesimit nuk është i kufizuar në kohë.

2.3.4 Avokati duhet t'u kërkojë kolegëve, stafit dhe kujtdo tjetër të angazhuar prej tij gjatë ofrimit të shërbimeve profesionale, që të respektojnë detyrimin për mirëbesim.

2.4 Respektimi i rregullave të dhomave të tjera të avokatisë dhe shoqërive ligjore

Sipas ligjeve të Bashkimit Europian dhe të Zonës Ekonomike Europiane, avokati i një shteti tjetër anëtar mund të jetë i detyruar të respektojë rregullat e dhomës së avokatisë ose të shoqërisë ligjore të shtetit pritës. Avokatët kanë detyrimin e marrjes së informacionit lidhur me rregullat që mund të kenë efekt mbi ta gjatë kryerjes së veprimtarive të veçanta.

Anëtarët e organizatave të Këshillit të Dhomave të Avokatisë dhe Shoqërive Ligjore të Bashkimit Europian janë të detyruar të depozitojnë Kodin e sjelljes pranë sekretariatit të këtij Këshilli, në mënyrë që çdo avokat të ketë mundësinë të tërheqë nga sekretariati kopjen e përditësuar të Kodit.

2.5 Funksionet e papajtueshme

2.5.1 Me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij me pavarësi dhe në përputhje me detyrimin për të dhënë kontributin e tij në administrimin e drejtësisë, avokati përjashtohet nga disa funksione.

2.5.2 Avokati që vepron si përfaqësues ose mbrojtës i një klienti në procedurat ligjore ose para çdo autoriteti tjetër publik në shtetin pritës, duhet të respektojë rregullat që lidhen me funksionet e papajtueshme, sikurse ato zbatohen për avokatët e shtetit pritës.

2.5.3 Avokati që e ushtron veprimtarinë në një shtet pritës në të cilin ai dëshiron të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtari tregtare ose lloje të tjera të veprimtarive që nuk lidhen me praktikimin e ligjit, duhet të respektojë rregullat që lidhen me funksionet e ndaluara ose të papajtueshme sikurse ato zbatohen për avokatët e shtetit pritës.

2.6 Publiciteti personal

2.6.1 Avokati nuk duhet të reklamohet ose të kërkojë publicitet personal në rastet kur kjo gjë nuk është e lejueshme.

Në raste të tjera, avokati duhet të reklamohet ose të kërkojë publicitet personal në masën dhe mënyrën e lejuar nga rregullat të cilave ai u nënshtrohet.

2.6.2 Reklamimi dhe publiciteti personal konsiderohen se kryhen në vendet e lejuara, nëse avokati në fjalë tregon se ato janë vendosur në vendet ku ky reklamim ose publicitet personal është i lejueshem me qëllim tërheqjen e klientëve dhe se komunikimi i tyre në vende të tjera ka qenë incidental.

2.7 Interesat e klientit

I detyruar të respektojë të gjitha normat e së drejtës dhe të sjelljes profesionale,

avokati duhet të veprojë gjithmonë për më të mirën e interesave të klientit të tij, si dhe duhet t'i vendosë këta interesa mbi interesat e tij personalë ose të anëtarëve të tjerë të profesionit ligjor.

2.8 Kufizimi i përgjegjësive ligjore të avokatit ndaj klientit të tij

Avokati mund t'i kufizojë përgjegjësitë ligjore ndaj klientit të tij në përputhje me rregullat e Kodit të sjelljes të cilit ai i nënshtrohet, në masën e lejuar nga ligji i shtetit anëtar të origjinës dhe i shtetit anëtar pritës.

3 Marrëdhëniet me klientët

3.1 Pranimi dhe refuzimi i kërkesave

3.1.1 Avokati duhet ta marrë përsipër një çështje (për një palë të caktuar) vetëm me kërkesë të palës. Por, ai mund të veprojë në një çështje sipas kërkesës së një avokati tjetër që vepron për këtë palë, ose kur çështja i është caktuar këtij avokati nga një organ kompetent.

Avokati duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të vërtetuar identitetin, kompetencën dhe autoritetin e individit ose organit që e ka kërkuar atë, në rast se rrethanat specifike tregojnë pasiguri për identitetin, kompetencën dhe autoritetin.

3.1.2 Avokati duhet ta këshillojë dhe ta përfaqësojë klientin në kohë, me devotshmëri dhe besnikëri. Duhet të mbajë përgjegjësi personale për përmbushjen e kërkesave që i paraqiten dhe duhet ta mbajë klientin vazhdimisht të informuar për ecurinë e çështjes që i është besuar.

3.1.3 Avokati nuk duhet ta marrë përsipër një çështje, të cilën ai e di ose duhet ta dijë se nuk është kompetent për ta trajtuar, pa bashkëpunuar me një avokat që është kompetent për çështjen në fjalë.

Avokati nuk duhet t'i pranojë kërkesat nëse nuk arrin t'i përfundojë ato në kohën e duhur, në mundësinë e presionit të një pune tjetër.

3.1.4 Avokati nuk duhet të lejohet të heqë dorë nga çështja në mënyrë të tillë ose në rrethana të tilla, që klienti të mos ketë mundësinë e sigurimit të ndihmës tjetër ligjore në kohë për të shmangur dëmtimet që mund të bien mbi të.

3.2 Konflikti i interesit

3.2.1 Avokati nuk duhet të këshillojë, të përfaqësojë ose të veprojë në emër të dy ose më shumë klientëve në të njëjtën çështje nëse ekziston një konflikt ose një rrezik potencial për konflikt, ndërmjet interesave të këtyre klientëve.

3.2.2 Avokati duhet të pushojë së vepruari në emër të këtyre dy klientëve në rast konflikti të interesave midis tyre, si dhe sa herë që ekziston rreziku i dhunimit të mirëbesimit ose cenimit të pavarësisë së tij.

3.2.3 Gjithashtu, avokati nuk duhet të veprojë në emër të një klienti të ri nëse ekziston rreziku i dhunimit të mirëbesimit ndaj tij nga klienti i mëparshëm, ose në rast se njohuritë që avokati ka për çështjen e klientit të mëparshëm do t'i jepnin klientit të ri epërsi të pajustifikuara.

3.2.4 Në rastet kur avokatët e ushtrojnë profesionin e tyre në shoqëri avokatore, paragrafët nga 3.2.1 deri në 3.2.3 do të zbatohen për gjithë shoqërinë dhe anëtarët e saj.

3.3 Pactum de quota litis

3.3.1 Avokati nuk autorizohet të lidhë një *pactum de quota litis.*

3.3.2 Me *pactum de quota litis* kuptohet marrëveshja midis avokatit dhe klientit të tij që hyn në fuqi përpara përfundimit të çështjes në të cilën klienti është palë, nëpërmjet së cilës klienti pranon t'i paguajë avokatit një pjesë të rezultatit pavarësisht nga fakti nëse kjo pjesë përfaqësohet nga një shumë të hollash ose nga çdo përfitim tjetër i marrë nga klienti me përfundimin e çështjes.

3.3.3 *The pactum de quota litis* nuk përfshin marrëveshjen që tarifat të përcaktohen në përpjesëtim me vlerën e çështjes që trajtohet nga avokati nëse kjo gjë është në përputhje me një përshkallëzim të tarifave të miratuar zyrtarisht ose sipas kontrollit të autoritetit kompetent që ka juridiksion mbi avokatin.

3.4 Rregullimi i tarifave

3.4.1 Tarifa që i ngarkohet klientit nga avokati i tij, duhet të jetë plotësisht e qartë, e drejtë dhe e arsyeshme.

3.4.2. I detyruar të respektojë çdo marrëveshje tjetër midis avokatit dhe klientit të tij, tarifat e caktuara nga avokati duhet t'u nënshtrohen rregullimeve në përputhje me rregullat që zbatohen për anëtarët e dhomës së avokatisë ose shoqërisë ligjore së cilës ai i përket. Nëse ai është anëtar i më shumë se një dhome të avokatisë ose të një shoqërie ligjore, rregullat që do të zbatohen, do të jenë ato që kanë lidhje më të afërta me kontratën midis avokatit dhe klientit të tij.

3.5 Pagesa

Nëse avokati kërkon një pagesë në bazë të tarifave të tij dhe/ose shpenzimeve, pagesa të tilla nuk duhet të kalojnë një vlerë të arsyeshme të tarifave dhe të shpenzimeve të mundshme që mund të përfshihen.

Në rast moskryerjeje të pagesave të tilla, avokati mund të tërhiqet nga çështja

ose të refuzojë të merret me të, por gjithmonë duke respektuar paragrafin 3.1.4 të përmendur më sipër.

3.6 Ndarja e tarifave me persona të tjerë që nuk janë avokatë

3.6.1 Sikurse do të përmendet edhe më poshtë, avokati nuk mund t'i ndajë tarifat e tij me një person që nuk është avokat, me përjashtim të rasteve kur një marrëdhënie midis avokatit dhe personit tjetër lejohet nga ligjet e shtetit anëtar të cilit i përket avokati.

3.6.2 Dispozitat e pikës 6.1, të përmendur më sipër, nuk duhet ta ndalojnë një avokat që t'i paguajë një tarifë, një komision ose një lloj tjetër kompensimi trashëgimtarit të një avokati që ka vdekur ose një avokati të dalë në pension, pasi ka marrë funksionin dhe detyrën e avokatit që ka vdekur ose avokatit të dalë në pension.

7.7 Zgjidhjet efektive për shpenzimet dhe mundësia e ndihmës ligjore

3.7.1 Gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tij, avokati duhet të përpiqet të arrijë zgjidhjen më efektive për shpenzimet e klientit që ka një mosmarrëveshje dhe ta këshillojë klientin në momente të caktuara për epërsitë e përpjekjeve për ta zgjidhur çështjen me marrëveshje dhe/ose t'i rekomandojë një mundësi alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

3.7.2 Avokati duhet ta informojë klientin për mundësinë e ndihmës ligjore aty ku është e mundur.

3.8 Fondet e klientëve

3.8.1 Në rastet kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, avokatët vihen në posedim të fondeve në emër të klientëve të tyre ose të palëve të treta (në vazhdim fondet e klientëve) është e detyrueshme që:

3.8.1.1 Fondet e klientëve të mbahen gjithmonë në një llogari bankare ose institucion të ngjashëm që i nënshtrohet mbikëqyrjes së autoritetit publik. Të gjitha fondet e klientëve të marra nga avokati duhet të derdhen në këtë llogari me përjashtim të rasteve kur klienti, në mënyrë të shprehur ose të tërthortë, ka rënë dakord që fondet të administrohen në një mënyrë të ndryshme.

3.8.1.2 Çdo llogari në të cilën fondet e klientëve mbahen nga avokati, duhet të tregojë në titull ose emërtesë se fondet mbahen në emër të klientit ose të klientëve të avokatit.

3.8.1.3 Në çdo kohë, llogaria ose llogaritë në të cilat fondet e klientëve mbahen nga avokati, duhet të përmbajnë një shumë jo më të vogël se totali i fondeve të klientëve që mbahen nga avokati.

3.8.1.4 Të gjitha fondet duhet t'u paguhen klientëve menjëherë ose me realizimin e kushteve që mund të autorizohen nga klienti.

3.8.1.5 Të gjitha pagesat e bëra nga fondet e klientëve në emër të klientit ndaj një personi tjetër që përfshijnë:

(a) pagesat që i bëhen një klienti ose për një klient, të cilat merren nga fondet që mbahen për një klient tjetër dhe

(b) pagesat për tarifat e avokatit, të jenë të ndaluara me përjashtim të rasteve të lejuara nga ligji ose kur ato kanë autoritetin e shprehur ose të nënkuptuar të klientit nga llogaria e të cilit bëhet pagesa.

3.8.1.6 Avokati duhet të mbajë të dhëna të sakta dhe të plota, të cilat i vihen në dispozicion klientit me kërkesën e tij dhe që tregojnë të gjitha veprimet e kryera me fondet e klientëve dhe që bëjnë dallimin ndërmjet fondeve të klientëve dhe fondeve të tjera që mbahen prej tij.

3.8.1.7 Autoritetet kompetente në të gjitha shtetet anëtare duhet të kenë kompetencën që të ekzaminojnë dhe të investigojnë mbi baza mirëbesimi të dhënat financiare të fondeve të klientit që ka avokati për të vërtetuar nëse janë zbatuar rregullat për mbajtjen e tyre dhe për të vendosur sanksione mbi avokatët që nuk kanë vepruar në përputhje me këto rregulla.

3.8.2 Sikurse do të përmendet edhe më poshtë dhe pa cenuar rregullat e parashikuara në paragrafin 3.8.1, avokati që mban fondet e klientëve, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij në secilin prej shteteve anëtare duhet të respektojë rregullat për mbajtjen dhe llogaritjen e fondeve të klientëve që zbatohen nga autoritetet kompetente në shtetin anëtar të origjinës.

3.8.3 Avokati që ushtron veprimtarinë e tij ose ofron shërbime në shtetin anëtar pritës, në marrëveshje me autoritetet kompetente të shteteve anëtare përkatëse pritëse dhe të origjinës, mund të respektojë kërkesat e shtetit anëtar pritës dhe të përjashtohet nga kërkesat e shtetit anëtar të origjinës. Në një rast të tillë, ai do të jetë përgjegjës për informimin e klientëve të tij se do të përmbushë kërkesat në fuqi të shtetit anëtar pritës.

3.9 Sigurimi i përgjegjësive profesionale

3.9.1. Avokatët duhet të jenë të siguruar gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre nga pretendimet e bazuara mbi neglizhencën profesionale, në një masë të tillë të arsyeshme nëse mbahet parasysh natyra dhe shkalla e rrezikut me të cilin ai përballet gjatë kryerjes së funksionit të tij.

3.9.2. Në rastet kur avokati ofron shërbime ose e ushtron profesionin në një shtet anëtar pritës, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

3.9.2.1 Avokati duhet të respektojë të gjitha rregullat që lidhen me detyrimin

e tij për të qenë i siguruar nga përgjegjësia ligjore profesionale si avokat, të cilat janë në fuqi në shtetin e tij anëtar të origjinës.

3.9.2.2 Avokati që është, pra, i detyruar të jetë i siguruar në shtetin e tij anëtar të origjinës dhe që ofron shërbime ose ushtron veprimtarinë profesionale në secilin prej shteteve anëtare pritëse, duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të siguruar, në bazë të kërkesave të shtetit të tij anëtar të origjinës, përgjegjësitë profesionale të cilat mbulojnë edhe shërbimet që ai garanton ose funksionin që ai kryen në shtetin anëtar pritës.

3.9.2.3 Avokati që nuk arrin të sigurojë mbulimin e zgjeruar të shërbimeve që referohen më sipër në paragrafin 3.9.2.2, ose që nuk është i detyruar të sigurojë veprimtarinë që kryen në shtetin e tij anëtar të origjinës dhe që ofron shërbime ose ushtron funksionin e tij në një shtet anëtar pritës, duhet të sigurojë sa të jetë e mundur mbulimin e përgjegjësisë së tij profesionale si avokat kur ushtron veprimtarinë e tij për klientë në këtë shtet anëtar pritës, ose të paktën një bazë ekuivalente me atë që u kërkohet avokatëve në shtetin anëtar pritës.

3.9.2.4 Sa kohë që avokati nuk është në gjendje të sigurojë mbulimin e përgjegjësisë profesionale që kërkohet sipas rregullave të sipërpërmendura, ai duhet të informojë klientët e tij të cilët mund të cenohen nga kjo gjë.

3.9.2.5 Avokati që ushtron veprimtarinë e tij ose ofron shërbime në një shtet anëtar pritës, në marrëveshje me organet përkatëse kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe të shtetit anëtar pritës, mund të respektojë kërkesat për sigurimin e përgjegjësisë profesionale që janë në fuqi në shtetin anëtar pritës dhe të përjashtohet nga kërkesat e shtetit anëtar të origjinës. Në një rast të tillë, ai duhet të marrë masat e nevojshme për të informuar klientët e tij se ai është siguruar sipas kërkesave në fuqi të shtetit anëtar pritës.

4 Marrëdhëniet me gjykatat

4.1 Rregullat që zbatohen për sjelljen në gjykatë

Avokati që paraqitet ose merr pjesë në një çështje para një gjykate ose tribunali të një shteti anëtar duhet të respektojë rregullat e sjelljes që zbatohen para asaj gjykate ose tribunali.

4.2 Zhvillimi me drejtësi i procedurave gjyqësore

Avokati duhet ta respektojë gjithmonë zhvillimin me drejtësi të procedurave ligjore. Për shembull, ai nuk duhet të kontaktojë me gjyqtarin, pa informuar më parë avokatin që vepron për palën kundërshtare ose të depozitojë pranë gjyqtarit relacione, nota ose dokumente, pa ia komunikuar ato në kohë avokatit të palës tjetër, me përjashtim të rasteve kur veprime të tilla janë të lejueshme sipas rregullave

përkatëse të procedurës. Në shkallën e lejuar nga ligji, avokati nuk duhet të sugjerojë ose të parashtrojë para gjykatës ndonjë propozim për zgjidhjen e çështjes të bërë nga pala tjetër ose nga avokatët e saj, pa pëlqimin e shprehur të avokatit të palës tjetër.

4.3 Sjellja në gjykatë

Ndërsa ruan respektin dhe mirësjelljen ndaj gjykatës, avokati duhet të mbrojë interesat e klientit të tij me ndershmëri dhe pa frikë, pa menduar për interesat e tij ose për ndonjë pasojë që mund të ketë ai ose ndonjë person tjetër.

4.4 Informacioni i pavërtetë ose keqorientues

Avokati nuk duhet t'i japë asnjëherë gjykatës me dijeninë e tij informacion të pavërtetë ose keqorientues.

4.5 Shtrirja e rregullave për arbitrat etj.

Rregullat që drejtojnë marrëdhëniet e avokatit me gjykatat zbatohen edhe në marrëdhëniet e tij me arbitrat ose cilindo individ tjetër që ushtron funksione gjyqësore ose *kuazi* gjyqësore, qoftë edhe në raste të veçanta.

5 Marrëdhëniet midis avokatëve

5.1 Fryma e bashkëpunimit e profesionit

5.1.1 Fryma e bashkëpunimit e profesionit kërkon një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi midis avokatëve për të mirën e klientëve të tyre dhe për të shmangur mosmarrëveshjet e panevojshme dhe sjellje të tjera të dëmshme për reputacionin e profesionit. Megjithatë, kjo nuk mund të justifikojë asnjëherë vënien e interesave të profesionit kundër interesave të klientit.

5.1.2 Avokati duhet t'i pranojë të gjithë avokatët e tjerë të shteteve anëtare si kolegë profesionalë dhe të sillet me ta me ndershmëri dhe respekt.

5.2 Bashkëpunimi midis avokatëve të shteteve të ndryshme anëtare

5.2.1 Është detyra e avokatit të mos pranojë kërkesa për një çështje për trajtimin e së cilës ai nuk është kompetent, në rast se kjo çështje i parashtrohet atij nga një koleg i një shteti tjetër anëtar. Në raste të tilla, ai duhet të jetë i përgatitur ta ndihmojë kolegun e tij për të siguruar informacionin e nevojshëm që do ta mundësonte atë të kërkonte një avokat të aftë për të ofruar shërbimet e kërkuara prej tij.

e tij për të qenë i siguruar nga përgjegjësia ligjore profesionale si avokat, të cilat janë në fuqi në shtetin e tij anëtar të origjinës.

3.9.2.2 Avokati që është, pra, i detyruar të jetë i siguruar në shtetin e tij anëtar të origjinës dhe që ofron shërbime ose ushtron veprimtarinë profesionale në secilin prej shteteve anëtare pritëse, duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të siguruar, në bazë të kërkesave të shtetit të tij anëtar të origjinës, përgjegjësitë profesionale të cilat mbulojnë edhe shërbimet që ai garanton ose funksionin që ai kryen në shtetin anëtar pritës.

3.9.2.3 Avokati që nuk arrin të sigurojë mbulimin e zgjeruar të shërbimeve që referohen më sipër në paragrafin 3.9.2.2, ose që nuk është i detyruar të sigurojë veprimtarinë që kryen në shtetin e tij anëtar të origjinës dhe që ofron shërbime ose ushtron funksionin e tij në një shtet anëtar pritës, duhet të sigurojë sa të jetë e mundur mbulimin e përgjegjësisë së tij profesionale si avokat kur ushtron veprimtarinë e tij për klientë në këtë shtet anëtar pritës, ose të paktën një bazë ekuivalente me atë që u kërkohet avokatëve në shtetin anëtar pritës.

3.9.2.4 Sa kohë që avokati nuk është në gjendje të sigurojë mbulimin e përgjegjësisë profesionale që kërkohet sipas rregullave të sipërpërmendura, ai duhet të informojë klientët e tij të cilët mund të cenohen nga kjo gjë.

3.9.2.5 Avokati që ushtron veprimtarinë e tij ose ofron shërbime në një shtet anëtar pritës, në marrëveshje me organet përkatëse kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe të shtetit anëtar pritës, mund të respektojë kërkesat për sigurimin e përgjegjësisë profesionale që janë në fuqi në shtetin anëtar pritës dhe të përjashtohet nga kërkesat e shtetit anëtar të origjinës. Në një rast të tillë, ai duhet të marrë masat e nevojshme për të informuar klientët e tij se ai është siguruar sipas kërkesave në fuqi të shtetit anëtar pritës.

4 Marrëdhëniet me gjykatat

4.1 Rregullat që zbatohen për sjelljen në gjykatë

Avokati që paraqitet ose merr pjesë në një çështje para një gjykate ose tribunali të një shteti anëtar duhet të respektojë rregullat e sjelljes që zbatohen para asaj gjykate ose tribunali.

4.2 Zhvillimi me drejtësi i procedurave gjyqësore

Avokati duhet ta respektojë gjithmonë zhvillimin me drejtësi të procedurave ligjore. Për shembull, ai nuk duhet të kontaktojë me gjyqtarin, pa informuar më parë avokatin që vepron për palën kundërshtare ose të depozitojë pranë gjyqtarit relacione, nota ose dokumente, pa ia komunikuar ato në kohë avokatit të palës tjetër, me përjashtim të rasteve kur veprime të tilla janë të lejueshme sipas rregullave

përkatëse të procedurës. Në shkallën e lejuar nga ligji, avokati nuk duhet të sugjerojë ose të parashtrojë para gjykatës ndonjë propozim për zgjidhjen e çështjes të bërë nga pala tjetër ose nga avokatët e saj, pa pëlqimin e shprehur të avokatit të palës tjetër.

4.3 Sjellja në gjykatë

Ndërsa ruan respektin dhe mirësjelljen ndaj gjykatës, avokati duhet të mbrojë interesat e klientit të tij me ndershmëri dhe pa frikë, pa menduar për interesat e tij ose për ndonjë pasojë që mund të ketë ai ose ndonjë person tjetër.

4.4 Informacioni i pavërtetë ose keqorientues

Avokati nuk duhet t'i japë asnjëherë gjykatës me dijeninë e tij informacion të pavërtetë ose keqorientues.

4.5 Shtrirja e rregullave për arbitrat etj.

Rregullat që drejtojnë marrëdhëniet e avokatit me gjykatat zbatohen edhe në marrëdhëniet e tij me arbitrat ose cilindo individ tjetër që ushtron funksione gjyqësore ose *kuazi* gjyqësore, qoftë edhe në raste të veçanta.

5 Marrëdhëniet midis avokatëve

5.1 Fryma e bashkëpunimit e profesionit

5.1.1 Fryma e bashkëpunimit e profesionit kërkon një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi midis avokatëve për të mirën e klientëve të tyre dhe për të shmangur mosmarrëveshjet e panevojshme dhe sjellje të tjera të dëmshme për reputacionin e profesionit. Megjithatë, kjo nuk mund të justifikojë asnjëherë vënien e interesave të profesionit kundër interesave të klientit.

5.1.2 Avokati duhet t'i pranojë të gjithë avokatët e tjerë të shteteve anëtare si kolegë profesionalë dhe të sillet me ta me ndershmëri dhe respekt.

5.2 Bashkëpunimi midis avokatëve të shteteve të ndryshme anëtare

5.2.1 Është detyra e avokatit të mos pranojë kërkesa për një çështje për trajtimin e së cilës ai nuk është kompetent, në rast se kjo çështje i parashtrohet atij nga një koleg i një shteti tjetër anëtar. Në raste të tilla, ai duhet të jetë i përgatitur ta ndihmojë kolegun e tij për të siguruar informacionin e nevojshëm që do ta mundësonte atë të kërkonte një avokat të aftë për të ofruar shërbimet e kërkuara prej tij.

5.3 Korrespondenca midis avokatëve

5.3.1 Nëse avokati, i cili i dërgon një komunikim një avokati në një shtet tjetër anëtar, dëshiron që ky informacion të mbetet në mirëbesim ose i pacenuar, ai duhet ta shprehë qartë qëllimin e tij në kohën e dërgimit të dokumentit.

5.3.2 Nëse marrësi i komunikimit nuk është i aftë të garantojë statusin e këtij komunikimi si në mirëbesim ose të pacenuar, ai duhet t'ia kthejë komunikimin dërguesit, pa e bërë të ditur përmbajtjen e tij te persona të tjerë.

5.4 Tarifat për referimet

5.4.1 Avokati nuk duhet të kërkojë ose të pranojë nga një avokat ose person tjetër një tarifë, komision ose ndonjë lloj tjetër kompensimi për referimin ose rekomandimin që i bëhet klientit për një avokat të caktuar.

5.4.2 Avokati nuk duhet t'i paguajë askujt një tarifë, komision ose ndonjë lloj tjetër kompensimi si shprehje të konsideratës për referimin e një klienti.

5.5 Komunikimi me palët kundërshtare

Avokati nuk duhet të komunikojë drejtpërdrejt për një çështje ose problem me asnjë person, të cilin ai e di se përfaqësohet në këtë çështje ose problem nga një avokat tjetër, pa miratimin e avokatit tjetër (dhe duhet ta mbajë të informuar avokatin tjetër lidhur me këto komunikime).

5.6 Ndryshimi i avokatit

5.6.1 Avokati që kërkohet të përfaqësojë një klient lidhur me një çështje të caktuar si zëvendësues i një avokati tjetër dhe i detyruar të respektojë pikën e mëposhtme 5.6.2, nuk duhet të fillojë të veprojë derisa të përcaktohet përfundimi i rregullimeve për shpenzimet dhe tarifat e avokatit tjetër. Megjithatë, kjo detyrë nuk e bën avokatin e ri personalisht përgjegjës për tarifat dhe shpenzimet e avokatit të mëparshëm.

5.6.2 Nëse për interesat e klientit duhet të ndërmerren hapa urgjentë përpara përmbushjes së kushteve të parashikuara në pikën 5.6.1, avokati mund t'i ndërmarrë këta hapa nëse avokati tjetër njoftohet menjëherë.

5.7 Përgjegjësia për tarifat

Në marrëdhëniet profesionale midis anëtarëve të dhomave të avokatisë të shteteve të ndryshme anëtare, në rastet kur avokati nuk rekomandon një avokat tjetër ose nuk e prezanton atë me klientin, por cakton një relator për një çështje të caktuar ose kërkon këshillën e tij, ai është personalisht i detyruar, edhe në rast se klienti është pa mjete financiare, të paguajë tarifat, shpenzimet dhe të hollat që i përkasin relatorit të huaj. Por, avokatët në fjalë, në fillim të marrëdhënies së tyre, mund të bëjnë një rregullim të veçantë për këtë çështje. Po ashtu, avokati kërkues mund ta kufizojë në çdo kohë përgjegjësinë e tij personale vetëm për tarifat, të hollat dhe shpenzimet e kryera përpara se t'i bëjë të ditur avokatit të huaj heqjen dorë nga përgjegjësia për të ardhmen.

5.8 Trajnimi i avokatëve të rinj

Me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve të besimit dhe të bashkëpunimit midis avokatëve të shteteve të ndryshme anëtare në të mirën e klientëve, ekziston nevoja e inkurajimit të njohurive më të thella për ligjet dhe procedurat në shtete të ndryshme anëtare. Pra, kur marrim në konsideratë nevojën e profesionit për t'i ofruar një trajnim të mirë avokatëve të rinj, avokatët duhet të mbajnë parasysh nevojën e ofrimit të trajnimeve të mira edhe për avokatët e rinj nga shtete të tjera anëtare.

5.9 Mosmarrëveshjet midis avokatëve në shtete të ndryshme anëtare

5.9.1 Nëse avokati mendon se një koleg i tij në një prej shteteve anëtare ka vepruar duke shkelur rregullat e sjelljes profesionale, ai duhet të tërheqë vëmendjen e kolegut të tij për këtë problem.

5.9.2 Nëse midis avokatëve të shteteve të ndryshme anëtare lind një mosmarrëveshje personale me natyrë profesionale, ata para së gjithash duhet të përpiqen ta zgjidhin këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

5.9.3 Avokati nuk duhet të fillojë asnjë formë të procedurave ligjore kundër një kolegu të një shteti tjetër anëtar për çështjet e referuara në pikat 5.9.1 ose 5.9.2, pa informuar më parë dhomat e avokatisë ose shoqëritë ligjore të cilave ata u përkasin, me qëllim që t'u japë këtyre të fundit mundësinë e arritjes së një zgjidhjeje me marrëveshje.

e – BIBLIOGRAFI

Për avokatët

R.Danovi, *Corso di ordinamento forense e deontologia*, Milano, Giuffrè, 7° ed., 2003

P.Gianniti, *Principi di deontologia giudiziaria*, Padova, CEDAM, 2002

Për caktimin e shpenzimeve gjyqësore:

F.Chiovenda, *La condanna nelle spese giudiziali*, Torino, Fratelli Bocca, 1901 (rep. Napoli, ESI, 2001)

P.Hurst, *Civil Costs*, London, Sweet & Maxwell, 3rd ed., 2004.

W.Pfenningstorf, "The European Experience with Attorney Fee Shifting", in *Law and Contemporary Problems*, 1984, pp. 47 ff.

f - FJALORI TERMINOLOGJIK

Tarifa e ngjarjeve të mundshme = Rregullime sipas të cilave avokati paguhet vetëm në rast të një rezultati të suksesshëm. Në ShBA, zakonisht, kjo tarifë jepet sipas një përqindjeje të shumës së të hollave të fituara nga vendimi gjyqësor.

Ndihma ligjore = Forma të mbështetjes të garantuara nga shteti ose entitete të tjera (kryesisht publike) me qëllim mundësimin e aksesit në gjykata edhe për personat që nuk kanë mjete ekonomike të mjaftueshme.

Tarifa që bazohet mbi kohën = Tarifë e llogaritur nga shumëzimi i numrit të arsyeshëm të orëve të shpenzuara për kryerjen e punës me honoraret e arsyeshme për një orë.

Pro bono = Shërbime ligjore të ndërmarra, pa pritur marrjen e tarifës përkatëse, zakonisht për ideale, motive sociale ose humanitare.

g - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Qëndrimi që mbahet ndaj avokatëve është po aq i rëndësishëm sa edhe cilësia e vendimit që jepet nga një gjyqtar. Respektimi i rregullave të etikës profesionale nga avokatët që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një juridiksion të caktuar, varet gjerësisht nga perceptimi nëse sjellja joetike do të ndëshkohet ose jo nga gjyqtarët (formalisht ose joformalisht).

2. Vendimet për caktimin dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore janë elemente të rëndësishme të veprimtarisë së gjyqtarit, pasi ato mund të kenë efekte mjaft të rëndësishme për aksesin në drejtësi. Për këtë arsye, hapësirat e diskrecionit që ekzistojnë për gjyqtarët, duhet të përdoren me shumë kujdes.

KREU I PESTË

E DREJTA E PROVAVE

a - OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet të kenë njohuri për:

- kufijtë objektivë dhe subjektivë të pranimit të dëshmisë si provë, si dhe për kufizimet e kompetencave diskrecionale të gjyqtarëve në vlerësimin e provave;
- rregullat kryesore që lidhen me marrjen në pyetje të dëshmitarëve;
- kushtet që duhet të përmbushen nga provat shkresore në mënyrë që ato të kenë fuqi provuese;
- hapat që duhet të ndiqen në marrjen e provave të ekspertëve, si dhe metodat që duhet të përdoren për vlerësimin real të tyre;
- përkufizimet dhe karakterin e mjeteve të provave, të ndryshme nga ato të përmendura më lart.

b - MATERIALET REFERUESE KRYESORE

1. Kuptimi i së drejtës së provave – Parime të përgjithshme

Parimet e përgjithshme për provat janë parashikuar në nenet 11 – 15 të Kodit shqiptar të procedurës civile.

Neni 12 parashikon parimin e paraqitjes së provave nga palët, duke ecur kështu në linjën e shumicës së sistemeve kontinentale. Një zbatim i drejt-përdrejtë i këtij parimi mund të gjendet në nenin 213, sipas të cilit, palët

lejohen t'i paraqesin gjykatës provat e domosdoshme për të provuar faktet mbi të cilat bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre.[1)]

Neni 13 parashikon një rregull tjetër, të përhapur në traditën kontinentale procedurale, sipas së cilës faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk kanë nevojë të provohen. Faktet për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi.

Këto rregulla të rëndësishme janë të parashikuara edhe në Kodin italian të procedurës civile (konkretisht, në nenin 115) dhe gjenden në pjesën më të madhe të kodeve kontinentale. Provat që duhet të pranohen nga gjyqtari, duhet të kenë lidhje me çështjen dhe të jenë ligjërisht të pranueshme.

Këto rregulla të përgjithshme për provat në procedurën civile italiane, të cilat, sikurse e përmendëm edhe më sipër, janë shumë të ngjashme me sistemin shqiptar, shpjegohen shkurtimisht dhe qartësisht nga M. Taruffo në librin *"Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile".*[2)]

"Provat që kanë lidhje me çështjen, duhet të paraqiten nga palët në pretendimet e tyre ose në seancën e parë gjyqësore. Në fakt, sistemi procedural italian mbështetet kryesisht mbi parimin e paraqitjes së provave nga palët. Thuhet kryesisht, pasi disa lloje të provave mund të urdhërohen me iniciativën e vetë gjykatës: prova e ekspertit, disa lloje të deklaratave të bëra nën betim, këqyrja e vendit dhe e personave, si dhe kërkesa për marrjen e informacionit nga organet qeveritare.

Por, këto kompetenca *ex officio* të gjykatës kanë rëndësi të kufizuar në kontekstin e përgjithshëm të paraqitjes së provave. Nga ky këndvështrim, sistemi italian bie në kundërshtim me reputacionin e tij si sistem "inkuizitor."

Shënim i autorit: *Disa kompetenca ex officio përmenden edhe në modelin shqiptar të procesit civil, si p.sh.: në nenet 223, 224 që lidhen me marrjen e provave te të tretët, ose në nenin 225 për caktimin e ekspertëve.*

Parimi i përgjithshëm që lidhet me pranimin e provave, është se provat pranohen nga gjyqtari kur kanë *lidhje me çështjen* dhe janë *ligjërisht të pranueshme.* Lidhja me çështjen varet nga lidhja logjike, qoftë edhe të një pjese të vetme të

1) Neni 213 - Kapitulli V – Rregulla të përgjithshme për marrjen e provave – Titulli II – Shqyrtimi i çështjes, Pjesa II – Gjykimi në shkallë të parë.

2) Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile, në J.S. LENA AND U. MATTEI, Hyrje në të drejtën italiane, Hague-London-New York, Kluwer International, 2002, faqe. 159.

provës me faktet e çështjes. Prova që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një fakt material, ka edhe lidhje logjike, p.sh., kur ajo mund të shërbejë si premisë për një ndërhyrje logjike që sjell përfundime mbi një fakt material. Sikurse kemi parë edhe më lart, sistemi i "paraqitjes së fakteve" synon t'i lejojë gjyqtarit hapësirën e nevojshme për të vlerësuar si duhet lidhjen që kanë me çështjen e gjykimit provat e paraqitura nga palët".

Shënim i autorit: *Parimi i lidhjes së provave me çështjen është parashikuar në nenin 213 të Kodit shqiptar të procedurës civile: "Në zbatim të nenit 12 të këtij Kodi, gjykata, me vendim, lejon palët të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur në gjykatë vetëm ato prova që janë të domosdoshme dhe që kanë lidhje me çështjen e gjykimit".*

Pranueshmëria ligjore e provave përcaktohet nëpërmjet rregullave të ndryshme që kufizojnë ose përjashtojnë disa lloje të provave në bazë të rrethanave të caktuara të parashikuara me ligj. Rregullat më të rëndësishme përjashtuese trajtojnë rastet në të cilat të vetmet prova të lejuara janë *dokumentet shkresore.* Në këtë fushë, sistemi italian ndjek modelin tradicional francez, sipas të cilit disa lloje të kontratave mund të provohen vetëm nëpërmjet shkresave, duke përjashtur provat gojore (veçanërisht dëshmitë). Në disa raste, kjo vjen si rezultat i faktit se forma shkresore kërkohet si kusht për vlefshmërinë e kontratës ose për provimin e saj.

Shënim i autorit: *Në këtë kontekst, edhe sistemi shqiptar tregon se është ndjekës i modelit francez, po të shihen, për shembull, nenet 231-232 në pjesën "Kufijtë e lejimit të provave me dëshmitarë". Gjithsesi, rregullat që lidhen me dëshminë dhe provat shkresore do të analizohen në mënyrë më të hollësishme në § 2.*

Në raste të tjera, përjashtimi bazohet mbi prezumimin e besueshmërisë relativisht të ulët të dëshmisë si provë. Ekzistojnë edhe rregulla të tjera përjashtuese. Për shembull, individët që nuk janë palë në gjykim, të cilët mund të ndërhyjnë në çështjen në gjykim, nuk lejohet të dëshmojnë. Po ashtu, palët nuk mund të dëgjohen si dëshmitarë, megjithëse mund të japin deklarata provuese në formën e pohimeve ose të betimeve. Nga ana tjetër, nuk ekziston ndonjë gjë e ngjashme me rregullën amerikane të 'gjërave të dëgjuara', duke qenë se dëshmia e dorës së dytë zakonisht pranohet (megjithëse gjykata mund të urdhërojë, aty ku është e mundur, pyetjen e dëshmitarëve të "dorës së parë" dhe fuqia provuese e provave të "gjërave të dëgjuara" duhet të vlerësohet me shumë kujdes).

Një grup tjetër i rëndësishëm i rregullave për përjashtimin e provave synon ruajtjen e disa llojeve të sekreteve.

Pranueshmëria e provave që nuk janë përmendur në mënyrë të shprehur nga ligji (të ashtuquajturat *provat jotipike),* është një çështje tjetër me mjaft rëndësi. Mendimi më i përhapur është se çdolloj prove që nuk është përjashtuar në mënyrë të shprehur nga ligji, pranohet kur ka lidhje me çështjen e gjykimit dhe se kjo gjë vlen edhe për provat jotipike. Megjithatë, shpesh theksohet fakti se gjykatat duhet të tregohen shumë të kujdesshme në vlerësimin e fuqisë provuese të provave të tilla, duke qenë se këto zakonisht krijohen jashtë kontekstit gjyqësor, të zhveshura nga çdolloj kontrolli apo garancie për besueshmëri.

Mbi bazën e standardeve të pranueshmërisë dhe lidhjes që kanë me çështjen e gjykimit, gjykata bën një përzgjedhje të provave të ofruara nga palët dhe vendos se cilat prova do të paraqiten. Vendimi nëpërmjet të cilit pranohen apo përjashtohen pjesë të ndryshme të provave, lëshohet nga gjykata në fund të fazës përgatitore. Në përfundim të kësaj faze, palët nuk mund të depozitojnë më pretendime ose mbrojtje të reja, si dhe nuk mund të ofrojnë prova të tjera (ndonëse një përjashtim e përhapur gjerësisht pranon se palët duhet të lejohen të paraqesin dokumente në çdo moment).

Më pas, fillon një fazë e re e procesit gjyqësor, e cila i kushtohet paraqitjes së provave. Provat nuk paraqiten në një seancë gjyqësore të mirëfillshme. Kur duhet të paraqiten shumë prova gojore, mund të jetë e nevojshme të zhvillohen disa seanca. Këto seanca mund të zhvillohen në intervale të gjata kohore njëra nga tjetra, sikurse gjykohet e arsyeshme nga gjyqtari. Në çështjet e ndërlikuara, mund të kërkohet zhvillimi i shumë seancave. Kjo nënkupton se mund të duhen edhe vite për paraqitjen e provave (për shembull, në rastet kur një gjyqtar i zënë me punë apo zvarritës cakton një seancë në vit, madje edhe më pak për çështje të caktuara)[...]".

2. Dëshmitarët

2.1. Përdorimi i provës me dëshmitarë kur janë të disponueshme edhe provat shkresore

Neni 232 i Kodit shqiptar të procedurës civile parashikon se: "Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja me anë pagimi ose falje e detyrimeve me të holla, që rrjedhin nga një kontratë që është bërë ose duhej bërë me dokument, edhe sikur shuma ose vlefta e paguar të jetë më e vogël se 50.000 lekë".

Kjo rregull ka ekuivalenten e saj në Kodin italian të procedurës civile dhe, konkretisht, në nenet 2722 dhe 2723 të tij. Për sa u takon kufijve objektivë të provës me dëshmitarë, një shpjegim i qartë mund të gjendet në S. CHIARLONI, *"Vlera e provës me dëshmitarë në të drejtën italiane*, në *raportet kombëtare italiane*:[3)]

"Para së gjithash, në Kodin civil, ligjvënësi parashikon një numër të kufijve objektivë për pranueshmërinë e provës me dëshmitarë, të cilët varen nga lloji i mosmarrëveshjes. Këta kufij nuk merren parasysh në rastet kur, sikurse mund të ndodhë dhe që në të vërtetë ndodh shpesh, dëshmitarët janë e vetmja pjesë e disponueshme e provës gjatë procesit gjyqësor. Mjafton të mendohen këtu të gjitha çështjet që lidhen me dëmet. Por, këta kufij janë shumë të rëndësishëm në rastet e mosmarrëveshjeve që lidhen me kontratat, ku ato luajnë një rol të dyfishtë: ato i nxitin palët të mbajnë dokumentacion të shkruar për marrëveshjet e tyre, në mënyrë që të garantohet një shqyrtim i kujdesshëm dhe vlerësim i saktë i përmbajtjes së tyre në rast mosmarëveshjeje, krahasuar me atë çka do të mund të sigurohej nga prova me dëshmitarë.

Rregullat për raportin ndërmjet provave gojore dhe shkresore derivojnë dukshëm nga tradita franceze, nëpërmjet Kodit civil të vitit 1865. Por, gjithsesi, ato janë të strukturuara shumë më mirë sesa në Kodin e Napoleonit, ndoshta falë mësimeve sistematike të marra nga tradita gjermane në kulturën ligjore të vendit tonë në intervalin midis dy kodifikimeve të Italisë së bashkuar.

Gjatë rregullimit të kufijve të provës me dëshmitarë, për sa i takon objektit të mosmarrëveshjes, ligjvënësi pranon se rëndësia e marrëveshjeve të shkruara është më e madhe krahasuar me marrëveshjet gojore.

Ekzistojnë raste (kryesisht kontrata për pronësinë reale) në të cilat forma me shkrim është element thelbësor i transaksionit ligjor. Thuhet se dokumenti kërkohet *ad substantiam.* Rregullat përkatëse nuk kanë të bëjnë me të drejtën e provave, por me vlefshmërinë e kontratës. Në këto raste, sikurse edhe në ato në vijim, prova me dëshmitarë pranohet kur pala e ka humbur pa faj dokumentin dhe do t'i duhet në këtë mënyrë të rindërtojë përmbajtjen e tij.

Në raste të tjera, thotë ligjvënësi, kontrata duhet të provohet "me shkrim" *(per iscritto).* Për shembull, ky është rasti i kontratave të sigurimit, të risigurimit, të rregullimit, të transferimit të pronës apo të gëzimit të biznesit të ndërmarrjes që i nënshtrohet regjistrimit, të transferimit të të drejtave të shfrytëzimit të veprave intelektuale dhe të shpikjeve industriale ose të kufizimit të konkurrencës. Thuhet se dokumenti këtu kërkohet *ad probationem.*

---

3) S. CHIARLONI, Vlera e provës me dëshmitarë në të drejtën italiane, në Raportet kombëtare italiane, 1994, faqe. 223:

Duhet nënvizuar këtu se ligjvënësi është i pasaktë. Ai thotë se këto kontrata duhet të provohen me shkrim (shih nenin 2725 të K.civil), por, në të vërtetë, kjo nënkupton se ato nuk mund të provohen me dëshmitarë.

Gjatë procesit, pala e interesuar, përveçse paraqet dokumentin, mund të provojë edhe se këto kontrata, për arsye të caktuara, janë lidhur gojarisht, duke përdorur mjete të tjera të provave, efekti ligjor i të cilave është pranuar sipas sistemit tonë ligjor (ato nuk i nënshtrohen vlerësimit të lirë të gjyqtarit, por e kanë efektin ligjor të paracaktuar me ligj). Më konkretisht, pala mund t'i provojë ato nëpërmjet pohimit (edhe jashtëgjyqësor) ose betimit, nëse pala kundërshtare nuk e pranon prapësimin dhe refuzon të betohet [...].

Çfarë ndodh nëse gjatë procesit gjyqësor, njëra prej palëve kërkon thirrjen e dëshmitarëve për të provuar një pohim që shton ose që vjen në kundërshtim me përmbajtjen e dokumentit?

Përgjigjja formulohet në bazë të një dallimi që mbështetet në përvojën e krijuar nga ajo çka është parashikuar në Kodin e Napoleonit. Është e nevojshme të provohet pretendimi i palës, nëse lidhja e kontratës është bërë para, në të njëjtën kohë ose pas përpilimit të dokumentit. Në rastin e parë (neni 2722), në parim, prova nuk mund të pranohet mbi bazën e supozimit se, nëse palët kanë vendosur ta bëjnë me shkrim kontratën, si rregull, dokumentacioni duhet të jetë i plotë, pa pasur nevojë të provohen klauzola të tjera. Në rastin e dytë (neni 2723), mbi bazën e supozimit se faktet interferuese mund t'i kenë detyruar palët të bëjnë marrëveshje të reja gojore që modifikojnë, madje edhe vijnë në kundërshtim me origjinalin, gjyqtarit i është dhënë kompetenca diskrecionale e lejimit të provës, nëse, mbi bazën e të njëjtëve tregues që provojnë tejkalimin e vlerës, "bëhet i mundshëm fakti që shtesat ose modifikimet gojore të kenë ndodhur".

Në nenin 2724, ligjvënësi shpreh shqetësimin lidhur me rrethanat e mundshme sipas të cilave, në çdo rast, rekomandohet përjashtimi i ndalimit i provës me dëshmitarë.

Neni i fundit ka karakter më të përgjithshëm, duke qenë se ai zbatohet – sikurse e kemi parë tashmë – edhe në rastin e një dokumenti që Kodi e kërkon *ad substantiam* ose *ad probationem*. Kjo i referohet humbjes pa faj të dokumentit që garantonte provën. Në një rast të tillë, përveç provimit të vetë përmbajtjes së dokumentit, është e qartë se duhet të provohet edhe qenia e tij reale, si dhe të provohet se ai ka humbur pa faj.

Dy rastet e tjera përjashtimore lidhen me kufizime të tjera objektive. Prova me dëshmitarë mund të pranohet: a) në rastin kur ekziston një provë shkresore *prima facie* (e përkufizuar nga i njëjti ligjvënës, si "çdo shkresë që e bën të mundshëm faktin e pohuar dhe që paraqitet nga personi kundër të cilit është ngritur padia, ose nga përfaqësuesi i tij") dhe b) në rastin kur është materialisht

ose moralisht e pamundur për palët kontraktuese të sigurojnë ndonjë provë shkresore.

Reforma e procedurës të së drejtës së punës është e rëndësishme në historinë e sistemit procedural italian, duke përfaqësuar një hap përpara në transicionin nga modeli francez në modelin gjerman, i cili nuk parashikon kufizimet objektive të pranueshmërisë së provës me dëshmitarë. Faktikisht, sipas nenit 421 të Kodit të procedurës civile, gjyqtari i mosmarrëveshjeve të së drejtës së punës mund të pranojë në çdo moment çfarëdolloj mjeti si prove, qoftë edhe jashtë kufizimeve të vendosura nga Kodi civil. Duhet të vihet në dukje këtu se, edhe para reformës, jurisprudenca zotëronte një instrument për pranimin e provave: marrëdhënia psikologjike e "varësisë" që, normalisht, ekziston midis punëdhënësit (pala e fortë kontraktuese) dhe të punësuarit (pala e dobët kontraktuese), në të vërtetë është një marrëdhënie në të cilën presupozohet automatikisht se ekziston një kusht i pamundësisë "morale" për të siguruar prova shkresore; në çdo rast, ky kusht lejon kapërcimin e kufirit ligjor të pranimit të provave me dëshmitarë.

Së fundi, është me rëndësi të thuhet se, në mënyrë të ngjashme me atë që ndodh kur zbatohet i ashtuquajturi "parim se dokumenti, i cili konsiderohet nga palët si finalizimi i marrëveshjes së tyre, nuk mund të modifikohet me anë të një prove që shton, ndryshon ose kundërshton këtë dokument," kufiri objektiv i provës me dëshmitarë në çështjet kontraktore kuptohet shumë ngushtë. Andrioli e përmbledh këtë gjë në mënyrë shumë të thukët: "kufizimi zbatohet vetëm në rastet kur kontrata bëhet me kërkesë të palës paditëse ose si përgjigje e palës së paditur dhe jo në rastet kur ajo hartohet si një fakt i thjeshtë".

Kufizimi nuk është i vlefshëm për faktet mbi të cilat mbështetet pabazueshmëria e shkakut *(causa)* ose e objektit, mundësia ose pamundësia për të vepruar, "veset e vullnetit", ose kur problemi është ai i interpretimit të përmbajtjes, ose përsëri kur përfundimi i një kontrate kërkohet nga një palë e tretë, si një fakt material që prodhon efekte ligjore të pavarura.

Reduktimi i fushës së veprimit të kufizimeve të trajtuara më sipër, kompetencat e gjera diskrecionale që i jepen gjyqtarit që dëshiron t'i kapërcejë ato, pazbatueshmëria e tyre në një fushë të rëndësishme, si për shembull në rastin e mosmarrëveshjeve që lindin në të drejtën e punës, na lejojnë të vijmë në përfundimin se edhe Italia, për sa kohë bëhet fjalë për kufizimet objektive të provave me dëshmitarë, po ecën në rrugën e evoluimit modern të të drejtës së provave, duke u zhvendosur nga formalizmi i rregullave të përjashtimit në racionalitetin e rregullave të "mosbesimit".

2.2. Personat që nuk mund të pyeten si dëshmitarë

Për sa u përket kufizimeve subjektive të pranueshmërisë së provës me dëshmitarë, në procedurën civile italiane, sikurse edhe në atë shqiptare, ka një rregull themelore, sipas së cilës, as palët pjesëmarrëse në proces, as palët e treta të mundshme, nuk mund të jenë dëshmitarë të të njëjtit proces. Aktualisht, palët mund të pyeten nga gjyqtari në mënyrë informale, por kjo nuk mund të konsiderohet dëshmi në kuptimin e mirëfilltë të fjalës (shih nenin 235 "Ndalimi i pyetjes si dëshmitarë", të Kodit shqiptar të procedurës civile dhe nenin 182, të cilët parashikojnë se palëve mund t'u kërkohet të paraqiten personalisht për t'u pyetur për rrethanat e çështjes).

Fragmenti në vijim, i cili i referohet procesit civil italian, është shkëputur nga M. TARUFFO, *"Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile"*:

"Dëshmia mund të jepet nga çdo individ që nuk është palë në gjykim, i cili mund të kenë dijeni për fakte që lidhen me çështjen në shqyrtim. Nga këndvështrimi anglo-amerikan, nuk ka asnjë hezitim se palët në gjykim dhe palët e treta nuk mund të dëshmojnë si dëshmitarë; edhe palët e treta të mundshme nuk janë kompetente për të dëshmuar. Palët mund të pyeten - ose, sipas ligjit, *duhet të pyeten,* por kjo nuk ndodh gjithmonë – nga gjyqtari në rrugë informale, pa bërë betimin për thënien vetëm të së vërtetës (e ashtuquajtura *pyetja e lirë*), por kjo gjë nuk është dëshmi në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kjo marrje në pyetje synon vetëm qartësimin e objektit të çështjes dhe, ndoshta, nxitjen e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre".

Kjo rregull e ka origjinën e saj historike në sistemin e provave të marrë prej kodifikimit të Napoleonit, sikurse përshkruhet qartë edhe në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar.*[4] Shkrimi ilustron shkurtimisht fillimet e sistemit të përjashtimit të dëshmitarëve, të cilat gjenden në shumë prej sistemeve kontinentale të frymëzuara nga modeli francez:

"*Statusi i përjashtimit të dëshmive (reproches).* – Një mbetje tjetër nga sistemi formal i provave në kodifikimin e Napoleonit ishte sistemi i të ashtuquajturave *përjashtime*, i ngjashëm me sistemin e përjashtimeve të dëshmive që gjendet në vendet e common law. Sipas këtij sistemi, një numër dëshmitarësh – dëshmitarët e përjashtuar – mund të kundërshtohen nga një prej palëve. Nëse kundërshtohet në mënyrë të bazuar, dëshmitari përjashtohet. Midis atyre që konsideroheshin si dëshmitarë të përjashtuar ishin personat që "kishin ngrënë ose kishin pirë" me palën, shërbëtorët ose personat që jetonin në një shtëpi me palën, personat

4) *IECL, vëll. XVI,* **Procedura civile,** *kapitulli V,* **Dobësimi i fomalizmit në rregullat e provave,** *J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London), faqe. 37*

nën akuzë ose personat e dënuar, si edhe shumë të tjerë (K.pr.civile 1806, neni 284, § 2). Ndonëse ligji i shkruar nuk e parashikonte këtë gjë në mënyrë të shprehur, doktrina franceze dhe vendimet e gjykatave ndanin të njëjtin opinion se edhe individët që kishin interesa në mënyrën e përfundimit të procesit gjyqësor duhet të përjashtoheshin. Po ashtu, bashkëshorti/bashkëshortja dhe disa të afërm të palëve ndaloheshin të dëshmonin edhe nëse nuk kundërshtoheshin (K.pr.civile 1806, neni 283, § 1).

Arsyeja fillestare e këtyre përjashtimeve të dëshmitarëve ishte frika se persona të tillë do të shtyheshin të ndiqnin interesat e tyre më shumë sesa të thoshin të vërtetën. Duke marrë në konsideratë sistemin e vlerësimit mekanik dhe numerik të provave në mesjetë, pasojat e dëshmive të rreme për shkak të njëanshmërive (favorizimeve) ose korrupsionit kishin shumë gjasa të ndodhnin. Në kohën e kodifikimit francez, dyshimi mbi aftësinë e gjyqtarit për të peshuar provat sipas rrethanave konkrete të çështjes ishte ende aq i fortë, sa këto përjashtime u ruajtën.

Kritikat e autorëve francezë për ruajtjen e një koncepti të tillë arkaik, sigurisht, nuk munguan. Kritikat *ante litteram* të *Volterit* , para kodifikimit, tashmë ishin bërë evidente. Gjatë mesit të shekullit të 19-të, Bonieja (*Bonnier*, jurist i shquar francez) shkruante se: "Duke qenë se vlerësimi numerik i provave nuk ekzistonte më dhe duke qenë se tashmë provat peshoheshin dhe nuk mateshin, nuk kishte më asnjë arsye për refuzimin *a priori* të dëshmisë së personave të caktuar". Megjithatë, në Francë, shumë prej këtyre sistemeve mbetën në fuqi deri në reformat e vitit 1958, ndonëse nuk u arrit të shmangeshin të gjitha këto sistemeve të përjashtimit (shih Kodin e ri të procedurës civile, nenet 205-206).

Një model i ngjashëm me përjashtimin e vjetër francez vazhdon të jetë në shumë vende të së drejtës kontinentale. Për shembull, në Itali personat që kanë interes për çështjen, ende ndalohen të dëshmojnë. U desh një vendim i kohëve të fundit të Gjykatës Kushtetuese që të hidhte poshtë përjashtimin tradicional të bashkëshortit/bashkëshortes, të afërmve të tyre ose të afërmve personalë të palëve (Kodi italian i pr.civile, neni 246 "Përjashtimi i personave të tretë të interesuar" dhe neni 247 "Përjashtimi i bashkëshortit/bashkëshortes, të afërmve të tyre ose të afërmve personalë të palëve". Neni 247 është konsideruar si antikushtetues për shkak të kufizimit të paarsyeshëm të së drejtës së palëve për të provuar çështjen e tyre (Gjykata Kushtetuese, 23 korrik 1974).

Shënim i autorit: *Neni 246 i Kodit italian të procedurës civile thotë se roli i dëshmitarit u ndalohet personave "që kanë në mosmarrëveshje një interes të tillë që do të përligjte pjesëmarrjen e tyre në gjykim".*

Neni 247 lidhej me ndalimin e dëshmisë nga persona që kanë marrëdhënie të ngushta familjare me palët e përfshira në gjykimin e çështjes (përjashtime janë bërë për proceset e divorceve ose të çështjeve familjare). Gjykata Kushtetuese e Italisë, në vitin 1974, shfuqizoi nenin 247 të Kodit të procedurës civile me një ven dim që deklaronte se ndalimi i dhënies së provave ishte antikushtetues.

Në ndryshim nga kjo, në Kodin shqiptar një rregull e tillë ekziston ende: shih nenin 235. Kode të tjera europiane kanë përqafuar një qëndrim më modern. Për shembull, e drejta federale zvicerane, Kodi i Austrisë i vitit 1895 dhe ai i Gjermanisë i vitit 1877 nuk kanë asnjë analogji me sistemin e vjetër francez të përjashtimeve.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis sistemit të vjetër të përjashtimit të dëshmive dhe koncepteve moderne të "privilegjimit" të dëshmive. Shumë vende të së drejtës kontinentale dhe të common law kanë nxjerrë rregulla që i lejojnë palët të ndalojnë dhënien e dëshmive kundër tyre nga një kategori personash. Për shembull, komunikimet konfidenciale të palës me avokatin e saj, doktorin, priftin ose bashkëshortin/bashkëshorten zakonisht nuk mund të paraqiten si prova, nëse pala nuk bie dakord (shih, për shembull, Kodin gjerman të pr. civile, § 383; Kodin italian të pr.civile, neni 249). Ndërsa sistemi francez i *përjashtimeve* synonte të parandalonte dhënien para gjykatës të dëshmive potencialisht të njëanshme, justifikimi për ekzistencën e këtyre privilegjeve bashkëkohore zakonisht lidhet me parimet jashtë mosmarrëveshjes në shqyrtim, siç mund të janë, p.sh., mbrojtja e jetës private ose nxitja e harmonisë martesore. Ky arsyetim mund të shpjegojë faktin përse këto rregulla i mbijetuan reformës së vitit 1958 në Francë dhe duket se mbartin një rëndësi të tillë edhe në vende të tjera [...].

Pasojë tjetër e sistemit mekanik dhe numerik të vlerësimit të provave në mesjetë ishte edhe përjashtimi i vetë palëve nga qenia dëshmitarë. Palët mund të paraqesin dëshmi vetëm nëpërmjet "betimit përcaktues" (betim i bërë nga një prej palëve ndërgjyqëse dhe që përcakton përfundimin e çështjes në rastin kur pala kundërshtare, e cila nuk ka mundur të japë prova të mjaftueshme, pranon t'ia referojë palës tjetër vendimin për zgjidhjen e çështjes) ose në përgjigje të "marrjes formalisht në pyetje." Këto mbetje të sistemit mesjetar të provave u mbijetuan reformave liberale të Revolucionit Francez dhe u ngurtësuan në kodifikimin pasardhës të Napoleonit".

Shënim i autorit: *shih § nr. 5.3 të këtij kapitulli për betimin përcaktues, si provë ligjore.*

2.3. Marrja në pyetje e dëshmitarëve: marrja në pyetje nga gjykata dhe pyetja e kryqëzuar e dëshmitarëve

Dispozitat që lidhen me dëshminë gojore në Kodin shqiptar të procedurës civile, janë tepër të ngjashme me ato të Kodit italian të procedurës civile. Dallimi kryesor është se Kodi italian i procedurës civile nuk lejon pyetjen e kryqëzuar të dëshmitarëve.

Sipas procedures italiane, mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarëve shpjegohet mjaft qartë nga M. TARUFFO në *"Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile"*, cituar edhe më sipër.

"Paraqitja e provave gojore bëhet sipas *parimit procedimor të gjykatës.* Dëshmitari merret në pyetje kryesisht nga gjyqtari në raport me avokatët e palëve (shih nenin 251 të Kodit italian të procedurës civile) [...].

Shënim i autorit: *Neni 251 i Kodit italian të procedurës civile parashikonte se dëshmitarët, të paralajmëruar nga gjyqtari për rëndësinë morale dhe fetare të betimit, duhet të betohen se do të thonë vetëm të vërtetën. Kjo rregull u shpall si antikushtetuese, në vitin 1995, nga Gjykata Kushtetuese e cila ndryshoi edhe formulën e betimit që duhet të artikulohej nga dëshmitarët. Tani, dëshmitari duhet të deklarojë se, i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë morale dhe ligjore që mbart me bërjen e dëshmisë, ai detyrohet të thotë vetëm të vërtetën.*

Sipas Kodit shqiptar, dëshmitarit i kërkohet të betohet para gjykatës (shih nenin 237). Pasi paralajmërohet për përgjegjësinë që mbart dëshmia e rreme, ai duhet t'i përgjigjet me fjalën "Betohem" formulës që lexohet nga sekretarja gjyqësore: "Betohem se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën".

Gjyqtari e merr në pyetje dëshmitarin duke i drejtuar pyetje lidhur me faktet e çështjes, duke e lejuar ndonjëherë dëshmitarin të flasë lirisht për ato që di lidhur me faktet. Marrja në pyetje bëhet mbi bazën e deklaratave faktike të parashtruara nga palët në pretendimet e tyre. Gjyqtari mund t'i drejtojë dëshmitarit edhe pyetje të tjera duke synuar qartësimin e fakteve të çështjes, por, edhe kur ndodh kështu, marrja në pyetje nga gjyqtari është larg kërkimeve hetimore të së vërtetës. Avokatët e palëve mund t'i sugjerojnë gjyqtarit pyetje shtesë që kanë si qëllim qartësimin e dëshmisë së dëshmitarit, por, ndryshe nga sistemi anglo–amerikan, ata nuk mund t'i drejtojnë vetë pyetje dëshmitarit.

Nën drejtimin e gjyqtarit, ndihmësi i tij mban shënime lidhur me paraqitjen e provave. Është e rëndësishme të theksohet se këto shënime nuk mbahen

fjalë për fjalë; më konkretisht, gjyqtari dikton një rindërtim të përmbledhur të përgjigjeve të dëshmitarit. Dëshmitari i nënshkruan këto shënime duke u bërë kështu autori i deklaratave të shkruara, por shënimet nuk janë riprodhim i përsosur dhe analitik i thënieve reale të dëshmitarit. Palët mund të kërkojnë shtimin e deklaratave specifike në këto shënime dhe gjyqtari mund të autorizojë shtimin e këtyre deklaratave".

Sikurse e përmendëm edhe më sipër, Kodi shqiptar i procedurës civile parashikon se dëshmitarët pyeten nga palët. Fillimisht, dëshmitari pyetet nga pala që ka kërkuar marrjen e tij në pyetje dhe, më pas, nga pala kundërshtare. Gjithashtu, palët kanë të drejtë t'u drejtojnë dëshmitarëve pyetje shtesë me qëllim qartësimin ose plotësimin e përgjigjeve të dhëna. Gjithsesi, sipas Kodit shqiptar, palët i bëjnë pyetjet me lejen dhe nëpërmjet gjykatës (shih nenin 239).

Më tej, gjykata, në rast nevoje për shkak të thënieve të dëshmitarëve që krijojnë vështirësi për zbulimin e së vërtetës, mund të bëjë një ballafaqim të dëshmitarëve të pyetur më parë (shih nenin 240).

Në mënyrë të ngjashme, kjo gjë parashikohet edhe nga neni 254 i Kodit italian të procedurës civile: "Në rast mospërputhjeje midis deklaratave të dëshmitarëve, gjykata, me iniciativën e saj, ose mbi bazën e një kërkese të bërë nga palët, mund të garantojë ballafaqimin e tyre".

Disa përshkrime të sistemeve të ndryshme të marrjes në pyetje të dëshmitarëve janë dhënë nga një këndvështrim krahasues në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar:*[5]

"Duhet bërë një përmbledhje e disa ndryshimeve që kanë mbetur lidhur me vlerësimin e mënyrës më të mirë për nxjerrjen në dritë të së vërtetës. Është e lehtë të thuhet se ne favorizojmë – dhe shohim një prirje drejt – një prezantimi të hapur të të gjitha provave, por nuk është e lehtë të arrihet një marrëveshje për mënyrën si mund të prezantohet më mirë dëshmia gojore.

Një problem tashmë është bërë evident: *kush duhet t'i marrë në pyetje dëshmitarët, gjyqtari apo avokatët?* Ndërsa, në Suedi, avokatët drejtojnë pyetjet specifike ashtu sikurse ndodh në shumicën e sistemeve të common law, sistemet e së drejtës kontinentale dhe sistemet socialiste favorizojnë haptas gjyqtarin, duke ia lënë atij pyetjet specifike. Për më tepër, edhe mënyra e marrjes në pyetje është e ndryshme. Në sistemet e së drejtës kontinentale dhe në sistemet socialiste rregulla e mënyrës së marrjes në pyetje është në formën narrative

5) (IECL, vëll. XVI, Procedura civile, kap.5, Zbehja e formalizmit në rregullat për provat, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen-Hague-Boston-London, faqe 42:

(tregimtare), ndërsa në juridiksionet e common law, rregull e përgjithshme janë pyetjet specifike dhe pyetja agresive e kryqëzuar e dëshmitarëve. Cili prej sistemeve maksimizon shanset që personi që zbulon faktin, të marrë vesh edhe të vërtetën? Nuk ka asnjë mënyrë për të dhënë një përgjigje joekuivoke.

Por, është interesant fakti se sistemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës reflekton një shqetësim lidhur me procesin e pyetjes së drejtpërdrejtë dhe të pyetjes së kryqëzuar të dëshmitarit. Ndryshe nga sistemi anglez dhe sistemi tradicional i vendeve të së drejtës kontinentale, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës avokatët inkurajohen të takohen me dëshmitarët e mundshëm dhe t'i përgatitin ata të dëshmojnë. Ka pak mundësi për spontanitet dhe arsyeja e saktë është frika se një avokat i zgjuar mund të çojë në futjen në rrugë të gabuar të dëshmitarit dhe të ndryshojë dëshminë. Pyetja që shtrohet është se cila prej dëshmive – ajo e një dëshmitari "të parapërgatitur" ose dëshmia spontane – paraqet më mirë provat në mënyrë që gjyqtari që shqyrton faktet, ta kuptojë saktësisht dëshminë".

Seksioni i *Enciklopedisë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* që i kushtohet procedurës civile, përshkruan aspektet kryesore që lidhen me dëgjimin e dëshmitarëve duke iu referuar kryesisht sistemeve ligjore romaniste në kapitullin VI (IECL, vëll. XVI, *Procedura civile*, kapitulli VI, *Procedurat e zakonshme në shkallën e parë*).[6] Këtu pasqyrohet një analizë krahasuese e procedurave të ndryshme për dëgjimin e dëshmitarëve në vendet e së drejtës kontinentale:

"Në këtë kontekst, ekziston një prirje për të përjashtuar ndërmjetësimet dhe për të lehtësuar marrjen e menjëhershme të provave. Po ashtu, në rast nevoje, ekziston një prirje për të shmangur ngurtësinë e procedurave me dëshmitarë, duke autorizuar depozitimin e letrave dhe duke dëgjuar çdo person si dëshmitar, vetëm me disa përjashtime.

Këto zhvillime vazhdojnë të jenë ende modeste sa i takon marrjes në pyetje të vetë palëve, sidomos në Itali ku vazhdon të ruhet sistemi i marrjes në pyetje për fakte specifike (neni 230, § 1), Luksemburg (neni 325) dhe Holandë (neni 237). Në praktikë ndodh rrallë, me përjashtim të Francës dhe të Luksemburgut, që palët të merren në pyetje, megjithëse kodet e nxitin gjyqtarin që merret me shqyrtimin e çështjes, t'i marrë në pyetje edhe palët.

Tekstet legjislative shpalosin një prirje edhe më domethënëse sa i takon dëgjimit të dëshmitarëve: heqja e rregullave që kanë qenë e pranishme në Belgjikë, Francë dhe Itali vjen nga dëshira për të shmangur ndërmjetësimin e

6) (IECL, vëll. XVI, Procedura civile, kapitulli VI, Procedurat e zakonshme në shkallën e parë,) J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London), faqe 77.

gjyqtarit, të cilit nuk do t'i kërkohet të marrë vendim për çështjen duke ngritur një barrierë midis gjykatës dhe dëshmitarëve. Me fjalë të tjera, dëgjimi i dëshmitarëve duhet të bëhet pjesë e proceseve gjyqësore aktuale. Ligji belg, neni 946 i kërkon gjyqtarit që ka dëgjuar dëshmitarët, nëse është e mundur, të zhvillojë një seancë gjyqësore kur gjykata të vendosë për pretendimet. Po ky parim është mishëruar edhe në ligjin italian, neni 276, sipas të cilit, gjyqtari që shqyrton çështjen, është edhe gjyqtari relator në seancën para trupit gjykues dhe ai/ajo duhet të marrë pjesë në diskutimin e çështjes.

Në Holandë, ligji i datës 7 korrik 1986 parashikonte se, në parim, dëshmitarët duhet të dëgjohen nga i gjithë trupi gjykues, ndërsa sipas Kodit të procedurës civile, dëshmitarët dëgjohen nga një gjyqtar i autorizuar. Por, neni 200/a ka rivendosur dëgjimin e dëshmitarëve nga një gjyqtar i autorizuar, nëse kjo gjë kërkohet nga palët.

Në mënyrë më të përgjithshme mund të thuhet se ekziston një reduktim racional i formalizmit të vjetër. Aty ku është i pranishëm gjyqtari që shqyrton çështjen, rezultati i dëshiruar arrihet vetëm pjesërisht, pasi atij i kërkohet që, më pas, të marrë pjesë në marrjen e vendimit për çështjen. Ndërsa, në Belgjikë (neni 918) dhe në Francë (neni 205) dëshmitarët mund të dëgjohen para gjyqtarëve që duhet të marrin vendim për çështjen".

Kodi shqiptar i procedurës civile e lejon pyetjen e kryqëzuar të dëshmitarëve. Kjo praktikë i përket traditës së vendeve të juridiksionit common law, veçanërisht modelit të procesit kontradiktor. Sistemi kontradiktor përshkruhet si i tillë nga M. Damaska, *"Prirja e së drejtës së provave":*[7]

"Me fjalën kontradiktor unë kuptoj sistemin e gjykimit në të cilin padia procedurale kontrollohet nga palët dhe gjykuesi mbetet kryesisht pasiv. Në fushën e zbulimit të fakteve kjo nënkupton se palët ndërgjyqëse dhe avokatët e tyre vendosin se cilat fakte do t'i nënshtrohen provës. Më tej, kjo nënkupton se palët ndërgjyqëse dhe avokatët e tyre ngarkohen me kërkimin e materialeve provuese, përgatitjen e tyre për seancën gjyqësore dhe paraqitjen e tyre para gjykatës [...].

Për të kuptuar më mirë qëndrimet më kryesore të sistemit anglo-amerikan rreth mjeteve të provave, së pari, duhet të mbahet parasysh fakti i depozitimit të pretendimeve të kundërta. Duke qenë se avokatët e palëve janë në kërkim të materiale provuese, të cilat i përzgjedhin, i përgatitin dhe i përpunojnë në mënyrë që të mbrojnë sa më mirë interesat e klientëve të tyre, të gjitha mjetet e provave duket se lidhen patjetër me njërën prej palëve [...]. Ky perceptim i

7) M. Damaska, **Prirja e së drejtës së provave**, *New Haven – London, 1997.*

qëndrueshëm i lidhjes së provave me palët është lehtësisht i kuptueshëm, veçanërisht në vendet e traditës së common law, ku avokatët lejohen të përgatitin dëshmitarët për daljen e tyre para gjykatës nëpërmjet ekspozimit të "pyetjeve praktike", duke i paraprirë marrjes së tyre në pyetje, nëpërmjet sugjerimeve për sjelljen e duhur dhe teknikave "trajnuese". Dhe, në rastet kur ekspertët jo vetëm përzgjidhen dhe përgatiten, por edhe paguhen nga palët ndërgjyqëse, ky perceptim është ndoshta i pashmangshëm.

Pretendimet e kundërta shpjegojnë edhe hezitimin e gjyqtarëve anglo-amerikanë për t'i thirrur dëshmitarët me iniciativën e tyre, ndonëse kompetenca për të vepruar në këtë mënyrë as që vihet në diskutim. Kjo ndodh për shkak se mjetet "neutrale" të provave nuk mund t'i përshtaten mirë modelit të zbulimit të fakteve të administruar nga dy palë kundërshtare: modeli krijon një fushë tensioni bipolar, që vështirë se krijon një bërthamë të përqendruar.

Një qëndrim i ndryshëm ndaj mjeteve të provave zhvillohet në kontekstin procedural ku përgjegjësitë për zbulimin e fakteve u caktohen nëpunësve të gjykatës. Administrimi kontinental i drejtësisë na jep një leksion mjaft interesant në këtë aspekt.

Grumbullimi i provave para zhvillimit të procesit gjyqësor në këtë sistem është detyra kryesore e gjyqtarit ose e ndonjë nëpunësi tjetër të gjykatës. Ndonëse avokatët e palëve nuk ndalohen të kryejnë investigime, kontaktet e tyre duket se e ulin besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarëve. Përgatitja e dëshmitarëve për seancën gjyqësore nuk miratohet aspak dhe në disa vende mund të vijë shumë pranë interferimit me provat. Për të gjitha këto arsye, avokatët kryejnë shumë pak hetime faktike me iniciativën e tyre, duke mos i dhënë pothuajse fare pista investigative personit të ngarkuar nga gjykata me marrjen e provave"[...].

Në procesin gjyqësor, zbulimi i fakteve vazhdon të mbetet detyra kryesore e gjyqtarit, megjithëse përgjegjësitë e tij janë shumë të reduktuara në proceset civile. Por, edhe në rastet kur përgjegjësitë e zbulimit të fakteve janë në pikën e tyre më të ulët, sipas modelit të common law, shqyrtimi i provave mbetet i organizuar si një iniciativë vetëm plotësuese, pa një urdhër formal për provat".

Shënim i autorit: *Autori vëren se qëndrime të tilla ndaj mjeteve të provave e cenojnë ndjeshëm funksionin e tyre provues.*

Në drejtësinë anglo-amerikane mundësia që faktet mbi të cilat duhet të mbështetet vendimi i gjykatës mund të jenë të deformuara ose false, mbetet një arsye e fortë për t'u shqetësuar. Kështu, Damaska shkruan:

"Në këtë rast, është shumë e rëndësishme që secila prej palëve të ketë një

mundësi të shpejtë për të kundërshtuar burimin e informacionit të paraqitur nga kundërshtari. E drejta e pyetjes së kryqëzuar të dëshmitarëve mbulohet nga re lëvdatash, e theksuar sidomos për rolin e saj në zbulimin e së vërtetës. Sipas thënies së Uigmorit (Wigmore) "pyetja e kryqëzuar e dëshmitarëve është motori më i madh i shpikur ndonjëherë për zbulimin e së vërtetës." Dhe, realisht, kjo e drejtë merret aq seriozisht, sa në shumë situata dëshmia e drejtpërdrejtë mund të cenohet nga ana ligjore ose mund të deklarohet ndërprerja e gjyqit, nëse pyetja e kryqëzuar e dëshmitarëve nuk ka përfunduar për shkak të mungesës së papritur të disponibilitetit nga ana e tyre.

Çështjet që lidhen me testimin e burimeve informuese, justifikojnë shqetësimin e vendeve të common law për doktrinën e "dëshmitarit sipas dëgjimit": sa më lehtë të lidhen dëshmitarët me palët, aq më problematik bëhet burimi derivativ i informacionit. Në fakt, shqetësimet rreth nevojës për të testuar besueshmërinë nuk janë më pak të rëndësishme për justifikimin e doktrinës së "dëshmitarit sipas dëgjimit", pasi ajo është krijuar si garanci nga dëshira për ta mbrojtur jurinë nga informacionet që mund të mbivlerësohen. Kështu, pra, është e qartë se sistemi kontradiktor ofron mbështetje për "të metën" e "dëshmitarit sipas dëgjimit" edhe në kontekstin e gjyqeve pa juri.

Mendoni sa e vështirë është të testosh efektivisht një dëshmitar, i cili thjesht përsërit një deklaratë jashtëgjyqësore. Nëse ai gënjen për deklaratën që ka dëgjuar – në rastet kur kjo deklaratë kundërshtohet – ai thjesht mund të këmbëngulë në faktin se dëgjimi i tij është i mirë. Nga ana tjetër, nëse ai gënjen për një ngjarje vizuale, gënjeshtra për atë që ka parë duhet të thuret për të krijuar një histori koherente, duke e bërë disi më të thjeshtë ekspozimin e falsitetit. Por, më e rëndësishmja është se personi që ka artikuluar "gjërat e dëgjuara" që riprodhon dëshmitari sipas dëgjimit – pra deklaratën e pretenduar jashtë gjykatës – nuk mund të testohet. Kuptohet qartë se kjo gjë është në disavantazh të kundërshtarit të provës me "dëshmitarin sipas dëgjimit", i cili shpesh justifikohet duke e quajtur folësin jashtë gjykatës si një bashkëpunëtor të fshehtë të kundërshtarit të tij që shmang sfidën në sallën e gjyqit.

Kjo shmangie është shqetësimi më i madh i kundërshtarit të "dëshmitarit të gjërave të dëgjuara", pasi një pyetje e kryqëzuar e dëshmitarëve, e kryer me mjeshtëri, duke shtruar të paktën disa pyetje për besueshmërinë, mund të zbehë vlerën e çdo dëshmie dhe mund të anojë balancën e avantazheve në një çështje të mbyllur. Kjo sugjeron se qëndrimi i ashpër i vendeve të common law ndaj "dëshmitarit sipas dëgjimit" nuk mbështetet mbi shqetësime thjesht hipotetike: ajo vjen edhe prej parimeve të drejtësisë që zbatohen në një sistem konkurrues të zbulimit të fakteve. Në rastet kur këto parime nuk zbatohen, si p.sh. rasti i pohimeve të palës kundërshtare, është e thjeshtë të kuptohet se

përse informacioni i "dëshmitarit të gjërave të dëgjuara" lejohet, madje edhe nëse besueshmëria e tij nuk e kalon atë të dëshmive sipas dëgjimit, të papohuara.

3. Dëshmitarët sipas legjislacionit shqiptar

Dëshmitarë quhen personat juridikisht të painteresuar në përfundimin e procesit, të thirrur në gjykatë për të komunikuar mbi fakte të njohura prej tyre, që kanë rëndësi për zgjidhjen e një konflikti midis palëve.

Dëshmitarë mund të jenë vetëm personat fizikë. Qenia dëshmitar në gjyq është një detyrë e shtetasit në interes të drejtësisë. Këtej rrjedh edhe detyra e çdo shtetasi që të paraqitet me thirrjen e gjykatës dhe të dëshmojë. Kur dëshmitari që është thirrur në gjykatë, nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme, gjykata e dënon me gjobë deri në 30 000 lekë dhe urdhëron sjelljen e tij me detyrim (neni 165 i K.pr.civile). Përfaqësuesit diplomatikë nuk janë të detyruar të dëshmojnë në çështje gjyqësore dhe, në rast se pranojnë një gjë të tillë, nuk janë të detyruar që, për këtë, të paraqiten në gjyq. Shtetasit e huaj që nuk janë përfaqësues diplomatikë, janë të detyruar të dëshmojnë në gjyq.

Askush nuk ka të drejtë të refuzojë të bëjë dëshmi në gjykatë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm. Kur dëshmitari, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, kundërshton të dëshmojë, gjykata e dënon me gjobë deri në 30 000 lekë (neni 166 i K.pr.civile).

Nuk mund të pyeten si dëshmitarë:

- Përfaqësuesit e palëve në çështje, për rrethana për të cilat kanë marrë dijeni nga të përfaqësuarit e tyre për shkak të detyrës së tyre si përfaqësues.
- Personat që, për shkak të të metave fizike ose psikike, nuk janë të aftë të kuptojnë drejt faktet që kanë rëndësi për çështjen dhe të bëjnë dëshmi të rregullt.
- Bashkëshortët ende të pandarë, fëmijët, prindërit, gjyshërit ose kushërinjtë në vijë të drejtë ose të tërthortë deri në shkallë të dytë, përveç kur çështja ka lidhje me probleme personale e familjare, si dhe të miturit nën katërmbëdhjetë vjeç, përveç kur thënict e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

Këta persona vendosin vetë nëse do të dëshmojnë dhe nuk mund të dënohen për refuzimin për të dëshmuar (neni 235 i K.pr.civile). Refuzimi i dëshmitarit për të dëshmuar në gjyq, nën preteksin e ruajtjes së një sekreti të shërbimit, mund të ketë vend vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji.

Lind pyetja se ç'duhet bërë kur pa informacionet që përbëjnë një sekret të shtetit ose të shërbimit, gjykata nuk mund ta zgjidhë konfliktin konkret midis palëve. Me kërkesën e gjykatës, personi zyrtar nga i cili varet në shërbim

dëshmitari, duhet të japë autorizim për komunikimin në gjyq të informacioneve të nevojshme, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ndalohet shprehimisht nga ligji. Gjykata, në këto raste, i dëgjon dëshmitarët në seancë me dyer të mbyllura, duke respektuar të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e sekretit të shtetit ose të shërbimit.

Të gjithë shtetasit konsiderohen të aftë për të qenë dëshmitarë në gjyq. Nga kjo rregull e përgjithshme, ligji bën përjashtime duke i konsideruar disa absolutisht të paaftë dhe disa të tjerë relativisht të paaftë për të qenë dëshmitarë në gjyq.

Absolutisht të paaftë konsiderohen personat që, për shkak të të metave fizike ose psikike, janë në pamundësi të plotë për të riprodhuar në mënyrë besnike faktet. Këta persona janë krejt të paaftë për të qenë dëshmitarë, prandaj nuk mund të thirren për të dëshmuar për asnjë rrethanë dhe në asnjë çështje.

Relativisht të paaftë konsiderohen personat që, për shkak të të metave të tyre fizike, janë të paaftë të perceptojnë një fakt të caktuar që është objekt prove i një rasti konkret, prandaj nuk mund të jenë dëshmitarë vetëm në këto raste. Kështu, p.sh., i verbri nuk mund të jetë dëshmitar për një gjë që mund të perceptohet me shqisën e të parit, por ai mund të jetë dëshmitar për një gjë që mund të perceptohet me shqisën e të dëgjuarit; anasjelltas, shurdhi nuk mund të dëshmojë për një gjë që mund të perceptohet me shqisën e të dëgjuarit, por mund të dëshmojë për një gjë që mund të perceptohet me shqisën e të parit.

Çështja e pranimit të të miturve nën katërmbëdhjetë vjeç, si dëshmitarë, zgjidhet nga gjykata në çdo rast konkret sipas shkallës së zhvillimit psikik të të miturit, si dhe sipas kompleksitetit të rrethanave për vërtetimin e të cilave është thirrur i mituri.

Vetë pyetja e të miturit duhet të bëhet në mënyrën dhe në kushtet që sigurojnë mundësinë e vërtetësisë së deklarimeve, duke marrë parasysh tendencën e fëmijës ndaj fantazisë dhe mundësinë e influencimit mbi të nga ana e të rriturve.

3.1. Thirrja dhe deklarimet e dëshmitarëve

Dëshmitarët thirren në gjykim me kërkesë të palëve. Pala që kërkon thirrjen e një dëshmitari, është e detyruar të tregojë emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin dhe faktet për vërtetimin e të cilave thirret dëshmitari.

Kryetari i seancës, pasi të jetë siguruar për identitetin e dëshmitarëve, i ndërgjegjëson ata për rëndësinë e misionit të betimit përpara gjykatës, i njofton se janë të detyruar të tregojnë të vërtetën për atë çfarë dinë në lidhje me çështjen dhe i paralajmëron për përgjegjësinë që ata kanë për dëshmi të rreme. Ndërkohë, sekretari gjyqësor lexon formulën e betimit, si më poshtë: "I

ndërgjegjshëm, betohem se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën". Dëshmitari në këmbë përgjigjet "Betohem" dhe pret jashtë sallës së gjyqit me porosinë të mos merren vesh me njëri-tjetrin (neni 237).

Deklarimet e dëshmitarit duhet të bëhen me gojë, përpara trupit gjykues që shqyrton çështjen.

Radha e pyetjes së dëshmitarëve caktohet nga kryetari i seancës duke mbajtur parasysh dëshmitarët e secilës palë. Ata pyeten një nga një në prani të palëve, pa praninë e dëshmitarëve që pyeten më vonë (neni 238).

Dëshmitari pyetet më parë nga pala që e ka kërkuar thirrjen e tij, pastaj nga pala tjetër. Secila palë ka të drejtë t'i bëjë pyetje plotësuese dëshmitarit për të sqaruar apo për të plotësuar përgjigjet e dhëna nga ai. Në çdo rast, palët i drejtojnë pyetje dëshmitarit me leje dhe nëpërmjet gjykatës.

Gjykata mund të bëjë pyetje e të kërkojë sqarime kurdoherë që e konsideron të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes (neni 239).

Dëshmitari duhet të pyetet se nga i di faktet dhe rrethanat për të cilat dëshmon dhe për ato fakte që i ka perceptuar drejtpërdrejt nëpërmjet shqisave të tij. Por, në praktikë ndeshen raste kur dëshmitari deklaron se njohuritë për faktet i ka marrë nga tregimi i personave të tretë, të cilët mund të kenë qenë të njohur ose të panjohur për dëshmitarin. Në teorinë e provave gjyqësore, këta dëshmitarë njihen me emrin "dëshmitarë sipas dëgjimit". Në rast se ekziston personi nga i cili "dëshmitari sipas dëgjimit" pretendon se ka dëgjuar tregimin e fakteve që ai person i ka perceptuar drejtpërdrejt, gjykata, me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, duhet ta thërrasë atë për ta pyetur drejtpërdrejt në cilësinë e dëshmitarit. Por kjo jo gjithmonë mund të jetë e mundur praktikisht për t'u realizuar.

Në një rast të tillë lind pyetja: A do të pranohet si provë dëshmia e "dëshmitarit sipas dëgjimit"? Kodi i procedurës civile nuk e ndalon marrjen në pyetje të "dëshmitarit sipas dëgjimit", por, për shkak se këta dëshmitarë janë shumë të pasigurt, kur pyetja e tyre paraqitet e domosdoshme, gjykata duhet ta çmojë me shumë kujdes atë në raport me gjithë provat e tjera.

Pas mbarimit të dëshmisë, dëshmitari mund të largohet me leje të gjykatës. Në rastet kur mund të jetë e nevojshme ripyetja e tij, gjykata urdhëron që ai të qëndrojë në sallë, pa kontaktuar me dëshmitarët e tjerë (neni 241).

Në raste të veçanta, për shkak sëmundjeje apo për shkak të punës së veçantë që bën dëshmitari, rrethana këto që e bëjnë të pamundur paraqitjen e tij në gjykim, gjykata mund të vendosë që pyetja e tij të bëhet jashtë qendrës së gjykatës nga një anëtar i trupit gjykues. Në këto raste, pyetja e dëshmitarit bëhet përpara seancës gjyqësore të radhës dhe dëshmia e marrë lexohet në seancë gjyqësore. Pyetja e dëshmitarit bëhet kurdoherë në prani të palëve, të cilat njoftohen rregullisht (neni 236).

Të drejtat dhe detyrat e dëshmitarit. Në procesin civil, dëshmitarët gëzojnë të drejtat që vijojnë: a) të bëjnë deklarimet në gjuhën amtare; b) të kërkojnë shënimin e saktë në procesverbal të deklarimeve të tyre; c) të kërkojnë shpërblimin për largimin e tyre nga vendi i punës dhe për shpenzimet që kanë bërë për paraqitjen e tyre (neni 105/a).

Dëshmitarët janë të detyruar: a) të paraqiten me thirrjen e gjykatës dhe të dëshmojnë, përndryshe janë përgjegjës; b) të tregojnë të vërtetën, përndryshe janë penalisht përgjegjës (neni 245) dhe c) në rast ripyetje, të qëndrojnë në sallën e gjyqit deri në mbarimin e gjykimit të çështjes.

3.2. Vlerësimi i deklarimeve të dëshmitarëve

Gjykata i vlerëson thëniet e dëshmitarëve në harmoni ndërmjet tyre dhe me provat e tjera të marra gjatë shqyrtimit të çështjes (neni 236/4).

Deklarimet e dëshmitarëve vuajnë shpesh nga kundërshtime të thella që burojnë nga mënyra jashtëzakonisht e ndryshme e perceptimit të drejtë dhe të saktë të dukurive të ndryshme, nga njëra anë, si dhe mbajtja mend për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të vetëdijshme e asaj që është perceptuar, nga ana tjetër, dhe, më në fund, objektiviteti në parashtrimin dhe transmetimin e përshtypjeve.

Në çmimin e deklarimeve të dëshmitarëve, gjykata duhet të marrë parasysh një sërë veçorish të lidhura me këtë lloj prove, për të përcaktuar vërtetësinë e atyre fakteve që komunikojnë dëshmitarët.

Kur ndërmjet thënieve të dëshmitarëve ka mospërputhje të tilla që krijojnë vështirësi për zbulimin e së vërtetës, vetë gjykata ose me kërkesën e palëve bën ballafaqimin e dëshmitarëve të pyetur më parë (neni 240).

Gjykata duhet të zgjidhë tri çështje: A dëshiron një njeri të thotë të vërtetën? A mund ta thotë ai të vërtetën? A paraqitet i besueshëm deklarimi i tij?

Të rreme janë ato deklarime të dëshmitarëve me të cilat ata i komunikojnë me vetëdije gjykatës rrethana që nuk ekzistojnë ose që nuk kanë ekzistuar, ose heshtin me ndërgjegje për rrethana ekzistuese; si pasojë kërkohet ekzistenca e dhelit. Për të hetuar dhelin ka rëndësi të madhe që, përpara marrjes në pyetje, të hetohet personaliteti i dëshmitarit, raportet e tij me palët, nëse është i interesuar në zgjidhjen e çështjes etj.

Përpara gjykatës lind shpesh problemi i drejtësisë, i vërtetësisë së deklarimeve të dëshmitarit, jo për shkak dheli të dëshmitarit, por për shkak lajthimi të tij në mirëbesim. Çështja e vërtetësisë, e besueshmërisë së deklarimeve të dëshmitarit mund të zgjidhet nga gjykata duke marrë parasysh dhe duke analizuar një numër faktorësh subjektivë dhe objektivë.

Ndër faktorët *subjektivë* hyjnë: a) shkalla e përgjithshme kulturore e dëshmitarit, b) shkalla e kuptimit të dukurive të perceptuara nga ana e dëshmitarit; c) gjendja e organeve të tij të shqisave (të parët, të dëgjuarit etj.); ç) kujtesa e tij (e mirë, e keqe); d) aftësia për të riprodhuar atë që ka perceptuar; dh) shkalla e sugjestivitetit, si dhe një varg faktorësh të tjerë.

Ndër faktorët *objektivë* hyjnë: a) rrethana në të cilën dëshmitari perceptoi dukurinë, p.sh. distanca, drita; b) koha që ka kaluar nga momenti i perceptimit të dukurisë deri në riprodhimin e tij përpara gjykatës; c) njohja nga ana e dëshmitarit e nevojës së riprodhimit të fakteve të perceptuara përpara gjyqit, si dhe një varg faktorësh të tjerë.

Në sistemin procedural shqiptar provimi me dëshmitarë nuk lejohet në të gjitha rastet. Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë (neni 231 i K.pr.civile).

Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja me anë pagimi ose falje e detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë që është bërë ose duhej bërë me dokument, edhe sikur shuma ose vlera e paguar të jetë më e vogël se 50 000 lekë (neni 232).

Ndalimi i provës me dëshmitarë, parashikuar nga neni 232 i K.pr.civile, do të thotë: *e para,* që është e ndaluar të provohet me dëshmitarë se deklaratat ose marrëveshjet që përmbahen në akt nuk janë të sinqerta ose të sakta, prandaj duhet të zëvendësohen me marrëveshje, deklarata ose kushte të tjera; e *dyta,* që ndalohet provimi me dëshmitarë i ndryshimeve që i janë bërë aktit të shkruar. Me fjalën ndryshime kuptohen të gjitha ndryshimet ose shtesat që sjellin shtimin, pakësimin, shtrirjen ose kufizimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përmbajtura në aktin e shkruar; të tilla janë, p.sh., ekzistenca e një kushti, ndërsa në aktin e shkruar të drejtat dhe detyrat janë të thjeshta (pa kushte); ose tregimi i vendit të pagimit, në një kohë kur në akt ky vend nuk tregohet fare ose është i ndryshëm nga ai që pretendohet.

Në Kodin civil janë parashikuar një numër kufizimesh për pranueshmërinë e provës me dëshmitarë. Në disa raste, forma me shkrim është një element thelbësor i veprimit juridik dhe mosbërja e tij në këtë formë e bën atë të pavlefshëm. Kështu p.sh., veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm (neni 83/1 i Kodit civil); kalimi i pasurisë (neni 962/1 i Kodit civil) duhet bërë me shkrim, ndryshe është i pavlefshëm; kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose tek noteri, ndryshe është e pavlefshme (neni 547 i Kodit civil) etj.

Në disa kontrata, forma me shkrim kërkohet për efekt të provueshmërisë, si p.sh., kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë (neni 803/4 i Kodit civil); dorëzania duhet të bëhet me shkresë (neni 587 i Kodit civil); kontrata franchising duhet të bëhet me shkresë duke përcaktuar ndër të tjera ... (neni 1059 i Kodit civil); kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë së sigurimit ... (neni 1114 i Kodit civil).

Arsyeja se përse në këto raste parapëlqehen më shumë provat shkresore se ato me dëshmitarë ka të bëjë me atë se, në rast të një konflikti të mundshëm midis palëve lidhur me ekzekutimin e këtyre kontratave, forma shkresore krijon mundësinë për një vlerësim të saktë të përmbajtjes së tyre. Për sa i përket vlerësimit të thënieve të dëshmitarëve, duhen mbajtur parasysh një sërë faktorësh objektivë dhe subjektivë, të cilët ndikojnë në vlerësimin e tyre si mjete provuese. Të tillë janë: niveli kulturor i dëshmitarit; cilësitë e tij morale; shkalla e mundësisë së perceptimit të ngjarjeve dhe dukurive; mosha e dëshmitarit nga e cila shpesh varet gjendja e organeve të ndjimit, kujtesa, aftësia e riprodhimit të asaj çka është perceptuar më parë; profesioni; mjedisi i jashtëm (drita, terreni, distanca) në të cilën dëshmitari percepton ngjarjen, sendin ose personin; koha që ka kaluar që nga çasti i ndodhjes së ngjarjes apo shfaqjes së dukurisë deri në çastin e dëshmisë para gjykatës etj.

Nuk duhet harruar as fakti se dëshmitari, në interesin e tij personal, të palës apo të personit të tretë, herë-herë jep dëshmi të rreme, përkundrejt rrezikut nga ndjekja penale që parashikon Kodi penal në një rast të tillë. Prandaj, marrë në tërësi, dëshmitari është mjet provues më pak i besueshëm sesa dokumenti me shkrim.

Por, si përjashtim nga nenet 231 dhe 232 të K.pr.civile, të cilat ndalojnë provën me dëshmitarë, provimi me dëshmitarë lejohet në këto raste:

a) Kur dokumenti që kërkohet nga ligji për vlefshmërinë ose provimin e veprimit juridik, ka humbur ose është prishur pa fajin e palës.

b) Kur ka një fillim prove me shkresë. Quhet fillim prove me shkresë çdo shkresë që rrjedh nga personi, kundrejt të cilit drejtohet kërkimi dhe nga përmbajtja e së cilës del se fakti i pretenduar është pothuajse i vërtetë.

c) Kur veprimi juridik i bërë me shkresë është kryer:
- në kundërshtim me ligjin, në mashtrim të ligjit;
- nën ndikimin e mashtrimit, të kanosjes ose për shkak të një marrëveshjeje me keqbesim, të bërë midis përfaqësuesit të njërës palë dhe palës tjetër;
- nën ndikimin e nevojës së madhe të palës.

ç) Kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik, ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë (neni 233 i K.pr.civile).

Që të lejohet prova me dëshmitarë kur dokumenti ka humbur ose është prishur, pa fajin e palës, është e nevojshme që pala, e cila kërkon të përdorë provën me dëshmitarë, të provojë: a) se e ka pasur më parë dokumentin që shërbente për vlefshmërinë ose provimin e veprimit juridik dhe b) se ky dokument i ka humbur ose është prishur, pa fajin e saj, d.m.th. për shkak të një force madhore, për shkak të ndonjë krimi ose përgjithësisht të ndonjë veprimi të paligjshëm të ndonjë personi tjetër. Në praktikë mund të ndeshen, p.sh., raste kur një pjesëmarrës në një veprim juridik i cili duhet të provohet me shkresë, e humb shkresën të cilën e mbante në autoveturën personale për shkak të vjedhjes së autoveturës ose për shkak të përfshirjes në një aksident të rëndë automobilistik.

Për të pasur fillim prove me shkresë, siç del nga përmbajtja e germës "b" të nenit 233 të K.pr.civile kërkohen tri kushte: 1) të ekzistojë një shkresë; 2) shkresa të rrjedhë nga ai kundër të cilit drejtohet kërkimi ose nga personi nga i cili përfaqësohet; dhe 3) shkresa duhet ta bëjë të besueshëm pretendimin e anës tjetër.

Kështu, p.sh., në një konflikt gjyqësor për përmbushjen e një detyrimi që rrjedh nga një kontratë, e cila në bazë të ligjit duhet të bëhet me shkresë se përndryshe nuk mund të provohet me dëshmitarë, pala paditëse nuk mund të provojë me dëshmitarë ekzistencën e këtij veprimi juridik. Por, kur pala paditëse disponon një shkresë të shkruar ose të nënshkruar nga vetë i padituri, të cilën ai ia drejton një personi të tretë që nuk është palë në kontratë, ku ndërmjet të tjerave ai i shkruan edhe për detyrimin që ka ndaj palës paditëse, kjo shkresë përbën fillim prove me shkresë, sepse i përmban të tria kushtet e shpjeguara më lart. Në këtë rast, gjykata do ta lejojë palën paditëse ta provojë me dëshmitarë vërtetimin e ekzistencës së veprimit juridik.

Nëpërmjet përjashtimit të parashikuar në përmbajtjen e germës "c" të nenit 233 të K.pr.civile, lejueshmëria e provimit me dëshmitarë synon parandalimin dhe mosardhjen e pasojave nga veprime juridike të kundërligjshme. Në këto raste, veprimi juridik vërtet është bërë në formën e kërkuar nga ligji, por ai është absolutisht ose relativisht i pavlefshëm. Në këto raste, pala që bën pretendimin lejohet ta vërtetojë atë me dëshmitarë.

Përmbajtja e germës "ç" të nenit 233 të K.pr.civile parashikon lejimin e provës me dëshmitarë për rastet kur marrja e provës shkresore nuk është realizuar për shkak të pamundësisë morale ose fizike. Se çfarë duhet të kuptojmë

me pamundësi morale për marrjen e provës shkresore i është lënë detyrë gjykatës ta çmojë rast pas rasti.

Mund të ndodhë që pjesëmarrësit e veprimit juridik për provimin e të cilit ligji kërkon formën e shkruar, të jenë në marrëdhënie të afërta familjare (p.sh., prindër dhe fëmijë, bashkëshortë, vëllezër dhe motra), në marrëdhënie të afërta krushqie ose në marrëdhënie shumë të ngushta shoqërore. Në këto raste, për shkak të këtyre lidhjeve të ngushta, pjesëmarrësit e veprimit juridik kanë besim të plotë ndaj njëri-tjetrit, prandaj hartimi i shkresës për vërtetimin e veprimit juridik bëhet shumë i vështirë.

Edhe se çfarë duhet të kuptojmë me pamundësi fizike për marrjen e provës shkresore i është lëne detyrë gjykatës ta çmojë rast pas rasti. Në praktikën e përditshme, si raste të tilla mund të vërtetohen ato të detyrimeve që merren përsipër si pasojë e një ngjarjeje të papritur, të cilën palët nuk e kishin parashikuar dhe në këto kushte është bërë e pamundur marrja e provës me shkresë. P.sh., dikush që është nisur për një udhëtim me avion, gjatë kontrollit në aeroport konstaton se i ka humbur bileta dhe, për të realizuar udhëtimin, i merr para hua një bashkudhëtari për të blerë një biletë tjetër.[8)]

Gjithashtu, edhe neni 234 i K.pr.civile parashikon një përjashtim nga dispozitat që ndalojnë provën me dëshmitarë. Por formulimi që ka kjo dispozitë është i paqartë. Për të sqaruar përmbajtjen e saj mund ta krahasojmë atë me përmbajtjen e nenit 181 të K.pr.civile të vitit 1958, sipas të cilit, kur një veprim juridik i bërë me shkresë është kryer vetëm për dukje, pa pasur qëllim që palët të krijojnë pasoja juridike ose për të mbuluar një veprim juridik tjetër, të cilin palët e kanë dashur, prova me dëshmitarë lejohet pa kufizim kur kërkohet nga persona të tretë, kurse kur kërkohet nga njëra prej palëve kontraktuese, lejohet vetëm në rast se ka provë me shkresë të lëshuar nga pala tjetër ose deklarime të bëra prej kësaj përpara institucioneve shtetërore, nga të cilat bëhet e besueshme se veprimi juridik është kryer vetëm për dukje.

Nga ky krahasim duhet arritur në përfundimin se vetëm personat e tretë, të cilët nuk kanë qenë palë të një veprimi juridik të bërë me shkresë, i cili është kryer vetëm për dukje, pa pasur qëllim palët të krijojnë pasoja juridike ose për të mbuluar një veprim juridik tjetër, lejohet të përdorin provën me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së këtij veprimi juridik.

---

8) Në përgatitjen e pjesëve të veçanta është shfrytëzuar edhe trajtimi që i ka bërë Alqiviadh Lamani në tekstin "Procedura civile", botim i vitit 1962.

4. Provat shkresore

4.1. Paraqitja e shkresave në procesin civil

Nenet 246 – 280 të Kodit shqiptar të procedurës civile parashikojnë rregullat për provat shkresore.

Parimet e përgjithshme lidhur me paraqitjen e shkresave në procesin civil të sistemeve të frymëzuara nga sistemi francez, shpjegohen gjerësisht në *Enciklopedinë e së drejtës së krahasuar* (IECL, vëll. XVI, *Procedura civile*, kapitulli 6, *Procedurat e zakonshme në shkallën e parë,* Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London):[9)] "Në të gjitha sistemet ligjore të frymëzuara nga sistemi ligjor francez, paraqitja e shkresave që mbështeten nga palët, u nënshtrohet thuajse rregullave të ngjashme.

Disa sisteme parashikojnë si rregull të përgjithshme faktin se dokumentet shkresore të përdorura nga palët duhet të paraqiten gjithmonë para përdorimit të tyre (Belgjikë, neni 736; Francë, neni 132; Holandë, neni 147).

Shënim i autorit: *Teksti i nenit 132 të Kodit francez të procedurës civile thotë shprehimisht: "Pala që mbështetet mbi një dokument, është e detyruar t'ia bëjë atë të ditur edhe palës tjetër në proces. Paraqitja e dokumentit duhet të jetë spontane. Gjatë apelimit, paraqitja e dokumenteve të tjera, tashmë të regjistruara, të cilat lidhen me seancën në shkallën e parë, mund të mos kërkohet. Gjithsesi, secila prej palëve mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve të tjera".*

Shih edhe nenet 153 dhe 156 të Kodit shqiptar të procedurës civile: me paraqitjen e kërkesëpadisë, pala paditëse duhet të depozitojë dokumentet dhe mjetet e tjera provuese mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia.

Ndonëse ky parim nuk përmendet shprehimisht, rregulla teknike, e parashikuar në çdo sistem, tregon praninë e tij të nënkuptuar; në vende të ndryshme, pala paditëse duhet të dorëzojë kopje të dokumenteve që disponon: ose kur paraqet kërkesëpadinë, ose kur paraqitet në gjykatë (Itali, neni 165/1) ose, në Luksemburg, në një moment që ndryshon në varësi të faktit nëse është urdhëruar ose jo përgatitja me shkrim e çështjes. Pala e paditur duhet të ftohet të depozitojë dokumentet e saj brenda 15 ditëve nga paraqitja në gjykatë së bashku me pretendimet përkatëse (Luksemburg, neni 77) ose *i depoziton*

---

*9) **Enciklopedia e së drejtës së krahasuar** (IECL, vëll. XVI, **Procedura civile**, kapitulli 6, **Procedurat e zakonshme në shkallën e parë**, Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London), faqe 75.*

dokumentet me paraqitjen në gjykatë (Itali, neni 166), ose së bashku me pretendimet (Belgjikë, neni 736/2; Holandë, neni 147/1).

Ligji francez nuk parashikon ndonjë formë të veçantë për depozitimin e dokumenteve, por ligji belg, italian, luksemburgez dhe danez kërkon që kjo gjë të bëhet sipas zgjedhjes së palës që duhet të bëjë depozitimin: ose me dorëzimin e dokumenteve në gjykatën që do të merret me shqyrtimin e çështjes, ose nëpërmjet një komunikimi të qetë ndërmjet përfaqësuesve të palëve (Luksemburg, neni 644).

Mosparaqitja e një dokumenti sanksionohet ose nga gjyqtari që nuk ka mundur ta marrë atë në shqyrtim *(Belgjikë, neni 740; Francë, neni 135; Holandë, neni 146, § 3. Duhet të theksohet se në ligjin danez, për të shmangur vonesat në proces, pala e dëmtuar mund ta përmendë mosparaqitjen e dokumentit në pretendimet e saj, por deri në zhvillimin e gjyqit nuk mund të vendoset asnjë sanksion)*, ose nga pala kundërshtare, së cilës i jepet afat shtesë për të shqyrtuar dokumentet e padepozituara në momentin e duhur. Po ashtu, në ligjin francez, gjyqtari mund të caktojë një afat për depozitimin e dokumenteve, duke e bërë atë të zbatueshëm nëpërmjet vendosjes së një gjobe progresive, nëse do të ishte e nevojshme (neni 134). Gjithashtu, gjyqtari ka të drejtë të heqë nga dosja gjyqësore dokumentet e depozituara me vonesë nga palët (neni 135)[...].

Rregullat për paraqitjen e detyrueshme të dokumenteve në ruajtje të palës tjetër ose të palës së tretë ndryshojnë në njëfarë mase në sistemet ligjore të sipërpërmendura. Ligjet holandeze dhe luksemburgeze, daneze dhe belge (deri në vitin 1967) mbetën mospranuese të idesë që konsiderohej se vinte në kundërshtim me maxim *nemo tenetur edere contra se.* Sipas ligjit italian (nenet 210, 211) dhe kodit belg të vitit 1967 (neni 877), një urdhër i tillë mund të jepej në varësi të disa kushteve. Madje ato pranojnë një padi specifike për një urdhër, sipas të cilit pala e paditur duhet të paraqesë dokumente të caktuara, e ashtuquajtura padia *ad exhibendum.* Në Francë, gjyqtarit i është dhënë kompetenca diskrecionale për të urdhëruar paraqitjen e disa dokumenteve, por vetëm me kërkesë të një prej palëve (nenet 11, 138 dhe 139). Po ashtu, sikurse del qartë nga disa vendime franceze, gjyqtari mund t'i kërkojë një pale vetëm paraqitjen e elementeve të veçanta të provave. Vetëm ligji francez e lejon gjyqtarin ta bëjë të zbatueshëm urdhrin e tij nëpërmjet vendosjes së një gjobe progresive. Duhet përmendur, gjithashtu, se asnjë prej sistemeve ligjore nuk parashikon dënim për refuzimin e paraqitjes së një dokumenti; ligji belg parashikon dënime vetëm për shkatërrimin, fshehjen ose ndryshimin e një dokumenti, paraqitja e të cilit është urdhëruar (PC, neni 495)".

4.2. Dokumentet zyrtare dhe dokumentet private

Kodi shqiptar bën dallimin ndërmjet akteve zyrtare dhe shkresave të thjeshta. Ky dallim është i pranishëm edhe në Kodin italian të Procedurës Civile. Edhe në këtë rast, dispozitat shqiptare dhe italiane janë tepër të ngjashme, por këto të fundit i kushtojnë më shumë rëndësi noterit publik.

Dallimi ndërmjet dokumenteve zyrtare dhe dokumenteve private shpjegohet nga M. Taruffo në "*Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje gjyqësore*", cituar më sipër:

"*Provat shkresore ose dokumentet mund të përbëhen nga çdo dokument i shkruar që përmban cfarëdolloj deklarate që mund të ketë lidhje për të provuar faktin që diskutohet. Por, ekzistojne edhe lloje veçanërisht të rëndësishme të dokumenteve. I pari është akti publik që përpilohet nga noteri publik. Ky dokument përdoret për të provuar transaksionet më të rëndësishme dhe, në disa raste, kërkohet me ligj. Akti publik ka fuqi ligjore provuese; ai është provë ligjore. Kjo nënkupton se përmbajtja e tij është detyruese për gjykatën dhe palët, nëse nuk kontestohet autenticiteti i tij (autenticiteti i një akti publik mund të kontestohet vetëm me një mjet të veçantë që quhet ankim për falsitet (querela di falso)*; në një rast të tillë, gjykata vendos nëse akti publik është ose jo autentik).

Shënim i autorit: *Është e rëndësishme të përmendet përkufizimi që u jep Kodi shqiptar akteve zyrtare (nenet 253-255), si ato akte "që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe formës së përcaktuar". Ato përbëjnë provë të plotë të ngjarjeve të regjistruara nga nëpunësit publikë, të cilat kanë ngjarë në prani të tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar. Në sistemin shqiptar (si edhe në sistemin italian) barra e provës për falsitetin e shkresës i takon palës që pretendon falsitetin e saj.*

Lloji tjetër i rëndësishëm i provave shkresore përfshin çdo deklaratë të shkruar, që nënshkruhet nga autori i saj (*shkresa private*). Fuqia provuese e një dokumenti të tillë përcaktohet nga gjykata dhe mbetet nën vlerësimin e saj diskrecional. Por, lidhja midis deklarimit dhe nënshkrimit të autorit të presupozuar ka efekte detyruese në rastet kur autenticiteti i nënshkrimit përcaktohet nga noteri publik, kur autenticiteti nuk mohohet nga pala kundërshtare ose kur ai është kontrolluar nëpërmjet mjeteve të garantuara me ligj (i ashtuquajturi *verifikim).* Gjithsesi, çdolloj dokumenti shkresor mund të përdoret nga palët dhe nga gjykata kur ai ka lidhje me provimin e një fakti që diskutohet. Problemi me këto dokumente *jotipike* qëndron te çështja si do të bëhet vlerësimi i fuqisë së tyre provuese, duke marrë në konsideratë nevojën

e kontrollimit të origjinës dhe të autenticitetit të tyre. Lloje të veçanta të dokumenteve shkresore, si: kopjet, fotokopjet, telegramet, telekset etj., janë po ashtu të rregulluara me ligj.

Shënim i autorit: *Dispozita referuese shqiptare e dokumenteve të nënshkruara nga autori i tyre është neni 259. Në ndryshim nga dokumentet publike, shkresat private nuk presupozohet të janë autentike. Nëse autenticiteti i tyre kontestohet nga pala kundër së cilës është depozituar shkresa, pala që e ka paraqitur këtë shkresë ka barrën e provës.*

Lloje të tjera të veçanta të dokumenteve nuk janë të shkruara, por ato konsiderohen, gjithsesi, si "dokumente" duke presupozuar një përdorim specifik të kësaj fjale. "Dokumente" të tilla përfshijnë: pikturat, filmat, videokasetat, kasetat, regjistrimet dhe çdo lloj tjetër *riprodhimi.* Riprodhime të tilla prezumohet se japin një pasqyrim besnik të fakteve në diskutim, nëse pala kundërshtare nuk mohon lidhje e këtyre riprodhimeve me faktet e çështjes. Në rastet kur nuk ka kundërshtim nga pala tjetër, gjykata është e lirë t'i përdorë ose jo dokumentet e riprodhuara si provë të fakteve.

Shënim i autorit: *Për këto lloje të dokumenteve shih nenet 278-280 të Kodit shqiptar.*

5. Provat shkresore sipas legjislacionit shqiptar

Provë shkresore quhet çdo objekt mbi të cilin është shprehur nëpërmjet shenjash shkrimi i një përmbajtje që mund të shërbejë për gjykatën si burim për të njohur fakte të caktuara.

Tipare karakteristike të provave shkresore janë: a) përmbajtja e një mendimi që mund të perceptohet nga gjyqtarët; b) objekti mbi të cilin duhet të jenë shprehur mendimet: letër, pergamenë, dërrasë etj.; c) shenjat e shkrimit me anën e të cilave është shprehur mendimi: germa, shifra, shenja telegrafike dhe stenografie etj.

Gjëja kryesore është përmbajtja e mendimit, nga e cila gjykata mund të nxjerrë përfundimin për ekzistencën ose mosekzistencën e fakteve të caktuara. Prova shkresore është një dëshmitar i heshtur (i pagojë) që i komunikon gjykatës një mendim të caktuar të fiksuar në të. Në rast se nuk ka rëndësi përmbajtja, mendimi i provës, atëherë ajo nuk është provë shkresore, por provë materiale.

Në praktikë ndeshen objekte mbi të cilat janë rafiguruar jo mendime si të tilla, por shenja të caktuara, nga të cilat, në bazë të rregullave të përgjithshme

të caktuara, nxirret një përmbajtje e caktuar. Për shembull, xhetoni (prej hekuri, druri, kartoni), i lëshuar me rastin e dorëzimit për ruajtje të veshjeve në gardërobë, zakonisht përmban shkurtimisht emërtimin e pronarit të gardërobës dhe një numër, por, në bazë të rregullave konvencionale, kjo tregon marrjen në dorëzim të veshjeve për ruajtje. Në xheton nuk figurojnë të shënuara shumë gjëra që kërkohen për kontratën e ruajtjes (depozitimit), por ai shërben si provë për lidhjen e kontratës së dorëzimit të sendeve për ruajtje.

Në këtë mënyrë, ndër provat shkresore mund të hyjnë çdolloj xhetoni, etikete, marke, bilete etj. Prova me shkresë zë një vend shumë të rëndësishëm në gjykimin civil dhe shpesh gjykatat ndeshen me problemet që lindin nga ky mjet provues.

Sipas disa kritereve të ndryshme, provat shkresore mund t'i ndajmë në: akte zyrtare dhe private; dokumente për provueshmëri dhe për vlefshmëri; dokumente dispozitive dhe informative; dokumente të vendit dhe të huaja; dokumente origjinale dhe kopje etj.

Duke u bazuar në vendin ose personin nga i cili është nxjerrë, shkresat dallohen në: *akte zyrtare* dhe *akte private* (shkresa e thjeshtë).

Janë *akte zyrtare* ato që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar (neni 253 i K.pr.civile). Akte zyrtare janë, p.sh.: aktet noteriale, aktet e gjendjes civile, vendimet, urdhrat e dalë nga organet e administratës shtetërore, vendimet e gjykatave etj.

Që një shkresë të konsiderohet si akt zyrtar, janë të domosdoshme dy kushte: Së pari, akti duhet të përpilohet nga një person zyrtar që është i autorizuar për këtë qëllim dhe që është kompetent edhe lidhur me vendin në të cilin duhet të ushtrojë detyrën e tij. Së dyti, akti duhet të jetë redaktuar në formën e kërkuar nga ligji.

Shkresa e thjeshtë ose private. Shkresë e thjeshtë ose private, në kuptimin e vërtetë, është çdo akt i shkruar që bëhet pa ndërhyrjen e ndonjë personi zyrtar dhe që përmban nënshkrimin e palëve.

Për vlefshmërinë e shkresës së thjeshtë ligji nuk ka parashikuar ndonjë formë të posaçme për përpilimin e saj. Shkresa që është përpiluar nga një person zyrtar që nuk ka qenë kompetent ose që nuk është përpiluar sipas formës së caktuar, ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë, në rast se është nënshkruar nga palët (neni 258).

Shkresa private quhen edhe:

- librat e tregtarëve dhe të profesionistëve që mbahen sipas Kodit tregtar ose dispozitave të tjera;
- librat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve gjyqësorë, mjekëve, farmacis-

tëve e të profesioneve të tjera që mbahen sipas dispozitave në fuqi (neni 260 i K.pr.civile).

Shkresa private ose e thjeshtë nuk merr datë të saktë kundrejt të tretëve, veçse ditën që ajo është vërtetuar nga noteri ose nëpunësi publik sipas ligjit, ose prej ditës që njëri nga ata që e ka nënshkruar, ka vdekur ose nuk ka qenë në gjendje fizike të shkruajë, ose prej ditës që përmbajtja e shkresës është konstatuar ose është përsëritur në një akt zyrtar, si dhe nga dita në të cilën ka ngjarë ndonjë fakt tjetër që provon në të njëjtën mënyrë se shkresa është përpiluar në një datë të mëparshme (neni 261 i K.pr.civile).[10]

Akti i shkruar mund të kërkohet për provimin e një veprimi ose marrëdhënicje juridike dhe në këtë rast prova me dëshmitarë nuk mund të përdoret për provimin e veprimit ose të marrëdhënies juridike; ose si një element thelbësor i veprimit ose marrëdhënies juridike dhe në këtë rast ai është kusht kryesor, mungesa e të cilit e bën veprimin juridik të pavlefshëm.

Fakti se në cilat veprime juridike akti i shkruar konsiderohet si element përbërës i veprimit juridik dhe në cilat veprime juridike ai kërkohet vetëm për provimin e tij përcaktohet në nene të veçanta të Kodit civil si dhe në akte të tjera ligjore.

Disa veprime juridike ku akti i shkruar është element thelbësor i veprimit juridik dhe mosbërja e tij në këtë formë e bën atë të pavlefshëm, pasi një pasojë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji, janë, p.sh.: kalimi i pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to (neni 83/1 i Kodit civil) duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm; kalimi i pasurisë duhet bërë me shkrim, ndryshe është i pavlefshëm (neni 962/1 i Kodit civil); kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose tek noteri, ndryshe është e pavlefshme (neni 547 i Kodit civil) etj.

Në disa kontrata, forma me shkrim kërkohet për efekt të provueshmërisë, si p.sh.: kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë (neni 803/4 i Kodit civil); dorëzania duhet të bëhet me shkresë (neni 587 i Kodit civil); marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkresë, pavarësisht nga madhësia e tij dhe forma që kërkohet për kontratën kryesore (neni 545 i Kodit civil); kontrata franchising duhet të bëhet me shkresë duke përcaktuar ndër të tjera ..... (neni 1059 i Kodit civil); kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë së sigurimit ..... (neni 1114 i Kodit civil) etj.

---

10) Shih më gjerë Alqiviadh Lamani, Procedura civile, Tiranë 1962.

Duke u nisur nga përmbajtja e shkresave, ato i ndajmë në dispozitive dhe informative. Në llojin e parë futen shkresat në përmbajtjen e të cilave shprehet vullneti i një ose disa personave fizikë ose juridikë për të krijuar, për të ndryshuar ose për të shuar marrëdhënie juridike të caktuara. Të tilla mund të jenë, si aktet zyrtare, ashtu edhe ato private. Në llojin e dytë futen shkresat që përmbajnë informacion për ekzistencën ose mosekzistencën e fakteve ose të rrethanave të caktuara. Këto të fundit kanë rëndësi juridike, por nuk shprehin vullnetin e një ose të disa personave për të krijuar, për të ndryshuar ose për të shuar marrëdhënie juridike të caktuara.

Duke marrë parasysh vendin në të cilin është lëshuar dokumenti ose në të cilin ndodhet subjekti që e ka lëshuar atë, shkresat i ndajmë në vendëse dhe të huaja. Shkresat e përpiluara nga nëpunësi i shtetit të huaj ose nga personi i huaj që ushtron veprimtari publike dhe që konsiderohet si ent publik në atë vend, kanë fuqi provuese të njëjtë me aktet zyrtare shqiptare (neni 256 K.pr.civile). Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsulata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes (neni 266 K.pr.civile).

Shkresat mund të jenë origjinale ose kopje të origjinalit. Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent, kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin (neni 251 K.pr.civile).

5.1. Fuqia provuese e shkresave

Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen (neni 246 K.pr.civile).

Në rast se shkresa është e dëmtuar në mënyrën e përshkruar më sipër, prezumohet se është bërë për të zhvlerësuar vlerën provuese të saj, përveç kur provohet e kundërta (neni 247 i K.pr.civile).

Kodet e mëparshme kanë pasur një rregullim tjetër të çmimit nga gjykata të fuqisë provuese të një shkrese që ka gërvishtje, shuarje, shtesa midis radhëve dhe çrregullime të tjera materiale. Sipas nenit 199 të Kodit të vitit 1958 dhe sipas nenit 33 të Kodit të vitit 1982, parashikohej se: Gjykata çmon fuqinë provuese të një dokumenti që ka gërvishtje, shuarje, shtesa midis radhëve dhe çrregullime të tjera materiale, duke marrë parasysh edhe rrethanat e tjera të çështjes.

Aktet zyrtare përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara nëpunësve të shtetit ose të personave që ushtrojnë veprimtari publike për

faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Për këto akte lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar (neni 253). Pra, ato përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre, gjersa nuk provohet se janë të falsifikuara.

Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre, ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre. Për këto akte lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar (neni 254).

Kopjet dhe shkurtimet e akteve të përmendura në nenet 253 dhe 254 të K.pr.civile, të vërtetuara sipas ligjit, kanë fuqi provuese sikundër edhe origjinali (neni 255).

Në rast se akti zyrtar deklarohet fals, ai e humbet çdo vlerë provuese. Shkresa e thjeshtë e nënshkruar nga personi që e ka lëshuar, përbën provë të plotë se deklarimet që përmban, janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi kundër të cilit paraqitet shkresa pranon se është nënshkruar prej tij (neni 259).

Në këtë rast, fuqia provuese e shkresës së thjeshtë është e njëjtë me fuqinë provuese të aktit zyrtar. Si rregull, shkresa private nuk përbën provë në favor të përpiluesit, me përjashtim të rastit kur atë e paraqet si provë pala kundërshtare ose në qoftë se kemi të bëjmë me:

- librat e tregtarëve dhe të profesionistëve që mbahen sipas Kodit tregtar ose dispozitave të tjera;
- librat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, mjekëve, farmacistëve e të profesioneve të tjera, që mbahen sipas dispozitave në fuqi (neni 260).

Këta libra, kur janë përpiluar në formën e caktuar nga ligji, përbëjnë provë të plotë për sa shkruhet në to, për tregtarët ose personat e tjerë që detyrohen të mbajnë të njëjtët libra, por lejohet të provohet e kundërta kur pretendohet falsiteti (neni 263)

5.2. Mënyra e paraqitjes dhe e kërkimit të provave shkresore

Provat shkresore mund të paraqiten në gjyq nga palët ose mund të kërkohen me nismën e palëve. Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument, kur çmohet e nevojshme prej saj.

Në këtë rast, gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që kërkon me anën e gjykatës, nga persona që marrin pjesë ose që nuk marrin pjesë në çështje, paraqitjen e një dokumenti, është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme

se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument (neni 223).

Dokumentet e kërkuara nga gjykata, si rregull, duhet t'i dërgohen drejtpërdrejt asaj, por, në praktikë, gjykata mund t'u lëshojë palëve një autorizim me të cilin u jep atyre të drejtën për të marrë prej institucioneve ose personave përkatës dokumentet e duhura për të paraqitur në gjykatë.

Në rast se paraqitja e dokumenteve të kërkuara në gjykim është e vështirë ose për shkak të rëndësisë së saj ose të natyrës së saj, ekziston rreziku të humbasë ose të dëmtohet, gjykata mund të urdhërojë të verifikohet shkresa nga një anëtar i trupit gjykues ose të kontrollohet me letërporosi nga gjykata e vendit ku ndodhet shkresa, ose të lejojë të merret fotokopje e vërtetuar (neni 252 K.pr.civile). Në këtë mënyrë, gjykata mund të veprojë, p.sh., në rast se shkresat janë të shumta ose për shkak se vetëm një pjesë e tyre mund të kenë rëndësi për gjykimin. Kërkimi i gjykatës, në çdo formë që të jetë shprehur (drejtpërdrejt ose me anë të lëshimit të autorizimit), është detyrues për të gjithë.

Personat që nuk marrin pjesë në çështje, kur u kërkohet një shkresë që ndodhet pranë tyre dhe nuk kanë mundësi ta paraqitin brenda afatit që u ka caktuar gjykata, janë të detyruar të njoftojnë gjykatën për mosparaqitjen e shkresës në afat, duke treguar dhe shkaqet. Gjykata, kur nuk i gjen me vend shkaqet e treguara, si dhe kur nuk është lajmëruar se dokumenti i kërkuar nuk ka mundësi të dërgohet, ka të drejtë të dënojë personat përgjegjës, sipas nenit 167 të K.pr.civile (neni 276 i K.pr.civile). Neni 167 i K.pr.civile parashikon se, kur një person i tretë, që nuk është palë, nuk pranon të paraqesë një dokument që provohet se ndodhet pranë tij dhe që i është kërkuar nga gjykata, dënohet me gjobë deri në 30 000 lekë.

Sipas disa legjislacioneve, kur provat shkresore kërkohen prej palës në proces, në rast refuzimi të palës që të paraqesë provat e kërkuara, gjykata mund të konsiderojë të provuara faktet për vërtetimin e të cilave kërkohet dokumenti. Kodi shqiptar nuk e parashikon një zgjidhje të tillë.

Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes (neni 266 i K.pr.civile).

Një dokument origjinal i paraqitur në gjyq mund të merret prapë prej palës që e ka paraqitur, por me kushtin detyrues që të vihet në dosje kopja e tij e vërtetuar me nënshkrimin e personit që e ka paraqitur dokumentin.

5.3. Kundërshtimi i vërtetësisë së provave shkresore

Pala kundër së cilës është paraqitur si provë një shkresë, mund ta kundërshtojë vërtetësinë e saj në njërën nga këto mënyra:

1. duke mohuar shkrimin ose nënshkrimin e saj në shkresën e thjeshtë;
2. duke deklaruar se nuk di që shkrimi ose nënshkrimi në shkresën e thjeshtë të jetë i trashëgimlënësit të saj ose i personit nga i cili ajo heq të drejta;
3. duke pretenduar se akti zyrtar ose shkresa e thjeshtë është e falsifikuar. (neni 277 i K.pr.civile).

Në këto raste, gjykata bën kontrollin e vërtetësisë së shkresës, duke krahasuar shkrimin dhe nënshkrimin që ajo përmban me atë të shkresave të tjera, vërtetësia e shkrimit të të cilave nuk mund të kundërshtohet. Kur bëhet krahasimi i shkresave, ai që paraqet provën, detyrohet t'i njoftojë palës kundërshtare, jo më vonë se dhjetë ditë përpara datës së caktuar për krahasim, listën e shkresave me të cilat do të bëhet krahasimi ose të depozitojë origjinalet në sekretarinë e gjykatës. Kur shkresat që mund të krahasohen, i disponon pala kundërshtare ose personi i tretë, mund të kërkohet urdhërimi nga gjykata i paraqitjes së tyre. Kur nuk ka shkresa, vërtetësia e të cilave nuk mund të kundërshtohet, ose kur këto nuk janë të mjaftueshme, krahasimi do të bëhet me shkrimin ose nënshkrimin që pala ndërgjyqëse ose personi i tretë, të cilit i mohohet origjinaliteti i shkrimit ose nënshkrimit, detyrohet të bëjë para gjykatës. Në rast se ndërgjyqësi ose personi i tretë refuzon të shkruajë ose bën përpjekje për të ndryshuar shkrimin e tij, gjykata e çmon lirisht këtë fakt (neni 269 i K.pr.civile).

Krahasimi i vërtetësisë së shkresave të thjeshta për shkak të mohimit ose të mosnjohjes së shkrimit ose nënshkrimit duhet të bëhet me anën e ekspertëve për ekspertimin grafik të dokumenteve. Kontrolli i vërtetësisë së shkresës mund të bëhet edhe me anë të pyetjes së dëshmitarëve që kanë dijeni se pala ndërgjyqëse ose personi i tretë e ka shkruar ose nënshkruar shkresën, për shkak se ata e kanë parë vetë një gjë të tillë etj. Në këtë rast, detyrimin për të provuar vërtetësinë e shkresës e ka ai që e ka paraqitur shkresën si provë dhe jo ai që e kundërshton. Personi kundër të cilit paraqitet si provë një shkresë private në një gjykim, është i detyruar të deklarojë menjëherë se e pranon ose jo origjinalitetin e nënshkrimit, ndryshe shkresa konsiderohet e pranuar (neni 267/2 i K.pr.civile).

Gjykata, pas kontrollit të vërtetësisë së dokumentit, me vendimin që jep gjatë gjykimit ose me vendimin përfundimtar, shprehet nëse dokumenti është ose jo i vërtetë. Kur dokumenti nuk është i vërtetë, gjykata e përjashton këtë nga provat dhe, në qoftë se rezulton se dokumenti është i falsifikuar, ia dërgon prokurorit për të bërë ndjekjen penale.

Gjykata, me vendimin që pranon se dokumenti është i vërtetë, dënon palën që ka pretenduar falsifikimin ose që ka mohuar shkrimin, me gjobë deri në 50 000 lekë (neni 280 i K.pr.civile). Në këtë rast, gjykata, pasi e ka përjashtuar dokumentin e pavërtetë, e zgjidh çështjen në bazë të provave të tjera.

5.4. Kundërshtimi për falsitet

Në një gjykim palët mund të kundërshtojnë për falsitet, si aktet zyrtare, ashtu edhe ato private. Kur falsifikimi i atribuohet një personi të caktuar, mund të bëhet denoncimi për ndjekje penale (neni 271 i K.pr.civile). Pala mund të kundërshtojë për falsitet dokumentin e paraqitur nga pala tjetër, edhe pa i ngarkuar fajin e falsifikimit ndonjë personi konkret.

Në këtë rast pala që ka paraqitur dokumentin, duke hequr dorë nga përdorimi i këtij dokumenti si provë në çështjen në gjykim, mund të kërkojë nga gjykata shqyrtimin e çështjes në bazë të provave të tjera të depozituara në dosje ose në bazë provash të reja të paraqitura rishtas. Në këtë rast gjykata mund të përjashtojë dokumentin në fjalë nga marrja si provë.

Nga ana tjetër, në rast se pala që ka paraqitur dokumentin, nuk heq dorë nga përdorimi i tij si provë, pala që ka kundërshtuar dokumentin për falsitet, është e detyruar të paraqesë provat për falsitetin e dokumentit brenda afatit të caktuar nga gjykata, përndryshe pretendimi i saj është i papranueshëm. Pra, detyrimin për të vërtetuar falsitetin e dokumentit e ka pala që pretendon falsitetin. Kundërshtimi i një shkrese si false në gjykimin civil mund të bëhet qoftë si objekt kryesor i padisë (neni 32/c i K.pr.civile), qoftë rastësisht gjatë gjykimit të një padie kur një shkresë paraqitet si provë nga njëra prej palëve.

Gjykata që shqyrton çështjen, duhet të shqyrtojë edhe çështjen e falsitetit të dokumentit të paraqitur si provë. Në këtë rast, gjykata e kontrollon vërtetësinë e dokumentit me këto mënyra: a) me anë të krahasimit të tij me dokumente të tjera, vërtetësia e të cilave nuk mund të kundërshtohet, të shkruara dhe të nënshkruara, pa dyshim nga personi, shkrimi dhe nënshkrimi i të cilit kanë ngjallur dyshimin, dhe, kur nuk ka të tilla ose kur këto nuk janë të mjaftueshme, me shkrimin ose nënshkrimin që pala ndërgjyqëse ose personi i tretë vë para gjykatës; b) me anë të pyetjes së dëshmitarëve të figuruar në dokument ose të thirrur nga palët, të cilat kanë parë të shkruhet ose të nënshkruhet dokumenti i kundërshtuar ose që kanë dijeni mbi fakte të cilat mund të shërbejnë për zbulimin e së vërtetës; c) me anë ekspertimi grafik.

Si dokumente për krahasim, vërtetësia e të cilave nuk mund të kundërshtohet, janë:

1. aktet noteriale ose akte zyrtare të tjera që përmbajnë nënshkrimin e palës që ka kundërshtuar vërtetësinë e dokumentit;

2. shkresat që ka shkruar ose nënshkruar personi zyrtar, të cilit do t'i verifikohet shkrimi;

3. shkresat e thjeshta të ndryshme që pranohen se janë të shkruara ose të nënshkruara nga personi të cilit i atribuohet dokumenti që do të verifikohet;

4. pjesët e pranuara ose të pamohuara të atij dokumenti që do të verifikohet.

Duke u nisur nga objekti i falsitetit, dallojmë falsitetin material dhe atë intelektual. Është falsitet material i dokumentit ai që realizohet nëpërmjet fshirjesh, gërvishtjesh, shtesash, korrigjimesh etj. Është intelektual falsifikimi i dokumentit kur deklarimet dhe faktet e shënuara në të nga personi zyrtar ose jozyrtar nuk i përgjigjen së vërtetës.

Pas kontrollit të vërtetësisë së dokumentit, me vendimin që jep gjatë gjykimit ose me vendimin përfundimtar, gjykata shprehet nëse dokumenti është ose jo i vërtetë. Kur rezulton se dokumenti nuk është i vërtetë, gjykata e përjashton këtë nga provat dhe, në qoftë se rezulton se dokumenti është i falsifikuar, ia dërgon prokurorit për të bërë ndjekje penale (neni 280/1 i K.pr.civile). Në këtë rast, çështja civile zgjidhet në bazë të provave të tjera.

Konsiderohet *fals* dokumenti përmbajtja e të cilit në tërësi nuk i përgjigjet realitetit. Por mund të flitet për falsitetin e një dokumenti vetëm për sa i përket pjesës që nuk i përgjigjet realitetit. Provat shkresore mund të *kundërshtohen nga pikëpamja e përmbajtjes.*

Provat shkresore mund të kontestohen me çdo provë derisa nuk është parashikuar ndryshe me ligj. Për sa u përket dokumenteve të lëshuara nga organet e pushtetit shtetëror dhe të administratës, në ushtrim të pushtetit dhe brenda kufijve të kompetencës së tyre, këto mund të kontestohen vetëm kur një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht nga ligji, përveç rasteve të falsifikimit ose në rast të një vepre tjetër penalisht të ndëshkueshme. Nga ana tjetër, dokumente që dalin nga organet e pushtetit shtetëror ose të administratës, jo në ushtrim të pushtetit të tyre ose që dalin nga institucione, organizata, në bazë të kompetencave të tyre, mund të kontestohen me çdolloj prove, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji.

Çmuarja e provave shkresore bëhet sipas rregullave të përgjithshme të çmimit të provave. Megjithatë, për të përcaktuar drejt rëndësinë dhe fuqinë provuese të provave shkresore, duhen marrë parasysh kushtet materiale dhe formale nga të cilat varet rëndësia dhe fuqia provuese e secilës provë shkresore më vete. Kushtet materiale i referohen përmbajtjes dhe ato formale, formës së dokumentit.

6. Prova e ekspertit

6.1. Caktimi i ekspertëve të gjykatës dhe kërkesat që duhet të përmbushë ekspertiza

Në sistemet e përqendruara mbi përdorimin e ekspertëve të gjykatës në vend të dëshmitarëve ekspertë, gjyqtari përballet me një sërë problemesh në vlerësimin e ekspertizës, veçanërisht në rastet kur këto trajtojnë fusha shumë teknike. Në këtë mënyrë, është e rëndësishme të njihen mundësitë e rishikimit të rezultateve të ekspertimit edhe në mungesë të ndihmesës së mjaftueshme nga palët.

Fragmenti në vijim është shkëputur nga një shkrim i M. Taruffo, i cituar më sipër:

"Prova me ekspertë përdoret kur gjykata vendos se janë të nevojshme njohuri shkencore ose teknike specifike për të marrë një vendim për çështjen. Gjykata e merr këtë vendim me iniciativën e saj; pala mund të japë sugjerime, por gjykata është e lirë të vendosë ose jo për caktimin e ekspertit. Kur gjykata vendos për caktimin e ekspertit, ai zgjidhet nga gjykata; në këtë rast, gjykata zakonisht (por jo domosdoshmërisht) zgjedh një ekspert nga lista. Ekspertët duhet të jenë neutralë dhe të paanshëm në lidhje me palët dhe objektin e çështjes. Nëse nuk garantohet neutraliteti dhe paanshmëria e tyre, ata duhet të tërhiqen ose mund të kontestohen. Eksperti bëhet nëpunës i gjykatës. Ai nuk mund të thirret si dëshmitar, nuk duhet të ketë në asnjë mënyrë lidhje me palët dhe presupozohet se do t'i ofrojë gjykatës njohuri shkencore dhe teknike të pavarura. Kur eksperti e merr përsipër detyrën, gjykata parashtron çështjen që ai duhet të zgjidhë. Eksperti mund të sigurojë gjithçka që është e nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të shtruara nga gjykata, duke dëgjuar individë që i njohin faktet, duke kryer testime, eksperimente, inspektime etj.

Brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, eksperti duhet të dorëzojë një raport me shkrim në të cilin të përshkruhet veprimtaria e tij, si edhe përgjigjet për pyetjet e shtruara nga gjykata. Nëse është e nevojshme, eksperti mund të pyetet nga gjykata me qëllim sqarimin e raportit, por pyetja verbale nuk është metoda e zakonshme për marrjen e përgjigjeve të ekspertit. Nëse gjykata është e kënaqur me raportin e ekspertit, ai do të përdoret si bazë për vendimin përfundimtar. Por, gjithsesi, gjykata nuk është e detyruar të marrë në konsideratë mendimin e ekspertit; ajo është e lirë të marrë një vendim të ndryshëm për çështjen. Sikurse thuhet zakonisht, gjyqtari është *peritus peritorum.* Pra, është gjyqtari ai që do të vendosë nëse do ta ndjekë mendimin e ekspertit. Nëse jo, gjykata duhet të shpjegojë arsyet përse nuk është pranuar opinioni i ekspertit.

Kur gjykata cakton një ekspert, palët mund të caktojnë ekspertët e tyre. Këta ekspertë i ndihmojnë palët për t'u mbrojtur lidhur me veprimtarinë e ekspertit të caktuar nga gjykata. Ata lejohet të marrin pjesë në këtë veprimtari, të ngrenë pyetje dhe të bëjnë vërejtje. Megjithatë, ekspertët e palëve nuk konsiderohen burim provash. Ata janë *longa manus* teknik të palëve dhe në këtë mënyrë nuk janë as neutralë, as të paanshëm. Rrjedhimisht, ata nuk mund t'i ofrojnë gjykatës njohuri të pavarura dhe të besueshme".

Shënim i autorit: *Rregullat e Kodit shqiptar të procedurës civile për ekspertët ofrojnë zgjidhje tepër të ngjashme me Kodin italian, gjë që mund të konstatohet lehtësisht nga analizimi i neneve 225-230, që korrespondojnë ngushtësisht me nenet 191-197 të Kodit italian. Për caktimin e ekspertëve të gjykatës, për shembull, neni 225 thotë se caktimi i ekspertit bëhet nga gjykata duke marrë edhe mendimin e palëve. Po ashtu, kërkesat që duhet të përmbushen nga eksperti, janë parashikuar në nenin 226: para fillimit të kryerjes së detyrës, eksperti duhet të betohet se do t'i kryejë mirë e me nder detyrat që i janë caktuar. Më pas, ekspertit i caktohet detyra dhe ai duhet t'i paraqesë gjykatës një raport me shkrim për ekspertizën që ka kryer.*

6.2. Opinione krahasuese për provën e ekspertit

Mund të përmenden, gjithashtu, edhe disa opinione të shprehura në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar,* seksioni që i kushtohet procedurës civile, *kapitulli V: "Zbehja e formalizmit në rregullat e provave", i* cituar edhe më sipër, rreth ndryshimeve mbi pozitën e ekspertit në sistemet e common law dhe të së drejtës kontinentale:

"Së fundi duhet të përmendet edhe pozita e ekspertëve. Pyetja që shtrohet këtu, përgjigjja e së cilës përsëri nuk është shumë e thjeshtë, është se çfarë do të ishte më mirë për secilën prej palëve: marrja me pagesë e shërbimeve të një eksperti, e ashtuquajtura "beteja e ekspertëve" në juridiksionet common law apo vendimi gjyqësor më racional që vjen si rezultat i praktikës kontinentale me ekspertë të caktuar nga gjykata, i cili në disa raste mund të japë vetëm një raport me shkrim.

Përmendja e të metave të çdo sistemi nuk është vështirë të bëhet nëse mbahet parasysh fakti se dëshmia e ekspertit ka marrë rëndësi të tillë në mosmarrëveshjet civile. Ndoshta, e gjithë ajo çka pritet është që çdo sistem të jetë i ndjeshëm ndaj dobësive të tij dhe i gatshëm të përdorë herë pas here edhe metoda të tjera nëse e lejon situata konkrete. Për shembull, nga njera anë, në gjykatat e vendeve të common law ka tregues të gatishmërisë për të inkurajuar një përdorim më të madh të ekspertëve të paanshëm dhe, nga ana tjetër, në juridiksionet kontinentale ka një hapësirë lejuese më të madhe për

investigim nga palët që përdorin dëshminë e ekpertëve të caktuar nga gjykata".

Edhe për rregullimin e provave të ekspertit mund të lexohet kapitulli VI i seksionit që i kushtohet *procedurës civile, kapitullit 6," Procedurat e zakonshme në shkallën e parë", i Enciklopedisë ndërkombëtare për të drejtën e krahasuar,* cituar më sipër, f.*76*:

"Në rastet kur verifikimi i kërkuar nuk lidhet as me ndonjë dokument dhe as me ndonjë akt, por me një situatë faktike, gjejnë përdorim metoda të ndryshme. Këqyrja mund të urdhërohet si nga gjykata, ashtu edhe nga gjyqtari që shqyrton çështjen, kompetenca e të cilit për lëshimin e një urdhri të tillë me iniciativën e tij është pranuar formalisht (Francë, neni 771, § 5; Itali, neni 118 dhe 258); në Francë gjyqtari mund të urdhërojë edhe që verifikimi të bëhet nga një person i zgjedhur prej tij, që, për rastin në fjalë, njihet si "teknicien" (neni 232). Zakonisht, këto verifikime bëhen në formën e deklaratave të nëpunësit të gjykatës, megjithëse kjo nuk është e detyrueshme. Si gjyqtari që shqyrton çështjen, ashtu edhe gjyqtari që vendos për çështjen, kanë kompetencën që, me inicativën e tyre, të urdhërojnë marrjen e raportit të ekspertit ose të opinionit të ekspertit. Në Belgjikë, dispozita formale mbulon vetëm urdhrin për raportet e ekspertëve (art. 962).

Rregullat tradicionale për provat me ekspertë shpesh janë kritikuar. Është vërejtur se ky element i përgatitjes për gjykim është një mjet i përdorur mjaft shpesh dhe pak a shumë në çdo vend. Raportet e ekspertëve janë shumë të gjata, shumë të kushtueshme dhe u nënshtrohen kontrolleve të papërshtatshme. Duhet të vërehet, gjithashtu, se në të vërtetë gjyqtarët i largohen deri në një farë mase pozicionit të tyre. Ata shpeshherë kritikohen se e urdhërojnë provën me ekspertë, jo vetëm për të siguruar informacionin faktik, zakonisht të një natyre teknike, por edhe për t'ua lënë të tjerëve detyrën e përcaktimit të normës ligjore që duhet të zbatohet, duke deleguar kështu në mënyrë të paligjshme kompetencat e tyre (neni belg 11, §1). Me fjalë të tjera, është kritikuar gjerësisht fakti se gjyqtari, duke abuzuar me këto teknika, efektivisht pranon që hetimi të kryhet nëpërmjet një ndërmjetësi dhe, ndonëse vendimi përfundimtar merret nga gjyqtari, në më të shumtën e rasteve ai thjesht konfirmon mendimin e dhënë.

Kodi belg parashikon një ilustrim të përpjekjes për të luftuar abuzimet e ndryshme me të cilat mund të përballet prova me ekspertë: sipas nenit 973, § 1, ekspertët e kryejnë detyrën e tyre nën kontrollin e gjyqtarit, i cili mund të marrë pjesë në veprimet e tyre në çdo moment, me iniciativën e vet ose mbi bazën e një kërkese. Për të njëjtin qëllim, Kodi francez favorizon kontaktet midis gjyqtarit dhe eksepertit: gjyqtari mund të caktojë datën në të cilën duhet të paraqiten para gjykatës eksperti dhe palët për të përcaktuar detajet e detyrës

së ekspertit dhe ndoshta edhe afatin për përmbushjen e detyrës (neni 266); eksperti duhet ta informojë gjyqtarin lidhur me përmbushjen e detyrës së tij (neni 273) dhe gjyqtari lejohet të marrë pjesë në veprimet që kryen eksperti (neni 241). Po ashtu, pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme, rregullat e adoptuara dhe veçanërisht vonesat e mundshme janë të hapura ndaj kritikave".

7. Eksperti sipas legjislacionit shqiptar

7.1. Koncepti dhe llojet e ekspertimit

Ligji thotë se "kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim, kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, të teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë (neni 224/a i K.pr.civile). Pra, kur vetë gjyqtari nuk zotëron njohuritë e posaçme në shkencë, teknikë, art etj., ai duhet t'i drejtohet ndihmës së njerëzve që i zotërojnë këto njohuri. Nga të gjitha fushat e shkencës përjashtohet ajo e së drejtës, sepse gjyqtarët duhet të dinë të orientohen në problemet e së drejtës dhe nuk mund t'ia besojnë një tjetri zgjidhjen e problemit juridik të kontestuar, prandaj, nuk është në misionin e ekspertit të japë një mendim juridik.

Ekspertimi është metoda me të cilën gjykata vlerëson njohuritë e posaçme në fushën e shkencës, teknikës, artit etj., në hetimin e rrethanave të konfliktit të gjykuar midis palëve. Ekspertimi realizohet me anë të caktimit dhe thirrjes në gjyq të personave që zotërojnë njohurit e posaçme të kërkuara. Këta persona, për shkak të caktimit të tyre nga gjykata, quhen ekspertë gjyqësorë.

Në administrimin e drejtësisë, gjyqtarët ndeshin në dukuri të shumëllojshme të jetës dhe të aktivitetit të njerëzve, të aktivitetit të organizatave private dhe të institucioneve shtetërore. Prandaj, llojet e ekspertimit mund të jenë aq të shumëllojshme, sa e shumëllojshme është jeta, sa të shumëllojshme janë degët e shkencës, të artit, të teknikës etj. Më shpesh nga të gjitha, në praktikën gjyqësore ndeshen këto lloje ekspertimi: 1) ekspertimi mjekësor, 2) ekspertimi psikiatrik, 3) ekspertimi kimik, 4) ekspertimi i dokumenteve, 5) ekspertimi kontabël, 6) ekspertimi ekonomik, 7) ekspertimi teknik. Shpesh, në praktikë ndeshet edhe i ashtuquajturi ekspertimi letrar, kur gjykata shqyrton një konflikt që ka për objekt të drejtën e autorit mbi një vepër letrare; ndeshet, gjithashtu, ekspertimi artistik dhe shumë të tjerë.

7.2. Natyra juridike e ekspertimit gjyqësor

Ekspertimi është një mënyrë me të cilën gjykata aplikon njohuri të posaçme shkencore dhe të tjera, në hetimin e rrethanave të një çështjeje. Këto njohuri gjyqtarët nuk i posedojnë dhe prandaj i drejtohen ndihmës së personave që i

posedojnë – ekspertëve. Këtej del se ekspertimi, për gjyqtarët, është një lloj i veçantë konsultimi dhe ekspertët konsulentë e ndihmojnë gjykatën për të sqaruar rrethanat e çështjes, për të zbuluar rëndësinë e tyre të vërtetë.

Nga kjo rrjedh edhe pozita procedurale e ekspertit, pozitë që ndryshon në mënyrë rrënjësore nga pozita procedurale e dëshmitarit. Në veçanti kjo pozitë konsiston në sa vijon: 1) eksperti ka të drejtë të marrë dijeni për materialin e çështjes; 2) ai mund të kërkojë sqarimin e elementeve suplementare ose paraqitjen e materialeve suplementare të nevojshme për dhënien e mendimit nga ana e tij; 3) eksperti ka të drejtë të asistojë në seancën e gjykimit gjatë gjithë kohës së zhvillimit të saj; 4) ai ka të drejtë t'u bëjë pyetje palëve, dëshmitarëve; 5) objekti i ekspertimit kufizohet në kuadrin e pyetjeve të shtruara nga gjykata dhe në fushën e njohurive të posaçme të ekspertit.

7.3. Subjekti i ekspertimit

Subjekti i ekspertimit është eksperti, d.m.th. personi që kryen ekspertimin dhe jep mendimin. Për sa i përket çështjes se kush mund të jetë ekspert, ekzistojnë dy pikëpamje: disa mendojnë se ekspert mund të jetë vetëm një person fizik, ndërsa të tjerë janë të mendimit se ekspert mund të jetë, si personi fizik, ashtu edhe personi juridik.

Gjykata i drejtohet ekspertimit kur duhen njohuri të posaçme në fushën e shkencës, artit, teknikës, të cilat gjyqtarët nuk i zotërojnë. Këto njohuri mund t'i zotërojnë vetëm njerëz dhe jo institucione ose organizata. Përveç kësaj, për të dhënë një mendim duhen perceptuar rrethana të caktuara, duhen bërë vëzhgime, kërkime, analizime etj. Të gjitha këto s'ka dyshim se mund të bëhen vetëm prej një personi fizik.

Ligji penal parashikon përgjegjësi penale për dhënien e një mendimi jo të drejtë duke e ditur të tillë dhe kjo mund të aplikohet vetëm kundrejt një personi fizik. Subjekt ekspertimi – ekspert – mund të jetë vetëm një person fizik, por mund të caktohen disa ekspertë. Në rast se ata ndahen në mendime, secili prej tyre i paraqet gjykatës mendimin e vet të veçantë.

7.4. Objekt i ekspertimit

Objekt ekspertimi janë çështjet për sqarimin e të cilave nevojiten njohuri të posaçme. Objekti i ekspertimit ndonjëherë ngatërrohet me objektin e hetimit. Kështu, p.sh., kur lind një konflikt mbi falsitetin e një dokumenti, objekt i hetimit është dokumenti dhe objekt i ekspertimit çështja nëse dokumenti në fjalë është i nënshkruar prej një personi të caktuar. Kur lind çështja e gjendjes psikike të një personi në momentin e lidhjes së një kontrate, objekt i hetimit është personi i caktuar, ndërsa objekt i ekspertimit është gjendja psikike e këtij personi.

Në këtë mënyrë, objekt ekspertimi janë pyetjet e shtruara nga gjykata përpara ekspertit, mbi të cilat ai duhet të japë përgjigje, mendim.

7.5. Caktimi i ekspertimit dhe i ekspertëve

Legjislacioni procedural civil shqiptar nuk parashikon raste të caktimit të detyrueshëm të ekspertimit. Nevoja e caktimit të ekspertimit përcaktohet nga vetë karakteri i problemeve të lindura. Në rast se për sqarimin e problemeve të lindura duhen njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës dhe artit, caktimi i ekspertit është i domosdoshëm. Ekspertimi caktohet nga gjykata me kërkesë të palëve ose kryesisht. Gjykata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij (neni 227/ 1 i K.pr.civile).

Duke caktuar ekspertimin, gjykata duhet të përcaktojë ekzaktësisht objektin e ekspertimit, d.m.th. të tregojë se mbi cilat rrethana kërkohet mendimi. Për përcaktimin e rrethanave ose të pikave për të cilat kërkohet ekspertimi, gjykata duhet të dëgjojë mendimin e palëve. Kur refuzon ndonjë pikë të propozuar nga palët për t'u shtruar përpara ekspertit, gjykata duhet të arsyetojë refuzimin e vet.

E drejta e zgjedhjes së ekspertëve i takon gjykatës, por palët mund të paraqesin propozimet e veta. Në zgjedhjen e ekspertëve gjykata duhet të udhëhiqet nga nevoja e sigurimit që konkluzionet e ekspertëve të jenë dhënë me kompetencë dhe në mënyrë objektive, ajo duhet të marrë parasysh kualifikimin e ekspertëve të caktuar, si dhe raportet e tyre ndaj konfliktit që shqyrtohet dhe palëve, d.m.th. nëse eksperti, për ndonjë interes personal ose për shkak të marëdhënieve të tij me palët, është i interesuar në përfundimin e çështjes.

Palët mund të kërkojnë perjashtimin e personave të caktuar si ekspertë kur janë kushtet e përcaktuara prej nenit 72 të K.pr.civile. Shkak përjashtimi mund të jenë mungesa e kualifikimit të duhur, interesi në përfundimin e çështjes, raporte të veçanta me njërën prej palëve në proces.

Kur e dërgon çështjen për ekspertim në ndonjë institut ose laborator, gjykata ia beson zgjedhjen e ekspertit drejtuesit të institutit ose të laboratorit. Qenia ekspert është një detyrë shtetërore në interes të administrimit të drejtësisë. Eksperti është i detyruar të përmbushë detyrat e ngarkuara nga gjykata, përveç kur parashtron shkaqe të përligjura që pranohen nga gjykata. Mosparaqitja e ekspertit në gjykatë, pa shkaqe të përligjura, shkakton sjelljen e tij me detyrim (neni 224/ i K.pr.civile).

Të drejtat dhe detyrat e ekspertit.

Eksperti ka të drejtë:

- të njihet me materialin e çështjes;
- të marrë pjesë në të gjitha veprimet procedurale të gjykatës, të lidhura me hetimin e rrethanave të çështjes, t'u bëjë pyetje palëve, dëshmitarëve;
- të shtrojë përpara gjykatës nevojën e materialeve suplementare që i duhen për dhënien e mendimit;
- të marrë shpenzimet që ka bërë për paraqitjen e tyre, të shpërblehet për shërbimin e kryer. Masat e shpenzimeve dhe të shpërblimeve që u takojnë ekspertëve caktohen nga Këshilli i Ministrave (neni 105/a i K.pr.civile).

Eksperti është i detyruar:

- të paraqitet me thirrjen e gjykatës. Kur eksperti që është thirrur në gjykatë, nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme, gjykata e dënon me gjobë deri në 30 000 lekë dhe urdhëron sjelljen e tij me detyrim (neni 165 i K.pr.civile).
- të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes dhe të japë mendim. Kur eksperti, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, kundërshton të japë mendimin, gjykata e dënon me gjobë deri në 30 000 lekë (neni 166 i K.pr.civile).
- të shpërblejë dëmet që u janë shkaktuar palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces për faj të tij (neni 224/ç i K.pr.civile).
- të përmbushë me ndërgjegje funksionin e tij.

Sipas Kodit penal, në rast se eksperti kundërshton të kryejë detyrën që i ngarkohet, ose kryen një ekspertim të rremë, ai ka përgjegjësi.

7.6. Kryerja e ekspertimit dhe mendimi i ekspertëve

Përpara se eksperti të fillojë nga kryerja e detyrës, gjykata i kujton atij rëndësinë e funksioneve që duhet të përmbushë dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'i bëjë të ditur gjykatës të vërtetën (neni 226 i K.pr.civile).

Ekspertimi bëhet në gjykatë ose jashtë saj në rast se një gjë e tillë është e nevojshme për karakterin e ekzaminimit ose për shkak se mund të jetë e vështirë të sillet në gjykatë objekti i ekspertimit. Procesi i ekzaminimit është një etapë e veçantë e procesit unik të kryerjes së ekspertimit. Kjo fazë e kryerjes së ekspertimit mund të tregohet e paekzekutueshme në gjykatë për shkak të kushteve të posaçme në të cilat duhet të kryhet ekzaminimi (institucion shëndetësor, laborator etj.) ose për shkak se për ekzaminimin e objekteve kërkohet një kohë e gjatë, si p.sh. në rastin e ekspertimit kontabël.

Kur ekspertimi kryhet me praninë e gjykatës ose të gjyqtarit të deleguar, mbahet procesverbal, por gjykata mund t'i kërkojë ekspertit të japë përfundimet e ekspertimit në një raport me shkrim. Kur ekspertimi kryhet pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të gjykatës, eksperti duhet të hartojë një raport

me shkrim mbi ekspertizën e kryer, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim edhe vërejtjet dhe kërkesat e palëve.

Raporti duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës në afatin e caktuar nga gjykata (neni 228 i K.pr.civile). Për sa i përket komunikimit të mendimit nga ana e ekspertëve, ky duhet të bëhet në seancë gjyqësore. Prandaj paraqitja në gjyq për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes është e detyrueshme. Praktika sipas së cilës gjykata mjaftohet vetëm me mendimin e dhënë me shkrim nga ana e ekspertit, pa marrë pjesë ky i fundit në shqyrtimin e çështjes, është e kundërligjshme dhe shkel të drejtat e palëve. Një përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm mund të lejohet vetëm në raste të veçanta; megjithatë, në çdo rast konkret, gjykata duhet të marrë vendim të arsyetuar.

Konkluzionet e ekspertëve quhen mendime. Mendimi, si rregull, jepet në formë të shkruar, nënshkruhet nga ekspertët dhe shpallet në seancë gjyqësore. Mendimi duhet të përmbajë jo vetëm konkluzionet përfundimtare, por edhe arsyetimin e hollësishëm të këtyre konkluzioneve. Pra, mendimi i ekspertit duhet të jetë i arsyetuar (neni 230/1 i K.pr.civile).

Kur ka më shumë se një ekspert dhe janë të gjithë të një mendimi, përfundimet e ekspertimit mund t'i parashtrojë njëri që caktohet prej tyre. Kur kanë mendime të ndryshme, çdo ekspert duhet të parashtrojë mendimin e vet. Pasi të kenë dhënë mendimin, ekspertëve mund t'u bëhen pyetje (neni 230 i K.pr.civile).

Sqarimet me gojë që japin ekspertët në përgjigje të pyetjeve të palëve ose të gjykatës, në lidhje me mendimin e tyre, duhet të shënohen në procesverbalin e seancës gjyqësore. Kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë (neni 229 K.pr. civile).

7.7. Çmuarja e ekspertimit

Gjykata e çmon ekspertimin sipas rregullave të përgjithshme të çmuarjes së provave. Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe, kur ajo ka mendim të kundërt me ekspertin, duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim që jep gjatë gjykimit (neni 224/b, § 2, K.pr.civile). Kjo do të thotë se gjykata mund të pajtohet me konkluzionet e ekspertëve ose t'i refuzojë plotësisht ose pjesërisht ato. E kundërta, d.m.th. t'i heqësh gjykatës të drejtën e verifikimit të rregullsisë të konkluzioneve, do të çonte në një kundërshtim të papajtueshëm me parimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit, në mungesën e plotë të kontrollit mbi ekspertët dhe, në rezultat të fundit, që është më kryesorja, në gabimet gjyqësore.

8. Prova të tjera

8.1. Pohimi civil

Nenet 281-285 të Kodit shqiptar të procedurës civile rregullojnë të ashtuquajturat "pohime të palëve" që kanë efektshmëri provuese të ngjashme me pohimin civil në sistemin italian. Realisht, pohimi nuk është gjë tjetër veçse një deklaratë e bërë nga pala, e cila pohon se është i vërtetë një fakt që nuk favorizon interesat e saj dhe favorizon interesat e palës kundërshtare. Për të parë si rregullohen pohimet (pohimi civil) në të drejtën civile italiane, M. Taruffo në shkrimin e lartpërmendur (*Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile*) shkruan:

"Një pohim civil mund të bëhet nga njëra prej palëve që pranon se një fakt që shkon kundër interesave të saj, është i vërtetë. Një deklaratë e tillë mund të jetë spontane (dhe mund të bëhet kështu në gjykatë ose jashtë saj), ose mund të provokohet nga pyetjet e bëra nga gjyqtari mbi bazën e një kërkese specifike të bërë nga pala kundërshtare. Mohimi i një fakti jofavorizues nuk ka fuqi provuese. Pohimi i vërtetësisë së një fakti të tillë është një *provë ligjore,* e cila nënkupton se një deklaratë e tillë është detyruese si për gjykatën, ashtu edhe për palët. Me pak fjalë, gjykimi duhet të bazohet mbi një deklaratë të tillë, pa asnjë vlerësim diskrecional të bërë nga gjykata".

8.2. Betimi civil

Betimi civil është një provë ligjore: gjyqtari duhet ta bazojë vendimin mbi një provë të tillë, pa pasur asnjë mundësi për vlerësimin diskrecional të saj.

Një analizë krahasuese e betimit civil përshkruhet në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* (IECL, vëll. XVI, *Procedura civile*, kapitulli V, *Zbehja e formalizmit në rregullat e provave*, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London), § 37. *Marrjet formale në pyetje dhe betimet përcaktuese,* faqe 38:

"Betimi përcaktues merret nga njëra prej palëve në përgjigje të një prapësimi të bërë nga pala kundërshtare për të provuar disa fakte që janë dispozitivi i të gjithë çështjes gjyqësore ose i një pjese të saj. Një betim përcaktues i kryer si duhet është një provë përfundimtare, e pakontestueshme me çfarëdolloj mjeti; ajo përcakton përfundimisht mënyrën e përfundimit të çështjes, megjithëse pala që ka bërë betimin, mund të ketë artikuluar një betim krejtësisht të pavërtetë. Për shkak të papajtueshmërisë së dukshme me konceptet aktuale

moderne, betimi përcaktues është shfuqizuar në shumë prej vendeve të Europës, duke filluar me Austrinë (1895) dhe duke vazhduar me Hungarinë (1911), Rusinë (1917), Norvegjinë (1927), Gjermaninë (1933), Poloninë (1933, 1960), Jugosllavinë (1933), Suedinë (1948) dhe Finlandën (1949). Ndonëse betimi përcaktues nuk përdoret gjerësisht, ai vazhdon të praktikohet në Spanjë, Holandë, Itali, Belgjikë, Francë, si edhe në disa vende të Amerikës Latine.

Marrja formale në pyetje është një mjet procedural për sigurimin e pohimeve nga njëra prej palëve në një proces gjyqësor. Ky mjet mund të urdhërohet me anë të një kërkese me shkrim të palës, ku përmenden pyetjet specifike që do t'i drejtohen palës kundërshtare. Nëse gjyqtari që shqyrton çështjen, gjykon se pyetjet e parashtruara janë të sakta, ai ia drejton këto pyetje palës tjetër. Duke qenë se në kërkesë janë të përfshira pyetjet e sakta, pala që pyetet, i di paraprakisht pyetjet që do t'i drejtojë gjyqtari, duke pasur kështu mundësi të formulojë përgjigje evazive. Më tej, marrja në pyetje nuk bëhet nën betim dhe nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të thënë të vërtetën. Rrjedhimisht, marrjet formale në pyetje rrallë nxjerrin në pah pohimet që kërkohen dhe, për këtë arsye, ato janë shfuqizuar në pjesën më të madhe të sistemeve ligjore të së drejtës kontinentale duke filluar me Kodin austriak të vitit 1895 dhe, së fundi, në Francë, në vitin 1942. Me gjithë kritikat e gjera akademike drejtuar kundër tyre, marrjet formale në pyetje vazhdojnë të ekzistojnë në një sërë vendesh, duke përfshirë këtu Italinë dhe Spanjën.

Për të kompensuar disi shfuqizimin e betimit përcaktues dhe të marrjes formale në pyetje, në vendet e së drejtës kontinetale po zhvillohet një prirje e qartë drejt lejimit të gjyqtarëve për t'i pyetur palët gojarisht dhe në mënyrë informale në gjykatë, por pa i futur ato plotësisht në kategorinë e dëshmitarëve. Si edhe shumë prirje të tjera moderne, kjo rrymë fillimisht u shfaq në Kodin austriak të vitit 1895. Kodi austriak e autorizonte gjykatën, me iniciativën e saj *(sua sponte)* ose në bazë të një kërkese, të thërriste dhe të merrte në pyetje ose njërën prej palëve, ose të dyja palët. Megjithatë, në parim, përdorimi i kësaj kompetence është i vlefshëm në mungesë ose në pamjaftueshmëri të provave të tjera, duke qenë kështu një mjet plotësues i provave. Po i njëjta rregull u miratua nga reformat gjermane të vitit 1933 *(§ 141 dhe 445 i K.pr.civile. Japonia ka një dispozitë të ngjashme, por në praktikë gjyqtarët tentojnë t'i pyesin palët para subjekteve të tjera)* dhe në Kodin federal zviceran të procedurës civile, § 62. Evoluimi gradual i marrjes informale në pyetje (pyetja e lirë) në Itali dhe veçanërisht i paraqitjes personalisht të palëve në Francë, nga një institucion në të cilin gjyqtarët i pyetnin palët për të sqaruar pretendimet e tyre në një institucion ku palët mund të pyeten në mënyrë më të përgjithshme, është, gjithashtu, shprehje e kësaj rryme. Po ashtu, në sistemet ligjore të së drejtës

kontinentale, kryesisht ato të Danimarkës dhe Suedisë, karakteri plotësues i dëshmisë së palëve është anashkaluar dhe gjykata mund t'i urdhërojë palët të dëshmojnë që në fillim të procesit të marrjes së provave (në të vërtetë, Kodi suedez parashikon se palët duhet të thirren për të dëshmuar para dëgjimit të dëshmitarëve, me përjashtim të rrethanave specifike)".

Disiplina italiane e betimit civil përshkruhet nga M. Taruffo, *Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile*, cituar edhe më sipër, faqe 168-173:

"Betimi civil mund të ketë tri forma të ndryshme: *së pari,* ai mund të iniciohet nga njëra prej palëve që e sfidon palën tjetër të betohet për të vërtetën e një fakti material favorizues, nën paralajmërimin e sanksioncve morale dhe fetare, si dhe të sanksioneve penale në rast të thënieve të rreme; *së dyti,* ai mund të iniciohet nga gjykata kur ekzistojnë prova të një fakti, por gjykata është e mendimit se ato duhet të mbështeten nga deklarata të bëra nën betim dhe, *së treti,* ai mund të iniciohet nga gjykata vetëm për të përcaktuar vlerën e diçkaje. Në secilin prej rasteve, nëse betimi kryhet, rezultati i tij është detyrues, si për gjyqtarin, ashtu edhe për palët. Në këtë mënyrë, ai përcakton drejtpërdrejt vendimin përfundimtar për çështjen në gjykim".

Në Kodin shqiptar të procedurës civile, betimi civil nuk parashikohet si një provë ligjore. Por ai ka ekzistuar si provë në legjislacionin shqiptar në kohën e Mbretërisë Shqiptare. Konkretisht, betimi parashikohej në shtojcën e dytë të Kodit të procedurës civile, në titullin VI – Provat, kaptina IX – Beja, në nenet 257-285. Në këto nene përcaktohet koncepti i besë, llojet e saj, vlera provuese dhe procedura e betimit.

9. Shpjegimet e palëve dhe pohimi sipas legjislacionit shqiptar

Palët, si subjekte të procesit, marrin pjesë në hetimin e të gjitha rrethanave të çështjes, në ekzaminimin e të gjitha provave, paraqesin kërkesa, i japin gjykatës shpjegime në lidhje me rrethanat e ndryshme, i parashtrojnë gjykatës konkluzionet, konsideratat dhe mendimin e vet në lidhje me çmuarjen e provave, me aplikimin e normave ligjore etj. Gjykata mund të pajtohet ose të mos pajtohet me shpjegimet e palëve, por ajo është e detyruar t'i dëgjojë ato.

Në radhë të parë, palët i parashtrojnë gjykatës faktet juridike që janë bazë e kërkimeve ose e propozimeve të tyre. Vërtetësia e shpjegimeve të palëve, çmuarja e këtyre shpjegimeve, bëhet nga gjykata sipas rregullave të përgjithshme të çmuarjes së provave. Konkluzionin e vet mbi vërtetësinë e fakteve të parashtruara nga palët, mbi vërtetësinë e shpjegimeve të tyre, gjykata e nxjerr në bazë të analizimit të të gjitha rrethanave të çështjes. Vetëm një analizim i tillë mund ta çojë gjykatën në konkluzionin e vërtetësisë objektive të shpjegimeve të palëve.

Nga sa u tha më sipër, duhet arritur në konkluzionin se shpjegimet e palëve për sa i përket parashtrimit të fakteve të caktuara, janë prova.

Një prej llojeve të shpjegimeve të palëve është pohimi. Pohimi është shpjegimi i njërës prej palëve me anën e të cilit ajo vërteton ekzistencën e një raporti ose fakti që duhet të provohet nga pala tjetër. Pohimi mund të jetë gjyqësor dhe jashtëgjyqësor.

Pohimi gjyqësor është veprimi procedural i palës, mbi të cilin gjykata vjen në dijeni në mënyrë të drejtpërdrejtë, d.m.th. deklarata e palës, e bërë në gjyq gjatë zhvillimit të çështjes.

Pohimi jashtëgjyqësor nuk është veprim procedural; ai është një deklaratë e palës e bërë jashtë gjyqit; atë e komunikon në gjyq pala, në dobinë e së cilës ajo është bërë dhe mohohet nga pala, së cilës i atribuohet. Një pohim i tillë duhet të provohet nga pala në dobi të së cilës ai është bërë. Pohimi jashtëgjyqësor nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për konstatimin e një fakti ose të drejte; gjykata e çmon një pohim të tillë duke e bashkuar me tërësinë e të gjitha provave dhe rrethanave të tjera të çështjes, sipas rregullave të përgjithshme të çmuarjes së provave.

Rëndësia e pohimit gjyqësor. Pohimet e bëra në gjykatë prej palëve ose prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes (neni 214 i K.pr.civile). E drejta e pohimit të padisë nga përfaqësuesi i palës në proces duhet të rezultojë shprehimisht në prokurë (neni 97, § 2, i K.pr.civile).

Në rast pohimi të padisë ose të një raporti juridik, gjykata duhet të kontrollojë arsyet e pohimit, të hetojë nëse pohimi korrespondon me rrethanat reale të çështjes dhe vetëm atëherë ajo mund të marrë vendim në bazë të pohimit duke mos kërkuar prova të tjera. Në rast se, nga ana tjetër, nga kontrolli rezulton se pohimi nuk u përgjigjet rrethanave reale të çështjes, por ka për qëllim të shkelë interesat e shtetit ose të shtetasve, ose pohimi është bërë nën influencën e mashtrimit, të kërcënimit, të lajthimit etj., gjykata duhet të mos pranojë pohimin dhe të marrë vendimin duke u bazuar në raportet reciproke efektive të palëve, të konstatuara gjatë zhvillimit të çështjes.

Për sa i përket pohimit të një fakti, gjykata nuk shkarkohet nga detyra e verifikimit nëse pohimi i përgjigjet realitetit objektiv. Vetëm në rast përfundimi pozitiv të verifikimit, gjykata mund të mos kërkojë paraqitje provash të tjera; në rastin e kundërt, gjykata është e detyruar të kërkojë prova të tjera.

Pohimi mund të jetë i thjeshtë dhe i cilësuar. I thjeshtë quhet pohimi kategorik, i pashoqëruar prej ndonjë rezerve. I cilësuar quhet pohimi i shoqëruar prej

rezervash të bëra nga pohuesi. Rezerva ka zakonisht për qëllim të pakësojë rëndësinë e vetë pohimit. Kështu p.sh., i padituri pohon borxhin e kërkuar, por shton se nuk është i detyruar ta paguajë për shkak parashkrimi të padisë; i padituri, duke pohuar shumën e detyruar për një pasuri të blerë, njëkohësisht deklaron se kërkon çmuarjen e vlerës së pasurisë së blerë për shkak se në të ka zbuluar të meta të fshehta.

9.1. Ndërpyetjet e palëve (pohimet e palëve)

Pohimi i palëve ose, siç njihet ndryshe, ndërpyetja e palëve, është parashikuar si një provë e veçantë në nenet 281-285 të K.pr.civile. Kjo provë ka për qëllim të provokojë pohimin e palës kundërshtare. Ndërpyetja bëhet për fakte dhe rrethana që tregohen nga njëra palë dhe për të cilat duhet të japë përgjigje pala tjetër. Pohimi gjyqësor mund të jetë i rastit ose i nxitur nëpërmjet pyetjeve të bëra në mënyrë zyrtare për një qëllim të tillë (neni 281 i K.pr.civile).

Pyetjet bëhen për fakte, rrethana dhe në mënyrë të tillë që të pohohen apo të kundërshtohen pretendimet e palëve (neni 283, §1, i K.pr.civile). Për realizimin e ndërpyetjes me vendim të ndërmjetëm, gjykata vendos për pyetjet e pranuara, për mënyrën dhe afatet e realizimit të saj (neni 283, § 2, i K.pr.civile). Palët do të pyeten nga gjykata për secilin fakt veç e veç dhe për të gjitha rrethanat që kanë rëndësi për çështjen.

Pala e pyetur duhet të përgjigjet vetë personalisht. Ajo nuk mund të përdorë shënime të shkruara e të parapërgatitura. Megjithatë, gjykata mund të lejojë të përdoren shënime ose të dhëna të tjera të shkruara kur flasin për çështje që kanë të bëjnë me llogari e të dhëna që është vështirë të mbahen mend (neni 284 i K.pr.civile).

Kur pala e pyetur nuk paraqitet ose kur refuzon të përgjigjet, pa shkaqe të justifikuara, gjykata, duke vlerësuar edhe provat e tjera, mund t'i marrë si të pranuara faktet e parashtruara në pyetjet. Kur mosparaqitja e palës për t'u përgjigjur është me arsye, gjykata vendos shtyrjen e seancës ose marrjen e përgjigjeve edhe jashtë seancës (neni 285 i K.pr.civile).

Pyetja jashtë seancës mund të bëhet në raste të veçanta për shkak të ndonjë sëmundjeje ose për ndonjë arsye tjetër që e bën të pamundur paraqitjen e palës që duhet pyetur në seancën gjyqësore. Në këtë rast gjykata mund të delegojë njërin nga anëtarët e trupit gjykues ose ia delegon kompetencat e saj gjykatës së vendit ku ndodhet pala që duhet pyetur, sipas rregullave të parashikuara në nenet 215-217 të K.pr.civile .

10. Prezumimet dhe provat e tërthorta

Prezumimet dhe provat e tërthorta janë përkufizuar nga M. Cappelletti, në *"Procedura civile në Itali"*:[11)]

"Të dyja këto janë mjete të provave, nëpërmjet të cilave një fakt i panjohur mund të deduktohet nga një fakt i njohur, por që ka vetëm lidhje të tërthortë me çështjen. [...] Duke qenë se prezumimet, duke përfshirë edhe provat e tërthorta, përdorin arsyetimin deduktiv për përcaktimin e një fakti, ato shpesh quhen "prova logjike" ose "prova kritike." Si mjete të tërthorta të provave, ato quhen "prova të tërthorta".

M. Taruffo, në *"Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile"*, cituar më sipër, bën një shpjegim të përmbledhur të mënyrës së trajtimit të provave të tërthorta dhe prezumimeve nga e drejta italiane,

"Provat e tërthorta kryesisht përbëhen nga përfundime që gjykata mund t'i nxjerrë nga ndonjë fakt apo rrethanë e njohur ose e provuar, kur një rrethanë apo fakt i tillë mund të mendohet si premisë që do të mbështetë përfundimet lidhur me ekzistencën ose mosekzistencën e një fakti material. Gjykata mund t'i tërheqë këto konkluzione duke u mbështetur kryesisht mbi përvojën dhe arsyetimin e një personi me inteligjencë normale në vendin dhe kohën e marrjes së vendimit. Kur këto konkluzione (të ashtuquajturat *praesumptiones hominis*) janë të sakta, të qarta dhe ecin drejt të njëjtave përfundime, ato mund të prodhojnë një provë të arsyeshme për provimin e një fakti. Megjithatë, përdorimi i provave të tërthorta është krejtësisht në dorë të gjykatës, e cila vendos konkluzionet e mundshme faktike dhe kontrollon qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë logjike të tyre".

11. Prezumimet sipas legjislacionit shqiptar

Neni 13/2 i Kodit shqiptar të procedurës civile parashikon se faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi.

Prezumime quhen konkluzionet e bëra mbi ekzistencën e një gjendjeje (fakti) nga ekzistenca e një gjendjeje (një fakti) tjetër. Në këtë kuptim, prezumimet zbatohen në fusha të ndryshme të së drejtës. Në të drejtën e provave, prezumime quhen përfundimet e nxjerra për vërtetësinë e një fakti nga ekzistenca e fakteve të tjera.

---

11) M. Cappelletti, ***Procedura civile në Itali****, The Hague, 1965, faqe 212.*

Në teorinë e provave gjyqësore, prezumimet ndahen në: prezumime ligjore (preasumtiones juris) dhe prezumime të njeriut ose të zakonshme (preasumptiones dominis).

Konkluzionet e detyrueshme me ligj për gjykatën për vërtetësinë e një fakti kur është provuar një fakt tjetër, quhen prezumime ligjore. Për sa u përket prezumimeve të njeriut, të tilla quhen përfundimet logjike të bëra zakonisht në jetë, kur një fakt zakonisht shoqërohet nga një tjetër ose është shkak a pasojë e një tjetri. Këto prezumime nuk janë të urdhëruara nga ligji, prandaj gjykata mund t'i përdorë në rast se i quan të drejta. Këto prezumime qëndrojnë deri në provimin e së kundërtës.

Por, çështja konsiston në mënyrën e dallimit se cilat prej këtyre prezumimeve duhen konsideruar si të drejta dhe cilat si jo të drejta. Disa mund ta konsiderojnë një prezumim të drejtë dhe disa të tjerë jo. P.sh., një prezumim i njeriut është se heshtja është shenjë pranimi. Por ky prezumim nuk i përgjigjet gjithmonë realitetit, prandaj, kur i padituri hesht lidhur me një fakt të përmendur nga paditësi, gjykata nuk mund të nxjerrë si përfundim se i padituri e pranon atë fakt dhe, duke u bazuar në të, të mos kërkojë nga paditësi paraqitjen e provave.

Përveç kësaj, prezumime të tilla mbi të njëjtat fakte gjykata mund t'i bëjë vetëm me rastin e çmimit të provave dhe jo me rastin e hetimit të rrethanave të çështjes gjatë gjykimit të saj. Gjykata nuk mund ta konsiderojë të vërtetë një fakt në bazë të një prezumimi, në rast se kjo gjë nuk është bazuar në ligj dhe palët kanë të drejtë ta kundërshtojnë këtë prezumim duke e konsideruar si jo të drejtë nga pikëpamja e tyre.

c – ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Në këtë kapitull e drejta e provave është trajtuar kryesisht duke iu referuar normave ligjore italiane, të përzgjedhura përkundrejt një vështrimi të përgjithshëm krahasues. Ndonëse ligjvënësi shqiptar ka zgjedhur prezantimin e një mundësie të gjerë të pyetjes së kryqëzuar të dëshmitarëve, kjo gjë nuk ka pasur ndikim të ndjeshëm mbi ngjashmëritë e tjera të afërta midis dy modeleve. Gjithsesi, për sa i takon marrjes në pyetje të dëshmitarëve, ne kemi shkëputur disa fragmente nga shkrime që trajtojnë këto aspekte në sistemet e common law, ku "marrja në pyetje" është ikona e procesit gjyqësor.

Në seksionin në vazhdim, studentëve u është dhënë mundësia të provojnë aftësitë e tyre për ta trajtuar të drejtën shqiptare të provave sipas një vështrimi krahasues:

Dëshmitarët

1) Në cilat raste nuk lejohet përdorimi i dëshmitarëve si mjete të provave në procedurën civile shqiptare?
2) Cila është arsyeja që në raste të tilla parapëlqehen provat shkresore para atyre gojore?
3) Identifikoni disa prej sistemeve ligjore që mbajnë të njëjtin qëndrim me sistemin shqiptar lidhur me përjashtim e provës së dëshmitarit.
4) Cilat janë pasojat që lidhen përkatësisht me zgjedhjen midis pyetjes së dëshmitarëve nga gjykata dhe pyetjes së tyre nga palët?

Provat shkresore

1) Cilat janë ndryshimet më të mëdha në trajtimin e akteve zyrtare dhe të shkresave private në të drejtën shqiptare?
2) Cila është fuqia aktuale e secilës prej tyre?

Prova e ekspertit

1) Renditni aspektet kryesore të një sistemi të mbështetur mbi përdorimin e ekspertëve të caktuar nga gjykata në vend të dëshmitarëve – ekspertë.
2) Cila është mënyra e caktimit të ekspertëve sipas së drejtës shqiptare?
3) Cilat janë kërkesat që duhet të përmbushë eksperti pas caktimit të tij?

Prova te tjera

1) Çfarë është "prova ligjore"?
2) A përmban e drejta shqiptare shembuj të "provës ligjore"?
3) Si bëhet vlerësimi i provave të tërthorta nga gjykatat shqiptare?

d – LEXIME PLOTËSUESE DHE BIBLIOGRAFI

Për të drejtën e provave në sistemet e vendeve të common law:

W.M. Best, The principles of the Law of evidence: with elementary rules for conducting the examination and cross-examination of witnesses (Parimet e së drejtës së provave: me rregulla elementare për marrjen dhe pyetjen e kryqëzuar të dëshmitarëve), London, Sweet & Maxwell, 1922.

Mirjan R. Damasca, *Evidence law adrift (Prirjet e së drejtës së provave),* New Haven, London, Yale University press, 1997.

Tristram Hodgkinson, *Expert evidence: law and practice (Prova e ekspertit: e drejta dhe praktika),* London, Sweet & Maxwell, 1990

Jenny McEwan, *Evidence and the adversarial process: the modern law (Prova dhe procesi kontradiktor: e drejta moderne),* Oxford, 1998.

A. Stein, *Foundations of evidence law (Themelet e së drejtës së provave),* Oxford, Oxford university press, 2005.

I. H. Tennis, *The law of evidence (E drejta e provave),* London, Sweet & Maxwell, 2002.

John Henry Wigmore, *Evidence in trials at common law (Provat në procesin gjyqësor në vendet e common law),* Boston, Toronto, Little, Brown and Co., 1970-1988

Sa i takon së drejtës së provave në sistemet e së drejtës kontinentale, sugjerojmë të lexohen:

M. Cappelletti, *Civil Procedure in Italy,* Chapter 8: The proof-taking stage, pp. 173-205 *(Procedura civile në Itali,* kapitulli 8: Faza e marrjes së provave, f. 173-205), The Hague, 1965.

H. Koch – F. Diedrich, *Civil Procedure in Germany (Procedura civile në Gjermani),* The Hague – London – Boston, Kluwer-Beck, 1998.

P. Yessiou-Faltsi, *Civil Procedure in Ellas (Procedura civile në Greqi),* the Hague – London – Boston, 1995, f. 307-362.

ALQIVIADH LAMANI, Procedura civile, Tiranë, 1962.

Lidhur me provat në të drejtën italiane mund të jetë i vlefshëm referimi të veprat e cituara në kapitullin 2.

e – FJALORI TERMINOLOGJIK

Eksperti i gjykatës = Teknicien që thirret nga gjyqtari për të dhënë opinionin e tij për fakte që kërkojnë kompetenca teknike dhe hetime komplekse.

Betimi (civil) = Procedura nëpërmjet së cilës njëra prej palëve i kërkon palës tjetër të betohet para gjykatës për të vërtetën e deklaratave të bëra prej saj.

Dëshmitar = Individi që thirret për të shprehur nën betim, gjatë një procesi gjyqësor, opinionet e tij mbi fakte për të cilat ai ka njohuri personale.

Prova shkresore = Material shkresor që mund të kontribuojë në zbulimin e fakteve gjatë procesit gjyqësor.

Ad probatiònem = Ligji kërkon shprehimisht formën e shkruar si mjet për provimin e veprimit juridik. P.sh., rezulton e papranueshme prova për dëshmitarë (jo në rastet e dëshmisë ose të betimit), pasi nevojitet një dokument i shkruar në të cilin shfaqet vullneti i shprehur i palëve.

Ad substàntiam = Është një formë e veçantë e imponuar nga ligji si element

përbërës i veprimit juridik. P.sh. (*ad substantiam*, që imponon formën e shkruar të një akti publik).

Nemo tenetur edere contra se = Rregull procedural i cili parashikon se "askush nuk është i detyruar të dëshmojë kundër interesit të tij". Në legjislacionin italian mungon detyrimi për të dëshmuar kundër vetvetes dhe, për rrjedhojë, askush nuk mund të ndëshkohet kur jep dëshmi të rreme ose refuzon të paraqitet për të dëshmuar. Por, gjyqtari, me pushtetin e tij diskrecional, nga përmbajtja e deklaratave të palëve dhe nga shqyrtimi që i bën çështjes, mund të nxjerrë argumente të provuara.

Actio ad exhibendum = Veprim i lejuar nga njëra palë për të marrë nga pala tjetër ose nga një i tretë paraqitjen e një dokumenti ose të një objekti, i cili është i nevojshëm për rezultatin përfundimtar të procesit.

Sua sponte = Vullnetarisht, me iniciativën e tij.

Peritus peritorum = Përdoret për gjyqtarin i cili, kur gjykon se duhet të shmanget nga konkluzionet e ekspertit teknik, duhet të japë motive të përshtatashme ose të arsyeshme për bindjen e tij.

Præsumptiònes hominis = Janë të ashtuquajturat prezumime ligjore.

Præsumptiònes dominis = Prezumim i zotërimit të diçkaje.

Præsumptiònes iùris = *Prezumim ligjor.* Institut i origjinës postklasike, që ka zbatim të gjerë në fushën e procesit privat. Janë, në veçanti, rrjedhoja logjike që burojnë domosdoshmërisht nga fakte të provuara dhe konsiderohen në këtë mënyrë si të provuara edhe faktet e mëtejshme (nga ekzistenca e një fakti të njohur del fakti i panjohur).

f - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Fakti që Kodi shqiptar pranon pyetjen e kryqëzuar të dëshmitarëve, duke u dhënë kështu palëve një rol më të rëndësishëm në marrjen e provave krahasuar me kodet e tjera, nuk do të thotë se gjyqtari ka rol të dorës së dytë në marrjen e provave. Është thelbësor fakti se gjyqtari kontrollon në mënyrë të vazhdueshme respektimin e rregullave për pranimin e provave, veçanërisht të atyre që lidhen me depozitimin brenda afateve të përcaktuara të dokumenteve shkresore, duke respektuar në të njëjtën kohë kërkesat për autenticitet dhe besueshmëri.

KREU I GJASHTË

VENDIMET

a - OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet të zotërojnë njohuri për:

- kërkesat formale që duhet të respektohen në hartimin e vendimeve,
- efektet e vendimeve,
- çështjet më kryesore që lidhen me përdorimin e materialeve të huaja në hartimin e vendimeve,
- marrëdhëniet ndërmjet llojit të vendimeve dhe rolit që u është caktuar gjykatave.

b - MATERIALET REFERUESE KRYESORE

1 Dhënia e vendimeve

Kodi shqiptar i trajton procedurat e dhënies së vendimeve në nenet 302-319. Parimet që aplikohen gjatë kësaj faze finale dhe delikate të procedurave gjyqësore, gjejnë zbatim në një numër të konsiderueshëm të sistemeve ligjore kontinentale. Edhe në këtë rast mund të vinte në ndihmë paralelja që hiqet me sistemin ligjor italian të procedurës civile, nga Michele Taruffo [1]:

---

1) Michele Taruffo, **Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile,** *në S. Lena dhe U. Mattei (ed.),* **Hyrje në të drejtën italiane,** *Hague, Kluwer Law International,*

"Pasi të jenë paraqitur të gjitha provat, procesi gjyqësor arrin në fazën e tij finale, e cila i kushtohet marrjes së vendimit. Para marrjes së vendimit, avokatëve të palëve u jepet mundësia të paraqesin versionin e tyre përfundimtar për pikat më të rëndësishme faktike dhe ligjore të çështjes. Secili prej avokatëve depoziton një përmbledhje të pretendimeve ku rishpreh edhe një herë qëndrimin e tij përfundimtar, duke tërhequr konkluzionet që mund të jenë arritur nga provat e paraqitura dhe nga çdo gjë tjetër që ka ndodhur gjatë procesit gjyqësor. Këto konkluzione shkëmbehen ndërmjet palëve dhe i paraqiten edhe gjykatës. Më pas, secilës prej palëve i jepet mundësia të paraqesë një përmbledhje tjetër të shkurtër për t'iu përgjigjur disa prej çështjeve të ngritura në pretendimet e depozituara nga pala tjetër. Këto dy përmbledhje janë pretendimet përfundimtare për çështjen. Në raste mjaft të rralla, para gjykatës mund të zhvillohet edhe një diskutim gojor. Në ndryshim nga procedura e sipërpërmendur, në disa procese të veçanta gjyqësore, sikurse mund të jenë proceset gjyqësore që lidhen me marrëdhëniet e punës, këto pretendime përfundimtare nuk gjejnë përdorim. Në vend të kësaj procedure, pretendimet përfundimtare të palëve prezantohen gojarisht para gjykatës nëpërmjet avokatëve të palëve".

Shënim i autorit: *Në këtë aspekt, Kodi shqiptar i procedurës civile ndryshon nga Kodi italian. Sipas nenit 303, pasi të kenë paraqitur pretendimet, palët bëjnë diskutimet përfundimtare, duke folur sipas radhës së parashikuar në këtë dispozitë.*

"Faza tjetër e procesit është dhënia e vendimit përfundimtar nga gjykata. Vendimi përfundimtar zakonisht jepet me shkrim dhe dorëzohet në sekretarinë e gjykatës. Në disa raste, si p.sh. në proceset gjyqësore që lidhen me marrëdhëniet e punës, gjatë seancës gjyqësore, gjyqtari mund të lexojë vetëm dispozitivin e vendimit dhe më vonë të dorëzojë vendimin e arsyetuar.

Një vendim i zakonshëm trajton gjithë çështjet faktike dhe ligjore përkatëse të ngritura nga palët. Për sa u përket çështjeve faktike, gjyqtari vendos nëse faktet materiale të pretenduara nga palët do të konsiderohen të vërteta në bazë të provave të paraqitura. Si rregull, gjyqtarët janë të lirë të vendosin për fuqinë provuese të këtyre provave, bazuar në vlerësimin e tyre diskrecional, por, në disa raste, vazhdojnë të ekzistojnë rregulla për përcaktimin e fuqisë provuese të *provave ligjore* me efekt detyrues për gjykatën dhe palët në proces. Një fakt është *i vërtetë* kur deklarata që lidhet me këtë fakt, konfirmohet nga një numër provash të mjaftueshme dhe të arsyeshme. Kur për faktin në fjalë nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme, vendimi do të merret sipas parimit të *barrës së provës*. Sipas këtij parimi, pala paditëse do të humbasë nëse nuk provohet fakti mbi të cilin mbështetet mbrojtja e saj. Vlen të përmendet se në

sistemin procedural italian nuk ka asgjë të ngjashme me sistemin amerikan të *barrës së paraqitjes së provave*. Secila prej palëve është shumë e interesuar të paraqesë të gjitha provat e mundshme, në mënyrë që të maksimizojë shanset për fitore, por procedimet do të vazhdojnë derisa të jepet vendimi përfundimtar dhe gjykata do të marrë në konsideratë çdo provë që ka lidhje me çështjen, pavarësisht nga origjina e saj. Sipas sistemit italian, *barra e provës* 'hyn në lojë' në fund të procedurave gjyqësore, kur ka ardhur koha e marrjes së vendimit dhe nuk janë provuar ende të gjitha faktet materiale ose disa prej tyre. Ekziston një kriter *objektiv* dhe *i paracaktuar* për marrjen e vendimit: gjykata nuk ka asnjë diskrecion për caktimin e *barrës së proves* ndërmjet palëve. Gjithsesi, rregulla bazë mund të ndryshohet ose të modifikohet me ligj nëpërmjet [...] prezumimeve ligjore. Prezumimi ligjor mund të përdoret kur legjislatori dëshiron të favorizojë një palë të caktuar (për shembull, një të punësuar ose një person të dëmtuar) ose në rastet kur paraqitja e një prove ose provimi i një fakti të caktuar do të ishte shumë i vështirë ose thuajse i pamundur me mjete të zakonshme.

Gjatë marrjes së vendimit për çështjet ligjore, gjykata ka kompetencën të vendosë për kualifikimin e saktë ligjor (i ashtuquajturi *nomen juris*) të fakteve të çështjes, duke iu referuar normave të duhura ligjore. Kjo nënkupton se gjykata nuk është e detyruar të zbatojë kualifikimet ligjore të propozuara nga palët, megjithëse ajo mund të pranojë versionin ligjor të propozuar nga njëra prej palëve. Zgjedhja e normave ligjore që do të zbatohen për çështjen, interpretimi i tyre dhe zbatimi i tyre për faktet, duke tërhequr konkluzionet që dalin nga marrëdhënia fakt – ligj, mbeten në vlerësimin e gjykatës.

Sikurse e kemi thënë edhe më lart, vendimi përfundimtar jepet me shkrim. Përveç përshkrimit të identitetit të palëve dhe të gjykatës që shqyrton çështjen, vendimi përfundimtar përfshin edhe një pjesë përshkruese, e cila përmbledh ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë procesit gjyqësor, *dictum* përfundimtar që përcakton përgjigjen e gjykatës ndaj pretendimeve dhe mbrojtjes, të paraqitura nga palët, si dhe arsyetimin që përmban argumentet që gjykata ka përdorur në mbështetje të zgjidhjeve të arritura për të gjitha pikat faktike dhe ligjore të çështjes.

Kjo është [...] pjesa arsyetuese e vendimit që merret nga gjykata. Si rregull, pjesa arsyetuese duhet të jetë e plotë, e arsyetuar, koherente dhe me vijueshmëri. Kjo pjesë është shumë e rëndësishme, pasi opinioni nuk duhet të shprehë vetëm arsyet përse vendimi duhet të pranohet si i bazuar logjikisht, por duhet të hedhë edhe bazën për apelimet që mund të depozitohen nga palët, si edhe për rishqyrtimin që mund të kryhet nga gjykata e apelit".

Shënim i autorit: *Procedura shqiptare e dhënies së vendimeve paraqet disa ngjashmëri me procedurën greke (për shembull, detyrimi për të përshirë në vendim edhe mendimin e pakicës). Për më shumë detaje, mund t'i referohemi Pelaya Yessiou-Faltsi* (Procedura civile në Greqi)[2]:

"Vendimi i gjykatës duhet të jepet vetëm nga gjyqtari para të cilit është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor. Nëse kjo nuk është e mundur, seanca për shqyrtimin e çështjes duhet të përsëritet. Në rastet kur çështja nuk shqyrtohet nga gjyqtar i vetëm, trupi gjykues e përpilon vendimin dhe, nëse është e nevojshme, voton për të në mënyrë të fshehtë. Përpilimi i vendimit bëhet në dhomat e këshillimit ose menjëherë pas seancës gjyqësore, ose, të shumtën e rasteve, në një datë të mëvonshme që caktohet nga kryetari gjykatës ose nga kryetari i trupit gjykues. Ky i fundit cakton gjyqtarin relator, i cili ngarkohet me detyrën e raportimit të të gjithë çështjes gjatë diskutimeve dhe dhënies së vendimit. Duke qenë drejtues i diskutimeve për çështjen dhe duke pasur detyrën e specifikimit të radhës së diskutimeve dhe të votimit që mund të vazhdojë më pas, gjyqtari relator luan rol kryesor. Vendimi merret me shumicën e votave, të cilat ndahen sipas mendimeve që ka secili gjyqtar për çështjen. Gjyqtarët më të rinj votojnë më parë se gjyqtarët më të vjetër; kryetari i trupit gjykues voton i fundit. Kur ka më shumë se dy opinione, gjyqtarët duhet të bashkohen me një prej opinioneve që kanë marrë më shumë vota [...]. Mendimet e pakicës duhet të përfshihen në vendim.

Pasi të kenë mbaruar diskutimet për çështjen, gjyqtari relator ngarkohet me detyrën e hartimit të vendimit, i cili më pas datohet dhe nënshkruhet nga gjyqtari relator dhe kryetari i trupit gjykues. Nga ky projekt i nënshkruar në mënyrë korrekte bëhet edhe shpallja e vendimit në seancë gjyqësore publike.

[...] Teksti autentik i vendimit formohet pas shpalljes së tij dhe nënshkruhet nga gjyqtari kryesues i seancave dhe nga kryesekretari i gjykatës. Vendimi mbetet në kryesekretari. Çdo palë e interesuar mund të marrë kopje të vendimit nga zyra e kryesekretarisë.

Vendimi ka katër elemente përbërëse: Së pari, pjesën hyrëse që përfshin emrat e gjyqtarëve, me një shënim të veçantë për gjyqtarin relator, në gjykimet me trup gjykues, dhe emrat, profesionet, vendbanimet e palëve, të përfaqësuesve dhe të avokatëve të tyre, duke përmendur në mënyrë specifike faktin nëse palët kanë marrë pjesë në seancë dhe nëse kanë depozituar pretendime. Më pas vjen pjesa përshkruese e vendimit, e cila përfshin deklarata

2) *Pelaya Yessiou-Faltsi, Procedura civile në Greqi, Athens – The Hague – Boston*

të shkurtra mbi objektin e mosmarrëveshjes dhe rrugën e saj procedurale që nga ngritja e padisë. Dy pjesët e tjera kryesore janë: pjesa arsyetuese, premisat e arsyetimit juridik që kanë çuar në zgjidhjen e çështjes, dhe vendimi aktual që merret (dispozitivi). Ky i fundit duhet të jetë i plotë, i qartë, konkret dhe, si rregull, pa kushte. Së fundi, vendimi duhet të përmendë edhe shpalljen e tij".

Sipas nenit 310 të Kodit shqiptar të procedurës civile, pjesa urdhëruese e vendimit duhet të përmendë palën që ngarkohet me shpenzimet gjyqësore. Tema e shpenzimeve është veçanërisht e rendësishme, pasi ka ndikim të konsiderueshëm mbi suksesin konkret të palës së interesuar, duke merituar kështu një trajtim më të hollësishëm. Disa mendime, kryesisht nga këndvështrimi gjerman dhe austriak, mund të gjenden te *Enciklopedia ndërkombëtare e së drejtës së krahasuar* (IECL, vëll. XVI, në *Procedura civile*, kap. 6, *Procedurat e zakonshme në shkallë të parë,* J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London), faqe 136-137:

"Ligji "Për shpenzimet" bazohet mbi premisën se pala humbëse detyrohet t'i paguajë palës kundërshtare të gjitha shpenzimet që kjo e fundit ka kryer gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ose mbrojtjes së të drejtave të saj. Pala fituese duhet të gëzojë suksesin e saj të plotë duke mos qenë e detyruar të paguajë një pjesë të shpenzimeve të saj. Megjithatë, është e nevojshme mbrojtja ndaj abuzimit me institutin e padisë, pasi vendimi për kompensimin e shpenzimeve mund të jetë fitimprurës në vetvete. Sasia e shpenzimeve që shpërblehet, duhet të përfaqësojë sa të jetë e mundur shpenzimet të cilat ka qenë e detyruar t'i përballojë pala fituese.

Shpenzimet procedurale janë shuma e të hollave që detyrohet të paguajë pala për të zhvilluar procesin gjyqësor: shpenzimet e gjykatës (tarifat dhe kostot) dhe shpenzimet e palëve (veçanërisht tarifat e avokatit, tarifat dhe kostot e përfaqësuesve të tjerë, shpenzimet për udhëtimet).

Sipas pjesës më të madhe të autorëve gjermanë, mbi bazën e parimeve të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve, pala fituese ka të drejtë të kërkojë edhe një pretendim material. Gjithsesi, një padi mbi këtë bazë mund të mbështetet vetëm nëse pretendimi material është më i madh se pretendimi procedural për shpenzimet. E drejta zvicerane ndjek një model të ngjashëm. Neni 408 i Kodit austriak nuk shkon kaq larg dhe e lejon një pretendim për kompensim të shpenzimeve që e tejkalon vlerën e shpenzimeve procedurale, vetëm nëse pala humbëse ka vepruar dukshëm në mënyrë të pamenduar lidhur me fillimin e procedurave gjyqësore ose me mënyrën e zhvillimit të tyre.

Pretendimi procedural për shpenzimet nuk mund të gjykohet në një padi të veçantë. Çdo vendim ose urdhër që zgjidh përfundimisht një padi të kontestuar në gjykatën që e ka shqyrtuar, duhet të përmbajë edhe vendimin mbi përgjegjë-

sinë e palëve për shpenzimet. Gjykatat gjermane e përmendin në vendim se cila prej palëve mbart përgjegjësinë për shpenzimet; më pas, kryesekretari ose kancelari i gjykatës, nëpërmjet një urdhri të veçantë, vendos sasinë e shpenzimeve që duhet të paguhen. Në Austri, përcaktimi i shumës përfshihet në vendimin me shkrim të gjykatës (neni 414). Në kantonet zvicerane, gjykata vendos se cila prej palëve do të përballojë shpenzimet e gjykatës (tarifat). Ky vendim mbi shpenzimet e gjykatës përcakton në tërësi edhe sasinë e shpenzimeve të palëve. Kjo përfshihet në vendimin për themelin e çështjes; vetëm në kantonet e Argovisë (Aargau) dhe të Uollisit (Wallis) kërkohet një padi e veçantë.

Përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve është e ngjashme me përgjegjësinë për kompensimin e dëmeve. Ajo është mjet i rëndësishëm për të garantuar se palët do t'i zhvillojnë procedurat e çështjes së tyre me kujdes dhe të dokumentuara mirë, pasi një palë e vonuar do të duhet të përballojë edhe shpenzime shtesë – të vetat dhe të kundërshtarit të saj – të cilat mund të jenë rezultat i vonesës së shkaktuar prej saj".

2. Llojet e ndryshme të vendimeve

Sikurse edhe shumë sisteme të tjera procedurale, Kodi shqiptar i procedurës civile bën dallimin ndërmjet tri llojeve të vendimeve gjyqësore: vendimet përfundimtare (neni 126), të cilat përfundojnë gjykimin dhe e zgjidhin çështjen në themel; vendimet jopërfundimtare (neni 127), të cilat i japin fund procesit gjyqësor, pa e zgjidhur çështjen në themel (kjo mund të ndodhë, për shembull, kur gjykata rrëzon kërkesën e palës paditëse si të papranueshme, në mungesë të plotësimit të kërkesave procedurale) dhe vendimet e ndërmjetme (neni 125). Lloji i fundit i vendimeve lidhet me kërkesat incidentale të palëve ose me masat e tjera përgatitore (për shembull, marrja e provave) dhe, në ndryshim nga dy llojet e tjera, sipas nenit 315, ato mund të ndryshohen nga e njëjta gjykatë që i ka dhënë këto vendime.

Një dallim tjetër, i cili duket se gjen zbatim të plotë në sistemin procedural shqiptar, mund të bëhet ndërmjet tri llojeve të ndryshme të vendimeve përfundimtare, sikurse trajtohet edhe në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* (f. 135):

"Këto janë vendimet e detyrimit, vendimet deklarative dhe vendimet për ndryshimin e marrëdhënieve ligjore. Këto tri lloje të vendimeve dallohen në varësi të qëllimit të tyre:

1) Një vendim detyrimi konsiston në kërkesën (pozitive) për kryerjen e një veprimi ose në kërkesën (negative) për moskryerjen e një veprimi të caktuar.

2) Një vendim deklarativ deklaron se një e drejtë e caktuar ose një marrëdhënie ligjore ekziston, ose nëse një dokument është ose nuk është autentik.

3) Një vendim që ndryshon një marrëdhënie ligjore ose shpall ndryshimin drejtpërdrejt, qoftë të një të drejte, qoftë të një marrëdhënieje ligjore, ose një ndryshim i tillë është efekti i domosdoshëm i këtij vendimi. Nuk është e qartë vija ndarëse midis këtyre formave të vendimeve dhe vendimeve deklarative.

Në proceset gjyqësore, në gjykatat e shkallës së parë, dallimi ndërmjet llojeve të vendimeve është i rëndësishëm, pasi vendimet deklarative mund të jepen vetëm nëse ekziston një kërkesë e veçantë procedurale, *d.m.th.* nevoja për të mbrojtur një interes ligjor – pra interesin e përmendur në deklaratë. Në çdo rast, një vendim deklarativ nuk mund të jepet nëse i njëjti qëllim mund të arrihet nëpërmjet një vendimi detyrimi. Kjo shpesh shprehet duke thënë se, me qëllim mbrojtjen e të drejtave, funksioni i vendimit deklarativ është plotësues i funksionit të vendimit të detyrimit.

3. Llojet e vendimeve që parashikon legjislacioni shqiptar

Gjatë gjykimit të një çështjeje gjyqësore, gjykata jep tri lloje vendimesh:

1) vendime të ndërmjetme,
2) vendime përfundimtare,
3) vendime jopërfundimtare.

3.1. Vendimet e ndërmjetme

Jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që ajo t'u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës civile (neni 125 i K.pr.c.). Këto vendime u shërbejnë përgatitjeve për dhënien e vendimit përfundimtar në gjykimin konkret, i cili është qëllimi kryesor i çdo procesi. Këto vendime mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç rasteve kur në Kodin e procedurës civile parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë. Gjykata duhet të zgjidhë me vendim të ndërmjetëm të gjitha kërkesat e parashtruara nga palët gjatë gjykimit, si dhe të gjitha problemet procedurale të dala gjatë gjykimit. Këto vendime mund të jepen nga gjykata në seancë gjyqësore, por mund të jepen edhe jashtë seancës gjyqësore. Në veprimet përgatitore për marrjen e këtyre vendimeve, edhe në rastet kur çështja gjykohet me trup gjykues, kompetent për marrjen e tyre është kryetari i trupit gjykues, kurse në seancë gjyqësore marrja e tyre është në kompetencë të të gjithë trupit gjykues. Në rast se çështja gjykohet me trup gjykues, vendimet e ndërmjetme duhet të merren në mënyrë kolegjiale nga i gjithë trupi gjykues, pasi anëtarët konsultohen

dhe shkëmbejnë mendime sesi duhet zgjidhur rasti konkret në pajtim me normën materiale apo procedurale. Në rast se mendimet e anëtarëve të trupit gjykues janë të ndryshme, vendimi merret me anë të votimit. Në këtë rast vendimi konsiderohet i dhënë kur kanë votuar pro tij shumica e anëtarëve. Kur vendoset për çështje pak të rëndësishme dhe jo të ndërlikuara, trupi gjykues mund të konsultohet dhe të japë vendim në sallën ku zhvillohet gjykimi, në praninë e palëve dhe të personave të tjerë. Kështu mund të veprohet, p.sh., kur duhet vendosur për marrjen e provave, për shtyrjen e seancës, për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur etj.

Një nga vendimet e ndërmjetme është edhe vendimi për pezullimin e gjykimit. Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur:

a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative;
b) kërkohet nga të dyja palët;
c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik;
d) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor;
e) parashikohet shprehimisht në ligj.

Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale (neni 297 i K.pr.c.).

Në rastin kur njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik, si dhe në rastin kur njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor, pezullimi i gjykimit vazhdon gjersa të paraqitet për të marrë pjesë në çështje ose të thirret nga pala kundërshtare personi që hyn në të drejtat ose përfaqësuesi ligjor i palës që ka humbur zotësinë për të vepruar si palë.

Në rastet kur pezullimi i gjykimit është vendosur për shkak se çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative, pezullimi i gjykimit është kërkuar nga të dyja palët dhe pezullimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj, gjykimi i çështjes rifillon pasi të jenë zhdukur pengesat që shkaktuan pezullimin e tij. Në këto raste, edhe kur nuk është caktuar seanca e ardhshme, pala e interesuar i drejtohet gjykatës me kërkesë për vazhdimin e gjykimit. Gjykata cakton datën e seancës për vazhdimin e gjykimit dhe urdhëron që kjo t'u njoftohet palëve.

Gjykata mund të marrë masa, edhe kryesisht, për mënjanimin e këtyre pengesave. Gjykimi fillon nga veprimi procedural i mbetur në kohën e pezullimit (neni 298 i K.pr.c.). Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi i gjykimit

3.2. *Vendimet përfundimtare*

Me vendimin përfundimtar, të cilin gjykata e jep në fund të gjykimit duke e zgjidhur çështjen në themel, pranohet ose rrëzohet padia e paditësit.

Vendimi përfundimtar i gjykatës duhet të bazohet vetëm në ligj dhe në provat e shqyrtuara gjatë gjykimit, të cilat gjyqtarët i çmojnë sipas bindjes së brendshme të tyre, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre.

Vendimi përfundimtar duhet të jepet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes. Ai duhet të shpallet i arsyetuar, por, në raste të veçanta, për çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë, ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit për pesë ditë.

Për dhënien e vendimit, trupi gjykues duhet të kryejë këto veprime: bisedimin e çështjes, votimin dhe shpalljen.

Bisedimi i çështjes përfshin diskutimin që bëjnë midis tyre anëtarët e trupit gjykues për mënyrën si duhet të zgjidhet konflikti nga gjykata. Ai bëhet në dhomën e këshillimit dhe, për të shmangur mundësinë e ndërhyrjes ose të ndikimit të gjyqtarëve nga persona të tretë, aty qëndrojnë vetëm anëtarët e trupit gjykues duke mos lejuar të hyjnë e të qëndrojnë aty sekretarin e seancës, ekspertë ose persona të tretë. Nën drejtimin e kryetarit të seancës, trupi gjykues shtron për bisedim dhe vendos me radhë për të gjitha çështjet që janë shqyrtuar gjatë gjykimit. Gjykata duhet të vendosë mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Votimi përfshin shfaqjen e mendimit të secilit prej anëtarëve të trupit gjykues, i cili konkretizohet me votim. Të gjitha çështjet në diskutim zgjidhen me shumicë votash. Po kështu, edhe vendimi përfundimtar merret me shumicë votash. Asnjë nga anëtarët e trupit gjykues nuk mund të abstenojë nga vendimi. Në rast se njëri nga gjyqtarët ka shfaqur një mendim i cili ka mbetur në pakicë, ai duhet ta parashtrojë atë me shkrim dhe ky mendim i bashkohet vendimit përfundimtar.

Në rast se për një nga çështjet, gjyqtarët propozojnë zgjidhje të ndryshme dhe, si pasojë, nuk krijohet shumica në votimin e parë, kryetari i seancës hedh në votim dy zgjidhje për të përjashtuar njërën e kështu me radhë, derisa zgjidhjet të ngelen vetëm dy e për të cilat bëhet votimi përfundimtar. Pasi të jetë vendosur për të gjitha çështjet e diskutuara, kryetari i seancës bën arsyetimin e vendimit

gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën "kundër" dhe e nënshkruan vendimin.

Shpallja e vendimit është komunikimi që gjykata u bën pjesëmarrësve të procesit si dhe publikut për vendimin përfundimtar. Shpallja e vendimit duhet të bëhet në sallën e gjykimeve në ditën dhe orën e caktuar. Ai lexohet me zë të lartë nga kryetari i seancës gjyqësore ose nga njëri prej anëtarëve të tjerë të trupit gjykues të ngarkuar prej tij. Edhe në rast se gjykimi është zhvilluar me dyer të mbyllura, shpallja e vendimit duhet të bëhet gjithmonë në prani të publikut.

Vendimi përfundimtar jepet në "Emër të Republikës".

Sipas nenit 310 të Kodit të procedurës civile, vendimi përbëhet nga tri pjesë: hyrja, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe pjesa urdhëruese.

Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:

1) gjykata që ka gjykuar çështjen;
2) trupi gjykues dhe sekretari;
3) koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
4) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre, si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre;
5) emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë;
6) objekti i padisë;
7) kërkimet përfundimtare të palëve;
8) mendimi i prokurorit, nëse ka marrë pjesë.

Në hyrjen e vendimit, në mënyrë të veçantë, duhet të përmenden këto elemente: Në fillim të vendimit duhet të shënohet se ai jepet në "Emër të Republikës". Në këtë pjesë duhet të tregohet mënyra e shqyrtimit të çështjes, d.m.th. nëse është bërë me pjesëmarrjen e publikut apo me dyer të mbyllura, nëse pjesëmarrësit kanë qenë të pranishëm ose në mungesë. Në rast se ndonjë nga palët ose personat e tretë nuk ka marrë pjesë personalisht, por është përfaqësuar nga përfaqësues, duhet të tregohet nëse këta janë përfaqësues ligjorë apo të emëruar me prokurë dhe të shënohet lloji i prokurës, vendi dhe data e hartimit të saj. Tregohet padia që është shqyrtuar dhe, nëse në gjykimin e padisë është pranuar për shqyrtim edhe kundërpadia, duhet të tregohet edhe kjo e fundit. Gjithashtu, nëse gjatë gjykimit të padisë kryesore ndonjë person i tretë ka ndërhyrë në proces si ndërhyrës kryesor dhe gjykata e ka pranuar atë, duhet të tregohet edhe kjo padi e shqyrtuar në të njëjtin gjykim. Po kështu, nëse persona të tretë kanë ndërhyrë në gjykimin e padisë si ndërhyrës dytësorë,

kërkimet e parashtruara nga pala paditëse dhe baza ligjore mbi të cilën ajo i mbështet këto kërkime si dhe kërkimet përfundimtare që palët kanë parashtruar në pretendimet e tyre përfundimtare, pasi gjykata i ka dhënë fund hetimit gjyqësor.

Në pjesën përshkruese arsyetuese duhet të përmenden:

1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e tjera nga gjykata;
2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;
3) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.

Në këtë pjesë gjykata tregon faktet juridike të cilat kanë rezultuar të vërtetuara gjatë gjykimit. Këto janë, si faktet mbi të cilat paditësi ka bazuar pretendimet e tij, ashtu edhe faktet e prezantuara nga pala e paditur mbi të cilat ajo ka bazuar prapësimet dhe kundërshtimet e saj. Lidhur me sa më sipër, gjykata bën çmimin e provave duke analizuar provat e paraqitura nga të dyja palët për vërtetimin e këtyre fakteve juridike. Bazuar në ekzistencën ose jo të fakteve të prezantuara nga palët, gjykata tregon konkluzionin e saj përfundimtar mbi marrëdhëniet juridike të palëve, si dhe bazën ligjore që duhet të zbatohet për zgjidhjen e konflikit. Në përfundim të kësaj analize, gjykata duhet të tregojë arsyet përse ka vendosur se kërkimet që ka paraqitur paditësi, duhet të pranohen ose të refuzohen plotësisht ose pjesërisht.

Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden:

1) çfarë vendosi gjykata,
2) kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore,
3) e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.

Në këtë pjesë duhet treguar çfarë ka vendosur konkretisht gjykata në lidhje me çështjen.

Në rast se gjykata e ka pranuar padinë në dispozitiv, duhet të tregohet me saktësi se kush detyrohet, në dobi të kujt dhe çfarë detyrohet.

Në rast se padia është pranuar pjesërisht, gjykata duhet të tregojë se cilat janë kërkimet që ajo ka pranuar dhe cilat janë kërkimet që i ka rrëzuar.

Kur në vendimin përfundimtar padia pranohet, gjykata vendos edhe ligjërimin e sigurimit të padisë, nëse më parë ka marrë një masë të tillë.

Në rast se gjykata e rrëzon padinë, kjo gjë duhet thënë e qartë.

Kur vendoset rrëzimi i padisë, gjykata, nëse më parë ka marrë një masë për sigurimin e padisë, në vendimin përfundimtar vendos heqjen e sigurimit të padisë, e cila zbatohet kur vendimi merr formë të prerë.

Në varësi të pranimit ose të rrëzimit tërësisht ose pjesërisht të padisë, në vendimin përfundimtar, gjykata vendos se cilës palë i ngarkohen shpenzimet. Gjithashtu, në pjesën urdhëruese duhet të tregohet e drejta që kanë

treguar afatin për paraqitjen e tij. Për pjesëmarrësit e gjykimit në mungesë duhet të tregohet edhe momenti se kur duhet të fillojë llogaritja e këtij afati.

Kur vendimi përmban detyrimin për dorëzimin e një sendi në natyrë ose detyrimin për kryerjen e një veprimi të caktuar, gjykata mund të tregojë në vendim afatin për ekzekutimin e vendimit.

Gjykata mund të caktojë një afat për ekzekutimin e detyrimit në të holla ose ta ndajë atë me këste, me kërkesën e palës së interesuar, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të palëve ose rrethanat e tjera të çështjes (neni 311 i K.pr.c.).

3.3. Vendimet jopërfundimtare

Janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilat gjykata ose gjyqtari i japin fund procesit gjyqësor civil, pa e zgjidhur çështjen në themel, si dhe çdo vendim tjetër që, pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procedimit gjyqësor të filluar (neni 127 i K.pr.c.).

Pra, gjykimi i një çështjeje mund të marrë fund edhe me pushimin e tij, pa u shprehur gjykata lidhur me themelin e çështjes.

Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

a) asnjëra prej palëve nuk kërkon brenda gjashtë muajve rifillimin e gjykimit të pezulluar me kërkesën e tyre, kur gjykata nuk ka caktuar në vendimin e pezullimit një seancë të ardhshme;

b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë;

c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.

Sipas nenit 297, germa "b", të Kodit të procedurës civile, gjykimi i filluar pezullohet kur këtë e kërkojnë të dyja palët. Në këtë rast, pezullimi vazhdon derisa palët ose njëra prej tyre të kërkojë nga gjykata rifillimin e gjykimit. Por, në rast se kanë kaluar gjashtë muaj nga pezullimi i gjykimit dhe asnjëra nga palët nuk e ka kërkuar rifillimin e tij, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Neni 201 i Kodit të procedurës covile parashikon se paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi.

Në rastin e heqjes dorë nga gjykimi i padisë, paditësi nuk e humbet të drejtën për ta ngritur përsëri padinë në një gjykim të ri.

Sipas ne kur Kodi i procedurës civile parashikon shprehimisht pushimin

a) Nenin 179 - Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve.

Nëse paditësi osc asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore, ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit.

Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore.

Nëse ky nuk paraqitet edhe në seancën tjetër dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

b) Nenin 59

Kur në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak dhe të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.

c) Nenin 463 - Heqja dorë nga ankimi.

Në çdo fazë të gjykimit në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.

d) Nenin 468

Gjykata e apelit, kur konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte, prish vendimin dhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes.

3.3.1. Efektet juridike të pushimit të gjykimit

Pushimi i gjykimit sjell si pasojë anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimit, por, në rast se paditësi ngre përsëri të njëjtën padi, provat e mbledhura në gjykimin e pushuar mund të merren parasysh në gjykimin e kësaj padie, në qoftë se për marrjen rishtas të tyre ka vështirësi ose pengesa të pakapërcyeshme.

Pushimi i gjykimit nuk shuan padinë (neni 300 i K.pr.c.).

Kundër vendimit me të cilin vendoset pushimi i gjykimit mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit (neni 301 i K.pr.c.).

Një tjetër vendim jopërfundimtar që i jep fund procesit gjyqësor civil, pa e zgjidhur çështjen në themel, është vendimi për kthimin e kërkesëpadisë paditësit. Gjykata e jep këtë vendim me gjyqtar të vetëm, në rast se të metat konstatohen në kohën e paraqitjes së padisë ose me trup gjykues, kur të metat konstatohen gjatë gjykimit. Padia konsiderohet me të meta edhe kur paditësi, megjithëse i është kërkuar plotësimi i të metave të padisë brenda një afati të

Kundër vendimit për kthimin e kërkesëpadisë mund të bëhet ankim i veçantë (neni 154/a i K.pr.c.).

Vendimi jopërfundimtar që i jep fund procesit gjyqësor civil, pa e zgjidhur çështjen në themel, është vendimi që jep gjykata për miratimin e pajtimit që palët arrijnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Pajtimi mund të arrihet nga palët në veprimet përgatitore ose në seancë gjyqësore në çdo fazë të hetimit gjyqësor.

Kur arrihet pajtimi pa filluar seanca gjyqësore, mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga palët. Në këtë rast, gjyqtari, me vendim, miraton pajtimin. Kur pajtimi arrihet në seancë gjyqësore, kushtet e marrëveshjes pasqyrohen në procesverbalin gjyqësor. Gjykata jep vendim për miratimin e tij, por në çdo rast ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjin.

Kundër vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ose mospranimin e pajtimit mund të bëhet ankim i veçantë (neni 158/b i K.pr.c.).

Gjithashtu, vendim jopërfundimtar që i jep fund procesit gjyqësor civil, pa e zgjidhur çështjen në themel, është vendimi që jep gjykata për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor në bazë të nenit 59/1 të Kodit të procedurës civile, si dhe vendimi për shpalljen e moskompetencës së gjykatës për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e akteve në gjykatën kompetente në bazë të nenit 61 të Kodit të procedurës civile.

Kundër këtyre vendimeve palët mund të bëjnë ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë. Vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil, jepen në "Emër të Republikës" dhe duhet të përmbajnë përkatësisht bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së saj (neni 126 i K.pr.c.).

4. Vendimet e formës së prerë

Vendimi i gjykatës, sipas nenit 451 të Kodit të procedurës civile, merr formën e prerë kur:

a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij;
b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose ankesa është tërhequr;
c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar;
d) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, është ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

Vendimi që ka marrë formë të prerë, është i detyrueshëm për palët, për

Vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formën e prerë, janë tituj ekzekutivë, por tituj ekzekutivë janë edhe vendimet e gjykatës me ekzekutim të përkohshëm, si dhe vendimet e dhëna nga gjykata për sigurimin e padisë (neni 510, germa "a", i K.pr.c.).

Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur detyrimi:

a) për ushqim,
b) për shpërblimin nga puna,
c) për rivendosjen në posedim të banesës bashkëshortore.

Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci (neni 317 i K.pr.c.).

Gjykata, në vendimin përfundimtar, duhet të tregojë me hollësi rrethanat dhe arsyet për të cilat arriti në përfundimin se duhet ta pranojë kërkesën për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Kundër vendimit me të cilin pranohet ose rrëzohet kërkesa për ekzekutim të përkohshëm të vendimit, mund të bëhet ankim i veçantë (neni 318 i K.pr.c.).

Kur vendimi prishet nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, ekzekutimi i përkohshëm pezullohet.

Në rast se pas prishjes së vendimit të parë padia rrëzohet dhe vendimi merr formë të prerë, gjyqfituesi i parë detyrohet t'i kthejë palës tjetër gjithçka që ka marrë me ekzekutim të përkohshëm të vendimit të parë (neni 319 i K.pr.c.).

5. Efekti *res judicata* (gjëja e gjykuar)

Dallimi që bëhet ndërmjet vendimeve përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme, ka ndikim shumë të madh mbi efektin më të rëndësishëm të vendimeve: efektin *res judicata*. *Res judicata* është një koncept i zbatuar në shumicën e sistemeve ligjore kontinentale, i cili gjen zbatim edhe në sistemin procedural shqiptar. Kjo çështje trajtohet me hollësi në *Procedura civile në Itali* (Martinus Nijhoff, Hague, 1965, faqe 251-255):

"Në Itali bëhet dallimi midis *res judicata* formal dhe *res judicata* material. Një vendim është *res judicata* formal (një frazë që nuk e ka ekuivalenten e saj në sistemin common law) kur ai nuk i nënshtrohet më shqyrtimit [...]. Vetëm vendimi që është *res judicata* formal, mund të ketë efekte përfundimtare në procedurat gjyqësore vijuese.

judicata material. Një vendim që vendos vetëm për çështje procedurale dhe që nuk mund t'i nënshtrohet më asnjë prej formave të zakonshme të kundërshtimit, është *res judicata* formal dhe ndalon rishqyrtimin e këtyre çështjeve në të njëjtat procese. Megjithatë, ai nuk është *res judicata* material, pasi ai nuk ndalon rishqyrtimin e këtyre çështjeve në procese të mëpasshme. Për shembull, një vendim pushimi mbi bazën e arsyetimit se gjykata është jokompetente, se palës paditëse i mungon zotësia për të ngritur padi ose se pala paditëse nuk ka mundur ta ndjekë çështjen gjyqësore, nuk ka efekte përfundimtare në procedurat e mëpasshme. Vetëm vendimi që është *res judicata* formal dhe vendos për çështje materiale, ka efekt *res judicata* material – pra, është përfundimtar në procedurat e mëpasshme nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat e tjera për zbatimin e doktrinës së *res judicata.*

Qëllimi i përbashkët i *res judicata* formale dhe materiale është se për çdo mosmarrëveshje duhet të ketë një fund, si dhe duhet të ketë siguri në marrëdhëniet ligjore [...].

Si rregull, efekti *res judicata* material shtrihet vetëm për palët, për trashëgimtarët e tyre dhe për pasuesit (suksesorët) e tyre në interes. Pra, nëse një vendim për një padi të ngritur midis A-së dhe B-së vendos se A-ja është pronar i *Blackacre*, C-ja nuk pengohet të ngrejë një padi kundër A-së, në të cilën ai të pretendojë pronësinë për të njëjtën tokë. Ndonëse, në pjesën më të madhe të rasteve, të drejtat e personave që nuk kanë marrë pjesë në gjykim, nuk cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, vendimi që jepet në procesin gjyqësor, mund t'i cenojë ata në mënyrë të tërthortë. Për shembull, G-ja, garanti i shlyerjes së borxhit që A-ja i detyrohet B-së, do të dëmtohej ose do të privilegjohej nga një vendim për një padi të ngritur nga B-ja kundër A-së. Nëse vendimi e detyron A-në të shlyejë detyrimin, G-ja mund të mos e kundërshtojë ekzistencën e detyrimit midis palëve pjesëmarrëse në proces; nëse vendimi vendos se borxhi është shlyer (shuar), B-ja mund të mos e kërkojë ekzistencën e borxhit kundër G-së. Gjithsesi, personat, interesat e të cilëve mund të cenohen në mënyrë të tërthortë nga një vendim gjyqësor, normalisht, mund t'i mbrojnë interesat e tyre nëpërmjet ndërhyrjes në procedurat gjyqësore ose nëpërmjet kundërshtimit të palës së tretë [...].

Res judicata materiale ndalon ngritjen e çdolloj padie për të siguruar të njëjtin pushim cenimi *(petitum – objekti i kërkesës)* të kërkuar edhe në padinë e mëparshme, duke arsyetuar se ajo mbështetet mbi të njëjtën bazë ligjore dhe faktike (*causa petendi*) të përdorur në padinë e mëparshme. Për shembull, nëse padia për një vendim që deklaron përfundimin e kontratës së qirasë me arsyetimin se prona e dhënë me qira është sekuestruar nga shteti, mohohet, pala paditëse nuk pengohet të ngrejë një padi tjetër për të deklaruar përfundimin e kontratës se

qirasë me arsyetimin se prona e dhënë me qira është bërë e pabanueshme për shkak të dëmeve të luftës. Ndonëse në të dyja paditë kërkohet pushimi i të njëjtit cenim, padia e dytë ngrihet mbi një bazë të ndryshme ligjore dhe faktike. Megjithatë, është vështirë të hiqet vija ndarëse midis padive që mund të ngrihen dhe padive që pengohen të ngrihen.

Gjykatat dhe doktrina kanë zbatuar një kriter kufizues për të limituar kërkesat me të cilat palët mund të kërkojnë të njëjtën rivendosje të drejtë që është mohuar, mbi një bazë të ndryshme ligjore dhe faktike. Nëse në pretendimin e A-së kundër B-së, se është A-ja pronari i *Blackacre* dhe se e ka fituar pronësinë nëpërmjet dhuratës së bërë nga B-ja, vendimi jepet kundër A-së, A-ja ndalohet të ngrejë padi tjetër në të cilën të pretendojë titullin nëpërmjet një mënyre tjetër të fitimit të pronësisë. Po ashtu, ai ndalohet të ngrejë padi, të cilën e mbështetet përsëri mbi po të njëjtën dhuratë dhe të përpiqet të shtojë prova të tjera për të provuar pretendimin e tij.

Në disa raste, *res judicata* materiale vepron si pengesë e pjesshme për padinë vijuese. Për shembull, nëse një vendim deklarativ do të vendoste se A-ja është babai i B-së, në një padi vijuese të ngritur nga B-ja kundër A-së për mbajtje dhe mbështetje, A-ja ndalohet ta mohojë atësinë, por nuk ndalohet të kundërshtojë, me argumente të tjera, të drejtën e B-së për mbajtje dhe detyrim për ushqim".

6. Gjëja e gjykuar sipas legjislacionit shqiptar

Vendimi që ka marrë formën e prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë, nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe (neni 451/a i K.pr.c.).

Me marrjen e formës së prerë vendimi fiton fuqinë e gjësë së gjykuar për konfliktin që ka zgjidhur dhe përcakton në mënyrë përfundimtare dhe të pandryshueshme marrëdhëniet juridike civile midis palëve, duke përjashtuar mundësinë e ndonjë konflikti gjyqësor tjetër midis po atyre palëve, për të njëjtën çështje.

Ky institut shmang gjyqet pa mbarim dhe u jep siguri të drejtave që burojnë nga vendimet gjyqësore. Gjykata nuk mund të pranojë për të shqyrtuar një kërkesëpadi kur bindet se në lidhje me një konflikt midis të njëjtave palë, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak, ekziston një vendim përfundimtar i formës së prerë. Nga zbërthimi i paragrafit të fundit të nenit 451/a të Kodit të procedurës civile, rezulton se elementet e gjësë së gjykuar janë: të njëjtat palë

(identiteti i palëve), i njëjti objekt (identiteti i objektit) dhe i njëjti shkak (identiteti i shkakut).

a) Identiteti i palëve

Çdo gjyq zhvillohet midis personave të caktuar. Nga vendimi që jep gjykata në favor të njërës palë kundër palës tjetër, as nuk mund të përfitojnë dhe as nuk mund të dëmtohen të tretët, pra, gjëja e gjykuar është relative. Nga sa u tha më sipër, kuptohet se prapësimi i gjësë së gjykuar, me të cilën personat imponojnë respektin e fuqisë së gjësë së gjykuar, nuk mund të përdoret përveç personave që kanë qenë ndërgjyqës ose janë pasues (suksesorë) të palëve. Kur pasuesi është i veçantë, prapësimi i gjësë së gjykuar mund të paraqitet vetëm kur gjëja e gjykuar është më e vjetër nga data, në të cilën është transferuar mbi të e drejta që e bëri pasuesin të veçantë. Efekti relativ i gjësë së gjykuar do të thotë se gjëja e gjykuar midis ndërgjyqësve nuk u sjell as dëm dhe as dobi të tretëve.

b) Identiteti në objekt

Efekti i gjësë së gjykuar midis palëve duhet të përkufizohet vetëm mbi objektin e konfliktit, duke lënë palët të lira të gjykohen për të drejtat e tjera të tyre. Pra, për t'u bërë prapësimi i gjësë së gjykuar, objekti i të dyja padive duhet të jetë i njëjtë.

c) Identiteti i shkakut

Kur themi shkak, duhet të kuptojmë një fakt juridik që formon bazën e drejtpërdrejtë të së drejtës që pretendohet. Paditësi, në një padi të dytë, mund të kërkojë po atë gjë që kërkonte me padinë e mëparshme të rrëzuar, në qoftë se parashtron një fakt juridik të ndryshëm midis palëve.

7. Efekte të tjera të vendimeve

Res judicata nuk është efekti i vetëm i vendimeve. Rrjedhojë tjetër e rëndësishme është ekzekutimi i vendimeve. Në Itali, para reformës së vitit 1990, vendimi nuk mund të ekzekutohej para se të merrte formën e *res judicata* formal (formë të prerë). Po e njëjta rregull zbatohet edhe sot në sistemin procedural shqiptar (neni 510). Kjo çështje mund të trajtohet edhe duke iu referuar *Procedurës civile në Itali* (faqe 249-250).

hen në periudhën që ato u nënshtrohen apelimeve, ose gjatë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor në apel. Megjithatë, në rastet kur një vendim që i nënshtrohet procedurës apeluese, mbështetet mbi prova me fuqi të lartë provuese ose kur vonesat në ekzekutimin e tij mund të vënë në rrezik mundësinë e palës fituese për të realizuar plotësisht suksesin që ka arritur, në vendimin e saj gjykata mund të përfshijë një klauzolë që parashikon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit. Vendimet e gjykatave të apelit janë të ekzekutueshme menjëherë pas shpalljes së tyre. Gjithsesi, nëse vendimi i apelit kundërshtohet, ekzekutimi i tij mund të pezullohet.

Nëse gjykata e shkallës së parë nuk plotëson kërkesën e palës fituese për të përmendur në vendim edhe klauzolën për ekzekutimin e tij të menjëhershëm, ajo mund t'i kërkojë gjykatës së apelit shtimin e një klauzole të tillë para marrjes së vendimit për çështjet e tjera. Anasjelltas, nëse klauzola përfshihet në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, apeluesi mund të kërkojë nga gjykata e apelit ndryshimin e vendimit duke hequr këtë klauzolë para së të vendosë për çështjet e tjera".

Përveç efekteve *res judicata* dhe të ekzekutimit, vendimi gjyqësor mund të ketë edhe efekte dytësore. Një shembull i kësaj në sistemin ligjor italian janë efektet e vendimeve për urdhrat e ekzekutimit për vendosjen e sekuestros dhe kalimin e afateve (parashkrimi). Përsëri këtu mund t'i referohemi *Procedurës civile në Itali* (faqe 250-251):

"*Vendimet e sekuestros.* Lëshimi i vendimit që garanton ekzekutimin e detyrueshëm, vendos një sekuestro mbi pasuritë e paluajtshme të debitorit. Sekuestroja vendoset edhe nëse vendimi i nënshtrohet apelimit, pra duke qenë i pakzekutueshëm.

Kalimi i afateve (parashkrimi). Rregulla e përgjithshme e parashkrimit është dhjetë vjet. Megjithatë, ekzistojnë shumë padi që u nënshtrohen afateve më të shkurtra. Për shembull, shumica e padive për zhdëmtimet duhet të ngrihen brenda afatit prej pesë vjetësh dhe paditë për aksidentet automobilistike brenda afatit dyvjeçar. Sapo të jetë bërë ngritja e padisë, periudha e parashkrimit ndërpritet. Në rrethana të caktuara, si p.sh., në rastin e ndërprerjes së gjykimit të padisë, llogaritet një afat i ri që prej momentit të ndërprerjes së procedurave. Pavarësisht nga shkaku i ngritjes së padisë, një vendim për urdhrin e ekzekutimit i nënshtrohet rregullës së përgjithshme të afatit 10-vjeçar të parashkrimit".

8. Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat

Në botën tonë që po integrohet me shpejtësi, trajtimi i vendimeve gjyqësore nuk do të ishte i plotë nëse do të linim pa përmendur një çështje që po merr

rëndësi gjithmonë e më të madhe: përdorimi i materialeve të huaja ligjore. Kjo ndodh, për shembull, në rastin e zgjedhjes së normave ligjore, të cilat veprojnë kur ka konflikte të ligjeve[3] të ndryshme që mund të zbatohen për të njëjtën çështje. Për këtë çështje mund t'i referohemi *Së drejtës së huaj në mosmarrëveshjet civile* (Sofie Geeroms, Oxford, Oxford University Press, 2004, f. 1-2):

"Rregullat për konfliktin e ligjeve kërkojnë që, në rrethana të caktuara, çështjet ligjore me elemente ndërkombëtare të zgjidhen nga ligji i huaj. Edhe çështjet që nuk demonstrojnë ndonjë lidhje me modelin ligjor ndërkombëtar, mund t'i nënshtrohen ligjit të huaj në prani të një klauzole të shprehur në marrëveshje. Në të vërtetë, rregullat për konfliktin e ligjeve janë krejtësisht të pamjaftueshme nëse ato nuk arrijnë të adresojnë si duhet një zbatim të saktë dhe efektiv të ligjit të huaj përkatës. Po ashtu, autonomia e palëve për të strukturuar marrëdhënien e tyre ligjore është e pakuptimtë në mungesë të një regjimi të përshtatshëm për të garantuar zbatimin e dëshiruar të ligjit të huaj.

Pra, veprimi i rregullës së konfliktit të ligjeve, pavarësisht nga kuadri teorik që ofron arsyet se përse duhet të zbatohet ligji i huaj për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar, fiton ose dështon në varësi të trajtimit procedural që i bëhet atij. Rrjedhimisht, shumë tekse që flasin për konfliktin e ligjeve, i kushtojnë një kapitull ose një seksion të plotë fushës së veprimit të ligjit të huaj si dhe vlerësimit të tij. Pyetjet më të shpeshta që parashtrohen, lidhen me ndarjen e detyrave ndërmjet palëve dhe gjyqtarit: A janë palët subjektet që duhet të paraqesin dhe të provojnë ligjin e huaj? Cili është roli i gjyqtarit në këtë çështje? Cilat janë mjetet e lejimit të provave? Si mund të vlerësohet ligji i huaj? Zakonisht, ata e mbyllin kapitullin ose seksionin me diskutimin nëse gjykatat më të larta kanë të drejtë të rishikojnë zbatimin jo të duhur të ligjit të huaj dhe, nëse ndodh kështu, deri në çfarë mase.

Megjithatë, rëndësia e trajtimit procedural të ligjit të huaj shkon edhe më tej. Mënyra e trajtimit të ligjit të huaj në një gjykatë tregon nëse do të respektohen të drejtat që mund të gëzohen sipas një sistemi ligjor të huaj dhe të ndryshëm, çka përbën edhe gurin e themelit për pyetjen se deri në çfarë mase një sistem ligjor i caktuar do të toleronte idetë ligjore të një sistemi tjetër."

Një pyetje tjetër me mjaft rëndësi lidhet me "natyrën" e ligjit të huaj sipas gjykatave. Ligji i huaj mund të trajtohet edhe si çështje faktike, edhe si çështje ligjore. Tema është mjaft domethënëse nëse merret në konsideratë fakti se në traditën e sistemeve ligjore kontinentale palët kanë detyrimin e gjetjes së fakteve mbi të cilat do të mbështetin mbrojtjen, por, sipas parimit *iura novit curia*, jo të gjetjes së bazës ligjore. *E drejta e huaj në mosmarrëveshjet civile,* në faqet 221-223, na jep disa sqarime të mëtejshme:

"[...] të gjitha sistemet ligjore e trajtojnë në mënyrë disi ekuivoke ligjin e huaj, qoftë si çështje ligjore, qoftë si çështje faktike. Megjithatë, çdo sistem ligjor tregon haptas një prirje drejt njërit prej aspekteve të sipërpërmendura të ligjit të huaj. Kjo justifikon edhe përdorimin e dikotomisë (dyzimit) fakt/ligj në klasifikimin e secilit prej sistemeve, duke qenë përkrahës të njërit apo të tjetrit këndvështrim. Në varësi të karakterizimit faktik ose ligjor, një sistem ligjor e trajton ligjin e huaj nga aspekti i provave ose i procedurës civile. Nëse ligji i huaj karakterizohet si çështje faktike, ai nuk është nën kompetencën e gjykatës dhe duhet të përdoret ose të kërkohet nga palët. Më pas, palët duhet të provojnë përmbajtjen e tij sipas rregullave të provave. Nga ana tjetër, nëse ligji i huaj konsiderohet si çështje ligjore, atëherë janë gjykatat ato që luajnë rol më të rëndësishëm në prezantimin dhe vlerësimin e tij. Në varësi të mbizotërimit të aspektit faktik apo ligjor të ligjit të huaj, dallohen tri aspekte të ndryshme: aspekti faktik anglez, aspekti ligjor amerikan dhe aspekti i së drejtës kontinentale për ligjin e huaj.

Pavarësisht nga zhvillimet e kohëve të fundit drejt një aspekti ligjor, gjykatat angleze vazhdojnë ta trajtojnë ligjin e huaj si çështje faktike. Palët duhet ta paraqesin ligjin e huaj para gjykatës nëpërmjet një deklarate formale. Më tej, ato kanë edhe barrën e provës për përmbajtjen e tij, sipas rregullave formale të provave. Gjykatat refuzojnë ta marrin të mirëqenë ligjin e huaj, ndonëse këtë gjë e bëjnë për ligjet vendëse [...].

Të gjitha sistemet ligjore kontinentale të studiuara në këtë kapitull mund të konsiderohen se e trajtojnë ligjin e huaj si çështje ligjore. Kjo vlen sidomos për sistemet gjermane, holandeze dhe belge, të cilat i detyrojnë gjykatat ta paraqesin dhe ta vlerësojnë *ex officio* ligjin e huaj. Megjithëse gjykata franceze e kasacionit vazhdon t'u lërë palëve rol të rëndësishëm në paraqitjen e ligjit të huaj dhe një rol më pak të rëndësishëm sa i takon vlerësimit të tij, ajo e ka pranuar shprehimisht ligjin e huaj si çështje ligjore. Edhe në rastet kur të drejtat e përfshira në proces janë në dorë të palëve, gjykatat franceze e kanë autoritetin e nevojshëm për t'i ngritur *ex officio* çështjet e ligjit të huaj dhe për të vlerësuar përmbajtjen e tij. Po ashtu, gjykata franceze e kasacionit, sikurse edhe të gjitha sistemet e tjera kontinentale, favorizon zbatimin suplementar të së drejtës së brendshme, e cila është një zgjedhje e qartë e karakterit ligjor të doktrinës së konfliktit të ligjeve.

Përveç rregullave të konfliktit të ligjeve, ekzistojnë edhe raste të tjera kur gjykatat duhet të përdorin materiale të huaja ligjore, të cilat, në varësi të

3) *Ndryshime midis ligjeve të shteteve ose vendeve të ndryshme për një çështje,*

Grupi i parë trajton rastet që përfshijnë normat e brendshme ligjore, të cilat mund të zbatohen vetëm me ndihmën e ligjit të huaj. *Grupi i dytë* përfshin rastet në të cilat zbatimi i normave ligjore bëhet për çështje që kanë një element ndërkombëtar. *Grupi i tretë* përfshin rastet kur normat që duhet të zbatohen, janë tërësisht kombëtare dhe adresimi që mund t'i bëhet ligjit të huaj, është krejtësisht vullnetar.

Për të tria këto grupe, gjyqtarët mund të përfitojnë njohuri nga një vështrim krahasues që ilustrohet nga U. Drobnig:[4]

I. Krahasimi i domosdoshëm

Në kontekstin aktual të "matjes" së motivimit të gjykatave për t'i kushtuar rëndësi ligjit të huaj, grupi i parë nuk kërkon ndonjë vëmendje të veçantë. Referimi në ligjin e huaj dhe, në disa raste, krahasimi i vërtetë, është i pashmangshëm për zbatimin korrekt të normave që i përkasin këtij grupi.

Parimet e përgjithshme të së drejtës. Sipas disa dispozitave kushtetuese të këtyre vendeve, në Gjermani dhe në Greqi normat e pranuara gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare publike janë drejtpërdrejt të zbatueshme, madje ato kanë edhe përparësi mbi ligjet vendëse. Këto dispozita kushtetuese i përballin gjykatat me detyrën e identifikimit të 'normave të përgjithshme' përkatëse. Në Gjermani, kjo detyrë është monopol i Gjykatës Kushtetuese Federale, ndërsa në Greqi, ajo mund të bëhet nga çdo gjykatë, ndonëse çështje të tilla mund të sillen edhe para Gjykatës Supreme Speciale. Gjykata Kushtetuese Federale gjermane ka analizuar gjerësisht faktin nëse normat e pashkruara të së drejtës ndërkombëtare publike janë pranuar nga shumica e vendeve sipas mënyrave të tyre specifike; ajo ka kryer studime dhe krahasime gjithëpërfshirëse të qëndrimeve që janë mbajtur për normat përkatëse në pjesën më të madhe të shteteve të huaja. Në ndryshim nga Gjermania, raporti grek tregon se analizat e nevojshme krahasuese janë bërë shumë rrallë; pra, gjykatat thjesht pranojnë ose mohojnë karakterin e përgjithshëm të normës përkatëse të pashkruar të së drejtës ndërkombëtare, por pa bërë analiza krahasuese [...].

Një ilustrim disi i ndryshëm i lëvizjeve krahasuese që u referohen 'parimeve të përgjithshme të së drejtës' jepet nga fusha e së drejtës private në Brazil. Sipas një dispozite të shprehur, hapësirat në fushën e së drejtës private vendëse mund të plotësohen me 'analogji - përdorimi i parimeve të përgjithshme të së

4) ***(Përdorimi i së drejtës së krahasuar nga gjykatat,*** *në U. Drobning, S. Van Erp (ed.),* ***Përdorimi i së drejtës së krahasuar nga gjykatat,*** *Kluwer Law International,*

drejtës'. Këto parime të përgjithshme duhet të përcaktohen nga e drejta e krahasuar [...].

Shembuj nga konflikti i ligjeve. Për zbatimin korrekt të disa normave ligjore kërkohet një analizë krahasuese [...].

Një ilustrim i konfliktit të ligjeve mund të jepet nga problemi i njohur i krahasimit të normave dhe instituteve ligjore. Sipas pikëpamjes tradicionale dhe të pranuar gjerësisht, krahasimi i një instituti ose norme ligjore të huaj të panjohur për juridiksionin e shtetit, duhet të fillojë nga *lex fori (e drejta vendëse).* Megjithatë, ekziston një marrëveshje e gjerë, sipas së cilës kjo gjë duhet të paraprihet nga një përshkrim dhe vlerësim i normës ose institutit ligjor të huaj në përputhje me qëllimin dhe kuptimin e tyre. Në të vërtetë, është i nevojshëm një krahasim i normës ose institutit ligjor të huaj me institutin ose normën më të afërt të *lex fori.*

Klauzolat për interesin publik janë një ilustrim tjetër. Ato i kërkojnë gjyqtarit të krahasojë normën ligjore të huaj të zbatueshme sipas rregullave të zakonshme të konfliktit të ligjeve me parimet themelore të së drejtës së brendshme.

Ilustrimi i tretë: disa rregulla moderne për konfliktin e ligjeve parashikojnë shprehimisht krahasimin ndërmjet dy sistemeve ligjore dhe deklarojnë si të zbatueshëm sistemin që është më favorizues për një palë të caktuar. Si shembuj aktualë mund të shërbejnë dy dispozitat e konventës së shteteve anëtare të Bashkimit Europian "Për të drejtën e zbatueshme në marrëdhëniet kontraktore" (Konventa e Romës), e vitit 1980. Neni 5 mbron konsumatorin dhe neni 6 punëtorin, duke u garantuar të dyve mbrojtjen minimale të një sistemi ligjor, nëse klauzola për konfliktin e ligjeve nga palët do të bënte të zbatueshëm një sistem ligjor më pak të favorshëm.

II. Normat ligjore me elemente ndërkombëtare

Për këtë grup të dytë, krahasimi nuk është më një kërkesë e domosdoshme për zbatimin korrekt të një norme kombëtare, sikurse ishte në grupin e parë. Gjithsesi, përdorimi i metodës krahasuese mund të ishte i nevojshëm për shkak të larmisë së elementeve ndërkombëtare ose lidhjeve me vendet e tjera. Nëndarjet e mëposhtme janë bërë në varësi të shkallës së lidhjeve me vendet e tjera, sipas një rendi zbritës.

Normat ndërkombëtare uniforme. Një element i rëndësishëm ndërkombëtar, i cili u bashkëlidhet atyre normave të së drejtës së brendshme që mbështeten mbi marrëveshje ndërkombëtare që parashikojnë norma uniforme vetëvepruese në fusha të ndryshme të së drejtës ose në vetë këto instrumente ndërkombëtare.

nëse nuk janë detyrime ligjore, të cilat janë shprehur me disa formula që aktualisht përdoren në marrëveshjet ndërkombëtare me qëllim garantimin e njëtrajtshmërisë së dëshiruar të interpretimit nga të gjitha shtetet anëtare? Për shumë konventa, vendimet përkatëse të gjykatave kombëtare janë lehtësisht të pranueshme.

Po ashtu, mund të përmenden vendime të cilat, ndonëse jashtë fushës së këtij libri, ndikojnë në mënyrë të tërthortë. Shtetet që mbajnë një qëndrim të dyzuar lidhur me të drejtën ndërkombëtare publike, kanë nevojë për një rregull të veçantë interpretuese për të ruajtur sa të jetë e mundur pajtueshmërinë e rregullave kombëtare me marrëveshjet ndërkombëtare që nuk janë të detyrueshme për qytetarët. Ky qëndrim i përgjithshëm ndaj detyrimeve që lindin nga marrëveshjet, kufizon, megjithëse nuk përjashton plotësisht, predispozicionin dhe përpjekjet e gjykatave për interpretimin e njëtrajtshëm të tyre.

Një vullnet më i gjerë për të marrë në konsideratë qëndrimin dhe praktikën e shteteve të tjera kontraktuese në interpretimin e ligjit ndërkombëtar uniform mund të gjendet në Gjermani. Gjykata Supreme Federale është shprehur se interpretimi i normave uniforme ndërkombëtare duhet të synojë edhe një qëllim tjetër, përtej metodave tradicionale të interpretimit, d.m.th. të garantojë sa të jetë e mundur një interpretim të njëtrajtshëm nga të gjitha shtetet kontraktuese. Pra, interpretimi i normave duhet të jetë autonom, pasi referimet në kuptimin e nocioneve ligjore kombëtare do të vinin në rrezik njëtrajtshmërinë e normave, d.m.th. qëllimin kryesor të marrëveshjeve ndërkombëtare. Në rast se ka hezitime, një normë e ligjit uniform merr të njëjtin kuptim që i jepet normës korresponduese të vendit nga ka e ka prejardhjen norma uniforme. Më tej, nevoja për interpretime të njëtrajtshme do të përkrahte qëndrimin se formulimeve të dispozitave uniforme duhet t'u jepet më shumë rëndësi sesa u jepet zakonisht në procesin e interpretimit.

Dy vendime meritojnë vemendje të veçantë, pasi ato demonstrojnë nevojën dhe kufizimet e metodës krahasuese të interpretimit të ligjit uniform ndërkombëtar. Në nëntor 1956, Gjykata Supreme Federale duhet të vendoste mbi çështjen nëse duhej të shfuqizohej një prezumim i parashikuar nga ligji uniform i Gjenevës "Për kambialet" (titujt e kreditit), i vitit 1930, neni 31, paragrafi 4. Kjo çështje është shumë e diskutueshme për të gjitha shtetet kontraktore. Gjykata citoi vendime të ndryshme nga gjashtë shtete, ku të dyja qëndrimet ishin pothuajse të balancuara në numër. Midis vendimeve të citura, tri ishin marrë nga gjykatat franceze të apelit; Gjykata Supreme Federale mbështeti qëndrimin e tyre se prezumimi i parashikuar nga dispozita duhet të shfuqizohej. Por, dhjetë muaj më parë, gjykata franceze e kasacionit i kishte

hedhur poshtë këto vendime të gjykatave franceze të apelit dhe, 4 vjet më pas, një vendim në seancë plenare i gjykatës franceze të kasacionit konfirmoi këtë vendim, ndoshta duke mos ditur gjë për vendimin e ndryshëm të marrë nga shteti gjerman. Pas një periudhe prej afro dhjetë muajsh, Gjykata Supreme Federale e Gjermanisë konfirmoi vendimin e saj të vitit 1956, me sa duket pa pasur dijeni për vendimet franceze të kohëve të fundit. Ky rast tregon, si nevojën për një interpretim të normave uniforme ndërkombëtare duke përdorur ligjin e huaj, ashtu edhe problemin teknik të shkëmbimit të shpejtë të informacionit [...].

Norma që përdoren edhe nga vende të tjera. Ky seksion përfshin dy klasifikime të ndryshme të situatave, të cilat titulli nuk i shpreh njësoj. Klasifikimi i parë, të cilit i drejtohet edhe titulli, i referohet një grupi të përbashkët të normave të pashkruara, shembulli tipik i të cilit është sistemi common law anglo-amerikan. Dukuria ekuivalente në nivelin e kodifikimeve ose të legjislacionit është mirëpritja e një sistemi ligjor të huaj në tërësi ose e pjesës kryesore të tij; ose miratimi i plotë ose i pjesshëm i dispozitave individuale. Së pari, do të trajtohet situata specifike e së drejtës së pashkruar të common law dhe, më pas, legjislacioni i adoptuar.

Raporte [të ndryshme] nga vendet e së drejtës anglo-amerikane [...] theksojnë rolin e metodës krahasuese me shumicën e vendeve të tjera të common law. Trashëgimia e përbashkët e common law, sikurse kuptohej në Angli, ishte aq e fortë në Australi, saqë, deri në vitin 1970, mendohej se e drejta e pashkruar në fuqi ishte e drejta angleze, pasi kjo ishte e drejta e pranuar në Australi dhe Këshilli i Kurorës, si gjykata e fundit apeluese, ndodhej në Angli dhe përbëhej nga lordë të së drejtës angleze. [E drejta anglo-kanadeze] paraqet "vështirësi të madhe për të vendosur se cila pjesë e së drejtës është e huaj", pasi e drejta e common law nuk është as e lidhur dhe as e kufizuar me një shtet të vetëm. Vetëm gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit mund të vërehet një lloj shkëputjeje e së drejtës kanadeze dhe australiane nga e drejta angleze dhe njëra prej arsyeve ka qenë rritja e integrimit të së drejtës angleze në të drejtën europiane. Një tjetër arsye ka qenë shkalla më e lartë e mbrojtjes së konsumatorit në Australi dhe, së treti, legjislacioni më i pavarur. Megjithatë, uniteti dhe qëndrueshmëria e common law janë shumë më të fuqishme sesa disa prirje decentralizuese të saj [...].

Ekuivalenti më i afërt i së drejtës së pashkruar common law është e drejta e shkruar common law. Kjo situatë – e kombinuar me përmasat shumë të vogla të vendit – mund të gjendet në Luksemburg. Në këtë vend janë në fuqi pesë kodet më të mëdha franceze, ndonëse pa praninë e ndryshimeve dhe të rishikimeve të mëdha që kanë pësuar në Francë. Legjislacioni tjetër u ngjason

modeleve franceze ose belge. Duke qenë së në këtë shtet nuk ka fakultet të së drejtës, studentët e drejtësisë duhet të studiojnë jashtë shtetit dhe këtë gjë e bëjnë ose në Francë, ose në Belgjikë. Faktori i fundit është numri i ulët i vendimeve gjyqësore që merren nga gjykatat e Luksemburgut, të cilat rrallë publikohen.

Kombinimi i gjithë këtyre fakorëve të veçantë, në terma praktikë, nënkupton se shumë pak vendime gjyqësore nuk do të përmbanin referenca në ligjin e huaj, kryesisht në ligjet franceze, por edhe belge [...].

Kodi civil grek i vitit 1946 ka ndikim shumë të madh nga ligjet gjermane, franceze dhe zvicerane; në këtë mënyrë, këto sisteme ligjore përdoren edhe për interpretimin e Kodit. Burimi kryesor është e drejta gjermane, pasi ajo bëri kodifikimin e formës moderne të së drejtës romako – bizantine që ka sunduar në Greqi deri në vitin 1946. Kjo shfaqet shumë dukshëm aty ku teksti i dispozitave të Kodit grek është identik ose shumë i ngjashëm me dispozitat e huaja.

E drejta administrative që nuk u kodifikua, duhej të zhvillohej nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Shtetit, i cili në fillim ndoqi rigorozisht modelin e tij institucional, pra të Këshillit të Shtetit (*Conseil d'Etat) francez.*

Në Australi dhe Gjermani nuk ndodhin shpesh referenca të tilla të ngjashme në dispozitat (dhe jurisprudencën) e një vendi të huaj, të cilat mund të shërbejnë si model për një dispozitë të brendshme specifike. Në Australi, në shumicën e rasteve, referenca i drejtohet legjislacionit në fushën e rregullimit ekonomik dhe tregtar. Duke qenë se ky legjislacion shpesh është i modeluar në ligjet e Shteteve të Bashkuara, jurisprudenca amerikane që zbaton këto ligje, përdoret si një ndihmesë për interpretimin e ligjislacionit ekuivalent australian.

E drejta ajore dhe detare. E lidhur ngushtë me seksionin pararendës, e drejta ajrore dhe detare është një fushë me lidhje të huaja dhe ndërkombëtare relativisht të forta. Raportet gjermane vënë në pah pozitën mbizotëruese të së drejtës angleze në çështjet detare. Sipas raporteve italiane, e drejta ajrore dhe detare është e vetmja fushë ku gjykatat italiane citojnë legjislacionin e huaj, si dhe në çështjet 'ekuivalente', veçanërisht në interpretimin e disa klauzolave tipike kontraktore.

Konflikti i ligjeve. Në hartimin e rregullave të reja të konfliktit të ligjeve, Gjykata Supreme Federale gjermane u është referuar shpesh rregullave të huaja për konfliktin e ligjeve. Një prej arsyeve kryesore të kësaj prirjeje ndaj sistemeve të huaja ligjore është pa diskutim fakti se rregullat ligjore gjermane për konfliktin e ligjeve kanë shumë boshllëqe. Në krijimin e një rregulle për konfliktin e ligjeve që rregullojnë përplasjet e anijeve në ujërat territoriale, Gjykata Supreme

min, *inter alia (midis të tjerash),* se kjo rregull pranohet edhe në disa vende të tjera; pra, një vendim në favor të kësaj rregulle nxit njëtrajtshmërinë ndërkombëtare të praktikës gjyqësore në këtë fushë. Po e njëjta logjikë përdoret edhe në një vendim tjetër të Gjykatës Supreme Federale, në të cilin ajo shprehet se disa aksidente rrugore që ndodhin jashtë vendit, i nënshtrohen ligjit të rezidencës së përbashkët të shkaktarit të dëmit dhe shoferit të dëmtuar.

Me interes të veçantë është edhe një zbatim tjetër i metodës krahasuese, d.m.th specifikimi i dispozitës gjermane për interesin publik. Në shqyrtimin e çështjes nëse dispozita gjermane për interesin publik duhet të përdoret kundër zbatimit të ligjit të huaj, në një sërë rastesh, Gjykata Supreme Federale ka mbajtur një qëndrim të gjerë krahasues ndaj normave ligjore të zbatuara në vende të ndryshme. Gjykata është përpjekur të përcaktojë nëse norma e huaj në fjalë përbën një prej zgjidhjeve 'tipike' të zbatuara në skenën ndërkombëtare, ndonëse kjo ide ka qenë e panjohur për Gjermaninë. Në pjesën më të madhe të rasteve, një studim i tillë krahasues ka shmangur injorimin e normave ndërkombëtare që vijnë në kundërshtim me dispozitën gjermane për interesin publik.

III. Normat ligjore me natyrë krejtësisht kombëtare

Grupi më interesant i këtyre rasteve ka të bëjë me normat ligjore me natyrë krejtësisht kombëtare [...]. Shpeshherë, e drejta e krahasuar përdoret, qoftë për shfuqizimin e normave kombëtare ekzistuese, qoftë për të plotësuar boshllëqet ligjore, megjithëse ndonjëherë thjesht për qëllime dekorative. Shfuqizimi i normave ekzistuese të shkruara mund të ilustrohet nga një çështje australiane dhe nga një numër çështjesh gjermane.

Çështja australiane *Mabo* përkrah një shfuqizim veçanërisht të gjerë të një norme të qëndrueshme të së drejtës common law. Vendimi i Gjykatës së Lartë të Australisë (1992) njohu të drejtat e tokës të popullsisë para kolonizimit të vendit, të cilat, sipas doktrinës së common law për *terra nullius,* ishin mohuar për më shumë se dy shekuj. Mbështetur në një përmbledhje prej 14 rastesh të huaja, *inter alia,* një opinion i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (në çështjen e *Western Sahara* të vitit 1975), Gjykata e Lartë e solli të drejtën common law në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e së drejtës së huaj dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Në tri vendime gjermane, metoda krahasuese është përdorur për të justifikuar një devijim nga formulimi i qartë ligjor i Kodit civil gjerman (§ 253), i cili përjashton kompensimin e përgjithshëm të dëmeve morale. Në një vendim të mëparshëm, në të cilin Gjykata Supreme Federale e kishte injoruar

saj duke iu referuar shkurtimisht ligjeve zviccrane. Pak kohë pas kësaj, Gjykata përdori një arsyetim më gjithëpërfshirës për referimin e saj në ligjin e huaj në një çështje në të cilën pala e paditur, një botues gazete, argumentonte se vendimi i mëparshëm vinte në rrezik lirinë e shtypit: "... në pothuajse të gjitha sistemet ligjore në të cilat vlerat e individit kanë një pozicion të rëndësishëm, sikurse edhe në sistemin tonë, kompensimi i dëmit moral pranohet si sanksioni i duhur i së drejtës private për cenimin e jetës private".

Plotësimi i boshllëkut ligjor me ndihmën e së drejtës së krahasuar mund të demonstrohet vetëm me dy shembuj të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Në të dy këta shembuj, një fëmijë pretendonte për një rregullim të ri të dëmeve, kryesisht për 'jetën e tij të padrejtë'. Gjykata Surpreme Federale gjermane jo vetëm përdori këtë term ligjor amerikan, por mori në shqyrtim edhe vendime angleze dhe amerikane për këtë çështje, shumica e të cilave e hidhnin poshtë një pretendim të tillë. Gjykata Supreme Federale arriti në të njëjtin përfundim, nën ndikimin e dukshëm të jurisprudencës së huaj. Një çështje e ngjashme në Izrael u vendos në po të njëjtën mënyrë, duke u mbështetur fuqimisht në çështjet angleze dhe amerikane".

Pra, deri tani janë përshkruar shkurtimisht rastet në të cilat gjykatat përdorin materiale të huaja ligjore dhe metodën krahasuese. Le të shohim tani më nga afër mënyrat praktike që përdorin gjykatat në referimet e tyre në ligjin e huaj. Për këtë çështje, mund t'i adresohemi përsëri librit: *Përdorimi i së drejtës së krahasuar nga gjykatat* (f. 17-19):

"Një çështje fillestare me shumë rëndësi është nëse gjykatat do ta drejtojnë vëmendjen e tyre vetëm te përmbajtja e normës së huaj apo nëse ato do të marrin në konsideratë edhe efektet e saj (qoftë edhe vetëm efektet). Nga sa duket, gjykatat përqendrohen kryesisht te përmbajtja e normës së huaj.

Gjithsesi, disa përjashtime nga kjo prirje e përgjithshme mund të gjenden në vendimet e Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane. Në dy raste janë marrë ekskluzivisht në konsideratë vetëm efektet e një dispozite ligjore të huaj. Të dyja këto raste kishin të bënin me kushtetutshmërinë e ligjeve gjermane. Gjykata mori përsipër vlerësimin e pasojave të vendimeve, duke deklaruar ligjet përkatëse si antikushtetuese, pasi mori në shqyrtim situatën ligjore të atyre vendeve që kishin adoptuar një zgjidhje të ndryshme ligjore. Po ashtu, një vendim i kohëve të fundit [...] bëri një referim më të përgjithshëm për t'u njohur me zgjidhjet e ndryshme ligjore të përdorura nga vende të tjera; gjithsesi, gjykata shprehu disa rezerva, pasi rëndësia e përvojave të tilla kufizohej nga 'shkalla e papërcaktuar e krahasueshmërisë së rrethanave'.

Ndikimi i zgjidhjeve të huaja është gjithmonë i kufizuar. Të gjitha raportet

një normë ligjore të huaj. Një referim në ligjin e huaj e pasuron, por mbetet gjithmonë element suplementar në arsyetimin e vendimit të gjykatës. Madje, raporti italian e redukton ndikimin e referencave të tilla në një 'funksion thjesht dekorativ'.

Por, edhe brenda këtyre kufizimeve, është e vështirë arritja e përfundimeve të përgjithshme lidhur me ndikimin relativ të ligjit të huaj. Referimet në materiale të huaja ligjore shpeshherë janë tepër të shkurtra. Nëse gjykatat citojnë vendime të huaja, në pjesën më të madhe të rasteve, ato përshkruajnë vetëm përfundimet dhe rrallë arsyetimet e këtyre vendimeve. Pra, gjykatat veprojnë në mënyrë pragmatiste dhe shmangin sa munden situatën e krahasimit akademik të ligjeve.

Në rastet kur bëhet krahasimi i normave ligjore me element ndërkombëtar, shpesh ky i fundit do të tregojë vendet që ofrojnë vetveten për krahasime të dobishme. Në raste të tjera, përzgjedhja e vendeve ndryshon gjerësisht dhe ndonjëherë duket se është aksidentale. Shpesh, gjykata përmend vetëm një zgjidhje të huaj ligjore, pa treguar kriterin e përdorur për zgjedhjen e këtij sistemi ligjor specifik. Ndonjëherë bëhet një shikim i përgjithshëm mbi më shumë se një zgjidhje ligjore të huaj në bazë të njësive politike ose gjeografike, i cili përsëri është shumë i thjeshtë.

Zgjidhjet e shpërndara gjeografikisht do të kenë ndikim më të madh sesa të tjerat. Kjo ndoshta është edhe arsyeja përse Gjykata Kushtetuese e Italisë dhe ajo e Gjermanisë parapëlqejnë t'u referohen grupeve të veçanta të shteteve, p.sh., demokracive liberale ose perëndimore, njerëzve me trashëgimi kulturore të përbashkët apo vendeve të Europës Perëndimore.

Për fat të keq, nuk mund të thuhet dot nëse zgjedhja e vendeve që përdoren për krahasim, përcaktohet ose kufizohet nga problemet praktike të aksesit të informacionit. Disa raporte duket se nënkuptojnë përdorimin e referimeve nga vende që janë më të zhvilluara në fusha të caktuara".

9. Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat shqiptare

Sipas nenit 220 të Kodit të procedurës civile, në rast se për gjykimin e një çështjeje është e nevojshme të zbatohen ligjet e një shteti tjetër, gjykata duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i gjetur dhe për t'i zbatuar ato sipas përmbajtjes së tyre.

Kur çdo përpjekje e gjykatës, sipas paragrafit të mësipërm, është e pasuksesshme dhe asnjë nga palët nuk ka mundur t'i sigurojë gjykatës dispozitat e kërkuara, të vërtetuara nga organi kompetent i shtetit tjetër, gjykata vendos

Nga zbërthimi i përmbajtjes së këtij neni rezulton se ligjvënësi shqiptar nuk ka parashikuar një ndarje të qartë të detyrave të gjyqtarit dhe të palëve lidhur me zbatimin e ligjit të huaj. Paragrafi i parë tregon haptas prirjen drejt trajtimit të ligjit të huaj si një çështje ligjore dhe është vetë gjykata që luan rolin e gjetjes, të prezantimit dhe të vlerësimit të ligjit të huaj ex officio. Në të njëjtën kohë, paragrafi i dytë e trajton ligjin e huaj edhe si çështje fakti, sipas të cilit palët duhet të provojnë përmbajtjen e tij sipas rregullave të provave. Por, kur përpjekjet e gjykatës për të paraqitur dhe për të vlerësuar ligjin e huaj ex officio, si dhe përpjekjet e palëve për ta paraqitur dhe për ta provuar përmbajtjen e ligjit të huaj sipas rregullave formale të provave kanë qenë të pasuksesshme, gjykata favorizon zbatimin e së drejtës së brendshme.

Pra, rregullimi ligjor është ekuivok duke e trajtuar çështjen e ligjit të huaj, qoftë si çështje ligjore, qoftë si çështje faktike.

Në këtë aspekt vlen t'i referohemi praktikës së Gjykatës Kushtetuese shqiptare e cila, në raste të veçanta, për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ka provuar të zbatojë në mënyrë të drejtpërdrejtë rregullat e gjithëpranuara ndërkombëtare.

Në vendimin nr.13, datë 12.7.2004, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në çështjen me objekt: *"Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.1, datë 30.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; nr.413, datë 20.3.2003, të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë; nr.461, datë 10.9.2003; të gjykatës së apelit Tiranë dhe nr.56, datë 30.1.2004, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Mosnjohja e vendimeve penale nr.6/01 e nr.30/09, datë 2.2.2001, të gjykatës së parë penale të apelit, të Milanos, Itali"*, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar:

"Kërkuesi [...] është dënuar nga gjykata e apelit e Milanos, Itali, me burgim të përjetshëm për veprat penale të vrasjes me dashje dhe të armëmbajtjes pa leje. Gjykimi i tij ishte zhvilluar në mungesë dhe, meqë autoritetet italiane kishin të dhëna se ai ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë, ato kanë kërkuar njohjen e këtij vendimi penal nga autoritetet shqiptare. Ministria e Drejtësisë e Italisë i ka përcjellë dokumentacionin e nevojshëm Ministrisë së Drejtësisë të Shqipërisë dhe kjo e fundit Prokurorisë së Përgjithshme, e cila, në bazë të nenit 512/1 të Kodit të procedurës penale , ka kërkuar në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë njohjen e vendimit penal të huaj.

Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.555, datë 20.6.2002, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit.

Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit Tiranë, me vendimin nr.384, datë 24.7.2002. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1, datë 30.1.2003, kanë prishur dy vendimet e mësipërme dhe e kanë kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Kjo

e fundit, me vendimin nr.413, datë 20.5.2003, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe ka bërë konvertimin e dënimit duke e dënuar kërkuesin me burgim të përjetshëm. Gjykata e apelit, Tiranë, me vendimin nr.461, datë 10.9.2003, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.56, datë 30.1.2003, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Kërkuesi, [...] i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të vendimeve të tjera të mëpasshme për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar shkaqet e ngritura në kërkesë, në lidhje me vendimet e gjykatave, çmon se ato nuk janë të tilla që ta bëjnë procesin e parregullt në kuptimin kushtetues.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë tejkaluar funksionin dhe kompetencat e tyre dhe as kanë marrë funksione të Gjykatës Kushtetuese. Nga arsyetimi i vendimit del se Kolegjet e Bashkuara nuk janë shprehur për papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe as kanë bërë interpretim përfundimtar të normave të Kushtetutës. Duke cituar dispozitat kushtetuese mbi raportin midis marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjit të brendshëm, ato kanë pohuar zbatimin e marrëveshjeve në rast papajtueshmërie midis tyre. Ky pohim nuk është interpretim i dispozitave kushtetuese dhe as ndërhyrje në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë brenda juridiksionit të tyre edhe në rast se do të bënin interpretim të Kushtetutës, sepse një gjë e tillë është e drejtë e gjykatës në çdo shkallë të gjykimit si dhe e çdo organi që e zbaton Kushtetutën në veprimtarinë vendimmarrëse e më gjerë. Fakti që interpretimi bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pra nga organi më i lartë i sistemit gjyqësor, nuk do të thotë se ai është përfundimtar, sepse, për një interpretim të tillë, në bazë të nenit 124/1 të Kushtetutës, kompetente është vetëm Gjykata Kushtetuese.

Në këto rrethana që paraqitet çështja, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin e tyre, kanë bërë interpretim të dispozitave të Kodit të procedurës penale, veçanërisht të neneve 512-518. Duke interpretuar dispozitat përkatëse ligjore, ato arrijnë në përfundimin si duhen kuptuar ekstradimi, ekzekutimi i një vendimi penal të huaj dhe transferimi i të dënuarve.

Mbi bazën e këtij interpretimi dhe krahasimi të dispozitave përkatëse, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë se kemi të bëjmë me dy forma të njohjes së një vendimi penal të huaj: a) me konvertimin e dënimit penal të dhënë nga një gjykatë e huaj kundër një shtetasi shqiptar që është

duke e vuajtur dënimin në shtetin e huaj, kur ky i dënuar ka kërkuar vetë që ta vuajë ose të vazhdojë ta vuajë dënimin e dhënë në shtetin e tij dhe b) me njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të dhënë nga një gjykatë e huaj kundër një shtetasi shqiptar (ose edhe një shtetasi të huaj ose personi pa shtetësi) që, në momentin e dhënë, ndodhet me banim në Shqipëri.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me të drejtë theksojnë se, në rastin e parë, pëlqimi i personit të dënuar është i domosdoshëm dhe përbën kusht *sine qua non* për transferimin e tij në shtetin e origjinës, në pajtim me nenin 3/d të konventës europiane "Për transferimin e personave të dënuar", ndërsa, në rastin e dytë, njohja dhe zbatimi i vendimit penal të huaj me pëlqimin e personit të dënuar do të ishte absurditet.

Kërkuesi pretendon se gjykatat shqiptare nuk duhej ta kishin njohur vendimin e huaj edhe për një shkak tjetër, për mungesë të marrëveshjes dypalëshe të nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë si dhe për faktin se kjo e fundit nuk është palë në konventën europiane "Për vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale". Lidhur me këtë pretendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen në vendim se: ***"në mungesë të instrumenteve juridike të nënshkruara e të ratifikuara, normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen edhe sipas parimit të vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit"***. Gjithashtu, në këtë vendim theksohet se marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja janë në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka diskrecionin e plotë, si shprehje e një vullneti politik të shtetit shqiptar, që të procedojë për të kërkuar njohjen e një vendimi penal të huaj.

Gjykata Kushtetuese çmon se argumentet e përmendura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe konventat. Njohja e ndërsjellë e vendimeve gjyqësore i shërben qëllimit për forcimin e bashkëpunimit juridik midis shteteve për arritjen e objektivave të caktuar për lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Parimi i reciprocitetit presupozon zbatimin e mjeteve ligjore të ndërsjella në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare, reciprocitet do të thotë e drejta për barazi dhe respekt të ndërsjellë midis shteteve. Kështu, në bashkëpunim në fushën penale, doktrina dhe praktika ndërkombëtare kanë konfirmuar që bashkëpunimi i shteteve mund të bëhet edhe në mungesë të traktateve dypalëshe, bazuar në parimin e reciprocitetit.

Parimi i reciprocitetit, si rregull, zbatohet nëpërmjet instrumenteve ndërkombëtare, si traktatet dhe marrëveshjet, në të cilat, parashikohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella. Por, në raste të veçanta, në mungesë të këtyre marrëveshjeve, shtetet nuk pengohen të zbatojnë drejtpërdrejt parimin e

reciprocitetit, normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe vullnetin e mirë në rastet që u paraqiten. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit mes shteteve, në luftë kundër krimit të organizuar dhe të kriminalitetit në përgjithësi.

Gjykata Kushtetuese konstaton se interpretimet që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u kanë bërë dispozitave të Kodit të procedurës penale e konkretisht neneve 512 e 514 të tij, nuk janë antikushtetuese, duke arritur kështu në përfundimin se nuk ka përplasje (kolizion) mes tyre dhe dispozitave korresponduese të konventave ndërkombëtare dhe se ato duhet të zbatohen sipas kuptimit që kanë dhe interpretimit të bërë me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara.

Sipas nenit 512 të Kodit të procedurës penale, Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efektet e tjera në shtetin shqiptar. Nga formulimi i këtij paragrafi, me shprehjen: "...edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje...", lihet të kuptohet që, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kërkesa për njohjen e vendimit të huaj bëhet edhe kur nuk ekziston ndonjë marrëveshje, pra në bazë të vullnetit të mirë, normave të gjithëpranuara dhe parimit të reciprocitetit.

Pranimi nga gjykatat i kërkesës së prokurorit për njohjen e vendimit penal të huaj edhe në kushtet kur nuk ka marrëveshje të veçantë për këtë qëllim, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me konventat ndërkombëtare.

Pretendimi i kërkuesit për proces të parregullt nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që nuk e kaloi çështjen në seancë kur shkaqet e ngritura në rekurs ishin reale e ligjore, nuk qëndron për faktin se çështja është kthyer për rigjykim nga Kolegjet e Bashkuara dhe është zgjidhur në përshtatje me vendimin e tyre njësues, i cili është i detyrueshëm për shkallët më të ulëta të gjykimit, përfshi edhe Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë. Ky i fundit, duke shqyrtuar çështjen brenda kompetencave që i njeh ligji në dhomën e këshillimit, ka konstatuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të procedurës penale, përderisa ato janë shqyrtuar më parë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe u është dhënë përgjigje.

Vlerësime të tilla nuk përbëjnë objekt të kontrollit nga Gjykata Kushtetuese, sepse "kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete" (vendimi nr.95, datë 27.7.2001, i Gjykatës Kushtetuese).

Për sa i përket pretendimit tjetër për pavlefshmëri të vendimit të gjykatës së apelit për ekzistencën e dy vendimeve me të njëjtën përmbajtje, por me

ndryshim të kryesuesit të seancës, nuk qëndron. Në dosje ndodhet vendimi që përputhet me procesverbalin e seancës, sipas të cilit vendimi është dhënë nga ai trup gjykues që ka shqyrtuar çështjen. Në këto rrethana, gjykimi në apel nuk mund të konsiderohet i parregullt.

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se edhe gjykimi në shkallë të parë ka qenë i parregullt, duke u gjykuar çështja me trup gjykues me tre gjyqtarë, kur në bazë të ligjit duhej me një gjyqtar të vetëm. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese konstaton se çështja në ngarkim të kërkuesit [...] është shqyrtuar në seancë, më datën 11.6.2002, në një kohë kur, sipas nenit 13 të Kodit të procedurës penale, gjykimi bëhej me trup gjykues me tre gjyqtarë. Me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, neni 13 i Kodit të procedurës penale pësoi ndryshime duke u përcaktuar se gjykohen nga një gjyqtar kërkesat për marrëdhënie juridiksionale me autoritetet e huaja. Në këto kushte, me qenë se në kohën e gjykimit të çështjes në shkallë të parë ligji procedural ishte ndryshuar, gjykimi i saj me trup gjykues me tre gjyqtarë, ndonëse përbën shkelje, nuk është i tillë që ta bëjë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e ngritura në kërkesë nuk janë të bazuara dhe ajo duhet të rrëzohet, sepse nga gjykatat nuk ka shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. (...)

10. Struktura e vendimit dhe roli i gjyqtarit

Juristët e së drejtës së krahasuar kanë nxjerrë në pah një lidhje të ngushtë midis strukturës së vendimit dhe rolit të gjyqtarit, krahasuar me pushtetet e tjera shtetërore në një sistem ligjor të caktuar. Sigurisht, kjo lidhje nuk shkakton ndonjë habi. Vendimi nuk është gjë tjetër veçse 'zëri' i gjykatës, mënyra si shpreh ajo autoritetin e saj dhe duket krejt e natyrshme që një gjykatë me kompetenca të larta në vendimmarrje ta shprehë vullnetin e saj në mënyrë të ndryshme nga një gjykate, kompetencat e së cilës janë kufizuar historikisht nga ligjvënësi.

Ky koncept mund të qartësohet nëpërmjet krahasimit midis llojit francez dhe anglez të vendimeve. Mund t'i referohemi këtu *Hyrjes në të drejtën e krahasuar (*K. Zweigert dhe H. Kötz)[5] :

5) K. Zweigert dhe H. Kötz, ***Hyrje në të drejtën e krahasuar****, Oxford, Clarendon Press, 1993, faqe 126-127:*

"Përmbajtja, struktura dhe frazeologjia e vendimeve të gjykatës së kasacionit dhe, në një shkallë më të vogël, e vendimeve të gjykatave më të ulëta, janë tepër karakteristike për stilin e veçantë të mendimit ligjor francez. Parë nga një vështrim i jashtëm, çdo vendim i një gjykate franceze përbëhet nga një fjali e vetme, e cila, në rastin e gjykatës së kasacionit, artikulon ose 'Gjykata ... rrëzon (kërkesën për kasacionin)', ose 'Gjykata ... shfuqizon (vendimin e atakuar) dhe e dërgon çështjen në gjykatën e ...' Të gjitha arsyet për marrjen e vendimit duhet të gjenden midis kryefjalës dhe kallëzuesit të kësaj fjalie, në formën e një serie fjalish të nënrenditura, të cilat fillojnë të gjitha me formulën 'ndërsa/por'. Nuk ka ndonjë seksion të veçantë që t'u kushtohet fakteve të çështjes ose të historisë së mosmarrëveshjes dhe, me të vërtetë, faktet referohen vetëm nëse janë të nevojshme për të sqaruar arsyet specifike mbi të cilat vihet në lëvizje kasacioni, arsyetimin e gjykatës më të ulët ose qëndrimin e veçantë të gjykatës së kasacionit, madje, edhe në këtë rast, referenca mund të jetë shumë e nënkuptueshme. Po ashtu, veçanërisht në gjykatën e kasacionit, bëhet çdo përpjekje për ta bërë tekstin e vendimit sa më të ngjeshur që të jetë e mundur. Mendimet e pakicës shmangen dhe, nëse një vendim shfuqizohet për një arsye, arsyet e tjera as që merren në shqyrtim.

Stili i vendimeve angleze është diametralisht i kundërt. Vendimet e gjykatave angleze, veçanërisht ato të Dhomës së Lordëve, janë shumë të vëllimshme, duke i kushtuar shumë rëndësi parashtrimit të fakteve; argumentimi ligjor është i zgjeruar dhe mendimet e pakicës janë të lejueshme. Edhe gjuha është krejtësisht e ndryshme: ndërsa gjykata franceze e kasacionit përdor një gjuhë tejet burokratike, vendimet më të mira të Dhomës së Lordëve konsiderohen si copëza të letërsisë angleze.

Ndryshimi i konsiderueshëm midis dy anëve të Kanalit mund të shpjegohet nëpërmjet analizës historike të roleve të ndryshme të gjyqtarëve në të dyja vendet. Gjyqtarët anglezë janë protagonistët e padiskututeshëm të sistemeve të tyre ligjore, duke pasur një kompetencë të gjerë vendimmarrëse. Në fakt, gjyqtarët anglezë janë krijuesit e vërtetë të common law dhe vendimet e tyre janë të detyrueshme për shkak të rregullës *stare decisis*, për gjykatat e të njëjtit nivel ose për gjykatat e niveleve më të ulëta. Historia e gjyqtarëve francezë është krejtësisht e ndryshme. Pas Revolucionit, Republika e re shfaqi një mosbesim të hapur ndaj gjyqtarëve, i cili lidhej ngushtë me regjimin që kishte rënë. Nga ky këndvështrim, historia e gjykatës së kasacionit ka rëndësi të veçantë. Nga K. Zweigert dhe H. Kötz, *Hyrje në të drejtën e krahasuar* (Oxford, Clarendon Press, 1993, faqe 124):

"Gjykata e Kasacionit u krijua nga legjislacioni i Revolucionit Francez. Sipas emërtesës së saj origjinale 'Tribunal de Cassation' (Tribunali i Kasacionit),

funksioni i saj fillestar ishte më shumë ndihma për ligjvënësin sesa veprimtaria e saj si gjykatë; detyra e saj ishte të kontrollonte gjykatat të mos devijonin nga teksti i ligjeve dhe të mos ndikonin mbi kompetencat e legjislativit. Në ato kohë, edhe interpretimi i një ligji konsiderohej si 'devijim' nga teksti i tij, sikurse edhe plotësimi gjyqësor i ligjit të paplotë. Kjo ndodhte për arsye se gjykatat provinciale të regjimit të vjetër – 'parlamentet' – kishin përdorur shpesh interpretimin si mjet për të anashkaluar ose për të kufizuar ligjet reformuese të mbretit. Po ashtu, kompetenca e gjyqtarëve për interpretimin e ligjeve dukej se vinte në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve; prandaj, gjykatat lejoheshin t'i referonin para legjislaturës çështjet e dyshimta të interpretimit të ligjeve – 'referimi fakultativ'. Fakti se Tribunali i Kasacionit ka qenë fillimisht jashtë sistemit të gjykatave ka sjellë dy pasoja: *së pari,* ai mund të shfuqizonte vendimet e gjykatave, pa i zëvendësuar ato me vendimet e tij për themelin e çështjes; *së dyti,* vendimet e Tribunalit nuk ishin të detyrueshme për gjykatat, pra ato mund ta zgjidhnin çështjen që rikthehej për shqyrtim ekzaktësisht si herën e parë; nëse edhe ky vendim i dytë kundërshtohej, Tribunali i Kasacionit ishte i detyruar ta parashtronte çështjen në fjalë para legjislaturës për një zgjidhje përfundimtare – 'referimi i detyruar'.

Fragmenti i mësipërm tregon mosbesimin e madh që ndiente qeveria revolucionare për gjykatat dhe mundësinë e tyre për të shmangur direktivat e legjislaturës. Ideologjia revolucionare donte që gjyqtarët të ishin thjesht 'goja e ligjit'. Parë nga ky këndvështrim, është e kuptueshme se edhe në ditët e sotme gjyqtarët francezë duan të krijojnë përshtypjen se vendimet e tyre vijnë thjesht nga zgjidhja e çështjes sipas normës ligjore, pa asnjë interpretim.

Kjo do të thotë se në Francë pasiviteti i rolit të gjyqtarit është më shumë fasadë, sesa fakt i vërtetë. Në praktikë, koncepti 'goja e ligjit' është zbutur së tepërmi dhe tani pranohet gjerësisht fakti se gjyqtarët francezë kanë dhënë një ndihmesë të madhe në bërjen e ligjeve në fusha të rëndësishme ligjore, si kompensimi i dëmeve, i rregulluar nga Kodi civil me vetëm 5 nene.

c – ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Materiali i paraqitur në seksionin B ka përshkruar në mënyrë krahasuese tiparet kryesore të vendimeve gjyqësore në një sërë sistemesh ligjore, disa prej të cilave kanë një strukturë tepër të ngjashme me sistemin shqiptar.

Megjithatë, disa prej çështjeve të analizuara më sipër varen shumë nga

veçantitë dhe tiparet dalluese të secilit kuadër ligjor. Shumë prej tyre varen nga roli i gjyqtarit në një sistem të caktuar dhe nga kultura ligjore e çdo vendi. Më tej, shumë prej aspekteve të përshkruara në seksionin e mëparshëm, si për shembull përdorimi i materialeve të huaja ligjore, ndryshojnë dhe evoluojnë në mënyrë dinamike.

Pra, një ushtrim i dobishëm do të ishte identifikimi i karakteristikave të vendimeve gjyqësore shqiptare për të nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet me sistemet e tjera procedurale.

Dhënia e vendimeve

1) Disa prej dispozitave të Kodit civil shqiptar që trajtojnë dhënien e vendimeve, janë shprehje e parimeve të përgjithshme që janë paraqitur edhe në kapitujt e mëparshëm. A mund t'i identifikoni këto parime?

2) Detyrimi i gjykatës për t'i ngarkuar njërës prej palëve pjesëmarrëse në proces shpenzimet gjyqësore ka si qëllim suksesin e plotë të palës fituese. Megjithatë, dispozitat për shpenzimet gjyqësore kanë edhe një funksion procedural më pak të dukshëm. A mund ta përshkruani këtë funksion dhe të identifikoni dispozitat e Kodit shqiptar të procedurës civile, që lidhen me të?

Llojet e vendimeve

1) Një dallim mjaft i rëndësishëm në Kodin shqiptar të procedurës civile i ndan vendimet në përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme. A mund të jepni të paktën tre shembuj, përkatësisht të vendimeve jopërfundimtare dhe të ndërmjetme?

2) Sikurse kemi parë edhe në seksionin B, tradita e së drejtës kontinentale bën një ndarje midis tri llojeve të vendimeve përfundimtare. A është ky dallim i zbatueshëm edhe në sistemin procedural shqiptar? A mund të jepni një shembull për secilin prej llojeve të vendimeve?

Efektet e vendimeve

1) A përshtatet koncepti i *res judicata* në sistemin ligjor shqiptar? Cilat janë dispozitat që e shprehin këtë koncept?

2) Përveç efektit *res judicata*, vendimet kanë edhe efekte të tjera të rëndësishme. A mund t'i përshkruani këto efekte duke iu referuar sistemit ligjor shqiptar?

Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat

1) Sikurse është shpjeguar edhe në seksionin e mëparshëm, një çështje mjaft e rëndësishme është natyra ligjore ose faktike e ligjit të huaj kur ai zbatohet nga gjykatat në bazë të rregullës së zgjedhjes së ligjeve. Kemi parë se përgjigjja varion sipas sistemeve të ndryshme ligjore. Përpiquni të shpjegoni pasojat që mund të vijnë si rezultat i zgjedhjes së një ligji në sistemin ligjor shqiptar.

2) Cili është statusi i parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare në Shqipëri? A është kjo e drejtë drejtpërdrejt e zbatueshme? A ekziston ndonjë dispozitë kushtetuese për këtë çështje?

Struktura e vendimeve dhe roli i gjyqtarit

1) Sipas nenit 307 të Kodit shqiptar të procedurës civile, mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë duhet t'i bashkëlidhet vendimit. Si duhet të kuptohet roli i gjyqtarit sipas kësaj dispozite?

d - LEXIME PLOTESUESE DHE BIBLIOGRAFI

AA.VV. *Civil Jurisdiction and Judgments in Europe (Juridiksioni dhe vendimet civile në Europë)*, London, Butterworths, 1992.

Schlesinger R.B., *Comparative Law (E drejta e krahasuar)*, 6.a ed. New York, Foundation Press, 1998.

Taruffo M., *La motivazione della sentenza civile (Arsyetimi i vendimit civil)*, Padova, Cedam, 1975.

Vacca L. (a cura di), *Lo stile delle sentenze e l'utilizzazione dei precedenti (Llojet e vendimeve dhe përdorimi i precedentit)* : Torino, Giappichelli, 2000.

V.Varano-V.Barsotti, *La tradizione giuridica occidentale (Tradita juridike perëndimore)*, Torino, Giappichelli, 2003.

e - FJALORI TERMINOLOGJIK

Res judicata = Autoriteti që i jepet një akti të caktuar gjyqësor, duke krijuar mundësinë e ekzekutimit të detyruar të së drejtës së vendosur në vendim dhe

duke penguar mundësinë që e njëjta çështje të sillet përsëri para gjykatës.

Vendimi deklarativ/vendimi "konstituiv" = Një vendim "deklarativ" ka për qëllim njohjen (deklarimin) e të drejtave të palëve kur procesi gjyqësor është hapur. Në sistemet kontinentale, vendimet, të cilat në vend që të njohin një situatë ligjore paraekzistuese, krijojnë një situatë të re, quhen vendime "konstituive".

Arsyetimi = Baza racionale për arsyetimin e vendimit e zhvilluar nga palët në konkluzionet e tyre dhe nga gjyqtarët në vendimet e tyre.

f - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Materialet e huaja, veçanërisht vendimet e gjykatave, duhet të përdoren me kujdes gjatë hartimit të vendimit dhe gjithmonë pasi të jenë marrë njohuritë bazë për sistemin ligjor nga vijnë ato.

Përdorimi i materialeve të huaja ligjore nga gjykatat

1) Sikurse është shpjeguar edhe në seksionin e mëparshëm, një çështje mjaft e rëndësishme është natyra ligjore ose faktike e ligjit të huaj kur ai zbatohet nga gjykatat në bazë të rregullës së zgjedhjes së ligjeve. Kemi parë se përgjigjja varion sipas sistemeve të ndryshme ligjore. Përpiquni të shpjegoni pasojat që mund të vijnë si rezultat i zgjedhjes së një ligji në sistemin ligjor shqiptar.

2) Cili është statusi i parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare në Shqipëri? A është kjo e drejtë drejtpërdrejt e zbatueshme? A ekziston ndonjë dispozitë kushtetuese për këtë çështje?

Struktura e vendimeve dhe roli i gjyqtarit

1) Sipas nenit 307 të Kodit shqiptar të procedurës civile, mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë duhet t'i bashkëlidhet vendimit. Si duhet të kuptohet roli i gjyqtarit sipas kësaj dispozite?

d - LEXIME PLOTESUESE DHE BIBLIOGRAFI

AA.VV. *Civil Jurisdiction and Judgments in Europe (Juridiksioni dhe vendimet civile në Europë)*, London, Butterworths, 1992.

Schlesinger R.B., *Comparative Law (E drejta e krahasuar)*, 6.a ed. New York, Foundation Press, 1998.

Taruffo M., *La motivazione della sentenza civile (Arsyetimi i vendimit civil)*, Padova, Cedam, 1975.

Vacca L. (a cura di), *Lo stile delle sentenze e l'utilizzazione dei precedenti (Llojet e vendimeve dhe përdorimi i precedentit)* : Torino, Giappichelli, 2000.

V.Varano-V.Barsotti, *La tradizione giuridica occidentale (Tradita juridike perëndimore)*, Torino, Giappichelli, 2003.

e - FJALORI TERMINOLOGJIK

Res judicata = Autoriteti që i jepet një akti të caktuar gjyqësor, duke krijuar mundësinë e ekzekutimit të detyruar të së drejtës së vendosur në vendim dhe

duke penguar mundësinë që e njëjta çështje të sillet përsëri para gjykatës.

Vendimi deklarativ/vendimi "konstituiv" = Një vendim "deklarativ" ka për qëllim njohjen (deklarimin) e të drejtave të palëve kur procesi gjyqësor është hapur. Në sistemet kontinentale, vendimet, të cilat në vend që të njohin një situatë ligjore paraekzistuese, krijojnë një situatë të re, quhen vendime "konstituive".

Arsyetimi = Baza racionale për arsyetimin e vendimit e zhvilluar nga palët në konkluzionet e tyre dhe nga gjyqtarët në vendimet e tyre.

f - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Materialet e huaja, veçanërisht vendimet e gjykatave, duhet të përdoren me kujdes gjatë hartimit të vendimit dhe gjithmonë pasi të jenë marrë njohuritë bazë për sistemin ligjor nga vijnë ato.

KREU I SHTATË

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

a - OBJEKTIVAT MËSIMORË

Në përfundim të këtij kapitulli, magjistratët duhet të kenë njohuri për:

- nocionin e titullit ekzekutiv,
- kërkesat që duhet të plotësohen për vlefshmërinë e titullit ekzekutiv,
- kërkesat procedurale për njoftimin e debitorit për fillimin e procedurave të ekzekutimit.

b - MATERIALET REFERUESE KRYESORE

PJESA 1

1. Ekzekutimi i detyrueshëm: Një vështrim krahasues i procedurave të ekzekutimit në sistemet ligjore europiane më kryesore

Pjesa e katërt e Kodit shqiptar të procedurës civile i kushtohet ekzekutimit të detyrueshëm dhe, më konkretisht: Titulli I parashikon dispozitat e përgjithshme për titujt ekzekutivë dhe fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Titulli II trajton llojet e veçanta të ekzekutimit të detyrueshëm dhe bën dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të procedurave të ekzekutimit: procedurat e ekzekutimit të detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë dhe juridikë (kapitulli I: nenet 527 – 539), ekzekutimi mbi sendet e luajtshme (kapitulli II: nenet 540 – 559) dhe ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme, mbi mjetet e lundrimit e të fluturimit (kapitulli III: nenet 560 – 580). Më pas, janë parashikuar dispozitat për ekzekutimin mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit (kapitulli IV: nenet 581 – 588). Po

ashtu, kapitulli VII i titullit II (nenet 601 – 604) parashikon dispozitat për ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar, ndërsa kapitulli VIII përcakton rregullat për ekzekutimin e detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar.

Shumë sisteme procedurale të Europës kontinentale njohin dhe zbatojnë këto lloje të ndryshme të procedurave të ekzekutimit në varësi të detyrimit që duhet të përmbushet.

I tillë është edhe rasti i Kodit italian të procedurës civile, i cili, sa i takon ekzekutimit të detyrueshëm, është tepër i ngjashëm me modelin shqiptar. Nga neni 609 e në vazhdim, Kodi shqiptar i procedurës civile trajton mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve.

Një vështrim krahasues për llojet e ndryshme të ekzekutimeve jepet në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* (IECL, vëll. XVI, *Procedura civile*, kapitulli V, *Zbehja e formalizmit në rregullat e provave*, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London). Në këtë fragment del në pah fakti se në të gjitha sistemet ligjore ekzistojnë lloje të ndryshme të ekzekutimit të vendimeve:

"Megjithëse në shumicën e rasteve ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundon me marrjen e të hollave nga pala fituese, thuajse të gjitha sistemet ligjore bëjnë dallimin ndërmjet llojeve të ndryshme të ekzekutimit. Këto dallime kryesisht janë të justifikuara. Para së gjithash duhet të përmendim se disa lloje të ekzekutimeve mund të mos përfshijnë fare pagesën e të hollave, si p.sh., në rastet kur detyrohet kthimi i një objekti të caktuar apo i një pjese të tokës. Por, edhe kur detyrimi përfundimtar që ekzekutohet, është kalimi i një shume të hollash te pala fituese, procedurat e ekzekutimit që zbatohen gjatë këtij procesi, janë të llojeve të ndryshme dhe kryhen në përputhje me rregulla të ndryshme.

Në teori, mënyrat për ekzekutimin e vendimeve mund të dallohen në bazë të pesë kritereve: 1) natyra e pretendimit që duhet të përmbushet nga ekzekutimi; 2) natyra e objektit mbi të cilin kryhet ekzekutimi; 3) mjetet specifike që përdoren për ekzekutimin (ekzekutimi specifik ose ekzekutimi nëpërmjet detyrimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta); 4) lloji i instrumentit të detyrueshëm (vendimi ose dokumenti jashtëgjyqësor) që i hap rrugën ekzekutimit dhe, së fundi, 5) brenda ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, lloji i veçantë i gjykatës që ka dhënë vendimin.

Në të vërtetë, vendet e Europës Qendrore priren drejt kriterit të natyrës së pretendimit. Në vijim të këtij qëndrimi, ligji gjerman bën dallimin ndërmjet

ekzekutimit të detyrimit në të holla (§ 803-882a), të dorëzimit të pronës (§§ 883-886), të kryerjes së një veprimi të caktuar (§§ 887-889, 894-898) ose të ndalimit të kryerjes së një veprimi të caktuar (§ 890).

Një klasifikim i ngjashëm, ndonëse më i detajuar, bëhet edhe nga ligji austriak për ekzekutimin e detyrueshëm. Në Zvicër, ligji federal për mbledhjen e borxheve dhe procedurën e falimentimit kufizohet vetëm në pretendimet në të holla, pra duke bërë dallimin brenda ekzekutimeve të detyrimeve në të holla, ndërmjet procedurës së vënies së sekuestros, procedurës së ekzekutimit nëpërmjet sendit të hipotekuar dhe zbatimit të procedurës së falimentimit, ndërsa ekzekutimet e detyrimeve jo në të holla i delegohen legjislacionit të kantoneve.

Nga ana tjetër, sistemet ligjore romaniste, megjithëse e parashikojnë ekzekutimin e detyrimit jo në të holla, përqendrohen kryesisht në llojet e ndryshme të garantimit të kthimit të të hollave, d.m.th. ato janë të orientuara më shumë drejt objektit të ekzekutimit, sesa drejt natyrës së pretendimit që duhet të përmbushet nëpërmjet ekzekutimit. Edhe kur bëhet fjalë për tërësinë e procesit të ekzekutimit, metodat e tij të ndryshme identifikohen nëpërmjet funksionit të objektit për të cilin ato aplikohen: ekzekutimi mbi persona, ekzekutimi specifik (ekzekutimi në natyrë), ekzekutimi mbi sendet. Shumë prej vendeve që flasin gjuhën spanjolle priren drejt bërjes së dallimit ndërmjet ekzekutimit të një vendimi gjyqësor ose të një dokumenti jashtëgjyqësor.

Ndonjëherë, aspekti negativ i sistemit amerikano-latin i atribuohet faktit se forma e ekzekutimit vendoset së pari për dokumentet jashtëgjyqësore dhe më pas zbatohet për vendimet gjyqësore, të cilat u nënshtrohen në këtë mënyrë të gjitha vonesave të mundshme dhe metodave të rishqyrtimit të përsëritur.

Shënim i autorit: *Modeli shqiptar zë vend mes sistemeve ligjore romaniste. Në të vërtetë, brenda ekzekutimit të detyrimeve në të holla, ai klasifikon procedurat e ekzekutimit sipas kriterit të objektit të ekzekutimit: Kodi shqiptar, sikurse e kemi përmendur edhe më sipër, i ka parashikuar në kapituj të veçantë ekzekutimin mbi sendet e luajtshme (nenet 540 – 559) dhe ekzekutimin mbi sendet e paluajtshme, mbi mjetet e lundrimit dhe të fluturimit (neni 560 – 580). Më pas, ai trajton ekzekutimin mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet për të cilat personat e tretë i detyrohen debitorit. Së fundi, gjendet disiplina e ekzekutimit specifik e, më konkretisht, ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar dhe i detyrimit për kryerjen e një veprimit të caktuar (nenet 601-604).* [...] Këto do të trajtohen më poshtë.

"Duke u përqendruar mbi metodat e ndryshme të sigurimit të të hollave nga debitori, ligji anglez bën dallimin ndërmjet tyre, duke u bazuar në llojet e ndryshme të sendeve që sekuestrohen. Pra, ai ka shumë ngjashmëri me sistemin romanist. Mund të shtojmë këtu dy dallime specifike me mjaft rëndësi:

Së pari, në ndryshim nga pasja e një sistemi të integruar për ekzekutimin e vendimeve për detyrimet në të holla, dhënë nga të gjitha gjykatat civile, janë parashikuar metoda të ndryshme në varësi të faktit nëse vendimi është dhënë nga Gjykata e Lartë apo nga një gjykatë qarku. Së dyti, përveç ekzekutimit ligjor, Gjykata e Lartë ka autoritetin ligjor të procedojë me caktimin e një përfituesi "nëpërmjet ekzekutimit me mjete jomonetare". Procedurat e ekzekutimit me mjete jomonetare zbatohen në mënyrë të ndryshme edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse dallimet e hershme midis metodave të common law dhe metodave të ekzekutimit me mjete jomonetare e kanë humbur disi rëndësinë e tyre".

Për sa i përket modelit italian, këtu mund t'i referohemi një shkrimi nga M. TARUFFO,[1] i cili na jep në mënyrë të përmbledhur dhe të qartë një analizë kritike të aspekteve më kryesore të sistemit italian të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore:

"Pasi italiani ynë John Doe u mbijetoi të gjitha vonesave, kompleksitetit dhe pengesave të procedurave të përshkruara deri më tani dhe pasi, më në fund, arriti të siguronte një vendim të detyrueshëm për t'u zbatuar, problemet e tij nuk mbaruan. Përkundrazi, nëse, sikurse ndodh shpesh, vendimi përfshin dënimin e debitorit për të dhënë një shumë të hollash ose për të kryer veprime të caktuara, dhe debitori nuk i përmbush vullnetarisht këto detyrime, del në pah një problem i ri (ndonëse ky nuk është rasti i vendimeve deklarative ose konstituive, të cilat konsiderohen se janë të vetëzbatueshme). Teorikisht, personat që kanë në dorë një vendim, kanë të drejtën e plotësimit të shpejtë të kredive të tyre nëpërmjet mjeteve të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që synojnë përmbushjen e të drejtave të tyre, sikurse është vendosur nga gjykata. Megjithatë, në praktikë, procedurat për ekzekutimin e vendimeve janë të vështira, të gjata dhe shumë joefektive. Procedurat janë komplekse dhe jooperative, dhe nuk ekzistojnë masat efikase detyruese të tërthorta. Po ashtu, shpesh nuk arrihet të kapërcehet ngurtësia e debitorit. Për rrjedhojë, në shumë raste, të drejtat ligjore të John Doe janë të paracaktuara të mbeten joefektive, pasi sistemi nuk garanton mjetet e duhura. E shumta që mund të marrë kreditori, është një shpërblim për dëmet e shkaktuara nga mospagimi i detyrimeve, të parashikuara në vendimin gjyqësor ndaj palës kreditore".

---

1) (M. TARUFFO, Procedura civile dhe rruga që ndjek një çështje civile, në J. S. LENA and U. MATTEI, Hyrje në të drejtën italiane, 2002, faqe 177-179)

Sikurse e kemi parë edhe më sipër, ekzistojnë lloje të ndryshme të procedurave për ekzekutimin e vendimeve të parashikuara nga Kodi italian i procedurës civile. Përdorimi i tyre është në varësi të llojit të detyrimit që rrjedh nga vendimi:

"Ekzistojnë lloje të ndryshme të procedurave të ekzekutimit të vendimeve, por ato nuk lihen në zgjedhjen e palës kreditore. Secila prej këtyre procedurave është konceptuar për t'iu përshtatur llojit specifik të detyrimit që duhet të përmbushet nga debitori. Pra, nëse pala kreditore inicion procedurat e gabuara, ato do të anulohen dhe nuk do të realizohet asnjë qëllim.

Kur vendimi përfshin urdhrin për të paguar një shumë të caktuar të hollash dhe debitori nuk e paguan, makineria ekzekutuese mbështetet në transformimin e pasurisë ose të sendeve të debitorit në të holla, për të përmbushur të drejtën e kreditorit për të marrë të hollat që i takojnë. Kjo është një procedurë shumë komplekse gjatë së cilës mund të dallohen disa etapa: 1) vënia e sekuestros mbi sendet e debitorit, 2) shitja e këtyre sendeve në ankand publik dhe 3) pagesa e shumës së të hollave që duhet të marrë kreditori. Secila prej këtyre fazave mund të jetë shumë komplekse për shkak të detajeve formale të parashikuara nga rregulloret e vjetra dhe joefektive. Kreditorit mund t'i duhen edhe disa vjet për të arritur momenti final kur ai/ajo të mund të marrë të hollat që i takojnë. Por procedurat janë shumë të kushtueshme dhe sendet e debitorit mund të jenë të pamjaftueshme për të plotësuar shumën e përcaktuar në vendim. Rezultati është se, në shumë raste, shitja e sendeve është e mjaftueshme vetëm për të paguar tarifat e avokatit dhe shpenzimet e procedurave. Në këto raste, të varfrit John Doe do t'i duhet të presë për disa vjet dhe të mos marrë asgjë ose, në rastin më të mirë, të marrë vetëm një përqindje të vogël të detyrimit ndaj tij.

Vështirësi të tjera mund të krijohen duke harxhuar edhe më shumë kohë. Për shembull, kreditorët e tjerë mund të ndërhyjnë në procedurat e ekzekutimit të filluara nga John Doe dhe, në raste të tilla, të ardhurat e përfituara nga shitja e sendeve të debitorit mund të ndahen midis disa kreditorëve. Në të njëjtën kohë, debitori ka disa mundësi për të ngadalësuar procedurat e ekzekutimit, madje edhe për t'i bllokuar ato për disa vjet. Kundërshtimet mund të ngrihen për pothuajse çdo akt të procedurave të ekzekutimit, duke provokuar përgjigje nga palët e tjera dhe vendime nga gjykata. Kjo mund të ndodhë disa herë gjatë zhvillimit të procedurave të ekzekutimit. Kështu, pra, kreditori duhet të kapërcejë një numër pengesash për të arritur në një përfundim, i cili, të shumtën e rasteve, është thjesht teorik dhe joefektiv.

Gjerat janë disi më të thjeshta kur problemi lidhet me dorëzimin e sendeve të caktuara ose të pronës. Në shumë raste, gjyqtari dhe nëpunësit e gjykatës

bëjnë atë që është e nevojshme për ta realizuar konkretisht dorëzimin e sendit apo të pronës, qoftë edhe kundër vullnetit të debitorit, nëse kjo kërkohet. Gjithsesi, edhe në këto procedura, debitori mund të krijojë pengesa për të fituar kohë ose për të bllokuar procedurat.

Por gjërat përkeqësohen kur bëhet fjalë për problemin e ekzekutimit të një urdhri të gjykatës, i cili e detyron debitorin e vendimit të kryejë ose të mos kryejë një veprim të caktuar. Në këtë fushë, vendimi mund të ekzekutohet efektivisht vetëm nëse 'kryerja' konsiston në shkatërrimin e diçkaje materiale dhe 'moskryerja' konsiston në shkatërrimin e diçkaje materiale që është ndërtuar në mënyrë të paligjshme (për shembull, të një ndërtese), duke garantuar se natyra e veprimit është e tillë që 'kryerja' ose 'moskryerja' mund të bëhet edhe nga persona të tjerë (të ndryshëm nga debitori).

Në rrethana të tilla, gjyqtari mund të urdhërojë që një person i tretë të kryejë gjithçka është e nevojshme për përmbushjen e detyrimit dhe debitorit fillestar do t'i ngarkohen të gjitha shpenzimet për këtë gjë. Këto procedura mund të jenë të gjata dhe të vështira. Por, problemi i vërtetë lind kur gjykata vendos një detyrim jomonetar dhe debitori fillestar nuk mund të zëvendësohet nga askush tjetër. Çështje të kësaj natyre janë të përbashkëta në fushat e mosmarrëveshjeve të punës, mbrojtjes së konsumatorit, diskriminimeve racore ose gjinore, kontrollit ambiental etj. Këtu thelbi i problemit është se, me përjashtim të rasteve shumë të rralla dhe të veçanta (në fushën e patentave dhe të markave dhe në disa raste në fushën e mosmarrëveshjeve të punës), sistemi italian i ekzekutimit të vendimeve nuk përfshin mjetet efikase të presionit shtrëngues në mënyrë të tërthortë mbi vullnetin e debitorit. Rrjedhimisht, shumë prej urdhrave për detyrime jomonetare të dhëna nga gjykata nuk zbatohen, pasi nuk aplikohen mjetet tradicionale të ekzekutimit dhe nuk ekzistojnë sanksione efektive për mospërmbushjen e detyrimit, të cilat mund të përdoren si mjete shtrënguese mbi debitorin, për të nxitur pajtueshmërinë e tij me vendimin.

Për ta përmbledhur: nëse John Doe siguron një vendim që parashikon një detyrim monetar, ai ka shpresa për të përmbushur realizimin e të drejtave të tij, megjithëse kërkohen procedura të gjata dhe të kushtueshme, që mbartin rrezikun e mosplotësimit ose të plotësimit të pjesshëm të pretendimit. Por, nëse John Doe siguron një detyrim jomonetar, shpresa për zbatimin e tij është e kotë, për aq kohë sa ai duhet të mbështetet në dëshirën e mirë të debitorit të vendimit. Me fjalë të tjera, ndodh shumë shpesh që, edhe nëse janë të mundshme, procedurat e ekzekutimit nuk e çojnë asgjëkundi kreditorin, ashtu sikurse ka edhe raste shumë të shpeshta kur nuk ka asnjë mjet për të vajtur deri tek kjo pikë boshe".

2. Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm: titulli ekzekutiv

Procedurat për ekzekutimin mund të iniciohen nga kreditori, i cili disponon një titull ekzekutiv. Ky është një instrument i domosdoshëm në ekzekutimin e detyrueshëm, i cili, normalisht, është një vendim gjyqësor i formës së prerë, por mund të jetë edhe një dokument jashtëgjyqësor.

Nocioni i titullit ekzekutiv shpjegohet mjaft qartë në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar,* cituar edhe më sipër, kapitulli 10, Procedura civile, f. 16-19:

"Çështja se cilat janë instrumentet e detyrueshme shkon deri te zanafilla e ekzekutimit. Lloji dhe origjina e dokumenteve në bazë të rëndësisë së të cilave pushteti shtetëror vë në lëvizje mekanizmin e tij shtrëngues për detyrimet e ekzekutueshme, mund të ofrojnë disa tregues rreth qëndrimit të shtetit ndaj marrëdhënies mes autoritetit shtetëror dhe ekzekutimit të detyrimeve private.

Disa lloje të instrumenteve të detyrueshme, si vendimet gjyqësore të formës së prerë, janë evidente në çdo sistem ligjor. Madje edhe dokumentet më pak të rendësishme, si p.sh., vendime të tjera gjyqësore, vendime të gjykatës së arbitrazhit ose akte *ex officio* të disa autoriteteve administrative (p.sh., për taksat, gjobat ose vlerësimet për sigurinë sociale), janë pranuar gjerësisht si instrumente të detyrueshme për ekzekutim.

Por, çështja më e rëndësishme që shtrohet për diskutim, ka të bëjë me mundësinë që dokumente të paraqitura nga palët të jenë instrumente të detyrueshme, në veçanti dokumentet noteriale. Shpeshtësia e këtyre dokumenteve të ekzekutueshme duket se po rritet gjithmonë e më tepër. Madje edhe nga një shtet ish-socialist, si Hungaria, raportohet se ekzekutimi, në shumicën e rasteve, iniciohet mbi bazën e dokumenteve noteriale krahasuar me vendimet gjyqësore.

Dokumentet e detyrueshme me pëlqimin e palëve janë shfaqur që në mesjetë, fillimisht në sistemet ligjore të qyteteve italiane dhe, më pas, gradualisht, si institut i *jus commune.*

Baza ligjore u krijua nga rregulla "*confessus pro judicato habetur*". Kjo rregull kërkonte një pohim përpara gjyqtarit, por që, para mesjetës, një deklaratë e bërë përpara noterit kishte po të njëjtin efekt. Më vonë u përfshi çdo dokument publik. Në fakt, një dokument privat bëhej i detyrueshëm kur pranohej nga pala humbëse në gjykatë.

Shpjegimi për fuqinë ekzekutuese të dokumenteve noteriale është dhënë nga Pothier. Origjina i përket një gjyqtari, i cili, mbi bazën e një deklarate noteriale, i detyroi palët të përmbushnin detyrimet e tyre; më pas, kërkimi i

ndihmës së gjyqtarit u eliminua dhe dokumenti noterial filloi të konsiderohej si vendim gjyqësor. Madje edhe në teori, Pothier nuk u jep dokumenteve noteriale më pak autoritet se vendimeve gjyqësore, duke qenë se këto të fundit jepen kundër një pale të pabindur (*in invitos*), ndërsa të parat mbështeten në pëlqimin e palëve (*in volentes*). Ekzekutueshmëria garantohet edhe nëse debitori nuk i nënshtrohet drejtësisë në distriktin ku është hartuar dokumenti: deklarata e tij konsiderohet si krijim juridiksioni për qëllimet e ekzekutimit, ndërsa, për qëllimet e gjykimit, një deklaratë e tillë do të ishte pa rëndësi për çështjen. Pra, ekzekutimi duket se është më i hapur ndaj vullnetit të palëve në raport me gjykimin.

Në kohët moderne, dokumentet noteriale janë pranuar gjerësisht si instrumente të detyrueshme nga ligji francez dhe gjerman dhe mund të konsiderohen si pjesë e një tradite tashmë të krijuar në çështjet e ekzekutimit. Kjo traditë është përhapur me shpejtësi në vendet e Amerikës Latine dhe në ato të Europës Lindore. Në disa vende socialiste mund të jetë i mjaftueshëm edhe një dokument privat i kualifikuar: p.sh. dokumentet private në favor të organizatave socialiste ose dëftesat e borxheve që u ka kaluar afati, mes organizatave socialiste, nëpërmjet një banke ndërmjetësuese. Ligji i ri japonez "Për ekzekutimin civil", i vitit 1979, i ka parashikuar shprehimisht aktet noteriale si instrumente të detyrueshme dhe kjo pavarësisht përvojave negative të sistemit të vjetër të "ankandit vullnetar" (1898)".

Shënim i autorit: *Modeli shqiptar tregon se i përket traditës europiane, duke i konsideruar si tituj ekzekutivë edhe instrumentet e tjera, përveç vendimeve gjyqësore, si p.sh., dokumentet noteriale ose vendimet e gjykatave të arbitrazhit. Kjo mund të vërehet në nenin 510 të Kodit shqiptar të procedurës civile, sipas të cilit "titujt ekzekutivë përbëhen nga vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, ose vendimet për ekzekutimin e përkohshëm, vendimet e gjykatave të huaja të arbitrazhit ose të gjykatave shqiptare të arbitrazhit, aktet noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, kambialet, çeqet dhe letrat me urdhër që barazohen me ato, si edhe akte të tjera që, sipas ligjeve të veçanta, quhen "tituj ekzekutivë".*

3. Detyrueshmëria provizore e vendimeve gjyqësore

Një prej problemeve më kryesore që lidhet me ekzekutimin e detyrueshëm, është ai që ka të bëjë me momentin kur vendimi bëhet i ekzekutueshëm.

Pjesa më e madhe e sistemeve ligjore të traditës europiane kanë parashikuar

norma për detyrueshmërinë provizore të vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë, të cilat mund t'i nënshtrohen ende të paktën njërës prej shkallëve të apelimit.

Aspektet më kryesore që lidhen me problemet që lindin nga detyrueshmëria provizore e vendimeve gjyqësore, janë trajtuar hollësisht në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar:*[2]

"Çështja se kur një vendim gjyqësor bëhet i detyrueshëm, është e lidhur drejtpërdrejt me procedurat e ekzekutimit. Ajo është e integruar nga ana funksionale në ligjin për ekzekutimet, por, në të njëjtën kohë, është e lidhur ngushtësisht me normat për vendimet gjyqësore dhe apelimet. Vetë ekzistenca e sistemit të apelimeve shtron çështjen e përmbushjes së afateve – për qëllimet e ekzekutimit – të një vendimi që mund të vazhdojë ende të kundërshtohet. Afatet kohore të ekzekutimit mund të përkojnë ose jo me afatet e efektit *res judicata*. Gjithsesi, edhe sistemet ligjore që nuk e lidhin detyrueshmërinë e vendimeve gjyqësore me *res judicata*, duhet të përcaktojnë një moment kohor në të cilin vendimet t'i hapin rrugën ekzekutimit. Çdo veprim për ekzekutimin e vendimit përpara këtij momenti njihet si detyrueshmëria provizore.

Detyrueshmëria provizore ka kuptim vetëm gjatë kohës që i duhet ekzekutimit normal për të përmbushur afatin e kërkuar prej të paktën një muaji brenda të cilit ai mund të apelohet. Në të kundërt, nëse vendimet e gjykatave të shkallës së parë ekzekutohen rregullisht, nuk ka më hapësira dhe nuk ndihet nevoja e deklarimit të këtyre vendimeve si provizorisht të detyrueshme, pasi ato, gjithsesi, janë të ekzekutueshme. Nga ana tjetër, sa u takon procedurave të ekzekutimit, ekzekutimi i kryer mbi një vendim provizorisht të detyrueshëm nuk devijon nga modelet normale të ekzekutimit, me përjashtim të llojit të veçantë të instrumentit kryesor të ekzekutimit. Pra, termi "detyrueshmëri provizore" është më i saktë se termi "ekzekutim provizor": rrethana cilësuese është më shumë lloji i vendimit sesa mënyra e ekzekutimit.

Doktrina moderne romaniste parapëlqen termin "ekzekutim i menjëhershëm" *(exécution immédiate; esecuzione immediata; ejeucion immediate)* [...]".

Në po të njëjtin paragraf të kapitullit X të *Encikopedisë*, që u kushtohet procedurave të ekzekutimit, përshkruhen mjaft qartë aspektet kryesore të sistemeve ligjore lidhur me ekzekutimin provizor:

"Në Gjermani, vendimet me efektin *res judicata* dhe vendimet me

2) IECL, vëll. XVI, **Procedura civile,** *kapitulli X, Procedurat e ekzekutimit, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London, faqe 19.*

detyrueshmëri provizore, për qëllime të ekzekutimit, janë vendosur shprehimisht në të njëjtin nivel (K.pr.c., § 704, par I). Detyrueshmëria provizore synon të garantojë kreditorin kundrejt një fitoreje të pavlerë dhe e nxit debitorin të përqendrojë mbrojtjen në gjykatën e shkallës së parë dhe të heqë dorë nga apelimet e panevojshme me qëllimin e vetëm të vonesave në ekzekutim. Duke qenë se *res judicata* kërkon shterimin e të gjitha mjeteve të ankimit (K.pr.c., § 705), detyrueshmëria provizore, si rregull, shtrihet te të gjitha vendimet, pavarësisht nëse ato merren nga gjykatat e shkallës së parë ose nga gjykatat e apelit. Realisht, të gjitha vendimet e gjykatave të apelit mbi çështjet financiare i nënshtrohen detyrueshmërisë provizore, ndërsa ligji parashikon edhe një sërë vendimesh të tjera, të cilat, në varësi të politikave të ndryshme, duhet të deklarohen si provizorisht të detyrueshme, pa vendosjen e asnjë lloj garancie nga kreditori (K.pr.c. gjerman, § 708). Për të gjitha vendimet e tjera, detyrueshmëria provizore u nënshtrohet garancive (K.pr.c. gjerman, § 709). Detyrueshmëria provizore urdhërohet me iniciativën e gjykatës dhe shtrihet në të gjithë vendimin. Sipas opinionit mbizotërues, plotësimi i pretendimit nëpërmjet këtij detyrimi është vetëm provizor, pasi plotësimi i tij përfundimtar varet nga mënyra e përfundimit të gjykimit në apel [...]".

Për sa u përket sistemeve romaniste, seksioni i *Enciklopedisë ndërkombëtare*, i cituar më sipër, trajton një çështje të rëndësishme të ligjit francez. Në të vërtetë, detyrueshmëria provizore ka lindur në Francë, në shekullin XIV dhe, më pas, është shpërndarë edhe në shumë vende të tjera, si në Gjermani dhe Itali:

"Detyrueshmëria provizore ka qenë pjesë e ligjit francez që në shekullin XIV. Ajo është pranuar nga Kodi i procedurës civile i Napoleonit dhe ka gjetur zbatim në shumë vende të tjera, veçanërisht në Gjermani. Një ligj i vitit 1942 thjeshtoi dhe njësoi rregullat e paqarta dhe tepër të detajuara, si dhe i dha përparësi diskrecionit gjyqësor. Këto rregulla janë modifikuar dhe përfshirë në Kodin e ri të procedurës civile (nenet 514-526)".

Shënim i autorit: *Për një kuptim më të mirë të rregullave franceze për detyrueshmërinë provizore, është e nevojshme t'i referohemi përmbajtjes së neneve më të rëndësishme të Kodit francez të procedurës civile:*

Neni 514: "Detyrueshmëria provizore nuk mund të bëhet pa qenë e urdhëruar, vetëm nëse disponohet si e drejtë. Në mënyrë të veçantë, urdhrat e shpejtë, vendimet që përmbajnë urdhra provizorë për zhvillimin e procedurave, urdhrat që parashikojnë masa mbrojtëse, si edhe udhëzimet e gjyqtarëve para

zhvillimit të gjyqit, të cilat i garantojnë një pagesë provizore kreditorit, do të konsiderohen provizorisht të detyrueshme si garantim i një të drejte".

Neni 515: "Përveç rasteve kur garantohet si një e drejtë, detyrueshmëria provizore mund të urdhërohet edhe me kërkesë të palëve ose me iniciativën e gjyqtarit kur ai/ajo e gjykon si të nevojshme dhe të përshtatshme për objektin e mosmarrëveshjes, me kushtin që kjo gjë të mos jetë e ndaluar nga ligji. Ajo mund të urdhërohet për të gjithë vendimin ose vetëm për disa pjesë të tij dhe në asnjë rast nuk mund të urdhërohet për shpenzimet e tatueshme".

Aktualisht, ligji francez bën dallimin ndërmjet detyrueshmërisë provizore nëpërmjet veprimit të ligjit, e cila kryesisht u referohet masave provizore dhe nëpërmjet vendimeve gjyësore (neni 514). Në rastin e dytë, kjo gjë bëhet ose me kërkesën e palëve, ose me iniciativën e vetë gjykatës (neni 515). Vetëm në situata përjashtimore, kryesisht për sa u takon shpenzimeve, detyrueshmëria provizore nuk është e lejueshme. Në parim, vendimi për detyrueshmërinë provizore përfshihet në vendimin që merret për çështjen (neni 516), megjithëse ai mund të jepet po njësoj edhe në apel (nenet 525, 526). Vendosja e garancisë, si edhe modalitetet e tjera përkatëse, janë në diskrecion të gjyqtarit.

"Në sistemet e tjera ligjore romaniste, detyrueshmëria provizore mund të thuhet se ndjek pak a shumë të njëjtin model. Normalisht, kërkohet aplikimi i palëve dhe detyrueshmëria provizore i shtrin efektet vetëm mes palëve. Klauzola përkatëse zakonisht përfshihet në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, megjithëse mund të shtohet edhe në apel. Shpenzimet gjyqësore i nënshtrohen njëlloj detyrueshmërisë provizore, me përjashtim të rasteve kur gjyqtari i përjashton shprehimisht ato. Në përgjithësi, e gjithë çështja mbetet në diskrecionin e gjyqtarit.

Megjithatë, ekzistojnë kufizime në dy aspekte: Së pari, detyrueshmëria provizore nuk lejohet në mosmarrëveshjet martesore. Së dyti, disa sisteme parashikojnë kërkesa materiale në bazë të të cilave një vendim mund të deklarohet si i detyrueshëm provizorisht, p.sh., kur ka një probabilitet të lartë që vendimi të jetë i bazuar si duhet (pretendimet që lindin nga një akt autentik ose akt privat i miratuar, ose që mbështeten mbi efektin res judicata), kur mund të vihet në rrezik nga vonesat, ose nëse vendimet japin një shumë të likuidueshme, pra kur dëmi nga detyrueshmëria provizore nuk është i pariparueshëm. Këto specifikime legjislative mund të shkojnë deri aty sa të kërkojnë deklarimin e detyrueshmërisë provizore, p.sh. të një vendimi me karakter të përgjithshëm që përmban një vlerësim të dëmeve ose të një vendimi

për pension ushqimor. Po ashtu, pretendimet më të bazuara mund të çojnë në detyrueshmërinë provizore *ope legis*, p.sh., pretendimet e punëtorëve".

Shënim i autorit: *Shih, për shembull, nenin 431 të Kodit italian të procedurës civile, i cili parashikon se vendimet që përmbajnë një urdhër për t'i paguar një punëtori një shumë të hollash në rastin kur detyrimi lind nga marrëdhënie të punës, janë provizorisht të detyrueshme.*

Kohët e fundit, Italia ka përkrahur këtë prirje duke deklaruar çdo vendim të gjykatave të shkallës së parë si të detyrueshëm provizorisht (ope legis), duke parashikuar se gjykata e apelit mund të pezullojë detyrimin provizor për arsye serioze. Gjithsesi, mbrojtja ligjore shpesh rezulton në shmangien nga barrat financiare. Kështu, ndërsa vendosja e garancisë nga kreditori për të siguruar detyrueshmërinë provizore zakonisht mbetet në vlerësimin e gjyqtarit, disa vendime, si p.sh., vendimet për pension ushqimor, mund të përjashtohen nga çdolloj garancie.

Teknikisht, ekzekutimi mund të vazhdojë të procedojë pa ndonjë njoftim të ri edhe pasi vendimi për detyrueshmërinë provizore të jetë lënë në fuqi në apel. Por, në disa sisteme, detyrueshmëria provizore nuk shkon aq larg sa të lejojë shitjen e sendeve të debitorit.

4. Kërkesa të tjera për ekzekutimin e vendimeve

Në mjaft raste, ekzistenca e titullit ekzekutiv nuk është kërkesë e mjaftueshme për të filluar ekzekutimin e detyrueshëm. Në të vërtetë, shpesh kërkohet një autorizim i veçantë për të filluar procedurat mbi bazën e titullit ekzekutiv. Më pas, debitori duhet të njoftohet për fillimin e ekzekutimit. Në rastet e ekzekutimeve në të holla duhet të plotësohen edhe disa kërkesa të tjera lidhur me sigurinë, maturimin dhe likuidimin e pretendimit në të holla që duhet të ekzekutohet.

Këto aspekte trajtohen nga Enciklopedia ndërkombëtare e së drejtës së krahasuar:[3]

"Në shumë prej sistemeve ligjore, ekzistenca e një instrumenti detyrues, megjithëse e domosdoshme, nuk është kërkesa e vetme për të filluar procedurat e ekzekutimit. Duhet të merren parasysh edhe disa kërkesa të tjera në rrugën prej krijimit të instrumentit detyrues dhe fillimit të ekzekutimit konkret. Nga ky këndvështrim, dalin në pah tri probleme të rëndësishme:

3) IECL, vëll. XVI, **Procedura civile,** *kapitulli X, Procedurat e ekzekutimit, J.C.B. Mohr Martinus Nijhoff, Tübingen – Hague – Boston – London , f. 26*

Së pari, shtrohet problemi nëse nevojitet një autorizim i veçantë për fillimin e procedurave të ekzekutimit. Shihet qartë se ky problem lidhet me kuptimin e përgjithshëm të marrëdhënies ndërmjet rolit të instrumentit detyrues dhe ekzekutimit, si një instrument i tillë në një sistem ligjor të caktuar: nëse ekzistenca reale e një instrumenti detyrues nëpërmjet veprimit të ligjit përbën edhe lejen përfundimtare për fillimin e procedurave të ekzekutimit, apo nevojitet shqyrtimi i mëtejshëm i rrethanave specifike për të vënë në lëvizje mekanizmin e ekzekutimit.

Së dyti, problemi lidhet me nevojën, metodën dhe specifikimet kohore të njoftimit të debitorit për ekzekutimin që do të fillojë. Normalisht, elementi i surprizës konsiderohet si thelbësor në procedurat e ekzekutimit për shkak të frikës se debitori mund të largohet ose të fshehë sendet e tij; por, sa larg mund të shkojë kjo surprizë, qoftë edhe nxitja e saj, duhet të vlerësohet kundrejt standardeve kushtetuese të dëgjimit paraprakisht dhe të procesit të drejtë.

Problemi i tretë lidhet kryesisht me ekzekutimin e detyrimit në të holla dhe paraqet një ngjyrim më material: Cilat janë kërkesat që duhet të plotësohen sa i takon sigurisë, maturimit dhe likuiditetit të pretendimeve në të holla që kërkohen të përmbushen nëpërmjet ekzekutimit?

Sipas ligjit francez, për të filluar procedurat e ekzekutimit, si rregull, nuk është i nevojshëm as autorizimi i gjyqtarit, as autorizimi i dikujt tjetër. Kjo është edhe arsyeja përse vënia e sekuestros quhet "procedurë jashtëgjyqësore". Në raste përjashtimore, siç është, për shembull, dëbimi i një qiramarrësi, kërkohet autorizim nga administrata (prefektura). Për të tjerat, kreditori duhet të veprojë mbi debitorin nëpërmjet kërkesës së përmbaruesit për të shlyer detyrimin, e cila e vendos debitorin në pamundësi dhe konsiderohet si një akt përgatitor për fillimin e ekzekutimit.

Efektet e kësaj kërkese për fillimin e ekzekutimit ndahen më pas në varësi të objektit të piketuar – sende të luajtshme ose të paluajtshme: në rastin e parë, garantohet një minimum kohor prej 8 ditësh në mënyrë që të lejohet fillimi i procedurave për vënien e sekuestros, çka i jep mundësi debitorit të zhvendosë ose të fshehë sendet e tij; në rastin e dytë, nuk ka më nevojë për afate kohore, sepse, pas një amendamenti të bërë në vitin 1938, kërkesa është e barasvlefshme me sekuestrimin aktual të sendeve të paluajtshme të identifikuara, e cila, në këto raste, e bën kërkesën realisht pjesë integrale të procedurave të ekzekutimit. Sa i përket intervaleve kohore maksimale midis paraqitjes së kërkesës dhe vënies së sekuestros, ligji i ri "Për ekzekutimet" parashikon 2 vjet për sendet e luajtshme, ndërsa anijet duhet të sekuestrohen brenda një periudhe prej 10 ditësh. Për sendet e paluajtshme çështja është e diskutueshme, pasi, sikurse u përmend edhe më lart, paraqitja e kërkesës

ekuivalentohet me vënien e sekuestros; regjistrimi i kërkesës në zyrat publike përkatëse duhet të bëhet brenda 90 ditëve.

Më poshtë po analizojmë me hollësi aspektet përkatëse të sistemeve ligjore franceze dhe romaniste, në traditën e të cilave mund të përfshihet edhe Kodi shqiptar:

"Sipas ligjit francez, kërkesat materiale përfshijnë: sigurinë, likuiditetin dhe maturimin e pretendimit që duhet të përmbushet nëpërmjet ekzekutimit. Megjithatë, shumë prej kërkesave janë moderuar me anë të normave të veçanta. Për sa i përket likuiditetit, sekuestroja mbi sendet e paluajtshme lejohet edhe mbi pretendimet jolikuide, duke siguruar se shitja mund të bëhet vetëm pasi pretendimi të jetë konvertuar në një shumë të hollash.

Sa i përket maturimit, gjyqtari, "duke llogaritur situatën e debitorit dhe duke marrë në konsideratë nevojat e kreditorit", mund të shtyjë shlyerjen e detyrimit ose mund ta ndajë atë në këste deri në dy vjet. Edhe për sa i përket sigurisë, doktrina franceze parashikon një përjashtim në ligjin e ri "Për ekzekutimet", të vitit 1991, neni 13/2, duke lejuar vënien e sekuestros mbi shpërblimet e pretendimeve që i nënshtrohen një kushti ose një periudhe kohore, ose që mund të përmbushen me anë të kësteve. Kjo rregull i përket më tepër pretendimeve nën sekuestron e shpërblimeve sesa pretendimeve që mund të përmbushen me anë të ekzekutimit. Devijime të rendësishme në sistemet e tjera ligjore romaniste përfshijnë minimumin e periudhës kohore midis njoftimit dhe fillimit të procedurave të ekzekutimit në Itali, dhe mbrojtjen e debitorit nëpërmjet institutit të caktimit të kufijve të vënies së sekuestros në Belgjikë. Lidhur me çështjen e parë, ligji italian parashikon një periudhë 10-ditore, duke e lejuar gjyqtarin, gjithsesi, që, në rast rreziku të shkaktuar nga vonesat, të autorizojë ekzekutimin e menjëhershëm, mundësisht me anë të një garancie që duhet të ofrohet nga kreditori paditës (shih nenin 482 të K.pr.c. italian). Trajtimi që u bëhet kufizimeve të venies së sekuestros sipas Kodit të procedurës (nenet 1403 – 1407, të cilat e lejojnë debitorin të lirojë sendet e tij ose të shmangë vendosjen e sekuestros duke u paguar organeve të përmbarimit shumën e kërkuar të të hollave, është mirëpritur veçanërisht, por, gjithsesi, ato limitohen vetëm te vendosja e sekuestros provizore ose ekzekutimi provizor".

Së fundi, do të ishte e dobishme të trajtohej shkurtimisht edhe përvoja gjermane, duke iu referuar aspektit të kërkesave të mëtejshme që duhet të plotësohen për fillimin e procedurave të ekzekutimit. Po citojmë një fragment nga *Enciklopedia e së drejtës së krahasuar,* e cituar edhe më sipër (f. 27):

"Sipas ligjit gjerman, autorizimi i kreditorit për të filluar ekzekutimin jepet nëpërmjet kopjes së vendimit ose nëpërmjet çdo instrumenti tjetër të

detyrueshëm që përmban urdhrin e ekzekutimit. Kjo kopje quhet kopje e detyrueshme për zbatim (K.pr.c. gjerman, nenet 724-725). Funksioni i saj rrjedh nga ndarja organizative e gjykatave nga organet e ekzekutimit dhe konsiston në paraqitjen para këtyre të fundit të vërtetimit zyrtar se janë përmbushur të gjitha kërkesat për ekzekutimin. Kjo kopje e detyrueshme për zbatim duhet t'i paraqitet debitorit dhe, si rregull, nuk parashikohet ndonjë minimum kohor. Për këtë gjë, ligji nuk kërkon më shumë sesa njoftimin për ekzekutimin në kohën që pritet fillimi i procedurave të ekzekutimit, me përjashtime të rasteve të veçanta, kryesisht për vendimet për caktimin e shpenzimeve dhe për dokumentet noteriale ose dokumentet e tjera autentike (§ 750). Edhe pretendimet e kushtëzuara mund t'i hapin rrugën ekzekutimit, por duke garantuar se kreditori, nëpërmjet dokumenteve publike ose dokumenteve të vërtetuara nga noteri, provon se termat dhe kushtet janë përmbushur (K.pr.c., § 726 para. 1)".

Nga krahasimi del qartë se të gjitha sistemet ligjore parashikojnë lëshimin e një dokumenti zyrtar para fillimit të procedurave të ekzekutimit. Ajo çka ndryshon, është niveli dhe fuqia e këtyre dokumenteve:

"Ato luhaten midis lëshimit të urdhrit të ekzekutimit ose kthimit të tij në një instrument të detyrueshëm, duke prodhuar kështu një kopje të detyrueshme për ekzekutim, dhe prezantimit të një procedure të plotë që kulmon me një urdhër përfundimtar nga gjykata, sikurse ndodh në Austri".

Shënim i autorit: *Neni 511 i Kodit shqiptar të procedurës civile parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Po sipas ligjit shqiptar, për fillimin e procedurave të ekzekutimit kërkohet lëshimi i një autorizimi të veçantë. Në të vërtetë, për këtë qëllim është i domosdoshëm një urdhër për ekzekutim, i cili mund të jepet nga gjykata që ka marrë vendimin, në rastet kur titujt ekzekutivë janë vendime civile të gjykatës ose vendime penale në pjesën që bën fjalë për të drejta pasurore. Urdhri i ekzekutimit duhet të jepet nga gjykata e apelit në rastet e vendimeve të dhëna nga gjykata të shteteve të huaja ose nga gjykata arbitrazhi të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi, si dhe nga gjykata e vendit ku është dhënë vendimi për vendimet e gjykatave shqiptare të arbitrazhit. Së fundi, nga gjykata e vendit ku është caktuar të bëhet ekzekutimi në rastet e akteve noteriale ose të dokumenteve të tjera që kanë fuqi ekzekutuese sipas Kodit shqiptar.*

Sipas nenit 515, titulli i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor me kërkesën e kreditorit, si edhe të prokurorit, në çështjet për të cilat ai ka ngritur padi.

Lajmërimi për ekzekutim i komunikohet debitorit nga përmbaruesi gjyqësor, i cili cakton një afat prej 5 ditësh nëse detyrimi që duhet të ekzekutohet, është pagë ose detyrim për ushqim, dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera (neni 517). Lajmërimi që i jepet debitorit, duhet të përmbajë një shkurtim të urdhrit të ekzekutimit, vendin dhe adresën e kreditorit dhe paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim (neni 518).

Me kalimin e afatit 10-ditor (ose 5-ditor në dy rastet e veçanta të përmendura më sipër) të lajmërimit për ekzekutim të parashikuar në nenin 517, fillon ekzekutimi i detyrueshëm. Nëse ka rrezik se, me kalimin e afatit, ekzekutimi bëhet i pamundur, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm.

Ndonjëherë, për ekzekutimin e detyrueshëm mund të kërkohet ndihma e policisë së rendit publik. Kjo parashikohet nga neni 523, sipas të cilit, kur është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit për të kërkuar sendet e tij që ndodhen në to, përmbaruesi gjyqësor mund të kërkojë ndihmën e policisë së rendit.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm në të holla

Ekzekutimi i detyrimit në të holla është procedura më e rëndësishme dhe më e përdorur e procedurave të ekzekutimit. Për të njohur më nga afër arsyet dhe shpjegimet e një mbizotërimi të tillë, si edhe të metodave të pranuara nga sistemet më kryesore të traditës europiane, mund të lexohet një fragment i qartë dhe i plotë i shkëputur nga kapitulli X i *Enciklopedisë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar*, të cituar më sipër, f. 57:

"Më lart është përmendur se klasifikimi i përgjithshëm i llojeve të ekzekutimit në kohët moderne është i orientuar drejt natyrës së pretendimit. Kjo nënkupton se natyra e pretendimit që duhet të përmbushet nëpërmjet ekzekutimit, shërben si kriter për dallimin e llojeve të ekzekutimit, e parë kjo në raport me kriteret që lidhen me natyrën e objektit të ekzekutimit ose të mjeteve të tij të veçanta, llojin e instrumenteve detyruese ose llojin e gjykatës nga kanë rrjedhur ato. Pra, ekzekutimi i detyrimit 'në të holla' i përket përmbushjes së çfarëdolloj instrumenti të detyrueshëm të shprehur në termat e pretendimeve në të holla.

Brenda ekzekutimit të detyrimit në të holla, trajtimi i mëtejshëm i mënyrave të ndryshme duhet të ndjekë linja të ndryshme, duke qenë se të gjitha ato, në çdo rast, kanë të bëjnë me pretendime monetare. Por, në shumicën dërrmuese të rasteve, mënyra normale e ekzekutimit të një vendimi që parashikon një detyrim në të holla, konsiston në vendosjen e një sekuestroje mbi pronën e debitorit në kuptimin më të gjerë të fjalës".

Shënim i autorit: *Kjo ndodh edhe sipas ligjit shqiptar, sikurse mund të shihet në nenin 527 të Kodit shqiptar të procedurës civile, sipas të cilit, në rast të ekzekutimit të*

detyrimit në të holla, "përmbaruesi gjyqësor fillon ekzekutimin e detyrueshëm me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, në masën që do të jetë e arsyeshme për plotësimin e detyrimit".

"Rëndësia aktuale e ekzekutimit të detyrimit në të holla në raport me llojet e tjera të ekzekutimeve mund të shpjegohet nëpërmjet dy faktorëve. Së pari, karakteri mbizotërues monetar i transaksioneve moderne financiare i lë shumë pak hapësira zbatimit të llojeve të tjera të ekzekutimeve. Së dyti, duke qenë se ekzekutimi i detyrimit në të holla i drejtohet kryesisht sendeve të debitorit, koncepti dhe funksioni real i pronës së debitorit për plotësimin e pretendimeve të kreditorëve të mundshëm bëhet relevant. Në këtë aspekt, sistemet ligjore romaniste kanë pranuar një rregull të shprehur duke ua nënshtruar të gjitha sendet e debitorit masave të ekzekutimit nga kreditorët e tij ose për përfitimin e tyre. Sipas një formule të qartë të Kodit francez të procedurës civile, "sendet e debitorit janë pengu i përbashkët i kreditorëve të tij" (neni 2093); sigurisht, fjala "peng" nuk përdoret në kuptimin teknik të termit. Kjo rregull franceze është pranuar edhe nga disa sisteme ligjore të Amerikës Latine. Në Kodin civil italian, neni 2740, para.1, dhe në Kodin civil spanjoll, neni 1911, parashikohet se "debitori është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të tij me të gjitha sendet që disponon dhe do të disponojë".

Në vendet e Europës Qendrore është pranuar gjerësisht po i njëjti parim (nenet 829-845 të K.pr.c. gjerman dhe nenet 294-319 të K.pr.c. austriak). Në përgjithësi, përjashtimi i vetëm i kësaj rregulle të përgjithshme për t'ua nënshtruar të gjitha sendet e debitorit ekzekutimit të detyrimit në të holla kundrejt tij, është parashikuar dhe, në të njëjtën kohë, edhe është kufizuar nga përjashtimet ligjore".

Ndërsa parimi i "përgjegjësisë financiare" të debitorit është pranuar kudo, ekzistojnë mënyra të ndryshme për vënien në jetë të këtij parimi. Pjesa më e madhe e sistemeve ligjore duket se bëjnë dallimin ndërmjet tri llojeve të ekzekutimit: ekzekutimit mbi sendet e luajtshme, ekzekutimit mbi sendet e paluajtshme dhe ekzekutimit mbi shpërblimin. Të tria llojet e ekzekutimit të detyrimit në të holla, duke përfshirë edhe ekzekutimin mbi shpërblimin, kërkojnë një instrument detyrues. Dallime të tilla, bazuar në traditat e gjata ligjore, janë analizuar në mënyrë të hollësishme në *Enciklopedinë ndërkombëtare të së drejtës së krahasuar* (seksioni që i kushtohet procedurës civile, kapitulli X, Procedurat e ekzekutimit, f. 57 e në vazhdim):

"Sistemet ligjore të Europës Qendrore pranojnë një ekzekutim monetar të degëzuar, në varësi të objektit të ekzekutimit – sende të luajtshme ose të paluajtshme. Kategoria e parë nuk mbulon vetëm sendet, por edhe të drejtat, veçanërisht pretendimet e debitorit kundrejt palëve të treta [...]. Ndërsa sekuestroja mbi sendet e debitorit, për shkak të "ekzistencës së tyre fizike", mund të vendoset me anë të një akti të përmbaruesit gjyqësor (K.pr.c. gjerman, neni 808/1), sekuestroja mbi të drejtat e debitorit kërkon pjesëmarrjen aktive të gjykatës që lëshon urdhrin e ekzekutimit me efekt të tillë. Nga ana tjetër, ekzekutimi i detyrimit në të holla mbi sendet e paluajtshme u nënshtrohet kërkesave formale më të rrepta dhe mund të çojë në regjistrimin e detyrueshëm hipotekor, në shitjen e sendit të paluajtshëm me ankand publik ose në administrimin e tij të detyrueshëm (K.pr.c. gjerman, § 866).

Tradicionalisht, sistemet ligjore romaniste kanë njohur larmi të llojeve të ekzekutimit të detyrimit në të holla, në varësi të natyrës së sendeve mbi të cilat do të vendoset sekuestroja. Bazuar në dallimin themelor ndërmjet sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, i cili në çështjet që lidhen me ekzekutimet, përkrah idenë se sendet e paluajtshme duhet të ruhen për familjen sa më shumë që të jetë e mundur, Kodi francez i procedurës civile ka pranuar jo më pak se katër lloje të ekzekutimit mbi sendet e luajtshme (sekuestroja e rregullt, sekuestroja mbi të korrat, sekuestroja mbi shpërblimet, si edhe sekuestroja mbi sendet në bashkëpronësi kundrejt sendeve me pronar të vetëm, pa përmendur sekuestron e ndërlikuar mbi sendet e paluajtshme [...].

Por, brenda sistemeve romaniste, jo të gjitha vendet kanë imituar larminë franceze të llojeve të sekuestros. Në këtë kontekst, trajtimi i ligjit italian do të ishte i vlefshëm, pasi, në disa aspekte, ai duket shumë i ngjashëm me modelin shqiptar.

"Ligji italian bën vetëm dallimin ndërmjet sendeve që mbahen nga debitori dhe sekuestron mbi shpërblimet (shih nenet 513 dhe 543 të Kodit italian të procedurës civile) dhe, në të njëjtën kohë, paraqet një kapitull të parë për "shitjen e detyruar në përgjithësi" (nenet 483-512); po ashtu, ai është sistemi i vetëm që parashikon një procedurë më të thjeshtë në rast se vlera e sendeve të luajtshme mbi të cilat vendoset sekuestroja nuk e kalon shumën prej 5164,57 eurosh".

Shënim i autorit: *Dallimi ndërmjet sekuestros së sendeve të debitorit dhe sekuestros mbi shpërblimet parashikohet edhe në Kodin shqiptar. Shih nenet 540 e në vazhdim, të cilat rregullojnë çështjen e parë dhe nenet 581 e në vazhdim, të cilat rregullojnë çështjen e dytë. Kodi shqiptar ngjan me Kodin italian edhe për faktin se ai përmban një kapitull që u kushtohet dispozitave të përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm (nenet 510-539).*

"Nga ana tjetër, edhe në Francë, reforma ligjore e vitit 1991 i ka reduktuar në dy llojet e ekzekutimeve të detyrimeve në të holla mbi sendet e luajtshme, d.m.th. vënia e sekuestros mbi shpërblimet (e cila praktikisht mbulon shpërblimet më specifike të pagave) dhe vënia e sekuestros mbi sendet e luajtshme fizike. Një sekuestro që nuk njihet më, është sekuestroja mbi të korrat, e cila në të vërtetë kishte kohë që nuk përdorej më dhe tashmë është zëvendësuar me një sekuestro tjetër mbi të korrat. Duke dashur të sjellë së bashku llojet e ekzekutimeve dhe të përmirësojë instrumentet përkatëse të ekzekutimit, po i njëjti ligj francez e lejon sekuestron mbi shpërblimet vetëm mbi bazën e një instrumenti detyrues, duke shmangur në këtë mënyrë nevojën e konfirmimeve të tjera gjyqësore ose të çfarëdolloj ndërhyrjeje tjetër lidhur me të".

6. Etapat në procedurat e likuidimit

Në vijim, do të paraqesim shkurtimisht etapat kryesore të procedurave të likuidimit. Në sistemin italian, i cili është shumë i ngjashëm me sistemin shqiptar, ato janë trajtuar me hollësi nga në *Procedura civile* në Itali (M. Cappelletti ,1965, f. 325 e në vazhdim):

"Likuidimi i detyruar i sendeve kryhet në disa etapa. Së pari, sekuestrohen sendet e debitorit. Së dyti, mund të ketë ndërhyrje të kreditorëve të tretë. Së treti, sendet e debitorit likuidohen. Së katërti, kreditori paguhet ose të ardhurat nga likuidimi i sendeve të debitorit shpërndahen mes kreditorëve [...].

Sekuestroja është hapi i parë i domosdoshëm në likuidimin e detyrueshëm të pronës që është lënë peng. Me kërkesë të kreditorit, përmbaruesi gjyqësor urdhëron debitorin të mos kryejë asnjë veprim që do të ingatërrohej me likuidimin e pronës së sekuestruar.

Shënim i autorit: *Sikurse e kemi parë edhe sipas ligjit shqiptar, vënia e sekuestros bëhet në mënyra të ndryshme në varësi të objektit mbi të cilin do të kryhet ekzekutimi – sende të luajtshme ose të paluajtshme (shih nenet 540-559 të Kodit shqiptar, për sendet e luajtshme dhe nenet 560-580, për sendet e paluajtshme).*

"Pasi procedurat e ekzekutimit të jenë iniciuar nga njëri prej kreditorëve, mund të ndërhyjnë edhe kreditorët e tjerë"

Shënim i autorit: *Për këtë mund të shihen nenet 534 e në vazhdim të Kodit shqiptar, në pjesën që trajton pjesëmarrjen e kreditorëve të tjerë.*

"Normalisht, sendet e sekuestruara te debitorit shiten. Por, ndonjëherë, në vend të shitjes, kreditorëve u kalohen sendet e debitorit. Sendet e sekuestruara mund të shiten ose mund t'u kalohen kreditorëve me kërkesë të kreditorit që ka filluar procedurën e ekzekutimit ose të kreditorëve të tjerë ndërhyrës që posedojnë tituj ekzekutivë. Nëse sendet nuk prishen, kërkesa për shitjen ose për kalimin e tyre nuk mund të bëhet pa kaluar afati 10-ditor i sekuestros. Sendet e sekuestruara zakonisht shiten në ankand publik [...].

Nëse sendet e debitorit nuk u kalohen kreditorëve në përmbushje të pretendimeve të tyre, të ardhurat nga likuidimi duhet të shpërndahen. Të parat paguhen kostot dhe shpenzimet për procedurat. Së dyti paguhen kreditorët e privilegjuar sipas rëndësisë që kanë. Së treti paguhen kreditorët e pasiguruar që kanë filluar ose kanë ndërhyrë në kohën e duhur në procedurat e ekzekutimit: nëse nuk ka fonde të mjaftueshme për t'i kënaqur këta kreditorë, ata paguhen në përpjesëtim me pretendimet e tyre. Së katërti paguhen kreditorët që kanë ndërhyrë pasi gjykata ka nxjerrë autorizimin për likuidimin e sendeve, duke i ndarë ato në përpjesëtim me pretendimet e tyre. Çdo diferencë mbi detyrimet i kthehet debitorit [...].

Disa sende të pronësisë personale përjashtohen nga likuidimi i detyruar. Ato përfshijnë objektet me natyrë fetare, armët e zjarrit, objekte të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrave publike, si dhe unazat e martesës, medaljet, mjetet që janë të domosdoshme për tregtinë e debitorit, krevatet, veshmbathjet etj.

Një rregull e tillë është parashikuar edhe në Kodin shqiptar: shih nenin 529 (sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja).

7. Ekzekutimet specifike: ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar dhe ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar

Megjithëse ekzekutimi i detyrimit në të holla është mbizotërues në të gjitha sistemet e procedurave civile të trajtuara më sipër për shkak të monetarizimit total të ekonomisë moderne, ka fusha ku ekzekutimi i detyrimit në të holla është jopraktik dhe disi i pamundur. Në këtë kontekst, po shkëputim një fragment nga Enciklopedia e së drejtës së krahasuar, e cituar edhe më sipër (f. 94):

"Së pari, brenda fushës klasike të kontratave, ku palët që paguajnë të holla, paditin palët e tjera për mospërmbushje të detyrimit që kanë marrë përsipër, p.sh. shitësi, pala paditëse mund të mos mbrohet si duhet nga shpërblimi i dëmeve, por mund të parapëlqejë ekzekutimin specifik. Së dyti, brenda dhe

jashtë fushës së kontratave (p.sh., në rastet e konkurrencës së padrejtë edhe të pandershme), ekzekutimi specifik do të përkonte më mirë me interesin e kreditorit nëse thelbi i detyrimit të palës së paditur do të konsistonte në moskryerjen e një veprimi të caktuar ose në lejimin e kryerjes së një veprimi të caktuar; në raste të ngjashme, dëmet, nëse ka ndonjë, në rastin më mirë, kanë funksion ndihmës [...]".

Shënim i autorit: *Ligji shqiptar e rregullon ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar në nenet 601-604. Neni 601 parashikon: "Kur sendi i luajtshëm për të cilin është dhënë vendim, nuk është dorëzuar vullnetarisht nga debitori brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbaruesit gjyqësor, merret në mënyrë të detyrueshme prej tij dhe i dorëzohet kreditorit". Ndërsa neni 602 lidhet me rastet e sendeve të paluajtshme dhe parashikon: "Kur sendi i paluajtshëm për të cilin është dhënë vendim, nuk është liruar vullnetarisht nga debitori brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbaruesit gjyqësor, kreditori vihet në posedim të sendit". Paragrafi i dytë i këtij neni specifikon: "Në ditën dhe orën e caktuar, përmbaruesi gjyqësor, i pajisur me urdhrin e ekzekutimit, shkon në vendin ku ndodhet sendi dhe vë kreditorin në posedim të tij, duke porositur persona të tjerë të cilët mbajnë sendin që ta njohin si pronar të tij".*

Rregulla të tilla janë ekuivalente me ato të Kodit italian të procedurës civile për ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar të luajtshëm ose të paluajtshëm (nenet 605-611). Procedurat e këtij lloj ekzekutimi, sipas ligjit italian, janë shpjeguar qartë nga M. CAPPELLETTI në librin e tij "Procedura civile në Itali" (1965, f. 335):

"Procedurat për dorëzimin e një sendi të luajtshëm ose për lirimin e një sendi të paluajtshëm kryesisht kryhen nga përmbaruesi gjyqësor (sherifi). Me kërkesën e kreditorit, me mbarimin e afatit të paralajmërimit që jepet në parim, përmbaruesi gjyqësor procedon me ekzekutimin, pa ndërhyrje gjyqësore. Gjyqtarit i kërkohet të marrë vendim për çdo vështirësi që mund të krijohet. Këto vështirësi paraqiten gojarisht nga palët në gjykatë, pa shumë formalitete (Kodi italian i procedurës civile, neni 610).

Nëse kërkohet dorëzimi i sendeve të luajtshme, përmbaruesi gjyqësor shkon në vendin ku ndodhet sendi. Ai mund të vihet në kërkim të objekteve duke përdorur të njëjtat kompetenca, si në rastin e venies së sekuestros. Nëse i gjen këto sende, ai ia dorëzon ato kreditorit ose agjentit të tij. Nëse urdhërohet transferimi i sendeve të paluajtshme, përmbaruesi gjyqësor i fillon procedurat për ekzekutimin duke e lajmëruar debitorin të paktën tri ditë përpara vajtjes

së tij (neni 608, paragrafi 1). Në datën e caktuar, përmbaruesi gjyqësor e vendos kreditorin ose agjentin e tij në posedim të sendit, duke i dhënë çelësin (nëse ka) dhe i njofton personat e tjerë që mund të janë në ndërtesë, për pronarin e ri. Përmbaruesi gjyqësor mund të përdorë policinë nëse është i nevojshëm përdorimi i forcës për të parandaluar shqetësimet publike".

Procedimi tjetër special i rregulluar nga Kodi shqiptar është ai i ekzekutimit të detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar (nenet 605-607).

Neni 605 parashikon se, kur debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij që ka të bëjë me një veprim që mund ta kryejnë edhe persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë këtë veprim për llogari të debitorit. Sipas nenit 606, në rast të kundërt, pra kur veprimi mund të kryhet vetëm nga debitori, gjykata kompetente e vendit të ekzekutimit, me kërkesë të kreditorit, mund ta detyrojë debitorin ta kryejë veprimin, duke parashikuar se, në rast refuzimi, ai do të gjobitet. Rregulla të tilla mund të gjenden edhe në sistemet e Europës Qendrore, veçanërisht në Gjermani dhe në Austri.

PJESA 2

1. Ekzekutimi i detyrueshëm sipas legjislacionit shqiptar

Sado bindës dhe i drejtë të jetë në vetvete një vendim përfundimtar i dhënë nga gjykata, ai mbetet një deklaratë e thjeshtë për të drejtat dhe detyrimet e palëve po qe se palët nuk kanë mundësi ta vënë në zbatim me anë të masave shtrënguese. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për të gjithë titujt e tjerë ekzekutivë. Këto masa shtrënguese për respektimin e normave të së drejtës në fushën e raporteve juridike civile gjejnë shprehjen e tyre pikërisht në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Ekzekutimi i titujve ekzekutivë u është ngarkuar përmbaruesve gjyqësorë. Me kërkesë të kreditorit, urdhri i ekzekutimit, i lëshuar nga gjykata, vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor kompetent. Kompetent për të vënë në ekzekutim titullin ekzekutiv është përmbaruesi gjyqësor i:

a) vendit ku ndodhen sendet e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë, ndaj të cilave drejtohet ekzekutimi;
b) vendit të banimit të personit të tretë të detyruar, kur ekzekutimi drejtohet kundër kredisë që ka për të marrë debitori nga ky person;
c) vendit të ekzekutimit të detyrimit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën, ia dërgon këtë përmbaruesit gjyqësor kompetent, pasi vë më parë sekuestro mbi sendin ose mbi kredinë e debitorit.

Konflikti për kompetencë nuk lejohet, por përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të parashtrojë moskompetencën e tij në gjykatën e shkallës së parë ku e ushtron veprimtarinë, e cila e shqyrton atë. Kundër vendimit të gjykatës palët kanë të drejtë të bëjnë ankim të veçantë (neni 516 i K.pr.c.). Nga pikëpamja administrative, përmbaruesit gjyqësorë varen nga Ministria e Drejtësisë. Mbikëqyrja gjyqësore e veprimeve të përmbaruesve gjyqësorë ushtrohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, kompetente e vendit të ekzekutimit.

Në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe të titujve të tjerë ekzekutivë, si rregull, marrin pjesë dy palë: njëra që kërkon vënien e titullit ekzekutiv në ekzekutim – **kreditori** dhe tjetra e detyruar nga titulli i ekzekutimit për ekzekutim – **debitori.**

Koncepti i kreditorit dhe i debitorit në procesin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor nuk përputhet gjithmonë me konceptin e paditësit dhe të padituri në procesin e gjykimit të padisë. Kur me vendimin përfundimtar të gjykatës kërkimet e paditësit janë pranuar, në ekzekutimin e vendimit, paditësi është kreditor dhe i padituri debitor. Por, kur kërkimet e paditësit janë refuzuar dhe paditësi është detyruar me diçka në favor të të padituri, p.sh., me shpenzimet gjyqësore, kreditor në procesin e ekzekutimit bëhet i padituri dhe palë e detyruar, d.m.th. debitor, bëhet paditësi.

Në procesin e ekzekutimit mund të ketë edhe raste suksedimi në të drejta, p.sh., në rast riorganizimi të personave juridikë ose në rast transferimi të të drejtave mbi pasurinë objekt ekzekutimi me trashëgimi ose me kontratë, këto të drejta kalojnë nga paditësi ose i padituri në persona të tjerë. Suksesorët në të drejtat e personave juridikë ose fizikë mund të fillojnë procesin e ekzekutimit të vendimit të dhënë në favor të personit prej të cilit ata heqin të drejtat ose të ndërhyjnë në një proces të filluar duke zënë vendin e kreditorit ose të debitorit të dalë nga procesi.

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor bëhet në bazë të po atyre parimeve të procesit civil mbi të cilat është bazuar gjykimi i padisë. Po ashtu, sikundër procesi gjyqësor fillon vetëm me kërkimin e palës së interesuar, në përputhje me parimin e disponibilitetit, ashtu edhe procesi i ekzekutimit të vendimit fillon mbi kërkimin e kreditorit. Në procesin e gjykimit të padisë, paditësi ka të drejtë t'i ndryshojë kërkimet e padisë, t'i shtojë ose t'i pakësojë ato, ka të drejtë të heqë dorë nga padia, ta përfundojë çështjen me pajtim; po ashtu edhe

në procesin e ekzekutimit, kreditori ka të drejtë të shtyjë ekzekutimin për një kohë tjetër, ka të drejtë të heqë dorë pjesërisht ose plotësisht nga ekzekutimi dhe t'i japë fund ekzekutimit me marrëveshje pajtimi.

Po ashtu, sikundër në procesin e gjykimit, palët mund të marrin pjesë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit edhe në kryerjen e veprimeve përmbarimore, kanë të drejtë të asistojnë të gjitha veprimet e përmbaruesit gjyqësor, të bëjnë përpara përmbaruesit çdolloj pretendimi dhe të paraqesin prova të nevojshme nga pikëpamja e tyre për mbrojtjen e interesave të vet, të marrin akte dhe kopje të dokumenteve që u nevojiten nga dosja e përmbaruesit gjyqësor, të kundërshtojnë veprimet e përmbaruesit gjyqësor në procesin e ekzekutimit. Debitori duhet të njoftohet nga përmbaruesi gjyqësor, si mbi fillimin e ekzekutimit të vendimit, ashtu edhe mbi veprimet më të rëndësishme përmbarimore, p.sh., për ditën e inventarizimit, ditën e shitjes në ankand etj. Kreditori ka të drejtë të tregojë mënyrën e ekzekutimit dhe debitorit i është dhënë e drejta të caktojë sendet mbi të cilat duhet të procedohet në radhë të parë ekzekutimi, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se kjo plotëson kërkesën e kreditorit (neni 528 i K.pr.c.).

Përmbaruesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesverbal, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklarimet e bëra nga palët, sendet e marra, shuma e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin. Shpenzimet e bëra për ekzekutimin paguhen fillimisht nga kreditori, me rastin e kryerjes së çdo veprimi, dhe pastaj ndalen nga shuma e nxjerrë duke ia kthyer kreditorit (neni 525 i K.pr.c.).

1.1. Objekti i ekzekutimit

Objekt i ekzekutimit mund të jetë vetëm pasuria e debitorit. Objekt ekzekutimi mund të jetë, si pasuria e ndodhur në disponimin e drejtpërdrejtë të debitorit, ashtu edhe pasuria që persona të tretë i detyrohen atij. Por disa nga sendet e debitorit nuk mund të sekuestrohen. Sipas nenit 529 të Kodit të procedurës civile, nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit përjashtohen:

1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij, si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet, për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;

2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;

3. dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;

4. librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;

5. deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;

6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjare, ose bursa të studimit, përveç kur detyrimi është për ushqim (në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se gjysma e shumës së pensionit ose të bursës);

7. frutat natyrore, një muaj para se ato të piqen.

Për të ruajtur veprimtarinë publike të institucioneve buxhetore, pasuritë e tyre të luajtshme dhe të paluajtshme nuk mund të jenë objekt sekuestrimi dhe shitjeje në ekzekutim të detyrimeve në të holla. Përmbaruesi gjyqësor e fillon procesin e ekzekutimit duke i dërguar debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim, dhe prej 10 ditësh, në të gjitha rastet e tjera (neni 517 & I K.pr.c.).

Lajmërimi duhet të përmbajë një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit, vendin dhe adresën e kreditorit, si dhe paralajmërimin se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se detyrimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Në rast se debitori vdes pas vënies në ekzekutim të titullit, por para se të jenë përfunduar së kryeri veprimet e nevojshme të ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, para se të vazhdojë veprimet e tij, duhet t'u dërgojë trashëgimtarëve të debitorit të vdekur, kur këta janë njohur, një lajmërim të ri për ta ekzekutuar ata vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit (neni 518 i K.pr.c.).

Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit trashëgimlënës vihet në ekzekutim mbi pasurinë e trashëgimtarëve të tij, por brenda masës së pasurisë së trashëguar prej tyre nga trashëgimlënësi (neni 520 i K.pr.c.). Dërgimi i lajmërimit ka për qëllim që debitori të vihet në dijeni se kreditori kërkon prej tij ekzekutimin e detyrimit dhe se, në rast se nuk e ekzekuton vendimin vullnetarisht, kundër tij do të përdoren masat e ekzekutimit të detyrueshëm. Lajmërimi i komunikohet debitorit nga përmbaruesi gjyqësor, duke zbatuar rregullat e përgjithshme për njoftimet e akteve (nenet 128-144 të K.pr.c.).

Në rast se debitorit nuk i dihet banimi, përmbaruesi gjyqësor i kërkon gjykatës së shkallës së parë të vendit të ekzekutimit t'i emërojë debitorit një përfaqësues. Gjykata, pasi sqarohet për këtë rrethanë, i emëron debitorit me vendim një përfaqësues (neni 522 i K.pr.c.). Përfaqësuesi e përfaqëson debitorin në të gjithë procesin e ekzekutimit dhe ka të drejtë të shpërblehet për punën e kryer.

Lajmërimi i ekzekutimit mund të shfrytëzohet prej debitorit në keqbesim për të fshehur pasurinë dhe për të ndërruar vendbanimin me qëllim që t'i shmanget ekzekutimit. Prandaj, në rastet kur ka arsye të dyshohet se debitori do të marrë masa për t'iu shmangur ekzekutimit ose me kalimin e afatit të lajmërimit ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm, përmbaruesi gjyqësor, njëkohësisht me komunikimin e lajmërimit, mund të fillojë menjëherë ekzekutimin duke vënë sekuestron mbi pasurinë e debitorit dhe me këtë të shmangë mundësinë e fshehjes ose të shitjes së pasurisë (neni 519 i K.pr.c.).

2. Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë dhe juridikë

2.1. Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme

Në rastin kur debitori është detyruar me pagimin e një shume të hollash, përmbaruesi gjyqësor e lajmëron debitorin për të bërë ekzekutimin vullnetar të detyrimit brenda afatit 5-ditor. Në rast se debitori nuk e bën ekzekutimin vullnetar brenda afatit të lajmërimit, përmbaruesi gjyqësor fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij (neni 527 i K.pr.c.).

Sekuestrimi mbi sendet e luajtshme të debitorit bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbaruesi gjyqësor (neni 540 i K.pr.c.). Inventarizimi përfshin vetëm sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveçse kur del se ato janë të një personi tjetër (neni 541 i K.pr.c.). Inventarizimi i pasurisë konsiston në mbajtjen nga përmbaruesi gjyqësor të një procesverbali të veçantë, i cili duhet të përmbajë:

a) shënimin e urdhrit të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja;
b) emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor, të debitorit, të kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim;
c) vendin ku kryhet inventarizimi dhe kohën e kryerjes së tij;
ç) pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara;
d) përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre;
dh) kujt i lihen për ruajtje sendet;
e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim (neni 542 i K.pr.c.).

Pra, sekuestroja konsiston në deklarimin që i bëhet debitorit, me kundërfirmë në procesverbalin e inventarizimit se, nga data e inventarizimit,

pasuria në fjalë konsiderohet nën sekuestro dhe se atij i ndalohet disponimi mbi pasurinë e inventarizuar (shitja e saj, dhurimi, asgjësimi i saj etj.), nën paralajmërimin e përgjegjësisë penale.

Inventarizimi i pasurisë bëhet në praninë e debitorit ose të përfaqësuesit të tij dhe të dy dëshmitarëve. Mungesa e debitorit nuk pengon kryerjen e inventarizimit. Kur mungon debitori, inventarizimi i pasurisë mund të bëhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe, kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore.

Me rastin e inventarizimit të pasurisë, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të hyjë në shtëpinë e debitorit, si dhe në të gjitha lokalet e debitorit dhe të kontrollojë mjediset që shërbejnë për ruajtjen e sendeve. Në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga sigurimi (neni 530 i K.pr.c.).

Masat shtrënguese të aplikuara në procesin e ekzekutimit kanë për qëllim t'i sigurojnë kreditorit pagimin e plotë. Masat ekzekutuese nuk duhet të shkojnë tej këtij qëllimi. Prandaj pasuria mund t'i nënshtrohet inventarizimit vetëm aq sa nevojitet për të paguar kreditorin dhe për të mbuluar shpenzimet përmbarimore. Njëkohësisht me inventarizimin bëhet edhe vlerësimi i pasurisë së inventarizuar. Në rast se në inventar përfshihet një pasuri, çmuarja e së cilës paraqitet e vështirë, si dhe kur kreditori ose debitori nuk pajtohen me çmimin që i ka vënë përmbaruesi gjyqësor, çmuarja e kësaj bëhet prej një eksperti të thirrur për këtë punë nga përmbaruesi gjyqësor. Vlerësimi bëhet në bazë të çmimeve të tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre (neni 544 i K.pr.c.).

Për të shmangur asgjësimin, vjedhjen ose prishjen e pasurisë së inventarizuar, merren masa për mbrojtjen e saj duke ia dorëzuar në ruajtje një personi të caktuar ose duke e vendosur pasurinë në një vend depozitimi të veçantë. Si rregull, pasuria e inventarizuar i dorëzohet në ruajtje debitorit. Në rast se debitori refuzon ta marrë pasurinë në ruajtje ose kur ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë që pasuria t'i besohet në ruajtje debitorit, përmbaruesi gjyqësor ia beson këtë detyrë një personi të tretë, duke i caktuar atij një shpërblim. Ruajtësi është i detyruar ta ruajë të paprekur pasurinë që i është dorëzuar. Ai nuk ka të drejtë ta përdorë pasurinë që i është dorëzuar në ruajtje dhe as ta japë atë në përdorim të personave të tretë. Kur pasuria e inventarizuar i lihet në ruajtje debitorit, ky mund ta përdorë atë kur, për shkak të cilësive të saj, përdorimi nuk sjell prishjen ose pakësimin e vlerës së pasurisë. Debitori ose personi i tretë, të cilëve u janë lënë në ruajtje sendet e inventarizuara, duhet të japin

llogari për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për sendin. Sipas dispozitave të Kodit penal, këta janë përgjegjës për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e sendeve të inventarizuara (neni 545 i K.pr.c.).

Sendet e çmueshme të debitorit, si: ari, argjendi, platini dhe metalet e grupit të platinit në shufra, copa, monedha dhe artikuj të bërë prej tyre, gurët e çmueshëm, margaritarët dhe artikujt e bërë prej tyre, si dhe valuta e huaj, dokumentet e pagesës në valutë të huaj si kambiale, çeqe, mandate e letra të tjera të kësaj natyre, si dhe tituj të huaj me vlefte, si aksione, obligacione e kuponat përkatës, i jepen për ruajtje një banke (neni 548 i K.pr.c.).

Çdo disponim i sendit të luajtshëm nga ana e debitorit pas vënies së sekuestros, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin, përveç kur, me disponimin, sendi ka kaluar në pronësi të një tjetri që ka qenë në mirëbesim sipas nenit 166 të Kodit civil (neni 547 i K.pr.c.). Kur ekzekutimi bëhet mbi sendet e luajtshme që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe të personave të tjerë, përmbaruesi gjyqësor, pasi bën inventarizimin e gjithë pasurisë së përbashkët, i bën kërkesë gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit, e cila cakton dhe ndan pjesën që i takon debitorit, sipas rregullave të parashikuara nga nenet 369-374 të Kodit të procedurës civile. Mbi këtë pjesë bëhet pastaj ekzekutimi nga përmbaruesi gjyqësor (neni 546 i K.pr.c.).

2.2. Veprimet e shitjes së sendeve të luajtshme të sekuestruara

Pas sekuestrimit, përmbaruesi gjyqësor i dërgon debitorit një lajmërim se, në qoftë se brenda pesë ditëve ai nuk ekzekuton detyrimin, sendet e sekuestruara do të shiten (neni 549 i K.pr.c.). Në rast se edhe pas këtij lajmërimi debitori nuk e ekzekuton detyrimin brenda afatit pesëditor, përmbaruesi gjyqësor i vazhdon veprimet e ekzekutimit me shitjen e sendeve të sekuestruara. Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit ose në dyqanet me shitje të lirë. Sendet e çmueshme, të depozituara në bankë, i shiten asaj dhe merret kundërvlera e tyre nga përmbaruesi gjyqësor, në bazë të kursit zyrtar në kohën e pagesës së tyre (neni 550 i K.pr.c.).

Por, mund të qëllojë që sendi i sekuestruar që duhet shitur për shkak të natyrës ose gjendjes së tij, nuk mund të dërgohet fizikisht në dyqanet me shitje të lirë me qëllim që aty të ekspozohet dhe blerësit e mundshëm të kenë mundësi të njihen me të. Kështu, për shembull, në praktikë, mund të qëllojë që përmbaruesi gjyqësor të ketë sekuestruar aparatura dhe pajisje të ndryshme të debitorit, të cilat janë të vëllimshme dhe nuk mund të lëvizen lehtësisht, ose të ketë sekuestruar produkte ushqimore të debitorit të cilat mund të ruhen vetëm në frigorifer masiv etj. Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor shpall

lajmërimin për shitjen e sendit në një vend të dukshëm të dyqanit me shitje të lirë dhe në zyrën e tij duke treguar në të edhe vendin ku ndodhet sendi (neni 551 i K.pr.c.).

Çmimi i sendit të sekuestruar caktohet nga përmbaruesi gjyqësor dhe debitori. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre, përmbaruesi thërret ekspertë për caktimin e çmimit (neni 552 i K.pr.c.). Për realizimin e shitjes në dyqanin me shitje të lirë, shitësi ka të drejtën e përfitimit të një shpërblimi, masa e të cilit caktohet në një marrëveshje që përmbaruesi gjyqësor dhe shitësi lidhin ndërmjet tyre. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar pas shitjes së tij (neni 553/1 i K.pr.c.). Në rast se brenda dy muajve nga dërgimi i sendit në dyqanin me shitje të lirë ose nga shpallja e lajmërimit për sendet të cilat nuk mund të ekspozohen në këtë dyqan, sendi nuk shitet, përmbaruesi gjyqësor bën një vlerësim të ri të sendit në prani të debitorit dhe të një përfaqësuesi të dyqanit. Mosparaqitja e debitorit nuk e ndalon përmbaruesin gjyqësor të bëjë vlerësimin e ri të sendit (neni 553/2 i K.pr.c.). Në qoftë se brenda dy muajve pas vlerësimit të ri, sendi nuk shitet, përmbaruesi gjyqësor i propozon kreditorit të marrë sendin kundrejt kredisë së tij dhe, kur ky nuk e pranon, sendi i kthehet debitorit (neni 553/4 i K.pr.c.).

Për një kuptim të drejtë të dispozitës së mësipërme na vjen në ndihmë teksti "Procedura civile"me autor Alqiviadh Lamanin (botim i vitit 1962, faqe 275). Sipas autorit, kur thuhet se sendi merret nga kreditori kundrejt kredisë së tij, kjo ka kuptimin se, në qoftë se vlefta e këtij sendi me vlerësimin e ri nuk është baras me kredinë dhe shpenzimet që ka për të marrë kreditori nga debitori, atëherë ai ruan të drejtën e tij për të mbeturën (diferencën) e kredisë së tij dhe të kërkojë një ekzekutim të ri kundrejt debitorit të tij.

Në rast se, për shkak të natyrës ose të gjendjes së sendit të sekuestruar, sendi nuk pranohet për shitje nga dyqanet me shitje të lirë, përmbaruesi gjyqësor organizon shitjen e sendit të sekuestruar me ankand (neni 554 i K.pr.c.). Për shitjen e sendeve me ankand, përmbaruesi gjyqësor shpall në zyrën e tij, në vendin ku ndodhet sendi dhe në vendin e caktuar për shitjen në ankand, një lajmërim ku duhet të tregohet çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand, vendi, dita dhe ora që do të bëhet shitja. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar pesë ditë nga shpallja (neni 555 i K.pr.c.). Shitja në ankand e sendit bëhet ditën e caktuar në lajmërim dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të asaj dite. Blerës quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë. Blerësi duhet ta paguajë çmimin menjëherë (neni 556/1, 2 i K.pr.c.). Në ankand, sipas nenit 709 të Kodit civil, nuk mund të marrin pjesë:

a) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, për sendet që administrojnë ose ruajnë;

b) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, për sendet që këta shesin;

c) gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, për sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi to.

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, pas pesë ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor, duke thirrur debitorin, bën një vlerësim të ri dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit. Mosparaqitja e debitorit nuk e ndalon përmbaruesin të bëjë vlerësimin e ri të sendit. Në qoftë se edhe në ankandin e dytë nuk paraqiten ofertues, përmbaruesi gjyqësor i propozon kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e caktuar në ankandin e ri dhe, kur ky nuk e pranon, sendi i kthehet debitorit (neni 557 i K.pr.c.).

Në rast se kreditori e pranon sendin me vlerën e çmimit të caktuar për ankandin e dytë dhe kjo vlerë është më e vogël se kredia që kreditori ka ndaj debitorit, kredia e tij do të pakësohet me vlerën e sendit të marrë dhe, për pjesën e mbetur të kredisë, të paekzekutuar, kreditori ka të drejtë të kërkojë vazhdimin e ekzekutimit mbi sende të tjera të debitorit. Debitori ka të drejtë të caktojë radhën, sipas së cilës duhet të shiten sendet në ankand. Në qoftë se nga shitja e një ose disa sendeve nxirret një shumë e cila mjafton për të shlyer kredinë e kreditorit dhe shpenzimet e tjera që kanë lidhje me kredinë, ankandi përfundon dhe sendet e tjera nuk shiten (neni 558 i K.pr.c.).

Blerësi i sendit të shitur në dyqanin e shitjes me shitje të lirë ose në ankand bëhet pronar i tij edhe sikur sendi të mos ishte në pronësi të debitorit (neni 559/1 i K.pr.c.). Kjo do të thotë se personi që bëhet pronar i një sendi të shitur nga dyqani me shitje të lirë, i cili ishte lënë atje për shitje nga përmbaruesi gjyqësor, ose i një sendi të shitur në ankand, quhet si blerës me mirëbesim, prandaj dhe pronari i mëparshëm i këtij sendi ka të drejtë të kërkojë vetëm çmimin e realizuar nga shitja në dyqanin me shitje të lirë ose në ankand dhe jo kthimin e sendit.[4]

Kundër shitjes nuk mund të bëhet ankim dhe as të kundërshtohet vlefshmëria e saj, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 556 të këtij Kodi, d.m.th. kur sendi është blerë nga persona që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand (neni 559/2 i K.pr.c.).

---

4) Shih "Procedura civile", Alqiviadh Lamani, botim i vitit 1962, faqe 276.

3. Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme

Sekuestroja për sendet e paluajtshme vihet me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrit të pasurive të paluajtshme të aktit të përmbaruesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të. Një kopje e aktit të përmbaruesit gjyqësor detyrimisht i komunikohet debitorit (neni 560 i K.pr.c.).

Përpara se të vendosë sekuestron, përmbaruesi gjyqësor duhet të sigurohet nëse sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit. Për këtë, përmbaruesit gjyqësor duhet t'i paraqiten dokumente pronësie nga kreditori, ose edhe vetë ai kërkon informata nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit lokal (neni 563 i K.pr.c.). Sendi i paluajtshëm mbi të cilin është vendosur sekuestroja, vlerësohet nga përmbaruesi gjyqësor mbi bazën e vlerës së regjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme apo të organit financiar dhe, në mungesë të një regjistrimi të tillë, me anë të ekspertëve.

Kur debitori apo çdo person tjetër që ka interes për të, pretendojnë për një vlerë më të madhe të sendit në krahasim me atë që figuron në regjistrat e pasurisë së paluajtshme apo të organit financiar, përmbaruesi bën një vlerësim të ri me anë të ekspertëve (neni 564 i K.pr.c.). Sendi që sekuestrohet, i lihet në ruajtje debitorit derisa të bëhet shitja e tij, duke qenë i detyruar debitori të kujdeset për të, si për sendin e tij.

Në rast se debitori nuk kujdeset si duhet për sendin e lënë në ruajtje, përmbaruesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e tij, duke i caktuar një shpërblim. Emërimi dhe caktimi i shpërblimit bëhen në marrëveshje midis përmbaruesit dhe personit tjetër. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar, pas shitjes së tij. Debitori ose personi tjetër, të cilëve u është lënë në ruajtje sendi i paluajtshëm i sekuestruar, duhet të japin llogari për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra për sendin. Për veprime që bëhen pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, ata përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit penal (neni 565 i K.pr.c.).

Çdo veprim i debitorit që përbën disponim të sendit të paluajtshëm pas regjistrimit të sekuestros në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin (neni 566 i K.pr.c.). Kur ekzekutimi bëhet mbi një send të paluajtshëm që është në bashkëpronësi, për detyrimin që ka ndonjë nga bashkëpronarët, bëhet sekuestrimi i sendit. Përmbaruesi gjyqësor i bën kërkesë gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe mbi këtë pjesë bëhet ekzekutimi.

Sendi mund të shitet në tërësi kur për këtë kanë dhënë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët e tjerë. Pëlqimi duhet të jepet me akt noterial. Kur sendi është në bashkëpronësi dhe debitorë janë të gjithë bashkëpronarët, për sekuestron dhe shitjen e sendit veprohet njëlloj sikur sendi të ishte në pronësi të një debitori të vetëm.

3.1. Veprimet e shitjes së sendeve të paluajtshme

Pas vënies së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor i dërgon debitorit një lajmërim me të cilin e njofton se sendi i sekuestruar do të shitet, në qoftë se brenda 10 ditëve të njoftimit ai nuk e përmbush detyrimin. Me kalimin e afatit të mësipërm, përmbaruesi gjyqësor bën shpalljen për shitjen e sendit në ankand (neni 567 i K.pr.c.).

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm, Shpallja duhet të përmbajë emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit, nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash, çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja, vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja e ankandit. Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen edhe kreditorët që kanë hipotekë (neni 568 i K.pr.c.).

Shitja e sendit bëhet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor. Ajo vazhdon 15 ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand (neni 569 i K.pr.c.).

Në ankand nuk kanë të drejtë të marrin pjesë debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, si dhe personat e tjerë që tregohen në nenin 709 të Kodit civil, d.m.th.: personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, për sendet që administrojnë ose që ruajnë; personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, për sendet që këta shesin; gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, për sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi to (neni 572/1 i K.pr.c.).

Secili ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit, duhet të depozitojë si garanci në zyrën e përmbarimit një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Kreditori nuk depoziton garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë (neni 570 i K.pr.c.). Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesit

shënojnë, kundrejt nënshkrimit, çmimin që japin për sendin, pavarësisht nga çmimi që kanë dhënë më parë. Kur ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet edhe prokura noteriale (neni 571 i K.pr.c.).

Në përfundim të ankandit, blerës i sendit quhet ai ofertues që ka dhënë çmimin më të lartë, por pronësia mbi sendin i kalon blerësit vetëm pasi të paguajë të gjithë çmimin, duke zbritur prej tij shumën e lënë si garanci. Blerësi duhet ta paguajë çmimin e sendit të blerë brenda 5 ditëve nga mbarimi i ankandit. Me pagimin e çmimit dhe të taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbaruesi gjyqësor jep vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit. Nga kjo ditë, blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitori (neni 574 i K.pr.c.). Kur shuma e realizuar nga shitja në ankand është më e madhe se shuma e kredisë së kreditorit apo kreditorëve, diferenca i kthehet debitorit, pasi zbriten shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit apo për zhvillimin e ankandit (neni 579 i K.pr.c.).

Blerësi vihet në posedim të sendit nga përmbaruesi gjyqësor, si kundrejt debitorit ose personit të cilit i është lënë në ruajtje, ashtu edhe kundrejt çdo personi të tretë që ka në posedim sendin. Personi i tretë për heqjen e sendit nga posedimi mund të mbrohet vetëm me padinë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi sendin (neni 575 i K.pr.c.). Në rast se blerësi nuk paguan brenda pesë ditëve çmimin e sendit, shuma e lënë prej tij si garanci kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri (neni 576 i K.pr.c.).

Garancitë e lëna nga pjesëmarrësit në ankand, të cilët nuk janë shpallur fitues, u kthehen atyre menjëherë pas përfundimit të ankandit (neni 573/3 i K.pr.c.).

Kur në ankandin e parë nuk është ofruar shtesë mbi çmimin me të cilin ka filluar shitja ose nuk është paraqitur asnjë ofertues, për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke zbatuar rregullat për ankandin e parë. Ankandi i ri bëhet pasi të kenë kaluar 3 muaj nga mbarimi i ankandit të parë dhe në bazë të një çmimi të ri jo më të ulët se 20 për qind të çmimit të parë të caktuar nga përmbaruesi gjyqësor në marrëveshje me debitorin. Kur edhe në ankandin e ri sendi nuk shitet, përmbaruesi gjyqësor i propozon kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e caktuar për ankandin e ri dhe, kur ky refuzon, hiqet sekuestroja mbi sendin. Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë, janë disa, përmbaruesi gjyqësor deklaron blerës kreditorin që brenda 3 ditëve nga propozimi jep çmimin më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e ri (neni 577 i K.pr.c.). Në rast se një person pretendon të drejta pronësie mbi sendin e shitur në ankand, shitja e bërë nuk e ndalon këtë të kërkojë sendin e shitur me padi (neni 580/1 i K.pr.c.).

4. Ekzekutimi mbi mjetet e lundrimit

Kur sekuestrohet një anije, në procesverbalin përkatës përmenden emri dhe kombësia e pronarit të anijes, emri i anijes, përshkrimi dhe kapaciteti i saj, si dhe të dhëna të tjera lidhur me regjistrimin e saj. Kopja e procesverbalit të sekuestrimit, si për anijet shqiptare, ashtu edhe për ato të huaja, i jepet personit që mban regjistrin detar të anijes si dhe drejtorit të portit ku është vendosur sekuestrimi, i cili njofton menjëherë pronarin e anijes. Sekuestrimi ndalon lundrimin e anijes (neni 561 i K.pr.c.). Kur sekuestrohet një mjet fluturimi, në procesverbalin përkatës përmendet emri dhe kombësia e pronarit, shenjat dalluese të mjetit, vendi i regjistrimit, kapaciteti e të dhëna të tjera të kësaj natyre.

Kopja e procesverbalit të sekuestrimit i jepet komandantit të aeroportit ku është bërë sekuestrimi i mjetit. Sekuestrimi ndalon fluturimin e mjetit. Komanda e aeroportit kur mjeti i fluturimit është i huaj, njofton menjëherë zyrën ku është regjistruar mjeti i fluturimit (neni 562 i K.pr.c.). Në Kod nuk janë parashikuar rregulla të veçanta lidhur me vlerësimin dhe procedurat për shitjen e mjeteve të lundrimit dhe të fluturimit. Në këto kushte, duke u nisur nga fakti se mënyra e ekzekutimit mbi këto mjete është parashikuar në kreun III të titullit II të pjesës së katërt – *Ekzekutimi i detyrueshëm*, së bashku me rregullat për ekzekutimin mbi sendet e paluajtshme, nxjerrim përfundimin se rregullat e parashikuara për mënyrën e ekzekutimit mbi pasuritë e paluajtshme do të zbatohen për aq sa do të jetë e mundur edhe për ekzekutimin mbi mjetet e lundrimit dhe të fluturimit.

5. Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet për të cilat personat e tretë i detyrohen debitorit

Objekt ekzekutimi mund të jetë jo vetëm pasuria e ndodhur në posedim të drejtpërdrejtë të debitorit, por edhe pasuria e debitorit që, për një arsye ose një tjetër, ndodhet përkohësisht pranë personave të tretë, ose pasuria që i takon të marrë debitori nga persona të tretë, p.sh. qiratë që i detyrohen debitorit qiramarrësit. Veprimet e përmbaruesit gjyqësor në këtë rast janë konstatimi i ndodhjes së pasurisë pranë tyre dhe marrja e masave për të mos lejuar disponimin mbi pasurinë prej debitorit ose personave të tretë, në dëm të kreditorit. Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit, bëhet duke vënë sekuestro mbi ato. Për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin. Me marrjen e lajmërimit të sekuestrimit, personi i tretë ndalohet t'i dorëzojë

debitorit kredinë dhe sendet e tij. Kredia dhe sendet duhet të tregohen me saktësi nga përmbaruesi gjyqësor në lajmërimin e sekuestrimit. Nga dita që personit të tretë i është bërë lajmërimi i sekuestrimit, ai përgjigjet për kreditë dhe sendet e detyruara si ruajtës i tyre (neni 581 i K.pr.c.).

Personi i tretë, brenda pesë ditëve nga lajmërimi i sekuestrimit, është i detyruar t'i përgjigjet përmbaruesit gjyqësor:

a) nëse pranon se kredia ose sendet, mbi të cilat është vendosur sekuestroja, janë të debitorit dhe nëse është gati të shlyejë kredinë ose të dorëzojë sendet;
b) nëse mbi kredinë ose mbi sendet kanë pretendime edhe persona të tjerë;
c) nëse mbi kredinë ose mbi sendet është vënë sekuestër edhe në bazë të një urdhri tjetër ekzekutimi (neni 583/1 i K.pr.c.).

Kur personi i tretë, në përgjigjen e tij, nuk kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, detyrohet t'ia dorëzojë këto përmbaruesit gjyqësor, i cili në këtë rast vepron në të njëjtën mënyrë si për ekzekutimin mbi pasurinë që ndodhet pranë debitorit (neni 584 i K.pr.c.). Por, kur personi i tretë, në përgjigjen e tij drejtuar përmbaruesit gjyqësor, kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, ekzekutimi mbi to nuk mund të vazhdojë dhe kreditori duhet të ngrejë padi për të vërtetuar se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit të tij (neni 585 i K.pr.c.).

Në rast se me vendim gjyqësor të formës së prerë yërtetohet se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit, atëherë përmbaruesi gjyqësor vazhdon veprimet e ekzekutimit në të njëjtën mënyrë si për ekzekutimin mbi pasurinë që ndodhet pranë debitorit. Kur kredia e sekuestruar që personi i tretë i detyrohet debitorit është siguruar me peng, personi që mban sendin mbi të cilin është vënë peng, detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi, pa urdhrin e përmbaruesit gjyqësor (neni 568/1 i K.pr.c.). Kur kredia e sekuestruar është siguruar me hipotekë, në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të bëhet shënim për vënien e sekuestros (neni 568/1 i K.pr.c.).

Personi i tretë të cilit përmbaruesi gjyqësor i dërgon lajmërimin për vënien e sekuestros mbi kreditë ose mbi sendet që ai i detyrohet debitorit në procesin e ekzekutimit, është i detyruar t'i kthejë përgjigje përmbaruesit gjyqësor brenda pesë ditëve nga lajmërimi i sekuestrimit, pasi, nëse nuk jep përgjigje brenda këtij afati, pa shkaqe të aryeshme, dënohet nga përmbaruesi gjyqësor me gjobë nga 1000 deri në 50 000 lekë. Në rast se personi i tretë është institucion ose ndërmarrje shtetërore, përmbaruesi do të dënojë me gjobë personin zyrtar

përgjegjës për moskthimin e përgjigjes. Kundër vendimit të përmbaruesit për dënimin me gjobë personi i tretë mund të bëjë ankim në gjykatën e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga komunikimi i vendimit (neni 583/2, 3 i K.pr.c.).

6. Ekzekutimi mbi pagën e debitorit

Kur debitori është në marrëdhënie pune, ekzekutimin e detyrimit që debitori ka ndaj kreditorit, përmbaruesi gjyqësor ka mundësi ta realizojë nëpërmjet pagës dhe shpërblimeve të tjera që debitori përfiton nga marrëdhënia e punës. Për të realizuar ekzekutimin mbi pagën dhe shpërblimet e tjera nga puna, përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë punëdhënësin e debitorit për vendosjen e sekuestros mbi pagën dhe mbi shpërblimet. Kur vihet sekuestroja mbi pagën e debitorit, prej saj nuk mund të ndalet më shumë se një e dyta, përveç kur parashikohet ndryshe me dispozita të veçanta (neni 533 i K.pr.c.).

Por, në caktimin e masës që i ndalet debitorit nga paga, përmbaruesi gjyqësor duhet të mbajë parasysh faktin se debitorit duhet t'i ngelen mjete financiare për të përballuar jetesën. Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë urdhrin e përmbaruesit gjyqësor për të ndaluar pjesën e caktuar të pagës ose të shpërblimit dhe t'ia kalojë ato drejtpërdrejt kreditorit ose t'i derdhë në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor në bankë. Kjo mënyrë ekzekutimi, në praktikë, gjen zbatim më shumë në rastin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit për ushqim dhe për detyrime të tjera financiare relativisht të vogla.

Kur debitori ndërron vendin e punës, lajmërimi i sekuestrimit i dërgohet qendrës së re të punës nga qendra ku punonte më parë debitori dhe quhet se i është dërguar nga përmbaruesi gjyqësor. Në këtë rast, si edhe në rastin kur debitori pushohet nga puna, duhet të lajmërohet përmbaruesi gjyqësor brenda pesë ditëve (neni 587/2 i K.pr.c.). Kur personi kompetent në qendrën e punës ku punon debitori nuk bën ndalesat nga paga e debitorit, sipas lajmërimit të përmbaruesit gjyqësor, ose nuk lajmëron përmbaruesin gjyqësor për kalimin e debitorit në një punë tjetër ose për pushimin e tij nga puna, ai dënohet nga përmbaruesi gjyqësor me gjobë deri në 30 000 lekë. Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor personi i gjobitur mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij (neni 588 i K.pr.c.).

Gjykata, pasi shqyrton pretendimet e personit të dënuar me gjobë, në rast se i gjen shkaqet e parashtruara të bazuara, revokon vendimin e dënimit me gjobë. Ajo mund të pakësojë edhe vetëm gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, gjykata e refuzon kërkesën për heqjen e dënimit.

7. Ekzekutimi i kërkuar nga shumë kreditorë

Në çdo fazë të ekzekutimit, gjersa nuk është përgatitur nga përmbaruesi gjyqësor projekti i ndarjes së shumave të nxjerra, mund të marrin pjesë në ekzekutim edhe kreditorët e tjerë të po atij debitori. Marrja pjesë e kreditorëve të tjerë në ekzekutim bëhet me kërkesë të tyre të shkruar, së cilës i bashkëngjitet urdhri i ekzekutimit ose një vendim nga përmbaruesi gjyqësor se urdhri i ekzekutimit i është bashkëngjitur një çështjeje tjetër që është në ekzekutim (neni 534 i K.pr.c.).

Kreditori që merr pjesë në ekzekutim, bashkë me kreditorët e tjerë, ka po ato të drejta që ka edhe kreditori, i cili ka vënë i pari sekuestron mbi sendet ose mbi kreditë e debitorit, përveç kur ekzistojnë shkaqe të ligjshme të preferimit. Veprimet e ekzekutimit, të kryera para se kreditori të marrë pjesë bashkë me kreditorët e tjerë, krijojnë të drejta edhe për ta (neni 535 i K.pr.c). Nga shumat e nxjerra nga pasuria e debitorit, në radhë të parë mbulohen shpenzimet përmbarimore dhe shumat e tjera përdoren për të paguar të drejtat e kreditorëve.

Në qoftë se shuma e nxjerrë nga debitori mjafton për të paguar plotësisht të gjithë titujt ekzekutivë të paraqitur për ekzekutim, kreditorëve u paguhen shumat e përmbajtura nga titujt ekzekutivë. Por, në rast se shuma e nxjerrë nga debitori nuk mjafton për të paguar plotësisht të gjithë titujt ekzekutivë, midis kreditorve bëhet ndarja e të hollave sipas radhës dhe proporcionit të kredive. Për të caktuar radhën, të gjitha kreditë ndahen në kategori të përcaktuara. Në nenin 605 të Kodit civil është përcaktuar radhitja e kredive të cilat paguhen me preferim. Në rast se kreditori nuk ka një kredi të preferuar, ai do të procedojë për ekzekutimin me të drejta të barabarta me kreditorët e tjerë.

Ndarja e shumave të nxjerra midis kreditorëve në bazë të radhës konsiston në faktin se në fillim bëhet ndarja e shumës midis kreditorëve të radhës së parë. Në rast se pas pagimit të kredive të radhës së parë mbeten të holla për radhët pasuese, bëhet pagimi i kreditorëve të radhës së dytë, pastaj të radhës së tretë etj. Gjersa të mos jenë paguar kreditë e radhëve të mëparshme, nuk mund të bëhet pagimi i kredive që vijnë më pas. Shteti quhet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimet që po ai debitor i ka shtetit dhe që rrjedhin nga tatimet dhe nga kredi të tjera, shuma e të cilave i është njoftuar përmbaruesit gjyqësor, para se të bëhet ndarja e shumave të tjera. Për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor njofton seksionin përkatës të financës për çdo ekzekutim të filluar prej tij dhe për çdo ndarje që ai bën (neni 536 i K.pr.c.).

Në rast se shuma e nxjerrë nuk mjafton për pagimin e plotë të kreditorve të një radhe, pagimi i tyre bëhet në përpjesëtim me kreditë e tyre. Për pagimin e kreditorëve sipas radhës dhe proporcionit, përmbaruesi gjyqësor bën projektin e ndarjes së shumave të nxjerra midis kreditorëve dhe, në një ditë të caktuar prej tij, thërret debitorin dhe kreditorët dhe u njofton këtë projekt. Në qoftë se brenda 5 ditëve nga paraqitja prej përmbaruesit gjyqësor të projektit të ndarjes nuk bëhet ankim nga palët, përmbaruesi gjyqësor paguan kreditorët sipas projektit të ndarjes. Në rast se nga ana tjetër ka kundërshtime, projekti i ndarjes i paraqitet për miratim gjykatës së shkallës së parë. Gjykata, pasi dëgjon në seancë gjyqësore debitorin dhe kreditorët, vendos për mënyrën e ndarjes së shumave të nxjerra. Vendimi i gjykatës për ndarjen e shumave mund të ankohet me ankim të veçantë në gjykatën e apelit. Pagimi i kreditorëve bëhet vetëm pasi vendimi i gjykatës për ndarjen e shumave merr formën e prerë.

8. Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët dhe, kur nuk ka të tilla, në llogari të thesarit. Nuk lejohet ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e luajtshme e të paluajtshme të institucionit buxhetor. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi te të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga buxheti i shtetit. Kur detyrimi i shtetit është në metale të çmuara, ekzekutimi bëhet me pëlqimin paraprak të ministrit të Financave. Ministri i Financave nxjerr udhëzimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimeve në të holla të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit (neni 589 i K.pr.c.).

9. Ekzekutimi mbi shumat e llogarive në banka

Një mënyrë shumë e shpejtë dhe efektive për ekzekutimin e detyrimeve në të holla është ekzekutimi nëpërmjet llogarive ose depozitave që debitori mund të ketë në banka. Në rastet kur për detyrimet në të holla dihet se debitori ka llogari ose depozita në bankë, në urdhrin e ekzekutimit duhet të përcaktohet edhe banka ku debitori ka llogari ose depozita. Por, kur banka e përcaktuar në urdhrin e ekzekutimit nuk ka gjendje në llogari ose depozitë për debitorin, përmbaruesi gjyqësor njofton të gjitha bankat shetërore dhe private të cilat janë të detyruara të njoftojnë zyrën përkatëse të përmbarimit kur kanë llogari,

depozita ose kredi në emër të debitorit, në të kundërt, personat përgjegjës për mosdhënien e këtij informacioni përgjigjen sipas dispozitave të Kodit penal (neni 593 i K.pr.c.).

Banka, me të marrë urdhrin e ekzekutimit, vë sekuestro mbi llogarinë, depozitat dhe kreditë e debitorit në masën e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, pa pezulluar pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit civil, paguhen me preferim ndaj kredisë për të cilën është vënë sekuestroja (neni 594 i K.pr.c.). Shumat e nxjerra nga llogaria, depozitat dhe kreditë e debitorit kalojnë në llogarinë e kreditorit në të njëjtën bankë ose në një bankë tjetër ose, kur nuk ka të tilla, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor (neni 595 i K.pr.c.).

Kur shuma e llogarive, e depozitave ose e kredive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka respekton radhën e preferimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit civil (neni 597 i K.pr.c.). Kur përmbaruesi ka bazë të dyshojë se banka nuk e ekzekuton pa vend detyrimin tërësisht ose pjesërisht, shkel afatet e ekzekutimit ose nuk respekton radhën e preferimit, përmbaruesi ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga organi drejtues i bankës, duke mbajtur procesverbalin përkatës.

Kur konstatohen shkelje apo parregullsi, përmbaruesi fikson në procesverbal veprime dhe afate të detyrueshme për bankën. Për shkeljet dhe parregullsitë, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të zbatojë masat e parashikuara në nenin 588 të këtij Kodi, d.m.th. të dënojë, sipas rastit, me gjobë deri në 30 000 lekë punonjësit bankarë fajtorë ose organin drejtues të saj, që ka urdhëruar veprime të parregullta (neni 598 i K.pr.c.). Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e rrethit brenda pesë ditëve nga marrja dijeni e vendimit të dënimit (neni 599 i K.pr.c.). Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimet e nevojshme për mënyrën e zbatimit të dispozitave të mësipërme, të detyrueshme për të gjithë sistemin bankar (neni 600 i K.pr.c.). Kur në bankë nuk mund të ekzekutohet detyrimi për mungesë gjendjeje në emër të debitorit ose për shkak preference nga detyrime të tjera, urdhri i ekzekutimit i kthehet kreditorit nëpërmjet zyrës së përmbarimit. Nga ky çast fillon një afat i ri parashkrimi për ekzekutimin e titullit ekzekutiv (neni 596 i K.pr.c.).

10. Ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar

Kur në bazë të vendimit të gjykatës debitori është i detyruar t'i dorëzojë kreditorit sende të luajtshme, të caktuara në mënyrë specifike, p.sh., një orë të një marke të caktuar dhe me një numër të caktuar, në rast se pas lajmërimit që

i është bërë debitorit nga përmbaruesi gjyqësor për ta dorëzuar sendin vullnetarisht në afatin e caktuar, debitori nuk e dorëzon atë vullnetarisht, atëherë ekzekutimi kufizohet në zbulimin nga përmbaruesi gjyqësor i këtyre sendeve pranë debitorit. Për këtë bëhet kontrolli i mjediseve të banesës dhe, në rast nevoje, edhe çelja e lokaleve të debitorit; merren sendet objekt ekzekutimi dhe i dorëzohen kreditorit. Në rast se këto sende nuk zbulohen pranë debitorit ose pranë debitorit ndodhet vetëm një pjesë, ose ato janë prishur, përmbaruesi gjyqësor i merr debitorit vlerën e sendit ose të pjesës që mungon dhe ia dorëzon atë kreditorit si kundërvleftë. Në rast se në urdhrin e ekzekutimit nuk është treguar vlefta e sendit, kjo caktohet nga gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, pasi të dëgjohen palët dhe, në rast nevoje, pyeten edhe dëshmitarë dhe ekspertë. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e vleftës së sendit, palët mund të bëjnë ankim të veçantë në gjykatën e apelit (neni 601 i K.pr.c.).

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit për të kërkuar sendet e tij që ndodhen në to, këto veprime i kryen përmbaruesi gjyqësor në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore, të caktuar nga organet e tij sipas kërkesës së përmbaruesit. Në rast nevoje, përmbaruesi kërkon ndihmën e policisë së rendit (neni 523 i K.pr.c.). Në rast se sendi i luajtshëm që duhet t'i kthehet kreditorit nuk ndodhet pranë debitorit, por pranë një personi të tretë, në këtë rast ekzekutimi do të bëhet sipas rregullave të caktuara në nenet 581 deri në 585 të Kodit të procedurës civile, që bëjnë fjalë për ekzekutimin mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit.

Kur në bazë të vendimit të gjykatës, një pasuri e paluajtshme duhet t'i dorëzohet kreditorit nga pala debitore, përmbaruesi gjyqësor e lajmëron debitorin për të bërë lirimin dhe dorëzimin vullnetar të këtij sendi në një afat të caktuar. Në rast se debitori nuk e liron dhe nuk e dorëzon sendin e paluajtshëm brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbaruesit gjyqësor, atëherë përmbaruesi gjyqësor e vendos kreditorin në posedimin e sendit duke e liruar atë nga të gjitha sendet e debitorit. Për këtë, përmbaruesi gjyqësor, të paktën tri ditë përpara, i njofton debitorit ditën dhe orën në të cilën do të vërë kreditorin në posedim të sendit (neni 602/1 i K.pr.c.).

Në ditën dhe orën e caktuar, përmbaruesi gjyqësor, i pajisur me urdhrin e ekzekutimit, shkon në vendin ku ndodhet sendi dhe e vë kreditorin në posedim të tij, duke porositur personat e tjerë të cilët mbajnë sendin, që ta njohin kreditorin si pronar (neni 602/2 i K.pr.c.). Për lirimin dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm kreditorit, në rast nevoje, përmbaruesi gjyqësor mund të përdorë edhe forcën. Gjithashtu, përmbaruesi gjyqësor duhet ta vërë kreditorin në

posedim të sendit të paluajtshëm edhe në rast se konstaton se sendi ndodhet në posedim të një personi të tretë, i cili ka fituar për vete posedimin e sendit, pas fillimit të çështjes për të cilën është dhënë vendimi që ekzekutohet. Për nxjerrjen e personit të tretë nga sendi, përmbaruesi gjyqësor, në vendimin e tij, duhet të tregojë si ka konstatuar kohën në të cilën personi i tretë ka fituar posedimin (neni 603 i K.pr.c.). Konstatimi i kohës në të cilën personi i tretë ka fituar posedimin lidhet me efektet e nenit 200 të K.pr.c., i cili ka të bëjë me efektet që ka vendimi gjyqësor kundër personit të cilit gjatë zhvillimit të gjykimit midis dy palëve të tjera i kalon e drejta që është në konflikt me akt ndërmjet të gjallëve ose me titull të posaçëm.

Edhe në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor duhet ta lajmërojë personin e tretë për vendimin që ai ka marrë për t'ia dorëzuar sendin kreditorit dhe e fton atë për të bërë ekzekutimin vullnetar të vendimit. Pas përfundimit të afatit për ekzekutimin vullnetar, përmbaruesi e njofton personin e tretë të paktën tri ditë përpara, për ditën dhe orën në të cilën ai do të vërë kreditorin në posedim të sendit. Në rast nevoje, përmbaruesi gjyqësor mund të përdorë edhe forcën për lirimin dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm kreditorit. Kur debitori ose personi i tretë, të cilit i është hequr posedimi i sendit të paluajtshëm, vihet përsëri me çdo mënyrë të paligjshme në posedimin e këtij sendi, përmbaruesi gjyqësor, me kërkesën e kreditorit, i heq atij posedimin e sendit. Në këto raste, debitori ose personi i tretë kanë përgjegjësi sipas dispozitave të Kodit penal (neni 604 i K.pr.c.).

11. Ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar

Kur me vendimin përfundimtar i padituri detyrohet me kryerjen e një veprimi që nuk është i lidhur me dorëzim të hollash ose të një pasurie tjetër, ose kur i padituri detyrohet të heqë dorë nga kryerja e një veprimi, ekzekutimi i një vendimi të tillë nuk është i mundur me asnjërën prej mënyrave të përmendura më sipër (inventarizimi, sekuestroja, shitja e pasurisë). Përmbaruesi gjyqësor e fton debitorin për ekzekutimin e detyrimit brenda një afati të caktuar. Pas plotësimit të afatit, përmbaruesi gjyqësor është i detyruar të kontrollojë nëse debitori e ka plotësuar kërkesën për ekzekutimin vullnetar. Në rast se debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij, që ka të bëjë me një veprim që mund të kryhet edhe nga persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë vetë këtë veprim për llogari të debitorit (neni 605 i K.pr.c.). Në këtë rast, të gjitha shpenzimet për ekzekutimin e detyrimit parapaguhen nga kreditori dhe, më pas, ato nxirren nga përmbaruesi gjyqësor nga pasuria e debitorit sipas rregullave për pagimin e detyrimit në të

holla. Në rast se ekzekutimi i detyrimit mund të kryhet vetëm personalisht nga debitori (si p.sh., bërja e një pikture murale ose e një mozaiku) dhe ky i fundit refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar (si p.sh., kur prindi, i detyruar sipas vendimit gjyqësor për zgjidhjen e martesës për dorëzimin e fëmijës për rritje dhe edukim prindit tjetër, nuk e dorëzon fëmijën), përmbaruesi gjyqësor e gjobit debitorin deri në 50 000 lekë në çdo rast që atij i kërkohet ekzekutimi i detyrimit, deri në ekzekutimin e detyrimit (neni 606/1 i K.pr.c.). Kundër vendimit të gjobitjes të përmbaruesit gjyqësor debitori ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i vendimit.

12. Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit

12.1. Kundërshtimi i vlefshmërisë së titullit ekzekutiv

Gjatë kohës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor ose të titujve të tjerë ekzekutivë mund të ndodhin rrethana ose mund të zbulohen rrethana të reja që e bëjnë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshëm titullin ekzekutiv. Në këto raste, Kodi i procedurës civile, në nenin 609 të tij, i njeh të drejtën debitorit të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas. Në këto raste, titulli ekzekutiv mund të jetë i vlefshëm, por rrethanat që kanë ndodhur më vonë, e bëjnë detyrimin e paqenë ose passjellin shuarjen ose pakësimin e detyrimit. Normalisht, mund të goditet çdo titull ekzekutiv, megjithatë, nga përmbajtja e nenit 609, del se ekziston një ndryshim ndërmjet vendimit gjyqësor si titull ekzekutiv dhe të gjithë titujve të tjerë ekzekutivë.

Vendimi gjyqësor mund të goditet në fazën e ekzekutimit vetëm për fakte që kanë ngjarë pas dhënies së vendimit, sepse shkaqet që kanë ngjarë para dhënies së vendimit, duhet të zgjidhen në fazën e gjykimit të çështjes. Në qoftë se një fakt i rëndësishëm nuk është pranuar padrejtësisht nga gjykata ose nuk është marrë prej saj, kjo bën shkak për goditjen e vendimit me mjetet ligjore të parashikuara për këtë qëllim. P.sh., zbulimi i një dokumenti i cili vërteton se detyrimi është paguar, i cili ka një datë të saktë, por të mëparshme nga dhënia e vendimit, ekzistencën e të cilit debitori nuk ka pasur mundësi ta dinte gjatë kohës së gjykimit të çështjes, nuk mund të përbëjë shkak për goditjen e vendimit si titull ekzekutiv, sepse ka ngjarë para dhënies së tij, por mund të përbëjë shkak për të kërkuar rishikimin e vendimit. Kurse titujt e tjerë ekzekutivë mund të kundërshtohen, si për fakte që kanë ngjarë para daljes së tyre, ashtu edhe për fakte që ngjasin pas daljes së tyre.

Për një kuptim të drejtë të nenit 609 të Kodit të procedurës civile na vjen në ndihmë teksti "Procedura civile", i A.Lamanit që, në faqet 296-297, nënvizon: "Një akt noterial ose kambial, ose një akt tjetër detyrimi mund të goditen për shkak se detyrimi i përmbajtur në të është i simuluar ose se është marrë përsipër nën ndikimin e mashtrimit, të kanosjes ose të lajthimit, ose nga nevoja e madhe, ose për shkak se debitori nuk ka pasur zotësinë juridike për të vepruar, ose se nënshkrimi nuk është i debitorit, ose se personi që godit titullin ekzekutiv, megjithëse ka të njëjtin emër, nuk është debitori i vërtetë etj.".

Gjithashtu, titulli ekzekutiv mund të goditet edhe për fakte që shkaktojnë shuarjen ose pakësimin e shumës së detyrimit, siç janë p.sh.: pagimi, falja e detyrimit, parashkrimi i ekzekutimit etj.".

12.2. Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nga palët

Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim i paraqitet gjykatës së shkallës së parë kompetente të vendit të ekzekutimit. Në këtë mënyrë, për efektet e kompetencës në këtë rast nuk ka rëndësi, as vendbanimi i palëve, as fakti se cila gjykatë e ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit. Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim paraqitet brenda pesë ditëve. Për personat që kanë asistuar në kryerjen e veprimeve objekt ankimi ose që janë njoftuar mbi to me anë lajmërimi, ky afat llogaritet nga dita që është kryer veprimi objekt ankimi. Për personat që nuk janë njoftuar mbi veprimet përmbarimore ose që nuk kanë asistuar në kryerjen e tyre për shkaqe të justifikuara, për shembull për shkak sëmundjeje, afati pesëditor llogaritet nga dita që ankuesi ka marrë dijeni për veprimin objekt ankimi.

Ankimi është parashikuar shprehimisht në disa nene në Kodin e procedurës civile, si p.sh. në nenin 538, për ndarjen midis kreditorëve të shumave të nxjerra nga ekzekutimi. Por, ankimi mund të paraqitet kundër të gjitha veprimeve të përmbaruesit gjyqësor për të cilat nuk flitet shprehimisht në Kodin e procedurës civile, por palët pretendojnë se janë në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe cenojnë interesat e tyre. Në rrugë gjyqësore shqyrtohen ankimet kundër atyre veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, me të cilat ligji lidh pasoja juridike të caktuara, d.m.th. kundër veprimeve që kanë karakter juridik, si për shembull: përfshirja në inventar e një pasurie që në bazë të ligjit nuk mund të jetë objekt ekzekutimi, përfshirja në inventar e një pasurie që nuk është e debitorit, shitja e një pasurie që nuk është e debitorit, shitja e një pasurie duke shkelur rregullat e ankandit etj.

Shqyrtimi i ankimit bëhet nga gjykata në seancë gjyqësore me dyer të hapura,

duke thirrur personat e interesuar, në rast se shihet e nevojshme. Përmbarucsi gjyqësor thirret nga gjykata në cilësinë e personit të tretë, i cili jep shpjegime për veprimet për të cilat paraqitet ankimi. Ankimi kundër veprimeve osc refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kundër vendimit të gjykatës bëhet ankim i veçantë (neni 611 i K.pr.c.). Por, shkak për paraqitjen e ankimit mund të jenë edhe veprimet zyrtare jo të rregullta të përmbaruesit gjyqësor, të cilat, për karakterin e tyre, nuk janë veprime përmbarimore (për shembull, ngadalësia në ekzekutimin e titullit, refuzimi i lëshimit të kopjeve të akteve etj.). Ankimet për shkak të veprimeve të tilla të përmbaruesit gjyqësor u paraqiten strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë. Paraqitja e këtyre ankimeve nuk është e kufizuar me ndonjë afat dhe shqyrtimi i tyre bëhet në rrugë administrative. Pasoja e këtyre ankimeve nuk është revokimi i veprimeve përmbarimore të kryera nga përmbaruesi gjyqësor, por zhdukja e të metave në veprimtarinë e përmbaruesit gjyqësor.

12.3. Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nga personat e tretë

Në kushtet kur ekzekutimi i detyrueshëm drejtohet kundër debitorit, ekzekutimi nuk duhet të dhunojë të drejtat e personave të tretë. Pasurinë e gjetur në një lokal të poseduar nga debitori, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë ta konsiderojë pronë të debitorit dhe ta sekuestrojë. Mirëpo në një lokal të debitorit mund të ketë pasuri që nuk është e debitorit, por e një personi të tretë. Në posedim të debitorit mund të jetë edhe një pasuri që është pronë e përbashkët e debitorit dhe e personave të tjerë. Në rast se sekuestrohet një pasuri që nuk është e debitorit, personat e tretë-pronarë të pasurisë (ose bashkëpronarë të saj) mund t'i paraqesin përmbaruesit gjyqësor provat lidhur me të drejtën e tyre mbi pasurinë dhe të kërkojnë që, në bazë të tyre, të mos sekuestrohet pasuria. Në rast se nga provat e paraqitura rezulton në mënyrë të pakontestueshme se pasuria e sekuestruar nuk është e debitorit, por e personave të tretë, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të vendosë vetë mbi përfshirjen ose jo të pasurisë në fjalë në pasurinë e sekuestruar të debitorit. Në rast se, nga ana tjetër, pretendimet e personave të tretë mbi pronësinë e pasurisë në fjalë kërkojnë një verifikim gjyqësor të fakteve me anë provash, p.sh., me pyetjen e dëshmitarëve, kërkim dokumentesh dhe veprimesh të tjera që dalin nga kompetenca e përmbaruesit gjyqësor, pasuria përfshihet në pasurinë e sekuestruar, por në procesverbal shënohen pretendimet e personave të tretë në lidhje me këtë pasuri.

Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet

ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe, kur është rasti, për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci (neni 612 i K.pr.c.). Në qoftë se vërtetohet se sendi është në pronësi të personit të tretë përpara se sendi të jetë shitur nga përmbaruesi gjyqësor, atëherë gjykata anulon veprimet e përmbaruesit gjyqësor dhe urdhëron që sendi t'i dorëzohet personit të tretë.

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të luajtshëm të sekuestruar, por, në kohën që vendimi ka marrë formë të prerë, sendi është shitur në dyqanin me shitje të lirë ose në ankand, personi i tretë ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor çmimin e shitjes, në qoftë se nuk i është dhënë kreditorit. Në të kundërt, ka të drejtë të kërkojë prej debitorit atë që ka përfituar nga shitja e sendit (neni 613/1 i K.pr.c.). Kërkimi i çmimit të shitjes së sendit nga debitori është i drejtë, sepse, me shitjen e sendit të personit të tretë është paguar kreditori dhe debitori është çliruar nga detyrimi i tij, por me vleftën e një sendi të huaj, d.m.th. është begatuar pa shkak. Për këtë arsye debitori detyrohet t'i kthejë personit të tretë, pronarit të sendit të shitur, atë që ka përfituar nga shitja e këtij sendi.[5)]

Kur vërtetohet se kreditori, në kohën e shitjes së sendit të luajtshëm, e ka ditur se debitori nuk ishte pronar i këtij sendi, ai detyrohet t'i kthejë pronarit të mëparshëm çmimin që ka marrë nga shitja e sendit. Në rast se sendi i është dhënë kreditorit në vend të kredisë së tij, ai detyrohet t'i kthejë sendin, por ruan të drejtën e tij të kredisë kundrejt debitorit (neni 613/2 i K.pr.c.). Edhe kjo është e drejtë, sepse, për shlyerjen e kredisë së tij, kreditori ka kërkuar të shitet si send i debitorit të tij një send që ai e dinte se nuk ishte i debitorit, prandaj, duke nxjerrë një dobi pa të drejtë, ai është i detyruar t'i kthejë personit të tretë vleftën e sendit të shitur ose edhe vetë sendin, në rast se ky i është dhënë atij kundrejt kredisë së tij (shiko A.Lamani).

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të paluajtshëm të shitur në ankand dhe, në bazë të vendimit që ka marrë formë të prerë, sendi i merret blerësit, ky ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor çmimin që ka paguar në qoftë se ky nuk i është dhënë kreditorit. Kur ky i është dhënë kreditorit, personi i tretë ka të drejtë të kërkojë prej tij, si dhe nga debitori, atë

5) (Shih A.Lamani, punim i cituar më sipër, faqe 298)

pjesë të çmimit që ka marrë nga shitja e sendit. Edhe blerësi ka të drejtë, po ashtu, të kërkojë nga organi shtetëror kompetent t'i kthehen shumat që ai ka paguar si taksë për kalimin e sendit në pronësi të tij. Kur sendi i paluajtshëm i është dhënë kreditorit kundrejt kredisë së tij, në bazë të vendimit të gjykatës, sendi i merret kreditorit, i cili ruan të drejtën e tij të kredisë kundrejt debitorit (neni 614 i K.pr.c.).

13. Pezullimi dhe pushimi i ekzekutimit

Procesi i ekzekutimit të një vendimi përfundimtar, i filluar nga përmbaruesi gjyqësor, duhet të vazhdojë pa ndërprerje deri në përfundimin e ekzekutimit. Por ekzekutimi mund të pezullohet kur ekzistojnë disa rrethana që i ndalojnë veprimet ekzekutive dhe ky pezullim vazhdon deri në zhdukjen e shkaqeve ose të pengesave që rrjedhin nga këto rrethana. Pezullimi i procesit të ekzekutimit shënon vetëm një ndalim të përkohshëm të ekzekutimit. Në rast pezullimi nuk mund të kryhen veprime të mëtejshme përmbarimore, por të gjitha veprimet e kryera para pezullimit mbeten në fuqi.

Ekzekutimi pezullohet:

a) me vendim të gjykatës;
b) me kërkesë të kreditorit;
c) në rastet e parashikuara nga shkronjat "c" dhe "ç" të nenit 297 të Kodit të procedurës civile, d.m.th. kur njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik, kur shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor palës që nuk ka, ose që më vonë ka humbur zotësinë për të vepruar si palë, me përjashtim të shitjes në ankand të një sendi të paluajtshëm, për të cilin është shpallur lajmërimi;
ç) në raste të tjera të parashikuara nga ligji (neni 615 i K.pr.c.).

Procesi i ekzekutimit mbaron kur, në rezultat të masave shtrënguese, vendimi është ekzekutuar dhe të drejtat e kreditorit janë realizuar.

Pushimi i ekzekutimit ndodh në rastet kur zhduket baza e ekzekutimit. Ai parashikohet nga neni 616 i Kodit të procedurës civile në rastet kur:

a) debitori i paraqet përmbaruesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, të vërtetuar rregullisht se ka paguar shumën që shënohet në urdhrin e ekzekutimit, ose kuitancë të zyrës postare ose shkresë të bankës me të cilën vërtetohet se shuma që shënohet në urdhrin e ekzekutimit është derdhur në dobi të kreditorit;
b) kreditori heq dorë me shkresë nga ekzekutimi;
c) urdhri i ekzekutimit shfuqizohet;

ç) me vendim të gjykatës që ka marrë formën e prerë, është pranuar padia e debitorit sipas nenit 610 të Kodit të procedurës civile ose personit të tretë, sipas nenit 613 të po këtij Kodi;

d) përmbaruesi gjyqësor vetë ose me kujdesin e kreditorit nuk gjen brenda 6 muajve nga fillim i i ekzekutimit pasuri të debitorit, ose sendi i sekuestruar nuk është shitur dhe kreditori nuk ka pranuar ta marrë sendin kundrejt kredisë së tij.

Pushimi do të vendoset, për shembull, në rast prishjeje të vendimit përfundimtar dhe shuarjes së padisë në bazë të së cilës ishte dhënë vendimi, në rast se kreditori heq dorë nga ekzekutimi pasi është arritur një marrëveshje pajtimi midis palëve etj. Në të gjitha këto raste, përmbaruesi gjyqësor, pasi formon bindjen se nuk ka më nevojë të kryhen veprime përmbarimore, merr vendim për pushimin e ekzekutimit. Ky vendim përjashton mundësinë e kryerjes së mëtejshme të veprimeve përmbarimore.

Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor për pezullimin dhe pushimin e ekzekutimit, palët mund të bëjnë ankim të veçantë në gjykatën e shkallës së parë. Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formën e prerë, përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme si dhe revokon të gjitha masat e marra më parë në lidhje me ekzekutimin. Në rast se pushimi i ekzekutimit është vendosur nga përmbaruesi gjyqësor mbi heqjen dorë me shkresë të kreditorit nga ekzekutimi ose kur përmbaruesi gjyqësor vetë ose me kujdesin e kreditorit nuk gjen brënda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit pasuri të debitorit, ose kur sendi i sekuestruar nuk është shitur dhe kreditori nuk ka pranuar ta marrë sendin kundrejt kredisë së tij, përmbaruesi gjyqësor i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit. Kreditori ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutimin brenda kohës së parashkrimit të titullit ekzekutiv. Në këtë rast, parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formën e prerë (neni 617 & III i K.pr.c.).

14. Parashkrimi i titujve ekzekutivë

Vënia në ekzekutim e një titulli ekzekutiv duhet të kërkohet brenda një kohe të caktuar, ndryshe parashkruhet. Kodi civil nuk parashikon afate të parashkrimit për kërkimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, por kjo nuk do të thotë se të gjitha këto kërkime nuk parashkruhen. Në nenin 113 & II të Kodit civil parashikohet se nuk parashkruhen kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi. Nga zbërthimi i kësaj dispozite nxjerrim përfundimin se kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi që

parashkruhen, i nënshtrohen parashkrimit. Afati i parashkrimit të së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi që lidhet me padi që parashkruhen, është i njëjtë me afatin e parashkrimit të këtyre padive.

E drejta për të kërkuar ekzekutimin e titujve të tjerë ezkzekutivë që nuk janë vendime gjyqësore apo të arbitrazhit, por që lidhen me padi që parashkruhen, parashkruhet sipas afateve të parashikuara në ligje të veçanta. Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli tjetër ekzekutiv ndërpritet me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim të titullit ekzekutiv (neni 131/ç i Kodit civil). Nga zbërthimi i kuptimit të kësaj dispozite nxjerrim përfundimin se lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga gjykata palës së interesuar, nuk e ndërpret ecjen e afatit të parashkrimit të së drejtës për të kërkuar ekzekutimin. Vetëm kërkesa për ekzekutim që i paraqitet përmbaruesit gjyqësor është mjeti që ndërpret parashkrimin.

Parashkrimi i ndërprerë fillon të ecë përsëri që nga dita që vendimi i pushimit të ekzekutimit, i marrë nga përmbaruesi gjyqësor, ka marrë formën e prerë, në rastin kur kreditori heq dorë me shkresë nga ekzekutimi ose kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit pasuri të debitorit, ose kur sendi i sekuestruar nuk është shitur dhe kreditori nuk ka pranuar ta marrë sendin kundrejt kredisë së tij. Në këtë rast kreditori ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutimin brenda kohës së parashkrimit (neni 617/3 i K.pr.c.).

Sipas neni 131/a të Kodit civil, parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të personit fizik ose juridik të detyruar që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës së kreditorit. Sipas punimit "Procedura civile" të A.Lamanit (faqe 266), kjo dispozitë vlen edhe për ndërprerjen e parashkrimit të një titulli ekzekutiv.

c – ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Në këtë kapitull, ekzekutimi i detyrueshëm është parë në pjesën më të madhe të praktikave të sistemeve ligjore europiane. Para së gjithash, u prezantuan parimet e ekzekutimit të detyrueshëm të përbashkëta për vendet e traditës kontinentale. Më pas, u shpjegua nocioni i titullit ekzekutiv dhe u renditën kërkesat e mëtejshme që duhet të plotësohen për fillimin e procedurave te ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Ekzekutimi monetar është analizuar me detaje, ndërsa, për ekzekutimin jomonetar dhe, në veçanti, për ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar dhe për

ekzekutimin e detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar janë dhënë disa prej rregullave dhe parimeve më kryesore.

Më poshtë po japim disa ushtrime që propozohen në këtë pjesë për testimin e njohurive për ligjin shqiptar të ekzekutimit të detyrueshëm dhe për të kuptuar më mirë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes modelit shqiptar dhe sistemeve më kryesore europiane.

Procedurat e ekzekutimit

1) Paraqitni strukturën e sistemeve më kryesore të ekzektutimit të detyrueshëm, si dhe kriteret e klasifikimit të tyre duke e vendosur modelin shqiptar në një prej këtyre klasifikimeve dhe duke dhënë arsyet përkatëse për këtë zgjedhje.

Titulli ekzekutiv dhe kërkesat e mëtejshme që duhet të plotësohen për fillimin e procedurave të ekzekutimit

1) Paraqitni nocionin e titullit ekzekutiv sipas ligjit shqiptar

2) Në ç' moment bëhet i ekzekutueshëm një vendim gjyqësor? Shpjegoni nëse ligji shqiptar parashikon ndonjë formë të ekzekutimit provizor të vendimeve gjyqësore dhe, nëse po, në cilat raste.

3) Cila është radha e ekzekutimit dhe, sipas Kodit shqiptar të procedurës civile, cili është organi kompetent për caktimin e saj?

4) Përshkruani etapat kryesore të ekzekutimit të një instrumenti të detyrueshëm sipas ligjit shqiptar, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet me sistemet e tjera europiane të traditës kontinentale.

5) Renditni kushtet, përveç titujve ekzekutivë, që duhet të plotësohen sipas Kodit shqiptar të procedurës civile, për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe provoni të krahasoni nga ky këndvështrim sistemin shqiptar me sistemet e tjera të përshkruara në këtë kapitull.

Ekzekutimi monetar

1) Shpjegoni karakteristikat kryesore të ekzekutimit monetar sipas ligjit shqiptar në raport me sistemet e tjera të traditës europiane.

2) Shpjegoni se ku parashikohet në sistemin shqiptar (si në shumë prej sistemeve europiane) parimi që garanton se të gjitha sendet e debitorit u nënshtrohen masave të ekzekutimit nga debitorët ose për përfitimin e tyre.

Ekzekutimi jomonetar

1) Ekzekutimi specifik: Në cilat raste mund të kryhet ekzekutimi specifik i detyrimit për dorëzimin e një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm?

2) Cila është mënyra e ekzekutimit të detyrimeve për 'kryerjen' ose 'moskryerjen' e një veprimi sipas ligjit shqiptar? Bëni dallimin ndërmjet rasteve kur detyrimi mund të përmbushet nga një person tjetër dhe kur kjo gjë është e pamundur. Identifikoni rregullat e parashikuara në Kodin e procedurës civile për të dyja rastet.

d - LEXIME PLOTESUESE DHE BIBLIOGRAFI

Sa i takon ligjit për ekzekutimin e detyrueshëm, sugjerohet të lexohen kapitujt që u kushtohen procedurave të ekzekutimit në tekstet e mëposhtme:

- *CAPPELLETTI, FERILLO:* Civil procedure in Italy (Procedura civile në Itali), *1965.*
- *HERZOG,* Civil procedure in France (Procedura civile në Francë), *1967.*
- *KERAMEUS, K.:* Enforcement proceedings (Procedurat e ekzekutimit), *Tuebingen, 2002.*
- *PELAYA Y-F,* Civil procedure in Hellas (Procedura civile në Greqi), *1995.*

Lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm në ligjin italian, mund t'u referoheni veprave të cituara në kapitullin 2.

e - FJALORI TERMINOLOGJIK

Ekzekutim i detyrueshëm = Ekzekutimi i një detyrimi që rrjedh nga një kontratë, një vendim ose drejtpërdrejt nga ligji, me ndihmën e autoriteteve publike ose nëpërmjet sekuestros.

Titull ekzekutiv = Akte që lejojnë përfituesit e tyre për të përdorur ekzekutimin e detyrueshëm.

Ope legis = në bazë të ligjit - sipas ligjit.

Confessus pro judicato habetur = Kush pranon fajin do të trajtohet si fajtor.

In invitos = kur kryen ose pëson një veprim kundër vullnetit tënd (i detyruar ose i shtrënguar).

In volentes = një veprim i kryer në mënyrë të vullnetshme.

f - UDHËZIME PRAKTIKE:

1. Ndonjëherë, ekzekutimi konsiderohet si pjesa me më pak vlera intelektuale e sistemit ligjor, si diçka që i përket stafit administrativ dhe specialistëve të rëndomtë. Por, një sistem joefikas i ekzekutimeve mund të anulojë efektet e vendimeve gjyqësore më të kualifikuara dhe mund t'i kthejë normat materiale në fjalë boshe. Drejtuesit e zyrave gjyqësore duhet t'i kushtojnë vëmendje shumë të madhe lehtësimit të punës për ekzekutimet e detyrueshme.

SHTËPIA BOTUESE & SHTYPSHKRONJA
"KRISTALINA-KH"
Rr. "Lord Bajron"
Tel.: ++355 04 356928;
Cel.: 068 20 38373, Cel.: 069 20 38373
Tiranë/Albania